

ENVER HOXHA

VEPRA

39

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

**BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË
SHQIPERISË**



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

39

GUSHT 1968 – DHJETOR 1968

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1983

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 39-TË

Në vëllimin e 39-të të Veprave të shokut Enver Hoxha përfshihen dokumente e materiale të periudhës gusht-dhjetor 1968, pjesa më e madhe e të cilave botohen për herë të parë.

Në këto vepra analizohen probleme të rëndësishme të zhvillimit me sukses të revolucionit dhe të socializmit, probleme të jetës së brendshme të Partisë e të vendit dhe shtrohen detyra për të ecur me hapa të sigurt në ndërtimin e socializmit, për fuqizimin ekonomik e për rritjen e aftësisë mbrojtëse të atdheut.

Zhvillimi i vrullshëm ekonomik i vendit kërkonte punën vetëmohuese të klasës punëtore dhe të fshatarësisë kooperativiste për realizimin me sukses të planit të katërt pesëvjeçar, rritjen e mobilizimit dhe të hovit revolucionar të tyre. Të frymëzuara nga orientimet dhe direktivat e Partisë, edhe në këtë periudhë masat punonjëse, nën udhëheqjen e komunistëve, u përfshinë në lëvizje të gjera, duke shpërthyer në iniciativa të shumta krijuese dhe përballuan me sukses detyrat e ngarkuara.

Vend të dukshëm në faqet e këtij vëllimi zënë materialet që trajtojnë probleme të jetës së Partisë, të rritjes së rolit udhëheqës të saj, të historisë së Partisë së Punës, si një Parti e tipit leninist, besnike, e

vendosur ndaj mësimëve të marksizëm-leninizmit. Në fjalën e mbajtur para Konferencës së 17-të të Partisë të Tiranës, si dhe në fjalën e mbajtur më 16 tetor «Suksetet e Partisë janë vepër e gjithë komunistëve shqiptarë» e në bisedën e zhvilluar me punëtorë tipografë dhe me punonjës të Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste, me rastin e botimit të tekstit të Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë, shoku Enver Hoxha vë theksin në mjaft momente të rëndësishme për revolucionarizimin e jetës dhe të veprimtarisë së Partisë. Në vëllim pasqyrohen domosdoshmëria dhe lufta e mëtejshme që duhet të bëjnë organizatat-bazë dhe të gjithë komunistët për zbatimin e parimeve dhe të normave marksiste-leniniste të Partisë, për zhvillimin drejt e me konsekuencë të luftës së klasave dhe për ruajtjen e pastërtisë së radhëve të Partisë, për forcimin e lidhjeve të saj me masat dhe për drejtimin kolegjial.

Në materiale të këtij vëllimi tërhiqet vëmendja së një nga rrugët për revolucionarizimin e vazhdueshëm të udhëheqjes së Partisë në rreth e në bazë është edhe ngritja në përgjegjësi e të rinjve nga radhët e klasës punëtore, të kooperativistëve, të cilët duhen ndihmuar nga shokët me përvojë. Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi i ngushtë midis tyre janë një nga faktorët e rëndësishëm të formimit të udhëheqësve të rinj, për zhvillimin me sukses të luftës kundër burokratizimit të njerëzve, për rritjen e iniciativës së tyre. Po kështu, siç del në vëllim, një kusht tjetër i domosdoshëm për revolucionarizimin e organeve udhëheqëse të Partisë e të pushtetit, është edhe puna për mënjanimin e metodave dhe të qëndrimeve burokratike, që i largojnë nje-

rëzit nga puna krijuese, nga iniciativa e përgjegjësia. Mënjanimi i tyre arrihet kur kuadrot, drejtuesit vendosin lidhje të ngushta me bazën, kur ata luftojnë çdo ditë për përsosjen e metodës e të stilit në punë, për gjetjen e formave të reja të punës, të cilat duhet ta justifikojnë veten në praktikë për zbatimin e direktivave të Partisë. Shokët e organeve udhëheqëse të Partisë, vë në dukje shoku Enver Hoxha, duhet të kuptojnë gjendjen dhe zhvillimin e ri të shoqërisë sonë në gjithë dinamizmin e dialektikën e vet dhe në përputhje me to të gjejnë format e metodat e përshtatshme të punës, që kërkojnë situata dhe ky zhvillim.

Në kuadrin e thellimit të mëtejshëm të luftës ideologjike në të gjitha sferat e veprimtarisë shoqërore, në këtë vëllim trajtohen edhe probleme të revolucionarizimit të shkollës sonë. Në bisedën me shokun Ramiz Alia, në zbërthim të ideve të fjalës historike të 7 marsit 1968, shoku Enver Hoxha, midis të tjerash, thekson se sistemi i ri arsimor do të ndihmojë në rritjen e nivelit të përgjithshëm kulturor të popullit e veçanërisht të rinisë, sepse ata që do të dalin nga dyert e shkollës do të mbushin radhët e klasës punëtore e të fshatarësisë. Prandaj kërkohet që gjithë puna edukative e shkollës të synojë në përgatitjen sa më të mirë të tyre. Revolucionarizimi i vazhdueshëm i sistemit arsimor të shkollës sonë ka lidhje edhe me masivizimin e saj, pa lënë pas dore ngritjen e nivelit cilësor të arsimit tonë. Për këtë, veç të tjerave, tërhiqet vëmendja edhe në harmonizimin e studiuar të cikleve shkollore, si dhe hidhet ideja shumë e rëndësishme e kualifikimit pasuniversitar të kuadrove të lartë.

Një vend të rëndësishëm në këtë vëllim zë edhe trajtimi i problemeve të letërsisë dhe të artit tonë të realizmit socialist. Nga pozita të drejta e të qarta marksiste-leniniste shtrohen probleme kardinale të këtyre fushave, si për një raport më të harmonizuar midis temës historike dhe asaj aktuale, probleme të raportit midis së resë e të vjetrës, traditës e novatores dhe të lidhjeve dialektike midis tyre etj.

Mjaft artikuj e bisedat me të huaj përmbajnë probleme të gjendjes e të situatave ndërkombëtare. Nëpërmjet tyre shprehet qëndrimi i vendosur marksist-leninist i Partisë sonë në mbrojtje të forcave revolucionare, të proletariatit e të popujve lirishtës dhe në luftë të papajtueshme me imperializmin dhe me revizionizmin modern. Në raportin e mbajtur në Plenumin e 5-të të KQ të PPSH «Mbi gjendjen aktuale ndërkombëtare», shoku Enver Hoxha analizon thellë situatat ndërkombëtare, natyrën imperialiste dhe hegjemoniste të socialimperializmit sovjetik. Pushtimi fashist i Çekosllovakisë prej Bashkimit Sovjetik vërtetoi parashikimet largpamëse të Partisë sonë për natyrën thellësisht socialimperialiste e socialfashiste të Bashkimit Sovjetik.

Duke pasur parasysh këto kushte e situata Partia argumentonte domosdoshmërinë e daljes së vendit tonë nga Traktati i Varshavës. Ky veprim, drejtësinë e të cilit e vërtetoi koha, ishte shprehje e qëndrimit konsekuent marksist-leninist të Partisë sonë dhe, njëkohësisht, një qëndrim i drejtë e i studiuar politik në mbrojtje të interesave të atdheut e të popullit, në mbrojtje të lirisë e të pavarësisë së tij. Dalja nga Traktati i Varshavës do t'i rriste edhe më shumë autoritetin dhe

fuqinë mbrojtëse të atdheut dhe do t'u hiqte imperialistëve nga duart mundësitë për justifikime në rastin e një sulmi agresiv ndaj nesh nën petkun e një vendi të Traktatit të Varshavës.

Gjithashtu edhe në këtë periudhë Partia jonë shpreh qëndrimin e saj të matur, por të vendosur ndaj udhëheqjes kineze, duke vënë në dukje domosdoshmërinë e luftës së forcave revolucionare në të dy krahët, si kundër imperializmit, ashtu edhe kundër revizionizmit modern, pa u pajtuar kurrë me teorinë revizioniste kineze të mbështetjes të një superfuqi për të luftuar tjetrën.

Gjendja e popullsisë shqiptare që jeton në trojet e veta në Jugosllavi dhe qëndrimi armiqësor i klikës titiste ndaj saj gjejnë pasqyrim edhe në materiale të këtij vëllimi. Partia jonë ka shprehur edhe në këtë periudhë qëndrimin e saj marksist-leninist në mbrojtje të të drejtave legjitime të vëllezërve kosovarë.

Vëllimi i 39-të i Veprave të shokut Enver Hoxha do t'i njohë më nga afër masat tona punonjëse, komunistët e kuadrot me politikën e Partisë në këtë kohë dhe do t'i mobilizojë akoma më shumë për arritje të reja në stadin aktual të ndërtimit të socializmit.

DISFATA E REVIZIONISTËVE SOVJETIKË NË BRATISLAVË

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

10 gusht 1968

Përpara pak ditësh morën fund bisedimet e gjata e të vështira, që u zhvilluan në Çerna nad Tisu, në Sllovakinë Lindore, midis Byrosë Politike të KQ të Partisë revizioniste të Bashkimit Sovjetik dhe presidiumit të partisë revizioniste të Çekoslovakisë, si dhe takimi në Bratislavë¹ i delegacioneve të partive revizioniste të Bashkimit Sovjetik, Çekoslovakisë, Polonisë, Republikës Demokratike Gjermane, Hungarisë e Bullgarisë.

Në artikullin tonë të 24 korrikut², «Revizionistët sovjetikë dhe Çekoslovakia», ne e kishim parashikuar se udhëheqja revizioniste e Bashkimit Sovjetik, e zënë për gryke nga vetë tradhtia e saj, do të përpiqej të binte në kompromis me klikën e Dubçekut dhe, për të shpëtuar nderin, do të gjente një *modus vivendi*. Ne

1 U zhvillua më 3 gusht 1968.

2 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 38, f. 468.

paralajmëronim se i gjithë komploti i revizionistëve sovjetikë ndaj Çekosllovakisë, në fillim, për të likuiduar klikën e Novotnit dhe për sjelljen në fuqi të asaj të Dubčekut, përpjekjet e mëpastajme për rrëzimin e klikës së Dubčekut, me gjithë gamën e njohur të shantazheve, të synimeve të letrës famëkeqe të Varshavës, do të përfundonin në fazën e tretë me kurorëzimin e disfatës së revizionistëve sovjetikë, me vajtjen e tyre në Kanosa, e cila do të mbyllej me një komunikatë pompoze, se u arrit «kulmi i miqësisë së sinqertë e të pavdekshme në mes Bashkimit Sovjetik dhe Çekosllovakisë».

Tani nuk do t'ia vliente që ne të merreshim me analizën e një çështjeje të tillë të turpshme si mbledhja e Bratislavës, e cila është e zbuluar nga të katër anët. Por ne duam të vëmë në dukje se deklarata e të gjashtëve në Bratislavë është një nga dokumentet më hipokrite e më demagogjike të revizionistëve, e cila as mund të pajtojë grindjet e kacafytjet e së kaluarës midis tyre, as mund të evitojë degjencrimin dhe dezintegrimin e mëtejshëm të frontit revizionist.

Deklarata e Bratislavës, megjithëse përsërit me bollëk termat e njohur demagogjikë të revizionistëve për bashkëpunimin midis tyre për interesat dhe fatet e përbashkëta dhe megjithëse përmban edhe nënshkrimin e Dubčekut, konfirmon disfatën skandaloze të revizionistëve sovjetikë dhe të miqve të tyre.

Ndryshe as që mund të ndodhte. Kërcënimet e tyre ushtarake, presionet ekonomike e politike mbi grupin revizionist të Pragës, britmat hysterike të shtypit sovjetik etj., rezultuan se ishin një bluf i maskuar keq,

që plasi si një flluskë sapuni. Bisedimet në Çerna nad Tisu dhe në Bratislavë vërtetuan edhe një herë tjetër se revizionistët sovjetikë janë antimarksistë dhe shantazhistë të tërbuar.

Sundimtarët e Kremlinit u gjendën përpara faktit të izolimit dhe të braktisjes nga revizionistët italianë, francezë e të tjerë, që morën krahun e Dubçekut, gjë që vinte në rrezik mbledhjen e ardhshme të partive revizioniste në Moskë.

Në këto kushte, ata zgjodhën rrugën e mbledhjes së Bratislavës si të keqen më të vogël, megjithëse ajo duket sheshit se është një kapitullim i plotë. Ata po bëjnë tani përpjekje për ta paraqitur atë dhe deklaratën e Bratislavës si sukses, por ky është sukses i formulave. Të tillë terma e formula bajate ishin shprehur nga pjesëmarrësit e takimit në kryeqytetin e Sllovakisë jo shumë kohë më parë në Dresden, ishin thënë e stërt-hënë në deklaratat dhe në fjalimet gjatë takimeve zyrtare sovjeto-çekosllovake etj. Kush kishte, pra, nevojë përsëri për një «betim» tjetër solemn ndaj «socializmit e kampit socialist»?

Bratislava u duhej revizionistëve sovjetikë për të mbuluar disfatën e planeve të tyre, për t'u tërhequr disi me nder nga rruga pa krye ku u futën dhe për të shkëputur një deklaratë formale, që mund të përdorej si mjet propagandistik për konsum të brendshëm. Me se t'i përgjigjen ata popullit sovjetik, kur me të drejtë ai pyet se ç'u bë me letrën e Varshavës? Ata pranuan një zgjidhje me formula për të ecur së bashku, ashtu siç janë, me revizionistët çekoslllovakë dhe me revizionistët e tjerë, për të mos e acaruar më tej polemikën

dhe për të ruajtur sa të jetë e mundur fasadën «e unitetit të familjes socialiste».

Për opinionin e brendshëm të Bashkimit Sovjetik udhëheqësit hrushovianë nuk kanë harruar të vënë në deklaratë mjaft fraza të përgjithshme e bajate mbi rrezikun e imperializmit amerikan e atij botëror. Por revizionistët sovjetikë kot mundohen që flasin kundër imperializmit amerikan, mbasi ky e di fare mirë se zhurma që bëhet kundër tij, nga propaganda revizioniste sovjetike, në këtë rast, është sa për sy e faqe, për të gënjer naivët. Në Uashington dhe në vendet e tjera perëndimore e kanë plotësisht të qartë se në ç'kushte dhe për ç'qëllime u bë mbledhja e Bratislavës. Dhe amerikanëve nuk mund të mos u ketë pëlqyer rruga e Bratislavës, që zgjodhën sovjetikët. Nga çdo pikëpamje që ta shikosh Bratislavën duket qartë se ajo i ka shtuar pikat në favor të imperialistëve amerikanë dhe në dëm të revizionistëve sovjetikë.

Në radhë të parë, klika e Dubçekut mbeti e paprekur në fuqi dhe kjo u intereson imperialistëve. Në radhë të dytë, qarqet sunduese amerikane evituan tani në prag të zgjedhjeve presidenciale ngritjen e opinionit publik kundër tyre në rast se revizionistët sovjetikë do të ndërhyenin me forcë në Çekosllovakia. Ata nuk do të donin kurrë të detyroheshin të mbanin anën e ndonjëres palë, mbasi do t'u zbuloheshin kartat dhe shumë prej tyre mund t'u digjeshin. Në radhë të tretë, zgjidhja e Bratislavës u jep mundësi atyre të ruajnë aleancën sovjeto-amerikane dhe partnerin e tyre sovjetik. Në të njëjtën kohë, për shkak të disfatës që pësoi, Bashkimi Sovjetik nga mbledhja e Bratislavës doli më i dobësu-

ar. Pra, ai do të jetë një partner më i dobët i imperializmit amerikan në pazarllëqet dhe në komplotet e përbashkëta për sundimin e botës.

Kështu shpjegohet qëndrimi dashamirës që mbajten imperialistët amerikanë ndaj revizionistëve sovjetikë, gjatë ngjarjeve të fundit në Çekosllovakia. Din Rasku, disa herë gjatë këtyre ditëve të fundit, deklaroi publikisht se Çekosllovakia i takon sferës sovjetike të influencës, prandaj «u përket çekëve që t'i zgjidhin punët e tyre të brendshme». Zyrtarët amerikanë, vërtetonte agjencia UPI, e kanë këshilluar Çekosllovakinë «të pranojë vijën e paktit të Varshavës».

Nga Çerna dhe Bratislava grupi revizionist i Dubčekut doli i fituar dhe tani me përkrahjen e imperialistëve, të klikës së Titos dhe të revizionistëve të tjerë do të vazhdojë rrugën e shkëputjes së mëtejshme nga hegjemonia e revizionistëve sovjetikë dhe të ecjes drejt Perëndimit. Që tani po duket se Çekosllovakia po bëhet një pol tërheqës për ato grupe revizioniste, që nuk i binden më «shkopit të dirigjentit» në Kremlin dhe një qendër e re i kundërvihet bllokut të Moskës, i cili është në dekompozim të plotë.

Mbledhja e Bratislavës nuk i zgjidhi kontradiktat midis revizionistëve dhe as që mund t'i zgjidhte. Përkundrazi, ato u ashpërsuan dhe do të bëhen edhe më të thella, sa më shumë që afrohet kongresi i jashtëzakonshëm i partisë revizioniste çekoslovakike dhe mbledhja e nëntorit e partive revizioniste në Moskë. Klika e Dubčekut e ka thirrur kongresin për të stabilizuar më mirë pozitën dhe për të sanksionuar kursin e saj revizionist. Po edhe klika e Brezhnjev-Kosiginit nuk do të rrijë pa

lëvizur dhe të bëjë sehir si po shkallmohen pozitat e saj në Pragë. Si revizionistë që janë, udhëheqësit sovjetikë nuk mund të mos ëndërrojnë për revansh, nuk mund të rrinë pa intriguar, pa bërë presione e komplete kundër klikës së Dubçekut. Pra, kongresi i vjeshtës i partisë revizioniste çekoslllovakë do të jetë një fushë tjetër përleshjesh e kacafytjesh reciproke, që do të thellojë armiqtë e vjetra e do të shtojë të reja.

Ndërkaq, pas mbledhjes së Bratislavës akoma nuk dihet se ç'drejtim do t'i japin konferencës së ardhshme revizioniste të Moskës erërat që fryjnë tani në stanin revizionist. Udhëheqësit hrushovianë të Bashkimit Sovjetik e dëshirojnë dhe do të bëjnë çmos që ajo të mblihdhet, por ashtu siç kemi pasur rast të theksojmë edhe herë të tjera, ajo do t'u sjellë disfata të reja organizatorëve të saj. Ata mbas disa vjet përpjekjesh të ethshme dhe me shumë mundime ia arritën në fillim të këtij viti të bindnin disa parti të mëdha revizioniste që të merrnin pjesë në të, megjithëse nuk u arrit ndonjë marrëveshje për rendin e ditës. Pas ngjarjeve të Çekosllovakisë, shpërthimit të grindjeve midis grupeve të ndryshme revizioniste dhe rreshtimit të ri të tyre, ky problem kyç bëhet akoma më i komplikuar. Tanimë nuk mund të jetë vetëm supozim se edhe po të shkjojnë në Moskë, partitë revizioniste që i dolën krah Dubçekut nuk do të ndihmojnë në rivendosjen e hegjemonisë sovjetike në stanin revizionist, gjë që ka qenë një nga qëllimet themelore të udhëheqësve sovjetikë. Përkundrazi, ata tani kanë më shumë argumente t'u tregojnë kufijtë klikës së Brezhnjev-Kosiginit e shokëve të tyre dhe do të bëjnë çmos që edhe ajo influencë sovjetike që ekziston

akoma në disa parti e grupe revizioniste të dobësohet dhe të eliminohet.

Edhe vetë aleatët besnikë të revizionistëve sovjetikë vështirë e kanë ta marrin me entuziazëm udhën e Moskës për në konferencën e nëntorit. Loja e marionetave në Varshavë e në Bratislavë, së cilës ata iu nënshtruan, nuk mund t'i ketë lënë indiferentë ndaj fatit të vet. Në zhvillimin e ngjarjeve në Çekosllovakia, ata shohin edhe fatin e së ardhmes së tyre.

Tërheqja skandaloze e revizionistëve sovjetikë në konfliktin që patën me shokët e tyre çekoslovakë u jep kurajë dhe i nxit për aksion forcat ultrarevizioniste në ato vende, që qëndrojnë akoma të lidhura me Moskën dhe në vetë Bashkimin Sovjetik. Ato kanë gjithë inkurajimin e imperializmit botëror në përgjithësi dhe të Titos në mënyrë të veçantë. Nuk është e rastit që pikërisht këtë tel ngasin tani si gazetatat e Nju-Jorkut, ashtu dhe ato të Beogradit.

Procesi që filloi në Çekosllovakia dhe që e ka buri-min në vetë tradhtinë e krerëve sovjetikë nuk do të kufizohet vetëm këtu. Ne do të asistojmë në përleshje të tjera, në disfata të tjera edhe më të rënda për revizionistët sovjetikë, në grindje e në kacafytje akoma më të mëdha midis klikave revizioniste. Midis tyre nuk mund të ketë kurrë paqe, nuk mund të vendoset kurrë unitet, nuk mund të ketë kurrë besim reciprok. Ky është zhvillimi logjik i vijës së tyre tradhtarë. Lufta parimore dhe e vendosur e Partisë sonë të Punës dhe e partive të tjera marksiste-leniniste e ka demaskuar në mënyrë rrënjësore politikën tradhtarë të revizionizmit modern, që ka për qendër udhëheqjen revizioniste

sovjetike, dhe po shpejton shpartallimin e tij ideologjik e politik.

Situata që është krijuar tani në radhët e klikave revizioniste është e mirë për forcat marksiste-leniniste e revolucionare në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste. Ngjarjet e Çekosllovakisë dhe përleshjet e fundit midis klikave revizioniste, gafat e mëdha politike të udhëheqësve revizionistë sovjetikë dhe disfatat që ata pësuan nuk mund të mos shfrytëzohen në maksimum nga elementët e shëndoshë, bolshevikët dhe marksistë-leninistët revolucionarë për t'u treguar masave të gjera të popullit se çfarë armiqtë e tradhtarësh janë revizionistët e përfaqësuar nga klika Brezhnev-Kosigin, se sa dëme të mëdha ata i shkaktojnë çështjes së revolucionit dhe të socializmit në vendin e tyre dhe në gjithë botën.

Çdo qytetar sovjetik nuk mund të mos bëjë tani pyetjen: Ku është prestigji ndërkombëtar i Bashkimit Sovjetik, ç'u bë me autoritetin e madh të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që i patën dhënë Lenini dhe Stalini dhe luftërat legjendare të revolucionarëve sovjetikë? Përgjigjja nuk është dilemë. Populli sovjetik, komunistët sovjetikë, janë tradhtuar dhe po shtypen nga një klikë që me djallëzi ka uzurpuar frenat e vendit dhe e ka kthyer atdheun e Revolucionit të Madh të Tetorit në një vatër të kundërrevolucionit, në një fuqi imperialiste që thur plane komplotuese, grabitqare e agresive kundër popujve të tjerë në aleancë të ngushtë me forcat më të errëta të reaksionit ndërkombëtar me në krye armikun më të egër të njerëzimit, imperializmin amerikan. Vetëm përmbysja e saj me dhunë,

vetëm një revolucion i dytë proletar, mund t'i kthejë Bashkimit Sovjetik lavdinë e dikurshme dhe partisë së tij emrin e lartë të mëparshëm.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 191 (6230), 10 gusht 1968

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 172

**AGRESIONI IMPERIALIST I REVIZIONISTËVE
SOVJETIKË KUNDËR POPULLIT ÇEKOSLLOVAK
— NJË KRIM I SHËMTUAR NDAJ LIRISË
SË POPUJVE DHE SOCIALIZMIT**

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

24 gusht 1968

Një tragjedi e rëndë u luajt këta muajt e fundit me fatin e Çekosllovakisë nga revizionistët çekoslovakë, nga krerët tradhtarë të Bashkimit Sovjetik, nga imperializmi amerikan dhe nga reaksioni ndërkombëtar. Epilogu i saj është agresioni imperialist i revizionistëve sovjetikë dhe pushtimi ushtarak i territorit çekoslovak. Ato trupa, që njëzet e katër vjet më parë lanë me gjak rrugët e Pragës dhe ngritën flamurin e çlirimit, tani, të tradhtuara e të degjeneruara, hynë në qytetet dhe në fshatrat çekoslovake si pushtuese, si bartëse të një misioni të turpshëm të tipit fashist, të imponuar nga krerët tradhtarë revizionistë të Kremlinit.

Kjo është shumë tronditëse, por jo e papritur. Siç thuhet në Deklaratën e KQ të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH për agresionin e revizionistëve so-

vjetikë dhe të aleatëve të tyre kundër RS të Çekosllovakisë dhe popullit çekoslovak, tragjedia çekosllovake, e cila është njëkohësisht edhe tragjedia e Bashkimit Sovjetik, e Polonisë, e Hungarisë, e RD Gjermane dhe e Bullgarisë, e ka burimin në Kongresin e 20-të të PK të Bashkimit Sovjetik, që përmbysi vijën marksiste-leniniste të PK të Bashkimit Sovjetik të Lenin-Stalinit, duke e zëvendësuar atë me vijën revizioniste reaksionare hrushoviane dhe që çoi në gjallërimin e forcave revizioniste edhe në Çekosllovakia, që çoi në rrjedhime katastrofike në vetë Bashkimin Sovjetik dhe vuri në vështirësi gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Imperializëm, fashizëm, revizionizëm janë koncepte dhe rryma politike të ndryshme nga forma, por ato mbështeten në ideologjinë e përbashkët borgjeze të shfrytëzimit kapitalist dhe të shtypjes së popujve. Nga ato s'mund të lindë gjë tjetër përveç ndërhyrjeve në punët e brendshme të vendeve të tjera, agresionit e luftës. Çekosllovakia është rasti i fundit që vërteton këtë fakt tanimë të sprovuar.

Pretekstet e klikës renegate të Kremlinit për agresionin e saj të shëmtuar kundër popullit çekoslovak janë sa banale aq dhe cinike. Ajo pretendon pa pikë turpi se i dërgoi tanket e saj në Çekosllovakia në emër të Traktatit të Varshavës për të shpëtuar gjoja socializmin nga imperializmi dhe nga forcat kundërrevolucionare të brendshme. Për cilin socializëm mund të bëjnë fjalë udhëheqësit revizionistë sovjetikë, kur ata vetë e kanë tradhtuar prej kohësh këtë në vendin e tyre dhe kanë rivendosur kapitalizmin, kur po komplotojnë hap-tazi me imperializmin amerikan kundër socializmit dhe

lirisë së popujve për ndarjen e zonave të influencës dhe sundimin e botës nga dy fuqitë e mëdha?

Ndërhyrja e armatosur e revizionistëve sovjetikë në Çekosllovakë është pasojë e transformimit të Bashkimit Sovjetik në një shtet imperialist dhe e zbatimit në mënyrën më të hapët e më brutale të politikës shoviniste revizioniste të shtetit të madh. Ajo është rezultat i degjenerimit politik e ideologjik të këtyre udhëheqësve tradhtarë, që po kalojnë nga njëra aventurë në tjetrën.

Invadimi i tyre ushtarak në Çekosllovakë është agresion imperialist me të gjitha karakteristikat. Ata morën nëpër këmbë dhe shkelën në mënyrë brutale jo vetëm parimet socialiste, por edhe të drejtën elementare ndërkombëtare e dolën përpara gjithë botës me fytyrën e tyre të vërtetë, si përfaqësues tipikë të politikës imperialiste nga pozitat e forcës.

Krërët revizionistë të Kremlinit dërguan ushtritë e tyre në Pragë, për të vendosur ligjin dhe hegjemoninë e vet të fuqisë së madhe, për të rrëzuar një klikë revizioniste që nuk kërcente sipas daulles së Moskës dhe për të ngritur në këmbë një tjetër që ua mban mirë avazin. Ushtritë sovjetike, që pushtuan tani Çekosllovakinë, ashtu siç veprojnë edhe në Poloni, në Hungari apo në RD Gjermane, kanë për mision të sigurojnë atje influencën e pakundërshtueshme të fuqisë së madhe revizioniste sovjetike.

Dhe këtë agresion fashist, që është një krim monstruoz kundër popullit çekosllovak, kundër lirisë e pavarësisë së popujve dhe çështjes së socializmit, klika tradhtarë e Brezhnjev-Kosiginit dhe partnerët e saj

deklarojnë se e bëjnë në emër të Traktatit të Varshavës. Kjo vërteton edhe një herë tjetër se Traktati i Varshavës ka pushuar prej kohësh së qeni një pakt mbrojtës i vendeve socialiste, se ai nuk i shërben më, aspak, qëllimit të tij origjinal të mbrojtjes kundër revanshizmit gjermanoperëndimor, me të cilin të gjitha klikat revizioniste janë afruar e bëjnë pazarllëqe të shumta, të hapëta e të fshehta në dëm të socializmit. Kjo do të thotë, gjithashtu, se ai nuk i mbron as nga imperializmi amerikan, me të cilin klika tradhtarë e Moskës ka përfunduar një aleancë të gjithanshme kundërrevolucionare. Ai, ashtu siç e kanë deklaruar me kohë PPSH dhe Qeveria e RPSH, është kthyer në një vegël presioni, ndërhyrjeje e agresioni të më të fortit kundër më të dobët, të udhëheqjes revizioniste sovjetike kundër vendeve të tjera pjesëmarrëse në Traktatin e Varshavës.

Revizionistët sovjetikë i kryen shumë shpejt operacionet e tyre ushtarake në Çekosllovakë dhe plani i tyre operativ u realizua me përpikëri. Por «fitorja» ushtarake në Çekosllovakë do të jetë shumë e hidhur për ta. Në qoftë se mund t'u kishte mbetur diku ndonjëfarë prestigji, ai u zhduk tani, pas agresionit të tyre në Çekosllovakë. Edhe ato parti revizioniste të vendeve kapitaliste që deri më sot i janë bindur «shkopit të dirigjentit» në Moskë, tani, pas agresionit në Çekosllovakë, e kthyen fletën. Të detyruara nga opinioni i masave punëtore të revoltuara, ato po veçohen nga udhëheqja sovjetike dhe po e lënë ta konsumojë vetë corbën çekosllovake. Ato, jo vetëm që nuk u solidarizuan me veprimet sovjetike në Çekosllovakë, por janë

në hall të madh se si të fshehin përgjegjësinë e tyre për përkrahjen që i kanë dhënë vijës së Moskës dhe si të shpëtojnë shturjen e radhëve të tyre nga tronditja që u ka shkaktuar agresioni i revizionistëve sovjetikë. Në këto kushte ato do të kenë shumë pak qejf të shkojnë në konferencën e nëntorit në Moskë ku janë ftuar. Stani revizionist jo vetëm është tronditur, por mund të themi, tani ai është shpërbërë.

Ngjarjet e fundit në Çekoslovakia ua grisën edhe më shumë maskat e ndryshme që udhëheqësit revizionistë sovjetikë me të keq po mundoheshin t'i arnonin. Të gjithë tani kanë mundësi të shohin se politika që ndjekin udhëheqësit renegatë sovjetikë është një politikë imperialiste, se pushteti i tyre është një pushtet borgjez që shtyp popullin e vet dhe kërcënon të tjerët, se Bashkimi Sovjetik është shndërruar në një qendër të kundërrevolucionit, kundër socializmit dhe lirisë e pavarësisë së popujve. Të gjithë kanë mundësi të shohin se cilat janë qëllimet e revizionistëve sovjetikë dhe metodat e tyre fashiste të ndërhyrjeve dhe të shtypjes së popujve.

Popujt e botës nuk mund të mos shohin se ekziston një komplot imperialisto-revizionist i kurdisur mirë kundër lirisë së popujve, se ekziston një plan i koordinuar sovjeto-amerikan për ndarjen e zonave të influencës midis dy fuqive të mëdha. Agresioni kundër Çekoslovakisë është produkt i drejtpërdrejtë i bashkëpunimit kundërrevolucionar sovjeto-amerikan, i strategjisë së tyre globale të ndërhyrjeve në punët e brendshme të shteteve të tjera, i agresioneve dhe i përpjekjeve për sundimin e botës.

Situata për popullin çekoslovak, tani, pas ndërhyrjes së revizionistëve sovjetikë, u bë edhe më e rëndë. Ai u tradhtua nga jashtë dhe nga brenda, mbi kurriziu vu edhe një zgjedhë tjetër. Klikat e ndryshme revizioniste, secila për interesat e saj të ngushtë, kërkojnë ta heqin për hunde dhe ta bëjnë për vete. Por ai nuk mund të mos e shikojë tradhtinë e madhe që iu bë atdheut të tij dhe socializmit në Çekoslovakia. Dubçeku dhe klika e tij, që kapitulluan përpara pushtuesve, nuk mund të mbronin një socializëm që e kishin tradhtuar dhe një atdhe që e kishin shitur prej kohësh. Këtë nuk mund ta bëjnë as kolaboracionistët e rinj të pushtuesve revizionistë, që do të vijnë pas tankeve të agresorëve dhe që fshihen prapa bajonetave të tyre.

Atdheun dhe socializmin mund t'i mbrojnë vetë populli çekoslovak, klasa punëtore dhe komunistët e vërtetë çekoslovakë. Populli çekoslovak i priti me urrejtje dhe me indinjatë të thellë pushtuesit e vendit të tij. Ai po i shpreh këto me zemërim të madh në demonstratat dhe në protestat që janë zhvilluar këto ditë anembanë Çekoslovakisë, në bojkotimin dhe në izolimin e plotë të trupave të revizionistëve sovjetikë, në grevat e shumta dhe në format e ndryshme të luftës kundër invaduesve.

Populli çekoslovak ka tradita të mëdha revolucionare e liridashëse dhe ai nuk do të mund të durojë të merret nëpër këmbë, të shtypet e të torturohet nën zgjedhën revizioniste. Është e vërtetë se deri më sot, për shkak të tradhtisë e të goditjeve nga brenda e nga jashtë, ai ka qenë i hutuar dhe i dezorientuar. Por tanimë ai nuk mund të rrijë pasiv dhe të bëjë sehir se si

në qytetet dhe në fshatrat çekosllovake revizionistët sovjetikë dhe veglat e tyre hedhin vallen e pushtesve, të rrijë duarlidhur kur shikon se si vendi i tij po bëhet gur shahu në lojën imperialisto-revizioniste, kur nderi dhe dinjiteti i tij si komb e si popull po merren nëpër këmbë, kur socializmit në Çekosllovaki po i bëhet varri akoma më i thellë. Çdo hezitim në këtë situatë kritike që po kalon Çekoslllovakia mund të jetë fatal për të. Historia e popullit çekoslllovak ka pasur edhe raste të tjera kur ai ka hezituuar dhe këtë e ka paguar shtrenjtë. O sot, o kurrë duhet vepruar dhe duhet luftuar me vendosmëri e me abnegacion me të gjitha mjetet dhe me të gjitha mënyrat kundër pushtimit të revizionistëve sovjetikë. Me lutje e me peticione armiku nuk mund të mposhtet. Kur ai të vjen në shtëpinë tënde me pushkë, duhet dëbuar po me pushkë.

Me ndërhyrjen e armatosur në Çekosllovaki, klika hrushoviane u vuri një njollë tjetër të madhe Bashkimit Sovjetik dhe ushtrisë sovjetike, u dha një goditje të rëndë nderit dhe emrit të popullit sovjetik. Por ne kemi besim se populli sovjetik, ushtria sovjetike, bolshevikët sovjetikë jo vetëm që nuk do ta aprovojnë veprimin e shëmtuar të atyre që kanë uzurpuar pushtetin dhe që tradhtuan idealet e Revolucionit të Tetorit dhe veprën e lavdishme të Leninit e të Stalinit, por do të veprojnë me guxim e me trimëri për ta larë vendin e tyre nga ky turp i ri që klika e Brezhnjevrit dhe e Kossigininit i hodhën përsipër. Ata do të merrnin mbi vete një përgjegjësi të madhe përpara historisë në qoftë se do të lejonin më gjatë që klika uzurpatore ato armë, që populli i ka prodhuar për të mbrojtur vendin e vet, t'i

përdorë për të shtypur popujt e tjerë vëllezër, që ushtarët sovjetikë, pasardhësit e heronjve që shkatërruan nazizmin dhe çliruan Pragën, Berlinin, Varshavën, Bukureshtin, Budapestin etj., të venë atje si agresorë e pushtues, që Bashkimi Sovjetik, i cili dikur ishte kësh-tjellë e socializmit dhe e lirisë së popujve, të kthehet në një qendër imperialiste dhe reaksionare, në një aleat të imperializmit kundër lirisë e pavarësisë së popujve, kundër socializmit dhe revolucionit.

Populli shqiptar denoncon me indinjatë pushtimin e Çekosllovakisë nga trupat e revizionistëve sovjetikë e të tjerë dhe dënon me forcën më të madhe këtë agresion kriminal të pafalshëm.

Deklarata e Komitetit Qendror të PPSH dhe e Qeverisë së RPSH mbi agresionin e revizionistëve sovjetikë dhe të aleatëve të tyre kundër Çekosllovakisë shpjegon në mënyrë të thellë marksiste-leniniste bazat dhe burimet e ngjarjeve çekosllovake, vë gishtin në plagë dhe denoncon hapur agresorët revizionistë dhe logjikën e tyre të agresionit e të tradhtisë.

Me ndjenjën e përgjegjësisë më të madhe përpara popullit tonë, përpara socializmit e revolucionit, përpara vetë historisë, komunistët shqiptarë, populli shqiptar shprehin qëndrimin e tyre të drejtë revolucionar, parimor dhe konsekuent ndaj ngjarjeve të Çekosllovakisë, ndaj fateve të socializmit e të popujve në vendet revizioniste.

Ai është qëndrim i një partie dhe i një populli që kanë eksperiencë të madhe fitimtare në luftën kundër revizionizmit modern, që kanë paralajmëruar me kohë për pasojat e tanishme katastrofike në vendet ish-so-

cialiste të Evropës Lindore, që kanë qenë, janë dhe do të jenë kurdoherë përkrah popujve vëllezër të këtyre vendeve, sinqerisht e deri në fund si në ditë të mira ashtu edhe në të këqija.

Ne e denoncojmë dhe e dënojmë agresionin imperialist të revizionistëve sovjetikë në Çekosllovakia në emër të socializmit, të internacionalizmit proletar e të lirisë së popujve, në emër të atyre idealeve të larta revolucionare që kanë frymëzuar dhe frymëzojnë luftën tonë të gjatë kundër imperializmit e revizionizmit. Ne kemi besim se komunistët revolucionarë, klasa punëto-re, gjithë populli çekoslovak nuk do të pranojnë pushimin skllavërues fashist revizionist të huaj dhe kapitullimin e udhëheqjes tradhtarë revizioniste çekoslllovakë, se ata në emër të lirisë, të socializmit e të marksizëm-leninizmit do të ngrihen në luftë revolucionare kundër pushtuesve revizionistë sovjetikë, kundër tradhtarëve të vjetër e të rinj revizionistë të brendshëm, kundër imperialistëve e reaksionarëve të çdo ngjyre, për të rivendosur lirinë e humbur dhe diktaturën e proletaria-tit. Në këtë luftë të re çlirimtare populli çekoslovak ka solidaritetin dhe përkrahjen e të gjithë popujve revolucionarë të botës dhe ai me siguri do të fitojë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 203 (6242), 24 gusht 1968

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 179

MBI GJENDJEN AKTUALE NDERKOMBËTARE

*Nga raporti i mbajtur në Plenumin e 5-të
të KQ të PPSH*

5 shtator 1968

Të dashur shokë,

Byroja Politike, në mbledhjen e saj të datës 3 shtator 1968, pasi shqyrtoi dhe analizoi gjendjen ndërkombëtare në përgjithësi e në veçanti evenimentet tragjike që ndodhën këto kohët e fundit në Republikën Socialiste të Çekosllovakisë, pasi studioi gjendjen politike, ushtarake dhe juridike të Traktatit të Varshavës, nën dritën e agresionit fashist të Çekosllovakisë nga ana e qeverisë sovjetike, polake, gjermanolindore, hungareze dhe bullgare, vendosi të thërresë në këtë sesion Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë dhe t'i parashtrojë për diskutim e për aprovim konkluzionet e arritura për këtë Traktat tashmë agresiv.

Para kësaj, dëshiroj të theksoj disa momente të ngjarjeve aktuale ndërkombëtare dhe detyrat që u dalin Partisë, popullit dhe pushtetit tonë në këto situata. Pikërisht denoncimi i Traktatit të Varshavës nga Re-

publika Popullore e Shqipërisë në këto momente politike shumë të favorshme dhe duke pasur nga ana jonë të gjitha të drejtat dhe arsyet politike, ideologjike, ligjore etj., do ta ngrejë akoma më lart prestigjin e Partisë, të popullit, të Qeverisë dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë në sytë e të gjithë popujve përparimtarë të botës. Nga ana tjetër, Republika Popullore e Shqipërisë, duke denoncuar këtë Traktat agresiv nga i cili ajo, *de facto*, ishte përjashtuar me kohë nga anëtarët revizionistë të Traktatit, forcon pozitat e saj dhe eviton një rrezik të mundshëm agresiv që ne me kohë e kishim parasysh në luftën tonë me revizionistët sovjetikë, rrezik ky që u vërtetua plotësisht në Çekoslovakia.

Unë dëshiroj të theksoj se, kur u nënshkrua Traktati i Varshavës (1955), ishte një situatë tjetër, e cila tani ka ndryshuar katërcipërisht, sepse që nga tradhtia e revizionistëve sovjetikë dhe e të tjerëve ka ndryshuar krejtësisht karakteri i këtij Traktati si politikisht e ideologjikisht ashtu edhe ushtarakisht.

Në kohën e nënshkrimit të Traktatit të Varshavës, domethënë pas vdekjes së Stalinit dhe para Mbledhjes së Bukureshtit, aty nga shkurti i vitit 1956, kur akoma nuk kishin dalë në dritë si duhet pikëpamjet revizioniste të grupit të Nikita Hrushovit, kishte shenja të dukshme të njëfarë nxitjeje drejt liberalizmit politik dhe ideologjik në Bashkimin Sovjetik dhe sidomos në drejtim të afrimit me revizionistët jugosllavë. Por, megjithëse në atë kohë revizionistët sovjetikë nuk kishin dalë hapur me tezat e tyre, momentet politike paraqiteshin të atilla që kërkonin nënshkrimin e Traktatit të

Varshavës, i cili u krijua për të ruajtur pavarësinë e të gjitha shteteve socialiste veç e veç dhe të kampit socialist bashkërisht, kundër agresionit imperialist dhe bllokut agresiv të NATO-s si dhe për mosndërhyrjen në punët e tyre të brendshme. Në këtë mënyrë nënshkrimi i Traktatit të Varshavës nga ne ishte i drejtë, progresiv, atë e lypte situata, prandaj Partia dhe Qeveria jonë e pranuan dhe e firmosën.

Por duhet thënë se Traktati i Varshavës për ne edhe atëherë ekzistonte vetëm në letër, marrëdhëniet ushtarake lidhur me mbrojtjen e vendit tonë, me furnizimin e armatimeve në kuadrin e këtij Traktati dhe marrëveshjet përkatëse bëheshin brenda dy shteteve, midis Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë, kurse për sa u përket çështjeve të tjera si anëtarë të Traktatit të Varshavës ne trajtoheshim me gjithë kuptimin e fjalës si figurantë. Në një gjendje të tillë ishin edhe vendet e tjera anëtare të Traktatit të Varshavës. Mundet që sovjetikët bënin edhe mbledhje të veçanta me pjesëtarë të tjerë të këtij Traktati pa pjesëmarrjen e Shqipërisë, por ne shikonim se mbledhjet e përbashkëta bëheshin krejtësisht formale, siç ishte, për shembull, mbledhja për të zgjedhur herë pas here sekretarin e përgjithshëm të komitetit politik konsultativ dhe komandantin e përgjithshëm. Pra, me një fjalë, Traktati i Varshavës nuk funksiononte si një organizëm kolektiv i vendeve anëtare.

Kur ne goditëm tradhtinë e madhe të revizionistëve sovjetikë dhe të të gjithë revizionistëve të tjerë modernë, atëherë u duk hapur qëndrimi armiqësor i këtyre tradhtarëve ndaj Partisë, Qeverisë dhe Republikës

Popullore të Shqipërisë në të gjitha drejtimet: në lëmin politik, ideologjik, ekonomik dhe ushtarak. Pra edhe Traktati i Varshavës për Partinë dhe për popullin tonë jo vetëm që nuk ishte më një mjet mbrojtës, por në të kundërtën, ai përbënte një kërcënim për lirinë dhe për pavarësinë e vendit. Në fakt, që në atë kohë, revizionistët ne na përjashtuan nga Traktati. Byroja Politike dhe Komiteti Qendror i Partisë sonë me kohë e kanë pasur të qartë këtë situatë politike dhe ushtarake të Traktatit të Varshavës, prandaj, me prishjen e marrëdhënieve me vendet revizioniste, gjithë mbrojtja jonë është ndërtuar në mbrojtje rrethore të gjithanshme, duke pritur çdo rrezik sulmi si nga vendet imperialiste, ashtu dhe nga ato revizioniste.

Në fakt, duke qenë të përjashtuar nga Traktati i Varshavës, ne kemi kundërshtuar gjithnjë veprimet e tij të padrejta, por vendet pjesëmarrëse asnjëherë nuk i kanë pranuar kërkesat tona. Ato mund të kenë marrë edhe ndonjë vendim të brendshëm e të na kenë përjashtuar nga Traktati i Varshavës, por edhe sikur të mos e kenë marrë këtë vendim të fshehtë, efektivisht ne ishim të përjashtuar.

Ngjarjet e fundit të Çekosllovakisë vërtetojnë atë që ne parashikuam me kohë, se Traktati i Varshavës nuk e ka më karakterin për të cilin ai u krijua. Të gjitha vendet pjesëmarrëse në të, ku në fuqi janë klikat revizioniste, me përjashtim të Rumanisë, sulmuan në mënyrë të fshehtë dhe fashiste Çekosllovakinë, pra e përdorën Traktatin e Varshavës si një mjet shtypjeje e skllavërimi kundër një vendi anëtar të këtij Traktati, ndodhi ajo që parashikonte Byroja Politike e Partisë

sonë, që u krijuan situata të tilla politike që ne ta denoncojmë këtë Traktat. Denoncimi i Traktatit të Varshavës në këtë situatë ndërkombëtare do të gjejë përkrahjen dhe aprovimin e plotë të të gjithë popullit shqiptar, të Partisë, si edhe të elementëve demokratë përparimtarë të botës dhe të marksistë-leninistëve të vërtetë, të cilët do ta aprovonjë këtë veprim politik të Republikës Popullore të Shqipërisë. Kështu do të forcohet mbrojtja jonë, do të rriten simpatia dhe autoriteti i Partisë, i Qeverisë dhe i Republikës Popullore të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, sepse në këto momente, kur revizionistët sovjetikë me urë në dorë po kërcënojnë edhe vetë vendet e Traktatit të Varshavës, ne ua përplasim fytyrës dhe demaskojmë botërisht dhe trimërisht aktet e tyre fashiste.

Por, a është në favorin tonë denoncimi i Traktatit të Varshavës në këtë koniunkturë ndërkombëtare? Në këtë situatë të krijuar nga revizionistët sovjetikë, në kushtet e acarimit të krizës që ka kapur vendet kapitaliste, kur forcohet gjithnjë e më shumë aleanca sovjetto-amerikane për të shtypur luftërat çlirimtare të popujve të botës, ne themi se ky denoncim është në favorin tonë. Ne mendojmë dhe gjykojmë se ekzistenca e Traktatit të Varshavës nuk luante asnjë rol pozitiv për mbrojtjen e vendit tonë, përkundrazi ishte një rrezik, që vazhdon të mbetet edhe pasi ta revokojmë këtë Traktat. Pra në këtë rast ne nuk humbasim asgjë. Edhe armiqtë e tjerë, imperialistët, gjithashtu, nuk lëshojnë, ata janë po ata, që kërkojnë të na sulmojnë dhe të na robërojnë, prandaj edhe në këtë drejtim asgjë nuk ndryshon. Për sa u përket rreziqeve dhe mbrojtjes së

vendit tonë, denoncimi i Traktatit të Varshavës nuk prish asgjë.

Deri dje, në teori, imperialistët amerikanë e miqtë e tyre mund të thoshin se nuk duhet ta godasim Shqipërinë pasi mund të vihet në lëvizje Traktati i Varshavës. Për ne ky supozim teorik s'ka asnjë vlerë se qenia ose jo e Shqipërisë në Traktatin e Varshavës nuk mund të ketë asnjë efekt për sa i përket strategjisë së NATO-s në Ballkan, prandaj në të dy rastet imperialistët mund të na sulmojnë.

Por, në këto koniunktura, merr rëndësi të veçantë revokimi i Traktatit të Varshavës nga ana e Republikës Popullore të Shqipërisë. Kur ne revokojmë Traktatin e Varshavës, vendet e NATO-s nuk mund të vënë përpara arsyetimin se «e sulmojmë Shqipërinë pse është anëtare e Traktatit të Varshavës», por do të sulmojnë një vend që nuk është anëtar i Traktatit të Varshavës, kështu u heqim këtë argument nga dora e tyre. Prandaj në të dyja tablotë denoncimi i Traktatit të Varshavës nuk cenon aspak çështjen e mbrojtjes së vendit tonë. Ky veprim është qind për qind në favorin tonë. Propaganda e revizionistëve modernë do të çirret se «Shqipëria u lidh tani me NATO-n» etj., por kjo nuk pi ujë asgjëkundi, ata le të lehin, siç kanë lehur deri tani, se me siguri do të demaskohen pa mëshirë nga jeta dhe nga qëndrimet revolucionare e të vendosura të Partisë dhe të popullit tonë. Prandaj, shokë, është mirë që këtë çështje me rëndësi të madhe ta diskutojmë dhe të vendosim.

Komiteti Qendror i Partisë është plotësisht në dijeni të zhvillimit të ngjarjeve në arenën ndërkombëtare

dhe në veçanti të ngjarjeve në Çekosllovakë e në vendet e tjera revizioniste. «Zëri i popullit» dhe i gjithë shtypi i vendit tonë kanë informuar me hollësi për ngjarjet, kanë mbajtur qëndrimet e duhura revolucionare për to dhe kanë bërë analiza të hollësishme për të sqaruar prejardhjen e veprimeve agresive tradhtare revizioniste, si ato të revizionistëve sovjetikë dhe të satelitëve të tyre agresorë, ashtu edhe të revizionistëve kapitullantë e tradhtarë çekosllovakë. Prandaj mendojmë se nuk është e nevojshme të trajtojmë kronologjinë e ngjarjeve.

Dëshiroj të ritheksoj atë që kanë parashikuar drejt Partia jonë dhe Komiteti Qendror i saj, krizën e madhe që vërtetohet dhe që thellohet çdo vit e më shumë në kampin e revizionistëve modernë. Të gjitha këto ndodhi dhe ato që do të vërtetohen në të ardhmen e që do të jenë akoma më katastrofike për revizionistët, janë rezultat dhe pasojë e tradhtisë së tyre ndaj marksizëm-leninizmit, është kursi kapitalist që ata morën në ideologji, në politikë, në ekonomi, në organizimin e partisë, të shtetit dhe të ekonomisë.

Likuidimi nga revizionistët sovjetikë dhe nga revizionistët e tjerë i fitoreve të socializmit në vendet e tyre, shndërrimi i partive marksiste-leniniste në parti borgjeze socialdemokrate, transformimi i ekonomisë në një ekonomi kapitaliste sollën si rezultat të paevitueshëm ndryshimin e politikës së tyre të brendshme dhe botërore në një politikë shoviniste, shtypëse, fashiste, të sundimit me forcë e me terror mbi popujt e tyre, të ndryshimit të qëllimit të aleancave të ndryshme të arritura në mes tyre, në aleanca skllavëruese politike, eko-

nomike e ushtarake në favor të shtetit më të fuqishëm revizionist, që është Bashkimi Sovjetik, mbi satelitët e tij dhe, më në fund, të krijimit të aleancës sovjet-amerikane për ndarjen e sferave të influencës, për sundimin e botës nga dy fuqitë e mëdha, për luftën me armë dhe pa armë kundër lëvizjes komuniste ndërkombëtare, kundër socializmit dhe luftërave nacionalçlirimtare të popujve.

E gjithë kjo rrugë tradhtare e përshkuar nga revizionistët hrushovianë dhe shërbëtorët e tyre, që nga Kongresi i 20-të i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, është për ta plot disfata të bujshme e të pandërprera. Piramidat e vendosura prej tyre në këtë rrugë janë piramida me themele të lëkundshme e të kalbura, të vëna me përpjekje të mëdha e të dëshpëruara, që i kanë demaskuar plotësisht dhe përfundimisht jo vetëm në sytë e komunistëve revolucionarë, jo vetëm në sytë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, por edhe në sytë e të gjithë njerëzve të ndershëm të botës.

E gjithë kjo veprimtari e ethshme tradhtare e revizionistëve sovjetikë dhe e shërbëtorëve të tyre u zhvillua, kur është në proces e thellohet kriza e përgjithshme e kapitalizmit botëror, me imperializmin amerikan në krye. Pikërisht për ta shpëtuar kapitalizmin botëror nga kriza e rëndë dhe nga revolucioni, revizionistët hrushovianë dhe shërbëtorët e tyre ndërmorën rolin e tradhtarëve, të grevëthyesve të revolucionit e të luftërave nacionalçlirimtare të popujve, të maskuar me parullat e urryera «bota pa luftëra, bota pa armë», «bashkekzistencë paqësore» etj. Natyrisht në momentet e favorshme revolucionare, brenda krizës së madhe e

të përgjithshme të kapitalizmit botëror, kriza në vetë gjirin e revizionistëve modernë, të këtyre kapitalistëve të rinj, do të shtohet, do të thellohet dhe do të acarohet.

Në radhë të parë, revizionistët sovjetikë do të humbitnin hegjemoninë dhe kontrollin absolut politik, ideologjik dhe ekonomik mbi satelitët e tyre dhe mbi të gjithë krerët revizionistë të partive të ndryshme. Në këtë shpartallim të tyre, jo vetëm që do të influenconin ideologjia antimarksiste dhe format e reja që adaptoheshin, por imperializmi amerikan, në radhë të parë, dhe kapitalizmi botëror, secili veç e veç e të gjithë së toku, do të ndërmerrenin, siç ndërmorën, «ndërtimin e urave» për aktivizimin e minimumit të sundimit sovjetik, për aktivizimin e policentrizmit e të tendencave centrifugale nga Moska, për aktivizimin e liberalizimit të jetës në vendet ku sundonin revizionistët.

Revizionistët sovjetikë pësuan humbje kolosale prestigji, autoriteti dhe ekonomike në gjithë këtë zhvillim dhe sa më tepër që humbitnin, aq më shumë lidhej klika tradhtarë e Kremlinit me imperializmin amerikan, i cili nga aleancat me revizionistët sovjetikë kapërceu krizën indoneziane, atë domenikane, indopakistaneze, krizën me Francën e shumë të tjera.

Revizionistët sovjetikë janë në hall të madh se duan të kenë nën zap gjithë revizionistët e botës, për të cilët kanë aq shumë nevojë t'u mbajnë ison dhe të formojnë perden e tymit. Mbi të gjitha, revizionistët sovjetikë përpiqen të ruajnë hegjemoninë politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake mbi satelitët e tyre të Evropës.

Loja e madhe që luhet në Evropë është bashkimi i Gjermanisë. Ky është edhe synimi i Bonit dhe i imperializmit amerikan. Nga ana e tyre bëhen përpjekje që Republika Demokratike Gjermane të likuidohet pa luftë. Zhdukja e Republikës Demokratike Gjermane nga harta e Evropës dhe krijimi i Rajhut të ri, është epiqendra për ta likuiduar influencën sovjetike ndër satelitët e saj evropianë dhe për zhvillimin e marrëdhënieve të tyre miqësore me Bonin. Ofertat e Bonit po zënë vend në klikat revizioniste. Sovjetikët, Zhivkovi, Gomulka, Titoja, Ulbrihti vetë e të tjerë janë shumë sensibil në kreditë e shumta që marrin nga Boni, presin me gëzim turistët gjermanë. Këto bënë që Bashkimi Sovjetik, Jugosllavia dhe Rumania të lidhin marrëdhënie diplomatike me Bonin. Në këtë rrugë ishin gati edhe çekët e bullgarët, për të mos folur për hungarezët.

Revizionistët sovjetikë kanë frikë dhe nuk angazhohen të nënshkruajnë traktatin e paqes me Republikën Demokratike Gjermane dhe e sakrifikojnë këtë për hir të interesit të aleancës sovjeto-amerikane. Atëherë ç'i vënë përballë zgjidhjes së këtij problemi bazë? Sfumatura! Mbledhjen dhe propozimet e perealizueshme të Karlovi-Varit dhe shthurjen ideologjike në kampin e tyre, ose konferencën e ardhshme e të falimentuar të Moskës!

Në të tilla koniunktura ndërkombëtare plasi kriza çekosllovake, e cila ziente gati që prej një viti, krizë e brendshme e revizionizmit çekoslllovak, ku kishin futur duart deri në bërërl revizionistët sovjetikë, të cilën e kemi analizuar dhe faktet në përgjithësi na kanë dhënë të drejtë.

Klika e Dubçekut rrëzoi atë të Novotnit dhe mori kursin revan drejt Perëndimit. U prish ekuilibri strategjiko-ushtarak i mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik. Për sovjetikët Republika Demokratike Gjermane dhe Republika Popullore e Hungarisë gjendeshin të rrezikuara jo vetëm politikisht, por edhe ushtarakisht. Ngjarjet pra po precipitoheshin. Revizionistët sovjetikë, gjermanë dhe polakë gjendeshin në hall të madh. Në Poloni, në shembullin e Çekoslovakisë, filluan demonstratat kundër Gomulkës. Gjermanët e Ulbrihtit s'i përmbante gjë, ata pritnin sinjalin.

Klika e Dubçekut u rezistoi kundërshtarëve të tij në Dresden, të cilët u mbledhën më vonë në Varsnavë dhe i dhanë asaj ultimatumin që dimë dhe që shtypi i Partisë sonë e ka analizuar drejt, duke mbajtur qëndrim të vendosur e parimor.

Mbledhjet e mëvonshme të organizuara nga revizionistët sovjetikë dhe shërbëtorët e tyre në Çerna nad Tisu, në Bratislavë dhe në komunikatat e tyre që u lëshuan, ju i dini. Dini, gjithashtu, edhe për manovrat ushtarake të të pestëve të Traktatit të Varshavës brenda në Çekoslovaki e më vonë gjatë kufijve të saj, dini për vajtjen «triumfale» të Titos dhe të Çausheekut në Pragë. Ju jeni në dijeni për të gjitha këto nga shtypi ynë, i cili i komentoj gjerësisht në rrugën e vërtetë marksiste-leniniste.

Artikujt, komentet e shtypit tonë dhe të Radio Tiranës janë ndjekur me interesim të madh dhe kanë ngritur autoritetin e Partisë sonë, për qëndrimet e saj heroike, të vendosura, të drejta, marksiste-leniniste. Në mënyrë të veçantë brenda në Çekoslovaki ato kanë

bërë përshtypje të madhe për qartësinë dhe objektivitetin e tyre.

Sulmi fashist dhe pushtimi i Çekoslovakisë nga ana e revizionistëve sovjetikë, ia çorën krejtësisht maskën klikës së Kremlinit. Jo vetëm këto, por edhe metodat e përdorura, që nga presionet, shantazhet, të puthurat e Juda Iskariotit në Bratislavë dhe sulmi në befasi, në errësirën e natës, pa pasur asnjë fakt, qoftë edhe formal, që të arsyetonte ndërhyrjen brutale me armë, i japin kësaj ndërhyrjeje kuptimin e vërtetë që ka, fashiste, imperialiste. E njollosën prestigjin e Bashkimit Sovjetik si vendi i parë i socializmit!

Revizionistët sovjetikë me veprimtarinë e tyre armiqësore, duke punuar sistematikisht me një plan djallëzor, po e zhdukën atë kredi kolosale që ka fituar Bashkimi Sovjetik në sytë e botës si vendi i parë i socializmit. Kjo është humbja më e madhe që pësoi komunizmi dhe që do t'u duhet kohë, gjak e djersë komunistëve sovjetikë të vërtetë dhe të gjithë marksistë-leninistëve në botë për ta fituar përsëri. Për sa u përket vetë revizionistëve sovjetikë, ata e humbën edhe atë pak kredi që mund të kishin te revizionistët e vendeve të tjera dhe tek elementët e lëkundshëm oportunistë, pse i gjithë ky moçal, ky llum i komunizmit ndërkombëtar, megjithëqë në dukje nuk pajtohet me veprimet brutale dhe agresive të revizionistëve sovjetikë, nuk pajtohet me imperializmin dhe me hegjemoninë sovjetike. Ky llum është pjesë përbërëse e atij kapitalizmi kombëtar që synon të forcojë hegjemoninë e vet mbi të tjerët. Ky llum të paktën ëndërronte që revizionistët sovjetikë politikën e tyre të «bashkekzsis-

tencës paqësore» të mos e transformonin në një politikë brutale që të rrezikonte hegjemoninë e vendeve të tjera kapitaliste, te të cilët revizionistët janë shërbëtorë.

Prandaj, me pushtimin brutal të Çekoslovakisë ne shohim se gati të gjitha partitë revizioniste të botës, nga janë e nga s'janë, me Partinë Komuniste Franceze dhe Partinë Komuniste Italiane në ballë, po deklarohen haptazi kundër pushtimit me armë të Çekoslovakisë nga ana e revizionistëve sovjetikë. Përçarja në gjirin e revizionizmit modern, ashtu siç e kemi parashikuar, po thellohet, pavarësisht se ata nuk do t'i presin lidhjet me njëri-tjetrin dhe formalisht do t'i kurdisin përsëri. Por, sidoqoftë, baza e këtyre partive është krejt përtokë, e krimbur, e paqenë, e lëkundshme. Vetë borgjezia kombëtare e tyre do të bëjë kërdrinë në radhët e këtyre partive për ta dobësuar e për ta likuiduar edhe atë pak influencë relative që u kishte mbetur.

Partia Komuniste revizioniste e Bashkimit Sovjetik, të paktën për disa muaj, do të mbetet e vetmuar, e izoluar, do të ketë vetëm ato katër parti që e ndoqën në sulmin mbi Çekoslovakinë dhe disa sahanlëpirës të emigracionit *apatride*¹ dhe që «masë» kanë vetëm personin e tyre, e ideal të vetëm — rublën sovjetike.

Pra, ashtu siç parashikuam, konferenca revizioniste e Moskës u komprometua, por edhe sikur sovjetikët të arrijnë ta mbledhin atë, do ta bëjnë me kërcënime e me forcën e rublës, ajo do të jetë për të qeshur.

Mbi të gjitha sulmi i armatosur kundër Çekoslovakisë ka qenë një katastrofë për revizionistët sovjeti-

1 Frëngjisht — pa atdhe.

kë, një vetëvrasje. Është fakt se ky veprim është një grusht për politikën e tyre të «bashkekzistencës paqësore» dhe një dështim i paguar i politikës së tyre revizioniste liberale. Krahu i majtë revizionist në Bashkimin Sovjetik ose «konservatorët revizionistë», siç kërkojnë t'i quajnë, i detyruan liberalët të pushonin dhe këtu kanë luajtur kryesisht konsiderata të mbrojtjes strategjike dhe të prestigjit. U erdhi armiku në derë dhe thika në grykë.

Po flitet që në udhëheqjen aktuale revizioniste sovjetike do të bëhet ndryshimi i «gardës». Natyrisht kriza që ekziston në udhëheqjen revizioniste sovjetike do të thellohet. Por asnjë iluzion nuk duhet të kihet për ata që eventualisht mund të vijnë. Ata do të jenë si këta që mund të largohen, të gjithë janë puçistë revizionistë.

Por një ndryshim i «gardës» do ta zgjojë ca «Ivanin» që e ka zënë gjumi i rëndë. Nën presionin e ngjarjeve ai mund të fillojë disi të mendojë përse ngjasin këto dhe ç'duhet të bëjë. Kjo është ana pozitive e ndryshimeve që mund të bëhen. Ndryshimet do ta dobësojnë udhëheqjen revizioniste dhe do të nxitin rezistencën. Në gjirin e satelitëve, një ndryshim i «gardës» në Kremlin, mund të shkaktojë dhe duhet të shkaktojë ndryshime zhinxhir në mos përnjëherësh, gradualisht, në mos kudo, në disa.

Sidoqoftë, disa muaj më parë se të bëhej sulmi mbi Çekoslovakinë, krahu «i majtë konservator» mori masa ushtarake periferike për të siguruar «prapavijën» dhe «paravijën» e Bashkimit Sovjetik. Kështu që me këtë rast forcoi pushtimin në Poloni, në Republikën Demokratike Gjermane, dhe pasi pushtoi ushtarakisht

Çekosllovakinë, nga e cila trupat sovjetike nuk largohen, forcoi garnizonet në Hungari dhe në Bullgari, ku kontingjenti i ushtrisë sovjetike është veshur me uniformën e ushtrisë bullgare. E tërë kjo e diktuar nga frika e revizionistëve sovjetikë nga një shpartallim i plotë i satelitëve dhe nga shkëputja e tyre plotësisht nga Bashkimi Sovjetik dhe nga një shpërthim analog ose revolucionar brendapërbrenda në Bashkimin Sovjetik. Mund të bëjmë pra edhe hipotezën se i gjithë ky operacion mund të ketë pasur këtë objektiv.

Pra, ndërrohet ose jo «garda» në Kremlin, revizionistët sovjetikë i ka kapur një panik i madh, si brenda ashtu edhe jashtë dhe kanë vënë në plan të parë çështjen e mbrojtjes së kësaj situate edhe me armë, edhe duke pushtuar me armë Çekosllovakinë, edhe duke ditur e duke qenë të bindur se as polonezët, as gjermanolindorët dhe as hungarezët nuk janë dakord me ta. Situatat koniunkturale i bëjnë këta të jenë hëpërhë gjoja solidarë me këto veprime të sovjetikëve.

Pra këtej e tutje zgjidhja e çështjeve dhe e kontraktave që do të ashpërsohen e do të thellohen në mes revizionistëve sovjetikë dhe satelitëve të tjerë anëtarë të Traktatit të Varshavës, do të imponohen me forcë nga sovjetikët ose do të përfundojnë në përleshje me armë. Tjetër rrugë nuk ka për ta.

Shembulli më tipik për të gjithë satelitët e Bashkimit Sovjetik është Çekosllovakia. Ajo u pushtua, edhe të tjera janë pushtuar. Forcat e pushtimit sovjetik në Republikën Çekosllovake tash do të diktojnë ligjin atje, do të caktojnë udhëheqjen e partisë dhe të qeverisë çekosllovake. Kongresi i «Partisë Komuniste

Çekoslllovakë», në qoftë se ky do të bëhet, do të zhvillohet sipas direktivave të ardhura nga Moska. Çekoslllovakia, pra, u shndërrua në një koloni sovjetike. Kështu do të kthehet edhe Polonia, edhe Republika Demokratike Gjermane, edhe Hungaria, për të mos folur pastaj për Bullgarinë që është bërë me kohë e tillë. Kjo është rruga dhe këtë rrugë e ndryshojnë vetëm konfliktet e armatosura në mes të klikave, rrugë kjo që komprometon vetëm zgjedhën koloniale sovjetike, **ndërsa revolucioni proletar është mjeti më i mirë që i jep fund definitivisht kësaj tragjedie dhe intrige të kurditur nga imperialistët sovjetikë dhe imperializmi botëror.**

Prandaj momentet janë shumë të favorshme për marksistë-leninistët e vërtetë, për revolucionarët kudo në botë. Ata duhet të organizojnë dhe të hedhin popujt e tyre në rezistencë e në luftë të armatosur kundër revizionizmit modern si edhe kundër imperializmit.

Agresorët revizionistë sovjetikë pësuan disfatë të madhe dhe të turpshme me agresionin fashist që bënë kundër popullit dhe Republikës Çekoslllovakë. I gjithë opinioni botëror është ngritur kundër tyre. Veprimi i tyre është amoral, cinik, fashist. Ata nuk kanë asnjë bazë politike, ideologjike dhe ligjore ku të mbështeten. Të gjitha argumentimet e tyre për agresionin që kryen janë boshe dhe false. Tradhtarët e marksizëm-leninizmit dhe udhëheqësit e rrugës tradhtarë të revizionizmit nuk mund të akuzojnë revizionistët çekoslllovakë për tradhti ndaj marksizëm-leninizmit dhe për rrugë revizioniste.

Nuk mund, tradhtarët revizionistë sovjetikë, që janë partnerët, miqtë dhe aleatët politikë dhe ideologjikë të imperializmit amerikan, të akuzojnë revizio-

nistët çekoslovakë se shkojnë drejt aleancës së ngushtë me kapitalizmin botëror.

Nuk mund, tradhtarët revizionistë sovjetikë, që kanë bastarduar Partinë Bolshevike në një parti pa shpirt, në një parti pa norma leniniste, në një parti socialdemokrate që e mbajnë vetëm për emër e për të thënë se ekziston, të akuzojnë revizionistët çekoslovakë se po e shkallmojnë Partinë Komuniste Çekosllovake dhe po e shndërrojnë atë në një parti socialdemokrate.

Nuk mund, revizionistët sovjetikë, që po ndërtojnë vetë kapitalizmin në Bashkimin Sovjetik, duke shkallmuar socializmin me ligjet, me normat dhe me format organizative të tij, të akuzojnë revizionistët çekoslovakë se po ndërtojnë në vendin e tyre kapitalizmin, duke shkallmuar socializmin.

Nuk mund, revizionistët sovjetikë, që po marrin kredi kolosale nga kapitalizmi botëror, të akuzojnë revizionistët çekoslovakë pse marrin dhe kërkojnë të marrin kredi nga kapitalistët.

Nuk mund, revizionistët sovjetikë, që kanë lidhje diplomatike e lidhje të tjera me Bonin, të kërkojnë që revizionistët çekoslovakë të mos vendosin të tilla marrëdhënie me Bonin.

Mund ta zgjatim numrin e qëndrimeve të revizionistëve sovjetikë. Vetvetiu del pyetja dhe rezulton edhe përgjigjja: Ç'të drejtë politike, morale, ideologjike dhe juridike kanë revizionistët sovjetikë mbi revizionistët çekoslovakë? Ç'të drejta kanë që t'u kërkojnë atyre llogari dhe ca më keq akoma t'i sulmojnë me armë dhe të pushtojnë popullin dhe Republikën Çekosllovake? Asnjë të drejtë!

E gjithë kjo, pra, vërteton atë që kemi thënë se revizionistët janë tradhtarë, janë imperialistë, janë fashistë. Me këtë që bënë në Çekoslovakia, ata çorën çdomaskë, vërtetuan atë se për ata, ashtu si për fashistët, nuk ekziston as miqësi, as parime, as aleancë, as traktat, as demokraci, as liri, as pavarësi e sovranitet i popujve. Çdo gjë ata e shtypin, e marrin nëpër këmbë, e vënë nën çizme, me armë dhe me gjak.

Arsyetimi zyrtar revizionist sovjetik i agresionit kundër Çekoslovakisë është në vetvete një demaskim i madh për ta. Përveç të tjerave ata thonë sikur gjoja janë ftuar të ndërhyjnë në Çekoslovakia «nga personalitete çekoslovake», emrat e të cilëve nuk guxojnë t'i japin, pse e gjithë kjo mund të jetë një bluf, por edhe sikur të jetë ashtu, ata njerëz nuk mund të jenë veçse tradhtarë, spiunë të sovjetikëve, kolaboracionistë, kuislingë të urryer. Që të ndërhysh në një vend duhet të të kërkojë ndihmën zyrtare qeveria legale e atij vendi. Ata nuk i ftuan as qeveria çekoslovake, as presidenti i republikës, as Komiteti Qendror, as parlamenti. Të paktën Hitleri, kur sulmoi Çekoslovakinë, i mori me forcë firmën presidentit Hasha.

Pushtuesit revizionistë sovjetikë, kur ndërmorën këtë vepër, mendonin se që të nesërmen udhëheqja çekoslovake do t'u binte në gjunjë. Kjo udhëheqje revizioniste që kapitulloi në fakt, që i la kufijtë hapur dhe nuk dha urdhër të mbroheshin, kapitulloi për të dytën herë në Moskë dhe hyri në shërbim të pushtuesve. Por sovjetikët do të bëjnë përpjekje të mëdha për të gjetur njerëz të sigurt, qind për qind të tyre, me të cilët të formojnë të paktën një qeveri kuislinge hije

të qëndrueshme. Kjo do të jetë disfata tjetër e tyre e madhe. Me siguri ata do të gjejnë qojle dhe tradhtarë, por rezistenca nuk do të shuhet. Sovjetikët do të gjejnë ndonjë Kadar çek, por çështja do të zhvillohet ndryshe nga ajo e Hungarisë.

Akti i tyre barbar nuk do t'i lejojë të riorganizojnë, siç mendojnë revizionistët sovjetikë, Partinë Komuniste Çekosllovake, pa të cilën nuk mund të legalizojnë veprën e tyre fashiste. Por ata mund të arrijnë me zor të gënjejnë një pjesë, sa për të kapërcyer vështirësitë e para dhe për të lënë përshtypjen se «ndërhyrja ishte e nevojshme, shpëtimtare, çdo gjë u normalizua e vazhdon miqësia», dhe fillojnë shkëmbimet e delegacioneve me të përqafulara e me të puthura si të Judës. Por kjo asgjë nuk do të zgjidhë. Çdo ditë e më shumë situata në Çekosllovaki do të bëhet e vështirë për pushtuesit dhe e mirë për revolucionarët.

Marksistë-leninistëve të vërtetë çekoslllovakë do t'u duhet të organizojnë sa më parë Partinë Komuniste Çekosllovake marksiste-leniniste në ilegalitet, do t'u duhet të organizojnë frontin e rezistencës në baza parimore, por jo sektare, do t'u duhet të hedhin klasën punëtore dhe popullin çekoslllovak nga mbrojtja pasive aktuale, në mbrojtje aktive, me greva e me demonstrata, në goditje me armë dhe në organizimin e luftës partizane. Janë momente nacionale shumë të përshtatshme këto që mund të shfrytëzohen në kulm, pa prituri asgjë dhe nga askush. Bisedimet, tratativat, lëshimet ndaj pushtuesve, do të duhet të goditen pa mëshirë. Do të duhet të demaskohen shpresat për ndihmë nga ana e imperialistëve dhe të goditen ndërhyrjet e tyre,

si dhe agjentët e tyre, të cilët do të përpiqen në çdo etapë të marrin drejtimin e rezistencës.

Rezistenca pasive e çekoslovakëve është pozitive në fillim, por nuk zgjidh gjithçka. Kjo u jep kohë edhe pushtuesve të organizohen. Ata duan qetësi që të plotësojnë kusarinë dhe agresionin. Qetësia atyre u duhet edhe për opinionin e brendshëm në vendet e tyre, opinion të cilin ata e gënjejnë paturpësisht.

Prandaj revolucionarët marksistë-leninistë çekoslovakë duhet të kuptojnë rëndësinë e madhe që ka organizimi i rezistencës me armë në drejtim të ngritjes së opinionit në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste. Ata duhet të kuptojnë se prapavijat e pushtuesve revizionistë duhet të jenë në lëvizje, të shqetësuara dhe duhet t'u bëjnë presion udhëheqjeve tradhtarë të vendeve të tyre.

Bojkotimi i plotë i ushtrive pushtuese të revizionistëve është një taktikë e mirë dhe sa më i plotë që të bëhet aq më mirë do të jetë. Urrejtja kundër tyre duhet të rritet në popull. Ushtarët sovjetikë po të duan le të nxjerrin konkluzione. Njëkohësisht do të nevojitej të zhvillohet një propagandë sqaruese në radhët e ushtrisë së pushtuesve për të demaskuar revizionizmin modern, revizionizmin hrushovian, tradhtinë e udhëheqjes sovjetike, shkatërrimin e socializmit nga ana e tyre. U duhet thënë ushtarëve sovjetikë se kur ishte gjallë Stalini, ata shkuan si çlirimtarë në Çekoslovakë, kurse tani, që në krye të tyre kanë ardhur tradhtarët antistalinistë, këta vijnë si pushtues në Çekoslovakë. Një punë e tillë është e mirë dhe e domosdoshme të bëhet, por mendojmë se nuk do të jetë e mjaftueshme,

në rast se forcat pushtuese nuk do të goditen me armë dhe nuk do të hidhen jashtë kufirit të Çekosllovakisë, ndryshe ata nuk do të dalin andej.

Mbrojtja e Çekosllovakisë, siç e keni konstatuar, bëhet nga pozita të ndryshme. Pozita jonë si dhe e çdo partie tjetër me të vërtetë marksiste-leniniste është ajo më e drejta, revolucionarja, marksiste-leninistja, që mbron lirinë, pavarësinë, sovranitetin dhe socializmin e vërtetë në Çekosllovakë. Ajo lufton e demaskon nga rrënjët revizionistët pushtues, me ata sovjetikë në krye, imperializmin amerikan dhe borgjezinë kapitaliste botërore, si edhe revizionistët kapitullues çekosllovakë, të vjetër e të rinj, tok me borgjezinë reaksionare çekosllovakë.

Në krizën çekosllovakë u duk qartë se imperializmi amerikan dhe borgjezia kapitaliste botërore u lanë dorë të lirë sovjetikëve të vepronin. Ndërhyrja e tyre ishte një propagandë gazetareske, e sipërfaqshme. Marrëveshjet e fshehta sovjeto-amerikane në Kemp Dejvid dhe në Glasboro kanë ndarë zonat e influencës në mes dy superfuqive agresore për sundimin e botës dhe kanë përcaktuar me siguri strategjinë dhe taktikën e tyre të përbashkët. Kjo ka hyrë gjerësisht në veprim nën mbulesën e «bashkekzistencës paqësore». Këtë gjë nuk e vërtetojnë vetëm ngjarja e Çekosllovakisë dhe nënshkrimi i një sërë traktatesh dhe marrëveshjesh në mes SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik, por e vërtetojnë të gjitha qëndrimet antirevolucionare dhe tradhtarë të udhëheqjes sovjetike në lidhje me Amerikën Latine, me sulmin e Izraelit kundër vendeve arabe, po e vërtetojnë më së miri «bashkekzistenca» aq e përzemërt

dhe ndarja e zonave të influencës në mes amerikanëve dhe sovjetikëve në vendet arabe dhe në Lindjen e Mesme në përgjithësi, këtë e vërteton miqësia aq e përzemërt e Flotës së 6-të Amerikane dhe e flotës sovjetike që bashkëjetojnë në ujërat dhe në portet e Mesdheut si dy aleatë të ngushtë dhe të vërtetë që kanë të njëjtin qëllim, të mbajnë nën zgjedhë popujt e Mesdheut, t'i shfrytëzojnë ata brutalisht nga çdo pikëpamje, të shtypin me armë çdo lëvizje revolucionare të tyre.

Në luftën agresive fashiste që përgatitin të dyja fuqitë e mëdha imperialiste, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik, përpiqen, natyrisht, që t'u imponojnë vullnetin dhe politikën e tyre të gjithë pjesëtarëve respektivë të Paktit të NATO-s dhe të Traktatit të Varshavës dhe në rast pamundësie, këto do t'ua imponojnë me forcën e armëve dhe me presione të tjera. Këto dy shtete agresore imperialiste duan t'i kenë të qeta dhe nën varësinë e vet absolute të gjitha «prapavijat» botërore. A do t'ia arrijnë një gjëje të tillë? Koha do ta vërtetojë këtë, por për një kohë të gjatë kjo s'do të jetë e mundur, sepse kontradiktat në gjirin e tyre do të veprojnë dhe do të thellohen.

Klika revizioniste e Beogradit është treguar aktive në mbrojtjen e revizionistëve çekoslovakë dhe ka kundërshtuar pushtimin e Çekoslllovakisë. Tani Titoja është vënë përpara alternativave të rënda. Brenda në vendin e tij gjendja është rrëmujë dhe në këtë gjendje rrëmuje degjenerimi politik, ideologjik, nacionalist, atij i duhet të riorganizojë mbrojtjen e vendit, se tani nuk mund të llogaritet më në ndihmën e Kadarëve e të Dubçekëve me shokë. Sot Jugosllavia gjendet e rrethuar nga revizionis-

tët sovjetikë, të cilët diktojnë çdo gjë me forcën e armëve mbi satelitët e tyre të Traktatit të Varshavës.

Prandaj udhëheqjes jugosllave, sikundër deklaruan zyrtarisht vetë, u ka dalë si detyrë urgjente çështja e mbrojtjes së kufijve veriorë dhe lindorë të tyre. Organizimi i mbrojtjes jugosllave kundër çdo tentative invadimi të Jugosllavisë nga ana e sovjetikëve, është për ne në favor. Këto koniunktura ne duhet t'i ndjekim me kujdesin më të madh.

Është fakt se kërcënimi i kufijve të shtetit jugosllav nga ana e revizionistëve sovjetikë po bëhet më i dukshëm. Në rast se vërtetohet edhe invadimi i Rumanisë nga ana e sovjetikëve, atëherë kërcënimi për Jugosllavinë shtohet. Sidoqoftë invadohet ose hyn në «mënyrë paqësore» Rumania nën diktatin e Moskës, asgjë nuk e ndryshon kërcënimin e Jugosllavisë. Këtij kërcënimi mund t'i bëjë ballë vetëm rezistenca me armë e popullit jugosllav.

Përveç kësaj, politikisht, por edhe nga ana strategjike, Jugosllavia për NATO-n edhe pa qenë në të, në planet e saj strategjike konsiderohet si një pjesë e hapësirës mbrojtëse të NATO-s. Ky kufi tani rrezikohet dhe ka mundësi që dispozitat luftarake, strategjike, ofensive dhe të mbrojtjes së NATO-s për sektorin jugosllav, grek, të Mesdheut dhe të Adriatikut, të precizohen më shumë.

Këtu del çështja e përhershme e mbrojtjes së atdheut tonë. Ne vazhdimisht kemi qenë të rrethuar gjeografikisht nga armiq të egër, të pabesë, agresorë, fashistë dhe mbrojtja e atdheut tonë është parashikuar dhe ndërtuar që t'u bëjë ballë në çdo kohë, çdo agresori

ose grupi agresorësh. Një mbrojtje e tillë duhet të forcohet në kulm, për arsytet e shtimit të kërcënimit që përme nda më lart. Ne duhet të mbajmë kurdoherë parasysh kontradiktat në mes fqinjëve tanë në lidhje me Shqipërinë, kontradikta që veprojnë jo njëlloj në koniunktura të ndryshme dhe kur prishet ekuilibri i forcave në një sektor të caktuar, ose në shumë sektorë të botës.

Prandaj ne duhet të jemi plotësisht të gatshëm, vazhdimisht shumë vigjilentë, të ndjekim me kujdesin më të madh ngjarjet dhe të bëjmë deduksione sa më ekzakte për mbrojtjen tonë të gjithanshme nga të katër anët e kufijve, qoftë nga toka, qoftë nga deti, qoftë dhe nga ajri. Llogaritë e mbrojtjes sonë duhet të bëhen si kurdoherë të bazuara, kryesisht në forcat tona të armatosura, në forcën e armatosur të të gjithë popullit dhe në një luftë vendimtare dhe fitimtare deri në fund mbi të gjithë armiqtë tanë.

Në këto situata të ndërlikuara ndërkombëtare dhe veçanërisht në Evropën Qendrore, por sidomos në Ballkan, vigjilenca e popullit, e Partisë, e pushtetit dhe e Qeverisë sonë, duhet të jetë në kulm. Ne duhet të jemi të përgatitur më së miri për t'i bërë ballë çdo evenimenti, qoftë edhe të papritur. Asgjë nuk duhet të na gjejë në befasi dhe sidomos në drejtim të mbrojtjes së atdheut, së cilës duhet t'i kushtojmë edhe më shumë se çdo herë tjetër kujdesin më të madh.

Në Parti, në popull, në ushtri, të forcojmë e të kahlitim besimin e patundur në forcat tona, të ngremë në kulm patriotizmin, guximin, heroizmin në masat e gjera. Të gjitha këto duhet të lidhen ngushtë me një punë politike dhe ideologjike shumë të thellë dhe me një veprim-

tari praktike shumë revolucionare. Të gjithë njerëzit duhet të bëhen të ndërgjegjshëm për situatat e brendshme dhe ndërkombëtare, të jetojnë me këmbë mbi tokë dhe jo me ëndrra e supozime të kota. Çdo fjalë, çdo veprim, nga kushdo, duhet të maten dhe t'i shërbejnë vetëm interesit të Partisë, të popullit, të socializmit.

Puna politike dhe ideologjike e thellë, zbatimi me përpikëri të madhe dhe me disiplinë të hekurt i vijës dhe i normave të Partisë kudo, do të bëjnë që patriotizmi i masave të jetë i thellë e me kuptim të madh, që heroizmi i masave të mos jetë diçka individuale ose e përkohshme, por masive dhe e përhershme. Vetëm kështu zhduket nga njerëzit ndjenja e mburrjeve të sëmura që të lënë në baltë në momente të vështira, vetëm kështu zhduket ndjenja e frikës ose e panikut. Këto të këqija e kanë burimin e tyre te një punë politike e përciptë.

Kur themi se duhet të jemi të përgatitur plotësisht, duhet ta kuptojmë këtë çështje si nga ana politike, ideologjike e ushtarake, ashtu edhe nga ana ekonomike. Punët te ne, jo vetëm që duhet të vazhdojnë normalisht, në vijën e drejtë që na kanë caktuar Kongresi dhe Partia, por, duke qenë të ndërgjegjshëm për çdo situatë që krijohet e që sjell me vete edhe anët e mira, po edhe vështirësi të reja, ne duhet të organizojmë punën tonë akoma më mirë në çdo sektor. Asgjë nuk duhet të lëmë mangut, punën e sotme të mos e lëmë për nesër, se nesër kemi punë tjetër. Të punojmë me mend në kokë, me hov, me temp revolucionar. Të vëmë në lëvizje masat, të kemi besim në to, të kemi besim te kuadrot e rinj, të mos jemi sektarë ndaj tyre, t'i ndihmojmë, t'i korigjojmë kur bëjnë gabime, t'u japim

përgjegjësi në punë. Neve, brezit të vjetër, na bie detyra e shenjtë e Partisë ta bëjmë absolutisht drejt këtë gjë. Kur do ta bëjmë, në rast se nuk e bëjmë tani sa jemi gjallë e kemi mundësi të japim ndihmën dhe eksperiencën tonë në këtë çështje jetike për Partinë?

I madh e i vogël duhet ta ndiejë veten politikisht dhe praktikisht të mobilizuar plotësisht në punë për çështjen e madhe të atdheut tonë socialist. Më fort se kurrë duhet të shkëlqejë vitaliteti i çeliktë i Partisë dhe i popullit tonë; më fort se kurrë duhet të ngrihet vigjilenca revolucionare e Partisë dhe e masave ndaj çdo armiku e keqbërësi, të hapët ose të maskuar, të jashtëm dhe të brendshëm; më fort se kurrë ne duhet të punojmë që uniteti në radhët e Partisë dhe uniteti i Partisë me popullin të kaliten në kulm, nëpërmjet zbatimit të normave jetëdhënëse të Partisë dhe nëpërmjet zhvillimit të pandërprerë të luftës së klasave.

Situata e Partisë sonë, e vendit tonë, e popullit tonë, është jashtëzakonisht e fortë. Ta forcojmë këtë çdo ditë e më shumë, ky është i tërë qëllimi i jetës sonë, kjo është detyra jonë kryesore. Prandaj armiqtë kanë thyer dhe do të thyjnë kurdoherë kokën, ne do t'i shtypim ata për vdekje në rast se tentojnë të prekin Partinë tonë, popullin tonë dhe Republikën Popullore të Shqipërisë.

*Botuar për herë të parë
në «Dokumente kryesore të
PPSH», vëll. V, f. 416*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje
veprash), 1968-1970», f. 187*

**PO U SH TREMBËRUA POLITIKA MARKSISTE-
-LENINISTE MORËN FUND FITORET PËR ÇDO
VEND A POPULL, I MADH A I VOGËL QOFTË**

*Nga biseda me kryetarin e Misionit të Përhershëm
të Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit
të Jugut në Shqipëri*

16 shtator 1968

U gëzuam shumë që na erdhët në vendin tonë ju, përfaqësues i popullit luftëtar të Vietnamit të Jugut, që po lufton heroikisht me armë në dorë dhe vazhdimisht po fiton kundër barbarëve imperialistë amerikanë dhe satelitëve të tyre. Ne e pritnim prej kohësh ardhjen tuaj në Shqipëri, po vonesën e kuptonim lidhur me vështirësitë e luftës që po bëni.

Populli dhe Partia jonë me mendje dhe me zemër kanë qenë kurdoherë pranë jush, pavarësisht nga distanca e madhe në të cilën ndodhen vendet tona. Në luftën që bëjnë për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, në luftën e paepur kundër imperialistëve dhe revizionistëve modernë, populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës janë frymëzuar dhe nga lufta heroike e popullit tuaj, për të cilën edhe ne mburre-

mi dhe kemi një admirim të madh. Ne kemi besim të patundur në fitoren e popullit tuaj.

Është për këto arsye që ardhjen tuaj në Shqipëri e konsiderojmë si ardhjen e një luftëtari që vjen në gjirin e një populli vëlla, luftëtar edhe ky kundër të njëjtëve armiq, i vogël si populli juaj, por i papërkulur si dhe populli juaj. Populli shqiptar ka qenë sulmuar shumë herë si populli vietnamez, por armiqve u është përgjigjur kurdoherë me pushkë, i ka mposhtur ata dhe ka fituar. Me këto dua të them se, ashtu si populli juaj që ka parë t'i vërsulen mbi shpinë armiq të egër e të mëdhenj, të armatosur gjer në dhëmbë me armët më të fuqishme e moderne, edhe armiqtë e popullit shqiptar kanë qenë, gjithashtu, të mëdhenj e të armatosur gjer në dhëmbë, por ata as ne nuk na kanë mposhtur e kurrë nuk do të na mposhtin, as ju nuk do t'ju mposhtin dot.

Duke qenë deri në fund të vendosur për çështjen e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut, ne fituam mbi armiqtë tanë, ashtu si do të fitoni edhe ju, përderisa në luftën tonë ne udhëhiqemi nga marksizëm-leninizmi, ideologjia jonë e lavdishme dhe nga politika e drejtë nga e cila frymëzohen popujt tanë. Po u shtrembërua politika marksiste-leniniste, të jeni të sigurt se morën fund fitoret për ne, për ju dhe për çdo vend e popull tjetër, sado i madh që të jetë ai. Pikërisht te kjo politikë qëndron forca jonë, pse atje është sinteza e luftës së drejtë, e aleancave dhe e qëllimeve të drejta imediate e të perspektivës, të shikuara vetëm në prizmin e rreptë të marksizëm-leninizmit, të teorisë së Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit. Jashtë kësaj teorie rruga errësohet dhe vjen pastaj katastrofa. Marksizëm-leni-

nizmi përfaqëson ligjet e sprovuara të zhvillimit si të natyrës, ashtu edhe të shoqërisë, të vërtetuara nga eksperiencia e gjatë e luftës së përgjakshme të proletaria-tit dhe të popujve revolucionarë, nga përpjekjet dhe aspiratat e tyre.

Imperialistët, revizionistët modernë sovjetikë dhe të tjerë kudo që janë, përdorin çdo lloj maske për të fshehur qëllimet e tyre. Ata përdorin lloj-lloj manovrash, sloganesh dhe veshjesh, shfrytëzojnë çdo lloj situatash, por marksistët e vërtetë janë në gjendje t'i dallojnë ato. Pikërisht këtu qëndron forca e marksizëm-leninizmit që i ndihmon revolucionarët të mos ecin me sy mbyllur. Sigurisht, marksistët i marrin parasysh edhe situatat, i gjykojnë rrethanat dhe japin vlerësime se si duhet vepruar në këtë apo në atë rrethanë. Në situata të ndryshme imperialistët dhe revizionistët, duke bërë plane agresive, kanë dhe grindje. Në këtë apo në atë situatë imperialistët mendojnë se duhet vepruar kështu, revizionistët thonë jo, duhet vepruar në një rrugë tjetër. Rivaliteti do t'i çojë ata në një luftë të madhe, prandaj marksistët dhe gjithë popujt duhet të jenë shumë vigjilentë dhe të mos e nënvleftësojnë kurrë armikun.

Ju keni korrur suksese të mëdha në luftën tuaj dhe ne gëzohemi shumë për këtë, po gëzimi ynë më i madh do të jetë kur imperialistët amerikanë t'i hidhni në det dhe i gjithë Vietnami i Jugut të çlirohet plotësisht dhe të bashkohet me Vietnamin e Veriut.

Ne gëzohemi pa masë për sukseset e arritura, admirojmë e kemi besim të madh për luftën që bën veçanërisht populli i Vietnamit të Jugut. Lufta dhe rezistenca

e popullit tuaj dhe ndihma kolosale që i jep luftës suaj populli i Vietnamit të Veriut, përbëjnë pikërisht ato forca që i kanë shkaktuar humbje të mëdha imperializmit amerikan, fuqisë më të madhe imperialiste në botë.

Lufta e popullit tuaj ka vërtetuar shumë gjëra, e në radhë të parë se një popull, qoftë ai edhe i vogël, është i pamposhtshëm kur ka vendosur të luftojë deri në fitore kundër një armiku më të madh e shumë më të armatosur me armët më të fuqishme moderne. Shembulli juaj ka vërtetuar se lufta popullore fiton kurdoherë mbi luftën dhe strategjinë e imperializmit, fiton, gjithashtu, edhe mbi politikën dhe mbi të gjitha intrigat e tij dhe të lakenjve të tij si dhe të revizionistëve modernë. Këtë e vërteton vetë lufta e drejtë, parimore, e vendosur dhe e udhëhequr strategjikisht e taktikisht nga teoria e marksizëm-leninizmit.

Tani është e qartë për të gjithë se imperializmi amerikan ndodhet në një situatë shumë të vështirë politike, ushtarake dhe ekonomike. Ai është duke kaluar një krizë të madhe. Këtë, natyrisht, ia shkaktojnë një sërë faktorësh, veçanërisht rezistenca dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve të ndryshëm të botës, përfshirë këtu edhe lufta heroike e popullit tuaj. Imperializmi amerikan në krizë, pra, ka shumë armiç, bile të pamposhtur, popujt e të gjithë botës, të cilët kanë një fuqi kolosale që ai, megjithëse bën sikur nuk e ka parasysh, e llogarit mirë. Pikërisht forcës kolosale të popujve ia ka shumë frikën imperializmi amerikan dhe është kjo forcë që me siguri, në mos sot, nesër do ta mposhtë atë.

Në qendër të kësaj force kolosale qëndron marksizmi

zëm-leninizmi. Këtë ne nuk duhet ta harrojmë për asnjë çast, pse, po harruam këtë, atëherë humbëm busullën dhe po humbëm këtë, humbasim edhe ne. Dësh-tojnë e kurdoherë do të dështojnë të gjithë ata që humbasin busullën. Ata që futen në një pyll të ngatërruar pa pasur busullën përpara nuk mund të dalin dot prej tij, kurse ata që nuk futen në pyje të ngatërruara, ose edhe kur futen kanë me vete busullën, dalin lehtë prej tyre. Pikërisht imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë hrushovianë në aleancë dhe në rivalitet me njëri-tjetrin përpiqen që popujve, mark-sistë-leninistëve, t'ua heqin busullën nga duart ose për fare, ose të paktën t'ua çakërdisin, duke folur në mënyrë figurative, t'i prishin akrepat, t'i vënë pranë një magnet që, në vend të tregojë veriun, të tregojë jugun dhe pastaj t'i futin në pyll, nga i cili të mos dalin dot kurrë. Faktet kanë treguar që orvatje të tilla janë bërë gjatë historisë së lëvizjes komuniste ndërkombëtare, kur janë dukur ngritje dhe ulje revolucionare, vetëm se revolucioni kurdoherë ka ecur dhe ecën përpara, kurse kalbësirat janë spastruar.

Sipas pikëpamjes së Partisë sonë, imperialistëve amerikanë u kanë ardhur në ndihmë tradhtarët revizionistë sovjetikë dhe të gjithë revizionistët e tjerë, duke u shërbyer atyre gjithë zell. Të dyja palët synojnë të shuajnë luftën e popullit vietnamez e të çdo populli tjetër dhe të vendosin sundimin e tyre të egër në të gjithë botën. Ata janë demaskuar, kanë pësuar e kurdoherë do të pësojnë disfatë të madhe. Kohët që do të vijnë do t'i tregojnë botës akoma edhe më qartë fytyrën prej kriminelit të revizionistëve sovjetikë. Situata

që ata vetë e krijuan do të jetë vdekjeprurëse për ta, ajo po i çon dhe do t'i çojë në katastrofë. Çdo veprim i tyre politik, ekonomik, ushtarak është një veprim fashist, militarist, antipopullor, antisocialist që nuk mund të pranohet dhe jo vetëm kaq, po ai do të bëjë që të ngrihet gjithnjë e më lart rezistenca e popujve dhe lufta e tyre, e cila do të jetë e tmerrshme për ta. Ne kemi bindjen e plotë se në Bashkimin Sovjetik në mos sot, nesër do të ketë rezistencë, do të ringjallet Partia Bolshevike. Ne mendojmë se qysh tani revizionistët janë në krizë, prandaj katastrofa e tyre është e pashmangshme.

Pushtimi i Çekosllovakisë, që është një akt agresiv fashist me tërë kuptimin e fjalës, i ka futur një tjetër thikë të madhe prestigjit të dikurshëm të Bashkimit Sovjetik. Për këtë agresion ne nuk jemi aspak dakord me qëndrimin tuaj dhe të qeverisë së Vietnamit të Veriut, këtë ne e themi haptazi. Me ju ne nuk lëmë gjëra me dy kuptime, pse ju konsiderojmë shokë. Natyrisht, ju keni të drejtë të keni mendimin tuaj për këtë çështje, po edhe ne kemi mendimet tona. Ju i arsyetoni qëndrimet që mbani sipas pikëpamjeve tuaja, po edhe ne i arsyetojmë ato sipas logjikës sonë, prandaj dhe mbajmë qëndrime të ndryshme.

Si arsyetojmë ne për këtë çështje? Përse hynë ushtarakisht në Çekosllovakë revizionistët sovjetikë dhe të katër vendet e tjera pjesëtare të Traktatit të Varshavës? Ju deklaroni se ata «shpëtuan» Çekosllovakinë nga kundërrevolucioni që rrezikonte këtë vend me një invadim nga Perëndimi. Po pikërisht kjo është teza so-

vjetike. Le të supozojmë sikur ne, shqiptarët, jemi një popull i madh prej disa dhjetëra milionë njerëzish dhe ngaqë «jemi të fuqishëm», ta zëmë, nesër të sulmojmë Bashkimin Sovjetik ku jemi të bindur se atje është vendosur revizionizmi; ose të sulmojmë Republikën Demokratike Gjermane, se jemi të bindur që atje është duke u aktivizuar kundërrevolucionit ose pse rrezikohet të invadohet nga Gjermania Perëndimore, apo se revizionistët sovjetikë janë duke rrezikuar komunizmin në Gjermani; ose të gjithë e dinë se ne, shqiptarët, jemi në armiqësi politike dhe ideologjike të papajtueshme me revizionistët jugosllavë dhe, pse atje është vendosur revizionizmi, pse në fuqi është klika e Titos, ne ta sulmojmë ushtarakisht Jugosllavinë e kështu me radhë. Pra, në këto raste, çfarë do të thoshte qeveria e Republikës Demokratike të Vietnamit?

Po sikur revizionistët sovjetikë të sulmojnë Jugosllavinë, do të jeni dakord ju me këtë sulm? Sigurisht kushtet në Jugosllavi janë të njëjta si në Çekoslllovakë, bile revizionistët jugosllavë janë ca më të avancuar se ata çekoslllovakë, mbasi Titoja socializmin e ka shkelmuar prej kohësh.

Po le të largohemi nga Jugosllavia dhe të vijmë në Shqipëri. Radio Moska deklaroi para ca kohësh se gjoja me largimin e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, udhëheqësit shqiptarë e paskan shitur vendin tek imperialistët amerikanë, anglezë dhe te Greqia! Nesër, renegatët e Moskës, siç sulmuan Çekoslllovakinë, mund të sulmojnë edhe vende të tjera, pra edhe Shqipërinë. Do të jeni dakord ju me këtë sulm, të cilin ata do ta shpjegojnë se po e bëjnë «për të shpëtuar» Shqipërinë

nga «tradhtarët» e marksizëm-leninizmit? Është logjike kjo? Po të ndiqet logjika e revizionistëve sovjetikë, ata mund të veprojnë kështu kundër të gjitha vendeve që s'ndjekin kursin e tyre tradhtar. Po meqë e mora si shembull Shqipërinë, dua të shtoj edhe diçka: le të vijmë ta provojmë në Shqipëri revizionistët sovjetikë dhe revizionistët e tjerë anëtarë ose jo të Traktatit të Varshavës, po të duan le të vijmë ta provojmë, gjithashtu, Shqipërinë imperialistët amerikanë dhe aleatët e tyre të Traktatit të NATO-s, dhe kanë për të parë sa u vlen lëkura këtu.

Ne kemi armiq të egër, të cilët na kanë halë në sy. Ata e dinë kush jemi ne. Këtë e ka kuptuar mirë Titoja që na konsideron armiq të betuar. Ai dhe të tjerë thonë për ne se jemi «dogmatikë», por kjo nuk është e vërtetë, ne jemi marksistë-leninistë.

Partia jonë ishte e para që e demaskoi klikën e Dubçekut, dhe e bëri këtë në rrugë marksiste-leniniste. Po kush është Dubçeku? Ne kemi fakte që ai ishte njeriu i Brezhnjevrit dhe i Kosiginit, pse të dyja palët kanë qenë plotësisht dakord ta hiqnin qafe Novotnin. Mirëpo më pas Dubçeku u ktheu krahët ustallarëve të tij, revizionistëve sovjetikë, dhe ata, kur e panë se po u rrëshqiste nga dora, e sulmuan edhe udhëheqësin e ri revizionist çekoslllovak.

Sipas asaj logjike, edhe imperialistët paskan të drejtë të ndërhyjnë në Çekosllovaki a gjetkë, sepse atje edhe këta kanë njerëzit e tyre, kanë shtresat e tyre, të cilat dëshirojnë t'i mbrojnë! Sipas një arsytimi të tillë, atëherë kushdo paska të drejtë të sulmojë kufijtë e këtij apo të atij vendi. Jo, shokë, një arsytim

i tillë nuk është i drejtë, as marksist-leninist. Nuk është diçka kaq e thjeshtë kjo punë, siç po e paraqitin disa. Çështja duhet gjykuar ndryshe, mbi bazën e parimeve, të cilat në asnjë mënyrë nuk duhet të shkelen.

Nuk është, gjithashtu, i drejtë as arsyetimi i disave që thonë se meqë Bashkimi Sovjetik na «ndihmon», megjithëse ne e dimë ç'ndihmë jep, të pranojmë ndërhyrjen e tij ushtarake në Çekosllovakia dhe ca më tepër që thonë se ai «shpëtoi» Çekosllovakinë! Po sikur Kina të sulmonte Bashkimin Sovjetik çfarë do të thoshit ju vietnamezët, bravo Kina? Sigurisht që jo. Këto çështje kaq jetike për popujt nuk mund të zgjidhen me «arsyetime» të tilla, ato zgjidhen vetëm në rrugë të drejtë marksiste-leniniste.

Ne kemi një admirim të madh për rezistencën heroike të popullit të Vietnamit të Veriut, kemi një respekt të thellë për shokun Ho Shi Min, të cilin e njoh personalisht dhe e marr me mend si mendon ai për këtë çështje.

Ne po i ndjekim me vëmendje bisedimet që zhvillohni në Paris me përfaqësuesit e imperialistëve agresorë amerikanë. Partisë sonë edhe këto bisedime nuk i duken të drejta dhe mendon se nuk do të japin rezultat. Kjo është puna juaj, po ne si marksistë-leninistë e kemi për detyrë t'ua themi shokëve troç ato që mendojmë e ndiejmë pa mos na vajtur në mendje se ata do të na i marrin për keq. Ju thoni që çështjen e çlirimit të Vietnamit të Jugut do ta zgjidhë lufta, po njëkohësisht duhet bërë edhe ca politikë, edhe diplomaci. Po, por vendimtare, shokë, është lufta. Është e vërtetë që duhet bërë edhe politikë, po pasi të shihen pluset dhe

minuset e kësaj rruge, duke i gjykuar ato në mënyrë marksiste-leniniste.

Ne mendojmë se bisedimet e Parisit u interesojnë vetëm atyre që i nxitën, tradhtarëve revizionistë sovjetikë. Ato nuk i shërbejnë luftës çlirimtare të popullit vietnamez, pse nuk e dobësojnë imperializmin amerikan, klikën e Xhonsnit. Në qoftë se politika e kësaj klikë është bërë leckë, këtë e ka bërë lufta heroike e popullit tuaj dhe jo bisedimet e Parisit. Për mendimin tonë këto bisedime i kanë dhënë ca forcë presidentit Xhonson të cilit ato i interesojnë shumë. Ai po mban në Paris Harrimanin, diplomatit e tij më të madh, për të gënjyer opinionin publik ndërkombëtar me takimet që po bëhen atje nga një herë në javë. Këtë ai e bën për të lënë përshtypjen e rreme se gjoja nga ana e tyre po punohet për të arritur në një armëpushim në Vietnam. Kjo përshtypje u duhet për ta shfrytëzuar gjatë fushatës elektorale Hamfri ndaj Niksonit, i cili është kundër bisedimeve.

Po përse u hyjnë në punë revizionistëve sovjetikë këto bisedime? Për të shuar luftën e popullit tuaj. Një veprim i tillë do të shkaktonte krijimin e zjarreve të reja kundër vendeve të tjera të Azisë, do t'i linte dorë të lirë forcimit të imperializmit japonez, klikave anti-popullore të Indisë, të Indonezisë dhe të gjitha klikave reaksionare rreth e rrotull këtij pellgu, do të ndihmonte për forcimin e mëtejshëm të aleancave me të gjithë këta, do të konsolidonte sidomos aleancën tradhtare sovjetike me klikën e Xhonsnit. Revizionistët sovjetikë përpiqen me të gjitha mënyrat të arrijnë që bisedimet të përfundojnë pikërisht tani që klika e Xhonsnit është

të akoma në fuqi. Vetë Xhonsoni ka kaq vjet që po flet për bisedime, për të cilat kanë qenë dhe janë me të dyja duart revizionistët sovjetikë. Për këto arsye ne mendojmë se bisedimet e Parisit janë në interes të revizionistëve sovjetikë dhe të klikës së Xhonsonit. Ne përsëri këtu do të jemi dhe do të shohim se, edhe sikur klika e Hamfrit të fitojë, lufta në Vietnam do të vazhdojë, ju vetëm me armë do t'i hidhni në det agresorët amerikanë. Këto janë mendimet e Partisë sonë për bashkëbisedimet e Parisit.

Ju na folët këtu edhe për çështjen e «Aleancës së forcave demokratike e paqedashëse»¹, që është krijuar në Vietnamin e Jugut. Ne mendojmë se qëllimi i Frontit është të grumbullojë gjithë popullin në luftë kundër pushtuesve amerikanë. Po kush mund ta dijë situatën në Vietnam më mirë se ju? Mos vallë ne nga jashtë? Do të tregoheshim me të vërtetë mendjemëdhenj po të thoshim se situatën e vendit tuaj e njohim, do të gaboheshim po të kishim një pikëpamje të tillë.

Ne njohim mirë gjendjen në vendin dhe në Partinë tonë. Megjithatë nga sa na shpjeguat ju për situatën në Vietnamin e Jugut, që është shumë interesante, si dhe nga sa mësuam për qëllimin që ndjek Fronti i Çlirimit Kombëtar të Vietnamit të Jugut për grumbullimin e gjithë popullit në luftën kundër armiqve, mund të themi se ato janë të ngjashme me situatat e dikur-

1 Organizatë legale që po merrte shtrirje të madhe në atë kohë në Vietnamin e Jugut e që përbëhej nga intelektualë, elementë nga radhët e borgjezisë së vendit, me pjesëmarrës në qeveritë kukulla dhe nga elementë të tjerë që kishin shërbyer në radhët e armikut.

shme në vendin tonë kur na sulmuan e na pushtuan fashistët italianë e me atë të periudhës kur krijuam Partinë. Ato janë të ngjashme me kohën kur te ne u zhvillua lufta e armatosur, kur kapitulluan pushtuesit italianë, kur ushtria gjermane pushtoi Shqipërinë si edhe me fazën e fundit, kur ishim në prag të thyerjes së pushtuesve gjermanë. Duke marrë vijën e përgjithshme të Frontit tonë Nacionalçlirimtar, gjatë gjithë fazave nëpër të cilat kaloi lufta jonë, mund të themi se ajo i përngjet shumë vijës suaj në lidhje me mobilizimin e masave.

Por në atë kohë ka pasur edhe nga ne taktika, të cilat nuk mund të ishin njëlloj si tuajat, pse duhet të kemi parasysh që shtresat e ndryshme të futura në Front mund të kenë të njëjtat etiketa: «borgjezi kombëtare», «intelektualë» etj., kurse formacioni i tyre është i ndryshëm, potenciali dhe ndikimi i tyre në masat, gjithashtu, ndryshojnë dhe është pikërisht kjo arsyeja që ndryshojnë edhe taktikat, të cilat s'mund të jenë të njëllojta, si te ne, ashtu edhe te ju.

Partia jonë ka përvojën e saj lidhur me situatat që janë zhvilluar në Shqipëri. Cila është kjo përvojë? Nga fundi i vitit 1942, me përkrahjen e pushtuesve, në Shqipëri u krijua një «Front» i dytë, organizatë kjo e përbërë nga përfaqësues të borgjezisë reaksionare — intelektualë pseudopatriotë, çifligarë, tregtarë e fshatarë të pasur, të cilët e hiqnin veten si patriotë të flaktë! Ky «Front» që u vetëquajt Balli Kombëtar u krijua për t'iu kundërvënë drejtpërdrejt Frontit Nacionalçlirimtar që organizoi Partia, programi i të cilit nuk ishte si i Frontit tuaj. Ndryshimi qëndron në atë se

organizatën e Frontit tonë Nacionalçlirimtar Partia Komuniste Shqiptare e kishte shpallur haptazi se e udhëhiqte ajo, megjithëse ishte në ilegalitet, kurse ju flitni vetëm për Frontin. Në atë kohë Fronti Nacionalçlirimtar i kërkoi Ballit Kombëtar, këtij «Fronti» tjetër, të shpallte cili ishte programi i tij. Kur ballistët u përgjigjën se gjoja qëllimi i organizatës së tyre ishte lufta kundër pushtuesve, ne ramë dakord dhe u propozuam të bashkoheshim pa vonesë në luftë. Por ballistët nuk luftonin. Atëherë ne, me durim, vazhduam t'u bëjmë thirrje anëtarëve të kësaj organizate për bashkim në luftë kundër pushtuesve fashistë italianë. Mirëpo krerët e Ballit Kombëtar vazhduan të bashkëpunonin me pushtuesit.

Kur krijuam ne çetat tona partizane, me të cilat goditnim armikun, edhe Balli Kombëtar ngriti disa çeta, të cilat gjoja do të luftonin pushtuesin, por që s'luftuan kurrë kundër tij. Megjithëqë ne i dinim ç'i shinin ato, i ftonim të hidheshin bashkë me ne në luftë kundër armikut të jashtëm. Por, krahas përpjekjeve që bënim për t'u bashkuar dhe për t'u hedhur bashkërisht në luftë, ashtu sikurse drejt veproni sot ju me të tillë elementë në Vietnamin e Jugut, në të njëjtën kohë ne e vazhdonim me rreptësi edhe pa ata luftën kundër pushtuesve, u binim pa pushim armiqve. Nga ana tjetër, duke parë rrugën e tyre të bashkëpunimit me pushtuesit, ne punonim t'i izolonim krerët, duke u marrë bazën, masat e popullit të gënjyera prej tyre, të cilave u jepnim armë dhe i hidhnim në Luftën Nacionalçlirimtare. Erdhi kështu, më në fund, momenti që këta krerë tradhtarë, bashkëpunëtorë të pushtuesve,

u demaskuan nga Partia, u braktisën nga ato masa të popullit që ishin gënjyer prej tyre dhe u izoluan, u kthyen në agjentë të hapët të pushtesve.

Kur kapitulloi Italia fashiste, ballistët deklaruan se mbaroi çdo gjë. Sipas tyre Shqipëria «ishte çliruar» dhe kërkuan të krijonim një qeveri të përbashkët. Ne i paralajmëruam ata se nuk kishte ardhur koha as për të hequr dorë nga lufta, as për të krijuar një qeveri të përbashkët. I pyetëm ata nga kishin ardhur dhe ku kishin qenë gjer në atë kohë, kur patriotët e vërtetë ishin hedhur në luftë pa kompromis kundër pushtesve, duke dhënë kontributin e tyre me gjak e sakrifica për çlirimin e atdheut. I pyetëm kundër cilit kishin luftuar, prandaj edhe ç'pjesëmarrje në qeveri të përbashkët kërkonin kur për këtë Shqipëri po luftonin vetëm forcat e shëndosha të popullit? Ne u theksuam sidomos se lufta për çlirimin e atdheut akoma nuk kishte mbaruar, se vendin e pushtesve italianë të mundur po e zinin pushtesit e rinj, ata gjermanë, prandaj i këshilluam të hidheshin të paktën në luftë kundër këtyre. I vumë pra edhe një herë në provë. Por, sapo gjermanët filluan luftën kundër nesh, ballistët u kthyen në qytete, krijuan qeveri kuislinge, krerët e tyre qëndronin në hotel «Dajti» tok me komandantët gjermanë. Ata krijuan «ushtrinë» e tyre që, së bashku me atë të pushtesit, e hodhën në luftë kundër Frontit Nacionalçlirimtar. Me këtë ata u demaskuan dhe një herë keqas si tradhtarë të popullit dhe të atdheut. Këtë e kuptoi reaksioni.

Dhe ç'ndodhi? Ai nxori në shesh elementë të tjerë intelektualë borgjezë dhe simpatizantë e pasues të

mbretit Zog, me tendenca proangleze. Ata filluan të nxirrnin edhe gazetën e tyre me titull «Atdheu» nën hijen e pushtesve gjermanë, duke e botuar në një shtypshkronjë legale. Në këtë organ ata, nga një anë hiqeshin e shkruanin se gjoja «luftonin për atdheun», kurse nga ana tjetër, e vërteta ishte se ata qenë bërë një me pushtesit gjermanë. Kur gjermanëve po u vinte fundi në Shqipëri, zogistët, me ndihmën e oficerëve të misioneve angleze të dërguar nga Çerçilli e të desantëve të hedhur nga ajri si edhe të komandës gjermane që ishte akoma në vendin tonë, përpiqeshin të ruanin të paprekura forcat e tyre kukulla, e që, kur ne t'i mundnim pushtesit, ballistët të ishin gati të kthenin menjëherë xhaketën. Kështu u munduan të vepnin këta në vendin tonë. Ata u përpoqën, më së fundi, të futeshin edhe në qeverinë tonë.

Dua të them pra se te ne, në kohën kur kishim filluar ofensivën e përgjithshme dhe pushtesit gjermanë po thyheshin, na dolën të tillë njerëz që s'kishin hedhur asnjë pushkë për çlirimin e atdheut dhe, të armatosur me mjetet që u kishin dhënë gjermanët dhe anglezët, iu kundërvunë me armë Frontit tonë Nacionalçlirimtar. Mirëpo Ushtria jonë Nacionalçlirimtare, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, i goditi pa mëshirë e i shpartalloi ata dhe pushtesit gjermanë. Krejt tradhtarë që s'mundëm t'i kapnim u arratisën në Itali, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Munich të Gjermanisë e gjetkë. «Ushtria» që kishin u dorëzua te ne. Ne u bëmë thirrje të gjithë këtyre që, po të dëshironin, të rrëmbenin armët dhe brenda radhëve të Ushtrisë Partizane Nacionalçlirimtare të ecnin përpara

për çlirimin edhe të popujve të Jugosllavisë. Dihet se divizione shqiptare, pasi çliruan Shqipërinë, u hodhën përtej kufirit shtetëror dhe, përkrah popujve vëllezër të Jugosllavisë, çliruan Kosovën e Rrafshin e Dukagjinit, Malin e Zi, pjesën jugore të Bosnjës, Sanxhakun e disa krahina të Maqedonisë.

Të gjitha këto jua thashë për t'ju treguar si ka vepruar e ç'manovra ka përdorur reaksioni në vendin tonë dhe cila është përvoja jonë në lidhje me luftën kundër tij.

Vija juaj e Frontit mund të jetë e drejtë në këtë çështje që ju e dini më mirë nga ne. Ju i njihni çfarë njerëzish janë e ç'qëllime ndjekin ata të organizatës «Aleanca e forcave demokratike e paqedashëse».

Përse jua thashë juve sot këto? Jua thashë se ju duam të mirën, bile ju duam shumë dhe sinqerisht si shokë. Dhe në mes shokësh flitet haptazi. A nuk na mëson Lenini të flasim haptazi brenda në celulë? Me këtë mënyrë, haptazi dhe sinqerisht, duhet të flasim edhe me shokët e vendeve të tjera që u duam të mirën. Kur luftëtarët tuaj kryejnë një aksion kundër agresorëve amerikanë dhe kukullave vietnameze, sigurisht pas tij ata bëjnë analizën e punës, diskutojnë për sukseset, anët pozitive të aksionit dhe kritikojnë njëkohësisht, bile rreptë, të metat e konstatuara për të mos i përsëritur. Kështu flitet në mes shokësh të së njëjtës llogore e ideali. Duhet gjukuar drejt gjatë analizës, me partishmëri kush ka të drejtë, kush nuk ka, kush ka gjysmë ose një çerek të drejte, të gjitha duhen diskutuar dhe të gjendet bashkërisht rruga më e mirë.

E përsëris edhe një herë se ne ju duam e ju kemi

shokë, pse lufta që keni bërë dhe vazhdoni të bëni ju kundër imperialistëve amerikanë, nuk ka masë ta vlerësosh, ajo ka një vlerë kolosale, ajo nuk ka vlerë vetëm për Vietnamin, për çlirimin e Jugut. Jo! Me luftën e tij të madhe populli vietnamez u ka bërë një shërbim të madh gjithë popujve të botës, ai ka frymëzuar e ka inkurajuar gjithë revolucionarët e botës. Kush mohon një shërbim të tillë, në asnjë mënyrë nuk mund të quhet marksist. Por edhe kush nuk u thotë shokëve atë që mendon për disa çështje, edhe kjo nuk është marksiste. Kështu i kuptojmë ne këto gjëra.

Prandaj, këto që thashë janë mendimet dhe ndjenjat tona të sinqerta dhe të pastra për popullin tuaj heroik, për të gjithë partizanët dhe luftëtarët e Vietnamit. Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë, me të gjitha forcat e tyre kurdoherë do të jenë me ju dhe do t'ju ndihmojnë me të gjitha mundësitë që kanë. Ju jeni shokët tanë të luftës, prandaj ta ndieni veten në Shqipëri si në vendin tuaj, si në mes shokësh të vërtetë.

Le ta pimë këtë gotë për fitoren e plotë të popullit tuaj mbi agresorët amerikanë dhe kukullat e tyre!

Botuar për herë të parë me ndonjë shkurtim në librin: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 209

Botohet sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

ME DENONCIMIN E TRAKTATIT TË VARSHAVËS NE KRYEM NJË DETYRË TË LARTË KOMBËTARE DHE NDERKOMBËTARE

Kryeartikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

17 shtator 1968

Vendimi historik i Kuvendit Popullor të RP të Shqipërisë mbi denoncimin e Traktatit agresiv të Varshavës është shprehje e vullnetit sovran të popullit tonë, e vendosmërisë së tij të patundur për të ruajtur dhe për të forcuar lirinë e pavarësinë kombëtare, për të mbrojtur interesat e lartë të atdheut socialist e të revolucionit. Ai është një vendim që u mor nga pozita thellësisht revolucionare, marksiste-leniniste dhe përputhet plotësisht me interesat kombëtarë dhe me parimet e internacionalizmit proletar. Teju i tij drejtohet kundër revizionizmit hrushovian dhe kundër imperia- lizmit amerikan, të cilët, në bazë të strategjisë së tyre globale kundërrevolucionare, janë përpjekur dhe për- piquen të vendosin hegjemoninë e dy fuqive në botë.

Kanë kaluar 13 vjet nga dita kur në Varshavë u nënshkrua Traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke midis tetë vendeve socialiste të Ev-

ropës. Në themel të këtij Traktati qëndronin parimet e larta të marksizëm-leninizmit. Por ngjarjet që rrodhën nga ajo kohë nuk i justifikuan shpresat dhe aspiratat e popujve të vendeve pjesëmarrëse të Traktatit të Varshavës. Kongresi i 20-të i PK të BS i vuri minat vijës së drejtë marksiste-leniniste, themelet e së cilës i hodhën V. I. Lenini dhe J. V. Stalini, ai shënoi fillimin e kundërrevolucionit në Bashkimin Sovjetik, si edhe në shumë vende të tjera socialiste. Partia jonë, e udhëhequr nga Komiteti i saj Qendror me largpamjen dhe me nuhatjen e saj revolucionare, duke luftuar me guxim dhe me këmbëngulje për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, për çështjen e revolucionit e të socializmit, ka demaskuar dhe ka denoncuar hapur qëllimet e vërteta kundërrevolucionare të Kongresit të 20-të të PK të BS.

Udhëheqja revizioniste sovjetike nëpërmjet një veprimtarie të gjerë përçarëse dhe diskriminuese, nëpërmjet presioneve dhe shantazheve, pas Kongresit të 20-të, gradualisht, filloi të shkelë normat dhe parimet e Traktatit të Varshavës, filloi të diktojë politikën e saj shoviniste të shtetit të madh. Udhëheqja revizioniste sovjetike minoi nga themelet Traktatin e Varshavës, i cili nga një traktat paqeje, u shndërrua në një traktat lufte skllavëruese, në një instrument të politikës agresive rusomadhe të udhëheqësve revizionistë sovjetikë.

Partia dhe Qeveria jonë paralajmëruan me kohë popujt, dhe veçanërisht ata të vendeve pjesëmarrëse të Traktatit të Varshavës, për rrezikshmërinë që paraqiste ky Traktat që nga momenti kur revizionistët sovje-

tikë e zhveshën nga fuqia e tij efektive si një organizatë të rëndësishme në interes të socializmit e të paqes dhe e shndërruan në një bllok agresiv në shërbim të politikës neokolonialiste të carëve të rinj të Kremlinit. Dhe ndodhi ajo që kishte parashikuar prej vitesh Partia jonë. Traktati i Varshavës u shndërrua në një instrument agresiv. Viktima e tij u bë Çekosllovakia. Ky sulm i pabesë i revizionistëve sovjetikë dhe i shërbëtorëve të tyre njolloosi tmerrësisht emrin dhe nderin e Bashkimit Sovjetik. Ai i varrosi përfundimisht të gjitha parimet dhe qëllimet e drejta që kishte Traktati i Varshavës në kohën e krijimit të tij dhe e shndërroi atë përfundimisht në një instrument skllavërues në duart e klikës revizioniste sovjetike.

Në këto rrethana, kur me ngjarjet në Çekosllovakia shpërtheu karakteri agresiv e kundërrevolucionar i Traktatit të Varshavës, qëndrimi më gjatë në të, qoftë edhe formalisht, do të ishte një tradhti e madhe ndaj atdheut, ndaj çështjes së madhe të socializmit e të revolucionit. Populli ynë, besnik deri në fund ndaj Partisë së tij marksiste-leniniste, ndaj socializmit dhe komunizmit, me denoncimin e Traktatit të Varshavës, me hedhjen e tij në koshin e vjetërsirave, i tregoi botës se Shqipëria kurrë nuk do të pranojë të bëhet një vegël e të tjerëve dhe të tërhiqet në aventurat dhe në veprimet agresive të organizuara nga revizionistët sovjetikë.

Partia dhe Qeveria jonë kanë demaskuar me kohë bashkëpunimin sovjeto-amerikan, strategjinë e tyre të përbashkët kundërrevolucionare, që ka për objektiv

sundimin e botës nga dy fuqitë — SHBA dhe Bashkimi Sovjetik, ndarjen e zonave të influencës midis tyre. Si blloku agresiv i NATO-s, ashtu edhe Traktati i Varshavës janë baza e forcës agresive ku mbështeten ushtarakisht veprimi i tyre kundërrevolucionar, komplotet e tyre për të nënshtruar dhe për të skllavëruar popujt dhe vendet e tjera, që nuk i binden diktatit të të dyja fuqive. Agresioni i revizionistëve sovjetikë kundër Çekoslovakisë është produkt i kësaj politike, fryt i kësaj aleance.

Denoncimin e Traktatit të Varshavës mbarë populli ynë e vlerëson si një masë dhe një vendim revolucionar shumë të rëndësishëm. Me një akt të tillë ne mbrojmë atdheun tonë, ne mbrojmë fitoret tona socialiste, për të cilat janë dashur sakrifica të shumta, është derdhur aq gjak e djersë. Me këtë veprim të drejtë, të guximshëm dhe revolucionar populli ynë kryen, ashtu si kurdoherë, detyrën e tij kombëtare dhe në të njëjtën kohë atë internacionaliste. Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria dhe populli shqiptar denoncuan Traktatin e Varshavës duke u nisur nga pozitat e drejta parimore marksiste-leniniste.

Me largimin e tij nga Traktati i Varshavës, populli shqiptar plotëson një detyrë internacionaliste ndaj popujve të vendeve anëtare të këtij Traktati, ndaj gjithë popujve revolucionarë në botë. Populli sovjetik, komunistët e vërtetë dhe revolucionarët në Bashkimin Sovjetik, popujt çekoslovak, polak, bullgar dhe të vendeve të tjera anëtare të Traktatit famëkeq të Varshavës do ta mirëpresin denoncimin që Shqipëria i bëri

këtij Traktati. Kjo është një ndihmë prej miqsh dhe vëllezërish të singërtë që populli shqiptar u jep atyre në luftën e vështirë kundër klikave revizioniste në fuqi. Populli shqiptar e tha i vendosur fjalën e tij.

Ka ardhur koha që popujt e vendeve të vogla, anëtare të këtij Traktati agresiv, të nxjerrin mësimet dhe konkluzionet e nevojshme. Interesat e lartë të lirisë e të pavarësisë së atdheut të tyre, të çështjes së madhe të revolucionit dhe të socializmit, kërkojnë që ata të mos lejojnë më gjatë poshtërimin që po i bëhet flamurit të marksizëm-leninizmit, të mos lejojnë që një grusht shërbëtorësh revizionistë të luajnë me fatet e tyre. Sot, kur socializmi në këto vende është varrosur dhe po restaurohet kapitalizmi, kur po rrezikohen rëndë liria dhe pavarësia e popujve, paqja në botë, është detyrë e madhe që klasa punëtore, të gjitha forcat revolucionare të dalin në fushën e betejës për të përmbysur klikat udhëheqëse revizioniste, që kanë uzurpuar pushtetin, për të ngritur përsëri lart flamurin e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit, për të rivendosur diktaturën e proletariatit.

Marksistë-leninistët, forcat revolucionare, të gjithë njerëzit liridashës dhe përparimtarë në botë e përshëndetin me gjithë zemër vendimin e guximshëm dhe historik të popullit tonë për denoncimin e Traktatit të Varshavës. Këtë akt të madh të Partisë, të Qeverisë dhe të popullit shqiptar, ata e konsiderojnë si burim frymëzimi dhe një ndihmë internacionaliste që u jepet popujve të vendeve ku janë në fuqi revizionistët, që u jepet të gjitha forcave revolucionare, në luftën kun-

dër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye, kundër imperializmit dhe reaksionit, për lirinë dhe pa-varësinë, për paqen në botë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 223 (6262), 17 shtator 1968

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. VIII, f. 259. Tiranë, 1969

NE NDËRTIMIN E RRUGËVE TË KEMI PARASYSH LEVERDINË EKONOMIKE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

19 shtator 1968

Dëshiroj edhe unë të theksoj disa mendime. Aksionet për lidhjen e fshatrave me rrugë automobilistike kanë rëndësi të madhe, prandaj këto t'i vazhdojmë edhe në të ardhmen. Ato janë një aksion popullor dhe, për sa i përket ndihmës së shtetit, për të tilla aksione, ne duhet të qëndrojmë në vendimet që kemi marrë, të shohim mundësitë ekonomike që kemi. Në qoftë se ka mundësi që rretheve t'u jepet ndonjë ndihmë e re për këtë qëllim, ministri i Ndërtimit është vetë këtu dhe mund të flasë ç'mundësi ka. Në rast se Qeveria do të ketë mundësi të japë ndihma materiale, natyrisht, mirë, le të japë, por edhe këto gjithnjë me kriter. Por që

1 Në këtë mbledhje u diskutua për punën e organizatave të Frontit Demokratik për lidhjen e fshatrave me rrugë automobilistike; për këtë çështje raportuan Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm të FDSH dhe komitetet e Partisë të rretheve Skrapar, Përmet, Gramsh dhe Mirditë.

të marrim një vendim të ri për të dhënë më tepër dinamit, çimento ose lëndë të tjera ndërtimi, jashtë planit të caktuar, këtë nuk e bëjmë dot.

Dëshiroj, gjithashtu, të theksoj se, ashtu si kurdoherë, duhet të jemi modestë, sidomos në pretendime. Dihet se që të shkojë diku automobili, më parë është e domosdoshme të hapet rruga. Por, në kushtet tona, të kemi parasysh se jo në të gjitha rrugët që do të hapim duhet të shkojë medoemos automobili. Këtë ta kemi mirë të qartë, mbasi kam përshtypjen se shokë nga rrethet nuk e kanë parasysh si duhet. Bile në bazë ka raste që, me t'u hapur një rrugë e re, menjëherë na propozojnë të vendoset makina. Po ne nuk kemi mundësi të dërgojmë tani kudo automobila, deri edhe në zonat më të thella malore të vendit tonë, me qëllim që fshatarëve t'u jepet mundësia të lëvizin nga një vend në tjetrin kur të duan. Bile edhe autobusët në qytete ne i kemi vënë jo për të shëtitur qytetarët, por me qëllim që t'u vijmë në ndihmë punonjësve për të vajtur në kohë në qendrat e punës. Prandaj në zonat e thella malore, ku hapen rrugë të reja, jo më linja të rregullta interurbane, autobusë tash për tash nuk kemi mundësi të vendosim, por as kamionë për transport udhëtarësh nuk dërgojmë dot. Pastaj, nuk është ekonomike që kamionët të kalojnë nëpër këto rrugë të gjata nga 20-30 e 40 kilometra në zona të vështira. Jo, në kushtet tona aktuale një gjë e tillë nuk ka mundësi të bëhet.

Natyrisht, tani kamionë do të shkojnë në disa nga vendet ku hapen rrugë të reja, por është e domosdoshme që më parë këto rrugë të rregullohen mirë, në më-

nyrë që automjetet të mos shkatërrohen, pra, të mos lejojmë që makinat e rënda të lëvizin nëpër rrugë të papërshtatshme. Ministria e Komunikacioneve ka plotësisht të drejtë, më duket mua, që nuk e lejon një gjë të tillë, sepse nuk kemi ndër mend që këto rrugë të na bëhen varri i njerëzve dhe i automjeteve tona. Ne e dimë dhe të gjithë punonjësit, e jo vetëm shokët drejtues, duhet ta kenë të qartë se automjetet dhe veglat e ndërrimit për to i sjellim me vështirësi të mëdha, me devizë dhe me klering, nga jashtë. Në këto kushte, çfarë të sjellim më parë? Tani që po ndërtojmë kudo rrugë, mund të na kërkojë fshatarësia e një zone të thellë malore që të vihet një linjë e rregullt automobilistike për t'u lidhur me qytetin. Natyrisht, plotësimi i kësaj kërkesë do të ishte një gjë e mirë, e tillë është edhe dëshira jonë, por mundësitë akoma nuk i kemi.

Është e qartë se kur hapet një rrugë e re dhe automobili shkon gjer në ekstremin e fundit ku është ndërtuar rruga, kjo shërben për të plotësuar njëkohësisht edhe nevojat e fshatarëve të asaj zone. Prandaj rrugë të reja ne po ndërtojmë dhe duhet të hapim kudo edhe në të ardhmen, por të kemi kurdoherë parasysh që këtë punë ta bëjmë me mend, ato t'i ndërtojmë si duhet e në rregull, në radhë të parë, deri atje ku ka interes ekonomik, duke bërë kujdes që këto rrugë të mirëmbahen sipas rregullave nga vetë populli i secilës krahinë. Pra, atje ku kjo rrugë ka interes ekonomik dhe është ndërtuar në nivelin teknik që lejon qarkullimin e automjeteve, deri atje të vejë edhe kamioni, gjë që do të shërbejë njëkohësisht edhe për transportin e udhëtarëve. Ndërsa atje ku hëpërhë s'ka ndonjë in-

teres ekonomik (dhe me këtë nuk duhet të kuptojmë që kamioni të vejë për të marrë edhe pesë kuintalë rrush që mund të ketë një fshat i largët), edhe po të ndërtohet më tej rruga, automobili s'ka pse të shkojë. Paskan ose nukaskan rrush a kumbulla një ose më shumë fshatra të largëta, në qoftë se atje kemi për të shfrytëzuar, ta zëmë, një masiv pyjor me leverdi ekonomike, në një rast të tillë rruga të hapet me synimin që automobili të shkojë deri te pyjet dhe, si rrjedhim, kjo do t'u shërbejë edhe fshatrave rreth e rrotull. Kur shihet se interesi ekonomik për hapjen e një rruge të tillë është i madh atëherë të mobilizojmë popullin, por të vëmë forca edhe nga ana e shtetit për ta ndërtuar atë sa më shpejt.

Pra, kur ndërmerren iniciativa për hapje rrugësh automobilistike nga ana e popullit, në radhë të parë, duhet parë leverdia ekonomike e tyre. Prandaj në një zonë të thellë me shtrirje të gjerë, në vend që të hapim 60-70 kilometra trase që të përfshijë gjithë zonën, kjo punë të lihet për në perspektivë dhe më parë të hapim si duhet, sipas kërkesave teknike, 20-30 kilometra, me qëllim që makina të vejë pa u dëmtuar gjer në vendin ku ekonomia popullore ka leverdi për të transportuar prodhimet. Pastaj le të bëhet edhe pjesa tjetër, po jo në atë nivel teknik sa për të vajtur kamioni, as shkel e shko dhe vetëm sa për të qarkulluar kafshët, po të paktën të ndërtohet në atë mënyrë që në të të kalojnë lirisht edhe qerret e karrocet, me të cilat do të transportohet plehu kimik e çdo mall apo material tjetër që do të sjellin kamionët gjer në vendin e lejueshëm.

Për arsyet e mësipërme, mendoj se duhet të kemi

disa kritere të caktuara mirë për ndërtimin e rrugëve dhe për qarkullimin e automjeteve, sepse në këtë fazë të zhvillimit të vendit tonë, nuk mund të shtrihemi më shumë. Automjetet duhet t'i mirëmbajmë e t'i përdorim me ekonomi të madhe, prandaj të ndërtojmë rrugë të mira për to, por të ndërtojmë edhe të tilla ku të kalojnë pa vështirësi qerre, karroca, kafshë dhe udhëtarë. Të kemi, gjithashtu, parasysh që rrugët e ndërtoara për qerret e karrocën, në rast nevojë, të shërbejnë njëkohësisht edhe për qarkullimin e automobilave, natyrisht jo të çfarëdolloj automobili, po të makinave të lehta, për t'u ardhur në ndihmë fshatrave për nevoja urgjente, makina të tilla, si për shembull, auto-kinematë për shfaqjen e filmave, autoambulancat për të dërguar një mjek në fshat ose për të marrë andej një të sëmurë etj. Automjetet e këtij tipi nuk janë për qejf, po për të shpëtuar jetën e njerëzve ose për të ndihmuar në ngritjen politike e kulturore të banorëve në fshatrat e zonave të largëta. Edhe këto rrugë, sikurse të parat, duhet, gjithashtu, të mirëmbahen nga ana e fshatarësisë me qëllim që të paktën autoambulancat e autokinematë të shkojnë, po të jetë e mundur, kudo.

Ju, shokë të rretheve bëni më shumë kujdes e të mos i premtohet popullit të ndonjë zone që ndërmerr një aksion të tillë se, me t'u hapur e me t'u ndërtuar rruga, kudo do të vejë makina. Ku t'i gjejmë ne gjithë këto makina për të plotësuar çdo kërkesë edhe në ato zona ku hëpërhë ekonomia e përgjithshme nuk ka përfitim? Atje ku llogaritë e justifikojnë qarkullimin e automjeteve, ne do të dërgojmë jo një, por edhe më

shumë mjete transporti, se atje rrugët do t'i bëjmë e duhet t'i bëjmë të tilla që të mos na prishen këto mjete.

Disa ankohen se Ministria e Komunikacionit nuk po u dërgon makina. Po si mund të dërgohen kudo kamionë kur nuk ka mundësi? Për lëvizjen e njerëzve e të mallrave ministria ka një plan të aprovuar dhe për realizimin e tij disponon një kontingjent të caktuar mjetesh. Prandaj, në qoftë se ndërtohen jashtë planit qindra kilometra rrugë, shteti nuk mund të përballojë çdo kërkesë nisur nga dëshira e një fshati apo e një tjetri. Ta mendojmë më realisht këtë çështje.

Po të procedojmë sipas kritereve që përmenda, me një organizim më të mirë shkencor të punës, mua më duket se edhe Ministria e Ndërtimit dhe ndërmarrjet e saj, me mundësitë që kanë, do t'i ndihmojnë rrethet për përfundimin me sukses të këtyre aksioneve.

Kini parasysh edhe rrugët që hap ushtria. Sigurisht, ato hapen për destinacion tjetër, por njëkohësisht u shërbejnë edhe fshatrave të zonave ku ndërtohen, prandaj çdo rreth të kujdeset që populli t'i mirëmbajë edhe ato, e, kur duhet, edhe t'i zgjerojë.

Për ndërtimin e të gjitha rrugëve dhe për qarkullimin e automjeteve të mos nisemi nga dëshirat, por nga kriteret që u përmendën; t'i biem lapsit e të ndërtojme me sa më pak harxhime. Bie fjala, gjer në pikën ku është menduar të shkojnë kamionët, ose fundja gjer në qendër të lokalitetit, disa ura provizore prej druri, që prishen shpejt, do të ishte më mirë të ndërtohen definitivisht prej betoni, sepse kështu kemi më tepër leverdi; të gjitha të tjerat mund të ndërtohen provi-

zore, pse, edhe po t'i marrë lumi kur sjell shumë ujë gjatë dimrit, ato janë pak të kushtueshme, mund të rindërtohen shpejt dhe përsëri do të shërbejnë për të kaluar edhe automjetet e lehta.

Mendoj, gjithashtu, që këto aksione të kryhen me punë vullnetare, prandaj as pagesë, as «bedela» nuk duhen përdorur, përkundrazi, Partia duhet të punojë politikisht që të ngrihet i gjithë populli për ndërtimin e rrugëve.

Në materialin e paraqitur thuhet se kur vullnetarët punojnë shkëputur, nga një orë ose nga një ditë, puna është pa rendiment. Kjo duhet parë, se me të vërtetë nuk ka leverdi. Le ta vendosin vetë kooperativistët si duhet vepruar më mirë dhe drejt. Partia ka dhënë direktivën që fshatrat të lidhen me rrugë automobilistike me punën vullnetare të vetë popullit. Kjo është në interesin e tyre. Prandaj problemi i organizimit të punës të shtrohet e të diskutohet më parë në organizatën e Frontit, ku të vendosin vetë masat nga sa orë ose ditë do të punojnë dhe kur do të punojnë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**TË BEJNË GJITHÇKA KËRKON KOHA
PËR ZHVILLIMIN SOCIALIST
TË FSHATIT**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

19 shtator 1968

Duke u bazuar në të dhënat e mëparshme dhe në raportet që na kanë paraqitur komitetet e Partisë të rretheve që kemi thirrur në raport, del se në këtë çështje, pa asnjë dyshim ka përparime, bile këto janë të mëdha. Vetëm dua të theksoj se, gjithashtu, ka mundësi për të bërë akoma më shumë si nga ana materiale, ashtu edhe në punën e Partisë, sidomos për t'i shpjeguar edhe më thellë nga ana ideologjike këto probleme të mëdha shoqërore.

Problemeve të tilla kaq të mëdha më duket se u qëndrohet përciptas; ndodh që vendimet e drejta të Par-

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e Partisë për zbatimin e vendimeve të Plenumit të 2-të të KQ të PPSH për thellimin e mëtejshëm të luftës për emancipimin e plotë të gruas, në bazë të raporteve të paraqitura nga komitetet e Partisë të rretheve Tepelenë, Pukë, Krujë dhe Elbasan.

tisë zbatohen pa ua shpjeguar thellë ideologjikisht masave të gjera të popullit, nuk u shpjegohet atyre si duhet hopi i madh që bëjmë, duke kaluar nga një etapë në tjetrën. Kjo vjen se vetë anëtarët e Partisë, që e bëjnë këtë hop, shumë gjëra në zhvillim nuk i kanë të qarta ideologjikisht; edhe në qoftë se një pjesë e tyre i kanë pjesërisht të qarta, ata nuk kanë parasysh se masat e popullit nuk i dinë si duhet.

Njerëzit tanë janë dhe shprehen në favor të çështjeve të mëdha që ngre Partia, siç është edhe problemi i emancipimit të gruas, por ka nga ata, që në brendi kanë akoma pikëpamje të paqarta, të cilat duhen shpjeguar me kujdes e me durim gjersa të sqarohen. Por një gjë e tillë nuk bëhet mirë, shpjegimi bëhet të shumtën e herës fare thjesht. I thuhet, për shembull, një plaku, në mënyrë të prerë, pa i dhënë asnjëfarë shpjegimi: «Nuk ka perëndi!». Ai, duke qenë se është në rrugën e Partisë, nuk e kundërshton komunistin, duket sikur u sqarua, po në të vërtetë nuk është i bindur. Ose, kur i thuhet një tjetri që «vajza ose djali duhet të martohen me dashuri», ai mund të mos i pengojë të rinjtë në marrëdhëniet e tyre, por në ndërgjegjen e tij një praktikë të tillë nuk e pranon dhe për këtë nuk është fajtor, sepse ky koncept ka të bëjë me një botëkuptim të tërë të formuar tek ai që në vitet e para të jetës. Mundet plaku, *de facto*, edhe të pranojë diçka, po ai nuk e ka akoma si duhet të qartë atë, prandaj na bie detyrë t'ia sqarojmë. Duhet, pra, të ushqehen vazhdimisht njerëzit me fjalën e Partisë.

Po përse nuk bëhet mirë kjo gjë? Sepse është neglizhuar dhe vazhdohet të neglizhohet, nuk u jepet rë-

ndësia e duhur çështjeve shoqërore, zhvillimit të tyre gjatë disa periudhave. Nuk e kam çështjen që tani të fillojmë të interesohemi posaçërisht duke gërmuar në shekuj, megjithëse kjo nuk ekskludon as këtë, për të shpjeguar të kaluarën e popullit tonë, po të interesohemi, në radhë të parë, për jetën e tij në shekujt më të afërm, sidomos në të 18-tin, të 19-tin dhe në mënyrë të veçantë nga mesi i shekullit të 19-të dhe fillimi i shekullit të 20-të. Për këtë periudhë njerëzve tanë u vihet detyrë të analizojnë gjendjen sociale të Shqipërisë.

Përse duhet ta bëjmë këtë? Sepse kjo gjendje sociale ka reperkusione në ndërgjegjen dhe në botëkuptimin e popullit tonë edhe tani. Prindërit tanë kanë lindur e jetuar nga fundi i shekullit të 19-të dhe një pjesë nga fillimi i këtij shekulli. Tek ata, përveç mentaliteteve shekullore të kohës së kaluar që kanë zënë vend brez pas brezi në ndërgjegjen e tyre, dhe që, natyrisht, kanë bërë evolucion në ta, janë zëvendësuar edhe mjaft pikëpamje të kohës kur kanë lindur. Është fakt se pikëpamjet e reja zëvendësojnë pa pushim të njerëzit mentalitetet dhe botëkuptimet e kohëve të kaluara. Ne tani jetojmë në një periudhë tranzitore, ndryshimesh, prandaj, pa i njohur si duhet mentalitetet e botëkuptimet e kohëve të kaluara që do të na shërbejnë për t'i përdorur si argumentime për rrënjosjen e së resë dhe për të shkukur të vjetrën, nuk do të vendosim dot si duhet me atë forcë thelluese, të përhershme dhe sa më shpejt që të jetë e mundur pikëpamjet marksiste-leniniste të moralit, konceptet tona filozofike etj.

Të shohim, për shembull në rrethin e Pukës, pse kanuni nuk i ka lejuar martesat brenda fisit. Duhet gjetur këto arsye, të cilat t'i shpjegohen drejt popullit. E dimë se nga kanuni dhe feja martesat brenda fisit nuk lejohej për arsye shoqërore dhe ekonomike dhe jo vetëm për arsye shëndetësore, të lidhjes së gjakut etj., etj. Të tilla arsye rrëzohen, pas tre-katër brezash ato nuk kanë më asnjë bazë për t'u marrë parasysh.

Martesa brenda fisit nuk lejohej sepse vajza përdorej si një mjet për të lidhur miqësi dhe aleanca gjaku me fisin tjetër, me qëllim forcimi, pra, për të rritur më tej fuqinë mbrojtëse të fisit. Çdo fis, në kohën kur është përpiluar kanuni, për të siguruar ekzistencën e vet, e ndiente shumë nevojën për të krijuar aleanca politike, ekonomike dhe ushtarake me fise të tjera, ashtu sikurse bëjnë me njëri-tjetrin edhe shtetet. Një nga mjetet për të krijuar këto aleanca ishte vajza. Edhe sot, si në çdo kohë më parë, kur një familje marton vajzën, e do dhëndrin, ashtu sikurse familja e djallit e do vajzën me të cilën martohet i biri i saj, krijojnë kështu midis dy familjeve, me anën e martesës, lidhje miqësie të forta.

Duhet të kemi parasysh se në kohën e vendosjes së kanunit në shekujt 15 dhe 16, jo më fshatrat, po edhe qytetet që sot kanë dhjetëra mijëra banorë, nuk kishin më tepër se disa mijëra veta. Merret me mend sa mund të kishte në atë kohë fshati i Iballës në rrethin e Pukës, ai kishte vetëm disa shtëpi, ku ishin pothuajse të gjithë pjesëtarë të një familjeje, prandaj brendapërbrenda një fisi të tillë të vogël,

është e kuptueshme, nuk mund të lidheshin martesë, pasi nuk mund të merrte motra të vëllanë për burrë, as vajza djalin e xhaxhait, ata ishin shumë të afërt, të një gjaku. Një gjë e tillë pengohej, pra, edhe nga ana patologjike.

Sigurisht, më vonë, pas kalimit të shumë brezave, fisi i Iballës, nga një fshat i vogël, u rrit në dy, tri, dhjetë e më shumë fshatra. Në këto kushte, si ta evitonte kanuni martesën midis këtyre fshatrave me prejardhje nga një fis i largët, gjersa interesat e fisit duheshin mbrojtur? U kalua kështu më vonë nga mbrojtja me aleanca të entiteteve të vogla, në lidhjet me qëllime mbrojtjeje të entiteteve më të mëdha, duke vendosur që martesë brenda fisit të mos lejohej, sikur edhe 400 breza të kalonin. Ishin, pra, interesat e mbrojtjes, interesa jetikë të fisit ata që imponuan të kanunizohej një normë e tillë.

Të gjitha këto gjëra Partia duhet t'ia futë në kokë, t'ia shpjegojë mirë popullit, historikisht dhe teoretikisht, dhe ta bindë që sot, në periudhën e ndërtimit të socializmit dhe të ekzistencës së diktaturës së proletariatit, kur motivi i mbrojtjes nuk shtrohet në bazë fisi, kjo normë nuk ka asnjë vlerë. Normat e kanunit pa asnjë bazë për kohën e sotme, po t'i arsyetosh me zhvillimin dialektik të historisë, asgjëkundi nuk kanë ku mbahen më.

Preka shkurt disa probleme që kanë lidhje me fisin në rrethin e Pukës, po duhet të shohim me radhë të gjitha aspektet e jetës së popullit që nga lindja, martesë, vdekje, nga mënyra e jetesës gjer te pjekja e bukës dhe nga të gjitha këto të nxjerrim detyra për

punën tonë të tanishme. Mbjaj mend mirë si kanë jetuar qytetarët e Gjirokastrës aty nga viti 1920. Më kujtohet se të gjitha familjet e mëdha patriarkale, me nga 40-50 veta, për nevojat e tyre kishin furra në shtëpi. Në to ato piquin çdo ditë nga 5-6 tepsi të mëdha me bukë, përgatitnin, gjithashtu, gjyveçë të tërë me gjellë për ushqimin e gjithë pjesëtarëve të këtyre familjeve etj. E njëjta gjë bëhej edhe në fshat, ku buka në familje të mëdha piquej, gjithashtu, edhe atje në furra dhe jo me një saç.

Kur një gjë e tillë është realizuar në të kaluarën, në ato kushte dhe vetëm me forcat e mundësitë e kufizuara të një familjeje, sado e madhe që ishte kjo, përse të na duket sot si një gjë e madhe ngritja e një furre për pjekjen e bukës për nevojat e anëtarëve të një kooperative, që ka forca dhe mundësi shumë më të mëdha se një familje e vetme? Në kushtet e rendit tonë socialist dhe të ekzistencës së kooperativave bujqësore në fshatra një gjë kaq e vogël duhet të bëhet medoemos menjëherë dhe pa asnjë diskutim.

Po të njohim historikisht mënyrën e jetesës në fshatrat ose në qytetet tona, do të kemi parasysh se si përpara, një herë në javë, të shtunave ose të dielave, gratë merrnin të gjitha teshat e palara të familjes, deri edhe qilimat, dhe shkonin për t'i larë e për t'i kopanisur në krua ose në lumë. Tani ngritja e një lavaxerie në fshat, për të cilën po flasim kaq shumë, sepse është një nevojë e kohës, duhet të bëhet, gjithashtu, menjëherë, nga çdo kooperativë, pse nuk është diçka e jashtëzakonshme dhe e pamundur të bëhet.

Me kohë shoqëria e vendit tonë kaloi në periudha

të reja, më përparimtare, gjatë të cilave familjet e mëdha erdhën vazhdimisht duke u copëtuar, prandaj edhe hallet e nevojat e tyre u bënë më të kufizuara, si pasojë u prishën edhe furrat. Mirëpo tani që jemi duke ndërtuar socializmin, është krijuar një situatë e re, çdo fshat është bashkuar në kooperativë, si në një familje të madhe, ndarja e punës aty bëhet ndryshe nga përpara, prandaj ndërtimi i furrës, i lavanderisë, i çerdhes, i kopshtit etj., etj. duhen kuptuar si nevoja të domosdoshme të jetës kolektive socialiste që duhen plotësuar pa vonesë.

Mirëpo ndryshimet në këtë proces të shpejtë zhvillimi nuk kuptohen dhe nuk shpjegohen thellë. Për këtë arsye, në kooperativat tona nuk kuptohet si duhet nevoja e lehtësimit të grave nga disa punë, ose kjo kuptohet sikur është një qëllim më vete, kurse në fakt këto lindin objektivisht nga nevojat aktuale të ndërtimit të socializmit në fshat, ato janë kërkesa të domosdoshme të zhvillimit tonë shoqëror. Dhe pikërisht këtë zhvillim shoqëror Partia duhet t'ia shpjegojë qartë fshatarit. Që të kuptohen, pra, këto nevoja e të plotësohen më lehtë, më parë u duhet shpjeguar njerëzve tanë si ka ecur evolucioni shoqëror në të kaluarën e vendit, që ta dinë si ka qenë gjendja atëherë dhe përse tani duhet të jetë kështu si porosit Partia. Duke vepëruar në këtë mënyrë ne nuk do të gjejmë kundërshtim nga ana e fshatarëve kooperativistë për të bërë gjithçka kërkon koha për zhvillimin socialist të fshatit. Për mendimin tim gjëra të tilla nga ana materiale s'kanë asnjë pengesë për t'u realizuar, por, më duket, atyre nuk u vihet rëndësia e duhur. Prandaj duhet të marrim

masa për të ngarkuar kuadro partie, aktivistë shoqërorë, arsimtarë, shkrimtarë, historianë e punonjës të tjerë shkencorë që të bëjnë edhe të tilla studime.

Më ka qëlluar të lexoj, midis të tjerash, një sërë librash të shkruar nga autorë të huaj, në disa prej të cilëve përshkruhet si e kalonin ditën njerëzit e popullit. Në njërin, për shembull, flitet si e kalonte kohën populli bullgar në vitin 1827. Autori aty nis të flasë me radhë e me hollësi për çdo gjë, gjer edhe për cimbidhin (mashën) e zjarrit. Në një libër tjetër flitet si e kalonte kohën populli i qytetit të Fesit në Marok në fund të shekullit të 18-të. Aty përshkruhen marrëdhëniet midis njerëzve, martesat, lidhja e krushqive, si përgatitej paja etj.; me pak përjashtime, të gjitha këto zakone i kemi pasur gati njëlloj edhe në vendin tonë. Kështu, me radhë, nëpër të tillë libra shkruhet deri për hoxhallarët dhe ata që bënin nuska, pastaj përshkruhet evolucioni i bërë, duke treguar se si në këtë apo në atë qytet që përpara kishte 2 000 e pastaj me kohë 2 500, 3 000 e më shumë njerëz, kur arriti në 4 000 veta, u bë një hop përpara me çeljen e së parës farmaci me pesë shishe etj. Pra, në këta libra tregohet evolucioni, ecja përpara e shoqërisë. Një libër të tillë që të flasë për jetën e përditshme të popullit shqiptar nuk e gjen, sepse historianët e shkrimtarët nuk u kanë vënë rëndësi këtyre gjërave, që kanë të bëjnë me jetën e popullit. Sa herë na ndodh sot të themi: «Si nuk e kemi fotografinë e këtij vendi kaq pjellor që më parë ka qenë moçal?» dhe për këtë na vjen keq. Një dokument i tillë duhet që stërnipërit tanë nesër të shohin e të vlerësojnë punën e bërë, të dinë si ishte më parë ky vend

dhe si u bë, pse me siguri do të vijë një kohë që ata të pyesin si jetonin prindërit dhe gjyshërit e tyre. S'ka dyshim që edhe ata do të kenë probleme, siç kemi tani edhe ne, disa nga të cilat do t'ua lëmë trashëgim për t'i zgjidhur, se nuk do t'u zgjidhim dot çdo gjë, bile disa jemi larg t'i zgjidhë brezi ynë.

Të moshuarit shpesh na kanë treguar si jetonin njerëzit në vendin tonë kur ata vetë ishin të rinj. Pleqtë janë në gjendje të na flasin me hollësi për numrin e njerëzve të familjes së secilit dhe sa okë kripë, trahana, sheqer, vaj, gjalpë, djathë, dru etj. harxhonin gjatë vitit. Kur ne u kërkojmë atyre të na tregojnë për gjëra të tilla, na përgjigjen se nuk jetonin dhe aq keq, pse kënaqeshin me pak. Mirëpo kur krahason me të sotmen nivelin e jetesës së popullit tonë në të kaluarën, duke llogaritur numrin e frymëve që kishte familja dhe konsumin për çdo njeri, e vërteta del që nuk jetonin hiç mirë. Nga këto del gjendja e vështirë ekonomike që i detyronte familjet tona të ishin shumë ekonomë, prandaj edhe ndërtonin furra nëpër shtëpitë, hidhnin zahire rezervë që në vjeshtë dhe të gjitha këto i vinin në kyç e i administronin me krëk. Kështu fëmijëve, së bashku me bukën, atëherë u jepnin vetëm nga një copë të vogël djathi dhe u thoshin se me atë do të sosnin bukën, prandaj duhet ta hanin nga një çikë, që t'u arrinte dhe këtë e bënë, sepse, po të mbarohej rezerva e djathit, nuk kishin ku gjenin tjetër.

Jeta dhe zhvillimi shoqëror i popullit tonë akoma nuk studiohen sa duhet, nënvleftësohen e neglizhohen. Mirëpo kjo është një mungesë e ndjeshme që na pengon të nxjerrim detyra për zgjidhjen e disa proble-

meve që, aktualisht, na bëhen pengesë për të futur në ndërgjegjen e njerëzve botëkuptimin e ri, për zbatimin e direktivave që ka vënë përpara Partia jonë. Disa herë lufta për zbatimin e këtyre direktivave nuk shoqërohet me një punë paraprake bindëse gjë që shkakton fërkime me njerëzit dhe shfaqje të tjera të papëlqyera, prandaj edhe për këtë duhet ta sqarojmë mirë bazën.

Problemi që marrim në shqyrtim ka rëndësi të madhe. Kur jepet direktiva për marrjen e disa masave për të lehtësuar punën e gruas, si për shembull, për ngritjen sa më parë të furrës, lavanderisë, për afrimin e ujit të pijshëm sa më pranë ndërtesave të banimit etj., këto duhet të zbatohen, bile sa më parë. Moszbatimi në kohë i tyre më duket se vjen nga mungesa e masave organizative.

Për sa i përket moskuptimit ideologjik të këtyre çështjeve nga ana e fshatarësisë, mund të themi se edhe kjo ndodh ngaqë nuk thellohemi për t'u shpjeguar njerëzve problemin nga ana historike, ndryshimet e mëdha që janë bërë e po bëhen në vendin tonë, prandaj masat që rekomandohet të merren, janë në përputhje me kohën. Partia duhet t'u shpjegojë njerëzve të thjeshtë të popullit, për shembull, si bëhej fejesa kur jetonin gjyshërit tanë, të krahasohet evolucioni i këtij zakoni me periudhën e mëvonshme të prindërve tanë e pastaj më vonë me kohën që jetojmë, që ata të shohin qartë evolucionin e këtyre fenomeneve shoqërore nga brezi në brez. Duke i shpjeguar mirë këto ndryshime, pleqtë nuk do të çuditen me mënyrën se si bëhen e duhet të bëhen fejesat në kohën e sotme dhe nuk do të sjellin pengesa.

Malësorët e Pukës mund edhe t'i ndalojmë të mos pengojnë martesën brenda fisit, por kjo do të ishte një masë arbitrare administrative. Rruga e drejtë e Partisë është që atyre t'u shpjegohet arsyeja përse këshillohet Partia që martesat të mos bëhen vetëm brenda dy-tre brezash, sepse palët kanë lidhje gjaku midis tyre, por kjo arsye nuk ka të bëjë aspak me atë që kërkon kanuni, që të rinjtë të mos martohen deri në katërqind breza. Këtë duhet t'ua shpjegojmë atyre jo një, por dy dhe tri herë, pastaj të nxitim të rinjtë e të rejtat e fshatit që të martohen midis tyre, natyrisht brenda kufijve që lejojnë ligjet tona. Po e bënë këtë tri-katër çifte, pastaj do të fillojë të zgjidhet ky problem.

Të gjitha këto çështje ne i kemi diskutuar edhe herë të tjera, prandaj nuk e shoh të nevojshme të zgjatëm më tepër.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tarlatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

NË USHTRI MBI TË GJITHA ËSHTË KONTROLLI I PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

19 shtator 1968

Mendimi i përgjithshëm është se puna e Partisë në ushtri, dhe veçanërisht në repartet që po marrim sot në studim, është e mirë. Situata është, gjithashtu, e mirë dhe gatishmëria e plotë. Kam një vërejtje për raportet e paraqitura, të cilat janë pak të përgjithshme, në to më tepër numërohen se janë marrë këto ose ato masa. Kjo ndoshta ka ndodhur edhe për arsye se shokët përgjegjës nuk janë udhëzuar si duhet që të na paraqitnin diçka më konkrete.

Mendoj se raportet do të ishin më të frytshme për Sekretariatit e Komitetit Qendror, sikur në secilin prej tyre të trajtoheshin dy-tri probleme partie për repartet përkatëse, ku të viheshin në dukje më konkretisht si

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e komiteteve dhe të organizatave-bazë të Partisë për forcimin e rolit udhëheqës të organizatave-bazë të Partisë në drejtim të edukimit ideologjik e politik të efektivit aktiv dhe rezervist.

është organizuar puna për këto probleme, si paraqitet konkretisht realiteti, si janë përcaktuar detyrat në përputhje me këtë realitet, ku konsistojnë të metat dhe çfarë masash janë marrë e do të merren për t'i zhdukur ato. Kjo do të ishte një punë shumë e frytshme dhe do të na ndihmonte të shikonim konkretisht gjendjen. Në një raport shokët e komitetit të Partisë kanë filluar të flasin në këtë mënyrë aty nga fundi i raportit, duke vënë në dukje shkarazi se kanë pasur të meta, por menjëherë largohen nga paraqitja e këtyre të metave, se kujtojnë mos dalin jashtë temës, kurse neve pikërisht kjo na duhej, që të shikonim ku na çalojnë punët atje, në ç'forma paraqiten dobësitë në organizatën e Partisë, si vepron udhëheqja e saj për t'i gjallëruar komunistët për zhdukjen e të metave e të dobësi-ve që ekzistojnë, ç'punë edukative është bërë dhe ç'masa janë marrë për ndreqjen e tyre etj.

Të gjitha këto janë shumë të rëndësishme për ne, kurse ju i prekni fare pak, pastaj kaloni shpejt e shpejt. Sigurisht, ju keni eksperiencë në punë, po këto për të cilat fola kanë një rëndësi të madhe për udhëheqjen e Partisë, prandaj i kini parasysh për herë të tjera.

Pra, duke parë konkretisht si paraqiten gjendja në organizatat-bazë, jeta e gjallë e Partisë në repart, me të metat e të mirat e saj, si dhe masat që keni marrë për forcimin e organizatës, atëherë çdo gjë për ne bëhet e qartë, prandaj mund të diskutojmë më mirë e të japim ndihmën e duhur.

Ju i keni punuar direktivat e fundit të Partisë. Le të marrim direktivën e dhënë për kontrollin punëtor. Sigurisht, ju nuk keni punëtorë në repartet tuaja, se

nuk jeni si në një fabrikë, ku ka klasë punëtore, punëtorë të dalluar etj. Punëtorë ju keni në repart vetëm ata ushtarë që ju sjell kuraja, megjithatë direktiva e Partisë për kontrollin punëtor është, gjithashtu, edhe për ju një direktivë me shumë rëndësi. Për ne do të ishte shumë mirë të dinim si e zbatoni ju kontrollin punëtor në repartet tuaja. Kjo ka rëndësi edhe për ju. Nga kjo direktivë është e nevojshme ta keni të qartë nëse duhet t'ju kontrollojnë ju punëtorët e veshur me rrobën ushtarake dhe kuadrot e ulët? Po çfarë duhet të kontrollojnë ata mbi ju, mbi kuadrot? Ata duhet të kontrollojnë, në radhë të parë, për shfaqjet e burokratizmit, të shohin se në çfarë formash e në ç'masë paraqiten ato te ju se ndryshe është burokratizmi në fabrikë, ndryshe në institucion, ndryshe në ushtri e gjetkë. Te ju ka disa norma që medoemos duhet të ekzistojnë, por ka edhe të tjera që nuk duhet të jenë. Disa mund të thonë: «Oburra të hiqen të tëra rregullat», të veprohet «partizancë», «të kontrollohen në çdo gjë komandat dhe shtabet se është kontrolli punëtor» etj., por veprimet e tilla nuk mund të lejohen në ushtri. Ka disa çështje që duhen marrë parasysh, se kemi të bëjmë me ushtrinë, por me sa interes do të ishte për ne sikur të shkruanit në raportet tuaja se si është kuptuar kjo direktivë, si e keni trajtuar me shokët, ç'rezistencë keni gjetur, sepse, sigurisht, mund të ketë njerëz që të thonë, për shembull, se «tani ti, shoku komisar i repartit, nuk bën dot më si më parë, nuk të lejon nënoficeri të veprosh si të duash»; ose mund të ketë ndodhur që çështja e kontrollit punëtor të kuptohet shtrembër nga ndonjëri, duke thënë se «këtu jemi ushtri dhe për asgjë

askush nuk duhet të ngrejë zërin». Pra, mund të ketë tendenca të gabuara djathtas e majtas, por ka e duhet të ketë edhe kontroll të vërtetë, në bazë të të cilit duhet të jetë vija e drejtë e Partisë, kontroll të frymëzuar nga direktivat e Komitetit Qendror dhe që zbatohet në një sektor të veçantë, special. Pra, si kudo, edhe në ushtri mbi të gjitha është kontrolli i Partisë që ushtrohet për të parë si zbatohet vija e saj.

Në këtë drejtim e kisha unë vërejtjen: sikur raportet tuaja të kishin dy-tri probleme më të zbërthyera, ato do të ishin më të plota dhe më interesante për ne.

Te ju janë punuar direktivat e Partisë dhe nuk kam vërejtje për mënyrën dhe për metodën e punimit të tyre nga ana juaj. Faktet tregojnë se ju keni rezultate. Natyrisht, ka dhe disa gjëra të vogla, të cilat me të drejtë i vuri në dukje shoku Hysni [Kapo], pse, siç dihet, ka edhe elementë të paqartë që bëjnë gabime, por në përgjithësi në ushtri nuk kemi shfaqje shqetësuese që të na pengojnë punën.

Le të marrim, për shembull, çështjen e familjaritetit. Nga të gjitha raportimet që na bëjnë shokët nuk më ka zënë veshi të thuhet që në këtë ose në atë raport ka frymë familjariteti midis kuadrove, se ata mbrojnë njëri-tjetrin, apo fshehin gabimet e njëri-tjetrit etj. Po të jetë kështu kjo tregon se kuadrot e ushtrisë janë njerëz të pjekur partie, që i kuptojnë dhe i zbatojnë mirë direktivat e Partisë.

Për gatishmërinë e ushtrisë në drejtim të bashkëpunimit me organizatat e Partisë të rretheve dhe konkretisht për dhënien e ndihmës nga ana e ushtrisë për problemet bujqësore apo xheniere etj., Byroja Politike

dhe Sekretariati i KQ deri tani kanë dëgjuar fjalë të mira. Kjo tregon se ushtria jonë direktivat e Partisë i kupton dhe i zbaton drejt, se niveli ideopolitik i kua-drove ushtarakë në të gjitha repartet është i mirë. Një repart mund të ndihmojë në fushatat e bujqësisë, mund të hapë edhe një rrugë, por jo t'i bëjë këto në dëm të stërvitjes, domethënë duke dobësuar shërbimin dhe ngritjen profesionale ushtarake. Kjo do të thotë që ky repart të mos jetë në gatishmëri të plotë. Një gjë e tillë nuk ndodh në ushtrinë tonë, pasi është e qartë që detyra kryesore e saj është qenia në gatishmëri të plotë ushtarake, përgatitja politiko-luftarake e efektivit, pas-taj ndihma që i jep ajo terrenit. Në qoftë se kuptohet kështu atëherë kuadrot e ushtrisë do të punojnë mirë, do të kryejnë si duhet detyrën e tyre.

Situata në vendin tonë paraqitet shumë e mirë. Ushtria është në gatishmëri. Populli, gjithashtu, i tëri është në këmbë.

Revizionistët sovjetikë ndodhen në krizë të madhe, sepse, siç e dini dhe e keni konstatuar edhe vetë, ata nuk po dalin dot nga gjendja që krijuan me agresionin e tyre në Çekosllovakia. Nëse revizionistët sovjetikë do t'i tërheqin ose jo trupat e tyre nga Çekosllovakia, kjo është akoma një pikëpyetje, por një gjë është e sigurt: ose do të dalin me një zbythje të turpshme, me një disfatë të tmerrshme, ose do të shkojnë më tej në shtypjen e popullit çekoslovak. Tendencia e deritani-shme është se ata do të godasin akoma më shumë në Çekosllovakia, mirëpo një gjendje e tillë, edhe kështu si është sot, është skandaloze dhe ushtron një ndikim të madh në të gjitha vendet ku janë në fuqi revizionistët.

Brenda në Bashkimin Sovjetik situata është shumë e lëvizshme dhe kjo duket nga vetë propaganda revizioniste, e cila po bën të gjitha përpjekjet për ta bindur popullin sovjetik, me anë artikujsh dhe filmash të posaçëm, se gjoja ishte e domosdoshme që ushtria sovjetike të ndërhynte në Çekosllovakia, pasi kundërrevolucioni qenkësh në rrugë.

Ajo që ka rëndësi është, gjithashtu, se në Çekosllovakia populli po reziston në mënyrë sistematike, po u bën bllokadë ushtrive pushtuese, gjë që është e padurueshme për pushtuesit sovjetikë. Klika e Dubçekut përpiqet ta lidhë veten me rezistencën e popullit, po pjesëtarët e kësaj klike janë kapitullues, ata pranuan marrëveshjen e Moskës duke u justifikuar sikur s'kishin ç'të bënin, zbatuan censurën dhe masat e tjera që kërkuan sovjetikët. Nga ana tjetër masat e popullit po i bojkotojnë pushtuesit, prandaj sovjetikët e kanë keq punën në Çekosllovakia. Mirëpo kjo gjendje shkaktonte pasoja edhe në vendet e tjera satelite, si: në Poloni, në Gjermani, në Bullgari, në Hungari. Një situatë e tillë do të mahiset edhe në këto vende, kështu që pushtimi i Çekosllovakisë i ka futur revizionistët sovjetikë në vështirësi të jashtëzakonshme.

Në panairin e Bërnos, kur në hapjen e tij u fol për Bashkimin Sovjetik, asnjë nuk duartrokiti. Në pavijonin e sovjetikëve nuk vajti asnjë punëtor çek për të montuar makineritë që do të ekspozoheshin, prandaj sovjetikët u detyruan ta bënin këtë punë me anën e ushtarëve. Ja, pra, si është gjendja e «çlirimtarëve» në Çekosllovakia.

Kudo në botë tani po flitet për denoncimin e Trak-

tatit të Varshavës nga Republika Popullore e Shqipërisë. Ky hap ka bërë një përshtypje jashtëzakonisht të madhe. Për këtë po flasim miq e njëkohësisht edhe armiq. Miqtë mburrin guximin e Shqipërisë, aprovojnë të gjitha ato që themi ne për Traktatin e Varshavës dhe vendimin që morëm e cilësojnë plotësisht të drejtë, të argumentuar. Në qarqet diplomatike të vendeve të ndryshme, siç na njoftojnë përfaqësues të vendit tonë në shtete të tjera, në pritjet që jepen, me përjashtim të revizionistëve, nuk ka mbetur ambasador pa u folur me simpati shokëve tanë, pa lavdëruar gjestin e Shqipërisë.

Dalja jonë nga Traktati i Varshavës ka qenë një vendim shumë i drejtë dhe në kohën e duhur. Megjithatë, ne duhet të forcojmë më tej situatën, të jemi vigjilentë. Ushtria të jetë ditë e natë në gatishmëri, ajo duhet vënë vazhdimisht në korent për situatën ndërkombëtare. Masat e popullit t'i kemi të mobilizuara e vazhdimisht në aktivitet. Atje ku shihet se kemi të meta e boshllëqe të ndalemi konkretisht, të nxirren konkluzione, të ndreqen gabimet, të bëhen plotësimet e ndryshimet e nevojshme në të gjitha drejtimet.

U dërgojmë përshëndetjet tona gjithë ushtarëve e oficerëve dhe u urojmë atyre sukses në punë dhe në çdo detyrë që u ngarkon Partia dhe populli!

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TE PRODHOJME NË VEND E ME KOSTO TË ULËT SA MË SHUMË MALLRA TË PËRDORIMIT TË GJERË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

20 shtator 1968

Nuk do të flas gjatë. Së pari, do të thosha që Kiçoja [Ngjela] duhet të lëvizë këmbët, për të siguruar në kohë mallrat e importit, sepse nuk kënaqemi me raportin që na bëri dhe me atë që na tha se ato i paska kontraktuar. Kontraktimi dhe ardhja e tyre janë dy gjëra krejt të ndryshme. Për ne kryesorja është që mallrat të vijnë në portet tona. Në qoftë se na thuhet që këto mallra me devizë, për të cilat është dhënë autorizimi, janë kontraktuar, duhet të vëmë në dukje se ju nuk keni sjellë akoma mallrat e kontraktuara në vitet e kaluara. Kjo çështje ka rëndësi të madhe. Së dyti, në

¹ Në këtë mbledhje u diskutua për shtimin e mallrave të përdorimit të gjerë, për mbulimin e fuqisë blerëse me mallra dhe për qarkullimin monetar.

ndërmarrjet e Durrësit duhet të merrni masa dhe të bëni këlaudimin e shpejtë të mallrave të importit dhe jo të rrinë ato nga 5-6 muaj në magazinë pa t'u vihet çmimi. Prandaj punonjësit e ngarkuar me këtë detyrë të punojnë intensivisht. Në qoftë se mallrat janë kontraktuar, faturat duhet t'i keni në dorë që tash, kështu që, në bazë të tyre, të punohet për të vendosur çmimet përkatëse dhe, me të ardhur mallrat, të ngarkohen në trena e në makina dhe të shpërndahen.

Ju në Qeveri i gjetët fondet në 5 minuta, por mendoj se kjo nuk është një punë aq e lehtë sa t'i biesh lapsit për 5 minuta, se kështu, në mënyrë kaq të nxituar do të veprohej gabim. Duhet t'i mendojmë thellë që më përpara këto çështje dhe me kujdes e me llogari të saktë. Sigurisht, ne do të sjellim nga jashtë mallra të domosdoshme të përdorimit të gjerë, por duhet të mendojmë dhe të bëjmë përpjekje që gradualisht ato t'i prodhojmë në vend. Për të inkurajuar ngritjen e reparteve dhe të linjave të reja, ku do të prodhojmë shumë artikuj, mund ta rritim pak të drejtën e ndonjë ndërmarrjeje për të marrë fuqi punëtore mbi planin. Në këto raste kurdoherë duhet pasur parasysh që të shihet çështja e rendimentit dhe në asnjë mënyrë të mos merren vend e pa vend punëtorë të tepërt duke u nisur nga fakti se punëtorëve të rinj në linjat e reja nuk mund t'u kërkohet rendimenti sipas planifikimit.

Kur merren punëtorë më shumë nga sa parashikon plani, natyrisht që fondi i pagave tejkalohet. Por duhet të llogaritet qartë nëse këta punëtorë që janë marrë mbi planin e kanë ngrënë bukën kot, apo kanë pro-

dhuar dhe i kanë nxjerrë shpenzimet, kanë dhënë ose jo të ardhura më shumë, nëse është ulur ose jo kostoja e prodhimit, dhe, nëse është ulur, sa më pak apo më shumë nga parashikimi? Kështu bëhen llogaritë. Duke marrë parasysh se këta punëtorë mund të jenë dhe të rinj, sigurisht rendimenti i tyre nuk shtohet, megjithatë të mos stepeni me llogaritë. Sidoqoftë, leverdia jonë është e dyfishtë, sepse në këtë mënyrë do të zëmë më shumë njerëz me punë, por edhe pse do të prodhojmë në vend disa mallra për të cilat kemi nevojë.

Nga ana tjetër të kujdesemi që të rritim mekanizimin dhe, me gjithë këta miliona lekë valutë, që nuk mund të thuhet se i kemi të tepërt, më mirë të sjellim makineri qofshin edhe të pjesshme, për të prodhuar në vend mallra të tilla, sesa t'i blejmë këto të fundit jashtë. Gjithashtu, këto makineri t'i vëmë në punë shpejt, pse në këtë drejtim kemi një praktikë të keqe: pasi merret një vendim, në vend që të punohet shpejt për zbatimin e tij, diskutohet gjatë, për muaj të tërë për këto çështje.

Specialistët tanë të industrisë duhet të jenë në pararojë dhe të mos i zërë gjumi. Ata kanë detyrë të sugjerojnë se çfarë duhet të sillët nga jashtë dhe jo të presin nga të tjerët, sepse janë ekspertë në këtë punë. Është menduar të blihen jashtë një sërë fabrikash të vogla, por për këtë duhet të veprohet shpejt, të kontraktohen sa më parë, se fondet për këto objekte janë caktuar, po kuadrot tanë të tregtisë së jashtme s'po e kryejnë si duhet këtë detyrë. Këto çështje kanë rëndësi të madhe e nuk presin, prandaj të merren masa e t'u

kërkohet me insistim punonjësve të tregtisë së jashtme për t'i sjellë në kohë makineritë që nevojiten. Pra, duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet e të marrim çdo masë që varet nga ne dhe jo të kënaqemi duke thënë kemi kohë, aq më tepër kur, edhe pasi vijmë, mallrat qëndrojnë në Durrës me muaj pa u shpërndarë. Çdo gjë që varet nga ne, ta kryejmë shpejt, mirë e në kohë dhe të mos i zvarritim punët, ndryshe na krijohen situata të papëlqyeshme, pas të cilave kërkohen përsëri fonde shtesë.

Me këto çështje, ju, shokët e tregtisë, duhet të merreni më seriozisht. Kam dëgjuar se italianët me stofrat e Kombinatit të Tekstileve të Beratit bëjnë tekstile të mrekullueshme me një makinë stamposjeje. Nuk mund të blejmë edhe ne një makinë të tillë për përpunimin e mëtejshëm të stofrave? Pse «të vihet në plan» dhe të mos silllet sa më parë? Po t'i jepnim paratë në dorë përfaqësuesit tonë tregtar ai do të na e sillte makinën për 15 ditë. Me këto kombinat moderne që kemi mund të bëjmë shumë gjëra.

Importojmë akoma mjaft tekstile nga jashtë, kurse, po të sjellim fije dhe lëndë të para, çfarë nuk mund të bëjmë, ashtu siç bëjmë në Durrës me plastmasin: na u desh vetëm një makinë që kushtoi 20 000 lekë valutë. Fundja, sikur edhe shumë më tepër fonde të na duhen për makineritë e Kombinatit të Tekstileve në Berat për t'i bërë në vend tekstilet që na duhen na del shumë më lirë sesa të importojmë dy milionë metra linear tekstile çdo vit. S'ka pse të na mendojë koncepti që, ose të sjellim makineri komplet, ose s'ka. Sigurisht, do të

sjellim edhe pajisje të tilla komplet, por kur me disa pajisje të pjesshme mund të prodhojmë në vend një sërë mallrash të konsumit të gjerë, për të cilat harxhojmë çdo vit 2-3 milionë lekë valutë, atëherë të kujdesemi për të sjellë në radhë të parë këto makineri. Këtu futen të gjitha ato që u thanë për rendimentin, për plotësimin e nevojave të popullit me artikuj të tillë, për qarkullimin e monedhës etj.

Qeveria duhet t'i shohë një çikë më mirë këto çështje e të ketë më shumë iniciativë. Askush nuk e ka ndaluar atë të marrë të tilla masa se, fundja, këtu është dhe interesi ynë ekonomik. Jashtë ka plot mekanizma jo të rëndë që ne me devizën që disponojmë mund t'i blejmë dhe të kemi leverdi të konsiderueshme. Makineri të tilla mund dhe duhet t'i sjellim. Natyrisht, ne kemi edhe nevoja të tjera dhe nuk do t'i harxhojmë të gjitha paratë për mallra konsumi, por të mos trembemi kur na thonë se një makinë kushton shtrenjtë, po të nisemi dhe të shohim leverdinë që do të kemi prej saj.

Propozoj t'i shikojmë me këtë sy këto çështje, ndryshe nuk ka si na shtohet prodhimi i mallrave të konsumit të gjerë. Prodhimi i sandaleve të Ndërmarrjes së Gomës në Durrës u shtua atëherë kur sollëm makineritë e nevojshme, gjë që bëri të mundur të na mbushet tregu. Me enë kuzhine dyqanet do të mbushen kur të sjellim makinën e cingos etj. Në këtë mënyrë do të krijojmë rezerva për mallrat e konsumit, ndryshe nuk kemi si t'u japim zgjidhje këtyre problemeve. Në plan do të caktojmë për të importuar edhe të tilla mallra, por për sigurimin e tyre të vazhdueshëm të përpiqemi të

sjellim makineritë që i prodhojnë ato, pse nuk është e drejtë të japim fonde çdo vit për të sjellë mallra. Duhet, pra, të mendojmë për shtimin e mallrave në këtë rrugë të drejtë.

*Etohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË ÇAKTOHEN MIRË E TË RESPEKTOHEN KOMPETENCAT

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor¹*

23 shtator 1968

Përpara se të fillojmë nga diskutimet për këtë problem është e domosdoshme të dimë disa gjëra: nëse duhen apo jo këshillat popullorë të qyteteve dhe komitetet e tyre ekzekutive, apo mund t'ia dalë vetëm komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit punës me këshillat popullorë të lagjeve.

Pasi u shfaqën mendime për këtë çështje nga pjesëmarrës në mbledhje, që ishin ftuar nga disa rrethe, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Mendoj se është vështirë t'u jepen kompetenca të plota gjithë komiteteve ekzekutive të lagjeve të qytetit, kur në fakt, këto kompetenca s'ka arritur t'i ketë komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të qytetit. Si do të

¹ Në pikën e parë të rendit të ditës të kësaj mbledhjeje u diskutua raporti: «Për punën e këshillave popullorë dhe të komiteteve ekzekutive të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve».

kontrollohen me anë të komiteteve të lagjeve gjithë ato ndërmarrje që ka rrethi, kur, në fakt këtë nuk po e bën dot një komitet ekzekutiv qyteti? Si do të ndahen, pra, këto ndërmarrje në të gjitha lagjet që ka qyteti?

Pastaj lind problemi i kompetencave të komiteteve ekzekutive të lagjeve, të cilat duhet të jepen në bazë aktesh normative të shkruara, që puna e njërit komitet të mos ngatërrohet me punën e tjetrit, që asnjë të mos pretendojë se «këto kompetenca janë të miat, janë të mëhallës sime dhe jo të tuat», ose se «janë të tuat e jo të miat».

Kur një kooperativë bujqësore ndërton një furrë buke, kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit nuk bëhet pengesë, por ngul këmbë që të mbarojë shpejt, po kur shikon se duhet një furrë buke në qytet, këtë e pengon! Kjo s'është e mirë. Unë e kuptoj që këto ndodhin për arsye se nuk janë përcaktuar mirë kompetencat. Derisa shtatëdhjetë e ca për qind e fondit të qytetit të Shkodrës, bie fjala, konsumohet për qytetin, atëherë komitetit ekzekutiv të qytetit duhet t'i jepen kompetenca në problemet komunale, pra, ai komitet ta ketë fondin në dispozicion dhe të marrë përgjegjësi të plotë për çështjet komunale që i përkasin qytetit.

Siç është tani, problemi del pak a shumë kështu: Fondin e ka komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të qytetit, kurse për shpenzimin e tij vendos komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit. Mendoj se kjo ndarje nuk është e përshtatshme. Po të mendohet se ekzistenca e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të qytetit është e nevojshme, atëherë ai duhet të bëhet zot

i punës, të ushtrojë pushtetin për të gjitha problemet e qytetit, kurse komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit ka detyra dhe kompetenca në shkallë rrethi. Pra, në qoftë se do të jetë komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të qytetit, atëherë t'i jepen atij të gjitha kompetencat për qeverisje në njësinë administrative të qytetit. Duke i dhënë këto kompetenca, komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit nuk duhet të futet në to, pra, të mos i ndërhyjë e t'i bëjë presion komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të qytetit, siç ka bërë deri sot.

Kur krijohet një hallkë shtetërore, siç është komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të qytetit dhe i jepen kompetencat në bazë të të cilave ai zhvillon veprimtarinë e tij të ligjshme, atë nuk mund ta spostojë komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit. Sigurisht, do të bashkëpunohet midis instancave të ndryshme të organeve të pushtetit shtetëror të rrethit dhe të qytetit, por ky bashkëpunim të ndërtohet mbi bazën e parimeve të drejta të marrëdhënieve midis tyre. Këshilli popullor i rrethit, ka të drejtë të shfuqizojë aktet e paligjshme ose të parregullta të komitetit ekzekutiv të një instance më të ulët, por kompetencat midis tyre duhet të jenë të përcaktuara. Organi më i lartë duhet të mbiqëqyrë dhe të bashkëpunojë me organin më të ulët, por s'ka të drejtë ta mënjanojë ose ta zëvendësojë këtë të fundit.

Komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit drejton fshatin dhe qytetin, por çështja është se si i drejton. Qeveris nëpërmjet këshillave popullorë në qytet dhe në fshat, apo i kapërcen këto hallka të pushte-

tit në bazë? Këto organe të pushtetit, në forma të ndryshme, lidhen me të si rreth, sepse ai është organi ekzekutiv dhe urdhërdhënës i këshillit popullor të rrethit dhe përgjigjet për punët e pushtetit në rreth. Pra, këshilli popullor i fshatit, qoftë drejtpërdrejt, qoftë indirekt duhet të lidhet me komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, sepse edhe ky, si rreth, mban lidhje me Qeverinë, me ministritë, me Presidiumin e Kuvendit Popullor. Këto lidhje ai i mban për nevojat dhe për problemet e rrethit me qendrën dhe me bazën. Këshilli popullor i rrethit kryen të gjitha detyrat që ka me ligj, në fushat politiko-administrative, të industrisë, të tregtisë, të arsimit, të financës, të komunales, të shëndetësisë, të bujqësisë etj., ai ndan përpjesëtimisht dhe sipas nevojave fondet për fshatin, për qytetin.

Gjithashtu direktivat, rrethi ua jep ndërmarrjeve vartëse, por dhe këto duhet të kenë dy lidhje: së pari, atë më kryesoren, me rrethin, për plotësimin e planit të prodhimit dhe të shpërndarjes sipas vendimit të këshillit popullor të rrethit dhe, së dyti, me komitetin ekzekutiv të qytetit për të gjitha ato çështje që, sipas planit, i kanë kaluar atij në kompetencë. Interesimi dhe drejtimi i këshillit popullor të rrethit për fshatin, në gjendjen siç është ai sot, duhet të jenë diçka më direkte. Pra, duke vepruar në këtë mënyrë, ai do të lehtësohet nga detyrat e pushtetit për qytetin dhe do të futet më thellë në problemet e rrethit. Atje ku ka komitete ekzekutive, në zona të thella, t'u rritet atyre përgjegjësia.

Këshilli popullor i rrethit ka detyrë të kontrollojë nëse vajtën mallrat në fshat, si furnizohet populli, si i

shërbehet atij etj., gjithashtu, është përgjegjës për plotësimin e nevojave të qytetit dhe, nga ana tjetër, të japë llogari për mosplotësimin e nevojave të popullit, por edhe vetë komiteti ekzekutiv i qytetit, sikurse thamë, të marrë në dorë drejtimin e të gjitha problemeve që i përkasin. Paska apo nuk paska mallra në një dyqan, furnizohet ose jo me sendet e duhura ky etj., me këtë punë nuk duhet të merret komiteti ekzekutiv i rrethit, por i qytetit. Komiteti ekzekutiv i rrethit interesohehet kur nuk ka mallra ndërmarrja grosiste që furnizon qytetin dhe fshatin, që furnizon krejt rrethin. Shokët e komitetit ekzekutiv të qytetit përgjigjen në qoftë se dyqani mbetet bosh dhe nuk janë marrë masa të organizohet sa më parë furnizimi në këtë apo në atë njësi.

Ka ndërmarrje që, megjithëse i shërbejnë qytetit, varen nga rrethi. Domethënë komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të qytetit, të cilit i vijnë kërkesat për nevojat e popullit, nuk urdhëron dot, nuk e thërret dot drejtorin e ndërmarrjes, sepse ndërmarrjet varen nga komiteti ekzekutiv i rrethit. Pse është lejuar që këto ndërmarrje të varen vetëm nga rrethi? Kjo vjen sepse komiteti ekzekutiv i rrethit e ka «syrin» të madh dhe kërkon t'i ketë në mbikëqyrje të gjithë vetë. Kur them komitet ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit, këtu kam parasysh kuadrot me eksperiencë, që janë të lidhur me qendrën, që vijnë në Qeveri dhe thonë se u duhen këto apo ato fonde, jo vetëm për buxhetin, por edhe për furnizimin e fshatit dhe të qytetit, e kam fjalën për ata shokë që kontrollojnë lëvizjen e gjithë mekanizmit në tërë rrethin. Komiteti ekzekutiv i këshillit

popullor të rrethit ka me se merret, mos të trembet se mbetet pa punë, prandaj ai nuk duhet të kryejë edhe punët e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të qytetit, sepse nuk ka kohë dhe mundësi t'i bëjë këto.

Lidhur me këto duhet parë mirë në praktikë dhe çështja e aktivizimit të këshilltarëve. Nuk bëhet fjalë që të kemi këshilltarë funksionarë, sepse ne nuk e kalojmë drejtimin e pushtetit popullor në duart e rrogëtarëve burokratë, por të zgjedhurit, që janë përfaqësuesit e popullit, të luajnë plotësisht rolin e tyre.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Presi-
diumit të Kuvendit Popullor
të RPSSH që gjendet
në AQP*

REVOLUCIONARËT LUFTOJNË NË DY FRONTE: KUNDËR IMPERIALIZMIT DHE KUNDËR REVIZIONIZMIT

*Nga fjala në pritjen e dhënë nga ambasada
e RP të Kinës¹*

30 shtator 1968

*Pasi u përshëndet me ambasadorin e me miq të
tjerë dhe pasi uroi për festën e Republikës Popullore
të Kinës, shoku Enver Hoxha bëri një pasqyrë të gj-
ndjes aktuale ndërkombëtare:*

Shokë dhe shoqe,

Sistemi imperialist dhe revizionizmi modern po ka-
lojnë tani një krizë të madhe politike dhe ekonomike,
që vjen gjithnjë duke u thelluar. Ajo është rezultat i
hovit revolucionar të popujve dhe i zgjerimit të luftës
së tyre kundër shtypjes e shfrytëzimit borgjez, kundër

¹ Kjo pritje u dha me rastin e 19-vjetorit të shpalljes së Republikës Popullore të Kinës.

kolonializmit të vjetër e të ri. Politika grabitqare agresive e imperializmit amerikan, si dhe kursi hegjemonist e shovinist i revizionistëve sovjetikë, bashkëpunimi sovjeto-amerikan gjithnjë e më i hapur e më brutal për ndarjen e zonave të influencës dhe për vendosjen e sundimit të dy fuqive të mëdha mbi botën, kanë ngjallur kudo një rezistencë të fuqishme nga ana e masave punonjëse dhe e popujve revolucionarë. Stuhia e luftës revolucionare kundër imperializmit dhe revizionizmit po përhapet në të gjitha kontinentet. Me gjithë përpjekjet e dëshpëruara të borgjezisë e të revizionizmit, mjetet e shumta që disponojnë dhe shpenzimet e tyre kolosale për të trullësuar mendjet e njerëzve, idetë e revolucionit dhe të luftës çlirimtare çdo ditë e më tepër po bëjnë për vete popujt dhe revolucionarët e vendeve të ndryshme.

Kudo që kanë ndërhyrë imperialistët amerikanë, kanë shpërthyer rezistenca popullore dhe lufta me armë. Vietnami është një shembull i madh. Popujt e Amerikës Latine janë ngritur kundër sundimit janki dhe revolta e tyre zgjerohet vazhdimisht. Lëmshi i kontraktave midis partnerëve të imperializmit amerikan po ngatërrohet gjithnjë e më shumë.

Kriza e madhe politike dhe ekonomike që ka mbërthyer botën kapitaliste dhe revizionizmin modern po i revoltton edhe më tepër masat e shfrytëzuara, i afron ato edhe më tepër me revolucionin. Gjatë këtij viti në shumë vende kapitaliste dhe revizioniste shpërtheu lëvizja e gjerë e studentëve, që u përkrah fuqimisht nga punëtorët dhe që tronditi rëndë kudo themelet e pushtetit politik dhe ekonomik të borgjezisë.

Ky zjarr i ri revolucionar nuk mund të shuhet lehtë, pasi ai ushqehet nga gjendja e padurueshme e shtypjes dhe e shfrytëzimit kapitalist të punonjësvë, nga mbyllja e perspektivës së jetës që borgjezia i bën brezit të ri. Lëvizja e studentëve dhe e të rinjve është një forcë e madhe revolucionare, e cila akoma nuk e ka treguar gjithë forcën e saj. Atë e lufton me të gjitha mjetet borgjezia dhe e sabotojnë me të gjitha mënyrat revizionistët.

Por si studentët ashtu edhe klasa punëtore fituan një eksperiencë të madhe gjatë luftërave të tyre, rritën ndërgjegjen klasore dhe mësuan si t'i njohin më mirë armiqtë. Sa më mirë do të dijë të koncentrohet e të organizohet, sa më shpejt do të pastrohet nga elementët e huaj anarkistë, oportunistë, revizionistë e të tjerë, sa më mirë do të kanalizohet në valën e madhe të revolucionit proletar, aq më shpejt lëvizja e studentëve do të shkojë gjithnjë në ngjitje. Idealet e saj, lëvizja revolucionare e studentëve, mund t'i realizojë vetëm në unitet me klasën punëtore dhe kur mendjet dhe zemrat e të rinjve do të pushtohen nga idetë ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit, nga teoria shkencore e revolucionit proletar.

Imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë, të tronditur nga hovi revolucionar i masave dhe të tërbuar nga kriza e përgjithshme që po kalon sistemi i tyre, janë hedhur në aventura të rrezikshme dhe po kryejnë agresione të hapëta kundër popujve, për t'u grabitur lirinë e pavarësinë kombëtare, për t'i nënshtruar e për t'i skllavëruar. Aleanca famëkeqe kundërrevolucionare sovjeto-amerikane për ndarjen e zo-

nave të influencës dhe për sundimin e botës ka hyrë tanimë në veprim. Ndërsa Shtetet e Bashkuara vazhdojnë luftën barbare në Vietnam, duke pasur për qëllim të zgjerojnë flakët e agresionit në të gjithë Azinë, klika tradhtare e Brezhnjev-Kosiginit ndezi një vater tjetër agresioni në qendër të Evropës, duke u bërë kërcënime e shantazhe popujve të këtij kontinenti.

Agresioni kundër Çekoslovakisë është një produkt i shëmtuar i strategjisë globale kundërrevolucionare sovjeta-amerikane kundër lirisë së popujve, i ndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve të tjera.

Ndërhyrja e armatosur e revizionistëve sovjetikë në Çekoslovaki i vuri kapakun faktit të hidhur, por të vërtetë, se Bashkimi Sovjetik është shndërruar tanimë në një shtet imperialist, i cili zbaton në mënyrën më të hapur e më brutale politikën shoviniste revizioniste rusomadhe. Ajo tregoi se politika e udhëheqësve revizionistë sovjetikë është një politikë tipike imperialiste, se pushteti që ata mbajnë në duar është një pushtet tipik borgjez që shtyp popullin sovjetik dhe kërcënon të tjerët, se Bashkimi Sovjetik është transformuar në një qendër kundërrevolucionare kundër lirisë e pavarësisë së popujve të të gjithë botës.

Agresioni kundër popullit çekoslovak e bëri, gjithashtu, më të qartë edhe qëndrimin me dy faqe të revizionistëve sovjetikë ndaj Vietnamit, të cilin ata e kanë tradhtuar dhe e kanë shitur një mijë herë. Qëndrimin dashamirës të imperializmit amerikan ndaj agresionit të aleatëve të tyre në Çekoslovaki revizionistët sovjetikë përpiqen t'ua shpërblejnë amerikanëve po në atë mënyrë në Vietnam, duke sabotuar luftën çlirim-

tare të popullit vietnamez dhe duke bërë çmos që ai të gjunjëzohet dhe të kapitullojë përpara agresorëve.

Ndërhyrja e armatosur në Çekoslovakia u jep gjithë popujve mundësinë të shikojnë fytyrën e vërtetë të revizionistëve sovjetikë, të njohin më mirë qëllimet imperialiste dhe metodat e tyre fashiste, të kuptojnë shkallën e degjenerimit ideologjik e politik të revizionistëve.

Degjenerimi i mëtejshëm i revizionistëve sovjetikë, natyrisht, do të zhvillohej në drejtimin e shovinizmit të theksuar të shtetit të madh, për t'u imponuar vullnetin, me forcën e armëve, partnerëve të tyre në ideologji, por të pabindur në urdhrat dhe në diktatet e socialimperialistëve. Sloganet dhe frazeologjia pseudo-marksiste që ishin tjerrur për disa vite me radhë, nuk mund të shërbenin më jo vetëm për të zbutur divergjencat e mëdha që po thelloheshin, por as për t'i fshehur ato.

Demagogjia revizioniste në politikë, në ideologji, në marrëdhëniet ekonomike, kulturore dhe në aleancat ushtarake s'kishte më fuqi vepruese. Dolën sheshit dhëmbët e ujkut. Revizionizmi sovjetik kaloi në militarizmin e tipit fashist. Tani për zgjidhjen e kontradiktave ai kërcënon me agresion të armatosur dhe pushton ato shtete «aleate» të pabindura ndaj diktatit të tij. Ai sulmoi dhe pushtoi Çekoslovakinë. Askush nuk mund të gënjëhet se revizionistët sovjetikë, po aq, bile edhe më shumë të degjeneruar se klika revizioniste çekoslovakë e Dubčekut, kanë pasur të drejtën morale, politike dhe ideologjike të ndërhyjnë me armë dhe të vinin rregull në Partinë Komuniste Çekoslovakë dhe në Repu-

blikën Socialiste të Çekosllovakisë, në një kohë kur ata vetë janë iniciatorët dhe përkrahësit e këtij degjenerimi kapitalist, kur ata vetë e kanë shndërruar partinë e tyre komuniste në një parti revizioniste dhe Bashkimin Sovjetik në një vend kapitalist.

Askush nuk mund t'i besojë legjendës së kurdisur se gjoja Bashkimi Sovjetik u detyrua të pushtojë me armë Republikën Socialiste të Çekosllovakisë sepse kjo rrezikohej të sulmohej nga imperialistët. Në këtë rast, jo vetëm imperialistët amerikanë nuk morën mundimin të ngrinin as majën e gishtit, por as Gjermania e Bonit nuk tregoi nervozizëm, megjithëse edhe në kufijtë e saj të jugut i erdhën forca të shumta sovjetike. Situata të çuditshme për legjendën sovjetike «të komplotit», e cila nuk qëndron dot në këmbë, edhe pse po trumbe-tohet me forcë.

Qëllimi strategjik i revizionizmit hrushovian është vendosja e hegjemonisë botërore të Bashkimit Sovjetik, në aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat, si dy superfuqi, duan të sundojnë botën, duke ndarë zonat e influencës.

Kuptohet se vendet ku sundojnë revizionistët modernë janë zona jo vetëm të influencës sovjetike, por ato konsiderohen *de facto*, në mos *de jure*, nën sundimin direkt të tyre.

Renegatët hrushovianë, që tradhtuan marksizëm-leninizmin, popujt e Bashkimit Sovjetik, Leninin, Stalinin dhe revolucionin botëror, menduan, me megalomaninë e tyre shoviniste të shtetit të madh, se jo vetëm satelitët e tyre revizionistë do t'i kishin në zap, por me demagogji, me shantazhe dhe me rubla e do-

llarë do të mashtronin gjithë botën. Por as njërën, as tjetrën nuk e arritën dot. Lufta heroike, parimore, e zjarrtë, e pashuar kurrë dhe kurdoherë në ngjitje që zhvillohet nga ne e partitë e tjera marksiste-leniniste ua çorën maskën, ua prishën planet. Revizionistët sovjetikë nuk qenë në gjendje të ndalonin procesin e dezintegritimit politik, ideologjik dhe ekonomik të kampit revizionist. Ata i mbuloi kriza politike dhe degjenerimi ideologjik, u zhvillua policentrizmi, kurse kriza ekonomike kudo, në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet ku në fuqi janë revizionistët mbretëron dhe është shumë e thellë.

Një situatë e tillë nuk është vetëm në Çekosllovakia ku shpërtheu kriza, por ajo është edhe në Poloni, në Gjermaninë Lindore, në Hungari etj. Mbi të gjitha, ajo është e tillë brenda në Bashkimin Sovjetik.

Pra, përçarja e perandorisë revizioniste sovjetike kërcënohet më parë nga brenda sesa nga një komplot ushtarak «imediat» imperialist nga jashtë, siç pretendojnë sovjetikët «për të argumentuar» agresionin e tyre mbi Çekosllovakinë.

Situata, pra, paraqitet kështu: harmonia gjoja e vendosur në kampin revizionist është prishur, sundimi i revizionistëve sovjetikë është në rrezik dhe nuk mund më të ristabilizohet me anë formulash e sloganesh, as me premtime e shantazhe, por me forcën e armëve. Revizionistët sovjetikë dhe revizionistët në vendet satelite të tij kanë kaluar në një fazë tjetër të re, në fazën e një diktature militariste fashiste.

Gjendja në Bashkimin Sovjetik duhet të jetë aq e vështirë — dhe këtë e vërtetojnë shtypja, terrori, cen-

sura, deportimet — saqë revizionistët në fuqi u detyruan të vendosin diktaturën ushtarake fashiste për të shtypur revolucionin brenda në Bashkimin Sovjetik e në vendet ku sundojnë revizionistët dhe njëkohësisht, nën pretekstin e Traktatit të Varshavës, nën pretekstin e «mbrojtjes së vendeve socialiste», të marrin në dorë *manu militari* gjendjen kudo në këto vende. Këtu ata vendosën forca sovjetike dhe klikat në fuqi o do t'u binden plotësisht sovjetikëve, ose do të qërohen dhe, në vend të tyre, do të sillen kuislingë të hapët.

Tani në këto vende ushtron pushtet të plotë ushtarak, politik, ideologjik mareshali Jakubovski, përfaqësuesi ushtarak i juntës së Moskës, i cili shëtit kryeqytet më kryeqytet, u jep direktiva forcave të tij pushtuese dhe mban nën terror klikat revizioniste, që janë në udhëheqje të vendeve satelite.

Natyrisht, veprimet e revizionistëve sovjetikë nuk mund të ndalin evolucionin e procesit të dezintegrimit dhe të krizës së revizionizmit dhe ca më pak hovin e revolucionit. Revolucioni, rezistenca në Bashkimin Sovjetik, në Çekoslovaki, në vendet ku sundojnë revizionistët dhe në të gjithë botën do të marrë një hov të madh, do të kristalizohet më shumë, do të konsolidohet dhe do të hyjë në një stad të ri cilësor akoma më aktiv dhe luftarak.

Revolucionarëve, popujve, patriotëve do t'u çelen akoma më mirë sytë dhe do të ndjekin pa frikë rrugën e luftës, rrugën e revolucionit, ku i udhëheq marksizëm-leninizmi.

Por veprimet agresive sovjetike nuk do të pengojnë dot, gjithashtu, as rezistencën e asaj pjese të bor-

gjezisë së re revizioniste që aspiron të çlirohet nga zgjedha e borgjezisë sovjetike për të vendosur diktaturën e vet fashiste. Shumë parti revizioniste dolën hapur kundër ndërhyrjes sovjetike në Çekosllovakë. Ato u gjendën midis dy zjarresh: ose me borgjezinë e vendit të tyre, ose me klikën militariste fashiste të revizionistëve sovjetikë. Ky presion do të vijë duke u thelluar dhe do të ndjekë atë temp zhvillimi në raport me acarimin e me thellimin e kontradiktave të dy fuqive të mëdha imperialiste, amerikane dhe sovjetike.

Divergjencat midis revizionistëve do të degjenerojnë në përleshje në mbledhjen e ardhshme të Budapestit, ku do të vendoset fati i konferencës së Moskës, që revizionistët duan të mbajnë në nëntor. Partia jonë e Punës që me kohë ka parashikuar falimentimin e turpshëm të kësaj mbledhjeje. Që të vihet pak rregull në debatet e Budapestit dhe që të çojnë në Moskë bohemen revizioniste, udhëheqësit sovjetikë nuk do të bënin keq të dërgonin në Budapest mareshalin Jakubovski dhe, për çdo eventualitet, drejtorin e Gosbankës.

Kompleksi i gjerë i kontradiktave midis klikave revizioniste në fuqi, midis partive të ndryshme revizioniste dhe midis imperialistëve e revizionistëve do të zgjerohet e do të thellohet në dëmin e tyre dhe në favorin e revolucionit. Prandaj revolucionarët duhet të organizojnë luftën në dy fronte, si kundër imperializmit ashtu edhe kundër revizionizmit.

Rezistenca kundër klikave revizioniste në fuqi ka filluar dhe po rritet. Në Çekosllovakë këtë rezistencë nuk e përfaqëson as borgjezia çeke, as klika revizio-

niste e Dubçek-Svobodës, që kapitulloi përpara push-tuesve, por klasa punëtore dhe masat punonjëse të popullit çekoslovak. Marksistë-leninistët e vërtetë duhet të dalin në krye të rezistencës, të kuptojnë mirë dhe të mos konfundojnë kurrë në Çekoslovakia ose gjatë «rezistencën» e klikave të tipit të Dubçekut, ose të ndonjë tjetri si ai, me rezistencën dhe me luftën e vërtetë të popullit, të klasës punëtore. Kjo duhet të organizohet e të udhëhiqet nga komunistët revolucionarë kundër imperialistëve, kapitalistëve të jashtëm dhe të brendshëm, kundër revizionistëve sovjetikë, pushtuesve dhe klikave revizioniste satelite e kuislingëve të tyre.

Ky proces i rritjes së rezistencës po ngjet e do të ngjasë në të gjitha vendet. Ai po ngjet edhe në Bashkimin Sovjetik. Ne kemi besim se revolucionarët e bolshevikët sovjetikë do të ngrihen dhe, si trashëgimtarë të heronjve të Revolucionit të Madh të Tetorit do të sulen mbi tradhtarët revizionistë dhe do të rivendosin diktaturën e proletariatit në Bashkimin Sovjetik. Por revolucionarët e vendeve të ndryshme nuk duhet të presin që të ngrihen më parë bolshevikët sovjetikë, meqë në Bashkimin Sovjetik kanë lindur Lenini e Stalini, udhëheqësit e mëdhenj të Revolucionit të Tetorit. Lenini dhe Stalini nuk i përkasin vetëm Bashkimit Sovjetik, por të gjithë revolucionarëve të botës. Bolshevikët rusë, në kohën e tyre, bënë Revolucionin e Tetorit dhe nuk pritën që, më parë, në revolucion të ngrihej Partia Komuniste Gjermane pse Marksi e Engelsi ishin gjermanë. Revolucionarët e vërtetë marksistë-leninistë sovjetikë, në luftën e tyre kundër klikës tradhtare revizioniste

sovjetike duhet të frymëzohen nga Revolucioni i Madh i Tetorit dhe nga mësimet e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit.

Shokë dhe shoqe,

Populli ynë po e forcon gjithnjë e më shumë bashkimin e tij, po e çelikos përditë e më tepër unitetin e tij luftarak rreth Partisë së Punës dhe po e çon pa undalur përpara revolucionin e tij fitimtar. Planet tona në industri, në ndërtim, në transport dhe në të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë po plotësohen dhe po tejkalohen kudo. Me një hov të madh po ecin përpara bujqësia jonë socialiste dhe arsimi e kultura.

Si rezultat i punës vetëmohuese të klasës sonë punëtore, të fshatarësisë punonjëse, të grave heroike, të rinisë sonë të palodhur, jeta e popullit po bëhet përditë e më e mirë, po ngrihet vazhdimisht niveli i jetesës i masave punonjëse.

Në atmosferën e entuziazmit të lartë revolucionar që ka shpërthyer tani në vendin tonë, populli shqiptar i është përveshur punës me një hov të ri për të vënë në jetë programin madhështor të Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së tij, për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e atdheut, për të garantuar e për të zhvilluar më tej fitoret e revolucionit tonë popullor.

Ne po hyjmë në vitin e jubileut të lavdishëm të 25-vjetorit të Çlirimit më të fortë se kurrë, me besim të madh në forcat tona dhe të vendosur për ta bërë Shqipërinë socialiste edhe më të bukur, edhe më të be-

gatshme, një kala të pamposhtur të socializmit e të komunizmit.

Vendi ynë ka ndjekur një politikë të jashtme konsekuente e parimore. Pikërisht duke u udhëhequr nga kjo politikë, populli shqiptar, Partia e tij e Punës dhe Qeveria e tij, duke u nisur nga mbrojtja e interesave të lartë të vendit tonë dhe të frymëzuar nga mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit dhe nga parimet e internacionalizmit proletar, kanë mbajtur ndaj agresionit të revizionistëve sovjetikë në Çekosllovakia dhe ndaj ngjarjeve të tjera lidhur me të qëndrim të drejtë revolucionar, parimor dhe konsekuent. Ky është qëndrimi i një partie dhe i një populli që kanë paralajmëruar me kohë për pasojat katastrofike që i presin vendet e Evropës Lindore, ku sundojnë revizionistët. Në emër të idealeve të larta revolucionare që frymëzojnë luftën tonë pa kompromis kundër imperializmit dhe revizionizmit, ne e denoncuam dhe e dënuam me forcën më të madhe agresionin në Çekosllovakia. Ne kemi qenë dhe do të jemi kurdoherë mbrojtës të vendosur të së drejtës së sovranitetit, të lirisë e të pavarësisë së popujve. Ne kemi qenë dhe do të jemi kurdoherë përkrah popujve vëllezër të vendeve që vuajnë nën sundimin revizionist, dhe, veçanërisht, të popullit çekosllovak, që pësoi këtë fatkeqësi.

Vendimin historik që mori Kuvendi ynë Popullor për denoncimin e Traktatit të Varshavës, i cili, siç është tanimë i qartë për të gjithë, është kthyer në një Traktat agresiv, e aprovoi me unanimitet dhe me entuziazëm mbarë populli shqiptar.

Si një trup i vetëm janë ngritur tani në këmbë

burra e gra, i madh e i vogël dhe, me një entuziazëm të ri revolucionar, po tregojnë vendosmërinë e tyre për të ecur me guxim e ballëlart në rrugën ku na udhëheq Partia, për të mbajtur kurdoherë lart e të pashuar fenerin e marksizëm-leninizmit këtu në brigjet e Adriatikut.

Kjo është një shprehje tjetër konkrete e patriotizmit të lartë që karakterizon popullin tonë, e besimit të patundur që masat tona punonjëse kanë te Partia e Punës. Manifestimi i shkëlqyer i unitetit të çeliktë politik, i gatishmërisë dhe i vigjilencës luftarake që populli ynë shfaqti këto ditë, tregon forcën e Partisë sonë, të ideologjisë marksiste-leniniste. Gjithë populli ynë sypatrembur, me frymë të lartë revolucionare, duke shtrënguar edhe më fort në duart e tij të fuqishme kazmën dhe pushkën, po realizon detyrat më mirë se kurrë ndonjëherë. Me gjakftohtësi shembullore ai punon e vigjilon pa iu trembur syri nga kurrkush, sepse është në të drejtën e tij dhe ka besim të patundur në forcën e vet dhe të miqve të shumtë në të gjithë botën.

Kur Partia e Punës e Shqipërisë i çori maskën tradhtarit Nikita Hrushov, ky nuk gjeti argument tjetër kundër saj veçse të trillonte se «udhëheqja shqiptare u shit për 30 aspra tek imperialistët». Edhe tani tradhtarët hrushovianë, Brezhnjevi, Kosigini dhe shërbëtorët e tyre, kur Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë denoncuan Traktatin e Varshavës si një Traktat agresiv, s'gjetën argument tjetër veçse të shpifin se «udhëheqja shqiptare e shiti Shqipërinë tek imperializmi».

Në Bashkimin Sovjetik tani ndyrësirat po mbytin kanalet e Radio Moskës, shtypin revizionist sovjetik,

të Gomulkës, të Zhivkovit etj. TASS-i dhe Radio Moskë, të cilat ushqejnë edhe radiot e satelitëve, zbuluan një mëngjes në një gazetë bulevardi fashiste italiane, të quajtur «Hëna», se gjoja «udhëheqja shqiptare paska hyrë në tratativa të fshehta me vendet perëndimore dhe me fashistët e Athinës». Qentë lehin në hënë dhe është e natyrshme që ata ta kuptojnë gjuhën e njëri-tjetrit.

Nga ana e saj, gazeta lëvere e Gomulkës na zbuloi se «ekonomia shqiptare qenka vënë nën varësinë e Italisë».

Trillime e shpifje të tilla nuk e njollosin dot Shqipërinë socialiste, as udhëheqjen e saj. Gjithë bota e kupton se këto u duhen klikës hrushoviane sovjetike dhe klikave të tjera revizioniste në fuqi për të hedhur hije mbi politikën e drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila shkëlqen si drita e diellit, gëzon simpatinë dhe përkrahjen e zjarrtë të popujve.

Para disa ditësh Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, në notën që i dërgoi qeverisë bullgare¹, demaskoi rrezikshmërinë që paraqit transformimi i territorit bullgar nga ana e klikës së Zhivkovit në një vatër agresioni të revizionistëve sovjetikë. Qëndrimi i Qeverisë Shqiptare në këtë rast i shërben mbrojtjes së lirisë e të pavarësisë së popujve të Ballkanit e, në radhë të parë, të popullit shqiptar e të vetë popullit bullgar. Nota shqiptare është një paralajmërim shumë serioz që i bëhet klikës renegate të Todor Zhivkovit, e cila duhet

1 Notë e Qeverisë së RP të Shqipërisë drejtuar qeverisë së RP të Bullgarisë më 21 shtator 1968. Shih: «Zëri i popullit», nr. 228 (6267), 22 shtator 1968.

të respektojë Traktatin shqiptaro-bullgar. Ajo është një paralajmërim serioz se Republika Popullore e Shqipërisë dhe populli shqiptar do të dënojnë rreptësisht çdo agresion kundër lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit të popujve të Ballkanit dhe të botës.

Militaristët fashistë sovjetikë, që kanë përqendruar trupat e tyre agresive në Republikën Popullore të Bullgarisë, dhe klika e Todor Zhivkovit, e cila ka lejuar që toka bullgare të kthehet në një bazë agresive kundër popujve të Ballkanit, dhe në mënyrë të veçantë kundër Shqipërisë, nuk gënjejnë kërrkënd kur thonë se gjoja ne shpifim për praninë e këtyre trupave në territorin bullgar. As qenia e trupave sovjetike në territorin bullgar, as qëllimet agresive të revizionistëve sovjetikë për të prishur paqen në Ballkan nuk fshihen dot me një deklaratë-leckë të agjencisë bullgare të lajmeve, e cila, nën diktatin sovjetik, mund të bëjë njëzet të tilla në ditë. Bota e ka të freskët deklaratën e Bratislavës, deklaratë «solemne», bile me firma e me vula, mbi të cilën, pa u tharë akoma boja, kaluan tanket sovjetike që pushtuan Çekosllovakinë.

Ne i drejtohem popullit vëlla bullgar që të jetë shumë vigjilent dhe të marrë masa të rrepta e imediate kundër pushtuesve të rinj të vendit të tij, që quhen revizionistë sovjetikë, dhe kundër shërbëtorëve të tyre, kuislingëve bullgarë Todor Zhivkov e kompani. Si miq të vërtetë e besnikë që jemi me popullin vëlla bullgar, e kemi për detyrë të flasim hapur dhe ta paralajmërojmë se çdo orvatje agresioni që mund t'i vijë Shqipërisë socialiste nga territori bullgar, nga agresorët revizio-

nistë sovjetikë dhe shërbëtorët e tyre, do të asgjësohet menjëherë dhe fitorja do të jetë e popullit shqiptar.

Askush të mos mendojë se Shqipëria është një vend i vogël, me të cilin mund t'i qërojnë lehtë hesapet. Çdo orvatje e armiqve, qofshin këta imperialistë, revizionistë apo satelitë të tyre, për të cenuar sadopak integritetin e Republikës Popullore të Shqipërisë do të bëhet hi në zjarrin e luftës së armatosur të popullit tonë. Le ta mbajnë mirë shënim këtë armiqtë tanë dhe miqtë le të jenë të sigurt se populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës do t'i kryejnë me nder detyrat e tyre kombëtare e ndërkombëtare.

Populli shqiptar nuk kërcënon njeri dhe nuk i bie më qafë askujt. Ai do të rrojë në fqinjësi të mirë mbi bazën e parimeve të mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve të tjera, të respektimit të sovranitetit kombëtar dhe të moscenimit të integritetit tokësor.

Por askush të mos shkojë me iluzione se popullin shqiptar mund ta gjejë në gjumë. Barutin ne do ta mbajmë gjithnjë të thatë dhe kushdo që do të guxonte të prekte kufijtë tanë të shenjtë, qofshin këta imperialistët amerikanë, revizionistët sovjetikë ose ndonjë agresor tjetër, do të gjente vdekjen e sigurt. Të gjithë duhet ta kenë të qartë dhe askush të mos ketë iluzione se, besnikë të vijës sonë revolucionare, ne, si kurdoherë, do të qëndrojmë në ballë të luftës për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit dhe do të luftojmë ideologjikisht e politikisht të gjithë deviatorët e çështjes së socializmit e të komunizmit, nën çdo maskë që ata të fshihen.

Shokë dhe shoqe,

Imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik, duke ndjekur marrëzisht politikën e tyre agresive, janë hedhur në aventura të rrezikshme dhe po kërcënojnë popujt e botës. Por kjo s'do të thotë aspak se ata janë të fuqishëm. Ka kaluar ajo kohë kur fuqitë imperialiste mund të vepronin lirisht kundër popujve dhe të mbeteshin pa u dënuar. Historia ka vërtetuar se fitorja, në fund të fundit, u përket popujve, u përket forcave revolucionare përparimtare.

Situata e sotme për forcat antiimperialiste e anti-revizioniste është e mirë, perspektivat janë të shkëlqyera. Bota ka hyrë në epokën në të cilën fitorja e luftërave çlirimtare të popujve, e forcave marksiste-leniniste e të revolucionarëve të vërtetë, triumfi i socializmit dhe i komunizmit, nuk mund të ndalen. Zhvillimi i ngjarjeve çon në mënyrë të pashmangshme në dështimin e imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe të revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye. Urrejtja dhe lufta e popujve do t'i përblajnë ata përfundimisht nga faqja e dheut.

Partia e Punës e Shqipërisë duke mbajtur lart flamurin e marksizëm-leninizmit, do të ecë gjithnjë e paundur përpara dhe do të korrë suksese të reja, edhe më të mëdha, në luftë për mbrojtjen e interesave të lartë të vendit, për triumfin e socializmit e të komunizmit.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 235 (6274), 1 tetor 1968

Botohet me disa shkurtime sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DËSHTIMI SKANDALUZ I KONFERENCËS SË PËRGJITHSHME REVIZIONISTE

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

8 tetor 1968

Një grup delegatësh të partive e të grupeve të ndryshme revizioniste u mblodh para disa ditësh në Budapest, për të diskutuar përsëri çështjen e mbledhjes së partive revizioniste, të cilën ka tanimë gati pesë vjet që e kërkojnë me këmbëngulje udhëheqësit sovjetikë. Në fund u lëshua një komunikatë, e cila thotë se pjesëmarrësit e komisionit përgatitor «do të rishqyrtojnë përsëri çështjen për datën e mbledhjes ndërkom-bëtare dhe, pasi të bëjnë konsultime me komitetet qendrore të partive të tyre, do të mblidhen sërish më 17 nëntor në Budapest, ku do të shqyrtohet çështja për afatin e thirrjes së mbledhjes dhe rendin e përgatitjes së saj të mëtejshme».

Këta pak rreshta, që i ngjajnë një njoftimi funebër, shpallin kështu botërisht se e famshmja mbledhje e Moskës, e caktuar për më 25 nëntor të këtij viti, vdiq përfundimisht nën zinxhirët e tankeve sovjetike, që pushtuan Çekosllovakinë. Shtytja e saj për në ka-

lendat greke nuk është tjetër veçse një ngushëllim i rastit për iniciatorët e saj sovjetikë. Të gjithë tani e shohin dhe e kuptojnë se ajo tingëllon si një rekuiem për këtë dështim të ri të tyre skandaloz. Sa më gjatë të vazhdojnë «karnavalet e Budapestit», aq më tepër do të shtohen edhe grindjet e përleshjet midis grupimeve të ndryshme revizioniste, aq më i madh do të jetë edhe diskreditimi i tyre.

Dihet mirë se ç'rëndësi të jashtëzakonshme i kanë dhënë udhëheqësit sovjetikë dhe ç'përpjekje kolosale kanë bërë ata për t'i grumbulluar rreth vetes dhe për t'i mbajtur në zap forcat e ndryshme revizioniste. Në këtë çështje ata vunë gjithë prestigjin, peshën politike dhe ekonomike të Bashkimit Sovjetik, presionet e shantazhet, lajkat e mashtrimet. Kur në marsin e kaluar mbledhja përgatitore e Budapestit, pas shumë peripecish e skandalesh të bujshme, caktoi 25 nëntorin si ditën e hapjes së konferencës ndërkombëtare revizioniste në Moskë, «Pravda» gërthiste me sa fuqi që kishte se «lëvizja komuniste hyri e sigurt në fazën e përgatitjes direkte praktike të mbledhjes së re ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore», ndërsa Suslovi e konsideronte këtë si një «epokë të rëndësishme në kompaktësimin e lëvizjes komuniste».

Tani «Pravdës» e Suslovit nuk u dëgjohet më zëri. Por në qoftë se revizionistët sovjetikë duan të fshihen si struçë, bota i sheh fare mirë gjendjen e tyre qesharake dhe disfatën e madhe që pësuan. Për sa na takon neve, e gjithë kjo që ndodhi tani nuk ishte e papritur. Partia jonë ka parashikuar me kohë dhe ka deklaruar botërisht se përpjekjet e dëshpëruara të udhëheqësve

hrushovianë sovjetikë për të thirrur pseudokonferencën e «komunizmit ndërkombëtar» në Moskë, do të përfundonin në një disfatë të turpshme, ashtu siç përfunduan. Në artikullin «Karnavalet e Budapestit», kushtuar mbledhjes së marsit të komitetit përgatitor, ne shkruanim:

«Koha e përgatitjes deri në fund të këtij viti do të vërtetojë përçarje akoma më të thella e më të bujshme. Revizionistët sovjetikë do të hasin në kundërshtime nga më të ndryshmet, pasi revizionistët e tjerë kundërshtarë nuk e duan dhe nuk shpejtohen për një mbledhje të tillë»¹.

Këtyre rreshtave nuk kemi çfarë t'u shtojmë ndonjë gjë të re, koha vërtetoi përsëri atë që ka theksuar vazhdimisht Partia jonë se përçarjet, degjenerimi dhe falimentimet janë karakteristika dhe fenomene të përhershme në gjirin e revizionizmit modern, se midis revizionistëve nuk mund të ketë kurrë unitet e kompaktësi.

Udhëheqësit revizionistë të Bashkimit Sovjetik kanë bërë shumë përpjekje për të ruajtur pozitat e tyre dominuese në frontin revizionist dhe për t'i tërhequr partitë e ndryshme revizioniste pas qerres së tyre. Por me agresionin që ndërmorën kundër Çekosllovakisë, ata me duart e tyre i vunë minat edhe kësaj mbështetjeje që deri më sot në çështjet kryesore ka përkrahur politikën sovjetike. Revizionistët, si ata të Italisë, të Francës, të Anglisë, të Austrisë e të shumë vendeve të tjera kapitaliste, e veçuan veten nga ndërmarrja e

1 Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 37, f. 372.

revizionistëve sovjetikë në Çekoslovakia dhe e lanë udhëheqjen e Bashkimit Sovjetik ta konsumojë vetë çorbën çekosllovake. Ata nuk mund të mos e merrnin parasysh tendencën e përgjithshme të masave punonjëse në vendet e tyre të cilat u ngritën kundër agresionit në Çekoslovakia dhe e dënuan atë me forcë. Sado të forta të ishin lidhjet shpirtërore e financiare me udhëheqësit sovjetikë, ata nuk mund të shkonin kundër korrentit. Përveç kësaj, siç ka ndodhur kurdoherë me oportunistët, ata preferuan të bashkohen me borjezinë e tyre, e cila, për interesat dhe rivalitetet e saj, dënoi imperializmin revizionist sovjetik.

Tani udhëheqësit sovjetikë i akuzojnë shokët e tyre revizionistë të Perëndimit se, duke mos përkrahur agresionin në Çekoslovakia, ata paskan tradhtuar internacionalizmin proletar, paskan rënë viktimë e propagandës imperialiste etj., dhe u bëjnë thirrje patetike të kthehen në gjirin e «familjes komuniste», pasi «prindi zemërgjerë» është i gatshëm ta falë «djalin e penduar». Por grindjet midis tyre nuk mund të ndalohen. Polemika është vetëm në fillim, por që tani ajo tregon se revizionistët sovjetikë jo vetëm që humbën përkrahjen e partive revizioniste të Perëndimit në një çështje konkrete, jo vetëm që mbetën të izoluar, por ata u futën edhe në një grindje të re të madhe, e cila do të çojë patjetër në ashpërsimin e kacafytjeve brenda frontit revizionist, në demaskimin e mëtejshëm ideologjik e politik dhe në dezintegrimin e plotë të tij.

Ishte jashtë çdo dyshimi se klikat e ndryshme revizioniste, duke përfituar nga agresioni i udhëheqësve sovjetikë në Çekoslovakia dhe nga izolimi i tanishëm

politik i tyre, do t'i shfrytëzonin medoemos tratativat dhe mbledhjet përgatitore për konferencën e Moskës si mjet presioni e shkëmbimi, kush për të lehtësuar disi barrën e hegjemonisë sovjetike, kush për t'u shkëputur krejtësisht prej saj e kështu me radhë. Dhe faktet tregojnë se grupe të ndryshme revizioniste, që më përpara e kundërshtonin akoma me gjysmë zëri preponderancën sovjetike, tani nuk kanë frikë të kërkojnë nga Moska që ajo ta njohë *de jure* e *de facto* «pavarësinë» e tyre në «lëvizjen komuniste». Ata e bëjnë këtë pasi janë të sigurt se në pozitën e vajtueshme në të cilën ndodhet tani klika e Brezhnjev-Kosiginit, ajo nuk është në gjendje të përballojë sfidën e re që i bëjnë revizionistët e tjerë dhe nuk do të dëshironte kurrë një ndarje përfundimtare me ta. Prandaj nuk është për t'u çuditur, për shembull, që, ndërsa shtypi dhe e gjithë propaganda sovjetike ka nxjerrë shpatat kundër «kundërrevolucionarëve» çekoslovakë, nuk thotë as gjysmë fjale për revizionistët francezë, italianë, anglezë e të tjerë, të cilët jo vetëm kanë marrë nën mbrojtje miqtë e tyre të Pragës, por janë më përpara nga këta si në teori ashtu edhe në praktikë.

Komunikata e maskuar e mbledhjes së fundit të Budapestit nuk thotë asgjë për çka folën delegatët e ndryshëm, kush kërkoi shtyrjen e mbledhjes, si u argumentua kjo kërkesë etj. Mbledhja u zhvillua me dyer të mbyllura dhe mbi punimet e saj u vu një censurë e rreptë. Kuptohet se revizionistëve sovjetikë nuk do t'u pëlqente aspak të dilte në dritë fakti se në Budapest, ata që deri dje tundnin flamurin e «luftës kundër agresionit imperialist», qëndruan në bankat e të akuzuarve

dhe u kërkohet hesap për agresionin e tyre imperialist në Çekoslllovakë. Por atë që mundohen ta fshehin revizionistët sovjetikë, e zbulojnë ata italianë, të cilët kërkojnë të bëhen një qendër e re botërore dhe të grumbullojnë rreth vetes partitë e grupet e ndryshme revizioniste, që po braktisin udhëheqjen sovjetike. «Çështja çekosllovake, shkruante gazeta «Unita», në realitet e sundoi skenën e takimit të Budapestit. U nënvizua kotësia e konferencës, si dhe pamundësia për arritjen e konkluzioneve konkrete në çastin kur po vazhdon akoma drama çekosllovake dhe kur rreth ngjarjeve të Pragës, janë shkaktuar divergjenca të rëndësishme mbi çështjet kryesore parimore midis partive komuniste».

Udhëheqësit e Moskës janë futur në një qorrso-kak prej nga nuk dinë si të dalin. Të heqin dorë fare nga mbledhja e përgjithshme do të ishte një disfatë e madhe, ta mbajnë do të pësonin një katastrofë të vërtetë. Pas agresionit në Çekoslllovakë dilema e tyre është bërë edhe më hamletjane nga ç'ishte më parë.

Qëllimi themelor i revizionistëve sovjetikë për të organizuar një mbledhje të përgjithshme të partive revizioniste, ka qenë ai për të shpallur «dënimin ndërkom-bëtar» të Partisë Komuniste të Kinës dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë, «për t'i izoluar» ato e, sidomos, për të ndaluar rritjen e vrullshme të lëvizjes revolucionare marksiste-leniniste në botë. Këtë u përpoq të bënte Hrushovi më 1964, kur propozoi mbledhjen e partive komuniste e që dështoi plotësisht, këtë deshën të arri-nin edhe pasardhësit e tij në mbledhjen e Moskës të marsit 1965, të Karlovi-Varit më vonë, me mbledhjet e shumta të Budapestit etj.

Por, që të arrihej ky objektiv, udhëheqësve sovjetikë u duhej më parë të vendosnin të paktën «unitetin» në frontin revizionist, të detyronin më parë partitë revizioniste t'i pranonin ata si udhëheqës supremë të kësaj lufte dhe t'i nënshtroheshin plotësisht hegjemonisë sovjetike. Falimentimi këtu që i plotë. Lufta parimore e këmbëngulëse që bënë Partia e Punës e Shqipërisë dhe partitë e tjera marksiste-leniniste për demaskimin e tradhtisë së revizionizmit modern dhe për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit i bëri copë e thërrime ëndrrat e tyre.

Me kalimin e kohës dhe nën goditjet e vazhdueshme të partive tona, gjendja në frontin revizionist u bë edhe më kaotike, grindjet u shtuan edhe më tepër, divergjencat u bënë edhe më të thella. Fushatat e njëpasnjëshme për organizimin e mbledhjes, në vend që të ndihmonin në forcimin e kompaktësisë të partive revizioniste, në koordinimin e aksioneve dhe në unitetin e veprimit të tyre, çuan në kristalizimin dhe në konsolidimin e tendencave centrifugale, në shtimin e përpjekjeve të grupeve të ndryshme për të shpëtuar nga tutela dhe nga hegjemonia sovjetike, çuan në dobësimin e frontit revizionist.

Në manovrat e shumta për thirrjen e konferencës ndërkombëtare revizioniste dhe për të siguruar mundësisht një pjesëmarrje më të gjerë, udhëheqësit sovjetikë tundën me sa forcë kishin edhe flamurin e leckosur të «unitetit të veprimit kundër imperializmit». Koha vërtetoi se kjo parullë ishte fund e krye një bluf. Në vend të «unitetit të veprimit kundër imperializmit» u forcua uniteti i veprimit imperialisto-revizionist kun-

dër popujve, u zgjerua dhe u intensifikua bashkëpunimi kundërrevolucionar sovjeto-amerikan, klikat e ndryshme revizioniste i shtrënguan edhe më tepër lidhjet me borgjezinë e tyre kombëtare.

Aprovimi nga imperializmi amerikan i agresionit revizionist sovjetik në Çekoslovakia i nxori fare në shesh të palarat dhe e demaskoi përfundimisht blonin e antiimperializmit demagogjik e abstrakt të revizionistëve sovjetikë. Një mbledhje e gjerë, ku si strumbullar i saj do të shërbente «uniteti i veprimit revizionist kundër imperializmit», kishte për të qenë tanimë shumë qesharake dhe praktikisht e pamundur.

Në qoftë se në mbledhjen e marsit në Budapest revizionistët sovjetikë mund të pretendonin akoma për të udhëhequr frontin revizionist, në mbledhjen e tanishme ata u gjendën në rolin e partnerit të dobët, që kërkon mëshirë e ndihmë nga të tjerët, që u lutet e u bie më gjunjë të mos e braktisin në këtë ditë të keqe. Por është jashtë çdo dyshimi se nuk mundet që revizionistët italianë, francezë, anglezë, bile edhe ata të vendeve revizioniste të Evropës Lindore, ta lënë t'u ikë nga duart situata dhe të mos e përdorin izolimin e Bashkimit Sovjetik pas agresionit në Çekoslovakia, për të forcuar pozitat e tyre kundër revizionistëve sovjetikë. Deri më sot, këta të fundit mund të shpresonin se mund ta ruanin hegjemoninë e tyre mbi klikat e ndryshme revizioniste dhe të pengonin deri diku tendencat centrifugale të këtyre klikave pasi ato nuk paraqitnin akoma një front unik ndaj hegjemonisë së tyre, se ato e kundërshtonin vërtet tutelën sovjetike, por këtë e bënin nga baza të ndryshme dhe për interesa të veçantë.

Por pas agresionit në Çekosllovakë nuk mund të flitet më për një gjë të tillë. Pabesia e udhëheqësve sovjetikë ndaj aleatëve të vet doli sheshit, u bë normë e zakonshme e veprimeve të tyre. Agresioni i hapët ushtarak apo komplotet për të rrëzuar udhëheqjet e partive e për të vënë në krye të tyre kuislingë, në esencë nuk kanë asnjë ndryshim.

Në fillim të vitit të kaluar, kur udhëheqësve të Moskës u interesonte të futnin në thesin e tyre partitë e tjera revizioniste dhe t'u merrnin pëlqimin për të shkuar në Budapest dhe në konferencën e Moskës vetë Brezhnjevi, e pas tij edhe e gjithë kompania, shpalli me plot solemnitet se partia revizioniste sovjetike i qëndron besnike vijës sipas së cilës asnjë parti nuk ka të drejtë të përzihet në punët e brendshme të shteteve të tjera, se asnjë parti nuk ka të drejtë të kritikojë veprimet e partive të tjera, të cilat kanë plotësisht të drejtë ta zbatojnë marksizmin, sipas kushteve dhe interpretimit të tyre.

Tani në Moskë nuk dëgjohen më të tilla predikime; përkundrazi, propaganda sovjetike kërkon t'u mbushë mendjen të tjerëve se marksizmin mund ta interpretojnë vetëm patriarkët e lartë të Kremlinit, se pavarësia e partive dhe sovraniteti i kombeve nuk ekzistojnë, se për partitë komuniste paska vetëm një ligj — ai që diktohet nga Moska, se të gjitha partitë duhet t'i nënshtrohen udhëheqjes sovjetike që përfaqësoka «interesat e lartë» të socializmit etj., etj.

Një shembull konkret i zbatimit praktik të këtyre «teorive» të reja janë bisedimet e fundit në Moskë midis udhëheqësve sovjetikë dhe grupit të Dubçekut. Ko-

munikata e bisedimeve shpall hapur se klika e Brezhnjev-Kosiginit, duke marrë nëpër këmbë mbeturinat e fundit të pavarësisë e të sovranitetit kombëtar të Çekoslovakisë dhe parimet më elementare të marrëdhënieve normale midis shteteve, u dikton tani çekoslovakëve se cilët persona duhet të heqin ose të vënë në qeveri, kush duhet të jetë apo të mos jetë në Komitetin Qendror të Partisë, çfarë ligjesh të nxjerrin e çfarë të abrogojnë. Ajo i njeh tani të drejtën vetes jo vetëm të orientojë, por edhe të drejtojë praktikisht të gjithë veprimtarinë politike, ekonomike e shoqërore në Çekoslovakë.

A mundet që në këto kushte partitë e tjera revizioniste të shkojnë vullnetarisht në mbledhjen e Moskës dhe ta pranojnë klikën e Brezhnjev-Kosiginit si udhëheqëse supreme të «lëvizjes komuniste ndërkombëtare»?

Mbledhja e fundit në Budapest tregoi se çarjet në frontin revizionist janë bërë të pariparueshme. Mbledhjes së Moskës iu hodhën leckat në erë. Bile tani atë nuk e duan as vetë revizionistët sovjetikë. Ata e shohin se jo vetëm që dështoi qëllimi fillestar i saj për të dënuar partitë tona, por ajo do të kthehej në një forum ku do të shpërthenin haptazi mosmarrëveshjet e grindjet midis pjesëmarrësve dhe udhëheqja sovjetike, së bashku me partnerët e saj polakë, gjermanolindorë, hungarezë e bullgarë, do të viheshin në pozitën e vëshitirë të të akuzuarve. Duke e shtyrë mbledhjen, ata vënë me shpresë se mund të vijë kohë më të mira, kur mund të kenë grumbulluar disa argumente për të justifikuar agresionin, ose kur mund të ketë lindur ndonjë

çështje tjetër ndërkombëtare që të zbatohet parulla e dashur për revizionistët «të lëmë mënjanë mosmarrëveshjet dhe të bashkohemi për hir të kësaj ose të asaj». Por edhe kundërshtarët e mbledhjes, që pranuan kompromisin për ta shtyrë, kanë bërë llogaritë e tyre. Duke e ditur se për çështje prestigji udhëheqësit sovjetikë nuk mund të dalin tani e të thonë se nuk u duhet më mbledhja, se ata kanë mbetur të izoluar dhe kanë nevojë për përkrahje, Longoja, Valdek Rosheja e të tjerë do t'i shfrytëzojnë zvarritjet e mbledhjes fatkeqe për presion e shantazh ndaj sovjetikëve, për të shkëputur nga ata sa më shumë koncesione, e, sidomos, për t'i njohur policentrizmit të drejtën e qytetarisë brenda frontit revizionist dhe për të mënjanuar likuidimin e plotë të partive të tyre të kalbura të cilat, edhe kështu, mezi mbahen në këmbë.

Mbledhja e fundit e të ashtuquajturit grup përgatitor në Budapest tregoi jo vetëm dështimin skandaloz të ëndrrës së gjatë të revizionistëve sovjetikë për të vendosur sundimin mbi partitë e tjera revizioniste, por edhe rënien katastrofike politike, ideologjike e organizative të mbarë frontit revizionist. Në qoftë se deri tani revizionistët sovjetikë mundoheshin të krijonin perde të ndryshme tymi, për të mbuluar kalbëzimin dhe degjenerimin e revizionizmit, veprimet e tyre të fundit i nxorën ata lakuriq përpara gjithë botës. Asnjë mbledhje, asnjë takim, u bëftë ky shpejt apo vonë, apo mos u bëftë fare, nuk mund t'i shpëtojë ata nga hallet e mëdha që u ka shkaktuar tradhtia e tyre. Sa më shumë të kalojë koha, aq më shumë do të shtohen edhe grindjet e konfliktet midis klikave të ndryshme

revizioniste. Me anë të tankeve ata u munduan të bëjnë zap klikën e Dubçekut, por ngritën kundër vetes klika të tjera revizioniste. Ata përpiqen të zgjidhin një kontradiktë dhe u lindin një mijë të tjera. Barkës revizioniste sovjetike, që me shumë vështirësi po lundron midis furtunës së urrejtjes popullore, i hyn ujët nga të katër anët dhe asnjë përpjekje nuk do ta shpëtojë nga mbytja.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 241 (6280), 8 tetor 1968

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 223*

RRUGËT NË TRUPIN E ATDHEUT JANË SI ARTERIET E GJAKUT NË TRUPIN E NJERIUT

*Fjala në drekën e shtruar me rastin e inaugurimit
të Hekurudhës Rrogozhinë-Fier¹*

12 tetor 1968

Shoqe dhe shokë,

Në vargun e madh të sukseseve që kemi korrur në vendin tonë, u shtuan edhe tri rrugë të rëndësishme që po inaugurojmë këto ditë, të parën inauguroam rrugën që lidh Ballshin me Tepelenën, sot inauguroam Hekurudhën Rrogozhinë-Fier dhe nesër do të inaugurojmë rrugën automobilistike të Malësisë së Madhe, që lidh Vermoshin me Shkodrën. Nga praktika e ndërtimit tonë socialist të gjithë e dimë se rrugët në trupin e atdheut janë si arteriet e gjakut në trupin e njeriut. Ato janë arteriet e përparimit ekonomik, politik, ideologjik e

¹ Kjo fjalë u mbajt në drekën e shtruar në Hotel Turizmi pas ceremonisë së inaugurimit të Hekurudhës Rrogozhinë-Fier dhe pas mitingut të madh që u organizua me këtë rast në Fier.

kulturor të vendit. Ndërtimi i këtyre tri rrugëve do të ndihmojë në zhvillimin akoma më të madh të të gjitha zonave ku ato kalojnë, të të gjitha qendrave bujqësore dhe ekonomiko-industriale që prekin, duke ia shtuar begatinë popullit.

Por ne na gëzon akoma më shumë fakti që ndërtimi i këtyre veprave të mëdha është rezultat i mendimit krijues, i direktivave të Partisë dhe të Qeverisë sonë, të cilat janë vënë në jetë nëpërmjet punës së madhe të masave të gjera të popullit, sidomos të rinisë sonë të lavdishme. Dhe kjo është fitore e madhe, që gëzon gjithë popullin tonë e bashkë me të edhe ne që jemi sot këtu, sepse shohim që direktivat e Partisë përfaqshohen e zbatohen me entuziazëm të papërshtuar nga populli, i cili i është përveshur, kudo, me zell e me vendosmëri të madhe, ndërtimit të socializmit, përveçimit të diturisë, të kulturës e shkencës.

Në këto aksione e lëvizje të mëdha, që kanë shpërthyer në vendin tonë, çdo ditë e më mirë shohim se si po realizohet vija e Partisë për gërshetimin e punës mendore me atë fizike. Jo vetëm në punime të tilla, siç është ndërtimi i rrugëve, i fabrikave, i hekurudhave etj., po kudo shohim se si bashkë me masat marrin pjesë edhe specialistë të lartë, se si masat e gjera të rinisë dhe të popullit, nëpërmjet këtyre aksioneve të mëdha specializohen, përvetësojnë teknikën dhe shquhen në punën e tyre plot vullnet, zgjuarsishtë e iniciativë, duke u bërë ndihmësit kryesorë të specialistëve, të cilët pa ndihmësit nuk mund të ecin përpara sado të mëdhenj të jenë. Nëpërmjet aksionit, kësaj kudhre të madhe ku na kalit Partia, është arritur një fitore e rë-

ndësishme: gradualisht, te njerëzit tanë të qyteteve (fjala është veçanërisht për ata që bëjnë punë mendore dhe për rininë shkollore), po zhduket sëmundja e vjetër, mbeturina e rrezikshme mikroborgjeze, ndjenja e turpit që ekzistonte në qoftë se merreshin me punë prodhuese. Klasa punëtore dhe fshatarësia jonë kurdoherë e kanë vlerësuar shumë punën. Ajo ishte çështje jetike për ta, prandaj e kanë dashur dhe e kanë respektuar punën prodhuese, janë kalitur e janë mbrujtur në të.

Duke kaluar, tani, nëpër aksione intelektualët tanë formojnë koncepte të reja për punën në prodhim. Njerëzit e shkollave, punonjësit e qyteteve të kategorive që përmenda më lart, tani turpërohen në rast se nuk marrin pjesë edhe në punën në prodhim.

Për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit ne duhet të përgatitim një rini të tillë që ta ketë për nder të punojë në çdo front të prodhimit shoqëror dhe me këtë kam parasysh gjithë rininë tonë, rininë punëtore, fshatare, studenteske, rininë e të gjitha shkollave. Me rininë shkollore, sidomos, ne punojmë për të arritur që të zhduket krejtësisht qëndrimi jo i drejtë që mbahet akoma prej disa të rinjve e të rejave ndaj punës në prodhim, të futim vazhdimisht në zemrën dhe në jetën e kësaj rinie ndërgjegjen e lartë të punës, në atë nivel siç e ka të rrënjosur rinia punëtore dhe fshatare. Ne, gjithashtu, do të punojmë që të rritim nivelin arsimor e kulturor të rinisë punëtore e fshatare, me qëllim që pas një kohe të arrijmë t'i sheshojmë diferencat që na ka lënë e kaluara midis kësaj dhe rinisë studenteske e shkollore e të ecim kurdoherë përpara dhe me vull

akoma më të madh në rrugën e ndritur që u ka hapur njerëzve tanë Partia, sepse vetëm kështu do të ndërtojmë më shumë vepra të mëdha e të bukura.

Në rast se do të zbatojmë si duhet dhe me vendosmëri direktivat e Partisë, politikën e saj proletare në çdo aspekt të jetës, por sidomos në edukimin politik, ideologjik dhe në atë të punës e të futim në inteligjencien dhe në fshatarësinë tonë frymën dhe vetitë e larta të klasës punëtore, të mbujtura me marksizëm-leninizmin, me direktivat e Partisë, atëherë ndryshimet kolosale, që po bëjmë sot në Shqipëri, në të ardhmen me siguri do të na duken të vogla përpara realizimeve madhështore që na presin në perspektivën e afërt.

Ne sot jemi të gëzuar edhe sepse e dimë që Partia dhe Qeveria po mendojnë që ndërtimi i hekurudhave të mos mbesë me kaq, por të vazhdojë edhe në zona të tjera të atdheut. Këto vepra të pavdekshme, si dhe shumë të tjera, frytet e të cilave po i gëzon gjithë populli ynë, na i ndërtuan të rejtat e të rinjtë tanë. Gjatë kësaj pune madhështore u vërtetuan edhe një hcrë heroizmi, zotësia, dinamizmi dhe talenti i tyre i shquar.

Vetë aksioni i ndërtimit të Hekurudhës Rrogzhi-në-Fier u bë një shkollë e madhe, ku u edukuan dhe fituan ndërgjegje të lartë 65 000 të reja e të rinj. Edukata që ata morën këtu është njëqind herë më e vlefshme se ana materiale që u përfitua me ndërtimin e kësaj vepre. Po, bashkë me revolucionin që u bë në ndërgjegjen e 65 000 të rejave e të rinjve vullnetarë në këtë aksion të madh, të ndërmarrë sipas direktivave të Partisë dhe vendimit të Qeverisë, është e pallogaritshme edhe dobia materiale. Të rinjtë dhe të rejtat që

punuan në hekurudhë, bashkë me edukatën, me frymën revolucionare të heroizmit, të iniciativave, të guximit e të pjekurisë së tyre, që ata i çuan dhe po i çojnë në të katër anët e Shqipërisë, në çdo familje në malësi e në fushë, në fshat, në qytet e në shkollë, do të çojnë me ndërtimin e këtyre arterieve edhe mirëqenien e përparimin. Rëndësi të veçantë ka fakti që në këtë aksion të madh u mbrujtën me mësimet e Partisë, me cilësi të reja revolucionare qindra e mijëra djem e vajza. Ne dimë se sa prapa, sa të mbyllura e të ndrydhura ishin, para se të vinin në këto aksione vajzat e reja të malësisë. Dimë, gjithashtu, ç'ka ngjarë tani në fshat pas kthimit të tyre nga aksioni. Një revolucion i tërë është bërë jo vetëm tek ato, por në mentalitetin e gjithë fshatarëve, në zakonet, në mënyrën e jetesës, në punë e në luftë për jetën e re. Dhe kjo ishte një ndihmë kolosale që Partia, me organizimin e këtij aksioni të madh, i dha ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Përveç të tjerave, këta të rinj e të reja, të edukuar politikisht dhe ideologjikisht në punë e në shkolla, me virtytet e larta të klasës punëtore, janë e ardhmja e vendit tonë, këta janë punëtorët e ardhshëm, kooperativistët e ardhshëm, mësuesit, inxhinierët, teknikët e mesëm, mbjellësit e ardhshëm të pambukut, të ullinjve etj., etj. Këto të reja e të rinj janë ata që do të ripërtërijnë, do të gjallërojnë forcën e atdheut tonë socialist dhe do ta çojnë edhe më lart, edhe më përpara këtë hov të madh që u jep Partia ndërtimit të vendit dhe edukimit të njeriut të ri me ndërgjegje të lartë socialiste.

Tani, të gjithëve e veçanërisht shokëve të rretheve,

na bie detyrë që këto vepra të mëdha të Partisë, të popullit, të rinisë t'i shfrytëzojmë plotësisht nga ana ekonomike dhe politike, domethënë të realizojmë detyrat në të gjitha fushat jo në prizmin e mëparshëm, por në një prizëm më të gjerë, me një perspektivë të madhe, me një guxim të frymëzuar nga shembulli i klasës punëtore, i rinisë sonë heroike.

Sot gëzon e tërë Myzeqeja, që nga Lushnja e deri në Fier, e bashkë me të gëzon e gjithë Shqipëria, gëzon edhe Malësia e Madhe, ku nesër do të inaugurohet rruga e re. Rruga që u hap në këtë malësi ka rëndësi të jashtëzakonshme politike e shoqërore, por, gjithashtu, edhe ekonomike. Kush ka qenë në malësi, dhe unë dëshiroj t'ju them me këtë rast se edhe vetë kam qenë deri në katundin Rrapsh-Starje, por ka edhe shumë shokë të tjerë që kanë vajtur deri në Vermosh e Dukagjin, mund të gjykojë më mirë dhe të vlerësojë lart vendimin e madh që morën Partia dhe Qeveria për hapjen e rrugës së Malësisë së Madhe. Prandaj të gjithë ne që jemi sot këtu, i kemi zemrat edhe atje dhe e marrim me mend gëzimin e madh të papërshkrueshëm të malësorëve dhe të malësoreve tona, të cilët tani që u lidhën me rrugë automobilistike, e ndiejnë veten si të ringjallur. Bashkë me rrugën atje po shkon edhe drita elektrike. Pra, Malësia e Madhe dhe Dukagjini, vendi i Shkurte Pal Vatës, do të marrin së shpejti edhe dritë, për të cilën aq shumë kanë ëndërruar malësorët në të kaluarën. Edhe elektrifikimi po ecën me vrull të madh në gjithë Shqipërinë dhe ky është një tjetër sukses i madh për ne. E ku ka gëzim më të madh për popullin shqiptar kur mëson ose sheh vetë gjithë këto ve-

pra madhështore që po realizohen njëra pas tjetrës? Kudo sot në vendin tonë, deri edhe në skutat më të largëta të atdheut, dëgjohet një fjalë: Rroftë Partia!

Gëzuar shokë, urime e gëzuar të gjithëve!

Për shëndetin e rinisë dhe të gjithë specialistëve e kuadrove që morën pjesë në ndërtimin e këtyre rrugeve!

Rroftë Partia!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PARTIA KRENOHET ME KLASËN TONË PUNËTORE

Nga biseda me një grup punëtorësh të Tiranës¹

16 tetor 1968

Pasi u përshëndet me ta dhe i pyeti për punën e për realizimin e detyrave, shoku Enver Hoxha tha:

Ju faleminderit shumë, të dashur punëtorë! Jam thellësisht i lumtur dhe i prekur nga ndjenjat e zjarrta që ju keni për Partinë tonë të lavdishme. Partia jonë është Parti e klasës punëtoare, ajo krenohet me ju, punëtorët e Tiranës, sepse ju qëndroni në pararojë të klasës punëtoare, jeni një pjesë e çeliktë e saj dhe ndihmoni Partinë të jetojë, duke e furnizuar vazhdimisht me gjak të ri revolucionar, me elementët më të përparuar të radhëve tuaja. Ju, shokë, jeni ajo pjesë e fortë e klasës punëtoare që zbatoni me heroizëm e me vetëmohim vijën e Partisë, ashtu siç bën e gjithë klasa punëtoare e vendit tonë.

¹ Më 16 tetor, paradite, Sekretari i Parë i KQ të Partisë, shoku Enver Hoxha priti urime në selinë e KQ të PPSH me rastin e 60-vjetorit të datëlindjes së tij.

Gjithë jeta jonë është e lidhur ngushtë me Partinë. Partia është gjithçka për popullin. Pa Partinë nuk mund të çliroheshim e nuk mund të siguronim të gjitha këto fitore e të tjera më të mëdha që na presin. Prandaj populli me klasën punëtore në krye, e do Partinë si dritën e syrit.

Ju siguroj ju, shokë të dashur të klasës punëtore, se kurdoherë, do të jem në ballë të luftës tok me ju, që jeni shokët tanë më të shtrenjtë dhe një garanci e madhe për Partinë tonë. Do të jem besnik deri në vdekje për çështjen e madhe të Partisë dhe të klasës punëtore. Prandaj, me këtë rast, ju falënderoj ju, gjithë klasën punëtore të Shqipërisë dhe në emër të shokëve të Komitetit Qendror të Partisë e në emrin tim personal, ju lutem t'u transmetoni të gjithë shokëve punëtorë të kryeqytetit tonë të lavdishëm falënderimet tona më të përzemërta për çka kanë bërë e po bëjnë ata, të udhëhequr nga Partia, për ndërtimin e Shqipërisë sonë socialiste, për heroizmin, për vullnetin e tyre të hekurt që tregojnë në punë dhe për besimin e madh që ushqejnë ndaj Partisë së tyre. Unë dhe të gjithë shokët e mi të udhëheqjes, të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike e të Qeverisë, ju sigurojmë, shokë, se do të shkrijmë gjithë jetën, të gjitha energjitë tona, për çështjen e madhe të Partisë, të klasës sonë punëtore. Mos kujtoni, shokë, se tani që u bëra 60 vjeç u plaka. Jo. E ndiej veten akoma të ri. *(Të qeshura.)*

Shoqet dhe shokët përfaqësues të klasës punëtore i urojnë shokut Enver Hoxha: «Jetë të gjatë sa malet tona kreshnike!».

SHOKU ENVER HOXHA: Ta ngremë këtë dolli

për Partinë! Të rrojë Partia jonë e lavdishme — Partia pararojë e klasës punëtore!

Kam dëshirë të bëj një fotografi me ju, që të kem një kujtim të bukur me përfaqësuesit e klasës punëtore heroike të Tiranës.

Në sallë buçasin brohoritje, duartrokitje dhe ovacione të zjarra e të gjata.

Etohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

USHTRIA JONË ËSHTË ARMË E PAMPOSHTUR E PARTISË

Nga biseda me një grup ushtarakësh

16 tetor 1968

Ju faleminderit shumë, shokë ushtarë dhe oficerë, për urimet që më bëni! Të na rrojë Partia që na edukoi e na rriti, që na stërviti e na mësoi si t'u shërbejmë me besnikëri atdheut dhe popullit tonë të dashur! Urimet që na drejtohen neve, udhëheqësve, me rastin e festave të datëlindjeve tona, i përkasin Partisë, sepse jeta jonë i përket asaj dhe ne jemi gjithmonë ushtarët e saj. Nga zemra dhe nga mendja ne nuk plakemi kurrë. Edhe Partia jonë nuk plaket kurrë, ajo qëndron kurdoherë e re, e freskët, e gjallë dhe dinamike. Është për këto arsye që ne kemi një forcë të madhe, mbahe mi mirë e fort nga ana fizike e mendore. Apo jo? («Ashtu është, shoku Komandant», *përgjigjen ushtarakët.*)

SHOKU ENVER HOXHA: Partia kujdeset në mënyrë të veçantë për ushtrinë tonë, e cila është pjellë e dashur e popullit dhe e luftës së këtij. Që në ditët e para të themelimit, Partia i kushtoi kujdes të veçantë

punës për krijimin e një ushtrie revolucionare që do të luftonte për çlirimin e vendit dhe për mbrojtjen e atdheut e të diktaturës sonë të proletariatit. Ushtria jonë është armë e pamposhtur e Partisë për mbrojtjen e atdheut dhe të socializmit nga çdo rrezik.

Ne sot kemi një Parti të fortë si çeliku, kemi kuadro të përgatitur në çdo drejtim e, në radhë të parë, të ngritur ideologjikisht e politikisht, me eksperiencë të madhe e të pasur në punë dhe në luftë. Kuadrot tanë ushtarakë janë të zotët nga ana teknike dhe, bashkë me gjithë popullin-ushtar, të gatshëm në çdo moment rreziku për t'i dhënë grushte vdekjeje cilitdo armik sado i armatosur e me çfarëdo arme që të jetë pajisur. Nuk mund të ketë sot armiq që të mposhtin dhe të thyejnë popullin tonë, ushtrinë e tij dhe vijën e lavdishme të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Le ta pimë këtë gotë shokë, për Partinë tonë të shtrenjtë, për ushtrinë e saj të lavdishme, për popullin tonë, për ushtarët dhe për oficerët tanë, për shëndetin tuaj, shokë ushtarë dhe oficerë!

Këtë forcë të madhe që ka krijuar e që ka kalitur Partia jonë e njeh gjithë opinionin botëror, e njohin miqtë dhe armiqtë, kudo që janë. Prestigji i madh i Partisë sonë dhe i Republikës Popullore të Shqipërisë është rritur më tepër se kurrë dhe ka prishur të gjitha planet e armiqve. Tronditja e këtyre planeve duket qartë në opinionet e tyre, në shtypin e tyre, ku shpesh thuhet se kush prek Shqipërinë, duhet të mendohet mirë, se kjo do t'i nxjerrë telashe botës. Pra armiqtë e llogaritin shumë mirë forcën e madhe të Shqipërisë dhe të Partisë së saj.

Armiqtë e kanë halë në sy vendin tonë, por e dinë se po të sulmohet Shqipëria, bashkë me popullin shqiptar kundër tyre do të ngrihet gjithë opinioni përparimtar i botës, forcat revolucionare dhe popujt liridashës.

Por, që të të mbrojnë miqtë, në radhë të parë, duhet të luftosh vetë. Armiqtë tanë kanë frikë jo vetëm nga ndërlikimet në arenën ndërkombëtare, që do të shkaktoheshin në rast të një sulmi kundër Shqipërisë socialiste, por edhe nga vetë heroizmi i popullit shqiptar. Ata e marrin me mend se në rast të një aventure kundër nesh, nuk do t'ia dalin dot, gjë që do të lëkundë e do të dobësojë prestigjin e tyre. Ata janë të bindur që, në këtë luftë të madhe për mbrojtjen e atdheut, do të ngrihet i tërë populli ynë, i madh e i vogël. Pra është ky faktori kryesor që i bën armiqtë tanë të mendojnë mirë para se të sulmojnë Shqipërinë. Shqipëria zotëron një pozitë shumë të rëndësishme politike, ideologjike e strategjike në Evropë dhe ky është një tjetër faktor i rëndësishëm që rrit forcën tonë.

Fitoret tona të mëdha, shokë, u dedikohen vijës së drejtë të Partisë, unitetit të radhëve të saj. Uniteti është çështja më e rëndësishme, është kohezioni që mban gjallë trupin e Partisë. Ky unitet i pathyeshëm i Partisë sonë është i çeliktë, sepse bazohet në idetë e marksizëm-leninizmit, në normat marksiste-leniniste të partisë së proletariatit. Ne nuk pranojmë unitet tjetër jashtë këtyre parimeve dhe jashtë luftës së klasave. Vija e Partisë sonë buron nga ideologjia e klasës punëtore, mbështetet në veprimet e masave me klasën punëtore në krye, u përshtatet kushteve dhe situatës së vendit.

Me një unitet të fortë marksist-leninist brenda ra-

dhëve të Partisë, nga njëra anë dhe, të Partisë me popullin nga ana tjetër, Partia, populli dhe ushtria janë të paprekshëm. Prandaj e kemi për detyrë ta ruajmë si sytë e ballit këtë unitet, ashtu siç na mëson Partia, sepse kështu e duan interesat e socializmit dhe jeta e popullit. Detyra jonë kryesore për ruajtjen dhe për çelikosjen e këtij uniteti është edukimi i njerëzve tanë. Prandaj, në qoftë se ka ndonjë të paqartë e që gabon, duhet të punojmë vazhdimisht e me durim që ta sqarrojmë, ta bindim, kurse ata që me qëllim gabojnë rëndë e na dëmtojnë, t'i spastrojmë nga radhët tona.

Shokët ushtarakë i uruan shokut Enver Hoxha jetë të gjatë, shumë të gjatë dhe i premtuan se do të jenë kurdoherë besnikë të vijës së Partisë dhe do t'i mbrojnë me vetëmohim atdheun dhe fitoret e arritura.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe një herë, ju faleminderit shumë, të na rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

KUADROT TANË ZBATOJNË ME BESNIKËRI DHE ME GUXIM VIJËN E PARTISË

*Nga biseda me një grup punonjësish
të dikastereve qendrore*

16 tetor 1968

Ju faleminderit, shokë, për urimet. Të na rrojë Partia, se ajo është jeta jonë.

Partia ka besim të madh te kuadrot, sepse ata janë një garanci e madhe për të. Ajo gjithnjë ka treguar kujdes të veçantë për përgatitjen dhe për edukimin e kuadrove dhe ata, të udhëhequr nga mësimet e saj, të kalitur e të brumosur me idetë e saj, kanë qenë kurdoherë një mbështetje vendimtare e punës së përditshme të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë. Kuadrot tanë kanë zbatuar kurdoherë me besnikëri dhe me guxim vijën e Partisë, kanë luftuar për ta vënë atë në jetë. Të gjithë ju, shoqe dhe shokë, duke qenë ndihmës të parë të udhëheqjes së Partisë e të shtetit, atje ku jeni caktuar, po i kryeni si duhet detyrat dhe ndihmoni që të forcohen vazhdimisht lidhjet e udhëheqjes me bazën. Kjo është dhe duhet të jetë detyra kryesore e

punës suaj, ajo krijon siguri e qartësi në mendimet tuaja dhe ndihmon për kalitjen tuaj revolucionare.

Direktivat e Partisë bazohen dhe burojnë nga ideologjia e klasës punëtore. Ato japin siguri për të punuar dhe shërbejnë edhe në të ardhmen vetëm kur mbështeten e reflektojnë drejt vijën e masave, eksperiencën e madhe të klasës punëtore dhe të mbarë popullit. Ju jeni njerëz të Partisë dhe këto lidhje të ngushta me bazën duhet t'i forconi edhe më shumë. Të bëheni kurdoherë edhe në të ardhmen, sikurse jeni bërë, përçuesit e vijës së drejtë dhe të direktivave të Partisë në masat dhe, për këtë Partia ju falënderon.

Në luftë për ndërtimin socialist të vendit Partia ka përgatitur e ka ngritur me qindra e me mijëra kuadro, të cilët janë të pjekur, të formuar mirë si nga pikëpamja ideologjike e politike, ashtu dhe nga ana profesionale. Kuadrot tanë janë edukuar për t'u shërbyer kurdoherë popullit dhe atdheut me besnikëri të pakufishme e me ndërgjegje të lartë.

Le ta pimë, shokë, këtë gotë për atë që na jep gjithë këtë fuqi, për Partinë tonë të shtrenjtë!

SHOQJA ELENI PASHKO¹: Ne, punonjësit e dikastereve, në radhë të parë, falënderojmë Ju dhe Partinë tonë për gjithçka keni bërë për ne, për të na edukuar dhe për të na mësuar. Si punonjës të aparatëve qendrore jemi e do të jemi gjithnjë nën kudhrën e Partisë dhe të masave.

Megjithatë, pa na u rritur mendja që punojmë në

¹ Në atë kohë zëvendësministre e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore.

dikastere, ne duhet të punojmë edhe më mirë, të çajmë akoma më përpara, sepse në çdo hap të punës sonë kemi të mira, po bëjmë edhe gabime.

SHOKU RAMIZ ALIA: Rëndësi ka që gabimet të mos përsëriten dhe të merren masa për t'i shmangur me kohë.

SHOKU ENVER HOXHA: Gabime dhe të meta mund të ketë, por ato duhet të ndreqen menjëherë. E keqja qëndron se ngandonjëherë ai që i bën gabimet nuk i kupton si duhet dhe nuk reflekton drejt. Prandaj duhet luftuar më shumë në këtë drejtim. Megjithatë kryesore është besimi te Partia, te vija e saj, te populli, te klasa. Ku ekziston ky besim, atje edhe gabimet e të metat riparohen më kollaj.

SHOKU PROKOP MURRA¹: Ta pimë këtë gotë për shëndetin Tuaj shoku Enver, të na rroni sa malet, për të mirën e Partisë dhe të popullit!

SHOKU ENVER HOXHA: Të na rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

¹ Në atë kohë zëvendëskryetar i Komisionit të Planit të Shtetit.

GRUAJA SHQIPTARE — FORCË E MADHE E PARTISË DHE E POPULLIT

Nga biseda me një grup grash të rrethit të Tiranës

16 tetor 1968

SHOKU ENVER HOXHA: Në emër të Byrosë Politike dhe timin dëshiroj që nëpërmjet jush, të falënderoj të gjitha gratë heroike të vendit tonë, të cilat janë sot një forcë e madhe e Partisë dhe e popullit.

SHOQJA IJE FARKA: Të na rroni Ju, që udhëhiqni Partinë! Po të mos ishit Ju dhe Partia, që udhëhoqët luftën, ne nuk kishim ç'të bënim.

SHOKU ENVER HOXHA: Lufta nuk bëhet vetëm me një e me dy veta. Prandaj Partia u mbështet te populli, ngriti në luftë gjithë popullin, komunistë e patriotë bashkë dhe fituam. Duke luftuar, duke punuar e duke fituar çdo ditë, të gjithë së bashku do të shikojmë ditë akoma më të mira.

Derisa në vendin tonë gratë dhe vajzat kanë marrë krahë, derisa ato u ngritën në një radhë me burrat, socializmi do të ecë gjithnjë përpara me hapa të sigurt. Gratë shqiptare kanë dhënë një ndihmë shumë të madhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Ti, Ije, atëherë

ishe e re, po çfarë mund të bënim ne pa ndihmën tënde dhe të qindra e të mijëra grave të tjera të Shqipërisë, që ndihmuan me mish e me shpirt luftën për çlirimin e vendit?

SHOQJA IJE FARKA: Kur vinit në shtëpinë tonë¹, shoku Enver, unë kujtojsha se ishit doktori që do të vizitonte Xhoxhi Martinin e plagosur dhe thosha me vete: «Tani erdhi doktori me gjyzlykë».

SHOKU ENVER HOXHA: Xhoxhi ishte trim i madh. Zaten të gjithë komunistët e partizanët ishin trima, por edhe populli dhe gratë tona trimëresha të mëdha ishin.

Ç'rol të madh ka luajtur gruaja jonë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare! Ajo mori pjesë direkt në këtë luftë. Me të gjitha forcat dhe mjetet që kishin gratë luftuan krahas burrave në qytete, në fshatra e në male, ato punonin edhe për lëvizjen, edhe për shtëpinë. Ndihma, sidomos kuraja që jepnin ato ishin kolosale. Kur nëna i thoshte djalit të saj: «Shko lufto!», kur gruaja i thoshte burrit: «Rrëmbe pushkën, se fëmijët i rrit unë» etj., këto ishin një ndihmë e madhe për luftëtarët trima partizanë, për Luftën tonë Nacionalçlirimtare.

E shikoni ju shoqe këtë Ijen? Atëherë ishte në moshë më të re se tani, por dukej më plakë, kurse tani është bërë më e re nga sa është dhe të jeni të sigurtë se sikur të jenë në rrezik atdheu dhe Partia, Ija s'ka

¹ Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare shtëpia e Ije Farkës ishte një bazë e rëndësishme ilegale. Në këtë shtëpi ishin strehuar shokët Vojo Kushi, Xhoxhi Martini e Sadik Stavaleci një natë para se të binin heroikisht në luftën legjendare, në Kodrën e Kuqe, më 7 tetor 1942.

për të ndenjtur në shtëpi, por do të thotë: «Dua edhe unë një mitraloz». Apo jo Ije?

SHOQJA IJE FARKA: Ashtu është, shoku Enver.

DAVA MËLYSHI: Të gjitha jemi gati të luftojmë e s'na dhimbset asgjë, as jeta jonë, për mbrojtjen e atdheut.

SHOKU ENVER HOXHA: Pikërisht ashtu është, siç thotë nënë Dava. Pal Mëlyshi, shoqe dhe motra të dashura, ishte një hero i heshtur. Është e lehtë të shkosh në luftë krahas shokëve, të luftosh, të sakrifikosh e të vdesësh për popullin. Në një rast të tillë, të gjithë e dinë se ti je një patriot, por Pal Mëlyshi derisa dha jetën për atdheun dhe për popullin njihej sikur ishte një tradhtar. Merreni me mend, pra, çfarë forcë shpirtërore kishte Pal Mëlyshi, çfarë hero i ishte ai. Misionin e tij të lartë dhe fisnik në luftën kundër armiqve e dinin vetëm pak veta, unë dhe 2-3 shokë të tjerë. Ne e dërguam Palin të përzihej me të arratisurit, të cilët kujtonin se ai ishte me ta. Neve na digjte zemra për të dhe e porositim të kishte kujdes që nga kjo ndërmarrje kaq e vështirë, të dilte i gjallë. Edhe babai im, megjithëse plak, kur mori vesh se si u vra Pali tha: «I lumtë këtij djali trim që ra në krye të detyrës për mbrojtjen e interesave të atdheut». As nëna e vet nuk e dinte që Pali po kryente një mision të rëndësishëm. Ajo nuk e dinte të vërtetën, sepse ashtu e donte puna, ashtu e donte interesi i atdheut, ashtu e donin ligjet e luftës, të cilat janë shumë të rrepta.

Ne e dinim dhe e kuptonim gjendjen e rëndë shpirtërore të saj, por në atë kohë nuk na lejohej të thoshim asgjë. Na vinte jashtëzakonisht keq, por ishim

të bindur se kjo nënë mirditore ishte e fortë, do ta duronte dhimbjen aq të madhe dhe, më vonë, do ta kuptonte si qëndronte e vërteta. Vërtet, më vonë edhe ajo e kuptoi çfarë djali pati, çfarë heroji ishte Pali i saj, të cilin e njohu mirë i tërë populli ynë. Me luftën e tij të madhe dhe heroike Pal Mëlyshi rron i gjallë midis nesh.

Lufta e Palit dhe e shokëve të tij pati një rëndësi jashtëzakonisht të madhe, ajo ishte një kontribut i paçmuar në luftën e popullit tonë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut. Momentet që kalonte Shqipëria në atë kohë ishin të rrezikshme. Me qindra armiq hynin nëpërmjet kufirit, me qindra të tjerë hidheshin me parashuta nga aeroplanët. Popullit dhe forcave të tij të armatosura iu desh të bënin kundër tyre një luftë të gjithanshme për t'i asgjësuar e për të mos u dhënë mundësi të na dëmtonin.

Për këtë luftë është shkruar nga shkrimtarët e poetët tanë, por do të vazhdojë të shkruhet akoma më shumë. Ajo është një luftë legjendare, që ka ndihmuar shumë për të shpëtuar socializmin në Shqipëri. Në momentet kur armiqtë imperialistë dhe renegatët u vërsulën për të rrëzuar me çdo kusht pushtetin tonë të ri popullor, nga populli dhe forcat tona të armatosura, nga radhët e Armës së Sigurimit të Shtetit kanë dalë me qindra e qindra djem të zgjuar e trima të dalluar. Mirdita ka një popull trim, patriot e shumë të vendosur, me burra e me gra të zgjuara. Katër heroina kanë dalë nga kjo krahinë kreshnike. Partia, tani, i ka çelur sytë popullit të kësaj krahine dhe i ka hapur perspektiva të mëdha, ashtu si gjithë popullit të Shqipërisë.

Në mënyrë të veçantë, gratë mirditore, si kudo në Shqipëri, janë bërë një forcë e madhe dhe e gjithë kjo i dedikohet vijës së drejtë të Partisë sonë.

Le ta pimë këtë gotë për Partinë! Të na rrojë sa malet, të jetë kurdoherë e fortë dhe e çeliktë!

Ta pimë për gruan shqiptare, për shëndetin tuaj shoqe! Në emër të të gjithë shokëve të Byrosë Politike u transmetoni të gjitha grave të Tiranës, urimet tona më të përzemërta. Suksese gjithnjë e më të mëdha në punën tuaj të palodhur!

GRATË: Të na rrojë Partia dhe Ju, shoku Enver!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

KOLEKTIVIZIMI I BUJQËSISË — FITORE E MADHE HISTORIKE

*Nga biseda me një grup kooperativistësh
të rrethit të Tiranës*

16 tetor 1968

Në fillim, shoku Enver Hoxha përshëndetet në mënyrë të përzemërt me kooperativistët, të cilët me këtë rast i pyet për punët e stinës në bujqësi, për rendimentet që janë arritur e do të arrihen etj. Pastaj midis tyre zhvillohet një bisedë e ngrohtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju faleminderit shumë për vizitën dhe për urimet që më bëtë. Të na rrojë Partia, se të udhëhequr prej saj ne po ecim e do të ecim gjithmonë përpara. Nën drejtimin e urtë të Partisë ne po punojmë me vrull e me guxim, si në të gjithë sektorët, edhe në bujqësi.

Partia ka shtruar si detyrë që, veçanërisht, bujqësinë ta bëjmë të lulëzojë çdo vit e më shumë. Përparime të mëdha kemi arritur në këtë sektor të rëndësishëm e jetik, por duhet të mos kënaqemi me kaq. Ju e ndieni vetë se na mbetet shumë për të bërë, prandaj të shtojmë forcat dhe mobilizimin në punë për të arritur objektivat e dëshiruar.

Detyra e madhe që vuri Partia për kolektivizimin e fshatit, u realizua me sukses dhe me vendosmëri të lartë nga fshatarësia jonë heroike, e cila kurdoherë u është përgjigjur me nder detyrave që ka caktuar Partia. Kolektivizimi i bujqësisë është një nga fitoret më të mëdha historike të Partisë. Themi më të mëdha, sepse fshatarësia përbën shumicën e popullsisë së vendit dhe, nga ana tjetër, bujqësia është një sektor nga më kryesorët e ekonomisë sonë. Tani që kolektivizimi ka përfunduar plotësisht do të shikoni se bujqësia jonë socialiste do të bëjë përparime akoma më të mëdha. Ekonomia e përbashkët kolektive, s'ka dyshim se së shpejti do të japë frytet e saj. Gjithashtu ndihma e shtetit për fshatin në të ardhmen do të jetë edhe më e madhe se gjer tani, se mundësitë e tij janë rritur e rriten vazhdimisht. Ja, shikoni çfarë forcë e madhe është bërë industria jonë. Tani ajo e furnizon fshatin me pleh kimik, me traktorë e me makineri të tjera bujqësore. Kur të mësoni çfarë plane kanë Partia dhe Qeveria për të ardhmen e bujqësisë, do të shihni më qartë perspektivat e mëdha që i janë hapur fshatit tonë.

Të përpiqemi shoqe dhe shokë që tokës t'i marrim intensivisht shumë prodhime, ta punojmë më mirë, ta plehërojmë më shumë, t'u bëjmë bimëve bujqësore të gjitha shërbimet agroteknike. Qeveria do t'ju japë në të ardhmen më tepër mjete të tjera, por edhe ju vetë duhet të bëni një punë më të mirë.

Kooperativistët premtojnë se do të punojnë me të gjitha forcat për të rritur rendimentet e për t'i marrë tokës sa më shumë prodhime.

SHOKU ENVER HOXHA: Një ndihmë akoma më

të madhe duhet të japin në punët e fshatit, veçanërisht gratë. Kështu na mëson Partia. Pa punën dhe pa pjesëmarrjen e gruas, përparimet do t'i kemi më të ngadalshme. Gratë, si kudo, edhe në fshat, kanë shumë forca dhe shumë zgjuarsi. Përse na hiqen burrat si më të zgjuar? (*Të qeshura.*) Nëna, në kuptimin e thellë të punës për rritjen e fëmijëve në shtëpi, është edukatorja kryesore e çdo njeriu.

Tani që Partia na hapi sytë e u dha grave të drejta të barabarta me burrat, cilado nga gratë e kupton fare mirë si kemi qenë më parë dhe ku duhet të shkojmë në këtë drejtim. Ju gratë duhet ta ndihmoni Partinë në çdo punë e për çdo problem që shtrohet për t'u zgjidhur. Burrat kanë akoma shumë mbeturina në qëndrimin ndaj grave dhe që këto mbeturina të zhduken, vetë ju gratë duhet të ngrini zërin, që të gjithë ne, burrat, të spastrojmë ndërjegjen ashtu si na mëson Partia!

Sivjet, në bujqësi sidomos me drithërat jemi mirë. Tani që rruga automobilistike vajti edhe në zonën e Shëngjergjit, janë të gjitha mundësitë që fshatrat e Tiranës të ndihmohen për të ecur edhe më shpejt përpara.

Le ta pimë këtë gotë për Partinë tonë të lavdishme, për sukseset e kooperativistëve dhe, me këtë rast, të merrni nga toka 30-40 kuintalë misër për hektar! Dalshi faqebardhë, shoqe dhe shokë kooperativistë! U jepni përshëndetje nga ne gjithë kooperativistëve të rrethit, të gjitha shoqeve kooperativiste! U bëni të fala të gjithëve!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

PARTIA DHE POPULLI KANË UNITET TË PATHYESHËM

*Nga biseda me një grup shokësh përfaqësues
të ardhur nga të gjitha rrethet e vendit*

16 tetor 1968

Ju faleminderit shumë të gjithë juve dhe shokëve e shoqeve që ju dërguan këtu! Ju jam shumë mirënjohës për këtë dashuri të madhe që keni dhe shfaqni orë e çast për Partinë tonë të shtrenjtë e të dashur, që është zemra dhe jeta e gjithë popullit shqiptar.

Pjesëmarrësit në këtë takim e urojnë shokun Enver Hoxha për përvjetorin e datëlindjes, duke shprehur njëkohësisht dashurinë për Partinë dhe vendosmërinë për të milituar në çdo front ku e kërkojnë atdheu dhe socializmi.

SHOKU ENVER HOXHA: I udhëhequr nga Partia, populli shqiptar sot është më i fortë se kurrë, ai jeton i lumtur dhe i lirë në atdheun e vet. Këto ai ia detyron vetëm Partisë dhe, kur themi Partisë, kuptojmë gjithë komunistët, anëtarët e saj të lavdishëm. Por me Partinë e të Partisë janë të gjithë punonjësit revolucionarë

të vendit tonë edhe ata të paorganizuar në Parti, që e duan po me aq zjarr e vrull atë dhe janë gati në çdo moment të japin edhe jetën për të. Është Partia ajo që na ka siguruar e na siguron jetën dhe të ardhmen e lumtur të gjithëve ne që jetojmë sot dhe brezave që do të vijnë më vonë. Prandaj nga kjo dashuri e sinqertë e masave punonjëse për Partinë, lind ky unitet i madh i popullit rreth Partisë, i cili është i çeliktë dhe ne duhet të bëjmë përpjekje ta ruajmë e ta forcojmë çdo ditë e më shumë.

Partia na mëson se ne komunistët, në radhë të parë, duhet të jemi njerëz të thjeshtë, ashtu siç është populli, kurrë të mos na rritet mendja. Ne duhet të jemi njerëz që të bëjmë sakrificat më të mëdha e më parë nga kushdo tjetër; të jemi njerëz që të mos prekemi nga veset e këqija as në zemër, as në mendje; të jemi të dashur me popullin. Pikërisht për këto cilësi komunisti ka nderin të quhet anëtar i Partisë e të mbajë taserën e Partisë në xhep. Komunistët shqiptarë mendojnë e luftojnë të udhëhequr nga mësimet e Partisë, prandaj populli i do. Ata që nuk ecin në këtë rrugë, as populli nuk i do, prandaj nuk e meritojnë të jenë komunistë. Të tillë njerëz mund të fshihen për njëfarë kohe, por lufta e Partisë dhe e popullit nuk i lë ata të livadhisin gjatë.

Në Parti duhet të futen njerëzit më të mirë nga radhët e klasës punëtore, njerëzit e kalitur në prodhim. Puna prodhuese dhe klasa punëtore i kalitin njerëzit tanë, i edukojnë ata. Prandaj klasa punëtore është burimi kryesor për shtimin e radhëve të Partisë.

Direktivat e Partisë lidhur me kontrollin e klasës punëtore, kanë rëndësi të madhe jo vetëm për klasën punëtore, por edhe për fshatarësinë punonjëse dhe inteligjencien. Ato do të na ndihmojnë që të rritet prodhimi industrial, të lulëzojnë edhe bujqësia, arsimi, kultura etj.

Sot, pothuaj çdo rreth ka klasën e vet punëtore dhe industrinë e tij, bile edhe disa qytete si Kavaja, Shijaku etj., tani kanë fabrika, ndërmarrje, pra, kanë mjaft punëtorë. Planet e Partisë e të Qeverisë për të ardhmen në këtë drejtim janë për një numër gjithnjë e më të madh ndërmarrjesh e punëtorësh. Të mira të tjera e presin tërë Shqipërinë, pra dhe çdo rreth të saj. Të gjitha këto përparime të mëdha do të bëhen, në radhë të parë, duke zbatuar thellë vijën e drejtë të Partisë, me punën dhe me mendjen kolegjiale të udhëheqjes së saj, me punën e palodhur të klasës punëtore e të fshatarësisë kooperativiste, të rinisë, të grave etj. Dikur, për shembull, në Kardhiq, që ishte një zonë e varfër dhe e prapambetur në rrethin e Gjirokastrës, fshatarët për të siguruar jetesën shitnin vetëm dru zjarri e me këto siguronin diçka, kurse tani jeta atje ka ndryshuar shumë. Ekonomia bujqësore është zhvilluar dhe kësaj zone, me kolektivizimin e bujqësisë, po i hapen perspektiva të mëdha. Kështu fshatarësia e kësaj krahine, duke e zhvilluar më tej bujqësinë e blegtorinë do të sigurojë të ardhura më të mëdha.

Zgjerimi i nxjerrjes e i përpunimit të mineraleve ka rëndësi të madhe, shokë. Shtimi i tyre do të ndihmojë të rriten edhe prodhimet bujqësore. Në qoftë se

do të trefishojmë plehrat kimike, atëherë do të kemi më shumë edhe prodhime bujqësore, do të kemi kësh-tu më shumë bukë, qumësht, gjalpë e të tjera.

Kur fliste Partia për këto gjëra më parë, duheshin disa vjet për t'i realizuar, kurse tani fuqia jonë eko-nomike është rritur, prandaj kur sot Partia thotë për diçka, kjo realizohet brenda një kohe më të shkurtër. Kjo tregon se forcat tona janë shtuar, mundësitë tona janë shumëfishuar. Dhe kjo është një fitore e madhe e Partisë, e arritur me zgjuarsinë e zotësinë e saj dhe të popullit tonë të mrekullueshëm. Çështja është se popu-lli ka besim te Partia, te forca e saj dhe, duke u ndri-çuar nga vija e saj, ecën përpara, realizon e tejkalon plane dhe objekte jo të lehta. Shembulli i freskët është ndërtimi, brenda afatit, nga rinia jonë heroike, i Heku-rudhës Rrogozhinë-Fier. Prandaj populli e do me gjithë shpirt Partinë dhe sa mund të ndahet mishi nga thoi, aq mund të ndahet edhe populli nga Partia. Kështu është e lidhur Partia me popullin, me një unitet të pa-thyeshëm.

Ju falënderoj edhe një herë për zemërsisht për mu-ndimin që morët duke ardhur këtu që nga rrethet. Da-shuria dhe besimi juaj na jep forca për të punuar ako-ma më shumë, për të shmangur edhe ndonjë gabim a dobësi që mund të kemi në punë. Ne kemi pjesë edhe në gabimet tuaja. Prandaj, kur gabojmë ne, ju duhet të na bëni kritikë. Ta zhvillojmë kudo kritikën, sepse kjo është armë e fortë në duart e Partisë për të ndre-qur të metat. Ai që të do, të kritikon, kurse ai që nuk të do, kur gabon, të fërkon krahët; kur puna nuk ecën

drejt, duhet të kritikohet ai që pengon, kështu na mëson Partia.

Pastaj shoku Enver Hoxha bën një fotografi me të gjithë pjesëmarrësit e takimit.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

ASGJË TË MOS KURSEJMË PËR ÇËSHTJEN E PARTISË

*Nga biseda me punonjësit e aparatit të Komitetit
Qendror të Partisë, të Komitetit të Partisë të Tiranës
dhe të Shkollës së Lartë të Partisë «V.I.Lenin»*

16 tetor 1968

*Pasi i falënderoi për urimet, shoku Enver Hoxha
tha:*

Të na rrojë Partia! Ne jemi ushtarët e saj. T'i shërbejmë me besnikëri dhe me vetëmohim Partisë deri në fund të jetës sonë. Partinë e kemi të çeliktë, edhe popullin e kemi, gjithashtu, të çeliktë. Partia na ka rritur, na ka edukuar, na ka shtuar forcat mendore dhe fizike, prandaj asgjë të mos kursejmë për çështjen e saj.

Vërtet vitet ikin, po për punën dhe për idealet e Partisë jemi gjithnjë të rinj. Disa nga ne këtu janë më të moshuar, kurse disa të tjerë janë akoma të rinj. Megjithatë të gjithë jemi të fortë nga zemra, revolucionarë, të vendosur për Partinë.

Dëshiroj t'ju falënderoj nxehtësisht ju shokë që me punën tuaj i jepni një ndihmë të madhe Partisë. Partia

e çmon shumë, në çdo pikëpamje, ndihmën tuaj dhe sidomos qartësinë që keni për vijën e Partisë, kujdesin tuaj të madh për përmbajtjen e pastër ideologjike dhe politike të punës, për të theksuar thelbin e çështjeve, duke shmangur frazat e gjata e nganjëherë boshe, që shfaqen te ndonjë, për ndonjë problem. Për këtë natyrisht duhen ca përpjekje nga të gjithë ne. Këto gjëra do të kemi rast t'i themi edhe herë të tjera. Sot këtu nuk është vendi për kritikë, por edhe kur të vijë puna për të bërë kritikë, këtë ta bëjmë reciproke e jo të njëanshme.

Partia konstaton se orientimet e saj kuptohen mirë nga të gjithë komunistët dhe nga masat. Kudo, në të gjithë vendin po luftohet vazhdimisht për ngritjen e pandërprerë revolucionare të masave të popullit dhe të Partisë. Megjithatë nuk do të thotë se çdo gjë shkon plotësisht në rregull. Këtë nuk duhet ta harrojmë, as të mos gënjehemi e të mos e flemë mendjen, se kemi akoma shumë për të bërë.

Të pranishmit i premtojnë shokut Enver Hoxha se do të vënë të gjitha energjitë mendore e fizike për zbatimin e orientimeve dhe të direktivave të Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Le ta pimë këtë gotë, shokë, për Partinë tonë të lavdishme dhe për shëndetin tuaj!

Të na rrojë Partia!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

ARSIMTARËT JANË LUFTËTARË TË VIJËS SË PARTISË

Nga biseda me një grup punonjësish të arsimit

16 tetor 1968

Para bisedës shoku Enver Hoxha i takoi me gëzim arsimtarët, që kishin ardhur për ta uruar me rastin e 60-vjetorit të lindjes së tij. Pastaj ai u tha:

Ju falënderoj shumë për vizitën që po më bëni me rastin e 60-vjetorit të datëlindjes sime. Megjithatë mua më duket sikur jam 40 vjeç, sepse të tillë na bëri Partia. Partia na rilindi.

Ju përgëzoj shoqe dhe shokë për punën tuaj shumë të madhe, të vlefshme dhe revolucionare që ju, të udhëhequr nga Partia në rrugën e marksizëm-leninizmit, po bëni për edukimin e brezit të ri, i cili është e ardhmja e vendit tonë. Konceptet me të cilat do ta brumosim brezin e ri, edukata që do t'i japim, gjithë puna për formimin e tij përbëjnë garanci për të ardhmen e vendit tonë. Prandaj edukimi i brezit të ri me shkencën marksiste-leniniste, me ideologjinë e Partisë së klasës punëtore, është detyra kryesore e punonjësve të arsimit.

Ju jeni njerëz të mësuar, jeni njerëz të Partisë. Këtu nuk e kam fjalën vetëm për ju të moshës së re, por edhe për punonjësit e tjerë të arsimit, që janë me moshë të kaluar. Të gjithë së bashku, të vjetër e të rinj, jeni luftëtarë të vijës së Partisë, sepse të gjithë ju që jeni mësuar, jeni kulturuar e edukuar, keni në zemrat tuaja dashurinë për popullin dhe mësimet e Partisë. Në punën dhe në luftën që po bëni për të zbatuar mësimet e Partisë, ju punoni në mënyrë të ndërgjegjshme si revolucionarë. Duke marrë dituri dhe njëkohësisht duke dhënë dituri, ju lidheni ngushtë me vijën dhe me praktikën e Partisë, lidheni me bazën, gjë që ka rëndësi të madhe. Po me cilën bazë lidheni ju? Ju lidheni me atë bazë aq të pasur në ndjenja, aq të vrullshme në aksione, aq të pastër në shpirt dhe aq revolucionare, siç është brezi ynë i ri që është i gatshëm t'i marrë dhe t'i zbatojë me përpikëri të gjitha mësimet e Partisë.

Me këtë rast dëshiroj t'ju them se edhe unë kohë më parë, para themelimit të Partisë, kam qenë mësues. Ishte vërtet kohë e vështirë, por kur ndodhesha në mes të nxënësve e ndieja veten të fortë dhe kjo forcë e madhe është e tillë që të shtyn të ecësh përpara. Atdheu, populli e Partia u kanë besuar sot arsimtarëve edukimin e brezit të ri dhe kjo detyrë e lartë duhet t'u shtojë atyre ndjenjën e një përgjegjësie shumë të madhe.

Sukseset e mëdha që ka arritur vendi ynë, në të gjitha drejtimet, u dedikohen në radhë të parë Partisë, punës së palodhur të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste, të rinisë, të gruas, të inteligjencies dhe të arsimtarëve tanë, të cilët kanë dhënë, gjithashtu,

një kontribut të madh në edukimin e brezit të ri revolucionar.

Natyrisht ka njerëz të cilët ka dobësi, ka të meta, ka edhe njerëz që mbajnë qëndrime burokratike. Kur vjen rasti për të parë të metat që mund të vihen re në punën tonë, ato ne nuk i fshehim. Por vija e Partisë është e drejtë dhe, kur punonjësit bëjnë përpjekje për ta kuptuar mirë atë, spastrohen nga të këqijat në ndërgjegjen e tyre dhe edukohen.

Këtë ne e konstatojmë edhe gjatë punës për zbatimin e reformës së shkollës. Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës është një ngjarje me shumë rëndësi në jetën e vendit tonë. Direktivat e Partisë për këtë problem duhen kuptuar sa më thellë nga të gjithë, me qëllim që të bëjmë një shkollë të re revolucionare që t'u përgjigjet kërkesave të shoqërisë sonë socialiste. Me ndërtimin e saj ne do të ecim në rrugë të reja që nuk ka ecur ndonjë vend tjetër më parë. Ne duhet të ndërtojmë një shkollë të tillë revolucionare, të cilën nuk e ka pasur dhe nuk e ka asnjë vend tjetër.

Partia tani është duke e kapur mirë problemin e revolucionarizimit të shkollës sonë, gjë që do të përcaktojë dhe do të bëjë më të lehtë edhe ndërtimin e programeve, të teksteve, të orareve etj. Rëndësi ka këtu çështja që njerëzit të kuptojnë mirë ideologjikisht e të dinë se çfarë shkolle duhet të ndërtojmë, cila shkollë u përgjigjet situatës aktuale revolucionare të vendit tonë dhe kërkesave të përgatitjes së kuadrove, për ta çuar përpara revolucionin tonë. Kjo do të thotë që ne, duke u udhëhequr gjithnjë nga qëndrimi revolucionar i Partisë, e cila mbështetet në mësimet e

marksizëm-leninizmit, punojmë sot për nesër dhe nesër do të punojmë për pasnesër.

Kombinimi i mirë i mësimit me punën prodhuese, duhet të ketë objektiv t'i edukojë intelektualët, që do të dalin nesër nga shkolla jonë e re, të mos kenë frikë nga puna si dhe ta ndiejnë që nuk mund të rrojnë dot pa punë dhe askush të mos mendojë se meqë mbaroi shkollën duhet të zërë ndonjë qoshe të ngrohtë, ose se diploma merret për karrierë etj. Intelektualët duhet të mendojnë, mbi të gjitha, për ndërtimin e socializmit, për interesat e popullit, për interesat e përgjithshëm. Pasi të kemi arritur këtë do të shikojmë se çfarë transformimesh kolosale, që tani nuk mund t'i imagjinojmë, do të bëhen në botën shpirtërore të njerëzve, në rritjen e prodhimit të të mirave materiale e kulturore të shoqërisë sonë dhe në ngritjen e nivelit të përgjithshëm të jetesës së popullit.

Partia këto vitet e fundit është hedhur në një sulm të përgjithshëm për revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë jetës së vendit, duke na dhënë një impuls të gjithëve. Ne sot në vendin tonë disponojmë mundësi dhe mjete, për të ecur përpara me vrull akoma më të madh. Sa do të ndryshojnë këta kuadro, këta punëtorë, ky shpirt pune kur ne ta kemi ndërtuar këtë shkollë, për të cilën po punojmë, kur ta rritim inteligjencien në një masë shumë më të gjerë se kjo që kemi tani. Ne kemi krijuar inteligjencien tonë të re, të gatshme për të kryer me nder detyrat që i ngarkon Partia dhe, me këto mundësi që kemi, në të ardhmen do të bëjmë mrekulli edhe më të mëdha. Partia ka besim të plotë

te ju shokë mësues e pedagogë, se ju jeni bij të popullit e të Partisë, të cilët i doni me gjithë shpirt.

Prandaj me këtë rast ju falënderojmë dhe ju urojmë suksese në punën tuaj!

Dëshiroj ta ngremë të gjithë së bashku këtë gotë për Partinë tonë të lavdishme!

Për arsimtarët tanë të lavdishëm, për shëndetin tuaj, shokë!

ARSIMTARËT: Për shëndetin Tuaj, shoku Enver!

SHOKU ENVER HOXHA: Të na rrojë Partia! Të punojmë e t'u shërbejmë sa më mirë Partisë dhe popullit. Të jemi gjithnjë ushtarë të Partisë!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

LETËRSIA DHE ARTI YNË ECIN GJITHNJË PËRPARA SE UDHËHIQEN NGA MËSIMET E PARTISË

*Nga biseda me një grup punonjësish të artit
dhe të kulturës*

16 tetor 1968

Ju faleminderit shumë që erdhët në këtë takim, jua shpërblefsha në gëzime. Të na rrojë Partia! Ky është gëzimi më i madh dhe urimi më i mirë që ne i bëjmë njëri-tjetrit, pse me këtë shprehen ndjenjat më të thella e më të pastra të të gjithë njerëzve të Shqipërisë sonë socialiste. Partisë sonë të lavdishme i uroj të rrojë në shekuj! Të jetë kurdoherë e fortë si çeliku, pse me të janë të lidhura fitoret e popullit.

Kur me vetëmohim ia kushtojmë jetën tonë Partisë, atëherë mund të themi se kemi kryer si duhet detyrën, se i kemi shërbyer me nder popullit tonë të lavdishëm e trim, të zgjuar e përparimtar dhe kemi ndihmuar sadopak edhe ne në rrugën drejt fitores së revolucionit botëror.

Ju, shkrimtarët dhe artistët, jeni ajo pjesë e Partisë dhe e popullit që çdo ditë dhe çdo orë jepni një

kontribut të shquar në punën e madhe për edukimin revolucionar të punonjësve. Prandaj Partia tregon kujdes të veçantë për ju. Unë kam bindjen e plotë se ju e ndieni këtë kujdes të saj dhe ju vjen shumë mirë. Shkrimtarët dhe artistët janë njerëz të popullit, e duan shumë popullin dhe nëpërmjet krijimtarisë së tyre shprehin ndjenjat e aspiratat e tij. Ndjenjat dhe aspiratat tuaja, pra, janë një me ato të popullit. Prandaj ndihmën dhe kujdesin e Partisë është mirë t'i keni parasysh dhe të punoni kurdoherë me gëzim të madh.

SHOKU SHEVQET MUSARAJ: Të rrojë sa malet Partia dhe Ju shoku Enver, që na keni hapur horizonte të reja e të mëdha edhe në punën tonë. Me këtë rast ju premtojmë, se do të punojmë pa u lodhur për të merituar besimin e madh të Partisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Në vendin tonë, njerëzit me talent, punonjësit e frontit të artit e të kulturës, të dalë nga gjiri i popullit, dinë t'i shprehin bukur ndjenjat dhe aspiratat e tij. Ata, të udhëhequr nga Partia, ccin përkrah popullit, duke shkëlmuar fantazitë e kota. Unë mendoj se, natyrisht, njerëzit e artit dhe të kulturës nuk duhet të jenë pa fantazi, por ata duhet të dinë të zgjedhin midis fantazisë realiste dhe asaj anarkiste, joreale. Shkrimtarët borgjezë e revizionistë janë përkrahës të kësaj të fundit. Ne jemi në luftë me këtë fantazi të cilën synojmë ta shkatërrojmë dhe këtë do ta bëjmë, sepse jemi më të fortë se borgjezia, se bazohemi në shkencën marksiste-leniniste, në mësimet e Partisë, që ka lindur dhe është zhvilluar në bazë të ndjenjave dhe të aspiratave të popullit punëtor.

Në vendet borgjeze sot, në fushën e artit e të le-

tërsisë, janë zhvilluar dhe lulëzojnë shkolla të ndryshme, të cilat pretendojnë se janë në mbrojtje të lirisë së personit dhe të demokracisë, kurse në realitet mundohen të gjejnë çdo mundësi për të helmatisur shpirtërat e masave të nënshtruara prej tyre, për të siguruar kështu sundimin sa më mirë e sa më gjatë të borgjezisë. Pra të gjithë ata që përkrahin këtë literaturë dhe që krijojnë të tilla shkolla udhëhiqen nga ideologjia reaksionare.

Po të ndjekësh programet e televizionit të vendeve perëndimore, do të konstatosh në to gjithfarë mendime të shthurura, si në art, ashtu edhe në mënyrën e jetesës. Qëllimi i këtyre programeve është të korrtojnë e të mbajnë nën shtypje masat punonjëse. Socializmi nuk i ndalon, përkundrazi i inkurajon dhe i nxit shkrimtarët e artistët të përfytyrojnë, të krijojnë figura të bukura në letërsi e në arte, pra ai nxit fantazinë krijuese të tyre, duke mos i larguar nga realiteti. Kurse në vendet borgjeze inkurajohen ata shkrimtarë e artistë që shkruajnë e krijojnë vepra në shërbim të borgjezisë, vepra me përmbajtje reaksionare, me qëllim që të shkatërrojnë e të helmojnë ndjenjat e pastra të popullit, të mohojnë rolin e masave dhe pikërisht këtë ata e quajnë liri. Neve nuk ka ç'na duhet një «liri» e tillë! Përkundrazi, liria e vërtetë ekziston te ne, prandaj edhe ka në radhët e shkrimtarëve dhe të artistëve tanë një frymëzim kaq të madh e të shëndoshë, të cilin nuk e gjen tek ata që na akuzojnë ne për mungesë lirie. Përparimet tona në fushën e letërsisë e të artit duken në arritjet e mëdha që kemi pasur dhe, në të ardhmen, s'ka dyshim që këto përparime do të jenë edhe më të mëdha.

Prandaj, shokë punonjës të artit dhe të kulturës, vazhdoni të ecni si kurdoherë në rrugën e Partisë, se këtë e kërkon interesi i popullit dhe i atdheut! Partia është juaja dhe ajo do të bëjë të gjitha përpjekjet t'ju ndihmojë. Partinë e keni gjithmonë pranë, ajo është midis jush dhe ju këshillon të shfaqni lirisht e sa më mirë mendimet tuaja në rrugën e saj, të thelloheni në direktivat e saj dhe duke vepruar kështu, do të shikoni çfarë veprash madhështore do të dalin nga mendja dhe nga dora juaj.

Partia na mëson që, ndaj kritikës, kur është me vend e objektive, të mbajmë qëndrim të drejtë, ta analizojmë në dritën e mësimeve të marksizëm-leninizmit. Në këtë drejtim duhet të kenë kujdes, sidomos, intelektualët tanë popullorë. Po, kur kritika nuk mbështetet në fakte të vërteta dhe është e trilluar e pa baza, nuk është e drejtë të pranohet. Gjithashtu, nuk vepronhet drejt edhe kur ndonjë nuk flet e nuk kritikon diçka negative, nën pretekstin se mos ia marrin për keq. Në qoftë se ndonjëri e kupton shtrembër kritikën, të jemi të sigurt se kjo mund të ndodhë vetëm përkohehtësisht sepse Partisë nuk i shpëton gjë. Partia jonë është e madhe, ajo i ngre njerëzit në këmbë dhe e vë të drejtën në vend. Partia nuk është një, as pesë persona, ajo përbëhet nga qindra e mijëra njerëz të devotshëm, të drejtë e të vendosur gjer në fund për çështjen e popullit.

Unë i them këto, sepse qëllon që, nga ndonjë shok intelektual, më vjen ndonjë letër. Përgjithësisht këto letra kanë përmbajtje e kritikë të mirë, por kritikata ndonjëherë kanë qenë pa emër, të paadresuara. Mund

të jenë të drejta ato që shkruhen në një letër të tillë, por vetëm një gjë nuk është e drejtë, që autori i letrës nuk i thotë ato hapur. Kjo do të thotë se ai akoma nuk e ka kuptuar forcën e madhe të Partisë, drejtësinë e saj. Prandaj një njeri i tillë, ashtu siç më shkruan mua në letër, duhet t'ia thotë troç atë që mendon edhe shokut, të marrë kurajë e ta kritikojë atë hapur. Partia kërkon që njerëzit tanë të jenë kurajozë, t'i shohin gjërat drejt dhe, duke pasur besim te Partia, çështjet do të zgjidhen me siguri, se ato nuk varen nga një ose nga dy persona. Partia, me vijën e saj të drejtë, na edukon të gjithë, na hap horizonte e perspektiva, na krijon bindje e besim për luftën tonë të drejtë.

Mbrëmë pamë shfaqjen që u dha nga grupet më të mira folklorike të festivalit. Na pëlqeu shumë. Arti popullor, kultura jonë popullore janë me të vërtetë shumë të bukur.

Më lejoni shokë t'ju uroj me këtë rast suksese në punën tuaj!

Të na rrojë Partia!

GRUPI: Të rroni sa malet shoku Enver!

SHOKU ENVER HOXHA: Ju faleminderit shumë!

Të na rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

TE LUFTOJMË VAZHDIMISHT QË VENDI YNË TË PËRPAROJË NË TË GJITHA DREJTIMET

Nga biseda me kuadro të organizatave të masave

16 tetor 1968

Ju faleminderit shumë shokë e shoqe për vizitën që më bëni, jua shpërblefsha në gëzime! Të na rrojë Partia! Pa Partinë, në vendin tonë, jeta e popullit do të ishte në errësirë, ashtu siç është sot në vendet ku sundon kapitali, ku masat punonjëse vuajnë për çdo gjë. Atje shoqëria është e mbushur plot me kontradikta antagoniste klasore dhe vazhdon të rritet çdo ditë e më shumë lufta e punonjësve për të drejtat e tyre. Plot të çara të tilla ekzistojnë edhe në vendet revizioniste.

Ka rreth një muaj që gazetat tona nuk kanë shkruar gjë kundër renegatit Tito. Dhe për këtë çështje disa gazeta të huaja bënin komente të ndryshme se gjoja komunistët shqiptarë, të cilët kanë thënë se kurrë nuk do të bashkohen me Titon, tani e kanë pushuar polemikën me të! Ata e thonë këtë me qëllim për të bërë aluzione, megjithëse e dinë mirë çfarë armiku është Titoja për Shqipërinë si dhe qëndrimin e Partisë sonë ndaj tij. Titoja është armik jo vetëm për ne, por

ai është armiku kryesor i socializmit, është babai i revizionizmit modern dhe, bashkë me udhëheqësit revizionistë sovjetikë, është agjent i imperializmit. Ne i kuptojmë rrugën intrigante të Titos si dhe arsyet, qëllimet e planet me të cilat revizionistët sovjetikë kërcënonin popullin jugosllav. Në këto situata edhe Bullgaria, me përqendrimin e forcave ushtarake sovjetike, u bë shesh sulmi kundër popullit jugosllav dhe popullit shqiptar. Pikërisht në këtë kohë, Partia, me notën e Qeverisë sonë drejtuar qeverisë bullgare¹, i demaskoi këto plane që krijojnë një rrezik të madh për ne dhe demaskoi aktin e qeverisë sovjetike dhe atë të qeverisë bullgare. Kjo notë pati një jehonë të gjerë në opinionin botëror.

Një jehonë të madhe pozitive patën edhe dalja e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, demaskimi që ne i bëmë këtij Traktati si një pakt agresiv, si dhe qëndrimi ynë parimor ndaj sulmit të trupave sovjetike në Çekosllovakia. Partia jonë, të gjitha këto qëndrime nuk i mbajti për të përkrahur Titon, përkundrazi ajo paralajmëroi për rrezikun që përbënin këto veprime të revizionistëve për popujt e Ballkanit. Partia jonë bëri detyrën e saj internacionaliste ndaj popullit jugosllav, ndaj popullit bullgar dhe atij rumun.

Demaskimi që i bëmë ne vendosjes së trupave sovjetike në Bullgari zbuloi planet agresive të revizionistëve sovjetikë. Përpara këtyre planeve edhe Titoja e ndjeu rrezikun që i vinte nga sovjetikët dhe aleatët e tij, prandaj filloi të ndryshojë qëndrimin. Megjithatë

1 Shih në këtë vëllim shënimin 1 f. 118.

ne e dimë mirë kush është Titoja. Ai, sikurse e thashë edhe më parë, është një agjent i regjuri amerikanëve. Por, ndërsa sovjetikët në këto momente kërcënonin Titon, ky, nga ana e vet, dërgonte delegacione tregtare, shkencore etj., në Bashkimin Sovjetik, me qëllim që t'i zbuste revizionistët e Kremlinit dhe, në fakt, presioni i sovjetikëve ndaj Jugosllavisë tash është ulur ca. Sovjetikët, si revizionistë që janë, nesër do të shkojnë prapë atje ku ishin, ata do të puthen përsëri me Titon. Por, ngjarjet që ndodhën këto kohët e fundit tregojnë kontradiktat që ekzistojnë në gjirin e tyre dhe midis tyre e kapitalistëve.

Partia dhe populli shqiptar janë në luftë me të gjithë ata që shkulin lirinë dhe pavarësinë e popujve dhe i përkrah këta në përpjekjet e në luftën e tyre kundër çdo sundimi kapitalist e revizionist. Qëndrimi që mbajtëm ne bëri përshtypje të favorshme në popujt, e sidomos te popujt e Jugosllavisë e te populli bullgar, të cilët u bindën se Shqipëria, si tash dhe më përpara, ndjek me forca të dhjetëfishuara rrugën e drejtë marksiste-leniniste.

Ngjarjet e fundit, që u zhvilluan në Kosovë, e zgjuan ca më shumë popullsinë shqiptare të Kosovës, së cilës Serbia shoviniste i ka hyrë në hak. Titoja, si kurdoherë, bën të gjitha përpjekjet që vëllezërit tanë kosovarë të mos fitojnë të drejtat e tyre, por populli shqiptar i Kosovës dhe i viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi ka bërë e po bën vazhdimisht presion të madh për t'iu njohur e drejta për të përdorur flamurin e vet, flamurin e kuq shqiptar, me shkabën e zezë me yll. Me gjithë pengesat e shumta të titistëve, me gjithë

sulmet e vazhdueshme ndaj elementëve përparimtarë shqiptarë, më në fund titistët u detyruan t'ua njohin shqiptarëve të Jugosllavisë të drejtën për të mbajtur flamurin kombëtar.

Qëndrimi i Shqipërisë ndaj popujve të Jugosllavisë ndihmoi shumë që populli i Kosovës ta fitojë këtë të drejtë. E mbrojnë kosovarët flamurin e tyre, sepse ai përfaqëson luftërat dhe përpjekjet shekullore të popullit shqiptar për liri e pavarësi, ai përfaqëson sa e sa përpjekje, heroizma e sakrifica për të mbajtur të gjalla ndjenjat kombëtare, aspiratat e të parëve tanë, të cilat ne i realizuam e i gëzojmë pas vendosjes së pushtetit popullor, por populli vëlla kosovar ende nuk i ka fituar. S'ka dyshim se do të vijë koha që edhe ai t'i fitojë, sepse kudo do të fitojë marksizëm-leninizmi. Vija e Partisë sonë, taktika e saj për çështjen e popullit kosovar janë të drejta. Këtë askush nuk e mohon, përveç armiqtë imperialistë e revizionistë.

Sot në botë, për çështjen e Shqipërisë është krijuar një situatë shumë e favorshme, që nuk ka ekzistuar asnjëherë më parë. Prestigji i vendit tonë është ngritur si kurrë ndonjëherë. Kjo u duk qartë edhe tani së fundi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, kur, fjalimi¹ i delegatit tonë, shokut Halim Budo, kishte bërë një përshtypje të thellë dhe ishte dëgjuar me vëmendje edhe pse sovjetikët dhe amerikanët ishin përpjekur ta sabotonin, ta bojkotonin, duke krijuar komisione të posaçme në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, për çudinë e tyre, kur foli përfaqë-

¹ Shih: «Zëri i popullit», nr. 245 (6284), 12 tetor 1968.

suesi ynë, asnjë nuk lëvizi nga salla e mbledhjes plenare, me përjashtim të krerëve revizionistë. Ju e keni lexuar dhe keni parë sa i fuqishëm ishte ai fjalim, i cili zgjati 2 orë. Kur dolën në pushim të gjithë delegatët e shteteve të Afrikës, të Azisë, të Amerikës Latine e rrethuan Halimin, i shtrënguan duart dhe nëpër korridoret e sallat e pushimit dëgjoheshin shprehje të tilla si: «U lumtë shqiptarëve», «Vetëm ju shqiptarët flitni të vërtetën, ju na mbronin ne», «Si Shqipëria nuk ka» e të tilla shprehje të tjera të ngrohta e të hapëta. Kjo është rrjedhim i politikës së drejtë të Partisë dhe të Qeverisë sonë, i qëndrimeve kurdoherë parimore e marksiste-leniniste që kemi mbajtur.

Prandaj, për zbatimin e vijës sonë, për plotësimin e detyrave të mëdha e të rëndësishme që na shtron Partia, ne duhet të vëmë të gjitha forcat, energjitë e dijet tona. Të luftojmë vazhdimisht që kjo vijë të kalitet çdo ditë e më shumë, që vendi ynë të përparojë në të gjitha drejtimet, sepse sa më të fortë të jemi, aq më tepër armiqtë nuk do të guxojnë të na prekin. Dhe këtë nuk duhet ta kuptojmë sikur armiqtë nuk bëjnë plane e nuk mendojnë të na godasin. Jo, ata janë dhe mbesin gjithnjë armiq. Por, sa më të fortë të jemi ne aq më vështirë është për ta ta bëjnë një gjë të tillë, sepse po të na prekin sadopak, nuk do të dalin dot të gjallë nga Shqipëria. Kush do të guxojë të hyjë si armik në këtë tokë të shenjtë, me siguri do të lërë kokën. Këtë armiqtë e matin me guximin e popullit tonë, me drejtësinë e vijës së Partisë dhe me unitetin e çeliktë Parti-popull, dhe këtë ata e kanë thënë hapur.

Organizatat e masave kanë për detyrë të luftojnë,

të mbrojnë e të zbatojnë vijën e Partisë, ta bëjnë këtë të qartë dhe të kuptueshme në masat e ndryshme të popullit, të shpien në to frymën revolucionare të Partisë, t'i edukojnë me këtë frymë dhe të bëjnë që çdo gjë të ecë përpara.

Shokët e pranishëm. pasi e uruan shokun Enver Hoxha i premtuan se do t'i mbajnë gjithnjë parasysh këto mësimet të vlefshme e do të punojnë për t'i vënë në jetë.

SHOKU ENVER HOXHA: Le ta pimë këtë gotë për Partinë tonë të lavdishme, që na bëri kaq të pamposhtur, për popullin tonë trim dhe për ju të dashur shokë.

Të rrojë Partia!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

BREZI YNË I RI EDUKOHET E PUNON NË MËNYRE REVOLUCIONARE

*Nga biseda me një grup të rinjsh, pionierësh
e fatosash të Tiranës*

16 tetor 1968

Kur shoku Enver hyn në sallën e pritjes të Komitetit Qendror të Partisë, të rinjtë, pionierët dhe fatosat shpërthejnë në duartrokitje dhe në brohoritje të vazhdueshme për Partinë dhe për shokun Enver. Shoku Enver përshëndetet me ta ngrohtësisht, shumë nga ata i përqafojnë e i puth. Pasi zënë vendet, disa nga fatosat i drejtohen xhaxhit Enver me vjersha kushtuar 60-vjetorit të lindjes së tij, me vjersha për Partinë etj. Në fjalën e tij shoku Enver Hoxha tha:

Në emër të shokëve të mi të Partisë dhe në emrin tim ju falënderoj të gjithë nga zemra e nxehtësisht, ju përfaqësues të rinisë, të pionierëve dhe të fatosave të Tiranës, për këtë dashuri të zjarrtë, që ju, brezi i ri i Shqipërisë, keni për mëmën tonë të dashur, Partinë! Sa forcë të madhe, sa shpresa të mëdha, ç'siguri në të ardhmen ndien populli, kur shikon të rinjtë dhe të rejtat, pionierët e fatosat tanë, që e kanë në zemër, e

duan dhe e mbrojnë me zjarr Partinë, që mësojnë e kaliten në rrugën e saj! Ky është një gëzim i papërskrueshëm për popullin, sepse populli te Partia gjeti shpëtimin. Pa Partinë populli do të vuante në robëri të shumëllojta, kurse Partia e çliroi atë përgjithmonë dhe i hapi rrugë të ndritura. Është për këtë që jeta e popullit tonë është pleksur në mënyrë të pazgjdhshme me Partinë e tij të lavdishme dhe çdo gjë të tij, çdo mendim të tij, ndjenjat e tij më të pastra e të sinqerta, ai ia drejton Partisë, ato janë të lidhura ngushtë me Partinë. Kur populli shikon djemtë dhe vajzat e tij që e duan me kaq zjarr Partinë, kjo e ndien veten jo sikur ka dy krahë si shqiponja, por sikur ka dhjetë palë krahë.

Partia për ju të rinjtë dhe të rejat tregon kujdesin më të madh. Qëllimi i saj më i lartë është që ju të rriteni, të edukoheni e të punoni si revolucionarë, sepse vetëm me një kuptim e qëndrim të tillë në shoqërinë tonë të re, jeta bëhet më e bukur. Prandaj Partia ka vënë të gjitha forcat dhe interesohet që rinia jonë të edukohet e të punojë në mënyrë revolucionare.

Më përpara thuhej se në shkollë vetëm mësohet, kurse tani Partia thotë që njerëzit në shkolla duhet edhe të mësojnë, edhe të punojnë e të stërviten. Dhe kur të rejat e të rinjtë të dalin në jetë edhe të punojnë, edhe të mësojnë, domethënë të mësojnë në shkollë dhe jashtë saj. Prandaj krahas mësimet, në shkollë, brezi i ri do të fitojë shprehitë e punës, duke gërshetuar mirë punën mendore me punën fizike dhe këtë proces do ta vazhdojë edhe më pas, gjithë jetën. Derisa të ketë jetën, njeriu ynë, i brumosur me mësimet e Partisë, duhet të jetë kurdoherë zjarr e revolucionar, ta mbajë

gjallë e të pashuar, vazhdimisht, pishtarin e revolucionit.

Të rinjtë e të rejat tona kanë detyra jo vetëm ndaj atdheut, por, si komunistë internacionalistë e si revolucionarë, ata duhet të mendojnë kurdoherë edhe për çlirimin e popujve të tjerë të botës. Këtë të drejtë nuk e kanë vetëm rinia dhe popujt e mëdhenj të botës, këtë detyrë e të drejtë, e ka çdo njeri revolucionar, çdo marksist-leninist, i organizuar ose jo në parti, e ka çdo popull, i vogël ose i madh qoftë. Prandaj kur ne luftojmë, punojmë e realizojmë detyrat sipas rrugës marksiste-leniniste të Partisë, në çdo punë që na ngarkohet, qoftë si punëtorë në fabrika e në uzina, qoftë si kooperativistë në ara, apo si mësues, si inxhinierë e të tjerë, ne kryejmë jo vetëm detyrën tonë kombëtare, por njëkohësisht dhe atë ndërkombëtare.

Ne luftojmë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste në vendin tonë, luftojmë që ta bëjmë Shqipërinë një vend të bukur, por ne mendojmë njëkohësisht që populli ynë të bëhet shembull edhe për popujt e tjerë. Dhe sa më të fortë ta kemi situatën në vendin tonë, aq më tepër do të ndihmojmë e do të frymëzojmë me shembullin tonë edhe popujt e tjerë. Ju duhet ta kuptoni mirë këtë rol të madh të Partisë sonë, të të gjithë popullit dhe tuajin si brez i ri e kur them brezi i ri, kam parasysh jo vetëm ju më të rriturit, studentët, por edhe këta, të vegjlit, sepse edhe këta kanë ndërgjegjen e tyre që, çdo ditë rritet e kristalizohet, në fillim në forma të thjeshta, pastaj më thellë, për çështjen e ndërtimit të socializmit, që përbën një faktor të madh nxitës e frymëzues edhe për revolucionin botëror.

Prandaj, të dashur shoqe dhe shokë të rinj, nxënës, pionierë e studentë, të keni gjithmonë parasysh mësimet e Partisë dhe të jeni kurdoherë revolucionarë. Të mësoni me zell në shkollat që ndiqni, të qëndroni gjithnjë lart si militantë të organizatës suaj të rinisë e të pionierit, të cilat janë ndihmëse të fuqishme të Partisë. Të mendoni se mësimi në shkolla dhe puna jashtë shkollës, që do të bëhen njëkohësisht e të koordinuara, do të ndihmojnë që te ne të përgatitet një brez i shëndoshë, i kalitur fort për jetën, që nesër do të marrë në duar të sigurta frenat e shoqërisë.

Ju tani po përgatiteni të krijoni personalitetin tuaj si revolucionarë, ta çoni përpara socializmin, të krijoni jetën e re të gëzuar, të krijoni familjet tuaja të reja socialiste. Varet nga ju, shokë të rinj e të reja, se si do të jetë Shqipëria nesër dhe me ju, që udhëhiqeni nga mësimet e Partisë, ajo do të qëndrojë kurdoherë komuniste, bolshevike. Në këtë rrugë ecin e do të ecin populli dhe Partia jonë në shekuj, në këtë rrugë do të ecë edhe brezi i ri i rritur dhe i edukuar nga Partia. Partia do të shtojë radhët e saj me bij e bija nga ju brezi i ardhshëm, që të mbetet gjithnjë e re, revolucionare, e kuqe, pararojë, e shkathët e të mos myket. E theksoj këtë se në jetë ne kemi edhe shembuj se si parti të tjera, si Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, pas vdekjes së Stalinit degjeneroi, u myk, se për mungesë vigjilence armiqtë ia rrëmbyen fitoret nga duart dhe shkelën mësimet e ndritura të Leninit e të Stalinit të madh. Po ne a do të lejojmë vallë që armiqtë të na i rrëmbejnë fitoret tona? Në asnjë mënyrë! Ne do ta ndjekim me konsekuencë, pa shmangie, vijën e

Partisë, do të ecim në rrugën e klasës punëtore, do të punojmë, do të mendojmë e do të luftojmë si klasa punëtore, si revolucionarë. Dhe që ta bëjmë këtë, duhet që intelektualët, mësimin dhe edukimin të mos i konsiderojnë si konsideroheshin në të kaluarën, një stoli për karrierë e për përfitime personale, por si mjete për t'i shërbyer çështjes së madhe të Partisë dhe të mbarë popullit.

Tani për ju janë hapur dyert nga të katër anët. Shqipëria, e ardhmja e saj dhe Partia janë tuajat. Rinia ka treguar me vepra sa mirë i kupton dhe i zbaton direktivat e Partisë. Populli dhe Partia për këtë, që nga baza e deri në krye, i janë mirënjohëse dhe vlerësojnë lart punën heroike të rinisë sonë. Rinia ka qenë në ballë të luftës për çlirimin e atdheut dhe për ndërtimin e vendit. Kjo rini e zjarrtë, mund të themi, se në fillim me vrullin dhe me punën e saj plotësoi mungesën e një klase punëtore të madhe. Rinia vuri në balancë gjithë hovin e saj, u kalit në shkollën e madhe të luftërave dhe ishte gjithnjë e zjarrtë. Prej hovit e prej zjarrit të saj morën edhe të tjerët e duhet të merrni edhe ju. Tani në vendin tonë është krijuar e është forcuar klasa punëtore e kalitur me idetë revolucionare të Partisë. Ajo është zgjuar e edukuar dhe është në gjendje të ndikojë në gjithë jetën e vendit, të vërë kudo ligjin e saj, t'i japë tonin gjithë veprimtarisë së jetës e të ndërtimit të socializmit në Shqipëri.

Ne shikojmë se hovi i rinisë nuk është ndalur për asnjë çast. Edhe në momentet shumë të vështira, kur asaj i kanë munguar veshja e mbathja, kur ka qenë pa bukë dhe ishim të rrethuar nga armiqtë, ajo ka qenë

në ballë të punës. Rinia çante përpara, duke luftuar me vendosmëri kundër të gjithë armiqve të Partisë, kundër titistëve, kundër revizionistëve sovjetikë e çdo komploti imperialisto-revizionist, ajo i ka qëndruar kurdoherë besnike vijës së Partisë. Rinia jonë, e edukuar nga Partia, qëndron e pastër si qelibari, kujdesin e Partisë e të popullit ajo e justifikon me përvetësimin me zell të mësimëve të Partisë dhe me veprat e reja që ndërton, si: hekurudhat, rrugët, hidrocentralet e shumë e shumë të tjera që ka kryer me duart e saj të arta.

Para disa ditësh u inaugurua Hekurudha Rrogoshinë-Fier¹, një vepër me rëndësi shumë të madhe politike, ideologjike dhe ekonomike për vendin tonë. Kjo është vepra e të gjitha juve, shoqe dhe shokë të rinj, e punëtorëve nga më të thjeshtët e deri tek inxhinierët. Në këtë objekt rinia jonë ka derdhur djersën, dituritë dhe gjithë zotësitë e saj. Ajo e ndërtoi atë në një kohë rekord. Vetëm ju mund ta bënit këtë punë në një afat të tillë; po ta bënim me pagesë, do të donim jo më pak se katër vjet, ndërsa rinia e bëri për dy vjet.

Edhe rruga e Malësisë së Madhe është një tjetër vepër me shumë rëndësi politike dhe ekonomike. Sa do të gëzohen malësorët, sa do t'ju urojnë ata ju për këtë vepër! Ju çatë gjithë ato male dhe çfarë malesh! Ju i dhatë asaj zone dritën, zbatuat vijën e Partisë dhe tani ju presin të tjera vepra të mëdha. Si kurdoherë juve ju ndritin sytë kur thoni: «Ku do të shkojmë?». Do të vendosë Partia se ku do të shkoni e ç'Vepra të tjera do të kryeni. Prandaj ta doni kurdoherë Par-

¹ Shih në këtë vëllim, f. 134.

tinë tuaj të dashur, se edhe ajo, si mëma juaj ju do me gjithë shpirt! Ajo ushqen për ju dashuri të pakufishme.

Prandaj të brohorasim për Partinë:

Të rrojë Partia!

Të rrojë rinia!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

SUKSESET E PARTISË JANË VEPËR E GJITHË KOMUNISTËVE SHQIPTARË

*Nga fjala në darkën e shtruar me rastin e 60-vjetorit
të datëlindjes¹*

16 tetor 1968

Të dashur shokë,

Nga emocioni i madh që kam sonte, e ndiej të vështirë t'i lidh fjalët. Për këtë ju lutem të më kuptoni. Kjo ngjet jo se mbusha 60 vjeç, jo, përkundrazi, veten e ndiej akoma më të ri e më të fortë. Por komunistët, dhe veçanërisht njerëzit me ndjenja, siç jam edhe unë, nuk ka si të mos emocionohen nga dashuria kaq e zjarrtë, e singertë, komuniste, që ju, shokë të mi të shtrenjtë të luftës e të punës, që gjithë Partia jonë e lavdishme, e cila është jeta jonë dhe gjithë populli ynë heroik shprehët, me këtë rast, për mua. Kjo dashuri kaq e madhe më jep energji të reja, ma shton edhe më

¹ Kjo fjalë u mbajt në Pallatin e Brigadave në darkën e shtruar nga Komiteti Qendror i Partisë me rastin e 60-vjetorit të datëlindjes së shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të PPSH.

shumë ndjenjën e përgjegjësisë, ndjenjën e lartë të detyrës që si komunist të luftoj e të punoj akoma më shumë dhe me të gjitha forcat e mia, për çështjen e madhe të Partisë e të popullit.

Por, të dashur shokë dhe shoqe, dëshiroj të theksoj se të gjitha ato ndjenja të pastra e revolucionare që shprehët ju për mua, i takojnë, para të gjithash, Partisë sonë, e cila, ashtu si edhe ju, më lindi, më rriti, më edukoi e më mësoi si të punoj, si të luftoj e si të mendoj si një revolucionar, si të veproj e të realizoj, tok me të gjithë shokët dhe bashkë e të pandarë me popullin, veprën e madhe, të pavdekshme në shekuj të Partisë sonë të dashur. Unë jam, kam qenë dhe do të mbetem derisa të vdes një militant besnik, një ushtar i Partisë.

Formimi i Partisë, që është ngjarja më e lavdishme e historisë së popullit tonë, është vepër e komunistëve shqiptarë dhe jo vetëm e një njeriu. Formimi i saj ka rëndësi të madhe historike për vendin tonë. Krijimi i Partisë u bë i mundur në sajë të vullnetit të hekurt të të gjithë shokëve komunistë që morën pjesë dhe realizuan, në rrugën marksiste-leniniste, ëndrrën e madhe të revolucionarëve të vendit tonë, shpresat dhe aspiratat e popullit shqiptar të shumëvujtur, por trim e të papërkulur, konkretizuan përpjekjet e përgjakshme, të vazhdueshme, shekullore për liri, për pavarësi dhe tokë të gjyshërve e të stërgjyshërve tanë heroikë. Ishin, pra, gjithë shokët e orëve të para ata që tendosën nervat me një heroizëm të papërshkruar dhe krijuan Partinë tonë heroike. Partia jonë doli nga gjiri i popullit në rrethana të caktuara objektive, në momente

nga më të vështirat. Ajo lindi në situata të brendshme dhe të jashtme të rënda, por revolucionare. Krijimi i Partisë ishte një nevojë objektive që elektrizoi masat e popullit dhe në radhë të parë komunistët e grupeve.

Partia jonë dhe vepra e saj e madhe, teorikisht dhe në praktikë, nuk është dhe nuk mund të jetë rezultat i punës së një njeriu ose i dhjetë njerëzve. E gjithë rruga e lavdishme në të cilën ka ecur Partia jonë dhe vepra e saj, u arrit në sajë të gjakut, të mundit dhe të mendjes së shokëve tanë heroikë që luftuan e ranë në fushën e nderit për Partinë dhe për popullin, si dhe e të gjitha komunisteve dhe komunistëve që rrojnë e luftojnë edhe sot, në mes të të cilëve jam edhe unë; u arrit në sajë të luftës heroike e të papërkulur, parimore e të guximshme, kundër armiqve, u arrit nëpër dallgë e furtuna.

E gjithë kjo luftë, të gjitha fitoret e korrura gjer më sot, u arritën, sepse Partia jonë jo vetëm u krijua në kushte të tilla, por ajo grumbulloi në gjirin e saj njerëzit më të mirë, më revolucionarë e më të vendosur, të dalë nga gjiri i popullit, përqafoi doktrinën e lavdishme të proletariatit, doktrinën marksiste-leniniste dhe e zbatoi në mënyrë krijuese në kushtet reale të vendit tonë dhe çka është me shumë rëndësi, Partia jonë diti të lidhej ngushtë, në unitet të çeliktë me masat e gjera të popullit. Në vijën e Partisë, nëpërmjet luftës, përpjekjeve e furtunave të shumta që i duheshin të kapërcente, populli ynë gjeti atë që dëshironte, atë çka aspironte, atë për realizimin e së cilës ishte i gatshëm të luftonte deri në sakrificën supreme.

Partia jonë e shtrenjtë marksiste-leniniste i kush-

toi kurdoherë kujdes të jashtëzakonshëm unitetit të çeliktë, klasor, marksist-leninist të radhëve të saj. Për ruajtjen dhe për kalitjen e pandërprerë të këtij uniteti ajo ka zhvilluar me sukses të madh luftën e klasës, jashtë dhe brenda radhëve të saj. Qysh në fillim, ajo spastroi radhët nga elementët deviatorë, trockistë, oportunistë dhe agjentë të armikut. Pa këtë spastrim nuk do të ishte e mundur të arrihej sukcesi i madh i çlirimit të vendit dhe më pas e vazhdimisht ndërtimi i socializmit, nuk do të sigurohej rruga jonë drejt komunizmit. Uniteti i Partisë përbën në çdo kohë forcën e saj të madhe e të pathyeshme. Në këtë unitet qëndron mendimi i drejtë marksist-leninist që e ka udhëhequr vazhdimisht Partinë, qëndron veprimi i saj revolucionar. Ky unitet i çeliktë është arritur në sajë të zbatimit me rreptësi të normave marksiste-leniniste, të cilat, që në ditët e para të krijimit, Partia i rrënjosi thellë dhe i zbaton me rigorozitet në jetën e saj, i ka kalitur dhe po i kalit vazhdimisht çdo ditë e më shumë në ndërgjegjen e komunistëve shqiptarë.

Ju këto probleme i njihni prandaj nuk do të zgjatem. Unë dëshiroj të theksoj, me këtë rast, një çështje me rëndësi të madhe parimore, që lidhet me tezën marksiste-leniniste se historinë e bëjnë masat. Këtë nuk e them për modesti, por realiteti është se janë masat ato që me forcën dhe me veprimtarinë e tyre bëjnë që jeta e tyre të ecë në rrugën e drejtë, natyrisht kur udhëhiqen nga një parti marksiste-leniniste. Partia jonë është ndërtuar dhe është mbajtur në një mënyrë të tillë që roli i personave, i komunistëve të veçantë, nuk nënvleftësohet aspak, por ajo çka është

e drejtë, e vërtetë dhe shpëtimtare është se për realizimin e çështjes së madhe të popullit, të socializmit dhe të komunizmit, Partia jonë ka vlerësuar kurdoherë rolin vendimtar të masave, të kolektivit. Këtë praktikë ajo e ka zbatuar si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ashtu edhe sot gjatë ndërtimit të socializmit e luftës kundër imperializmit e revizionizmit dhe gjithë armiqve të marksizëm-leninizmit.

Në bazë të teorisë dhe të praktikës revolucionare të Partisë sonë të gjithë ne, anëtarët e saj, jemi njëlloj përpara Partisë. Nderi më i madh i gjithsecilit prej nesh, i fituar me luftë, me përpjekje, me sakrifica, është ta meritojmë, gjithë jetën, emrin e komunistit, vetëm kështu mund të jemi anëtarë të denjë të Partisë sonë të dashur dhe të lavdishme. Tësojta e Partisë ta mbajmë të pastër e të panjollosur. Por tësojta e Partisë, qenia anëtar i Partisë, askujt prej nesh nuk i siguron privilegje, përkundrazi, siç na mëson Partia, ajo i ngarkon gjithsecilit të kryejë me përpikëri e deri në sakrificën më të lartë detyrat e ngarkuara. Të tërë jemi njëlloj të dashur e të shtrenjtë për Partinë. Ajo të gjithë na porosit që për të realizuar programin e saj të jemi kurdoherë në ballë të punëve, të mbajmë kurdoherë në njërin dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën, për çështjen e saj të madhe dhe të punojmë e të luftojmë së bashku, me vetëmohim gjithë jetën. Dhe janë e duhet të jenë të parët anëtarët e Partisë ata që ta zbatojnë në mënyrë shembullore vijën e Partisë, që është vija dhe vepra e të gjithë komunistëve, të cilët e përpunojnë, e pranojnë, e ligjësojnë, e shpallin dhe e vënë në jetë. Kështu ka ndodhur që nga themelimi

i Partisë e gjer më sot, kështu do të ndodhë edhe në të ardhmen. Të tillë do të jenë anëtarët e Partisë sonë gjithmonë. Prandaj themi ne se sukseset e Partisë, vija e saj e lavdishme dhe e ndritur në rrugën marksiste-leniniste, në zbatim të normave marksiste-leniniste, janë vepër e gjithë komunistëve shqiptarë dhe jo e një, e pesë ose e dhjetë vetave. Pikërisht këtu qëndron forca e Partisë sonë dhe e unitetit të saj monolit.

Po ne e dimë që anëtarët e Partisë nuk janë të prerë të gjithë njëllor si me gërshërë. Disa përparojnë më shpejt, disa më ngadalë, të tjerë janë më të hedhur në punë, disa janë më pak të hedhur. Ka nga ata që kanë energji më të mëdha, disa janë më të rinj, disa më të moshuar etj. Por, e gjithë kjo forcë e bashkuar si një trup i vetëm, e mbrytur dhe e lidhur fort në një mënyrë të tillë, siç e ka mbrytur e lidhur Partia jonë, bëhet mundësi që cilido prej anëtarëve të saj të realizojë një punë të madhe revolucionare. Në këtë kala, në këtë ndërtesë të ndritur, që po ngre Partia, cilido nga komunistët vë gurin e vet dhe pikërisht në këtë vepër të madhe të përbashkët është edhe puna ime — një gur i njëllorjtë si edhe ai i të gjithëve ju, të dashur shokë, dhe asgjë tjetër.

Dëshiroj të përsëris edhe një herë, se detyrat që na ka ngarkuar Partia neve komunistëve, e sidomos neve që jemi në udhëheqje, nuk na japin privilegje. Përkundrazi ato na shtojnë më shumë ndjenjën e përgjegjësisë së madhe, ndjenjën e përgjegjësisë bolshevike, për ta kryer sa më mirë detyrën. Por që të kryhet sa më mirë detyra, duhet që secili nga ne të jetë kurdoherë nën kontrollin dhe nën ndihmën e vazh-

dueshme të Partisë dhe të popullit, ndryshe nuk është e mundur ta kryejë si duhet punën e vet një udhëheqje që mendon të qëndrojë ose të vërë veten mbi Partinë, mbi normat, mbi ligjet e saj dhe mbi popullin. Është merita e madhe e anëtarëve të Partisë sonë, që këto norma i kanë bërë mish e gjak të tyre.

Partia dhe klasa jonë punëtore kurdoherë na kanë mësuar dhe na mësojnë të mos kënaqemi me sukseset e arritura, të mos kënaqemi me këtë nivel kalitjeje, por vazhdimisht e vazhdimisht ta ngremë atë. Direktivat dhe orientimet e Partisë kanë për qëllim që kuadrot e saj, në radhë të parë, dhe pastaj gjithë masat e popullit, të jenë vazhdimisht e deri në vdekje revolucionarë, të hedhur, të guximshëm, të drejtë, të thjeshtë, të papërkulur përpara vështirësive, njerëz të sakrificës. Objektiv i tyre është që revolucioni ynë të ecë kurdoherë e pa u ndalur përpara, që socializmi të ndërtohet me sukses, që shoqëria jonë të kalojë në komunizëm, që Partia jonë të bëhet akoma më e fortë nga ç'është aktualisht, të bëhet një vare vdekjeprurëse kundër imperializmit me atë amerikan në krye dhe tradhtarëve revizionistë, me ata sovjetikë e titistë në krye, si dhe kundër gjithë armiqtë të tjerë.

Partia gjatë gjithë jetës së saj na ka mësuar se çdo punë shkon mbarë në qoftë se në udhëheqje, dhe jo vetëm në udhëheqje, ka drejtim kolegjal. Ky drejtim kolegjal marksist-leninist duhet të depërtojë thellë e të realizohet deri në organizatat-bazë të Partisë dhe jo vetëm te ne, në Komitetin Qendror. Kudo, siç na mëson Partia, duhet të zërë vend vija e masave. Ne mund të themi, shokë, se një nga arsyet e sukseseve

të mëdha, pas unitetit, dhe faktori kryesor që uniteti ynë është kaq i çeliktë, e ka burimin edhe në kolegjalitetin e udhëheqjes së Partisë.

Çështja e Partisë, çështja e interesit të përgjithshëm mbizotëron orë e çast në zemrat, në mendjen dhe në punën tonë. Dhe pikërisht problemet e mëdha, të koklavitura e të shumëllojta që ka zgjidhur vazhdimisht me sukses Partia jonë, gjatë këtyre periudhave, si me thënë plot patos, por edhe me vështirësi të mëdha, siç janë komplotet e intrigat e panumërta nga ana e imperialistëve dhe e revizionistëve, janë zgjidhur drejt e në mënyrë revolucionare marksiste-leniniste nga Partia jonë. Në zgjidhjen e të gjitha problemeve Partia nuk është frymëzuar nga as edhe një faktor sentimental ose mikroborgjez, por vetëm nga interesat e lartë të popullit dhe të Partisë, të shikuar nën dritën e marksizëm-leninizmit.

Mendimi kolegjal në gjithë Partinë tonë ka qenë, është dhe do të jetë fryt i kontaktit të vazhdueshëm e të përhershëm, si ai i nxënësit me mësuesin e vet, i udhëheqjes me bazën. Shokët e Komitetit Qendror dhe të Byrosë Politike, në debatet e shumta dhe në vendimet e tyre të drejta, kanë sintetizuar kurdoherë mendimin e madh krijues, revolucionar marksist-leninist të bazës së Partisë, të klasës punëtore, të kuadrove udhëheqës të bazës. Veç kësaj, vetë kuadrot udhëheqës të Partisë janë mbrujtur dhe janë pleksur me komunistët dhe me popullin si mishi me thoin, sepse ata janë bij të këtij populli. Shokët e udhëheqjes, të bazës, të rretheve, të Komitetit Qendror dhe të Byrosë Politike rrallë do t'i gjesh nëpër zyra. Ata janë kudo me

masat në mes të komunistëve, të punëtorëve, të kooperativistëve, të inteligjencies, jo për t'i urdhëruar e për t'u diktuar atyre, po për t'i ndihmuar dhe për t'i edukuar e njëkohësisht për t'u edukuar edhe vetë prej tyre. Me këtë dua të them që vija e Partisë, e sintetizuar në direktivat e saj, është vepra kolegjiale e tërë Komitetit Qendror dhe e Byrosë Politike.

Shokë,

Dëshiroj të them, gjithashtu, që atë punë që unë i kam dhënë, po i jap e do t'i jap Partisë edhe në të ardhmen, ua detyroj Partisë, shokëve të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike.

Shokët e udhëheqjes së Partisë sigurisht nuk kanë rënë nga qiejt, por kanë dalë nga zjarri i luftës për çlirim, kanë luftuar heroikisht në ballë të çdo beteje, në ballë të zjarrit, pa marrë parasysh as vdekjen. Ata si dje në luftë, ashtu edhe gjatë periudhës së ndërtimit të socializmit në vendin tonë, përbëjnë një siguri të madhe për Partinë. Prandaj do të ishte gabim të thuhet se të gjitha këto realizime kolosale në vendin tonë janë arritur vetëm në sajë të meritës së Enverit. Ato ç'ka bërë, ç'ka thënë e ç'ka shkruar Enveri lidhen me veprën, djersën, mençurinë, zotësinë e të gjithë Partisë, e të gjithë shokëve të udhëheqjes. Të gjithë, kush më shumë e kush më pak, kanë dhënë kontributin e tyre në këto realizime historike. Duke e studiuar me kujdes kontributin e gjithsecilit, del se ky, i bashkuar me forcën e gjithë Partisë, përbën një thesar ko-

losal. Kjo tregon se Partia ka ditur kë ka zgjedhur në udhëheqjen e saj.

Partia, me një kujdes dhe me dashuri të veçantë, jo vetëm e lëvdon udhëheqjen për punën e madhe që ka bërë për çështjen e saj dhe të popullit, por, kur është nevoja, edhe e kritikon. Kritikata neve na vijnë direkt dhe indirekt. Shumë herë dhe më shumë këto kritika u drejtohen bazës dhe udhëheqjes së saj. Por ne jemi komunistë dhe duhet të dimë se në kritikata që u bëhen bazës dhe udhëheqjes së saj kemi edhe ne këtu lart pjesën tonë. Prandaj kurdoherë që bëjmë analizën e punës së Partisë, ne marrim masa që t'i zhdukim të metat. Direktivat që nxjerr Komiteti Qendror dhe që zbatohen pa përjashtim nga gjithë komunistët dhe populli janë, në radhë të parë, direktiva edhe për ne, edhe këtu duhet bërë punë e pandërprerë, sepse edhe në skutat e ndërgjegjes së anëtarëve të udhëheqjes gjenden mbeturina, të cilat duhet t'i pastrojmë vazhdimisht me këmbëngulje që të mundim të ndihmojmë më mirë bazën, popullin.

Nuk dua të zgjatem më tej në këto çështje, shoqe dhe shokë të dashur, por edhe një herë dëshiroj të nënvizoj se të gjitha këto fitore të mëdha që janë realizuar në vendin tonë, ne ia detyrojmë Partisë dhe vetëm Partisë, prandaj neve, anëtarëve të saj, kurrë nuk duhet të na rritet mendja për çka kemi bërë. Për sa më përket personalisht, të gjitha sa u thanë sonte këtu për mua, unë i kuptoj drejt e si komunist dhe nuk do t'i lejoj vetes në asnjë moment të jetës, qoftë edhe për një grimë, të më rritet mendja. Jo, shoqe dhe shokë, unë punoj që të jem gjithnjë ushtar i Partisë

dhe të kryej me nder e në mënyrë revolucionare, në rrugën marksiste-leniniste, detyrën që më ka ngarkuar Partia. Prandaj ju siguroj, ju dhe Partinë tonë të shtrenjtë, se do të përpiqem gjithë jetën t'i kryej me nder e me devotshmëri detyrat ndaj Partisë dhe popullit.

Partinë ta ruajmë nga çdo rrezik dhe ta kalitim vazhdimisht, pse, situatat që po jetojmë vërtet janë të favorshme për revolucionin, por ato janë të mbarsura edhe me rrezeq e kërcënime. Imperializmi, me imperializmin amerikan në krye, revizionizmi modern, me revizionistët hrushovianë në krye, titistë e të tjerë e ndërlikojnë vazhdimisht këtë situatë. Është e qartë se për armiqtë tanë dhe të revolucionit Partia e Punës e Shqipërisë është armikja ideologjike kryesore, sepse ajo ndjek vijën e drejtë e të çeliktë marksiste-leniniste. Dhe ata kanë plotësisht të drejtë ta konsiderojnë Partinë tonë si armiken e tyre më të madhe. Është për këtë arsye që ata nuk flenë, por me një mijë e një intriga përpiqen e do të përpiqen edhe në të ardhmen të dëmtojnë Partinë dhe republikën tonë. Por vallë do t'ia arrijnë qëllimit? Kurrën e kurrës! Ata nuk mund ta përçajnë dot Partinë tonë, unitetin e çeliktë të radhëve të saj, të ngritur mbi ato baza të çelikta që përmenda më sipër. Ata kurrë nuk do të mund të përçajnë dot unitetin e Partisë me popullin, çfarëdo intrigë e demagogji që të përdorin. Armiqtë e Partisë së Punës të Shqipërisë, sado përpjekje e djallëzi të bëjnë, kurrën e kurrës nuk mund t'ia arrijnë qëllimet e tyre.

Armiqtë kanë bërë përpjekje të shumta gjatë periudhave të ndryshme historike të jetës e të zhvillimit

të Partisë sonë. Të gjithë ju i njihni mirë sulmet e tyre të panumërta kundër Partisë. Por ata nuk kanë pasur dhe nuk do të kenë kurrë sukses, nuk janë në gjendje të thyejnë republikën tonë, vullnetin e madh e të hekurit të popullit shqiptar për ndërtimin e socializmit dhe unitetin e tij të fortë në luftën e vendosur për ruajtjen e lirisë, të pavarësisë dhe të sovranitetit të atdheut tonë socialist. Edhe në qoftë se bëjnë ndonjë marrëzi, edhe sikur të arrijnë të hyjnë në ndonjë cep të vendit tonë, ata do të gjejnë vdekjen e sigurt, do të bëhen pluhur e hi nga forca e madhe luftarake dhe nga vullneti i çeliktë i ushtrisë, i mbarë popullit tonë të armatosur e të udhëhequr në rrugën e drejtë revolucionare të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Pa i nënvleftësuar rreziqet, ne duhet të jemi vigjilentë, kurdoherë vigjilentë dhe veten kurrë të mos e konsiderojmë të vetmuar, pse të gjitha forcat marksiste-leniniste dhe lridashëse në botë janë me ne.

Duke parë realisht situatën, mund të gjykojmë më drejt, shoqe dhe shokë, se ç'forcë të madhe ka marksizëm-leninizmi, ç'forcë të madhe përfaqëson ai që sot frymëzon me dhjetëra e qindra milionë njerëz në të gjithë botën. Veç kësaj shohim se ç'forcë kolosale marrin klasa punëtore, fshatarësia, rinia revolucionare, kur frymëzohen nga marksizëm-leninizmi, kur udhëhiqen në rrugë të drejtë nga partia komuniste. Vetëm në këtë rrugë ato janë në gjendje të përmbysin çdo armik. Dhe vala e lëvizjes komuniste marksiste-leniniste çdo ditë e më shumë po rritet. Kudo janë krijuar e po krijohen parti e grupe të reja marksiste-leniniste. Pikërisht kjo i tmerron imperialistët dhe

revizionistët, të cilët shohin me ankth situatën që ditë-ditës zhvillohet në disfavor të tyre. Ata budallenj s'janë pse kanë parasysh eksperiencën e revolucioneve borgjeze e të fitoreve të tyre, prandaj me ankth ndjekin rritjen e lëvizjes marksiste-leniniste në botë.

Të jemi kurdoherë në gatishmëri, vigjilentë, të punojmë që të forcohemi çdo ditë në të gjitha drejtimet, gjithnjë më shumë të forcojmë unitetin, pse vetëm kështu armiqët nuk kanë ç'të na bëjnë.

Është e vërtetë se imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë kanë frikë të madhe nga forcat revolucionare, pra edhe nga Partia e Punës e Shqipërisë dhe nga populli shqiptar. Dhe ne vazhdimisht do të punojmë që këtë frikë t'ua shtojmë akoma më tepër.

Prandaj le të mobilizohemi në punë sipas mësimave të Partisë. Partinë ta mbajmë kurdoherë të pastër, revolucionare. Partia jemi ne, anëtarët e saj, prandaj t'i zbatojmë me vendosmëri, deri në fund në çdo fushë të jetës, që nga ekonomia e deri në arsim, kulturë e kudo direktivat e Partisë. Kështu do ta bëjmë Shqipërinë tonë të dashur të pamposhtur, do ta bëjmë të shkëlqejë në botë si një vend socialist e komunist i fuqishëm, i begatshëm e i përparuar, i ndërtuar dhe i zbukuruar me luftë të pareshtur revolucionare, me gjakun, me djersën e me mundin e bijve dhe të bijave të saj që kanë përqafuar idetë e marksizëm-leninizmit dhe që dinë t'i zbatojnë e t'i pasurojnë këto me përpikëri, gjatë jetës së tyre revolucionare. Kjo është detyra jonë kryesore.

Prandaj, të dashur shokë dhe shoqe, le ta ngremë këtë doli për Partinë tonë të lavdishme marksiste-lenin-

niste, farkëtuesen e të gjitha fitoreve të popullit tonë! Le të na udhëheqë Partia në rrugën e saj të drejtë dhe ne kurdoherë do të jemi ushtarët e saj besnikë deri në vdekje. Ta ngremë dollinë për popullin tonë të shtrenjtë, për të cilin ne komunistët duhet të jemi dhe jemi gati në çdo moment të japim edhe jetën, që ai të rrojë i lumtur dhe i gëzuar në socializëm dhe në komunizëm!

Rroftë Partia!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**GRUSHTI I KOMUNISTËVE MARKSISTË-
-LENINISTË DUHET TË BJERË FUQISHËM EDHE
MBI AVENTURIZMIN E MAJTË — PJELLË
E REVIZIONIZMIT MODERN**

*Nga biseda me dy udhëheqës të PK (marksiste-leniniste)
të Ekuadorit*

21 tetor 1968

Jemi shumë të gëzuar që takohemi me ju, shokë të Ekuadorit. Natyrisht, dëshira jonë është të bisedojmë më shpesh e më gjatë, sepse lufta e Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) të Ekuadorit si dhe e të gjitha partive marksiste-leniniste në Amerikën Latine ka një rëndësi të madhe për revolucionin. Luftën tuaj ne e konsiderojmë një ndihmë të madhe për revolucionin botëror dhe për Partinë tonë, e cila ka nevojë kurdoherë të mësojë dhe të përfitojë nga eksperiencia e partive motra.

Marksizëm-leninizmi, doktrina jonë universale, e zbatuar në kushtet e çdo vendi, pasurohet me përvojë të re nga të gjitha partitë revolucionare. Eksperiencia e çdo partie marksiste-leniniste e fituar gjatë punës dhe luftës kundër armiqve të përbashkët — imperializmit e

revizionizmit, ndihmon njëkohësisht edhe partitë e tjera. Pa këtë përvojë ne do të ecnim në mënyrë të çalë.

Ju, shokë, me luftën dhe me punën tuaj revolucionare, në kontinentin e Amerikës Latine, me një popullsi të madhe në numër dhe me njerëz të mrekullueshëm e të zjarrtë, jeni, me tërë kuptimin e fjalës, vazhdimisht në kryengritje, në revolucion. Në krye të popujve të këtij kontinenti ekzistojnë sot parti motra marksiste-leniniste. Kuptimi realist marksist-leninist i situatës në kontinentin tuaj, i entuziazmon dhe i frymëzon pa masë partitë e vërteta marksiste-leniniste, të Evropës, të Azisë apo të Afrikës dhe na ndihmon të gjithë për të çuar gjer në fund aksionet revolucionare të çdo vendi në shkallë kombëtare, kontinentale apo ndërkombëtare kundër armiqve tanë të përbashkët: imperialistëve me imperialistët amerikanë në krye, revizionistëve modernë me ata sovjetikë në krye si dhe reaksionarëve të çdo ngjyre.

Partia e Punës e Shqipërisë, komunistët shqiptarë e ndiejnë shumë nevojën e kontakteve për shkëmbimin e eksperiencës me të gjitha partitë motra, sepse një bashkëpunim i ngushtë na forcon reciprokisht. Pavarësisht se gjeografikisht jemi shumë larg njëri-tjetrit, me mendje e me zemër jemi shumë afër dhe faktori «largësi» sot nuk përbën ndonjë vështirësi të pakalueshme.

Sikurse mund ta keni parë dhe vetë gjatë vizitave nëpër vendin tonë, pas fitores së revolucionit, janë bërë shumë ndryshime. Kjo u detyrohet vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë dhe shpirtit revolucionar të popullit tonë. Që ta përfytyroni më mirë gjendjen e

Shqipërisë në të kaluarën, si marksistë-leninistë që jemi, duhet ta krahasoni atë me një nga krahinat më të mjeruara, më të prapambetura e më të shtypura të Ekuadorit të sotëm. Shqipëria para Çlirimit, nën shtypjen e egër feudale ashtu si sot vendi juaj, ka vuajtur shumë. Te ne nuk kishte shkolla. Populli vuante për bukë, për veshmbathje e për çdo gjë të nevojshme për jetesë. Shumica e fushave që keni parë, para Çlirimit ishin moçalishte e kënetë. Malarja, tuberkulozi e sa e sa sëmundje të tjera korrnin jetën e popullsisë, veçanërisht të fëmijëve. Por si rezultat i revolucionit popullor që e udhëhoqi Partia jonë u bënë transformime kaq të mëdha e të shpejta që, pa u mburrur, mund t'i quajmë kolosale për realitetin tonë shqiptar.

Por, si marksistë, duke e parë realisht gjendjen, jemi plotësisht të ndërgjegjshëm, që krahas sukseseve shumë të mëdha që janë arritur, kemi edhe dobësi e na mbetet jashtëzakonisht shumë për të bërë në të ardhmen, në radhë të parë, për ta ngritur akoma më lart nivelin e masave punonjëse sidomos politikisht dhe ideologjikisht, por edhe ekonomikisht; neve na duhet të punojmë shumë për ta forcuar edhe më tepër vendin ushtarakisht, ta ngremë edhe më lart nivelin arsimor e kulturor të popullit tonë dhe, të gjitha këto, vetëm në rrugën revolucionare marksiste-leniniste.

Në këto drejtime punon Partia jonë. Mund të themi se tani kemi krijuar një bazë më të mirë, më të fuqishme, por kryesorja është se gjithçka që kemi arritur, gjithçka që kemi krijuar e kemi bërë në luftë të vazhdueshme me vështirësitë e zhvillimit, të rrethuar nga armiq të tërbuar, e kemi krijuar në kushte të tilla

që, në çdo moment rrezikoheshin pavarësia, liria, sovraniteti i atdheut, socializmi. Ne i kemi krijuar ato në luftë për mbrojtjen e forcimin e unitetit marksist-leninist të Partisë dhe të popullit, tek i cili armiqtë synojnë në mënyrë të veçantë. Ne kemi punuar për ta kalitur këtë unitet në çdo moment. Te çelikosja gjithnjë e më shumë e unitetit Parti-popull qëndron forca jonë. Kjo ka rëndësi jetike pse rreziqet e ndërhyrjes me anën e luftës së armatosur dhe me gjithë format e mundshme kundër vendit tonë kanë qenë e janë të mëdha e të vazhdueshme si nga ana e imperialistëve ashtu edhe nga renegatët titistë e militaristët revizionistë sovjetikë, të cilët e justifikojnë çdo veprim të tyre, siç tregoi pushtimi i Çekoslovakisë, me interesimin gjoja që tregojnë për konsolidimin e shteteve «vëllezër».

Në situatat e sotme revolucionare partitë marksiste-leniniste në të gjithë botën duhet të luftojnë vazhdimisht për të forcuar radhët e tyre, unitetin marksist-leninist, të lidhen ngushtë me masat e popullit dhe me njëra-tjetrën, sepse lëvizja komuniste e punëtore në të gjithë botën është një nga faktorët themelorë që i bën, si revizionistët sovjetikë ashtu edhe imperialistët amerikanë, të cilët dita-ditës po i forcojnë diktaturat e tyre fashiste për të sunduar botën, të dështojnë në planet e tyre kundër popujve. Këto parti duhet të forcojnë edhe vigjilencën.

Kurdoherë, por veçanërisht në situatat që po jetojmë, edhe vendi ynë do t'i shtojë dhe po i rrit vazhdimisht unitetin dhe vigjilencën. Ne, për këtë qëllim kemi marrë, si gjithnjë, masa ideologjike, politike, eko-

nomike dhe ushtarake. I gjithë populli ynë është i armatosur me tërë kuptimin e fjalës. Çdo qytetar ose fshatar shqiptar armën e ka në shtëpi. Vetë ushtria jonë, ushtri e popullit ushtar, është e gatshme në çdo moment të godasë çdo armik apo koalicion armiqsh. Në këmbë është gjithashtu rinia. Gatishmëria luftarake nuk na ndalon aspak në punën për ndërtimin e socializmit, përkundrazi, ajo u ka dhënë një hov më të madh ekonomisë dhe kulturës në vendin tonë.

Në këto momente revizionistët sovjetikë e jugosllavë, fashistët grekë dhe italianë e dinë mirë se, po të ndërmerin ndonjë aventurë për të sulmuar Shqipërinë, kurrë nuk do të fitojnë, por do të hanë grushte vdekjeje. Këtë ne ia kemi bërë të qartë kujtdo dhe kurdoherë. E tillë është situata në përgjithësi në vendin tonë, e shëndoshë, e sigurt dhe me perspektiva të shkëlqyera. Kjo s'duhet të na bëjë të flemë mbi dafina, por duhet të punojmë çdo ditë e më shumë.

Është e qartë për të gjithë se në Bashkimin Sovjetik tani ekziston diktatura fashiste militariste. Por dihet se atje ku ka shtypje ka edhe lëvizje, prandaj, si atje, ashtu edhe në vendet satelite, ka lëvizje revolucionare që ngrihet progresivisht. Një presion i madh po ushtrohet sot mbi Bashkimin Sovjetik edhe nga ana e imperializmit. Ky, nga njëra anë, synon për ta mposhtur atë si fuqi rivale imperialiste dhe nga ana tjetër, synon që të mos lejohet në asnjë mënyrë lindja e lëvizjeve revolucionare e për t'i shuar menjëherë ato po qe se lindin dhe, jo vetëm në Bashkimin Sovjetik, por edhe në vendet e tjera satelite të tij.

Vetë Bashkimi Sovjetik, nga ana e tij, synon në dy

drejtime: së pari, përpiqet për të shuar çdo lëvizje revolucionare që mund të ngrihet, dhe së dyti, në pamundësi për ta mposhtur SHBA-në si fuqi rivale imperia-liste, të ruajë pozitat e tij dhe tok me imperializmin amerikan të mundin të sundojnë secili në zonat që ka në sferën e vet të influencës.

Jemi shumë të gëzuar kur mësojmë që Partia Komuniste (marksiste-leniniste) e Ekuadorit po ecën përpara. Shokët me të cilët jeni takuar më vunë menjëherë në dijëni për zhvillimin e bisedimeve dhe shkëmbimin e eksperiencës së përbashkët. Për këtë gjë shumë të dobishme e frytdhënëse midis Partisë sonë dhe partive motra ne vëmë vazhdimisht në dijëni edhe Byronë Politike të KQ në mbledhje të veçanta të saj. Ne u gëzuan shumë që partia juaj po kalitet e po përparon vazhdimisht në rrugën marksiste-leniniste. Gjithashtu jemi plotësisht dakord me pikëpamjet e partisë suaj dhe kemi bindjen se rruga që po ndiqni ju është e drejtë. Nuk ka asnjë dyshim, jeni ju ata që i dini më mirë se kushdo tjetër çështjet që ju preokupojnë dhe rrugën më të drejtë se si duhen zgjidhur ato kurdoherë duke u bazuar në ideologjinë tonë, marksizëm-leninizmin.

Taktikën tuaj, të bazuar në strategjinë marksiste-leniniste, natyrisht, vetëm partia juaj është në gjendje ta përgatitë si duhet, sepse ajo, si zemra e proletariatit dhe e popullit të Ekuadorit, e njeh më mirë se kushdo tjetër gjendjen e vendit dhe aspiratat e ligjshme të popullit tuaj. Për këtë arsye, përderisa partia juaj ka një strategji të drejtë, të bazuar në teorinë marksiste-leniniste dhe në praktikën reale të vendit, edhe taktikat që

përpunon ajo do të jenë të drejta e revolucionare. Edhe ne, gjatë Luftës sonë Nacionalçlirimtare kemi përdorur lloj-lloj taktikash siç po bëni edhe ju.

Partitë tona të përpiqen të mësojnë e të përfitojnë nga njëra-tjetra. Por çdo parti duhet të ketë parasysh se disa gjëra nga të partive të tjera janë të përshtatshme vetëm për kushtet e vendeve të veta dhe mjaft nga ato nuk mund të jenë të përshtatshme edhe për kushtet e vendeve të tjera. Ato duhet ta përpunojnë dhe ta përshtatin përvojën e partive të tjera, kur ajo u nevojitet dhe u përputhet kushteve të tyre konkrete, ndryshe bie në shabllonizëm. Lidhur me eksperiencën tonë nuk u themi dot nëse shumë nga taktikat tona janë të përshtatshme për ju ose jo. Ju përket juve të studioni dhe të zgjidhni, por mendojmë të mbahet parasysh se busulla që nuk na gabon në këtë çështje është marksizëm-leninizmi, janë ligjet e përgjithshme të revolucionit proletar. Vetëm këto nuk e lënë të gabojë kurrë një parti të vërtetë marksiste-leniniste.

Ne i kemi të qarta këto ligje dhe përpiqemi çdo ditë e më shumë t'i njohim, prandaj nuk kemi rrëshqitur kurrë as në revizionizëm, as në trockizëm, as në aventurizëm të majtë e në rryma të tjera antimarksiste.

Ju i njihni më mirë nga ne këto teori, rreziqet dhe dëmet që sjellin ato. U vra për shembull Çe Guevara. Një gjë e tillë mund të ndodhë, pse revolucionari mund të vritet. Por Çe Guevara ra viktimë e pikëpamjeve të tij jomarksiste-leniniste.

Kush ishte Çe Guevara? Kur flasim për Guevarën ne kuptojmë edhe Kastron që e heq veten marksist dhe që, sipas mendimit tim, në krahasim me këtë Gue-

vara ishte një njeri me më pak llafe. Ai ishte një i revoltuar, një revolucionar, por jo marksist-leninist siç përpiqen ta paraqesin. Unë mund edhe të gabohem, ju si latinoamerikanë e njihni më mirë Çe Guevarën, por mendoj se ai ishte një luftëtar i majtë. Majtizmi i tij është një majtizëm borgjez e mikroborgjez, i pleksur me disa ide përparimtare, por njëkohësisht edhe anar-kiste, që në fund të fundit të çojnë në aventurizëm.

Pikëpamjet e Çe Guevarës e të Fidel Kastros që e heq veten marksist e «babain» e këtyre ideve nuk kanë qenë dhe nuk kanë të bëjnë aspak me marksizëm-leninizmin. Guevara ka pasur, gjithashtu, si të thuash disa «*éclaircies*»¹ në adoptimin e disa parimeve marksiste-leniniste, por ato nuk ishin bërë akoma botëkuptim i tij filozofik që ta shtynin atë në veprime të vërteta revolucionare.

Nuk mund të themi se Çe Guevara e shokët e tij kanë qenë njerëz frikacakë. Jo. Në asnjë mënyrë! Përkundrazi ata kanë qenë njerëz të guximshëm. Ka edhe borgjezë, që janë njerëz të guximshëm. Por njerëz heroikë, revolucionarë proletarë dhe trima me të vërtetë të mëdhenj, janë vetëm ata që udhëhiqen nga parimet filozofike marksiste-leniniste dhe vihen me të gjitha forcat e tyre mendore e fizike në shërbim të proletariatit botëror dhe të çlirimit të popujve nga zgjedha imperialiste, feudale etj.

Ne e kemi mbrojtur revolucionin kuban, sepse ai ishte kundër imperializmit amerikan. Ne, si marksistë-

¹ Frëngjisht — qartësi. Në këtë kontekst është përdorur me kuptimin: «rreze dielli në mes të reve».

-leninistë, le ta studiojmë ca këtë dhe idetë që e udhëhoqën atë në këtë luftë. Revolucioni kuban nuk u fillua duke u bazuar në marksizëm-leninizmin, nuk u zhvillua duke u mbështetur në ligjet e revolucionit proletar të një partie marksiste-leniniste. As pas çlirimit të vendit Kastroja nuk u fut në rrugën marksiste-leniniste, përkundrazi vazhdoi në rrugën me idetë liberale. Është fakt, dhe kjo nga askush nuk mund të mohohet, se pjesëmarrësit e këtij revolucioni rrokën armët e dolën në mal, por është, gjithashtu, fakt i pamohueshëm se ata nuk luftuan si marksistë-leninistë. Ata ishin luftëtarë çlirimtarë kundër klikës së Batistës dhe fituan kundër tij, pse pikërisht kjo klikë përbënte një hallkë të dobët të kapitalizmit. Batista ishte një shërbëtor i bindur i imperializmit që i qëndronte mbi shpinë popullit kuban, i cili luftoi kundër kësaj klike dhe fitoi kundër saj, njëkohësisht edhe kundër imperializmit janki.

Por ç'luftë bëri Kastroja dhe si mundi të fitojë? Lufta që ai filloi nuk ishte një luftë e gjerë, popullore dhe e organizuar në bazë të situatës. Në atë kohë nuk ekzistonte në Kubë një parti marksiste-leniniste që t'i udhëhiqte luftën dhe revolucionin në rrugë të drejtë. Lufta atje u bë me çeta të hallakatura dhe, në radhë të parë, nuk ishte në vijën marksiste-leniniste e revolucionare të luftës popullore, por ishte, si me thënë, një luftë e mbështetur në idetë e Fidel Kastros e të Çe Guevarës, ide këto jo të kristalizuara nga ana e tyre në rrugën marksiste-leniniste. Pikëpamjet e Kastros kishin për qëllim që lufta të bëhej kundër imperializmit dhe për çlirimin e popullit kuban nga zgjedha e

Batistës. Në pikëpamjet e tij nuk ekzistonte asgjë marksiste-leniniste, por vetëm mendimi i gabuar se ushtria zgjidh çdo gjë, me një fjalë, ekzistonin aventurizmi dhe anarkizmi.

Kur u çlirua Kuba, kastristët i quajtën marksistë-leninistë, por në fakt, ata nuk ishin të tillë, pse edhe pas çlirimit vazhduan në rrugën e tyre: jo vetëm që të mos kishin parti, por as të mendonin për ta organizuar atë dhe as t'i vinin rëndësinë e duhur partisë marksiste-leniniste. Ata as përpara, as edhe tani, nuk e kanë të qartë idenë e shtetit proletar, domethënë të diktaturës së proletariatit dhe të bazës së kësaj diktature. Nuk kanë të qartë, gjithashtu, se cila është ideologjia e proletariatit, cila është pararoja e tij dhe si duhet organizuar kjo pararojë. Në Kubë ka sot një formë të organizimit të partisë anarkiste, atje pushtetin e vërtetë e ka në dorë ushtria.

Fidel Kastropa, Çe Guevara e të tjerë e propagandojnë rrugën e tyre si «rrugën e vërtetë marksiste-leniniste», kurse ne, sipas mendimit të tyre, jemi dogmatikë.

Kastrizmi ka pasur dhe ka një influencë të ndjeshme në vendet e Amerikës Latine. Fidel Kastro, Çe Guevara e të tjerë, janë përpjekur bile ta përhapin teorinë e tyre edhe në Afrikë e në Azi, ndërsa Kim Ir Seni i bie defit dhe trumbeton se Kastropa dhe ai vetë qenkan marksistë-leninistë të vërtetë!

Ne mendojmë se atë që e pësoi Çe Guevara dje do ta pësojë kushdo që do të ndjekë atë rrugë. Neve na dhimbset populli heroik kuban, të cilin e duam se është me të vërtetë i mrekullueshëm. Ai vërtet u çlirua nga

klika e Batistës dhe nga kthetrat e imperialistëve janki, por fakt është se ndodhet shumë ngushtë nga ana ekonomike, megjithëse kanë kaluar afro dhjetë vjet dhe merr një milion rubla në ditë nga BS.

Ato që thonë kastristët janë vetëm maska. Të gjithë kemi kaluar nga triskat. Fill pas Çlirimit, me tërë kuptimin e fjalës, as ne nuk kishim bukë të hanim, nuk kishim as veshmbathje, por vija e drejtë e Partisë sonë bëri që të mos mbetemi ashtu siç e gjetëm gjendjen kur morëm pushtetin.

Mund të quhet veprim marksist-leninist të lejosh me mijëra njerëz të largohen lirisht nga Kuba për në Amerikën e Veriut e sa e sa veprime të tjera jashtëzakonisht të gabuara, që ju i dini edhe më mirë, të këtyre njerëzve që megjithatë e quajnë veten marksistë?

Sipas mendimit tonë teoria se revolucionin e kryejnë disa «heronj» përbën një rrezik për marksizëm-leninizmin, veçanërisht në vendet e Amerikës Latine. Në kontinentin tuaj jugor ka tradita të mëdha revolucionare, por, siç thamë më lart, ka edhe disa tradita të tjera që në pamje duken si revolucionare; kurse në fakt nuk janë në rrugën e vërtetë të revolucionit. Çdo puç që bëhet atje quhet revolucion! Por puçi nuk mund të jetë kurrë revolucion, pse në vend të një klike që rrëzohet vjen një tjetër, me një fjalë jemi po aty. Të gjitha bërthamave të rrymave antimarksiste që ekzistojnë akoma në gjirin e partive të vjetra, që janë vënë në shërbim të kundërrevolucionit, u shtohet tani edhe një rrymë tjetër, ajo që ne e quajmë aventurizëm të majtë.

Kjo rrymë si dhe pjella tjetër e borgjezisë, revisionizmi modern, përbëjnë rreziqe të mëdha për popujt,

pra edhe për vendet e Amerikës Latine. Revizionizmi modern është mashtrues i madh i popujve dhe i revolucionarëve, i maskuar me kujdes. Në vende të ndryshme ai vë maska të ndryshme. Edhe kastrizmi, i maskuar me marksizëm-leninizmin, në Amerikën Latine po i çon njerëzit, qofshin këta edhe revolucionarë, në aventurizëm të majtë. Kjo rrymë duket sikur është në kontradiktë me revizionizmin modern. Kështu mendojnë ata që nuk janë të pjekur ideologjikisht, por nuk është kështu. Kastriotët nuk janë në opozitë me revizionistët modernë, përkundrazi ata janë në shërbim të tyre. Rruga që ndjek secili në mënyrë të veçantë i nxjerr në një qafë të përbashkët.

Çështja qëndron në atë se, atje ku revizionistët sovjetikë nuk arrijnë dot t'i pengojnë masat e klasës punëtore dhe të popullit për të bërë revolucionin, pikërisht atje futet kjo rrymë dhe shkatërron me puç atë që nuk mundin ta shkatërrojnë dot revizionistët me evolucion. Revizionistët sovjetikë dhe të gjitha klikat tradhtarë që udhëheqin partitë revizioniste predikojnë evolucionin, bashkekzistencën e gjithë ato teori të tjera antimarksiste që dimë. Aventurizmi i majtë nga termat duket më revolucionar, sepse predikon luftën e armatosur! Por ç'kupton ai me luftë të armatosur? Është e qartë — puçet. Marksizëm-leninizmi na mëson se vetëm duke ecur me hapa të matur e të sigurt, vetëm duke u mbështetur fort në parimet e doktrinës marksiste-leniniste, vetëm duke i bërë masat të ndërgjegjshme, sigurohet fitorja në përgatitjen dhe në shpërthimin e kryengritjes së armatosur, vetëm kështu nuk bie kurrë në aventurizëm.

Autorët e teorisë «motori i vogël» vë në lëvizje «motorin e madh» hiqen sikur janë për luftën e armatosur, por në fakt ata janë kundër luftës së armatosur dhe punojnë për ta diskredituar këtë. Shembulli i Çe Guevarës dhe përfundimi i tij tragjik, teoritë e Fidel Kastros dhe të Debreit¹, që janë kundër luftërave të mëdha e masive popullore janë fakte të njohura botërisht që i hedhin poshtë pretendimet e tyre. Të ruhem nga populli se mos na tradhtojë, se mos na dorëzojë në polici, të formojmë çeta «të egra» e të izoluara gjoja që të mos i dijë armiku e të bëjë terror në popull! Këto dhe shumë teori të tjera të çoroditura propagandojnë ata, të cilat ju i dini mirë. T'i biesh armikut me këto çeta «të egra», ta luftosh atë me to etj., pa pasur në udhëheqje të luftës partinë marksiste-leniniste, çfarë marksizëm-leninizëm mund të ketë këtu? Asgjë marksiste-leniniste. Marksizëm-leninizmit dhe revolucionit teori të tilla antimarksiste-antileniniste nuk mund t'u sjellin tjetër përveçse disfata, siç solli në Bolivi ndër-marrja e Çe Guevarës.

Kjo rrymë diskrediton tezat e kryengritjes së armatosur. Sa dëm të madh i bën ajo revolucionit! Ja, masat e thjeshta të infektuara nga ndikimet që ushtrojnë mbi to pikëpamjet anarkiste, me vrasjen e Guevarës, do të mendojnë: tani nuk ka më njeri tjetër për të na udhëhequr për t'u çliruar! Ose, mund të ngrihet përsëri një grup njerëzish me një Guevarë tjetër e të hidhet në mal «në revolucion» dhe masat, që presin

¹ Socialist, publicist francez, ish-propagandues i teorive fokiste.

shumë nga këta njerëz, të djegurat për luftë kundër borgjezisë, të gënjehen e t'u venë pas. Dhe ç'do të ndodhë? Do të ndodhë ajo që ne e kemi të qartë. Gjersa këta njerëz nuk janë pararojë e klasës punëtore, gjersa nuk udhëhiqen nga parimet dritëdhënëse të marksizëm-leninizmit, do të ndeshen në moskuptimin e masave të gjera, shpejt a vonë do të dështojnë, por do të diskreditohet edhe lufta e vërtetë, lufta e armatosur se masat do ta shikojnë këtë me mosbesim. Masat duhet t'i përgatitim politikisht e ideologjikisht dhe t'i bindim nëpërmjet eksperiencës së tyre praktike. Prandaj themi se teoria frenuese e reaksionare që po përhapet në Amerikën Latine për revolucionin është pjellë e revizionizmit modern e duhet demaskuar nga marksistë-leninistët.

Kastroja flet ndonjëherë në mënyrë të maskuar «kundër» Bashkimit Sovjetik, por ne nuk mund ta konsiderojmë këtë sikur ai është në opozitë me të. Këto janë, nga njëra anë, vetëm presione e shantazhe për të nxjerrë ndonjë përfitim dhe, nga ana tjetër, për të gënjyer naivët. Në qoftë se predikuesit e teorive kastroiste nuk do t'u shërbenin sovjetikëve për qëllimet e ekspansionit të tyre imperialisto-revizionist, ata do t'ua pritnin të gjitha ndihmat. Ne i njohim mirë sovjetikët. Por kjo nuk do të ndodhë, sepse ata u shërbejnë mirë. Kjo është arsyeja që revizionistët sovjetikë vazhdojnë t'u japin ndihmë dhe t'i mbajnë gjallë ata.

Është detyrë për të gjithë marksistë-leninistët që ta demaskojnë këtë rrymë antimarksiste, predikuesit e së cilës vetëquhen marksistë-leninistë, që përdorin terma marksistë vetëm si maskë të cilën, po nuk e vunë

humbasin. Ne duhet t'ua çjerrim atyre këtë maskë dhe kjo bëhet vetëm me luftë të organizuar në rrugën marksiste-leniniste siç bëni ju, shokë të Ekuadorit e shokë të tjerë.

Ne u gëzuam shumë për mënyrën se si keni vepruar ju në lidhje me forcimin e partisë dhe për pikëpamjet e drejta që keni për luftën e armatosur. Pa e kuptuar mirë ne, marksistët, se partia duhet të jetë e fortë, e çeliktë dhe që kjo bëhet vetëm në rrugën marksiste-leniniste, nuk mund të arrihet asnjë fitore nga ana jonë. Populli ynë, si dhe populli juaj, edhe në të kaluarën ka luftuar, por s'ka fituar. Nga gjiri i popullit tonë kanë dalë njerëz, bile shumë të mirë e të zotë, me pikëpamje të qarta iluministe, me vendosmëri të madhe revolucionare, që kanë luftuar me pushkë e me penë kundër turqve e më vonë kundër pushtuesve të ndryshëm. Por mundi dhe gjaku i tyre kanë shkuar kot. Borgjezia dhe feudalët, fitoret e popullit dhe përpjekjet e këtyre njerëzve të shquar i kanë shfrytëzuar për interesat e tyre dhe populli përsëri ka mbetur i shtypur. Kjo vinte ngaqë nuk ekzistonte jo vetëm një parti marksiste-leniniste, por të paktën as edhe një parti progresiste që ta udhëhiqte e ta çonte popullin tonë përpara. Vetëm pas formimit të Partisë Komuniste populli shqiptar mundi të realizonte aspiratat e tij shekullore, vetëm nën udhëheqjen e saj gjaku dhe djersa e tij nuk shkuan kot. Pra, është udhëheqja e partisë marksiste-leniniste ajo që u siguron fitoren popujve dhe jo aksionet e «vatrës» guerile që predikojnë disa.

Ne gëzohemi shumë që ju shokë të Partisë Komuniste të Ekuadorit e spastruat partinë tuaj nga elementë

të huaj për një parti të vërtetë marksiste-leniniste. Na gëzon shumë fakti që ju e keni të qartë se si duhet forcuar e duhet shtrirë partia, me çfarë elementësh të klasës duhen mbushur radhët e saj, si duhet të zgjerohet ajo në fshat e, në radhë të parë, si të futet më thellë në gjirin e klasës punëtore. Njerëzit nuk lindin komunistë, por, veç, ata lindin të pastër dhe gjatë jetës e luftës së përditshme mësojnë, edukohen dhe bëhen komunistë që për idealet e tyre sakrifikojnë dhe jetën. Ju keni bërë shumë mirë që për edukimin marksist-leninist keni hapur kurse e shkolla. Kështu kemi vepëruar edhe ne gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Mësimi dhe përvetësimi i marksizëm-leninizmit janë të domosdoshëm e shpëtimtarë për çdo komunist dhe për çdo parti marksiste-leniniste.

Ne edhe sot në këtë rrugë po ecim. Në qendër të punës sonë në drejtim të edukimit të rinisë kemi vënë: mësim, punë në prodhim, përgatitje fizike e ushtarake për mbrojtjen e atdheut. Tani jemi duke hedhur bazat e një sistemi arsimor të ri, po rrëzojmë të gjitha normat e vjetra që kanë mbetur në shkollat tona, me qëllim që atje jo vetëm të mësohet, por dhe të punohet, që njeriu në shkollën tonë të mos bëhet intelektual në kuptimin e vjetër të fjalës, i shkëputur nga masa e nga puna në prodhim dhe kur të dalë nga shkolla, të mos bëhet burokrat e teknokrat, por të qëndrojë kurdoherë si proletar. Që të qëndrojë i tillë duhet t'i futen në gjak marksizëm-leninizmi dhe puna në përgjithësi, pa u kufizuar vetëm te puna e laboratorit siç bëhet zakonisht në shkollat borgjeze, por të punojë në fabrikë, në bujqësi ose në miniera. Ne duam që në shkollë të

rinjtë të mësojnë të bëhen edhe ushtarë të mirë për të
 genë të gatshëm që të mbrojnë revolucionin. Boshti
 ideologjik është boshti kryesor në edukimin e rinisë.
 Shkolla jonë, pra, synon të nxjerrë njerëz të mësuar
 e me nivel të lartë ideopolitik, punëtorë të kalitur dhe
 ushtarë të aftë për mbrojtjen e republikës sonë.

Të gjitha sa keni bërë ju për çështjen e edukimit,
 kanë rëndësi të madhe dhe ne jemi shumë të gëzuar
 për sukseset që keni arritur në këtë drejtim.

Ne ju themi, të dashur shokë, dhe ju sigurojmë se
 Partia jonë, e bashkuar ngushtë me popullin, ka vënë
 dhe do të vërë të gjitha forcat e saj për të mbrojtur
 me besnikërinë më të madhe pastërtinë e marksizëm-
 leninizmit, do të punojë pa u lodhur për të kalitur
 internacionalizmin proletar. Ajo do të bëjë çdo gjë që
 përpjekjet e saj dhe të popullit tonë të kuptohen dhe
 të krijojnë kushte jo vetëm për konsolidimin e atdheut
 tonë socialist, por edhe për forcimin e lidhjeve e të mi-
 qësisë me të gjitha partitë motra marksiste-leniniste,
 që edhe Partia jonë, në mënyrë modeste të kontribuojë
 me të gjitha forcat për fitoren tonë të përbashkët të
 revolucionit proletar.

Ne jemi shumë të prekur për vlerësimin e madh
 që i bëni ju punës modeste të Partisë sonë. Ne e kup-
 tojmë shumë drejt si marksistë-leninistë gjithçka që
 thatë ju, të dashur shokë, për Partinë tonë, për ekspe-
 riencën e saj. Për të gjitha këto ju falënderojmë dhe
 ju themi se ato janë një inkurajim i madh për ne,
 sepse e dimë që vijnë nga një gjykim real dhe i qartë
 shokësh marksistë-leninistë. Natyrisht, si marksistë-le-
 ninistë që jemi, ju sigurojmë që kjo nuk na e rrit

mendjen. Përkundrazi na shton përgjegjësinë për të merituar të paktën edhe një për qind të atyre që thatë ju. Pra, duhet të luftojmë akoma më shumë, të kryejmë akoma më me nder detyrën tonë, në mënyrë që çdo veprim yni jo vetëm të mos dëmtojë kauzën e madhe të socializmit në botë, kauzën e revolucionit botëror, por as të një partie apo grupi të veçantë marksist-leninist, përkundrazi, çdo veprim yni të shërbejë si nxitje e shembull për këdo, me qëllim që të rritet numri i partive marksiste-leniniste e të forcohen ato, sepse me një e me dy lule, siç thotë populli shqiptar, nuk vjen behari. Për të triumfuar kudo revolucionit socialist duhen dhe do të duhen shumë lule. Kështu e kuptojmë ne detyrën tonë internacionaliste.

Edhe për ne do të mbetet i paharruar takimi me ju, sepse ju na ndihmuat shumë me ato që na thatë për gjendjen në Amerikën Latine. Ne forcohem njëqind herë më shumë kur mësojmë se partia juaj është një parti e vërtetë marksiste-leniniste, me një vijë dhe me perspektivë të qartë. S'ka dyshim se një parti e tillë me siguri do të fitojë. Ju thoni se partia juaj është e vogël. Ne ju themi se kur u krijua Partia jonë kishte rreth 200 anëtarë. Por kjo ne nuk na pengoi aspak të tërhiqnim masat, t'i udhëhiqnim ato, të luftonim dhe bashkërisht t'i mundnim armiqtë e jashtëm e të brendshëm, të fitonim dhe të vendosnim diktaturën e proletariatit.

Sa forcë të madhe marrim ne për ta fuqizuar luftën tonë, kur shohim se partia juaj e Ekuadorit është një parti me të ardhme të ndritur derisa mban lart flamurin e marksizëm-leninizmit!

Ju thatë se keni bërë gabime, disa gjëra nuk i keni

parë si duhet. E, cila është ajo parti që nuk ka bërë gabime? Gabime ka bërë edhe Partia jonë gjatë veprimtarisë së saj revolucionare, por jo në vijën e përgjithshme. Rëndësi ka çështja që gabimet ne, sa i kemi kuptuar, i kemi korrigjuar menjëherë.

Çështja që thatë ju për forcimin e punës së Partisë me organizatën e rinisë dhe të gruas ka rëndësi të jashtëzakonshme për revolucionin. Unë kam konstatuar, dhe vetë ju e keni thënë në bisedat me shokët tanë, se interesoheni shumë për çështjen e studentëve. Kjo është shumë mirë, por kini parasysh se studentët janë pjesë e rinisë dhe jo gjithë rinia. Ju, gjithashtu, u keni vënë rëndësi çështjes së fshatit, çështjes së klasës punëtore. T'u vësh rëndësi fshatit dhe klasës punëtore është e pamundur të mos interesohesh për rininë dhe për gratë e fshatit. Tani është puna që ju t'i konkretizoni më mirë këto çështje. Ne do të jemi shumë të lumtur, po t'ju ndihmojë eksperiencia jonë modeste.

Doja të thosha edhe këtë: Partia jonë ka qenë e vogël, klasa jonë punëtore në kohën e krijimit të Partisë ishte jashtëzakonisht e vogël. Mirëpo ideologjia e saj, marksizëm-leninizmi, me punën e madhe që bëri Partia, u përqaftua në radhë të parë nga rinia. Partia e organizoi menjëherë rininë, e cila u hodh në luftë dhe luajti një rol të jashtëzakonshëm në të; ajo luftoi duke u ndriçuar nga ideologjia e klasës punëtore.

Sa për gruan qysh në fillim parulla e Partisë ishte se pa të nuk mund të bëhej e të përfundonte me fitore lufta e armatosur. Partia theksoi se këtë çështje duhet ta kuptojnë, në radhë të parë, vetë gratë, se duke bërë luftë për çlirimin e atdheut, luftohej që të çlirohej një-

kohësisht edhe gruaja. Partia në atë kohë tha: Në qoftë se gruaja nuk e kupton idenë e madhe të Partisë për pjesëmarrjen e saj në luftë, nuk do të ketë luftë të vërtetë çlirimtare. Kësaj çështjeje ne i vumë rëndësi të madhe, pa zgjidhjen e së cilës gruaja do të bëhej pengesë për luftën, pse ajo mjaft t'i thoshte burrit ose djalit: «Ku po shkon», «Ku po më lë», «Do të na vrasin», «Mos shko në luftë», «Të shikojmë punën tonë», «Përse na duhet neve lufta» etj., që ata të ngurronin të hidheshin në luftë.

Partia punoi aq thellë saqë gratë arritën të bëhen në familjet e tyre propagandiste të flakta të vijës së Partisë. «Merrni pushkën, — u thanë ato burrave e djemve, — dhe hidhuni përpara në luftë për çlirimin e atdheut!». Kuptohet, shokë, ç'kurajë i jepte një qëndrim i tillë nga ana e gruas djalit ose burrit të vet, të cilët rrëmbenin pushkën dhe bëheshin partizanë.

Kur shkonim në shtëpitë e popullit, në qytet apo në fshat, gratë na jepnin çdo ndihmë të mundshme, ato u lidhën ngushtë me luftën, me vijën e Partisë. Shumë prej tyre burrat apo djemtë i kishin në mal dhe, kur shkonim ne për t'u strehuar e për t'u ushqyer në shtëpitë e tyre, na trajtonin si djemtë e tyre, si njerëzit e tyre të afërt. Sa rëndësi kishte, pra, gruaja me punën e saj! Në këto kushte u krijua dhe u organizua në vendin tonë organizata e gruas. Natyrisht ky proces do të vërtetohet edhe te ju. Në fillim ne kemi pasur shumë vështirësi, çdo gjë nuk u bë menjëherë siç e shikoni sot. Ne e dimë ç'vështirësi ka në vendet kapitaliste, po të gjitha ato kapërcehen kur partia është e vendosur dhe vija e saj është e drejtë.

Ju, të dashur shokë, na ndihmuat shumë edhe në një drejtim tjetër: në forcimin akoma më tepër të besimit në luftën dhe në fitoret e ardhshme të përbashkëta. Ne ju sigurojmë se do t'i kryejmë me nder detyrat tona si ushtarë të revolucionit, si ushtarë besnikë të marksizëm-leninizmit. Ne dëshirojmë, të dashur shokë të Partisë Komuniste (m-l) të Ekuadorit, që Partinë tonë ta konsideroni si partinë tuaj për çdo gjë. Ne jemi gati t'ju japim çfarëdo ndihme që do ta konsideroni të dobishme pse si internacionalistë ne e kemi për detyrë ta bëjmë këtë. Po nuk e bëjmë ne këtë, nuk mund të quhemi internacionalistë, nuk mund të jemi marksistë. Ne nuk jemi kursyer dhe nuk do të kursehemi për t'ju dhënë çdo ndihmë që do të mundemi për shokët dhe vëllezërit tanë, siç jeni ju, pse edhe ndihma juaj internacionaliste në drejtimin tonë është e madhe.

Edhe ju na ndihmoni me eksperiencën tuaj dhe, në qoftë se do të konstatooni se mund të gabojmë në ndonjë drejtim, ju lutemi na kritikoni, na shkundni me kritikë të hapët dhe të jeni të sigurt se kritikata e shokëve ne i konsiderojmë dhe i trajtojmë si gjënë më të shenjtë. Populli ynë thotë kush të do, të kritikon, kush nuk të do, të fërkon kokën, që të vazhdosh në rrugën e keqe.

Dialektika jonë marksiste-leniniste na mëson se të gjitha punët nuk shkojnë drejt, kokat e të gjithë njerëzve nuk janë të prera me një gërshërë, energjitë e gjithsecilit nuk janë të njëllajta, disa ecin drejt, disa jo. Në këto kushte, zbatimi i normave të partisë, i kritikës dhe i autokritikës bolshevike, i ndreq njerëzit, partinë e ruan të pastër dhe revolucionin e çon përpara.

Të tilla marrëdhënie duam ne, të tillë dashuri të singertë dhe proletare duam të kemi ne me njëri-tjetrin dhe sa më shumë të kemi bërë për njëri-tjetrin, për revolucionin, aq më tepër modestë duhet të jemi. Prandaj thjeshtësia e komunistëve duhet të jetë shembullore si ajo e proletarëve, përpjekjet dhe mendimet e komunistëve duhet të jenë si ato të proletarëve, ndjenjat e shpirtit e të zemrës së tyre duhet të jenë si ato të proletarëve. Vetëm kështu revolucioni ynë do të ecë përpara.

Na vjen keq, të dashur shokë, që do të shkoni, por dijeni se zemrat tona janë të bashkuara me tuajat.

Ne e dimë se ju keni shumë punë. Detyra akoma më të mëdha e të vështira ju presin në të ardhmen, megjithatë ne do të ishim tepër të gëzuar sikur ju të na vinit më shpesh dhe të qëndronit më gjatë në vendin tonë, pavarësisht se kjo s'mund të realizohet në çdo rast sipas dëshirës që kemi ne.

Urojmë të realizohet dëshira juaj e madhe që të arrijë ajo kohë që edhe ne të vijmë te ju!

Botuar për herë të parë me ndonjë shkurtim në librin: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 233

Botohet sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

PËR NJË METODE DHE STIL PUNE REVOLUCIONAR

*Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë
të Partisë ku bën pjesë*

21 tetor 1968

Problemet që diskutohen në organizatën tonë janë të drejta. Rëndësi paraqit veçanërisht çështja e përgjithësimeve, si dhe ajo që ju e quani emancipimi i vetvetes. Në pamjen e parë këto duken si probleme të veçuara, por ato janë pjesë përbërëse të stilit dhe të metodës së punës, janë probleme të tilla, nga zgjidhja e drejtë e të cilave varet shumë edhe perfeksionimi i mëtejshëm i vetë stilit dhe i metodës së punës.

Nga sa rezulton, në metodën e punës në udhëheqje, si në Sekretariat, në Byronë Politike, ashtu edhe në Qeveri janë bërë përmirësime. Është e drejtë ajo që u ngrit këtu, se nga pranimi i të rinjve në radhët e Partisë duhen nxjerrë më mirë detyrat e aparatit dhe duhet parë çfarë përmirësimesh kemi në jetën e Partisë. Megjithatë mendimi ynë është se ndihma që i vjen tani udhëheqjes nga aparati është më e kualifikuar dhe më e thellë. Puna e mirë e aparatit i jep mun-

dësi udhëheqjes ta përmirësojë gjithnjë e më mirë metodën dhe stilin e punës, na jep mundësinë të bëjmë diçka më shumë se gjer tani, të bëjmë përgjithësi e të nxjerrim konkluzione, të bëjmë diskutime e të shkëmbejmë mendime me shokët, të kemi kohë të reflektojmë e të përfitojmë edhe vetë nga këto. Këto avantazhe që na krijoni ju, bashkëpunëtorët tanë të afërt dhe të gjitha organet e tjera të Partisë, janë, natyrisht, një punë e mirë që bëhet, nga e cila përfiton Partia. Këto mundësi nuk i kanë të gjithë njëjloj, por është e favorshme dhe e nevojshme që në këtë diapazon t'i krijoni edhe ju këto mundësi, të luftoni për të ngritur në një nivel më të lartë metodën dhe stilin e punës suaj.

Natyrisht, kushtet e punës nuk janë njëjloj të barabarta për të gjithë shokët. Prandaj është e nevojshme të krijojmë për çdo kuadër kushte për një punë akoma më të kualifikuar e më frytdhënëse. Këto duhet t'i krijoni edhe ju, që jeni, gjithashtu, kuadro me përgjegjësi dhe me përvojë të gjatë në punën e Partisë. Ne duhet të ndërtojmë një stil e metodë të tillë pune që secili, me aq sa ka mundësi, të krijojë kushtet për të pasur kohë që të studiojë, të mendojë, të reflektojë, pse vetëm kështu do të ketë mundësi t'i japë më shumë Partisë.

Më parë edhe unë kam kaluar në këto situata, sepse shokët ishin më pak të përgatitur, kishin, pra, nevojë për t'u këshilluar edhe për gjëra të vogla. Por tani kuadrot tanë u rritën, Partia ka krijuar e ka kalitur në çdo sektor kuadro të aftë. Edhe vetë baza, si në industri, ashtu dhe në kooperativat bujqësore nuk

është më ajo e 20 vjetëve të shkuar, bile mund të themi as e 5 ose e 2 vjetëve më parë. Prandaj, duke pasur të tillë kuadro me përvojë, udhëheqja duhet të dijë jo vetëm t'u hapë horizonte, por edhe t'u ngarkojë përgjegjësi të plotë për drejtimin e problemeve. Të kemi besim, shokë, se ata do të jenë në gjendje t'i kryejnë me sukses detyrat. Kështu edhe ne do të shkarkohemi nga punët e shumta, nga rutina e vogëlsirave, e informacioneve të tepruara që na pengojnë për të shikuar, për të studiuar e për të zgjidhur ato më kryesoret.

Ju, veç detyrave, presioneve dhe punëve që keni në aparat me njëri-tjetrin, shkoni edhe në bazë, ku rrihni mendimet me shokët e bazës se si të bëhet më mirë kjo ose ajo punë, kurse unë në krahasim me ju shkoj në bazë më pak. Megjithatë më duhet medoemos të jem i lidhur me gjithë jetën e Partisë, me problemet ideologjike e politike, me ato të zhvillimit ekonomik të vendit, të politikës së jashtme etj., etj., në mënyrë që të jap edhe unë kontributin tim në detyrën që më ka ngarkuar Partia. Në qoftë se do të krijoja një metodë pune si ajo që mund të jetë e përshtatshme për një shok tjetër, atëherë nuk do t'ia dilja dot punës që kam. Unë kam metodën time të punës dhe çdo komunist duhet të krijojë e të ketë metodën e tij të punës sa më frytdhënëse që të jetë e mundur. Një orë e gjysmë çdo ditë lexoj shtypin, duke u ndalur në problemet që i interesojnë më shumë Partisë. Natyrisht, shokët mund të përqendrohen në probleme të tjera që i kanë në qendrën e tyre të punës, ose në organizatën-bazë të tyre, sepse gazetat janë për masat e popullit.

Kështu, pra, në çështjet që më ngjallin interes, ndalem mirë, i studioj me vëmendje, shikoj si trajtohen e ç'probleme dalin dhe këto i fiksoj në kujtesë. Njihem, gjithashtu, edhe me lajmet e jashtme, duke përqendruar vëmendjen sidomos në ato çështje që kanë lidhje me politikën e Partisë, me luftën kundër imperializmit e revizionizmit etj.

Pastaj njihem me raporte të komiteteve të Partisë të rretheve, me materiale të tjera të Partisë e të Qeverisë, si dhe me raporte tuajat. Sa më të përmbledhura, të thjeshta e të mbushura me ide të jenë raportet, aq më shumë i shërbejnë punës së Partisë. Prandaj, ne theksojmë vazhdimisht që raportet të shkruhen kurdoherë shkurt, të mos kenë ujë, por çështje thelbësore, pasi jo vetëm që nuk jemi të painformuar për problemet, por, kur na duhen hollësi për ndonjë çështje të caktuar, ju drejtohem i juve dhe shokëve që e dinë. Gjithashtu bisedojmë me shokët edhe për problemet e shumta që ka Qeveria.

Duke i njohur çështjet dhe situatën në vend të krijohen mundësi të ngresh e të përpunosh probleme. Të marrim, për shembull, si lindi problemi i kontrollit punëtor. Ai lindi nga çështjet që ngrenë gazetatat, nga raportet tuaja etj., në të cilat është thënë se në mjaft raste ka veprime e qëndrime të padrejta, se ka aty-këtu vjedhje, se diku bëhen hatëre, se në këtë ose në atë sektor ka të meta etj. Atëherë, duke menduar se ç'duhet bërë, se ç'rrugë duhet ndjekur për zgjidhjen e tyre, të udhëhequr edhe nga teoria e pavdekshme marksiste-leniniste, gjenden rrugë e mënyra të reja revolucionare për t'i dhënë zgjidhje të drejtë problemit.

Unë, për shembull, kur arrij në konkluzionin se duhet t'i them Partisë diçka për klasën punëtore, mbasi e kam bluar mirë në kokë këtë problem dhe para se ta hedh në letër, lexoj edhe pjesë nga veprat e Leninit ose të Stalinit apo ndonjë material tjetër teorik për këtë çështje. Këtë e bëj si për të mësuar prej tyre, ashtu edhe për të verifikuar mendimet e mia për problemin që po përpunoj. Duke vepruar kështu, problemi bëhet për mua i qartë dhe i thjeshtë. Atëherë i shkruaj këto mendime. Njëkohësisht mbaj kontakt me shokun Hysni, me shokun Ramiz e me shokë të tjerë, të cilët ngrenë edhe ata probleme dhe japin mendime për rrugët e mundësitë e zgjidhjes së tyre. Kanë rëndësi të madhe konsultimet që bëjmë me njëri-tjetrin.

Puna e ditës nuk mbaron me kaq. Në mbrëmje, edhe gjatë shëtitjes, sipas rastit, bisedojmë me shokët, rrahim mendime për probleme të brendshme e të gjendjes ndërkombëtare që dalin gjatë ditës, veçse tani në ajër të pastër, siç është e këshillueshme për të gjithë. Pastaj, pasi ndjekim lajmet me televizor, ndiejmë nevojën të rrimë, të hamë e të bisedojmë edhe me fëmijët, edhe për t'u çlodhur, por edhe për t'i mbajtur afër, për të ndihmuar në edukimin e tyre. Shpesh edhe pasdarke na duhet të punojmë, por ajo është koha më e përshtatshme për të lexuar libra të ndryshëm.

Pra, një metodë pune të tillë na e kërkojnë rrethanat, sepse jemi të detyruar ta përdorim kohën në mënyrë sa më racionale, si dhe të punojmë në mënyrë kaq të lidhur e kolegjiale.

Prandaj, çdo komunist të krijojë mundësi të praktikojë një metodë pune sa më të frytshme, duke lënë

mënjatë gjërat e vogla. Ju jeni shokë udhëheqës në rang sekretarësh të parë ose sekretarësh të tjerë komitetesh partie rrethesh, prandaj konkluzionet që detyra e ngarkuar ju kërkon të nxirrni, nuk mund të formohen pa rezervuar një kohë të përshtatshme për të studiuar, për të menduar e për të reflektuar në qetësi. Ndryshe, duke i bërë punët shpejt e shpejt e si në ethe, do të nxirrni konkluzione të zbehta e të pathe-lluara. Ne mund të punojmë edhe me tension kur është nevoja, se nervat i kemi të fortë, por rregullisht për një problem duhet krijuar mundësi për të menduar, qoftë edhe për një kohë të shkurtër. Ju e keni këtë mundësi dhe jam i bindur se jo vetëm e keni, por edhe mund ta praktikoni dhe këtë jeni në gjendje ta bëni.

Shpesh konstatoj që shumë probleme i përsëritni si me njëri-tjetrin, ashtu edhe me shokët në bazë dhe për këtë duhet t'ju kritikojmë. Shumë nga këto probleme, që janë shtruar dhe që ju e shokë të tjerë në bazë i përsëritni, pikërisht, pse nuk janë të reja, por sepse akoma nuk janë zbatuar, i keni ditur që kur keni qenë anëtarë partie me disa vjet stazh. Atëherë përse t'i përsëritni të njëjtat gjëra edhe tani pas 20-25 vjetësh stazh partie? Ne duhet të insistojmë në zbatimin e atyre që janë thënë. Shokët të vihen për këtë para përgjegjësisë dhe të japin llogari përse nuk i kanë zbatuar akoma ato që duheshin zbatuar me kohë. Duke i zgjidhur problemet në kohë, krijojmë mundësinë për të menduar e për të prodhuar diçka të re. Prandaj të përpiqemi që shokëve në bazë t'ua sqarojmë çështjet mirë që në fillim që ato t'i bëjnë mish e gjak

të trupit të tyre e të luftojnë për t'i zbatuar, t'ua rrënjosim atyre më thellë edukatën komuniste, revolucionare.

Partia na mëson se duhet të interesohemi edhe për gjërat e vogla, në asnjë mënyrë të mos i nënvleftësojmë ato. Kjo nuk do të thotë që një ose disa shokë në udhëheqje t'i dinë të gjitha, kurse Partia, në tërësi, në gamën e saj të madhe, duhet të dijë çdo gjë. T'i mësojmë tërë komunistët që ta jetojnë si duhet vijën politike e ideologjike të Partisë, që të mos u shpëtojnë gjërat nga vështrimi i tyre i gjerë e i thellë. Vetëm kështu mund të themi se kemi ndërtuar një metodë e stil pune revolucionar.

Natyrisht, në gjithë veprimtarinë e madhe të Partisë mund të gjesh edhe të meta, por të gjithë ne këtu jemi shokë të vjetër dhe, kur shohim ku kemi qenë e ku jemi sot, rezulton se Partia ka përpunuar një stil pune të mirë, të cilin vazhdimisht e ka përmirësuar në të gjitha drejtimet. Pra, del se ne kemi qenë dhe jemi në rrugë të drejtë, se Partia ka qenë dhe është në rrugë të drejtë. Por për të shkuar më përpara duhet të hiqen format që vjetrohen, që nuk vlejné më, që nuk u përshtaten kohës e problemeve. Ato duhet të zëvendësohen me forma e metoda të reja pune, më frytdhënëse.

Si përfundim dëshiroj të them se këto që preka, janë probleme që preokupojnë gjithë shokët, prandaj ju do të bëni dhe vazhdoni të bëni diskutime rreth tyre, përpiquini të dilni me konkluzione; shokëve shkallë-shkallë t'u jepet përgjegjësi, t'u jepet besim e mundësi të mendojnë dhe t'i zgjidhin vetë problemet, sepse tani kudo, në çdo sektor kemi kuadro shumë të mirë dhe

kurdoherë të gatshëm për çdo punë. Kur një shok vjen të të pyesë për diçka që ti je i bindur se ai e di ose që mund ta gjejë vetë, këshilloje që të mendohet, ta vrasë pak mendjen dhe ta gjejë vetë rrugën e zgjidhjes dhe vetëm në qoftë se nuk mundet, të vijë ta ndihmojë. Këtë duhet ta bëjmë për të mirën e Partisë, sepse shumë nga shokët këtu, sipas përgjegjësisë, do të kenë më tepër mundësi t'i japin Partisë më shumë dhe t'i çojnë bazës diçka të re, të një shkalle më të lartë dhe jo përsëritje të gjërave të zakonshme; do t'ia japin asaj qartë dhe shkurtimisht. Të gjithë të përpiqemi t'i formulojmë mendimet tona sa më shkurt dhe gjithmonë qartë e kuptueshëm, sepse shkrimet tuaja i nevojiten Partisë; ato janë përvoja e saj. Ne jemi dakord me atë që të gjithë kemi të meta, prandaj, në këtë drejtim, duke filluar që nga unë e deri te komunisti më i thjeshtë, duhet të bëjmë përpjekje që t'i zhdukim.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të nxjerra nga pro-
tokolli i mbledhjes së orga-
nizatës-bazë të Partisë
që gjendet në AQP*

AKT QË LEGALIZON KTHIMIN E ÇEKOSLLOVAKISË NË NJË KOLONI TË REVIZIONISTËVE SOVJETIKË

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

23 tetor 1968

Këto ditë, siç është njoftuar, hyri në fuqi i ashtuquajturit traktat sovjeto-çekoslovak, i cili legalizon robërimin e Çekoslovakisë nga trupat e huaja të pushtimit dhe kolonizimin e plotë të saj nga revizionistët sovjetikë. Për të maskuar qëllimet e tyre prej pushuesish dhe neokolonialistësh, revizionistët e Moskës dhe kasnecët e tyre bëjnë bujë të madhe e reklamojnë «traktatin» sovjeto-çekoslovak si një «shprehje të vullnetit të lirë të palëve të barabarta», si një «mjet për të mbrojtur socializmin nga revanshizmi gjermanoperëndimor» etj., etj. Por të gjitha këto janë dokrra. Ky «traktat» demaskoi edhe më tepër, zhveshi lakuriq autorët e tij, u tregoi popujve liridashës të botës natyrën e tyre të vërtetë si agresorë imperialistë dhe renegatë kundërrevolucionarë.

Ky «traktat» është shembull skandaloz i cinizmit dhe i poshtërsisë së revizionistëve sovjetikë, një dëshmi

tjetër e politikës së tyre agresive dhe imperialiste. Qysh në fillim, qysh në nenin 1 të këtij dokumenti, zbulohet thelbi i «diplomacisë së tankeve», pasi flitet për «marrëveshje» midis agresorit dhe viktimës së tij, «marrëveshje» e cila është përfunduar pas faktit të kryer, pas pushtimit të plotë ushtarak, nën grykën e topave dhe nën zinxhirët e tankeve. Trupat sovjetike të pushtimit mbeten në Çekoslovakia dhe mbeten përgjithmonë. Ky fakt pranohet që në nenin 1, ku theksohet se «numri dhe vendi i qëndrimit të trupave sovjetike» do të caktohen më vonë dhe se këto trupa «do t'i nënshtrohen komandës ushtarake sovjetike». Kjo do të thotë legalizim i regjimit të pushtimit në Çekoslovakia dhe varësi e saj e plotë nga komanda ushtarake sovjetike e pushtimit.

Një provë tjetër e cinizmit të pushtuesve revizionistë sovjetikë e gjejmë edhe në nenin 2 të këtij «traktati» famëkeq, ku pretendohet se «qëndrimi i trupave sovjetike në Çekoslovakia nuk e shkel sovranitetin e saj», se «trupat sovjetike nuk ndërhyjnë në punët e brendshme të RS të Çekoslovakisë» dhe se ato «do të respektojnë ligjet çekoslllovakë». Edhe demagogjia e cinizmi duhet të kenë një kufi, por për revizionistët sovjetikë nuk kanë. E gjithë bota e pa se pas 21 gushtit sovraniteti i Çekoslovakisë u shtyp nën tanket sovjetike, se mareshalët sovjetikë Jakubovski e Pavllovski, bashkë me gaulajterin Kuznecov, u bënë zotër në shtëpinë e huaj, se dhuna e pushtuesve zëvendësoi ligjin çekoslllovak.

«Traktati» sanksionon privilegjet e tipit kolonial të pushtuesve revizionistë sovjetikë. Qeveria kukull e

Pragës, sipas nenit 3 të «traktatit», detyrohet t'u vërë në dispozicion trupave sovjetike të pushtimit «kazerma dhe ndërtesa banimi në qytetet ushtarake, ndërtesa shërbimi, depo e të tjera, aerodrome dhe instalime stacionare dhe pajisje, mjete të rrjetit shtetëror të ndërlydhjes dhe të transportit, energji elektrike dhe shërbime të tjera». Gjithashtu, poligonet, vendet e qitjes dhe fushat e stërvitjes së ushtrisë çekoslllovake do të shfrytëzohen nga trupat sovjetike të pushtimit. Me këto dispozita ushtria çekoslllovake, e cila është katandisur nga trojka kolaboracioniste e Dubçek-Çernik-Svobodës në rolin e majerë të një figuranti, tani do ta quajë veten të huaj në shtëpinë e saj.

«Traktati» famëkeq në fakt nuk njeh aspak ekzistencën e Çekoslllovakisë si një shtet sovran, me një rend të vet të pavarur shoqëroro-ekonomik dhe juridik. Imperialistët revizionistë sovjetikë, pasi u përpoqën ta zgjidhnin problemin çekoslllovak *manu militari*, me anën e dhunës ushtarake, e vunë veten në pozitë të zotit të shtëpisë, u shtruan këmbëkryq në sofrën çekoslllovake. Ata i krijuan vetes privilegje dhe mundësi të tilla që të diktojnë vullnetin e tyre prej neokolonialishtësh në të gjithë jetën e vendit — në politikë, në ekonomi, në fushën shoqërore-kulturore. Trupat pushtuese sovjetike, familjet e tyre, mund të hyjnë e të dalin në Çekosllvaki sa herë të duan, pa viza e pa kontroll doganor. Neni 4 thotë shprehimisht: «Njësitë ushtarake sovjetike, personat që bëjnë pjesë në efektivin e trupave sovjetike dhe anëtarët e familjeve të këtyre personave mund të shkojnë në RS të Çekoslllovakisë, në vendin e përqendrimit të trupave sovjetike dhe të kthehen nga

RS e Çekosllovakisë si me trenat dhe vagonët direktë që i përkasin Bashkimit Sovjetik, ashtu edhe duke zbritur nga vagonët e njërit vend dhe pastaj duke hipur në vagonët e vendit tjetër, si dhe me anën e transportit ajror e automobilistik. Personat që bëjnë pjesë në efektivin e trupave sovjetike dhe anëtarët e familjeve të këtyre personave nuk do t'i nënshtrohen kontrollit të pasaportave ose të vizave gjatë hyrjes, qëndrimit dhe largimit nga RS e Çekosllovakisë». Me këtë dispozitë, kufiri shtetëror çekoslovak, që simbolizon sovranitetin dhe paprekshmërinë e atij vendi, shndërrohet në një paçavure, në një gardh të shthurur dhe të pavlerë.

Regjimi i pushtimit dhe kapitullimi e nënshtimi i plotë i klikës revizioniste të Dubçekut e të Svobodës sanksionohen edhe nga neni 5. Sipas këtij neni «pala çekoslovakike është dakord për të lejuar nëpërmjet kufirit shtetëror të RS të Çekosllovakisë, pa marrjen e taksave dhe pa kontroll doganor dhe kufitar:

— Trupat sovjetike dhe personat, që bëjnë pjesë në efektivin e tyre, që kalojnë në përbërjen e njërive, të nënreparteve dhe të komandave ushtarake;

— të gjitha ngarkesat ushtarake, duke përfshirë edhe ngarkesat e destinuara për shërbimin tregtar dhe komunal të trupave sovjetike;

— personat që bëjnë pjesë në efektivin e trupave sovjetike, që hyjnë në RS të Çekosllovakisë dhe që largohen nga RS e Çekosllovakisë, vetëm ose të shoqëruar me anëtarët e familjeve të tyre, me sendet e tyre personale, me paraqitjen organeve doganore të dokumenteve mbi të drejtën për të kaluar kufirin shtetëror

të RS të Çekosllovakisë». Varësia e plotë ndaj vullnetit të pushtuesit provohet edhe nga fakti se i tërë shërbi-mi tregtar e komunal për efektivin e trupave sovjetike në tokën çekosllovake «do të bëhet nëpërmjet ndër-marrjeve tregtare e komunale sovjetike»!

Zbatimi i këtij «traktati» do të sjellë në mënyrë të pashmangshme një pështjellim të madh në tërë jetën ekonomike, tregtare e financiare të vendit, do ta vësh-tirësojë më tej jetesën e punonjësve çekosllovakë. Pri- vilegjet që u njihen pushtuesve për të bërë tregti me monedhën vendëse, domethënë për të hedhur në qar- kullim në mënyrë të pakontrolluar kartmonedhën çe- kosllovake, do të çojnë domosdo në çrregullimin e tërë sistemit valutor vendës, në inflacion dhe në lulëzimin e mëtejshëm të tregut të zi e të spekulimit ekonomik. Mbi të gjitha, qeveria kukull çekosllovake detyrohet të furnizojë me ushqime dhe me prodhime industriale trupat e pushtimit, duke u shtrënguar rripin popullit, masave punonjëse. Kjo është një mbingarkesë e pa- parashikuar, një haraç i rëndë që do ta tronditë më keq ekonominë çekosllovake, të tronditur prej kohësh nga «reformat» revizioniste.

Fytyra prej agresorësh e pushtuesish imperialistë e revizionistëve sovjetikë duket qartë edhe në ato dis- pozita të këtij «traktati» famëkeq që bëjnë fjalë për zbatimin e ligjit vendës lidhur me trupat e pushtimit, me përgjegjësinë e tyre për fajet penale dhe kundër- vajtjet që do të kryhen nga këto trupa në tokën çeko- sllovake. Në fakt, pika B e nenit 9 të «traktatit» sank- sionon hapur dhe pa pikën e turpit papërgjegjësinë e plotë të efektivit të trupave sovjetike «që kryejnë kri-

me ose veprime gjatë kryerjes së detyrave në rajonin e përqendrimit të njësive ushtarake». Në të vërtetë, kjo do të thotë se ligji çekoslovak nuk do të zbatohet kurrë për trupat sovjetike, pasi ato, për çdo krim ose veprim arbitrar që kryejnë, mund të lajnë duart, sepse janë gjoja duke kryer detyrat dhe e tërë Çekoslovakia mund të konsiderohet «rajon i përqendrimit të trupave ushtarake sovjetike». Më në fund, po në këtë nen «traktati» njihet juridiksionin e gjykatave sovjetike në tokën çekosllavake, kompetencat e prokurorisë dhe të organeve të tjera sovjetike në tokën çekosllavake, të cilat do të veprojnë në bazë të ligjeve sovjetike. Kjo është një ringjallje e ligjit të egër kolonialist të kapitulacioneve, që akoma ka mbetur në fuqi në disa koloni të humbura të Anglisë dhe të Portugalisë! Kjo është e barabartë me njohjen e së drejtës së eksteritorialitetit, të lirisë së pakufizuar për pushtuesit që të veprojnë si të duan dhe kur të duan, në kundërshtim me ligjet e vendit, në emër të ligjit të pushtimit, duke u tallur kështu me përbuzje me dinjitetin kombëtar të popullit çekoslovak.

Prania efektive dhe e përhershme e trupave sovjetike të pushtimit në Çekoslovakia, që tani legalizon «traktati», do të ushtrojë ndikimin e vet, siç është e kuptueshme, në të gjitha orientimet e politikës së jashtme të vendit. Krerët kolaboracionistë çekoslovakë qysh tani kanë filluar të rrinë sus në këmbë para pushtuesve sovjetikë, të binden përunjësisht dhe të bëjnë atë që u diktojnë ata. Politika e jashtme e qeverisë kukull të Pragës është vënë tanimë zyrtarisht në binarët e interesave hegjemonistë të pushtuesve revizionistë

sovjetikë dhe, pra, në këto kushte ajo nuk mund të jetë aspak në gjendje të shprehë aspiratat dhe interesat sovranë të popullit çekoslovak, të mbrojtë të drejtat e tij jetike. Vetë fryma dhe dispozitat e këtij «traktati» kolonialist që i është imponuar Çekosllovakisë, nuk janë aspak «lehtësim i pushtimit», siç thotë Çerniku, por në fakt e rëndojnë dhe e legalizojnë këtë pushtim. Ky është traktat-diktat dhe nuk bazohet aspak në «mirëbesimin reciprok», siç gënjen paturpësisht revizionisti Kosigin. Ky «traktat» bazohet në bajonetat dhe në tanket e pushtuesve revizionistë sovjetikë. Lëverja e Brezhnjevrit «Pravda» flet për «unitet» dhe «barazi». Po çfarë uniteti mund të ketë midis pushtuesit dhe të pushtuarit dhe çfarë barazie mund të ketë midis kalorësit e kalit?

Pesëmbëdhjetë nenet e këtij «traktati» skllavërues neokolonialist janë pesëmbëdhjetë nyje të reja të forta të litarit që i është vënë në fyt popullit çekoslovak. Ky është pjellë e agresionit të tipit fashist kundër Çekosllovakisë. Me këtë «traktat» u varrosën në mënyrë legale dhe përfundimisht liria, sovraniteti dhe dinjteti kombëtar i popullit çekoslovak. Tërë fryma e «traktatit», qëllimet dhe mënyra e zbatimit të tij u ngjasin atyre lloj traktateve me të cilat Hitleri u impononte kuislingëve evropianë «rendin e ri» të tij, apo marrëveshjeve të hitlerianëve të sotëm, imperialistëve amerikanë, me partnerët e tyre më të vegjël. Në këtë dokument të turpshëm as që bëhet fjalë më për «normalizimin» e gjendjes në Çekosllovakë dhe për tërheqjen përfundimtare të trupave të pushtimit.

Diktati, i gatuar në Moskë dhe i nënshkruar në

Pragë, nuk e zgjidh, por e thellon më tej krizën e klikës revizioniste sovjetike dhe të frontit revizionist në tërësi në Çekoslllovakia e kudo, ai acaron më tej gjendjen e vështirë politike, ekonomike e shoqërore në vetë Bashkimin Sovjetik dhe marrëdhëniet midis vendeve e klikave të ndryshme revizioniste; ai thellon dhe ashpërsion më tej në mënyrë të pashmangshme, sidomos, kontradiktat e papajtueshme midis pushtuesve revizionistë sovjetikë dhe popullit liridashës çekoslllovak. Me këtë «traktat» udhëheqja revizioniste e Moskës u mundua më kot të mashtrojë opinionin publik botëror, duke dashur të legalizojë veprimet e saj kriminale prej imperialisti e kolonialisti me anë të një marrëveshjeje gjojë dypalëshe. Por me këtë akt të ri revizionistët sovjetikë demaskuan edhe një herë veten si agresorë, si pushtues, si shfrytëzues dhe si imperialistë. Ndërsa klika Dubček-Çernik, duke vënë firmën e saj në këtë «tapi të pushtimit», e damkosi edhe një herë veten si një grup renegatësh, kolaboracionistësh dhe kuislingësh.

Por populli çekoslllovak do ta hedhë poshtë me përbuzje këtë akt që legalizon pushtimin kolonialist të atdheut të vet. Ai nuk ka pranuar as agresionin, as pushtimin dhe as «traktatin» e agresorëve revizionistë sovjetikë, as tradhtinë dhe kapitullimin e trojkës Dubček-Çernik-Svoboda, por i ka denoncuar dhe i kundërshton. Populli vëlla çekoslllovak, i cili ka tradita të mëdha revolucionare, i udhëhequr nga klasa e tij punëtoare dhe nga marksistë-leninistët revolucionarë, me siguri do ta zgjerojë rezistencën e tij e do të luftojë me vendosmëri e me çdo mjet, edhe me armë në dorë, kundër pushtuesve të huaj dhe tradhtarëve vendës, për

çështjen e shenjtë të çlirimit kombëtar e të rivendosjes së diktaturës së proletariatit.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 254 (6293), 23 tetor 1968

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revisionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 250

TA MBAJMË VAZHDIMISHT TË GJALLË FRYMËN REVOLUCIONARE TË AKSIONEVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

25 tetor 1968

Dëshiroj të vë në dukje disa çështje.

Të metat që vihen re gjatë punës dhe veprimtarisë së organizatës së rinisë janë pa dyshim refleksi i punës së pamjaftueshme dhe i të metave të organizatave të Partisë me rininë. Megjithatë mendoj të mos arrijmë në konkluzionin se duhen shikuar format organizative të organizatës së rinisë duke ua përshtatur ato formave të organizimit të Partisë. Këtë çështje ne e kemi pasur kurdoherë parasysht prandaj të bëjmë vazhdimisht kujdes edhe në të ardhmen.

Gjithashtu, nuk është mirë të na thuhet, siç u shpreh këtu Agim Mero, se, me nxitjen që u bëhet të rinjve që të hyjnë në radhët e BRPSH janë duke u shkelur normat e parimeve organizative të kësaj orga-

¹ Në këtë mbledhje, në të cilën ishin thirrur në raport komitetet e Partisë të rretheve Dibër, Berat, Gjirokastër dhe Vlorë, u diskutua për edukimin e rinisë nëpërmjet aksioneve.

nizate. Kërkesa për të hyrë në organizatën e rinisë ka të bëjë me bindjen e të riut ose të resë nëse ata kanë arritur të kuptojnë apo jo nevojën për t'u organizuar, prandaj, me sugjerimin që u bëhet për t'u futur në organizatë, më duket se nuk shkelet aspak ndonjë normë.

Nxitja e një të riu për të bërë kërkesë për t'u pranuar anëtar i BRPSH nuk e dobëson këtë organizatë, përkundrazi e forcon atë, sepse duke e pranuar në BRPSH këtë element të ri e të pastër ne e inkuadrojmë atë në një organizatë politike masash, i ngjallim atij, në mos menjëherë, gradualisht, ndjenjën e një pune dhe lufte të organizuar në kolektiv, ndjenjën e përgjegjësisë kolektive, e bëjmë të ndiejë se po merr pjesë edhe ai në jetën politike të vendit. Mbase i riu nuk e koncepton menjëherë plotësisht këtë çështje, siç e konceptojmë ne, por, nga çdo pikëpamje që ta marrësh, futja e tij në organizatën e rinisë për ne është më mirë sesa ta lësh jashtë saj.

Po të vihet çështja: «Është më mirë të kemi më shumë të reja e të rinj jashtë apo brenda radhëve të organizatës?», unë mendoj që sa më shumë t'i kemi të organizuar, sepse një gjë e tillë na lehtëson detyrën për edukimin e tyre politik e ideologjik. Prandaj nuk duhet ta ngushtojmë organizatën e BRPSH, përkundrazi, të punojmë që ta gjallërojmë më tepër. Kjo kërkon që edukimin e udhëheqjes së organizatës së rinisë dhe të aktivistëve të saj të mos ia lëmë spontaneitetit. Partia, që udhëheq organizatën e rinisë në të gjitha instancat, duhet të interesohet vazhdimisht dhe sistematikisht për edukimin e kuadrove e të aktivistëve të kësaj organizate. Ne duhet ta shohim me kujdes këtë çështje, kurse

ju, shokët përgjegjës kryesorë të Komitetit Qendror të Rinisë, duhet të na thoni, sa dhe si ju ndihmon Partia për këtë problem.

Ajo që u tha këtu, sidomos për Komitetin e Partisë të Rrethit të Tiranës, që insiston të zgjidhen sekretarë të organizatave të rinisë anëtarë partie, sipas mendimit tim, nuk është e rekomandueshme. Këtë praktikë ne e kemi kritikuar edhe më parë, jo se duke vepruar kështu do të na zgjidhen njerëz të këqij në krye të organizatës së rinisë, përkundrazi, në këtë mënyrë do të na vinin në udhëheqje njerëzit më të mirë, komunistët, që relativisht janë elementë më të pjekur, por çështja është se me këtë mënyrë ka rrezik që Partia të lidhë duart, të mos kujdeset sa duhet për problemet e rinisë, të mjaftohet vetëm me caktimin e një anëtari të saj në krye të organizatës së rinisë. Duke vepruar kështu, organizata-bazë e Partisë do ta varë fatin e ndihmës së saj, që duhet të jetë e vazhdueshme dhe që është shpëtimtare për organizatën e rinisë, vetëm te një komunist të cilin e cakton të punojë me rininë. Ky pra është një rrezik.

Rreziku tjetër qëndron në çështjen që anëtari i Partisë, duke u vënë në krye të organizatës së rinisë, do të futë aty format e punës së Partisë, të cilat nuk mund të jenë të përshtatshme për rininë. Rinisë s'kemi pse t'i kërkojmë të përballojë përnjëherësh tërë ato përgjegjësi të rënda që merr përsipër Partia, por ta kalitim gradualisht me tiparet e një organizate të edukuar nga Partia, nëpërmjet një veprimtarie sistematike edukative, politike dhe ideologjike në punë, në shkollë dhe jashtë saj.

Nuk duhet përjashtuar që ndonjë organizatë rinie të ketë për sekretar të saj një komunist, por kjo mendoj të ndodhë vetëm në raste të veçanta dhe për një kohë të caktuar. Për shembull, kur shohim se në një fabrikë, kooperativë bujqësore ose institucion ka një organizatë rinie, ku janë dukur shfaqje negative mjaft të theksuara e për zhdukjen e të cilave lypset një disiplinë dhe këmbëngulje më e fortë, atëherë, derisa ta përmirësojmë situatën, në këtë organizatë, pa i dhënë kësaj tiparet e organizatës së Partisë, mund të vihet në krye një komunist, që të punojë për të futur në të frymën e Partisë dhe, në të njëjtën kohë, të përgatitë për të ngritur në udhëheqje të kësaj organizate një kuadër të përshtatshëm nga vetë radhët e saj, i cili vërtet nuk do të jetë anëtar partie, po do të jetë në gjendje ta udhëheqë atë. Prandaj, me organizatat e masave, ashtu edhe me atë të rinisë, mendoj të mos jemi sektarë.

Edhe unë kam përshtypjen e shokëve që diskutuan se organizatat e Partisë në Gjirokastrë dhe në Berat i kanë parasysh dhe i zbatojnë më mirë direktivat e Partisë në drejtim të punës me rininë, veçanërisht në lidhje me edukimin e saj nëpërmjet aksioneve.

Mendimi im është se rinia jonë në përgjithësi qëndron shumë mirë politikisht dhe ideologjikisht, është e lidhur ngushtë me Partinë, me vijën e saj. Kjo duket edhe në pjesëmarrjen e saj të gjerë në aksionet e ndryshme që shërbejnë për ndërtimin socialist të atdheut, duket në punën e saj në fabrika e në kooperativa, në shkolla, në aktivitetet politike, ideologjike, kulturore, artistike etj., etj. Megjithatë nuk do të thotë

që edhe këtu s'kemi të meta. Të tilla ka dhe mendoj se ato u detyrohen në radhë të parë dobësive të punës së Partisë me rininë. Këto të meta ne i kritikojmë dhe duhet medoemos t'i kritikojmë, por të kemi parasysh edhe anën tjetër, të mos e nxijmë situatën, duke nxjerrë në pah vetëm dobësitë, por të shohim edhe anët pozitive të cilat janë të shumta, sepse është pikërisht puna e madhe e Partisë ajo që ka krijuar atë hov të madh revolucionar, që e bën rininë tonë të punojë pa u lodhur, në radhë të parë për ngritjen e saj politike dhe ideologjike dhe të thyejë shumë norma e koncepte të vjetra, të trashëguara nga e kaluara, që frenojnë ecjen tonë përpara. Të mos mendojmë se vetëm Partia e ndihmon rininë. Edhe vetë rinia e ka ndihmuar dhe e ndihmon shumë Partinë. Kështu, mendoj unë, duhet kuptuar kjo çështje.

Kur konstatojmë që në rini duken aty-këtu shfaqje jo të mira, si thyerje të disiplinës, të mos arrijmë në përgjithësime e konkluzione të gabuara, por të shohim me kujdes shkaqet e tyre, nëse bëhen me qëllim të keq ose jo. Në analizën e tyre ne duhet të mbajmë parasysh vetë moshën e rinisë, temperamentin e saj, ose faktin tjetër që edhe prindërit dhe gjithë shoqëria jonë kanë akoma të meta, mbeturina dhe shfaqje të tilla që e pengojnë rininë. Po ta shikojmë më drejt çështjen, do të konstatojmë se rinia jonë ecën kurdoherë në rrugën e Partisë, ajo është e pastër dhe në pararojë në luftën për thyerjen e normave të vjetra. Rinia jonë jo vetëm e do të renë, por lufton me guxim për atë, kurse të vjetrit janë më konservatorë. Këtë konservatorizëm i vjetri shumë herë e fsheh me kujdesin që gjoja du-

het të ketë për rritjen e fëmijës, por ky kujdes për të mos rënë i riu në këtë ose në atë gabim, në shumë raste përmban në fakt doza të mëdha konservatorizmi. Kjo nuk do të thotë që rinia të marrë frerët në dhembë. Çështja është që organizata e rinisë t'i kalitë si duhet anëtarët e saj me politikën dhe ideologjinë e Partisë.

T'i vëmë, pra, rëndësi të madhe, shumë më tepër se deri tani, punës politike dhe edukative me rininë. Mua më pëlqen mënyra si kanë punuar për aksionet e rinisë shokët e partisë në Gjirokastrë dhe në Berat. Sigurisht, edhe atje ka dobësi, siç ka edhe në rrethe të tjera, por në këto dy rrethe konstatoj se çështjen e aksioneve të rinisë e ndjekin në mënyrë të vazhdueshme.

Aksionet kombëtare që ndërmerren janë të nevojshme për ekonominë, por ato janë më të nevojshme sidomos, për kalitjen ideologjike dhe politike të rinisë. Ne nuk duhet të na dëshpërojë fakti se, pas kthimit në fshat nga aksionet e mëdha, si ai i hekurudhës etj. vruilli që e karakterizonte rininë gjatë jetës dhe punës në aksion nuk mbahen në të njëjtin nivel. Po të mendojmë kështu, do të thotë se nuk e shikojmë drejt këtë çështje.

Është e qartë se kur i riu ose e reja shkon nga fshati në aksion, atje futet në një botë të re, të gëzuar dhe, megjithëse puna që bën atje ka edhe vështirësi, ajo i duket e lehtë. Në aksion i riu ose e reja vihet në kontakt të vazhdueshëm dhe punon e bën një jetë plot gjallëri e entuziazëm së bashku me një masë të madhe të rinjsh e të rejash, që nuk ka si i gjen në fshat; atje

dëgjon konferenca, shikon shfaqje artistike, takohet me njerëz të ndryshëm që venë u flasin për gjithfarë problemesh etj. Prandaj, kur kthehen në fshat, një ambient të tillë nuk e gjejnë dhe tash për tash as është e mundur ta gjejnë. Kjo na vë përpara detyrën që pas aksionit të punojmë me këmbëngulje për të mbajtur vazhdimisht të gjallë frymën revolucionare dhe përmbajtjen e pasur të jetës në aksion, por të mos arrijmë në konkluzionin jo të drejtë se të rinjtë pas aksionit nuk punojnë si më parë, se thyhen etj. Është e pamundur të mos lërë aksioni në ndërgjegjen e të rinjve dhe të rejave mbresa të mëdha e përshtypje të thella, të cilat nuk mund të shlyhen menjëherë. Sigurisht, ka edhe të rinj që ngurrojnë, por dhe te këta influenca e aksionit është e gjallë, prandaj në mos sot, nesër, po të punojë si duhet e vazhdimisht Partia, do të shpërthejnë medoemos energjitë e tyre.

Çështja është që frymën e aksionit, hovin e rinisë në punë, ta mbajmë gjallë. Po si të veprojmë që ta mbajmë gjallë? Pikërisht në këtë drejtim duhet të përqendrohet veprimtaria e organizatës së rinisë dhe e asaj të Partisë. Vetë puna që do të zhvillohet nëpërmjet aksioneve lokale, në kuadrin e një kooperative ose në shkallë rrethi, është një faktor me rëndësi për ta mbajtur vazhdimisht gjallë frymën e aksionit. Natyrisht, në të tilla aksione më të ngushta se ato kombëta nuk mund të krijohet e njëjta situatë, ta zëmë, si në hekurudhë. Megjithatë, edhe në to duhet punuar që të kemi një ambient të shëndoshë, ku të zhvillohet një frymë revolucionare si në aksionet e mëdha. Kjo do të varet, natyrisht, nga mënyra e organizimit të ri-

nisë në këto aksione, siç është vepruar në rrethin e Beratit dhe siç po veprohet në rrethin e Gjirokastrës.

Sigurisht, aksionet kombëtare kanë rëndësi të madhe për edukimin ideopolitik të rinisë, sepse në to marrin pjesë masa të gjera të rinjsh e të rejash, si, fjala vjen, në hekurudhë, ku shkuan 65 000 veta. Këto aksione të rinjtë ngjallin, veç të tjerave, ndjenjën për t'i shërbyer interesit të përgjithshëm të të gjithë vendit, por ato nuk janë e vetmja formë edukimi. Edhe në aksionet lokale, siç kanë bërë Gjirokastra dhe Berati, bëhet, gjithashtu, një punë e gjithanshme politike dhe ideologjike, u kushtohet kujdes edukimit ushtarak, rrahjes së mendimeve etj. Të gjitha këto, së bashku me përfitimin ekonomik, ndihmojnë për edukimin ideologjik e kulturor të pjesëmarrësve, që është qëllimi ynë kryesor.

Për mendimin tim, edhe aksionet lokale bëjnë efekt të madh pse në to, sikurse në aksionet e mëdha, bëhet punë fizike dhe edukative, ideologjike e politike. Në aksionet lokale ka edhe një anë tjetër pozitive: ato janë të vazhdueshme, e lidhin rininë më ngushtë me jetën ekonomike, politike e psikologjike të rrethit apo të kooperativës, influencojnë, gjithashtu, për thyerjen e koncepteve të vjetra, sidomos në masat e fshatarësisë. Kur kooperativistët e malësisë së Beratit shohin djemtë e vajzat e fushës që, me entuziazëm e frymë të lartë patriotizmi, venë për të punuar së bashku me ta nga një, dy muaj ose edhe një vit të tërë, mbeten me përshtypje jashtëzakonisht të mira nga qëndrimi revolucionar dhe puna e palodhur e të rinjve e të rejave, thyhen tek ata konceptet e paragjykimet e vjetra. Ata

do të shikojnë me sytë e tyre punën që bëhet prej rinisë në këto aksione, do të shohin çdo ditë se si u hapën tokat e reja, si i ndihmojnë aksionistët t'u rritet rendimenti i grurit etj., prandaj nuk mund të mos mendojnë se këto të mira, veç punës së tyre, ua solli edhe puna e solidariteti i kësaj rinie të ardhur nga fushat, mudi, djersa e vendosmëria e vajzave, të cilat në disa raste, në jetën e përditshme ata nuk i trajtojnë mirë dhe as mendojnë drejt për to. Gjithashtu, në aksionet lokale, ata do të shohin se vajzat që erdhën nga fusha në fshatin e tyre u dalluan për punën e mirë, për ndershmërinë e patriotizmin e tyre të lartë. Kështu ata do të binden se edhe aksionet kombëtare janë një shkollë e madhe ku rinia punon, edukohet dhe mëson si revolucionare. Prandaj mendoj se do të ishte mirë që të rinjtë e të rejat të shkojnë edhe në aksionet lokale brenda rrethit krahas vajtjes në aksione kombëtare.

Me këto që thashë desha të theksoj se aksionet brendapërbrenda rrethit kanë vlera të mëdha, prandaj t'i organizojmë ato vazhdimisht e më mirë dhe t'i konsiderojmë si forma kryesore të edukimit klasor revolucionar të rinisë sonë nëpërmjet punës.

Të tilla aksione, që janë të një natyre tjetër nga aksionet e mëdha, kanë, siç thashë, të mirat e tyre, por natyrisht puna në to të perfeksionohet më tej, duke bërë kurdoherë kujdes nga Partia që të synohet që të rejat dhe të rinjtë atje jo vetëm të punojnë, por në radhë të parë të edukohen, të mësojnë edhe për çështje ushtarake e të argëtohen. Në qoftë se i kombinojmë si duhet të gjitha këto që përmenda, atëherë do të arrijmë atë që dëshirojmë, ta rritim rininë tonë në rrugë

revolucionare, ta kemi të edukuar, të mësuar dhe me shëndet të mirë. Përsëris që puna, mësimi e edukimi, përgatitja ushtarake, dëfrimi etj., duhet të jenë të balancuar mirë, pse, megjithëse flasim shpesh, në praktikë kalojmë disa herë nga ekstremi në ekstrem. Kjo, natyrisht, nuk do të na japë rezultate me një ditë, por, po t'i përvishemi me kujdes punës, do të kemi me siguri përfundimet që dëshirojmë. Me masat që po merren për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, ky problem do të zgjidhet gjithnjë e më mirë.

Nëpër fshatrat tani na kërkohet çdo ditë e më tepër që nxënësit të mësojnë edhe pas tetëvjeçares. Mirëpo nuk kemi aktualisht kudo shkolla të mesme për të plotësuar kërkesat që sa vijnë e rriten. Ka pastaj shumë nga ata që mbarojnë tetëvjeçaren e që duan të futen në punë, por të ndjekin njëkohësisht edhe shkollën. Këto probleme që shtrohen për zgjidhje duhet t'i kemi parasysh tani që po punojmë për riorganizimin e shkollës sonë, për t'iu përgjigjur nevojave aktuale dhe perspektive të ndërtimit socialist të vendit.

Në fazën e tanishme mendoj të bëhet një studim, sipas të cilit, në bazë të mundësive ekzistuese materiale dhe nevojave të ndërtimit të socializmit e të mbrojtjes së atdheut, të përcaktojmë një sistem arsimor të drejtë, që të përfshijë të gjithë vendin, ku mësimi, puna në prodhim, edukimi ideologjik e politik i rinisë dhe stërvitja ushtarake të zhvillohen sipas normave të kombinuara drejt. Kështu do të krijohen mundësitë që edhe në fshat kushdo që do të dëshirojë të mësojë pas tetëvjeçares, ta ketë rrugën të hapët. Në këtë mënyrë do t'i ngremë në masë rininë dhe popullin nga pikëpamja

ideologjike e kulturore në rrugën marksiste-leniniste dhe nxënësit do t'i përgatitim qysh në shkollë për të genë në gjendje të punojnë dhe të mbrojnë atdheun. Duhet të luftojmë që t'ia arrijmë këtij objektivi.

Por, duke punuar për këtë objektiv të madh, do të na dalë problemi i vendeve ku do të duhet të mësojë e të punojë gjithë kjo masë e madhe njerëzish. Kjo do të përbëjë objektin e një studimi tjetër, i cili, gjithashtu, duhet bërë me kujdes, me qëllim që çështja e lokaleve të mos na bëhet pengesë për t'u dhënë mësim dhe edukatë gjithë atyre që do të dëshirojnë të ndjekin shkollat më lart. Krahas problemeve të tjera, pra, të shikojmë edhe anën materiale, të zbulojmë mundësitë që kemi në këtë drejtim në fshat e në qytet, në bujqësi e në industri. Mbi këtë bazë të hartohen planet e të përcaktohen perspektivat e mëtejshme.

Profilet e shkollave që janë të drejta, t'i mbajmë, po në programe duhet të përcaktojmë me kujdes sidomos proporcionet, sa kohë do të nevojitet për mësim, sa për punë dhe sa për stërvitje ushtarake. Profili që kemi caktuar tani është i drejtë, po në bazë të kushteve të reja të zhvillimit të mëtejshëm të industrisë dhe të bujqësisë sonë, për sa u përket proporcioneve në programe do të jetë e nevojshme të bëjmë ndryshime të tjera.

Sot kemi parullën luftarake të Partisë «Në njërën dorë kazmën, në tjetrën pushkën». Si vegël pune, me zhvillimin e pandërprerë të vendit, kazmën do ta përdorim gjithnjë e më pak, sepse në këtë rrugë na çon revolucionin teknik. Ajo do të mbetet kështu në të ardhmen gjithnjë e më shumë simboli i një pune fizike të

lodhshme, që na ndihmon të ndërtojmë jo vetëm socializmin, por edhe njeriun tonë të ri. Edhe në bujqësi do të shkojmë gjithnjë e më shumë drejt një mekanizimi më të madh, por as ky mekanizim i madh nuk duhet të ndryshojë profilin e caktuar të shkollës, ai do të influencojë vetëm për të ndryshuar proporcionin e dijeve teorike apo praktike. Në qoftë se tani kemi nevojë, për shembull, që të gjithë nxënësit të kenë nga pak dijeni për pambukun, ose ai që mbaron teknikumin bujqësor të ketë edhe ca dijeni për mekanikën, në të ardhmen do të lindë nevoja t'i specializojmë më shumë nxënësit e teknikumeve, të mos i lëmë me profil të përgjithshëm. Do të vijë koha, pra, që të na duhet të nxjerrim specialistë me profile të ngushta, me teori më të gjerë për një degë të caktuar, për arsye se do të kemi arritur në një mekanizim më të madh të bujqësisë. S'ka dyshim se atëherë do ta kemi më lehtë ta bëjmë një gjë të tillë, sepse kohën do ta kemi në dispozicion, kuadrot që do të drejtojnë bujqësinë ose industrinë tonë me teknikë më të lartë do t'i kemi më të mësuar dhe fizikisht më të kalitur për punë. Kjo është çështje e perspektivës.

Partia duhet të llogaritë potencialin industrial që kemi tani dhe atë që do të kemi në të ardhmen, nivelin e bujqësisë që kemi sot dhe atë që do të kemi në perspektivë. Në bujqësi nuk do ta kemi problem çështjen e punës në prodhim të nxënësve të shkollave të fshatit, kurse për qytetin duhet t'i llogaritim me kujdes ndërmarrjet, fabrikat e uzinat ekzistuese dhe, lidhur me këto, sa nxënës mund të bëjnë atje punën praktike në prodhim, nga të cilët sa vajza e sa djem,

të kemi parasysh, gjithashtu, sa të rënda apo të lehta janë punët etj.

Duke u marrë me këto çështje, do të na dalin shumë probleme. Mund të dalë, për shembull, pyetja «ç'na duhen neve shkollat e rezervave të punës?», ku tani nxënësi, sa mbaron tetëvjeçaren, mëson një apo dy vjet zanat, pastaj shkon të punojë në fabrikë, ku merr për-njëherësh 500 lekë në muaj, pa e justifikuar një pagë të tillë. Në uzina e në fabrika ne mund të krijojmë shkolla me turne, ku punëtorëve të rinj t'u jepet mundësia të punojnë, të mësojnë e të krijojnë në mënyrë ritmike, duke bërë kështu gjatë kohës së punës atë që bën tani shkolla e rezervave të punës, pse nuk është e drejtë që një djalë 16-17-vjeçar, sa del nga shkolla e rezervave, të marrë 500 lekë, kurse një punëtor me 30 vjet stazh pune të marrë diçka më tepër se ai.

Natyrisht, në qytete nuk mundet dhe as nuk duhet të dërgohen të gjitha të rejat dhe të rinjtë vetëm në fabrika e në uzina, por të hapen edhe fronte të tjera pune për të drejtuar kontingjentet e reja të rinisë që mbarojnë tetëvjeçaren dhe dalin në jetë. Një pjesë e tyre mund të mësojnë të bëhen, fjala vjen, muratorë. Fabrika është një front i madh pune dhe mësimi, po edhe ndërtimi është një front i tillë i madh, sikurse mund të themi për të gjithë sektorët e prodhimit e të shërbimit.

Po ta studiojmë me kujdes përgatitjen e nxënësve në shkolla për të gjitha aktivitetet e ndryshme të ndërtimit socialist, sidomos në qytete, ata që do të bëjnë 12 vjet shkollë ka mundësi t'i inkuadrojmë në këto drejtime. Në rast se do të duhen 6 ose 7 muaj mësim,

të tërë nxënësit për pjesën e kohës që do të teprojë mund t'i futim në punë në prodhim. Kjo çështje duhet pasur parasysh në studimin që thamë.

Në përgjithësi jam dakord me vërejtjet e shokëve. Është një eksperiencë e mirë kjo e aksioneve, prandaj ta revolucionarizojmë e ta përmirësojmë më tej përvojën e fituar.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

VËREJTJET NGA BAZA NA NDIHMOJNË PËR TË PËRMIRËSUAR METODËN TONË TË PUNËS

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

25 tetor 1968

Informacioni i paraqitur nga sektori i Statutit është i kënaqshëm dhe jemi dakord me çështjet që trajtohen në të. Në qoftë se ka ndonjë vërejtje ose kritikë për punën tonë, apo ndonjë problem tjetër në interes të çështjes, që i preokupon shokët e rretheve², është mirë të na e thonë, të na bëjnë edhe kritika për metodën e punës sonë ose të aparatit të Komitetit Qendror.

Kur themi se s'ka kritikë ndaj nesh nga komitetet e Partisë të rretheve dhe nga sekretarët e tyre, kjo është një dobësi, që, sigurisht, ne e ndiejmë thellë. Ne s'duam që baza të na kritikojë sa për të thënë që ja,

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth informacionit të paraqitur nga sektori i Statutit të aparatit të KQ të PPSH mbi pranimet në Parti gjatë nëntë muajve të parë të vitit 1968.

2 Në mbledhje merrnin pjesë edhe sekretarë të komiteteve të Partisë të disa rretheve.

edhe ne bëjmë kritika, po me qëllim që të na vlejë si ndihmë për të përmirësuar punën. Nuk është e mundur që gjithnjë puna jonë, qoftë e sekretarëve të Komitetit Qendror, qoftë ajo e instruktorëve, të jetë e përsosur, apo me parashikime plotësisht të drejta. Edhe ne kemi gabime dhe të meta në punë, po kush do të na i vërë në dukje këto të meta dhe gabime? Këtë do ta bëni ju, shokë, se, në fakt, edhe kur ne vemi në bazë e kur kthehemi prej saj, objektivi ynë kryesor është si punoni ju, si i zbatoni ju vendimet dhe udhëzimet e Partisë.

Ju keni dobësi në punë edhe për faktin se në punën tonë ka dobësi dhe gabime. Në përgjithësi kemi marrë kontakt me ju, por ju keni në kurriz një punë të gjerë, të shumanshme, me shumë degë. Në rreth ziejnë të gjitha çështjet, vlon lufta e Partisë për zbatimin e vijës së saj në jetë. Ju hasni në shumë vështirësi në zbatimin e orientimeve dhe të vendimeve të Partisë, prandaj ne duhet t'i shikojmë patjetër të metat që ka puna e Partisë në bazë, pse nëpërmjet tyre do të shikojmë edhe të metat tona. Kështu do t'ju ndihmojmë konkretisht dhe jo vetëm të nxjerrim disa konkluzione si, për shembull, «puna në këtë rreth nuk vete mirë për arsye se janë dhënë disa udhëzime të pastudiuara». Në nxjerrjen e këtyre udhëzimeve, të cilat nuk u përshtaten njëlloj të gjitha rretheve, duket se puna dhe ndihma jonë nuk kanë qenë të specifikuara mirë. Prandaj kështu edhe ne thellohemi në konkluzionet tona, sepse ju i dini shumë mirë e konkretisht problemet në rreth, keni edhe përvojë dhe jeni kalitur në punë. Ne e dimë, gjithashtu, se direktivat

që ju dërgohen nga ana jonë nuk ecin si në gjalpë, për zbatimin e tyre dalin vështirësi materiale, subjektive e objektive, prandaj duhet të bëhet kujdes të mos regjistrohen vetëm rezultatet dhe, duke u nisur nga këto, t'ju vëmë juve «çmimin».

Duke na bërë vërejtje, ju na ndihmoni edhe për përsosjen e metodës e të stilit të punës sonë. Për këto ne flasim shumë dhe sigurisht kemi përparime të mëdha, por mbetet akoma shumë për të bërë. Prandaj, ne këtu në udhëheqje, duhet të japim shembullin të parët duke e perfeksionuar atë vazhdimisht.

Për përmirësimin e metodës sonë të punës, mund dhe duhet të na ndihmoni edhe ju, si shokë të pjekur dhe të aftë, sepse keni eksperiencën e bazës. Ju vërtet jeni të ngarkuar me punë, megjithatë sigurisht, edhe ne, edhe ju, duhet të mendojmë që të mund të ekonomizojmë njëfarë kohe për të reflektuar për përsosjen e metodës së punës. Edhe pse keni shumë punë, duke bërë një sforco më të madhe, të mendoni për të gjetur një metodë të tillë pune, nga e cila të mësojmë edhe ne, ashtu siç duhet të përpiqeni që edhe ju të mësoni nga metoda jonë e punës.

Nga çfarë gjërash, për shembull, duhet të heqim dorë? Unë mendoj se duhet të heqim dorë nga informacionet e tepërta, me të cilat ju na okuponi edhe për gjërat më të thjeshta. Informacioni është i domosdoshëm, por këtu duhet bërë një klasifikim se për cilat gjëra jemi të interesuar të na informoni, duke përcaktuar specifikat e informacionit. Në qoftë se do të bëhet një gjë e tillë, kjo do t'i lehtësojë shokët e bazës. Kur venë në bazë shokët, duke filluar që nga sekreta-

rët e Komitetit Qendror e deri tek instruktorët, shokët e bazës duhet të shikojnë se ne interesohemi për disa çështje kryesore, si për eksperiencën e zbatimit të vijës së Partisë, për gjendjen organizative të Partisë etj. Kështu sekretari i komitetit të Partisë në rreth, apo sekretari i organizatës-bazë, duke i ditur që më parë problemet për të cilat interesohemi, do të jetë në gjendje të përgjigjet. Me një mënyrë të tillë pune ne do të informohemi për çështje të nevojshme, të cilat do të ndihmojnë edhe në përgjithësimin e eksperiencës së Partisë dhe jo ta futim në ethe sekretarin e komitetit të Partisë apo të organizatës-bazë, duke i bërë një mijë pyetje për gjëra që ai nuk i di dhe s'mund t'i dijë.

Kuadrot, duke filluar nga sekretarët e komiteteve të Partisë e deri te sekretarët e organizatave-bazë, duhet t'i edukojmë ta kenë kurdoherë në dorë situatën, t'i dinë gjërat në thellësi, por kjo nuk do të thotë që t'i dinë të gjitha gjërat deri në hollësinë më të vogël, pse kjo është e pamundur të bëhet, megjithëse këta janë kuadro nga më kryesorët që drejtojnë jetën e Partisë dhe të pushtetit në rreth. Ata janë shokë të aftë dhe ndihmojnë fuqimisht në zbatimin e vijës së Partisë, por nuk është e thënë që të merren me hollësi të panevojshme.

Ju duhet të reflektoni për punën tuaj dhe keni nevojë të reflektoni duke i rrahur mirë problemet me njëri-tjetrin. Por kështu si punohet nuk premtion koha të mendoni sa duhet për këto çështje, sepse mbi sekretarët e komitetit të Partisë të rrethit presioni i punës është i madh. Një presion më të madh kanë nga të tjerët sekretarët e Komitetit Qendror, megjithatë unë

mendoj se ashtu si ne këtu, edhe ju duhet të punoni për të përmirësuar metodën e punës që keni se është në interes të punës. Kështu mund të na ndihmoni shumë edhe ne. Ndoshta tani nuk keni për të na bërë ndonjë vërejtje apo kritikë, apo të na sugjeroni diçka, por ka gjëra, duke filluar nga më kryesoret deri tek ato më të thjeshtat, për të cilat duhet të na thoni mendimin tuaj.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

NË ÇDO QËNDRIM NDAJ KUADRIT TË VEPROJMË ME DREJTËSI PARTIE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

25 tetor 1968

Shokët e Komisionit Qendror të Kontrollit dhe të Revizionimit mendoj se kanë punuar mirë për çështjet që kanë parë në rrethin e Fierit. Masat që janë marrë për të anuluar vendimet ndaj disa shokëve të ndëshkuar pa arsye të shëndosha, janë të justifikueshme. Tani ata me të drejtë u kthyen në Parti dhe në funksionet që kishin pasur.

Sipas mendimit tim, edhe autokritika e shokëve të Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit ishte e mirë. Ata e kanë kuptuar shpejtimin dhe mosthellimin sa duhet në gjykimin e masave të marra ndaj dy shokëve të organizatës së Partisë të rajonit të Patosit, duke influencuar t'u jepej atyre një ndëshkim i rëndë për një

1 Në mbledhje u diskutuan çështje që i kishin dalë Komisionit Qendror të Kontrollit dhe të Revizionimit të Partisë lidhur me disa masa të marra në rrethin e Fierit.

çështje të vogël. Nuk duhet dërrmuar kuadri kështu, shokë! Ata që gabuan duhet të kritikoheshin për fajet që bënë, por jo të shkohej deri në masa ekstreme siç vepruat ju. Një qëndrim i tillë nuk është i drejtë, është i gabuar, nuk tregon pjekuri në mendime e në veprime dhe nuk përfaqëson një zbatim të arsyeshëm të vijës së drejtë të Partisë.

Ne e besojmë se, për dënimin e këtyre shokëve, ju nuk jeni nisur nga pozita mikroborgjeze e hakmarrjes e të meta të tjera si këto. Por, kur analizohet një çështje e tillë, kur për një gjë kaq të vogël merren masa ekstreme, njerëzit kërkojnë të shpjegohet ky qëndrim, sepse, gjersa shokët që gabuan, patën bërë autokritikë në organizatat-bazë përkatëse të Partisë, në organizatën e bashkimeve profesionale dhe në popull, një gjykim i shëndoshë normal nuk shikon asnjë arsye që pas tre muajsh të merren masa të tilla.

Vihet pyetja: përse duhej t'i ktheheshin përsëri kësaj çështjeje? Këtë insistim kaq të madh të shokëve të rrethit më duket nuk e justifikon asnjë arsye. Me këtë qëndrim ata i vënë në dyshim shokët, të cilët kanë të drejtë të mendojnë se këtu mund të kemi të bëjmë me ndonjë arsye subjektive si: mendjemadhësi, hakmarrje etj.

Prandaj kritikrat që ju janë bërë juve, shokë, drejtues të Partisë në rajonin e Patosit, duhet t'i kuptoni mirë, mbasi këmbëngulja juaj për të mbrojtur pozitën e masës që keni marrë është e pashpjegueshme, kështu nuk është mirë as për ju, as për shokët e Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit, që i kanë aprovuar këto masa.

Në gjykimin e njerëzve, pra, duhet të jemi të matur e të kujdesshëm, pse subjektet për të cilat diskutojmë, sidomos kur është fjala për një shok të vjetër, me një të kaluar të mirë, me merita partie, me merita pune, shok që tërë jetën ka punuar në naftë dhe, nga punëtor i thjeshtë është bërë kuadër drejtues, nuk janë për një dënim të tillë. Gabimi ishte i vogël kurse ndaj tij u mor një masë e rëndë. Duhet bërë shumë kujdes me kuadrot, duke qenë kurdoherë të matur, për të zbatuar drejt vijën e Partisë me njerëzit.

Shokët, kur kanë faj, t'i kritikojmë, por, siç thashë, duhet të jemi edhe të kujdesshëm ndaj tyre, ashtu siç bëjmë konkretisht ne sot ndaj jush. Ju ratë në gabim në gjykimin e kësaj çështjeje. Këtë gabim e kuptuat, bëtë edhe autokritikë para Sekretariatit, prandaj s'kemi pse të zgjatemi shumë dhe t'ju leqendisim. Çështja është që kjo ngjarje t'ju bëhet mësim. Por kini parasysh që paskëtaj të mos hidheni në ekstremin tjetër, drejt liberalizmit, po të jeni kurdoherë të matur, siç na mëson Lenini.

M'u kujtua me këtë rast se si V.I. Lenini, në vëllimin 35 të veprave të tij, i tërheq vërejtjen gazetës «Pravda» për kritikën jo të drejtë që i bënte një njeriu me talent për diçka fare të vogël. Ai thotë:

*«Mos u kapni, o miq, pas dobësive njerëzore!
Talentit është një gjë e rrallë. Ai duhet përkrahur në mënyrë sistematike dhe me kujdes. Në ndërgjegjen tuaj do të rëndojë një mëkat, një mëkat i madh (njëqind herë më i madh sesa*

mëkatet personale, nëse ka të tilla. . .) përpara demokracisë punëtore, në qoftë se ju nuk do të dini të tërhiqni një bashkëpunëtor të talentuar, nuk do ta ndihmoni atë. Konfliktet kanë qenë të vogla, kurse çështja është serioze. Mendohuni për këtë!»¹.

Edhe ju pra, për një gabim të vogël i ratë në kokë një kuadri të dalë nga klasa punëtore, të rritur nga Partia, por që ka edhe ndonjë dobësi në jetën e tij, pse në të vërtetë, një gabim të tillë ai e ka përsëritur edhe një herë tjetër, gjë që, natyrisht, nuk është e mirë. Një hap i tillë jo i matur, për një gjë të vogël, duhet të na vrasë ndërgjegjen. Me qëndrimin që mbajtët ndaj tij, ju gjoja jeni përpjekur të vendosni normat e Partisë, demokracinë e Partisë, mirëpo duke vepruar kështu, i bëni një dëm të madh demokracisë punëtore, siç thotë Lenini, sepse i eliminuat Partisë një njeri me aftësi. Në vend që ta ndreqnit e ta afronit, e dënuat rëndë.

Prandaj, e theksoj edhe një herë, të kemi shumë kujdes, të mos shpejtohemi, të veprojmë me drejtësi partie në çdo qëndrim ndaj kuadrit, në mënyrë që t'i bëjmë mirë atij që ka gabime të vogla e të parëndësishme dhe jo ta largojmë, apo ta dëshpërojmë. Këto t'i kemi parasysh të gjithë, si ju për njerëzit në bazë, ashtu edhe ne ndaj jush që keni gabuar. Me gjithë qëndrimin e gabuar, për të cilin diskutuam, ne ju konsi-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 35, f. 83-84.

derojmë shokë të mirë, që keni një të kaluar pozitive, dhe për gabimin që bëtë, ju kritikuam, me qëllim që të nxirrni mësim.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

EDUKIMI I BREZIT TË RI — PROBLEM JETIK PËR SHOQËRINË TONË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 tetor 1968

Ky është një problem shumë i rëndësishëm me karakter ideologjik, social e pedagogjik, të cilin mendoj se duhet ta diskutojmë edhe në parim, por vendimet që mund të marrim t'i shikojmë mirë dhe të përcaktojmë drejt deri ku do të arrijmë, duke parë sa mundësi kemi.

Gjithashtu mendoj që këtë raport ta kenë parasysh në punën e tyre organet e Partisë dhe ato shtetërore, si edhe organizatat e masave.

Megjithëse raporti ka disa të meta, kryesorja e të cilave, më duket mua, është se në të kërkohet që tërë problemin e punës edukative të brezit tonë të ri ta zgjidhë shteti, duke marrë përsipër një angazhim të madh

¹ Në këtë mbledhje u diskutua për disa probleme të punës me fëmijët në bazë të raportit të paraqitur nga Komiteti Qendror i BRPSH, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe nga aparati i Komitetit Qendror të PPSH.

material, për të gjithë fëmijët e vendit, nga foshnjat e deri te pionierët, diskutimet që u bënë në këtë mbledhje, sqaruan dhe plotësuan drejt e realisht si duhet ta shikojmë këtë problem. Bashkohem me mendimet shumë të vlefshme të shokëve që diskutuan, sipas të cilëve çështja e edukimit të fëmijëve nuk mund të zgjidhet vetëm nga shteti, në qoftë se për këtë problem kaq të rëndësishëm nuk bashkohen forcat e gjithë shoqërisë, jo vetëm në parim, por edhe në praktikë. Për këtë çështje, pra, duhet të interesohen në mënyrë konkrete të tërë dhe, në qoftë se nga pikëpamja materiale nuk do të jemi në gjendje për shumë fonde në këtë pesëvjeçar, të paktën të hedhim baza qysh tani, për në pesëvjeçarët e ardhshëm.

Se çfarë mund të bëhet për këtë problem gjatë viteve të pesëvjeçarit të katërt me fondet që ka në dispozicion shteti ynë, kjo është vendosur nga Qeveria dhe e kemi të qartë, por në qoftë se duam të bëhet ca më tepër, jashtë mundësive materiale dhe monetare të shtetit tonë në këtë periudhë, atëherë t'i drejtohem shoqërisë, le të kërkojmë të kontribuojnë familjet në qytet dhe në fshat, uzinat e ndërmarrjet si kolektiva punonjës, kooperativat bujqësore, organizatat e Partisë dhe ato të masave, Fronti, rinia, organizata e pionierit, e gruas, bashkimet profesionale etj. Kontributi i shoqërisë në këtë drejtim, më duket mua, mund të jetë shumë më tepër nga ç'është në gjendje të japë shteti sot. Po ta lëmë pas dore këtë punë dhe çdo gjë ta mbështetim në ato ç'mund të bëjë shteti, do të gabonim, nuk do t'i realizonim dot ato që synojmë të arrijmë.

Puna për edukimin e fëmijëve, në çerdhet, në kop-

shtet e më pas në shkolla e në ambientet jashtë saj nga ana e organizatave të pionierit, të rinisë, nga Partia, familja etj., duhet të na preokupojë të gjithë.

Në radhë të parë, mendoj të bëjmë kujdes që investimet për këtë qëllim të jenë kurdoherë të studiuara mirë, pse kam përshtypjen se nuk po bëhen si duhet. Këto institucione, e kam fjalën për çerdhet e kopshtet, shtëpitë e fëmijëve etj., për kushtet që po kalojmë, nuk kontrollohen e nuk shfrytëzohen si duhet në bazë kriteresh të drejta.

Ministrisë së Arsimit e të Kulturës dhe asaj të Shëndetësisë nuk mund t'u lejojmë të na thonë se edukatorët ose kujdestarët e këtyre institucioneve janë me nivel të ulët pedagogjik kur, siç e dimë, vetëm në Tiranë kemi me dhjetëra mësuese që për arsye të transferimit të bashkëshortit në kryeqytet ose ndonjë arsye tjetër, rrinë në pritje për të zënë punë në profesionin e tyre ngaqë vendet «janë të zëna». Përse të mos çojmë nga këto shoqe në shtëpitë e fëmijës, në kopshte apo në çerdhe, ku punojnë edhe edukatore të papërshtatshme? Në qoftë se këto arsimtare, të përgatitura për këtë punë, nuk duan të venë në të tilla institucione, Partia e ka për detyrë të punojë politikisht e t'i bindë që të shkojnë.

Pra, më parë duhet të merren masa serioze për ta organizuar dhe për ta kontrolluar me shumë kujdes punën e këtyre institucioneve ekzistuese, pastaj të pretendojmë për të krijuar të tjera. Me këtë dua të them që, përpara se të kërkojmë për të ngritur shtëpi të reja fëmijësh, çerdhe e kopshte të tjera, të bëjmë përpjekje për të shfrytëzuar si duhet mirë e sa më racionalisht

këto që kemi. Mundësitë për një gjë të tillë, më duket mua, i kemi. Pastaj, pasi të kemi vënë rregull të plotë në këto që funksionojnë, të marrim masa për të përgatitur edhe disa qindra apo mijëra edukatorë të tjerë për institucionet e reja që do të planifikojmë të ndërtojmë. Kryesorja është që këta mijëra njerëz që kemi sot, gjithë trupin mësimor, ta mobilizojmë për ta kryer detyrën sa më mirë. Duke na folur këtu vetëm si duhet bërë, ç'duhet bërë e të tjera, në një kohë kur nuk shfrytëzohen plotësisht e me kriter gjithë këto kopshte, çerdhe e shtëpi fëmijësh që kemi, është njëlloj sikur të bësh teori jashtë realitetit, ndërsa ne duhet të shohim si është ky realitet te ne, si të marrim masa që ta përmirësojmë atë më tej, të mos mbetemi vetëm me nga një autokritikë sa për të kaluar radhën, prandaj duhet ndrequr në radhë të parë, situata në institucionet ekzistuese duke marrë masa serioze.

Thuhet se, veç kujdesit që duhet treguar për fëmijët nga ana fizike, në çerdhe e kopshte synojmë edhe t'i edukojmë. Këtë parim nuk e hedh poshtë njeri, por, më duket, sikur nuk janë përcaktuar drejt kriteret për pranimin e fëmijëve në këto institucione. Të kemi parasysh se dërgimi në çerdhe ose në kopsht i fëmijëve të familjeve që s'kanë njeri t'ua mbajë, është një problem jetik dhe, kur atyre u sigurohet vend, ky është një lehtësim dhe ndihmë e madhe për to. Këtë në asnjë rast nuk duhet ta nënvleftësojmë. Por, në kushtet ekzistuese, kur akoma s'kemi mundësi të sigurojmë vend për të gjithë fëmijët, në kopshte e në çerdhe duhet të preferohen, në radhë të parë, kalamanët e atyre familjeve që s'kanë ku ta lënë fëmijën. Mirëpo,

siç konstatojmë, në shumë raste lehtësohen ato familje që kanë njerëz kush ua mban, duke zënë kështu vendin e fëmijëve që duhen dërguar patjetër në çerdhe e në kopshte, pse, gjatë kohës që bashkëshortët janë në punë, s'kanë njeri në shtëpi.

Sigurisht, në bazë të planit të shtetit, do të hapim çerdhe e kopshte të tjera, për të cilat duhen bërë përpjekje të ndërtohen në kohën e duhur, po, për kushtet e tanishme, mendoj se është e nevojshme të pranojmë e të zbatojmë me rreptësi kriterin që thashë, kurse fëmijët e familjeve që kanë njerëz në shtëpi, mund t'i pranojmë vetëm pasi të kemi plotësuar më parë nevojat e atyre që s'ka kush i mban.

Orientimi që ka dhënë Partia dhe po zbaton Qeveria për fshatin, është i drejtë. Kooperativat që kanë mundësi, duhet t'i bëjnë çerdhet e kopshtet, por, duke parë nevojat e mëdha që lindin, nuk mund të mbështetemi vetëm në ndërtesat që do të ndërtohen në bazë të planeve të aprovuara. Për zgjidhjen e nevojave të ngutshme që ka sot në fshat për to, të shihet ç'mundësi tjetër mund të shfrytëzohet për të bërë akoma më shumë. Të kihet parasysh, gjithashtu, se shteti tani për tani nuk mund të paguajë me mijëra edukatore¹, përveç që do të ishte e pamundur të gjendeshin për këtë qëllim mijëra edukatore përnjëherësh.

1 Me vendim të Komitetit Qendror të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH, 22 mars 1976, «Mbi uljen e pagave të larta, mbi disa përmirësime në sistemin e pagave të punonjësve dhe mbi ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve midis fshatit e qytetit», investimet dhe shpenzimet shoqëro-kulturore të kooperativave bujqësore përballohen nga shteti.

Ajo që u tha këtu për t'i grumbulluar e për t'u kujdesur për fëmijët në disa momente të caktuara të ditës, si për shembull, në mbrëmje, kur disa prindër vazhdojnë akoma të punojnë, mendoj të shihet. Por të kihet parasysh që puna edukative me fëmijët pas shkollës të mos kthehet në diçka të ngurtë, me rregulla si në shkollë. Fjala është që fëmijët, me të dalë nga shkolla, të mos i mbyllim përsëri brenda në dhoma. Pas mësimit fëmijët kanë nevojë të dalin për të luajtur në ajër të pastër, kanë nevojë të hidhen, të kërcëjnë, të bredhin, të nduken me njëri-tjetrin pa ndonjë të keq etj. Nga disa gjëra që kam konstatuar më duket se ekziston një tendencë të disa arsimtarë, sipas së cilës, po qeshi ose foli një çikë një nxënës me shokun e vet në bankë gjatë kohës së mësimit, i vënë menjëherë epitelin «prishës i qetësisë», «nuk është djalë i mirë», po u pa në oborrin e shkollës që ndjek me vrap një shok ose nduket ca, pa të keq, me shokun e vet, është «i pasjellshëm» etj. Pikëpamje e qëndrime të tilla, sipas mendimit tim, nuk janë të drejta. Një djalë që bën zhurmë në klasë dhe prish mësimin, nuk duhet lejuar, por kur ndonjëri që është ca i hedhur, dëshiron t'i thotë diçka shoqes ose shokut të bankës, ulet të marrë diçka që i bie nga banka etj., nuk duhet të merret sikur vepron me qëllim.

Edhe për përgatitjen e mësimeve jashtë shkollës nuk tregohet ndonjë interesim i madh nga ana e shoqërisë, kjo çështje nuk ndiqet e nuk organizohet si duhet. Edhe këtu fjalën e kam sidomos për fëmijët që, kur vijnë nga shkolla, nuk kanë njeri në shtëpi. Ata nuk i udhëzon njeri si të rrinë e t'i përgatitin mësimet

bashkërisht me njëri-tjetrin. Edhe fëmijët e atyre që i kanë në shtëpi të tëra komoditetet, është mirë t'i mësojmë të studiojnë edhe me njëri-tjetrin, sepse kështu do t'u zhvillohet ndjenja e kolektivitetit. Ky kujdes duhet treguar, sidomos, për ata fëmijë që kur vijnë nga shkolla, prindërit i kanë në punë. Disa prej tyre, me radhë, herë në shtëpinë e njërit, herë në atë të tjetrit, mund të mblidhen në një dhomë, duke i porositur më parë që, pa bërë rrëmujë shtëpinë ku do të jenë të pranishëm, të studiojnë, pastaj, mbasi të kryejnë mësimet, të dalin jashtë për të luajtur. Natyrisht, organizimi i kësaj pune varet edhe nga edukata e secilës familje, po ka mundësi të bëhet, vetëm mungon kujdesi.

Problemi tjetër që doja të prekja ka lidhje me organizatën e pionierit. Mua më duket se psikologjia, karakteri i fëmijëve etj., etj., edukohen nëpërmjet familjes, punës, lodrave, shkollës etj. Në shkollë fëmijët marrin nga mësuesit edukatë dhe njohuri, por pjesa më e madhe e aktivitetit të tyre zhvillohet jashtë shkollës, në familje, në lodra etj. Ne nuk jemi për atë që fëmijët jashtë shkollës t'i organizojmë në mënyrë ushtarake, prandaj udhëheqësi i pionierëve, ose mësuesja që merret me punën e pionierëve, nuk është e domosdoshme të jetë e pranishme kudo, së bashku me pionierët. Për këtë qëllim duhen gjetur njerëz të përshtatshëm nga organizata e rinisë, që me veprimtarinë e tyre të dinë të punojnë dhe të ndikojnë pozitivisht te kalamanët. Pas shkollës, kur ata dalin në rrugë për të luajtur, të mos u bëjmë leksione pedagogjike, por të organizojmë punën në mënyrë që lodrat, dëfrimi, kër-

cimet etj., të bëhen në mënyrë të kulturuar, të lirshme, të natyrshme, me qëllim që te fëmijët të zhvillohet ndjenja e unitetit, dashuria për shoqi-shoqin, hovi, guximi, iniciativa, vetëveprimi etj. Kjo punë me fëmijët nuk mund të bëhet me konferenca, sepse kështu do t'i ndrydhim edhe në ambientet e lirshme aq të nevojshme e të dashura për rritjen dhe për zhvillimin e tyre.

Ne e dimë se kalamanët tanë një pjesë të mirë të kohës e kalojnë në rrugë. Mirëpo shumë njerëz janë të shqetësuar, thonë se, duke luajtur atje, ngjasin edhe aksidente me ta. Po ku të venë fëmijët në orët e lira? Prandaj mundet e duhet të bëjmë diçka, të ndërtojmë ndonjë shesh me lodra të thjeshta, ku fëmijët të kërcejnë, të mësohen të qitin me pushkë sportive etj. Qytetet e mëdha mund ta ndërtojnë një park të pajisur me të tilla lodra, por ambiente si ky nuk mund të bëhen kudo dhe për të gjithë fëmijët. Pastaj, ta kemi të qartë se prindërve nuk u intereson të dërgojnë kalamanin 4-vjeçar ose edhe më të rritur në një park larg shtëpisë, pa njeri, pse do t'u duhet t'i shoqërojnë, atyre u intereson më mirë që fëmijët t'u rrinë afër shtëpisë. Mirëpo aty pranë është rruga, ku kalojnë makina, biçikleta etj., dhe duhet pasur shumë kujdes. Aty-këtu nëpër lagje ka ndonjë shesh të vogël, nganjëherë bile edhe me ndonjë lodër, megjithatë kalamanët luajnë më shumë rrugëve, ndërsa parqet apo sheshet e përshtatshme për lodra rrinë bosh, sepse njerëzve tanë, kur shohin fëmijët që luajnë në mes të rrugës ku mund të rrezikohen nga automobilat etj., nuk u është bërë edukatë t'i këshillojnë e t'i drejtojnë për të luajtur atje ku do të jenë jashtë çdo rreziku.

Pse s'venë, kush i ndalon fëmijët të luajnë në sheshet e vogla? Gjersa kemi të tilla dhe nuk shfrytëzohen, atëherë përse kërkojmë fonde të bëjmë të tjera, bile kemi mani të kërkojmë gjëra të mëdha, parqe, stadione e të tjera si këto? Le të shfrytëzojmë më parë mundësitë që kemi, mendoj unë, pastaj të bëjmë kërkesa të reja, sigurisht të arsyeshme. T'i heqim një herë kalamanët nga rrugët, t'i drejtojmë në vendet që thashë, pastaj të llogaritim çfarë parqe e sheshe të tjera na duhen dhe çfarë nuk duhen. Të kuptohemi, nuk jam i mendimit për të mos krijuar parqe, por për këtë qëllim, në radhë të parë, të kontribuojë e gjithë shoqëria, pastaj të shfrytëzojmë edhe mundësitë e fondet që disponojmë si shtet.

Puna e «rrugaçëve» për të cilët flitet, të mos na alarmojë. Vetë duhet ta kemi të qartë kush është rrugaç, pse nuk është e drejtë të quajmë të tillë kalamanët që luajnë nëpër rrugë. Këta s'janë rrugaçë. Mirëpo në fjalorin e popullit të gjithë ata që luajnë rrugëve diku dhe zihen e bëjnë ndopak zhurmë etj., etj., quhen «rrugaçë». Të mos harrojmë se fëmijët kanë energji, duan të luajnë që t'i harxhojnë ato, ama gjatë kohës së lirë asnjë të rritur nuk të zë syri në një shesh ose park që të punojë, të merret me ta. Nuk bëhet ndonjë punë serioze se si të luajnë fëmijët, ku duhet të mblidhen. Kjo çështje i është lënë spontaneitetit dhe pastaj disa kanë tendencë ta nxijnë situatën, sa të duket sikur kushedi ç'po bëhet, kurse në të vërtetë nuk është kështu.

Po çfarë lodrash mund të organizojmë, na thonë, ato edhe kur vihen, fëmijët i prishin! Po, edhe i pri-

shin. Sigurisht, kur u vihen në dispozicion lodra e mjete, fëmijët disa nga ato edhe do t'i dëmtojnë. Lodra shumë të kushtueshme për kushtet tona tani për tani nuk i kemi mundësitë t'i sigurojmë, kurse për disa lodra të thjeshta i kemi mundësitë. Kur ndonjë nga ato priset, duhet zëvendësuar patjetër; banorët e lagjes, shoqëria, kanë mundësi t'i bëjnë këto. Po të shfrytëzohen mirë mundësitë që kemi, s'ka dyshim se do t'i tërheqim fëmijët në rrugën që duam, do të argëtohen dhe do ta kalojnë kohën e lirë në mënyrë të kulturuar.

Si konkluzion, më duket se të gjitha ato që ngrihen shokët në diskutimet e tyre dhe këto që thashë, janë orientimi më i drejtë, më praktik, konkret e i shumanshëm që duhet të ndjekim për edukimin e fëmijëve. Gjithashtu edhe Qeveria, megjithëse këtë problem e ka shqyrtuar drejt, të shohë edhe një herë brenda mundësive materiale që kemi, ç'mund të bëjmë akoma ndonjë gjë, për shembull, ku duhet krijuar ndonjë park i vogël etj. Këto mundësi ne duhet t'i shikojmë çdo vit, por, e përsëris edhe një herë, vetë populli mund të bëjë shumë më tepër për fëmijët, që nga edukimi e deri në organizimin për ta të parqeve e shesheve të vogla. Duke i parë me kujdes të gjitha mundësitë, mendoj që këto janë mjaft të mëdha, vetëm duhen zbuluar e duhen shfrytëzuar me kujdes e konsekuencë.

Mbrëmë, duke biseduar për këto probleme, ra fjala për vështirësitë që kanë dalë për sigurimin e fjetoreve për 500 konviktorët e universitetit, të ardhur mbi planin. Për këtë qëllim tani do të fillojnë ndërtimet, por mot ata do të bëhen dyfish. Çështja, pra, është

preokupante. Prandaj del problem i ngutshëm, ku do të flenë dhe ku do të hanë gjithë ky kontingjent shtesë? Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, si duket, nuk mendon sa duhet për këto probleme.

Në konviktet e universitetit më thonë se ambientet nuk mbahen pastër, qendrat e zërit nuk punojnë etj. Nëse është kështu, çfarë bën nga ana e vet organizata e rinisë, pse nuk mobilizohen vetë studentët për ta rregulluar gjendjen? Ata marrin pjesë dhe punojnë shumë mirë për ndërtimin e veprave të mëdha e të vështira, siç janë hekurudha e rrugë, punojnë pa u lodhur për elektrifikimin e fshatrave, kurse aty ku vetë banojnë e mësojnë për elektricitet, për ndërtim etj., si shpjegohet që nuk marrin iniciativën për të riparuar qendrën e zërit ose instalimet hidraulike? Këto janë disa iniciativa që ata mund t'i marrin fare mirë vetë, pa pritur të bëhet çdo gjë nga shteti.

Këto qëndrime tregojnë se mësimet revolucionare të Partisë për pjesëmarrjen e rinisë në punë, në prodhim etj., nuk po futen thellë si duhet te të rejat dhe të rinjtë tanë. Nuk e kam fjalën për ngritjen e një ndërtese për konvikt. Kur nuk ka ndërtesa, dakord, do të ndërtohen të reja, por për sa u përket gjithë këtyre që përmenda e shumë të tjerave si këto, nxënësit, rinia, studentët duhet të marrin iniciativa e të bëjnë me forcat e tyre ato për të cilat flasin aq shumë se i kanë të gjitha mundësitë. Natyrisht, kur rektorati ose pedagogët janë për të kritikuar, duhet të kritikohen edhe ata, por jo të ngrihen studentët e të flasin vetëm për pedagogët, kur për veten e tyre nuk janë në rregull dhe nuk bëjnë autokritikë. Një qëndrim i tillë nga

ana e të rinjve nuk është i drejtë. Të rinjtë duhet të mësohen si revolucionarë, të kritikojnë më parë të metat e dobësitë e tyre, t'i përvishen punës, të bëjnë të gjitha ato çka mund të bëjnë vetë dhe të mos presin nga të tjerët, pastaj le të kritikojnë dobësitë e të metat e pedagogëve, të rektoratit e të Ministrisë së Arsimit e të Kulturës, kur nuk i parashikojnë me kohë gjërat.

Për këtë problem të rëndësishëm që diskutuam, populli, masat, shoqëria me ndihmën e shtetit, por sidomos e në radhë të parë vetë me iniciativën e tyre, mund të bëjnë më shumë. Ne duhet ta mbajmë vazhdimisht ngritur këtë problem se është jetik, ta zgjidhim sa të jetë e mundur më mirë, mbasi është në interes të edukimit të brezit të ri, brezit të ardhshëm të vendit tonë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TA ÇOJMË EDHE MË PËRPARA REVOLUCIONIN TEKNIKO-SHKENCOR

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 tetor 1968

Është pozitiv fakti që direktivat e Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror të Partisë kanë vënë në lëvizje klasën punëtore dhe inteligjencien, sidomos atë të prodhimit. Tani na shtrohet detyrë që, duke u mbështetur në përvojën e arritur, ta çojmë edhe më përpara revolucionin tekniko-shkencor. Për shumë aspekte të këtij problemi, në këtë mbledhje të Byrosë Politike u vu në dukje një eksperiencë e madhe dhe e mirë, u vunë në dukje edhe sukseset që kemi arritur, të cilat janë inkurajuese, por edhe gabimet e vërtetuara, si dhe vështirësitë që janë hasur.

1 Në këtë mbledhje, në të cilën raportuan komitetet e Partisë të rretheve Tiranë, Korçë e Berat, u diskutua si punohej për zbatimin e vendimeve të Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror të PPSH për edukimin dhe aktivizimin e inteligjencies lidhur me kuptimin dhe zbatimin e detyrave që dilnin nga zhvillimi i revolucionit tekniko-shkencor.

Natyrisht, ecja përpara në këtë fushë do të bëhet edhe me vështirësi e me luftë. Duhet të bëjmë përpjekje që të gjitha mjetet, sidomos materialet që kërkohen lidhur me perspektivën e zhvillimit të mëtejshëm më të madh të revolucionit tekniko-shkencor në industri dhe në bujqësi, t'i gjejmë, po është e kuptueshme, gjithashtu, se do ta kemi vështirë t'i gjejmë të tëra. Megjithatë, në të ardhmen mendimi krijues i masave dhe i kuadrove do të ecë edhe më përpara, kurse realizimi i tyre konkret në jetë mund të mos ndjekë të njëjtin vrull e ritmin e duhur; ai, natyrisht, do të bëjë përpara, por mendoj se, që të realizohen të gjitha perspektivat e mëdha që na hapi Plenumi i 3-të i KQ të PPSH, do të duhet të kalojë një periudhë kohe.

Diskutimet për këtë problem në mbledhjen e sotme të Byrosë Politike përbëjnë një material jashtëzakonisht të vlefshëm, prandaj propozoj që të gjitha këto t'ia japim bazës nëpërmjet një aktivi ose konference kombëtare, si mendim krijues të masave që luftojnë për zbatimin e orientimeve të Partisë. Kështu do ta ndihmojmë bazën të shikojë, së pari, përparimet e arritura dhe, së dyti, të metat, gabimet që vihen re, si dhe luftën që ajo duhet të bëjë akoma për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes dhe për zhdukjen e të metave dhe gabimeve qofshin këto për shkaqe objektive, qofshin për shkaqe subjektive, si dhe të nxjerrë detyra që i takojnë së ardhmes. Është e nevojshme që për përcaktimin e këtyre detyrave të përgatitet një material, por mendoj që ky të mos bëhet në format e zakonshme e me fjalë të përgjithshme.

Diskutimet që bënë sot shokët mendoj se ishin

shumë konkrete. Natyrisht, çështjet që u ngritën në diskutime duhen zgjedhur, klasifikuar e përpunuar, se nëpër to ka edhe përsëritje që duhen evituar, por, duke i qëndruar besnik, në vija të përgjithshme, raportit që u diskutua në Byronë Politike, me materialin që do të përgatitet, mund t'u japim Partisë dhe punonjësve një orientim të qartë për të parë ku jemi në këtë fushë dhe ku duhet të shkojmë pas kësaj pune, ç'rrugë duhet të ndjekim, pa rënë në teorizime. Ai që interesohet për teorinë le të përpiqet ta gjejë, po njerëzit dëshirojnë të shohin ku i kemi dobësitë, të metat dhe pengesat që nuk na lejojnë të ecim edhe më përpara në fushën e revolucionit tekniko-shkencor. Kështu mendoj unë të paraqiten çështjet, dhe kjo është një punë që duhet bërë urgjent, me qëllim që njerëzit në bazë të shohin ku çalon puna diku lart, për shembull, në ministri dhe atëherë të ndalemi këtu, të shohim edhe të mirat, edhe të metat, po të dalin, gjithashtu, një nga një edhe të mirat e të metat e bazës.

Disa prej problemeve që janë të njëllota, pra, mund të bashkohen, të tjerat, me karakter të ndryshëm dhe që kanë rëndësi të madhe, të paraqiten veç e veç, duke pasur parasysh që në material të jepet edhe rru-gëdalja, në mënyrë që, në bazë të kësaj analize, jo vetëm të zhvillohet më tej puna ideopolitike, të kaliten kuadrot etj., por pastaj nga organet e Partisë dhe të shtetit të merren edhe masa për realizimin e tyre. Të gjithë jemi të mendimit, për shembull, që në ndërmarrjet të krijohen byro teknologjike, atëherë pse të mos merren masa menjëherë, në mënyrë që teknikët, specialistët, inxhinierët, kryeinxhinieri etj., të merren

më tepër me prodhimin, të ndjekin anën teknike në prodhim, dhe jo të harxhojnë kohën me çështje që i takojnë t'i bëjë administrata? Në raport ngrihet problemi se dikasteret frenojnë propozimet e novatorëve dhe të racionalizatorëve duke mos bërë përpjekjet e duhura për vënien e tyre në jetë. Pse ndodh kështu? Nuk është vetëm çështje fondesh mendoj unë. Edhe këto kanë rëndësi; jashtë limiteve të caktuara dikasteret s'mund të veprojnë, ndryshe do të kërkonin fonde shtesë nga Qeveria, por brenda kompetencave të njohura, brenda mundësive që ekzistojnë, rezultatet duhet të jenë më të mëdha. Ç'rol luan në këtë mes inteligjencia teknike? Ajo duhet të jetë mbështetje kryesore, jo vetëm në fjalë, por, duke vënë në shërbim të çështjes njohuritë e saj, t'i mësojë novatorët, që niveli i tyre teorik të ngrihet, t'u rekomandojë literaturën përkatëse, bile të bashkëpunojë me mjeshtrat në ndërmarrje e ku të jenë.

Mirëpo konstatohet se s'ndodh kurdoherë kështu. Literatura shkencore e teknike, sidomos ajo e përkthyer, është përqendruar në disa duar, sidomos pranë dikastereve, kështu që zor se arrin deri në bazë. Mos vallë këtu pengon metoda e organizimit nga ndonjë element intelektual që punon në ministri, i cili, për t'iu ruajtur qarkullimit, fjala vjen, e monopolizon «punën shkencore», që të hiqet si «kokë e madhe»?

Këto probleme të rëndësishme duhet t'i përcaktojmë e t'i theksojmë mirë, të kritikojmë ngurrimet që shfaqen, sepse na pengojnë të çojmë përpara mendimin shkencor e prodhimin.

Mjaft nga drejtuesit e ndërmarrjeve nuk e kanë

nivelin e duhur teknik dhe as aftësinë për të drejtuar në nivelin e duhur shkencor, por kanë vetëm shpirtin praktik e artizanal dhe shohin vetëm ç'duhet bërë sot për sot. Çfarë duhet të bëjmë që ta ndryshojmë gjendjen? Krijimi i byrove teknologjike, siç u tha këtu, do të ndihmojë për ta vënë prodhimin në baza shkencore, po do të ndikojë edhe në organizimin e në drejtimin e punës në tërësi. Sidoqoftë mund të ketë mendime e probleme të reja që përsëri, ndoshta, do të lindë nevoja për t'i parë edhe një herë, mund të ketë përsëri ndonjë vërejtje për të përcaktuar më mirë se sot ndonjë çështje etj., prandaj gjatë kësaj kohe shokët që do të merren me materialin që na duhet, të punojnë për të përgatitur diçka të mirë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

QËNDRIMET E GABUARA TË UDHËHEQËSVE KINEZË NUK JANË TË RASTIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 tetor 1968

Problemi për të cilin po diskutojmë ka rëndësi të veçantë për Partinë dhe për vendin tonë. Ato çka shprehu Çu En Lai janë pikëpamje dhe qëndrime në dëm të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, të revolucionit, të luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, në dëm, gjithashtu, edhe të vendit dhe të Partisë sonë, që mbajnë, vazhdimisht, lart të pastër flamurin e marksizëm-leninizmit dhe që po i tregojnë gjithë botës, si dhe vetë miqve kinezë, se sa të vendo-

1 Në këtë mbledhje u diskutua për një incident të ri që provokoi Kryetari i Këshillit të Shtetit të RP të Kinës, Çu En Lai gjatë qëndrimit të delegacionit të PPSH dhe të Qeverisë së RP të Shqipërisë që ishte në Kinë në shtator-tetor 1968. Delegacioni kryesohej nga Beqir Balluku.

Në librin «Shënime për Kinën», më 15 tetor 1968, shoku Enver Hoxha shkruante: «Çu En Lai, duke biseduar me Beqir Ballukun për situatën ndërkombëtare dhe veçanërisht mbi situa-

sur janë populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë për të mbrojtur vendin e vet, socializmin, marksizëm-leninizmin, revolucionin, sa të vendosur janë ata për të ndihmuar lëvizjen komuniste ndërkombëtare deri në sakrificat më të mëdha.

Të arrish në një konkluzion të tillë, sipas të cilit Partia e Punës e Shqipërisë mund të lidhë aleanca miqësie me armikun më të madh të socializmit dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë, me babanë e revizionizmit modern, Titon dhe titizmin, do të thotë se Çu En Lait i ka munguar edhe takti më elementar për të fshehur një mendim të tillë antimarksisht dhe antishqiptar. Kjo ngjarje na bën të mendojmë edhe një herë se Çu En Lai, në pikëpamjet e tij ideologjike dhe politike, është një revizionist, është një antimarksisht.

Këtë mendim për Çu En Lain nuk e kemi krijuar tani dhe nuk është pa baza. Ky mendim na ka lindur për arsye se në të gjitha marrëdhëniet me ne, ai vazhdimisht ka shfaqur pikëpamje të tilla, është dalluar

tën e krijuar në Ballkan pas invadimit të Çekoslovakisë, propozoi që të hynim në tratativa me titistët dhe të nënshkruanim me ta një traktat miqësie dhe ndihme reciproke!» (Shih: Enver Hoxha «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 411 dhe 419).

Siç u zbulua dhe u argumentua më vonë, Beqir Balluku, agjent i vjetër i jugosllavëve, komplotist dhe armik i egër i Partisë dhe i popullit, në «tezat e zeza» iu kundërvu parimeve strategjike dhe taktike të Partisë për mbrojtjen. Në mënyrë të fshehtë, së bashku me puçistët e tjerë dhe me kryeagjentin Mehmet Shehu ata punonin për realizimin e planit të tyre tradhtar. Vigjilenca e Partisë e shpëtoi vendin nga këta komplotistë të rrezikshëm, të cilët morën dënimin e merituar.

për qëndrime antishqiptare, antimarksiste dhe revizioniste ndaj Shqipërisë. Pikëpamje të tilla na i shprehu në Moskë, apo ato që më vonë, me brutalitet dhe me siguri të madhe ia shfaqti ambasadorit tonë në Pekin¹, duke vepruar sikur Partia dhe vendi ynë ishin shërbëtorë të fundit të tyre. Ai ka vepruar në këto raste pikërisht ashtu siç mund të veprojë një borgjez kapitalist. Natyrisht, ne u kemi dhënë përgjigjen e duhur të gjitha shfaqjeve e qëndrimeve të tij antimarksiste ndaj Partisë dhe vendit tonë.

Më vonë mësuam nga Kan Sheni se ato që kishte thënë Çu En Lai nuk ishin vetëm mendimet e tij, por edhe të Mao Ce Dunit. Se si e ka dhënë këtë mendim Mao Ce Duni nuk e dimë, por dimë atë që na tha Kan Sheni, se Maoja për këtë ka qenë në dijeni, megjithatë ne i drejtuam kritikën tonë të ashpër Çu En Lait.

Puna është se në të gjitha bisedimet që kanë pasur delegacione të ndryshme të Partisë dhe të Qeverisë sonë në Kinë, duke përjashtuar pritjet dhe përcjelljet, pra, fasadën, për problemet konkrete që kanë shtruar

¹ Pas rrëzimit të Hrushovit, gjatë takimit me një grup ambasadorësh në Pekin, Çu En Lai, në mënyrë brutale, i kërkoi ambasadorit tonë të dërgonim delegacionin në Moskë, pa marrë parasysh cilat do të ishte pikëpamja e PPSH për këtë çështje.

Lidhur me këtë, shoku Enver Hoxha shkruan në Ditarin Politik: «Është absurde dhe e papranueshme që, pa një konsultim të tillë paraprak, të dalë Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës dhe të na thotë neve: «Kam gjykuar kështu, kam vendosur kështu dhe pra ti më ndiq mua si manar i bindur» (Shih: Enver Hoxha. «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 137).

delegacionet tona, Mao Ce Duni ka shprehur pikëpamjet e tij në përgjithësi, ndërsa Çu En Lai me shokë kemi konstatuar se kanë qenë kurdoherë në kundërshtim me ne. Ata janë përpjekur të na imponojnë mendimet e tyre, po në çdo rast kanë marrë përgjigjen e duhur nga ana jonë. Natyrisht, ata, pastaj, janë tërhequr, po ne nuk i kemi lënë pa analizuar përpjekjet e tyre dhe kemi dalë në konkluzione të drejta, kemi qëndruar kurdoherë vigjilentë dhe mendoj që kemi bërë shumë mirë, bile vazhdimisht duhet të jemi vigjilentë në këtë çështje.

Megjithatë, jemi përpjekur njëkohësisht që në çështje kryesore, që kanë të bëjnë me miqësinë, me aleancën, me luftën kundër imperializmit amerikan, revizionizmit modern dhe reaksionit, të bëjmë kujdes, të jemi bashkë me ta, kurse pikëpamjet që për ne kanë qenë të kundërshtueshme, të papranueshme, armiqtësore, nuk ua kemi pranuar.

Ata kanë ndjekur ndaj nesh një taktikë trockiste: çdo delegacioni të udhëheqjes sonë, aq sa kanë mundur, janë përpjekur t'i imponojnë pikëpamjet e tyre, janë orvatur njëkohësisht ta komprometojnë, janë mundur në çdo rast të tatojnë pulsën, për të parë nëse kemi unitet me njëri-tjetrin në udhëheqje apo jo. Metoda të tilla, është e qartë, janë tipike trockiste.

Si ua nxuri goja sa të arrijnë të na sugjerojnë që të lidhim marrëveshje me titistët? Kjo është një çështje e madhe, në radhë të parë ideologjike. Sipas kësaj qëndrimi, gjersa mendojnë se marksistët mund të lidhin aleanca me armiqtë e socializmit, duhet të dalim në konkluzionin se, të paktën ideologjikisht, udhë-

heqësit kinezë nuk janë të qartë, kurse Çu En Lai me disa të tjerë jemi të bindur që janë krejtësisht në kursin revizionist.

Nga të gjitha këto që vëmë re mundet dhe duhet të supozojmë se edhe vetë Mao Ce Duni ka bërë gabime. Në qoftë se ai dëshiron të bëjë njëfarë paraqitje të koniunkturave, më parë duhet t'i analizojë mirë këto. Në qoftë se ai lë Çu En Lain t'i analizojë, përsëri gabon, dhe në qoftë se nuk e njeh kush është Çu En Lai, prapë është në rrugë të gabuar. Ca më keq nëse e njeh dhe e lejon të flasë, atëherë bën një gabim akoma më të madh.

Sidoqoftë, si konkluzion kam mendimin se Çu En Lai është kokë e këmbë revizionist, kurse Mao Ce Duni një udhëheqës që ka bërë gabime. Mbase ky akoma nuk ka arritur dot të thellohet mirë, në rrugën marksiste-leniniste, për çështjen e shfrytëzimit të koniunkturave dhe të aleancave. Jo vetëm kaq, por mendoj se edhe strategjinë dhe taktikën nga ana ushtarake dhe ideologjike, nuk i koncepton drejt. Këto që themi për ta i bazojmë në aq sa dimë. Kur Maoja sugjeron t'i shfrytëzojmë koniunkturat, kjo është e pranueshme parimisht, por kur shkon më tutje dhe thotë se Titoja, Dubçeku, Çaushesku e të tjerë janë aleatët tanë të tërthortë, Mao Ce Duni mendon gabim.

Tani shtrohet çështja nëse këto konkluzione që Çu En Lai vjen e na i servir neve i kanë diskutuar konkretisht në udhëheqje shokët kinezë apo jo. Ne mendojmë se ka të ngjarë të jenë diskutuar. Përderisa për këto çështje kishte dijeni Kan Shenit dhe na foli për to, kjo tregon se janë diskutuar.

Veçanërisht për Titon, mendoj unë, udhëheqësit kinezë qëndrojnë akoma në pikëpamjet e tyre të vjetra. Ato pikëpamje na i kanë shprehur qysh kur ishim në Pekin në vitin 1956 dhe ne nuk ua pranuan, por ua hodhëm poshtë. Shkurtimisht, e mbani mend se Mao Ce Duni na tha atëherë sikur Titoja nuk paskësh gabuar, po ishte Stalini ai që kishte gabuar.

Në luftën ideologjike të zhvilluar që nga viti 1956 e gjer në pushtimin e Çekoslovakisë nga trupat sovjetike, dukej sikur udhëheqësit kinezë patën një evolucion në pikëpamjet e tyre si ndaj revizionizmit sovjetik, ashtu edhe ndaj Titos. Por tani shohim përsëri se bindjet e udhëheqësve kinezë ndaj Titos, që për ne është e qartë se është armik shumë i rrezikshëm, nuk janë plotësisht të thella e të patundura. Ata mendojnë se mund të bashkëpunohet me të, bile mund të lidhen edhe traktate.

Këtu, sigurisht, del edhe qëndrimi i tyre ndaj Stalinit, për të cilin shokët kinezë aty-këtu në dukje flasin mirë, por kur i futesh brenda kësaj çështjeje, ndryshon puna. Çu En Lai erdhi apostafat për të na bindur se Stalini paskësh gabuar, por nuk na bindi dot. Pra, nxjerrim konkluzionin se udhëheqësit kinezë nuk kanë arritur të analizojnë si marksistë-leninistë si anët e shumta pozitive të Stalinit, ashtu edhe ndonjë të metë të tij. Në qoftë se ai ka pasur të meta, udhëheqësit kinezë që hiqen si marksistë-leninistë, duhet të thonë ku i ka konkretisht ato. Për ne kjo është një çështje serioze që duhet të na bëjë të mendojmë thellë.

Por, nga ana tjetër, në luftën kundër revizionizmit sovjetik, udhëheqësit kinezë duken si të vendosur, me-

gjithëse kjo luftë nuk është me baza parimore të palëkundura politike dhe ideologjike marksiste-leniniste, në atë nivel që e bën Partia jonë, pse në këtë luftë mund të themi se nga ana e tyre kanë dalë edhe tendenca shoviniste antiruse, antisovjetike. Kushdo që del kundër revizionizmit sovjetik, kinezët e konsiderojnë si aleat dhe, sipas tyre, duhet afruar me ta. Këtë e shpjegojnë me çështjen e shfrytëzimit të koniunkturave. Kjo do të thotë se tek udhëheqja kineze nuk është kristalizuar akoma si duhet, në baza ideologjike dhe politike, vija që duhet ndjekur kundër revizionizmit modern. Kjo i bën ata që të shkelin parimet strategjike dhe taktike të vijës marksiste-leniniste në luftën kundër revizionizmit modern.

Duke na sugjeruar për të lidhur marrëveshje me Jugosllavinë, ata nuk u thelluan aspak si do ta presim një gjë të tillë ne, shqiptarët, që kemi 20 e ca vjet që luftojmë me të drejtë dhe dhëmb për dhëmb me këta armiq kaq të tërbuar të socializmit, të cilët, duke u mbështetur në aleancat e në marrëveshjet që kemi pasur me ta dhe që për këtë arsye i kemi prishur, prej kohësh, janë përpjekur vazhdimisht për të ndërhyrë në punët e vendit tonë, për të shkatërruar Partinë tonë dhe për ta kthyer Shqipërinë në një republikë të shtatë jugosllave.

Si mund të mendojnë e të na sugjerojnë shokët kinezë të bëjmë aleancë me Titon, këtë tradhtar të marksizëm-leninizmit dhe agjent të hapët të imperializmit, që edhe ata vetë e kanë deklaruar si të tillë, por që nuk qëndrojnë në ato që thonë, pse flasin ndryshe sot e ndryshe nesër, siç e kanë zakon revizionistët.

vendimtare duhet ta bëjë Republika Popullore e Kinës. Mirëpo ajo sot nuk e bën si duhet një politikë të tillë. Udhëheqësit kinezë e justifikojnë këtë se janë të zënë me punët e Revolucionit të Madh Kulturor Proletar. Mirëpo politika ndërkombëtare, lufta politike dhe ideologjike kundër armiqve, nuk pret sa të përfundojë ky «revolucion». Ky qëndrim nga ana e Kinës është një minus për luftën tonë, për çështjen e revolucionit në botë. Është e vërtetë që Kina ka pasur vështirësi të brendshme, sidoqoftë, ky qëndrim që mban ajo është prapë një minus, një qëndrim në vend.

Te shtetet që hiqen si asnjane dhe që gjer në njëfarë shkalle janë të dispozuara të tregohen dashamirë ndaj Shqipërisë dhe Kinës, si dhe në rrethet demokratike e përparimtare të tyre, Qeveria jonë ka fituar një simpati të madhe, për arsye se ajo kurdoherë i ka përkrahur vazhdimisht në çdo hap që kanë bërë për të hedhur poshtë orvatjet e imperializmit ndërkombëtar dhe të revizionizmit modern për të skllavëruar vendet e tyre. Një mbështetje të tillë ato e kërkojnë sidomos nga Kina, e cila ka mundësi t'u japë edhe ndihmë konkrete politike e materiale. Ka ajo ose nuk ka mundësi sot për sot ta japë këtë ndihmë, ky është një tjetër problem, por ajo që ka rëndësi është çështja që ndihma politike, afrimi dhe njëfarë ndihme materiale që Kina u ka dhënë këtyre shteteve të reja nuk ka qenë e ndjeshme dhe e fuqishme në atë masë sa këto të shihnin dhe të shohin se në këtë botë rron e vepron edhe një shtet i madh socialist që i ndihmon me aq sa ka, po në të ardhmen ajo përsëri do t'u japë edhe më shumë.

Imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë livadhysin mbi këto vende të reja, i frikësojnë, ndrydhin e topitin forcat e tyre, pse ato nuk shohin forcën e madhe dhe ndihmën e vazhdueshme të Kinës që të marrin gjallëri e të hidhen më me guxim përpara. Veç kësaj, ndihma e Kinës në drejtim të këtyre vendeve duhet të jetë e zgjuar e jo të bëhen përpjekje për t'u futur njerëzve në xhep paketat me libra që përmbajnë citatet e Mao Ce Dunit. Këto vende dhe këta popuj, pra, kanë nevojë të dëgjohet fjala jonë.

Në këto koniunktura udhëheqësit kinezë mendojnë se nga të dyja këto fuqi të mëdha, më e dobëta duhet të shpartallohet. Të godasësh e të bësh të parrezikshëm më të dobëtin që në rast të vështirë t'i kesh të mbrojtur krahët është një gjë e mirë, por kjo duhet bërë kurdoherë duke ruajtur, medoemos, parimet.

Udhëheqësit kinezë, armiq të tyre kryesorë konsiderojnë revizionistët sovjetikë dhe, në një shkallë më të vogël, imperialistët amerikanë. Po ta gjykojmë këtë çështje objektivisht, nuk është ashtu si mendojnë ata. Imperializmi amerikan, me armatimet dhe eksperiencën si agresor nuk është më pak i rrezikshëm nga socialimperializmi sovjetik. Në qoftë se Bashkimi Sovjetik nga ana e kinezëve konsiderohet si armiku më i madh që mund të futet në një aventurë kundër Republikës Popullore të Kinës, hrushovianët nuk mund të mos kenë parasysh në këtë rast rrezikshmërinë e madhe që do t'u vinte nga ana e imperializmit amerikan, i cili, si kurdoherë, përpiqet e do të përpiqet t'i futë ata në luftë me Kinën. Pikërisht për këtë arsye dhe për të ruajtur krahët në Evropë, revizionistët sovjetikë tani

po bëjnë një punë të gjithanshme për të forcuar vijën e kufirit në përfundim, përpiqen të sigurojnë baza për flotën e tyre në Mesdhe etj.

Mundet që imperializmi amerikan dhe Bashkimi Sovjetik ta sulmojnë Kinën edhe të dy së bashku. Mund të duket në këtë rast sikur kontradiktat midis amerikanëve dhe sovjetikëve janë shumë të vogla. Po t'i hedhim një sy historisë së dy luftërave botërore, në të cilat kanë marrë pjesë edhe vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të shohim se këto kurdoherë janë përpjekur të nxjerrin gështenjat nga zjarri me gjakun dhe me sakrificat e njerëzve të vendeve që ishin aleate të tyre. Aleatët e tyre në Evropë, pasi i futën në luftë, në fillim i kanë «ndihmuar» vetëm me armë dhe kur ata kanë shkrirë të gjitha forcat, atëherë, në fund të dasmës, kanë ndërhyrë ushtarakisht imperialistët amerikanë.

Janë vallë tani në gjendje imperialistët amerikanë të sulmojnë Kinën kontinentale, të ndërlikohen në një luftë të pambaruar me të? Një gjë të tillë mund edhe ta bëjnë, po konstatojmë se edhe në Vietnam, ku kanë shpënë më se gjysmë milioni ushtarë, ata janë futur në një luftë nga e cila nuk po dalin dot. Prandaj, për të sulmuar Kinën, do t'u duhet të futin vetë forca shumë herë më të mëdha, të futin në valle të gjitha forcat e tyre, edhe ato atomike, si edhe Japoninë, Australinë etj.

Të mos harrojmë se s'duhet përjashtuar mundësia të vërtetohet edhe ajo që ka thënë Stalini, që lufta të shpërthejë më parë në mes vetë dy grupeve imperialiste. Dhe mundësia që të acarohen kontradiktat midis

vetë këtyre dy fuqive imperialiste ekziston, pastaj, ai që do të fitojë, t'i futet Kinës, por atëherë lufta do të kthehej në një luftë çlirimtare për popujt.

Në këto situata, shokët kinezë, me konsideracionet ideologjike e politike që ushqejnë dhe në gjendjen aktuale konkrete, kanë tendencën të bashkohen me cilindo që është kundër revizionistëve sovjetikë, pra, edhe me Rumaninë, me Jugosllavinë etj., se të gjitha këto, sipas kinezëve, qenkan aleate të tyre kundër Bashkimit Sovjetik. Kjo do të thotë të shkelësh parimet, të forcosh fuqinë e imperializmit amerikan, pse për ne është fare e qartë ku shkon Çaushesku, lëre pastaj Titoja, ose ku do të vejë nesër Kadari. Është evidente që këto çështje ata nuk i kanë të qarta.

Ne, veç luftës së papajtueshme ideologjike jemi edhe kundër synimeve e orvatjeve të revizionistëve sovjetikë për të sulmuar popujt e Ballkanit. Kjo është një çështje parimore. Sikur Bashkimi Sovjetik të sulmojë Jugosllavinë dhe në rast se kjo hidhet në luftë kundër agresionit, s'ka dyshim se ne jo vetëm do të jemi gati për t'u mbrojtur vetë nga rreziku që do t'i afrohej vendit tonë, po ne do të mbështetim në këtë rast Jugosllavinë, do të përkrahim luftën e popujve të Jugosllavisë për çlirim nga pushtimi sovjetik etj. Në rast se revizionistët sovjetikë do të sulmojnë edhe vendin tonë, ne do të luftojmë për mbrojtjen e atdheut gjer në fund kundër të njëjtit armik. Udhëheqësit kinezë nuk e kanë menduar këtë, prandaj kur sugjerojnë që, po plasi lufta, ne duhet të hidhemi edhe jashtë kufijve të territorit tonë, pra, të lëmë portat e vendit tonë hapur e të na i zënë sovjetikët, ose kur na thonë

të mos shqetësohemi, të rrimë rehat, se sovjetikët nuk mund të na sulmojnë, pse në këtë rast ne do të kemi me vete jo vetëm Titon, por edhe Italinë, e cila nuk na sulmon, kjo do të thotë të krijohet nga ne në këtë mënyrë një aleancë e heshtur me italianët, si pasojë logjike edhe me partnerët e tjerë të saj të NATO-s, bashkë me Titon, se edhe ky, siç e dimë, është aleat i NATO-s, pra, të jemi në një anë të barrikadës edhe me amerikanët që bëjnë pjesë në këtë organizatë, të cilët do ta ndihmojnë Jugosllavinë.

Me këtë që i kanë sugjeruar Shqipërisë udhëheqësit kinezë, veç të tjerash, janë treguar të frikshëm, por qëndrimi i vendosur e parimor marksist-leninist i Partisë dhe i shtetit tonë, lufta e popullit shqiptar gjer në sakrificën e fundit kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për të gjithë popujt. Çu En Lai nuk ka besim në vendosmërinë e Partisë dhe të popullit tonë dhe me hapin që bëri ka menduar të na futë frikën. Duke thënë se «sivjet nuk ka ndonjë rrezik, po nga gjashtëmuji i parë i vitit që vjen, kur të jetë zgjedhur edhe presidenti i ri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, atëherë Shqipëria do të jetë në rrezik», ai u përpoq të na bëjë një shantazh të madh. Me këtë ai indirekt na thotë: «Ju shqiptarët, oburra, hidhuni andej, bëhuni njësh me revizionistët».

Shokë, ne jemi në rrugë të drejtë. Udhëheqësit kinezë nuk na e hedhin dot, ne nuk biem në grackën ku duan të na futin. Artikulli i shokut Hysni [Kapo] me rastin e 60-vjetorit të datëlindjes sime ishte një përgjigje për ta. Edhe unë, kur erdhi më uroi me këtë rast më 16 tetor i ngarkuari me punë ad interim i

Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri, i fola, gjithashtu, me të njëjtën gjuhë.

E theksoj edhe një herë shokë, kjo çështje të mbetet tani për tani në Byronë Politike, për të mos u acaruar më tej gjendja me udhëheqjen kineze. Unë mendoj se pas gjithë këtyre përgjigjeve, ata do ta mbyllin gojën për ca kohë. Ne nuk e kemi akoma të qartë sa thellë ka reflektuar Mao Ce Duni për këtë çështje. Sidoqoftë, koha do të tregojë se ç'rruge i janë futur udhëheqësit kinezë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PROCESI I JETËS SONË E BASHKË ME TË EDHE SHKOLLA, ECIN NË RRUGËN E PAPERË TË ZHVILLIMIT

Nga biseda me shokun Ramiz Alia

30 tetor 1968

Në studimin që kam paraqitur me shkrim në mbledhjen e Byrosë Politike të datës 7 mars të këtij viti, e kam konceptuar revolucionarizimin e shkollës në këto drejtime kryesore: në sistemin, në brendinë, në strukturën dhe në zgjerimin masiv të shkollës sonë.

Lidhur me të gjitha këto mendoj që ne të kemi parasysh këto tri çështje:

Së pari, çështjen e marksizëm-leninizmit, i cili në shkollë duhet të studiohet edhe më vete si shkencë, por edhe nëpërmjet të gjitha lëndëve të tjera. Me marksizëm-leninizmin, si bosht kryesor, të lidhen organikisht të gjitha lëndët mësimore.

Së dyti, çështjen e punës prodhuese si faktor revolucionarizues dhe kalitjeje ideologjike të rinisë shkollore.

Së treti, përgatitjen e rinisë shkollore, në mënyrë të organizuar, për mbrojtjen e atdheut.

Në studimin që kam paraqitur me shkrim kam

vënë në dukje se sistemi i vjetër i shkollës sonë ka edhe anët e tij të mira, po ka edhe të këqijat e veta etj. Aty kam theksuar se rrethanat kanë qenë të tilla që na kanë detyruar ta bëjmë studimin në drejtimet që thashë, të cilin shokët e arsimit tani duhet të punojnë për ta konkretizuar. Neve na duhej, pra, ta analizonim sistemin e vjetër të shkollës me të mirat dhe me anët e tij negative. Por lidhur me këtë, kur vjen çështja për piramidën, kjo nuk do të ndryshojë as në sistemin e ri. Pra, te ne do të ekzistojnë, edhe në të ardhmen, shkolla fillore, tetëvjeçarja, e mesmja dhe shkolla e lartë. Ne jemi të bindur se kjo piramidë është ndërtuar mirë.

Por është e domosdoshme të sqarohen dy çështje, të cilat nuk duhet t'i konfundojmë me njëra tjetrën.

Ne ndërtojmë një sistem të ri shkollor për gjithë rininë e vendit tonë. Me këtë sistem do të fillojmë që kur të vihet në zbatim dhe gjersa të lindë nevoja për të bërë përsëri ndryshime, më vonë, në rrethana të tjera. Sistemi i ri nuk bën dallime midis qytetit dhe fshatit, midis rinisë që ndjek shkollën dhe asaj që punon. Ky është një sistem arsimit unik për gjithë rininë që rritet në socializëm në kushtet kur në vendin tonë shkojmë drejt likuidimit të klasave.

Të rinjtë dhe të rejat që ndjekin shkollat tona, ne i kalitim, i bëjmë revolucionarë, i përgatitim të jenë sa më afër punëtorëve dhe fshatarëve. Me masat që marrim në të gjitha drejtimet synojmë, gjithashtu, që qyteti me fshatin të afrohen sa më shumë, që dallimet midis tyre të ngushtohen sa më shumë. I gjithë procesi i jetës te ne ecën në rrugën e paprerë të zhvillimit. Kë-

tij procesi i nënshtrohet edhe shkolla jonë. Përpara gjendja ishte ndryshe, se kanë qenë të tjera rrethana.

Çështja tjetër për të cilën dua të flas ka të bëjë me rininë që nuk përfshihet në këtë sistem, me atë rini që ka dalë në jetë e, jo vetëm me këtë, por edhe me të gjitha masat e tjera të popullit, që punojnë.

Sistemin e ri të arsimit ne e ndërtojmë, në radhë të parë, për të kalitur në shkollat e të gjitha niveleve një brez të tillë rinie që t'u shërbejë qëllimeve për të cilat fola, por ky sistem duhet të na shërbejë njëkohësisht edhe për gjithë masën tjetër të rinisë dhe të punonjësve që kanë dalë në jetë, që edhe ajo të ngrejë pa ndërprerje nivelin e saj arsimor e kulturor. Sistemi i ri i arsimit tonë ndjek, pra, këtë qëllim, duke pasur parasysh edhe rininë shkollore, po edhe ata që punojnë, domethënë brezin që ka dalë në jetë. Ky sistem plotëson kështu një boshllëk që ka pasur shkolla jonë më parë. Me këtë unë nuk kam parasysh që ne të ndërtojmë një sistem shkolle edhe për një shofer që nuk ka kryer as filloren po që ka 20 vjet në këtë profesion dhe mund të jetë 38 ose 40 vjeç, por edhe atij mund t'i krijojmë mundësinë të vazhdojë shkollën. Ndonjë mund të thotë se një njeriu të tillë me moshë e me stazh kaq të gjatë në punë nuk ka ç'i duhet kjo shkollë. Kjo pikëpamje nuk është e drejtë.

Një çështje tjetër është edhe rregullimi i proporcioneve ndërmjet nxënësve që do të vijnë në shkolla nga fshati dhe nga qyteti. Më parë, 80 për qind e nxënësve që futeshin në universitet vinin nga qyteti, për arsye se nga shkollat e mesme na dilnin pak fshatarë. Pra, në këto shkolla vinin më shumë bij të punëtorëve

dhe sidomos të nëpunësve, megjithëse shumica e tyre janë njerëz të besuar të Partisë, të luftës, me origjinë nga klasa ose jo, por fakti është se janë nëpunës. Megjithatë duhet thënë se vigjilenca e Partisë në të tëra këto situata që kemi kaluar ka qenë shumë e mirë.

Gjer ca kohë më parë ne i kishim shumë të pakta mundësitë për të hapur në shkallë të gjerë shkolla të mesme në fshat. Megjithatë, nëpërmjet bursave të dhëna nga shteti, tani në universitet 30 për qind të studentëve i sjellim nga fshati. Këtë çështje ne duhet ta studiojmë realisht në përqindje të veçanta dhe, gjer tani, Partia kështu ka vepruar. Ajo është treguar kurdoherë vigjilente, prandaj nuk janë krijuar rreziqe. Gjithashtu, të kemi parasysh se ndryshe nuk mund të vepronim, se na mungonin profesorët, mjetet dhe shkollat e mesme të nevojshme që të bëhej e mundur edhe për bijtë e bijat e fshatarëve të mbaronin shkolla të mesme, të ndiqnin edhe ata universitetin.

Tani kushtet kanë ndryshuar shumë në krahasim me përpara, prandaj mund dhe duhet të bëjmë një ndryshim në shpërndarjen e shkollave të mesme. Në këtë kategori shkollash kemi pasur më shumë gjimnaze, që mund të kenë qenë edhe të tepërt dhe këtë vërejtje kritike e kemi bërë. Këto rrethana kanë bërë që te studentët tanë të lindin disa shfaqje jo të mira. Megjithatë puna e Partisë forcohet vazhdimisht, lufta e klasave vazhdon si kudo edhe në shkolla. Sidoqoftë këto rrethana ne nuk duhet t'i harrojmë.

Duke pasur parasysh sa thashë dhe mbasi kushtet në vendin tonë tani kanë ndryshuar, neve na duhet ta bëjmë këtë studim, se arsimin tetëvjeçar aktualisht e

kemi të detyrueshëm edhe në fshat. Prandaj sot i kemi të gjitha mundësitë për ta zgjeruar më tej rrjetin e shkollave të mesme, të gjimnazeve e të shkollave të mesme profesionale, jo vetëm në qytet, po edhe në fshat, të ndryshojmë njëkohësisht edhe proporcionin e nxënësve që do të dërgohen në gjimnaze dhe në shkollat teknike, pra, të përcaktohet se sa do të jenë nga fshati dhe sa nga qyteti. Të gjitha shkollat e mesme, qoftë gjimnazet apo teknikumet, ne duhet t'i orientojmë nga teknika, nga teknika bujqësore dhe ajo industriale. Në rrethet që kryesisht janë qendra bujqësore do të ngremë teknikume bujqësore, në ato që kanë më shumë industri do të ngremë teknikume industriale e kështu me radhë.

Pra, mbasi arsimin e përgjithshëm tetëvjeçar tani e kemi të detyrueshëm, na del detyrë të zgjerojmë edhe arsimin e mesëm, duke synuar t'ia ndryshojmë atij fytyrën, ta bëjmë edhe këtë çdo vit e më masiv, por pa e bërë shkollën e mesme të detyruar me ligj, sepse për sistemin tonë arsimor aktualisht nuk shtrohet ky problem ashtu si shtrohet për arsimin tetëvjeçar. Në rast se vendosim të hapim, për shembull, një shkollë të mesme në Krutje, është e mira dhe me leverdi që atje të hapim një shkollë të mesme bujqësore, ku do të shkojnë për të mësuar jo vetëm nxënësit e kësaj kooperative, por edhe të tjerë, nga kooperativat rreth e rrotull. Në rast se kjo shkollë nuk do t'i plotësojë nevojat, atëherë mund të ngremë një tjetër si kjo gjetskë, dhe kështu me radhë të shkojmë duke e shtuar këtë tip shkolle.

Gjithashtu, përveç shkollave të mesme, mund të

ngremë edhe shkolla të ulëta profesionale dyvjeçare, me profile të ndryshme, sipas nevojave. Ata që do të mbarojnë tetëvjeçaren dhe nuk do të dëshirojnë të ndjekin shkollat e mesme profesionale t'i bindim, të bëjmë me ta punë sqaruese politike që të ndjekin këto shkolla të ulëta. Kështu ata do të marrin kulturë teknike etj., pra do të kenë një profil më të ngushtë. Këto shkolla nuk do t'i kemi të detyrueshme. Natyrisht edhe të gjithë nxënësit nuk i dërgojmë dot në to, se as mundësi për ta bërë këtë nuk kemi. Do të ketë nga ata që nuk do të dëshirojnë të venë në të tilla shkolla dhe një pjesë e tyre do të përqipen të futen në punë. Mirëpo ata që porsa kanë mbaruar tetëvjeçaren janë me moshë 14-15 vjeç dhe kanë akoma nevojë për mësim. Ata mund të punojnë dhe njëkohësisht të mësojnë, domethënë të ndjekin shkolla drejtpërdrejt nga prodhimi. Ne duhet të krijojmë kështu një rrjet shkollash të ulëta profesionale për degë të ndryshme, ku do të venë ata që do të kenë mbaruar arsimin e rregullt tetëvjeçar. Pra, në këto shkolla, ata do të profilizohen në drejtime të ndryshme sipas nevojave të ekonomisë së vendit.

Gjatë këtyre dy vjetëve nxënësve duhet t'u jepet edhe një dozë e domosdoshme kulture të përgjithshme, pra, të bëhet në këto shkolla pak kimi, biologji, fizikë, botanikë, në atë masë që do të shihet e nevojshme. Ky të jetë si një vazhdim i natyrshëm i programit. Këtë ta bëjmë qëllimisht që nxënësi të jetë i pajisur me ato njohuri të nevojshme, të cilat do t'i duhen për të ngjitur shkallët më të larta të sistemit tonë shkollor. Duhet pasur, gjithashtu, parasysh që nxënësi njëkohësisht duhet dhe do të punojë gjatë viteve të shkollës, po sa

kohë pune duhet të bëjë konkretisht dhe sa lëndë mësimore duhet të marrë gjatë këtyre dy vjetëve, kjo është një çështje tjetër që duhet llogaritur me kujdes nga organet e arsimit.

Është e ditur që do të ketë edhe njerëz që nuk do të duan të venë në të tilla shkolla, disa do të thonë «ç'më duhet mua kjo shkollë» etj. Këto pengesa do të dalin përpara, por jemi të bindur se me këtë sistem të ri arsimor ne nuk i mbyllim rrugën asnjë të riu, përkundrazi, dyert e shkollës janë të hapura për ta e për këdo që do të mësojë. Ne duhet t'i nxitim të rinjtë tanë që t'i ndjekin këto lloj shkollash. Çështja e marrjes së diplomës nga ana e tyre do të jetë pastaj një gjë formale. Mendoj se me këtë sistem ne do të arrijmë shpejt në masivizimin e shkollës së mesme, pa e bërë të detyruar, do të kemi mundësi ta kontrollojmë më mirë punën dhe askujt nuk ia mbyllim rrugën për të ndjekur studime më të larta.

Del pyetja: me këtë sistem shkollor masiv a ka ndonjë rrezik që punëtorët dhe fshatarët të mos na vijjnë në universitet? Mendoj se jo. Në këto teknikume do të mësojnë punëtorë, fshatarë dhe nëpunës, bile në një numër më të madh nga sa kemi mundësi të pranojnë në universitet. Jeta do të na tregojë që me këtë mënyrë ne do të përgatitim aq shumë kuadro, sa nuk do të kemi vend për të gjithë në universitet. Këta do të jenë njerëz të përgatitur në një profesion, dhe për këtë do të marrin diplomën përkatëse të teknikutit e do ta kenë të hapur rrugën për të hyrë, po të dëshirojnë e po të ketë vend, edhe në universitet. Por qëllimi ynë është që jo të tërë teknikumasit t'i dër-

gojmë në universitet, se sot kemi nevojë edhe për kua-
dro të mesëm. Periudha që po jetojmë nuk është e tillë
që të gjithë ata që kryejnë shkollën e mesme të venë në
universitet, sepse praktikisht nuk ka mundësi të bëhet.

Me këtë mënyrë realizohet masivizimi i shkollës,
përmirësohet raporti i shpërndarjes së nxënësve nëpër-
mjet ngritjes së teknikumeve, në fshat e në qytet, asnjë
nxënësi nuk i mbyllet rruga për të ndjekur arsimin më
lart dhe zgjidhet çështja e përbërjes së atyre që do të
venë në universitet.

Të rinjtë që kanë kryer arsimin tetëvjeçar, më vo-
në, po të duan mund të ndjekin edhe teknikumet e
natës, pse mundësitë i kemi dhe teknikume po ngremë
e do të ngremë të tjera në të ardhmen në qytete, në
fabrika e në uzina, kurse në kooperativa nuk do të
ngremë dot kudo. Megjithatë ne duhet të studiojmë
demografinë e vendit, të shohim në bazë të popullsisë
për sa shkolla të mesme ka nevojë ky ose ai rreth, çfa-
rë shkollash dhe a sigurohet kuadri përkatës për të
dhënë mësim.

Le të shikojmë tani mundësitë për të mësuar të
atyre që janë jashtë shkollës. Nuk e kam fjalën për
ata që janë futur në punë mbasi kanë kryer shkollën e
mesme. Edhe këta po të duan dhe po të plotësojnë
kushtet, mund të venë në universitet, po fjalën e kam
për ata që janë në punë dhe nuk e kanë kryer shkollën
e mesme dhe në këtë kategori punonjësish kemi akoma
një numër të madh. Por ndjekjen e universitetit ne
nuk duhet ta shtrojmë për një punëtor që ka mbaruar
vetëm filloren dhe që punon, për shembull, prej 20
vjetësh shofer. Këtij do të përpiqemi t'i japim, po të

dëshirojë, nocionet e domosdoshme për mekanikë, ose mund t'i japim pa ndërprerje nga puna disa njohuri të tjera që i duhen, se praktikisht profesionin ai e di shumë mirë. Edhe shoferi duhet të mësojë, po këtë mësim atij ne mund t'ia japim veç shkollave të natës edhe nëpërmjet kursesh kualifikimi. Qëllimi është ta ndihmojmë këtë njeri të kualifikohet. Ky kualifikim do ta ngrejë atë në një nivel më të lartë teknik. Në goftë se ai ka kapacitet e zgjuarsi dhe është shembull në punë mund ta vëmë edhe në funksion drejtues në një park ose në një uzinë, po, për moshën që kanë, këtyre njerëzve nuk duhet t'ua vëmë detyrë të vazhdojnë shkollat deri dhe universitetin. Qëllimi ynë është t'i kualifikojmë njerëzit në profesion edhe nëpërmjet kursesh të veçanta, pse të tërë nuk mund dhe nuk do t'i drejtojmë në universitet. Edhe në ushtri ne nuk e bëjmë çdo ushtar oficer, po ngremë aq sa duhen dhe nga më të mirët, megjithatë punojmë që ushtarët t'i kualifikojmë nga ana teknike ushtarake, sipas armëve ku shërbejnë. Sigurisht në këtë drejtim Partia ka dhënë orientime të drejta dhe do të përpiqet që në përgjegjësi të ngrihen në radhë të parë bijtë e punëtorëve, sigurisht ata që japin prova zotësie në punë. Pra, gjithë këto masa të gjera punëtorësh ne duhet të synojmë t'i kualifikojmë.

Të njëjtin qëllim duhet të ndjekim edhe me gjithë fshatarët që kanë kryer arsimin shtatëvjeçar. Përveç këtyre ka edhe të tjerë që nuk kanë mbaruar as filloren, i kanë shpëtuar detyrimit shkollor. Ne edhe me këta duhet të bëjmë përpjekje që t'i kualifikojmë, bile po të jetë e mundur të gjithë. Por të jemi realistë. Kë-

tyre nuk do t'u mësojmë matematikën e gjeometrinë, po për kooperativistët që merren me kultivimin e pambukut ose të ullinjve, duhet të hapim kurse ku ata të mësojnë për ato gjëra që u hyjnë në punë. Kështu, pra, disa t'i kualifikojmë për drithërat, disa për pemëtarinë, të tjerë për blegtorinë etj. Në këtë mënyrë mund të bëjmë një punë të madhe të vazhdueshme për kualifikimin e tyre.

Kuadrot e lartë në fshat në shumicë duhet të jenë nga fshati dhe këtë duhet ta theksojmë. Sigurisht, në fshat do të dërgojmë kuadro edhe nga qyteti. Edhe bij punëtorësh duhet të venë të punojnë në fshat. Çështja, pra, nuk mund dhe nuk duhet të shtrohet që për fshatin të përgatitim kuadro të dalë vetëm nga fshati dhe për qytetin vetëm nga qyteti. Orientimi i përgjithshëm të jetë që në shumicë fshati t'i nxjerrë vetë kuadrot që i duhen, por edhe kuadro të qytetit të shkojnë të punojnë në fshat.

Këto orientime duhet t'i ruajmë kurdoherë, po të mos harrojmë se ne po çojmë në shkolla masa të tëra të rinisë, që do të jenë klasa punëtore e ardhshme, kooperativistët e ardhshëm, inteligjencia e ardhshme e vendit tonë. Të tërë këta njerëz popullorë, revolucionarë, të edukuar me mësimet e Partisë, do të dalin nga dyert e shkollës sonë revolucionare. E gjithë kjo punë që po bëjmë synon në forcimin e diktaturës së proletariatit, në forcimin e sensit të klasës. Pa i mohuar të drejtën ndonjërit, si dhe pa synuar të shkojnë të gjithë në universitet, me sistemin arsimor që mendojmë të vendosim do të rritet vazhdimisht niveli i kulturës së përgjithshme të njerëzve tanë.

Programin e universitetit ne duhet t'ia përshtatim sistemit shkollor për të cilin fola. Mendoj se kultura që do të japim në këto shkolla, të jetë në nivel më të lartë nga ajo që japim sot, prandaj programi i universitetit t'i përgjigjet këtij niveli, si dhe të synojmë që ata që do të dërgohen në shkollë të lartë ta mbarojnë atë. Sot nxënësit e teknikumeve e kanë më vështirë të ndjekin universitetin, sepse në këto shkolla nuk i kemi rregulluar drejt programet e kulturës së përgjithshme, kurse gjimnazistët janë më të përgatitur për në universitet. Në të gjithë këtë kompleks të kemi parasysh të zbatojmë të gjitha parimet që shtrojmë: njohuritë shkencore-teknike që do të japim në shkollë, punën në prodhim, përgatitjen ushtarake, kohën e nevojshme të studentit për pushim etj. Në qoftë se dëmtojmë qoftë edhe njëri nga këto, do të thotë se nuk zbatojmë revolucionarizimin e shkollës.

Po edhe pas mbarimit të universitetit të shikohen mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm, me të cilin do të ngremë edhe më shumë nivelin shkencor të kuadrit të ri.

Të gjitha këto kërkojnë që të bëhen studime për programet, të përcaktohet sa lëndë mësimore, sa kohë punë në prodhim dhe sa kohë stërvitje ushtarake do të bëhet, pastaj të përcaktohet edhe sa kuadro do të na duhen etj.

Në qoftë se do të thyejmë konceptet e vjetra, sentimentalizmin e profesionalizmin e mësuesve dhe të pedagogëve dhe do t'i bëjmë ata të ndërgjegjshëm të kuptojnë nevojën e revolucionarizimit të shkollës, do të ketë mundësi të bëjmë shkurtime në programet dhe në këtë punë unë mendoj se nuk do ta ulim aspak nivelin

e teorisë në shkollat tona. Përkundrazi, kur ne të kemi hequr nga programet ato që nuk na duhen, atë do ta ngremë edhe më lart. Kështu nuk do t'i ngarkojmë nxënësit e studentët me çështje që njeriu nuk i mëson vetëm në shkollë, e kam fjalën kur jepen më shumë nga sa duhen, për shembull, njohuri letrare etj., që pa i nënvleftësuar, shumë nga ato janë të tepërta.

Unë mendoj se shkencëtarët dhe profesorët tanë janë në gjendje të bëjnë shumë shkurtime edhe në programet e lëndëve shkencore dhe ta ngrenë, bile akoma më lart, nivelin e dhënies së teorisë në shkencat përkatëse. Duke bërë këtë, nxënësve në shkollë do t'u dalë koha edhe për të marrë teori, edhe për punën në prodhim, edhe për stërvitje ushtarake, edhe për të dhënë provime e për të gjitha të tjerat. Drejtimi i të gjitha këtyre çështjeve është detyrë e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës.

Në përfundim, mendoj se me këtë sistem ne i forcojmë pozitën e klasës punëtore në shkollë. Ata punëtorë ose bij punëtorësh që nuk do të kenë mundësi të venë në universitet, pra të përfundojnë këtë sistem shkollor, do të kenë eksperiencë të madhe dhe të gjitha mundësitë e drejtimit.

Këto janë disa mendime që kisha, për të cilat është e nevojshme të diskutojmë.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

HISTORIA E PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË — VEPËR E MADHE NË DUART E KOMUNISTËVE DHE TË MBARË POPULLIT

*Bisedë me një grup punëtorësh të shtypshkronjës
«Mihal Duri» dhe me disa bashkëpunëtorë të
Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste¹*

4 nëntor 1968

SHOKU ENVER HOXHA: Në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë ju shpreh falënderimet më të nxehta dhe gëzimin e madh për përfundimin me sukses të detyrës së rëndësishme, botimin e librit «Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë», detyrë me të cilën ju kishte ngarkuar Partia si ju, shokë të Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste, ashtu dhe shokët punëtorë tipografë, përfaqësuesit e të

¹ Në këtë bisedë, që u zhvillua me rastin e botimit të parë të librit të Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë, ndodheshin, gjithashtu, shoku Ramiz Alia, anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH dhe shoqja Nexhmije Hoxha, anëtare e Komitetit Qendror të PPSH dhe drejtore e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste pranë aparatit të KQ të PPSH.

cilëve më sollën sot kopjet e para të botimit të parë të kësaj vepre.

Botimi i tekstit të Historisë së Partisë përbën një ngjarje të shënuar. Ky tekst është një vepër e madhe ideologjike e shkencore. Atje paraqitet në mënyrë të sintetizuar rruga e lavdishme e Partisë sonë, bëhet përgjithësimi i eksperiencës së pasur revolucionare të saj e të masave punonjëse në bazë të teorisë marksiste-leniniste. Sinteza e luftës së Partisë jepet në mënyrë reale, e bazuar në dialektikën materialiste.

Historia e Partisë sonë të lavdishme nuk u përngjet historive të kategorisë së përgjithshme, as botimeve të tjera që kemi nxjerrë gjer më sot në vendin tonë. Kjo është një vepër historike, shkencore, teorike, në përmbajtjen e së cilës është koncentruar e gjithë vepra madhështore e Partisë dhe e popullit shqiptar, që nga 8 Nëntori 1941, kur u themelua Partia jonë Komuniste dhe deri në ditët e sotme. Ajo është historia e një partie marksiste-leniniste që i ka qëndruar gjithmonë besnike marksizëm-leninizmit, që ka përpunuar dhe zbatuar kurdoherë një vijë të drejtë marksiste-leniniste. Drejtësia e madhe e vijës dhe e luftës së Partisë është vërtetuar në praktikë. Në sajë të kësaj vije e të kësaj lufte populli ynë ka arritur gjithë këto fitore të mëdha, gjithë këto përparime që gëzojmë sot.

Komiteti Qendror i Partisë dhe veçanërisht shokët e ngarkuar me hartimin e librit të Historisë së Partisë sonë, kanë bërë një punë shumë të madhe, të çmueshme, të kujdesshme dhe me shumë përgjegjësi. Po t'i hedhim një sy datës kur është marrë vendimi për hartimin e kësaj vepre, del se që atëherë kanë kaluar shu-

më vjet. Komiteti Qendror i Partisë e ndiente shumë dhe vazhdimisht përgjegjësinë e madhe që kishte para Partisë dhe popullit për hartimin e kësaj vepre madhështore. Por, është e drejtë të themi se, nuk ishte kollaj të përfundonte shpejt një vepër e tillë dhe se vështirësia nuk qëndronte vetëm te formulimi, por sidomos se duhej thelluar akoma më tepër për zbërthimin e vijës së Partisë në mënyrë shkencore revolucionare, si gjatë kohës së Luftës Nacionalçlirimtare dhe revolucionit popullor, ashtu edhe gjatë periudhës së ndërtimit të socializmit. Pra, duhej një punë e madhe për t'i dhënë Partisë, klasës punëtore, gjithë popullit shqiptar veprën e shkruar që do të përmbante pasqyrimin besnik të kësaj vije të drejtë, të sprovuar gjatë gjithë jetës dhe aktivitetit të Partisë.

Përpara klasës sonë punëtore ne, anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë, mund të bëjmë autokritikë që vendimin për hartimin e tekstit të Historisë së Partisë e morëm para kohe, qysh në Kongresin I të Partisë, plot para 20 vjetësh. Pra, ne atëherë u shpejtuan, por kjo ndodhi se në atë kohë nuk e kishim këtë pjekuri që kemi sot. Të kuptohemi drejt, edhe sot pjekuria e secilit nga ne e marrë në veçanti prapë nuk është aq e madhe, por sidoqoftë në krahasim me 20 vjet të kaluar diçka më të pjekur jemi, kurse Partia, në tërësinë e saj, ka fituar që nga ajo kohë një eksperiencë jashtëzakonisht të madhe. Por, megjithatë duhet të themi se, edhe pse i shpejtuar, vendimi që morëm ishte i drejtë dhe, me këtë rast, ne duam t'i themi klasës sonë punëtore se zbatimin e tij Komiteti Qendror e kishte kurdoherë një nga preokupacionet më të mëdha. Edhe

më vonë, kur u bënë kongreset e tjera të Partisë, e them sot këtu para jush, ne e ndienim veten fajtorë para Partisë dhe klasës punëtore, gjersa nuk e kishim plotësuar detyrën që na ishte ngarkuar dhe nuk ua kishim dhënë akoma në dorë Partisë dhe popullit këtë armë të mprehtë, që është vepër e tyre.

Sidoqoftë klasa punëtore dhe populli ynë e kuptuan drejt këtë gjë dhe veç kësaj puna e Partisë nuk ngeli në vend. Komunistët, pavarësisht se nuk e kishin në dorë këtë manual teorik, kishin të qarta vijën, direktivat e kongreseve të Partisë dhe të Komitetit Qendror, vendimet e tij të shumta. Në bazë të tyre, Partia armatosej çdo ditë e më shumë me teorinë marksiste-leniniste dhe në krye të klasës punëtore, në krye të të gjitha masave punonjëse luftonte me këmbëngulje për zbatimin e tyre. Vendimet që merrte udhëheqja ishin të sprovuara sepse buronin nga përpjekjet me vështirësitë e panumërta, nga vazhdimi me sukses i luftës së ashpër klasore, si brenda në Parti, kundër deviatorëve, oportunistëve dhe sektarëve, ashtu edhe brenda vendit, kundër mbeturinave të borgjezisë reaksionare dhe të feudalëve, që me fitoren e Luftës Nacionalçlirimtare humbën çdo fuqi politike dhe ekonomike. Lufta e klasave, që u zhvillua e po vazhdon edhe sot kundër mbeturinave të klasave të përmbysura, të cilat kanë luftuar me ashpërsinë më të madhe Partinë tonë, vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste, pushtetin e diktaturës së proletariatit dhe ndërtimin e socializmit, nuk do të ndërpritet as në të ardhmen. Lufta e klasave në vendin tonë është zhvilluar e vazhdon jo vetëm në fu-

shën ekonomike, por sidomos në fushën politike dhe në atë ideologjike.

Armiqtë e klasës, që nga fashistët italianë e nazistët gjermanë, që nga bejlerët dhe borgjezia reaksionare, ballistët e zogistët, mbeturinat e reaksionit të mundur në Luftën Nacionalçlirimtare, deri tek imperialistët amerikanë e anglezë, titistët, revizionistët hrushovianë e armiq të tjerë rreth kufijve tanë e në të gjithë botën na kanë luftuar me ashpërsinë më të madhe për të shkatërruar Partinë, për të shkatërruar diktaturën e proletariatit dhe rendin socialist në vendin tonë.

Në vitet e para të Çlirimit, diktaturës sonë të proletariatit i duhej të luftonte përsëri me armë në dorë kundër mbeturinave të reaksionit të brendshëm, të mundur nga Ushtria Partizane Nacionalçlirimtare e udhëhequr nga Partia. Mirëpo më vonë, këto mbeturina dhe miqtë e tyre të jashtëm, pasi e panë se nuk u dilnin dot me forcë diktaturës së proletariatit, Partisë dhe popullit tonë, u detyruan ta ndryshojnë taktikën, natyrisht pa hequr dorë nga qëllimi i tyre i fundit, që ishte përmbysja me armë e diktaturës sonë të proletariatit. Me sabotime në ekonomi, me atentate kundër kuadrove të Partisë e të shtetit, me diversion e me gjithfarë presionesh politike dhe ideologjike ata u përpoqën të na gjunjëzonin, por as ia arritën, as do t'ia arrijnë dot kurrë qëllimit të tyre. Përkundrazi lufta e klasës punëtoje në krye të mbarë masave tona, të udhëhequra nga Partia, bëri që armiqtë të dobësohen dhe të humbasin vazhdimisht, kurse populli dhe Partia të fitojnë e të forcohen. Dhe kjo i detyrohet vijës së drejtë të Partisë.

Gjatë gjithë kësaj periudhe 27-vjeçare u vërtetua në jetë, në parim dhe në praktikë, drejtësia e madhe e vijës marksiste-leniniste të Partisë, se vetëm me përpjekje dhe me luftë të pandërprerë mund të arrihen objektivat e mëdhenj që cakton Partia e klasës. Dhe ja sot erdhi koha të dalë më së fundi, e paraqitur në këtë libër, gjithë sinteza e veprës madhështore të Partisë sonë. Kjo përbën, gjithashtu, një fitore të madhe që nuk u arrit lehtë, por me punë e me përpjekje të mëdha.

Është shkruar vallë në këtë tekst tërë historia e lavdishme e Partisë sonë? Sigurisht që jo në hollësi e kjo, jo se këto hollësi s'kanë rëndësi, ose s'kanë të bëjnë me jetën e komunistëve, të klasës punëtore, të mbarë popullit tonë, por ky është një tekst përmbledhës dhe s'ka dyshim që më vonë do të shkruhen vëllime e studime të veçanta për çdo gjë. Sidoqoftë në këtë tekst konkluzionet, vija dhe orientimet kryesore të veprës madhështore të Partisë në çdo drejtim, në të gjitha fushat e jetës janë koncentruar në rrugë shkencore, në mënyrë realiste, të bazuara në teorinë tonë marksiste-leniniste, në filozofinë e dialektikës materialiste dhe në normat leniniste të Partisë. Në këtë libër janë sintetizuar jo vetëm sukseset tona, por bashkë me to edhe të metat e gabimet gjer në periudhën që po jetojmë. Prandaj, për ne komunistët, për klasën punëtore, për gjithë popullin tonë, libri i Historisë së Partisë ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe.

«Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë» është libri më i rëndësishëm shkencor teorik që është botuar në Shqipëri, pas veprave të Marksit, të Engelsit, të

Leninit dhe të Stalinit. Ai ka së pari veçorinë se pasqyron historinë e Partisë sonë, luftërat dhe përpjekjet e saj gjatë këtyre 27 vjetëve, e mbështetur në teorinë e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit, e cila frymëzoi, kaliti dhe orientoi Partinë, klasën punëtore dhe gjithë masat e popullit shqiptar në rrugën e ndërtimit të socializmit në përshtatje me kushtet tona, me rrethanat tona, me specifikën shqiptare, në periudha e koniunktura të veçanta, të brendshme dhe të jashtme, prandaj dhe botimi i tij merr një rëndësi shumë të madhe. Për këto arsye themi se është vepra më e rëndësishme që është hartuar e botuar gjër më sot në Shqipëri.

Me botimin e historisë së saj, Partia u vë në dorë komunistëve, klasës punëtore, gjithë popullit një armë të mprehtë e të fuqishme ideologjike e politike për kalitjen e tyre revolucionare, për zgjidhjen e problemeve të mëdha aktuale. Vepra e madhe e Partisë nuk është vetëm vepër e komunistëve, por është edhe vepër e klasës punëtore, e fshatarësisë punonjëse, e intelektualëve patriotë. Të gjithë kanë kontribuar me gjakun dhe me djersën e tyre për ta shkruar historinë e Partisë. Për këtë arsye në historinë e Partisë populli ynë sheh si në pasqyrë luftën, punën, veprën e vet të madhe. Ai mburret me këtë vepër heroike, me farkëtaren e fitoreve dhe me mësuesen e tij të lavdishme, Partinë. Prandaj librin e Historisë së Partisë duhet ta ketë në dorë çdo njeri, ai duhet të mbahet, si thotë populli, pranë kokës, nën jastëk.

Vepra «Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë» do të jetë një armë kryesore që do të vihet në duart e

komunistëve dhe të gjitha masave punonjëse të vendit tonë, për edukimin e tyre ideologjik. Ajo është sinteza e veprës së gjithë atyre që kanë kontribuar me gjak e me djersë, me mundime e me luftë, që të realizoheshin të gjitha që shohim sot në vendin tonë. Kjo vepër është një armë jo vetëm për ne, por edhe për brezat e ardhshëm, që nuk e kanë jetuar periudhën që ka kaluar brezi ynë. Ky libër do të jetë, pra, një armë e përjetshme për njerëzit e Shqipërisë së re, për ata që do të jetojnë në të ardhmen. Më vonë ai do të plotësohet sepse në të do të pasqyrohen edhe sukseset e reja, akoma më të mëdha, që do të korrë populli ynë i udhëhequr nga Partia në frontin e luftës për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, kundër imperializmit dhe revizionizmit modern.

Çdo komunist, çdo punëtor, çdo fshatar, çdo intelektual do të gjejë në Historinë e Partisë mësim shume të vlefshme, që janë mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, të cilat do ta ndihmojnë atë për t'i kryer më mirë detyrat e veta revolucionare. Nga besnikëria e Partisë ndaj marksizëm-leninizmit, nga qartësia dhe pjekuria e saj e lartë politike, nga orientimet dhe direktivat e saj të drejta, nga vendosmëria dhe guximi i saj revolucionar, çdo komunist e punonjës do të frymëzohet dhe do të fitojë një besim të madh në forcat e veta, do të gjejë rrugën e daljes ngadhënjimtare në çdo rast kur ndodhet përpara vështirësive dhe pengesave, përpara një problemi sado i koklavitur që të jetë. Nga Historia e Partisë njerëzit tanë do të dinë më mirë të kuptojnë ideologjikisht e politikisht fenomenet dhe problemet e sotme të vendit tonë dhe të gjendjes

ndërkombëtare, do të shohin më qartë perspektivën e sigurt të zhvillimit të shoqërisë sonë drejt komunizmit.

Çdo njeri te ne, qoftë punëtor, fshatar ose intelektual kur t'i dalë përpara një problem për të zgjidhur dhe që e ka të vështirë të gjejë mënyrën e zgjidhjes së tij, le t'i referohet Historisë së Partisë, të shohë se si e ka zgjidhur ajo, në rrethana të ndryshme, këtë ose atë çështje gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ose pas Çlirimit të atdheut. Ajo do ta ndihmojë atë edhe në këtë rast. Mund që problemi për të cilin shkruhet aty të mos jetë i njëjtë me atë që preokupon të interesuarin, por referimi do t'i vlejë për t'u orientuar drejt. Vetë jeta, lufta dhe praktika e gjertanishme e vendit tonë janë një bazë që vërtetojnë drejtësinë e rrugës që ka ndjekur Partia. Kjo bazë është si të thuash shtylla kurrrizore, prandaj komunistët, punëtorët, fshatarët, inteligjencia, duke iu referuar kësaj, do të ndihmohen që të dalin në rrugë të drejtë për njërin ose për tjetrin problem. Historia e Partisë, si një vepër e përshkuar nga dialektika materialiste, nuk lë pa sqaruar e pa dhënë orientim për zgjidhjen e çfarëdo problemi, qoftë ky edhe shumë i koklavitur. Do ta ndiejmë dobinë e kësaj të vërtete vetëm në qoftë se do ta kemi përvetësuar mirë këtë libër dhe do të dimë ta mbajmë si pishtar, për të ndriçuar edhe skutat më të fshehta të një problemi. Edhe për ne, që kemi jetuar krijimin dhe luftën e Partisë në të gjitha etapat historike, që kemi kontribuar me të gjitha forcat për kryerjen e detyrave të saj me sukses, historia e Partisë mbetet kurdoherë e re, siç është gjithmonë i ri marksizëm-leninizmi, një udhë-

rrëfytes i pagabueshëm. Prandaj, ne, të gjithë, pa përjashtim, duhet t'i referohemi asaj në çdo situatë dhe për çdo problem.

Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë është një vepër e pavdekshme, ashtu siç është e pavdekshme vetë Partia jonë, kjo është një vepër e re, ashtu siç është e do të mbetet kurdoherë e re Partia jonë. Edhe për ne që kemi jetuar luftën dhe punën kolosale të Partisë dhe kemi kontribuar me të gjitha forcat dhe mundësitë tona për realizimin e vijës së saj, Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë do të mbetet një vepër kurdoherë e re, një orientues i pagabueshëm, së cilës duhet t'i referohemi të gjithë, pa përjashtim, në çdo situatë dhe për çdo problem, për të nxjerrë konkluzione nga mësimet e Partisë, nga vija e saj e drejtë marksiste-leniniste, për të zgjidhur probleme të reja që na dalin e do të na dalin përpara në të ardhmen. Për ne, që i kemi jetuar ngjarjet të cilat reflektohen në të, kjo vepër është dhe do të mbetet një udhërrëfyes i pagabueshëm drejt fitoreve të reja nën udhëheqjen e Partisë.

Duke studiuar Historinë e Partisë, komunistët dhe punonjësit tanë do të studiojnë marksizëm-leninizmin të zbatuar në mënyrë krijuese në kushtet e Shqipërisë e në rrethanat konkrete ndërkombëtare. Ata do të njihen më thellë me vijën e drejtë e luftën heroike të Partisë dhe nga kjo do të nxjerrin mësimet.

Në mënyrë të veçantë nga studimi i Historisë së Partisë komunistët do të kuptojnë më thellë ç'rëndësi vendimtare ka besnikëria ndaj marksizëm-leninizmit, zbatimi me vendosmëri, me vazhdimësi dhe në mënyrë revolucionare i parimeve dhe i normave marksiste-le-

niniste, që Partia jonë edhe në të ardhmen të kryejë me nder misionin e saj të madh, që ajo ta ruajë gjithmonë karakterin e saj proletar, të mbetet përgjithmonë Parti revolucionare e klasës punëtore.

Klasa punëtore nga studimi i Historisë së Partisë do të mësojë më mirë si të mbrojë me vigjilencë Partinë e vet nga degjenerimi borgjezo-revizionist, ta revolucionarizojë atë pa ndërprerje, që të jetë kurdoherë në gjendje të luajë rolin udhëheqës të popullit për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste e të komunizmit. Ajo do të luftojë më me ngulm për të ushtruar një kontroll të drejtpërdrejtë më të fortë dhe më të frytshëm në të gjitha fushat e jetës së vendit — në ekonomi, në pushtetin politik, në arsim e kulturë, në kuadrot e organet drejtuese dhe në vetë Partinë, sepse vetëm kështu do të sigurohet që Partia dhe pushteti politik në vendin tonë të mbeten përgjithmonë Parti dhe pushtet të klasës punëtore, armë të pazëvendësueshme për kryerjen e rolit të saj udhëheqës, që Shqipëria të mos kthehet prapa në kapitalizëm.

Fshatarësia kooperativiste nga studimi i Historisë së Partisë do të shohë më qartë se vetëm Partia e klasës punëtore ia përmbushi asaj ëndrrat shekullore për liri e për tokë, e nxori nga prapambetja dhe mjerimi shekullor, e vuri në rrugën e gjerë të përparimit të gjithanshëm, se vetëm kjo Parti i siguron asaj begatinë, kulturën, lumturinë në rrugën e socializmit, në rrugën e komunizmit. Nga kjo fshatari ynë nxjerr mësim që ta forcojë më shumë aleancën e çeliktë me klasën punëtore, nën udhëheqjen e klasës punëtore e të Partisë së saj.

Studimi i Historisë së Partisë do ta ndihmojë inteligjencien tonë socialiste, që ta forcojë më shumë besnikërinë ndaj Partisë dhe klasës punëtore, që të jetë kurdoherë një nxënëse e urtë dhe kokulur e mësuesit të madh popull, që të mbruhet me ideologjinë proletare dhe t'i shërbejë me të gjitha forcat çështjes së proletariatit, të socializmit, të atdheut, të përparimit ekonomik e kulturor të vendit, duke u shkrirë me punëtorët e fshatarët e duke u frymëzuar çdo ditë nga heroizmi dhe vrulli i tyre revolucionar.

Një rëndësi të posaçme ka studimi i Historisë së Partisë nga rinia, e cila do të shohë sa gjak është derdhur, sa vështirësi dhe rreziqe janë dashur të kalohen, sa mundime e përpjekje vigane janë dashur të tregohen nga komunistët, nga klasa punëtore, nga fshatarësia punonjëse, nga intelektualët patriotë, ç'besnikëri ndaj parimeve revolucionare marksiste-leniniste, ç'pjekuri politike dhe heroizëm është treguar nga Partia për të arritur këto ditë të lumtura që gëzojmë sot. Ajo do të krenohet me vetëmohimin dhe me heroizmin e parardhësve të vet, me pjekurinë e lartë politike marksiste-leniniste, me urtësinë dhe me zotësinë e Partisë, mëmës së saj më të afërt, mësueses dhe edukatores së saj të shtrenjtë. Kjo do ta frymëzojë atë për të përvetësuar virtytet dhe traditat e mëdha revolucionare e patriotike të Partisë e të popullit tonë, për t'u kalitur si revolucionare besnike në aksionin e pandërprerë revolucionar dhe në shkollën tonë socialiste, për t'u brumosur me ideologjinë proletare, me mësimet e mëdha revolucionare të Partisë. Kjo do ta frymëzojë atë të sulmojë me guxim drejt majave të shkencës e të teknikës mo-

derne, për t'i përvetësuar ato e për t'i vënë në shërbim të përparimit e të lulëzimit të atdheut tonë socialist. Studimi i Historisë së Partisë do ta bëjë brezin tonë të ri të jetë revolucionar i papërkulur, të luftojë me vendosmëri, pa përfillur asnjë sakrificë dhe me një ndjenjë të madhe përgjegjësie për të ruajtur si sytë e ballit e për të zhvilluar më tej veprën e madhe të etërve, gjyshërve e stërgjyshërve të tyre, për ta marrë, për ta mbajtur në duar të çelikut e për ta përcjellë më tej stafetën e revolucionit, të socializmit, të komunizmit.

Për ata që do të vijnë më vonë, Historia e Partisë do të ketë jo vetëm rëndësinë që ka sot për ne, por edhe diçka tjetër. Brezat e ardhshëm, që do t'i gëzojnë ato të mira që ka bërë e do të bëjë Partia edhe në të ardhmen, kur ta lexojnë këtë vepër të madhe, kur të njohin historinë e lavdishme të Partisë, do të mësojnë njëkohësisht për të kaluarën heroike dhe për përpjekjet që janë bërë për të arritur gjer në këtë nivel zhvillimi e mirëqenieje materiale e kulturore. Duke studiuar Historinë e Partisë, atyre do t'u sqarohet jo vetëm perspektiva e ecjes drejt komunizmit, por njëkohësisht do t'u ngjallen edhe ndjenjat e përgjegjësisë së madhe që do të kenë, që këtë vepër madhështore të krijuar nga populli, me Partinë në krye, ta ruajnë si sytë e ballit, të punojnë e të luftojnë pareshtur për t'u bërë revolucionarë, të jenë gjithë jetën njerëz të sakrificës, ashtu siç kanë qenë gjyshërit dhe baballarët e tyre.

Prandaj këtë vepër me vlerë të madhe njerëzit tanë duhet ta mbajnë në dorë, ta lexojnë e ta studiojnë me vëmendje. Për këtë arsye ne mendojmë se 100 000 kopje që jemi duke shtypur janë pak. Kjo na vë dety-

rën të punojmë për të nxjerrë më shumë kopje që të pajisen me të të gjithë komunistët, klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste, inteligjencia jonë, rinia dhe gratë, për të njohur nëpërmjet saj vijën e Partisë, drejtësinë e saj, për të nxjerrë mësim se si të hidhen vazhdimisht në luftë e të marshojnë përpara pa u ndalur drejt komunizmit.

Natyrisht, nga masat punonjëse do të ketë shumë kërkesa për ta pasur në dorë këtë libër. Njerëzit do të mbushin libraritë derisa ta shtien në dorë librin. Unë jam i sigurt se Komitetit Qendror do t'i vijnë letra e telegrame me kërkesa. Njerëzit do të na kritikojnë që nëpër libraritë do të dërgohen vetëm nga 100 ose 200 kopje dhe që nuk do të ketë aq sa të plotësohen kërkesat e të gjithëve. Këtë botim ne do ta nxjerrim në 100 000 kopje e, megjithatë, jam i bindur se kjo shifër prapë do të jetë e pamjaftueshme, para nevojave të mëdha që do të ketë për të.

Ju, shokë të Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste, punuat me këmbëngulje e me pjekuri për përgatitjen e botimit të librit «Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë», prandaj ju përgëzojmë për punën shkencore që keni bërë. Të bësh punë shkencore për botimin e një libri do të thotë të kuptosh rëndësinë e tij dhe sidomos të përmbajtjes së tij. Ju, duke punuar për këtë qëllim, treguat se e keni kuptuar thellë rëndësinë e veprës së Partisë dhe të përmbajtjes së saj.

Komiteti Qendror i përgëzon shokët e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste për punën e vlefshme që kanë bërë. Për hartimin e këtij libri ata kanë ditur të punojnë si duhet me materialet e Partisë, me doku-

mentet e saj shumë të rëndësishme, jo vetëm me ato më kryesoret, por edhe me të tjerat. Shokëve të Institutit iu desh t'i hapnin e t'i studionin të gjitha materialet e Partisë, me durim dhe me këmbëngulje, për të bërë dhe për të dhënë të shkruar në një libër sintezën e drejtë që kërkonte gjithë vepra e madhe e Partisë e dokumentuar në materiale dhe e zbatuar në praktikë.

Duke folur për botimin e kësaj vepre shumë të rëndësishme, punë të mirë keni bërë edhe ju, shokë tipografë, që jeni pjesë përbërëse e klasës sonë të lavdishme punëtore. Ju, shokë punëtorë, që punuat për këtë botim keni bërë një punë që nuk do të harrohet kurrë, pse, siç e thashë, ato për të cilat bëhet fjalë në këtë libër janë nga veprat më të mëdha që ka realizuar gjer më sot klasa jonë punëtore, me Partinë e saj të lavdishme në krye. Brenda mundësive që ju ka dhënë Partia, ju e keni kryer mirë detyrën, keni vënë kujdes të veçantë për shtypjen e këtij libri, duke filluar që nga puna gjatë radhitjes e gjer në lidhjen e në paraqitjen sa më bukur të veprës. Për punën e madhe që keni bërë meritoni përgëzime dhe ju themi: Ju lumtë juve, shokë punëtorë tipografë! Megjithatë ka vend të thuhet, dhe për këtë besoj se ju jeni dakord, që nga ana teknike duhen marrë akoma masa për ta përmirësuar punën. Por edhe për këtë nuk duhet t'ju ngarkojmë ju me përgjegjësi, pse në këtë drejtim kemi përgjegjësi edhe ne. Për këtë qëllim ne kemi parashikuar të ngremë një kombinat të ri poligrafik për botimin e librave. Realizimi i kësaj detyre do të jetë një tjetër sukses i madh, pse atëherë do të krijohen kushte

për më shumë botime. Kurse sot ne kemi nevoja të mëdha për botime, pse këto që nxjerrim janë akoma të pamjaftueshme.

Shokët e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste mund t'u kenë mërzitur ndonjë çikë, ju, shokë punëtorë, me vërejtjet e tyre gjatë punës për korrigjimin e këtij ose të atij gabimi që mund të keni bërë gjatë radhitjes etj., por jam i bindur se ju i keni kuptuar drejt ndërhyrjet e tyre. S'ka dyshim që si ju, ashtu edhe këta, në radhë të parë, keni pasur preokupacionin e madh që kjo vepër të dilte sa më e mirë, ashtu siç është vetë Partia jonë.

Në vendin tonë po shtohen vazhdimisht kërkesat për libra, sepse kuadrot, punëtorët, fshatarët, inteligjencia jonë tani janë pjekur, të gjithë kanë etje të madhe për dituri, pse të gjithë i ngriti dhe i zhvilloi Partia. Njerëzit tanë, kudo që janë, vazhdimisht po krijojnë, mendojnë e prodhojnë gjithnjë më shumë e më mirë. Këto vlera të paçmuara të klasës punëtore e të kuadrove tanë, këtë eksperiencë të madhe të tyre ne duhet t'i përhapim medoemos, sidomos me anën e shtypit, me anën e librave etj. Punëtorët më të vjetër mbajnë mend se disa vjet më parë, kur botonim ndonjë libër në tridhjetë e në dyzet mijë kopje, librarët na ankoheshin se u mbeteshin për një kohë të gjatë nëpër rafte pa u shitur, kurse tani, megjithëse shtypen në tirazh më të gjerë ata shiten brenda pak ditëve, bile është zor të plotësohen kërkesat e të gjithëve, sepse njeriu ynë i rritur në epokën e Partisë, çdo ditë e më shumë kupton dhe ndien rëndësinë jetike që ka studimi për përparimin e vendit tonë.

Megjithatë duhet të njohim se ka akoma mungesa në drejtim të përvetësimit të njohurive shkencore nga ana e njerëzve tanë. Këto mungesa ata duhet t'i plotësojnë duke u pajisur me dituri nëpërmjet librave e botimeve, që të mundin pastaj t'i vënë dituritë që marrin, në shërbim të Partisë e të popullit. Prandaj në drejtim të botimeve ne kemi akoma shumë për të bërë.

Komiteti Qendror u ka dhënë porosi shokëve të Qeverisë, që përveç agregateve të tjera që i duhen shtypshkronjës së re, të sjellin edhe disa makina për lidhjen e librave. Këto makina do të ndihmojnë që të rritet shumë rendimenti i punës në procesin e lidhjes së librit. Kështu, duke punuar me mjetet e reja që do të na vijnë, do të bëhet e mundur që librat tanë të dalin më shpejt në qarkullim. Punëtorët e rinj të shtypshkronjës suaj nuk ka pse të mendojnë se do të mbeten pa punë, kur shteti të sjellë makina të reja, sepse së pari kërkesat për libra, siç e thashë edhe më parë, do të vijnë gjithnjë duke u rritur. Pastaj do të duhet të shtohet edhe tirazhi i çdo libri të botuar. Veç kësaj ne jemi të bindur se edhe shokë marksistë-leninistë revolucionarë të vendeve të tjera do të na e kërkojnë tekstin e Historisë së Partisë sonë, bile në gjuhën e tyre, prandaj tipografëve tanë do t'u hapet shumë punë. Ne tani nxjerrim disa botime, të pakta, në gjuhë të huaja, që u duhen shokëve tanë marksistë-leninistë të vendeve të tjera. Materialet që botojnë vetë janë akoma shumë pak, se ata nuk i kanë mundësitë, janë në luftë, nën ndjekjet e policisë borgjeze, pra, nuk kanë as kohë, as mjete për t'i botuar materialet, për të cilat kanë shumë nevojë.

Pa pasur asnjë pretendim dhe si marksistë-leninistë që jemi e ndiejmë se Partisë së Punës të Shqipërisë i bie një detyrë e madhe internacionaliste t'i ndihmojë ata në luftërat e tyre. Dhe një nga llojet e ndihmës është edhe dërgimi i materialeve që botojmë ne, të cilat flasin për eksperiencën e Partisë sonë. Në këtë drejtim ne duhet t'i ndihmojmë. Por me mundësitë tona aktuale ne sot nuk i plotësojmë dot kërkesat e tyre të shumta dhe e kuptojmë sa borxhlinj jemi ndaj tyre, prandaj na vihet detyrë ta zgjidhim sa më shpejt këtë problem. Marksistë-leninistët revolucionarë të vendeve kapitaliste kanë nevoja të mëdha për veprat e Stalinit dhe të Leninit, se borgjezia i ka zhdukur të tëra dhe i ka mbushur tregjet e vendeve kapitaliste vetëm me «interpretime» sipas dëshirës së saj, të veprës së Leninit, apo të Marksit dhe të Engelsit, pse sa për Stalinin, as që bëjnë zë fare. Armiqtë e socializmit e të komunizmit në vendet kapitaliste dhe revizioniste kanë mbushur tregjet me literaturë dekadente, fashiste e borgjeze. Merreni me mend çfarë shkruhet në to. Duke u nisur nga këto kushte, shokët marksistë-leninistë të vendeve të tjera na lutën t'ua botojmë ne, në gjuhët e tyre veprat e klasikëve, prandaj e kemi për detyrë internacionaliste t'i ndihmojmë sa më shumë që të jetë e mundur. Një ndihmë jona që do të kontribuojë për shpejtimin e revolucionit proletar botëror është edhe përhapja kudo në këto vende e veprave të klasikëve të marksizëm-leninizmit.

Shokët e partive të reja marksiste-leniniste dhe grupet marksiste-leniniste revolucionare ne do t'i ndihmojmë me literaturë marksiste-leniniste gjithnjë e më

shumë dhe tani kemi filluar të bëjmë diçka. Të gjitha veprat e Stalinit as ne nuk i shtypim dot menjëherë, por një pjesë të veprave të tij dhe të Leninit jemi duke i përgatitur. Përveç këtyre tani duhet t'ua përkthejmë e t'ua shtypim bukur në gjuhët e tyre edhe librin e Historisë së Partisë sonë. Këtë punë do ta bëjmë sidomos në gjuhët më të përhapura si: në anglisht, në frëngjisht, në rusisht, në gjermanisht e në spanjisht. Pastaj duhet të kujdesemi t'u shtypim edhe libra e dokumente të tjera, që lidhen me aspekte të veçanta të veprimtarisë së Partisë sonë, artikuj të ndryshëm të «Zërit të popullit» etj.

Por juve, punëtorëve tipografë nuk ju takon të bëni një punë të madhe vetëm në sasi, por edhe në cilësi. Prandaj duhet të perfeksiononi gjithnjë e më shumë edhe përgatitjen tuaj tekniko-profesionale, duke vënë gjithnjë në krye politikën dhe ideologjinë e Partisë. Ju, shokë tipografë, si elementë të ndërgjegjshëm të klasës punëtore, e keni parasysh punën për realizimin e gjithë këtyre detyrave të mëdha që ju presin. Prandaj ideologjikisht, politikisht dhe teknikisht, si elementë nga më të mirët e në pararojë të klasës sonë punëtore, ju duhet të punoni akoma më shumë për kalitjen tuaj të pandërprerë, për të qenë në gjendje që ta kryeni këtë punë të madhe, në kushtet shumë të vështira të luftës që ne po u bëjmë imperializmit e revizionizmit modern edhe në sektorin e botimeve. Në këto kushte juve, tipografëve, ju vihet detyrë të punoni me këmbëngulje për të kualifikuar veten, sepse detyrat e mëdha që keni përpara nuk presin, ato duhen kryer sa më shpejt. Prandaj të punojmë që në punë e sipër të

përgatitim njerëzit tanë të ngritur ideologjikisht e politikisht, që t'i bëjmë, në radhë të parë, të ndërgjegjshëm, pra, të vendosur, njëkohësisht t'i përgatitim edhe me nivel të lartë teknik, sepse nuk do të jetë shumë larg kur, me ngritjen e kombinatit poligrafik, që do të na japë mundësi të përhapim në shkallë më të gjerë se gjer tani veprat e Marksit, të Engelsit, të Leninit, të Stalinit, veprat e Partisë sonë marksiste-leniniste, punët do të na shtohen shumë. Në luftën e madhe që po bën Partia kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, ju, shokë tipografë, keni nderin e madh të jeni një repart special i Partisë, një repart pararojë. Partia ka besim se ju do t'i kryeni detyrat si kurdoherë me nder, ashtu siç i ka kryer gjer më sot gjithë klasa punëtore e vendit tonë. Me punën tuaj duhet të frymëzoni inteligjencien tonë popullore që ajo të punojë me atë disiplinë e vullnet dhe me atë këmbëngulje e frymë revolucionare, siç punoni ju. I them këto se ne intelektualët duhet të futemi në rulonë e klasës punëtore, se ne kemi tendencën të ëndërrojmë ca, të mos e masim mirë e të mos e shfrytëzojmë si duhet kohën, kurse për punëtorin koha nuk pret. Punëtori nuk e lë dot makinën jashtë kontrollit, sepse ajo vazhdon të punojë dhe në qoftë se ai nuk ndjek çdo proces pune, prodhimi del skarco. Klasa punëtore gjithnjë duhet ta ndjekë nga afër jetën e inteligjencies, të fshatarësisë, të rinisë sonë, pra, t'u japë atyre kurdoherë frymën, disiplinën, guximin, drejtësinë dhe ashpërsinë e vet dhe, kur duhet, t'u japë edhe ngrohtësinë e saj.

Edhe një herë dëshiroj të theksoj se si shokët e

Instituti të Studimeve Marksiste-Leniniste ashtu dhe ju, shokë tipografë, keni bërë një punë të madhe, prandaj ju uroj që në të ardhmen të korrni suksese gjithnjë e më të mëdha në punën tuaj dhe të arrini që shtypja e plotë e kësaj vepre të realizohet me ritmin e kërkuar.

SHOQJA FIDARIE BELI: Ju japim fjalën, shoku Enver, se ne do të punojmë akoma më shumë për ta përmirësuar cilësinë e punës. Ne jemi mobilizuar me të tëra forcat që të realizojmë zotimin që kemi marrë për ta plotësuar në kohë sasinë prej 100 000 kopjesh të librit të Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë. Tani jemi duke përgatitur shtatëqind copë çdo ditë. Gjithë punëtorët tipografë janë të gatshëm të realizojnë çdo detyrë, që do të na ngarkojë Partia, si për këtë libër ashtu dhe për çdo vepër tjetër.

SHOKU ENVER HOXHA: Në shenjë kujtimi po ju jap nga një kopje të Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë.

SHOKU BESNIK FORTUZI: Ju lutemi, shoku Enver, të na vini dhe firmën në librin që na dhuruat.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe unë dëshiroj, që për kujtim, të më shkruani emrat tuaj, në kopjen që do të mbaj vetë.

SHOKU SKËNDER BEGU: Ne, shoku Enver, ju premtojmë Juve dhe Partisë se do të punojmë pa u lodhur, për të vënë në jetë porosinë e saj dhe ato që na thatë sot Ju në këtë takim, se do të kryejmë me nder gjithçka kërkon Partia nga ne. Me këtë rast dëshiroj t'Ju sjell përshëndetjet revolucionare nga gjithë shokët tanë punëtorë tipografë dhe t'Ju urojmë me gji-

thë zemër, të na rroni sa malet Ju dhe Partia jonë e lavdishme!

SHOKU ENVER HOXHA: Lufta heroike revolucionare që po zhvillon sot populli ynë i udhëhequr nga Partia për zgjidhjen e problemeve të mëdha e të ndërlikuara, në rrugën e mëtejshme të revolucionit, lufta kundër imperializmit e revizionizmit për mbrojtjen e atdheut tonë, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të çështjes së revolucionit botëror, të lirisë e të pavarësisë së popujve, do ta pasurojnë më tej rrugën e lavdishme të Partisë e të popullit tonë, duke ngritur gjithnjë lart e më lart emrin dhe autoritetin e tyre, si Parti revolucionare besnike e klasës punëtore, si popull i papërkulur revolucionar, liridashës dhe internacionalist.

Le të na ndriçojë historia e Partisë në rrugën tonë të drejtë, le të na e forcojë më tej besimin e patundur në doktrinën e madhe të mësuesve tanë të mëdhenj, Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit dhe le të na frymëzojë për të luftuar më me vendosmëri, më me pjekuri e guxim për të marrë të gjitha kalatë e për të ecur gjithnjë përpara drejt fitoreve të reja madhështore!

Le ta pimë këtë gotë për Partinë tonë të lavdishme, për klasën punëtore, për ju shokë tipografë dhe për të gjithë shokët që janë të pranishëm në këtë takim! U transmetoni shokëve tuaj tipografë urimet dhe falënderimet e Komitetit Qendror dhe të miat personalisht për kryerjen e kësaj detyre të madhe! Edhe ju, shokë të Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste u transmetoni gjithë shokëve dhe bashkëpunëtorëve, që

kanë kontribuar për përgatitjen dhe botimin e kësaj
vepre të madhe, falënderimet dhe urimet më të nxehta
të udhëheqjes së Partisë!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

REPUBLIKA SOCIALISTE E ÇEKOSLLOVAKISË E MBËRTHYER NË DARËN E PUSHTUESVE REVIZIONISTË SOVJETIKË

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

19 nëntor 1968

Po mbushen tre muaj që Republika Socialiste e Çekosllovakisë ndodhet nën zgjedhën e rëndë të pushtimit fashist të revizionistëve sovjetikë. Populli çekosllovak ndodhet sot para domosdoshmërisë objektive që të ngrihet në luftë për çlirimin e vendit dhe për pavarësinë kombëtare.

Pushtimi i Çekosllovakisë ishte për revizionistët sovjetikë vetëm hapi i parë në arritjen e synimeve të tyre, që shkojnë shumë larg. Tani gjithë vendi — ekonomia, politika e jashtme dhe e brendshme, ushtria çekosllovake, qeveria dhe Partia Komuniste Çekosllovake, tërë jeta shoqërore u nënshtrohet interesit, politikës e diktatit brutal të pushtuesve, të cilët po përpiqen me të gjitha forcat për të stabilizuar gjendjen dhe për të konsoliduar regjimin e pushtimit. Ata orvaten të krijojnë në popullin çekosllovak iluzionin se gjoja Çekosllovakia është «e lirë» dhe «e barabartë midis të

barabartëve», se ushtria pushtuese është «ushtri mike», që ka ardhur gjoja të shpëtojë socializmin dhe Çekoslovakinë nga rreziku i kundërrevolucionit e i imperializmit, se qëndrimi i trupave të huaja në territorin e Çekoslovakisë është i përkohshëm etj., etj. Për të rrënjësuar këto iluzione po luhet farsa mashtruese e «tërheqjes graduale» të ushtrive pushtuese sovjetike nga Çekoslovakia, gjë që është një mashtrim i thjeshtë, sepse pushtuesit kanë në xhep çelësat e kufirit çekoslovak, ata nuk i japin llogari askujt dhe mund të dalin e të hyjnë në Çekoslovakë pa kontroll e pa doganë në çdo kohë, ditën dhe natën, si në arën e vet.

Por ç'do të thotë për revizionistët sovjetikë stabilizim i gjendjes në Çekoslovakë? Cilat janë synimet e tyre? Për udhëheqjen revizioniste sovjetike, në kushtet e sotme, Çekoslovakia përfaqëson një pikë nevralgjike me rëndësi të madhe strategjike, ushtarake, politike dhe ekonomike. Për pozitën e saj gjeografike në qendër të Evropës, Çekoslovakia zë një vend të rëndësishëm në strategjinë e përgjithshme të klikës revizioniste sovjetike: ajo ka të bëjë drejtpërdrejt me sigurimin e kufijve të Bashkimit Sovjetik, është një urë kalimi midis tij e vendeve të tjera revizioniste evropiane, si dhe midis tij e Perëndimit. Si vend industrial e tregtar i zhvilluar, Çekoslovakia i duhet udhëheqjes sovjetike për përfitime ekonomike të drejtpërdrejta dhe si levë në marrëdhëniet e saj ekonomike me vendet e zonave të saj të influencës dhe me Perëndimin. Prandaj pikësynimi i përgjithshëm i klikës revizioniste sovjetike është që, me anën e diktatit ushtarak e me mjete të tjera, të marrë në dorë të gjitha pozitrat kyç në Çeko-

sllovak, në mënyrë që kjo të jetë një provincë e nënshtruar e Bashkimit Sovjetik, nën etiketën e rreme «Republika Socialiste e Çekosllovakisë».

Për të arritur një «stabilizim» të tillë, pushtuesit revizionistë sovjetikë përpiqen që ushtria çekosllovake të bëhet një apendiks, një ushtri e çarmatosur dhe e bindur ndaj urdhrave të sovjetikëve, krejt e paaftë të luajë ndonjë rol në kryengritje e në luftë kundër pushtuesit. Ata po e spastrojnë ushtrinë çekosllovake nga kuadrot kundërshtarë dhe po organizojnë brenda saj sigurimin sovjetik nën petkun e «këshilltarëve» të shumtë sovjetikë. Ata synojnë ta shndërrojnë kështu ushtrinë çekosllovake në një armë në shërbim të pushtuesve revizionistë sovjetikë e të veglave të tyre kundër popullit çekosllovak, i cili po ngrihet në një rezistencë gjithnjë më të vendosur.

Nënshtrimi ekonomik i Çekosllovakisë, si dhe i vendeve të tjera satelite revizioniste, ka qenë një politikë e përhershme e grupit udhëheqës shovinist hrushovian të Bashkimit Sovjetik. Pasojat e saj kanë qenë të rënda. Pas rrëzimit të klikës së falimentuar të Novotnit, grupi i Dubçekut ishte i detyruar të konstatonte me shqetësim se 9 nga 10 automobilë në Çekosllovakë vihen në lëvizje me anën e benzinës sovjetike, se 2 në çdo 3 bukë gatohen me miell sovjetik dhe se uzinat metalurgjike i ndërpresin punimet brenda pak ditëve në rast se ndërpritet furnizimi i mineraleve sovjetike. Marrëveshjet ekonomike skllavëruese, që klika kapitulluese e Dubçek-Svobodës nënshkroi me qeverinë sovjetike në ditët e pushtimit të Çekosllovakisë, e lidhën akoma më shumë ekonominë çekosllovake pas asaj

sovjetike. Por në kuadrin e «stabilizimit» udhëheqja revizioniste sovjetike synon të likujdojë edhe orvatjen më të vogël për pavarësi ekonomike të Çekoslovakisë dhe të bëjë që gjithë ekonomia çekoslovake të vihet nën varësinë e plotë të ekonomisë sovjetike, në formën e «bashkëpunimit socialist», të «ndarjes socialiste ndërkombëtare të punës» nëpërmjet KNER-it e mekanizmave të tjerë. Në maskën e «këshilltarëve» të panumërt, çdo degë e ekonomisë çekoslovake po vihet e do të vihet nën kontrollin e rreptë të sovjetikëve. Këta përpiqen të vënë nën kontroll investimet, në mënyrë që këto t'u përgjigjen në radhë të parë nevojave e interesave sovjetikë. Udhëheqja revizioniste sovjetike synon veçanërisht që zhvillimi i industrisë çekoslovake të varet kryesisht nga lënda e parë, nga nafta, nga mineralet dhe nga energjia elektrike, që i furnizon Bashkimi Sovjetik, të vihet ky zhvillim plotësisht në mëshirën e udhëheqjes sovjetike, të kontrollohet prej saj shpërndarja dhe korona çekoslovake të ndodhet nën varësinë e nën kontrollin e rublës sovjetike. Udhëheqja sovjetike kërkon, gjithashtu, të vërë nën një kontroll të rreptë tregtinë e jashtme çekoslovake, në mënyrë që kjo të zhvillohet në pjesën dërrmuese me Bashkimin Sovjetik e me satelitët e tij dhe t'u përgjigjet interesave ekonomikë e politikë të kësaj klike, në përshtatje me koniunkturën që krijohen në stanin revizionist e në marrëdhëniet e saj me botën kapitaliste. Kjo është në fakt rruga e shndërrimit të Çekoslovakisë në një «gjysmëkoloni industriale» të udhëheqjes socialimperialiste sovjetike.

Pushtuesit revizionistë sovjetikë po ushtrojnë një

presion të madh për të vënë nën një censurë të rreptë opinionin publik çekoslovak. Ky ishte një ndër nenet kryesore të marrëveshjes së pushtimit që ata nënshkruan me klikën kapitulluese të Dubçek-Svobodës. Çdo manifestim publik kundër pushtuesve shtypet egërsisht nga policia revizioniste çekosllovake, ndërsa prapa saj qëndrojnë të gatshme për të vepruar me zjarr e me hekur tanket sovjetike. Çdo shprehje e lirë e mendimit shoqërohet me masa represive dhe me një demagogji të madhe mbi «forcat kundërrevolucionare e antisocialiste akoma në veprim».

Nën presionin brutal të pushtuesve, arsimit dhe kultura, gjithashtu, do të pësojnë ndryshime në emër të «frymës së vërtetë internacionaliste e socialiste», që me fjalë të tjera do të thotë shuarje e frymës patriotike dhe e rezistencës kundër pushtuesve, sidomos në rininë çekosllovake, rezistencë që do të ziejë, do të jetë e madhe e me kokëçarje për pushtuesit.

Mbi të gjitha, e para së gjithash, synimi i udhëheqjes revizioniste sovjetike është të hedhë plotësisht në dorë udhëheqjen e partisë e të shtetit në Çekoslovakë. Kjo është copa e madhe, kyçi i çdo gjëje, sepse pikërisht kjo do t'i shërbejë si maskë për të stabilizuar e për të konsoliduar regjimin e pushtimit dhe sundimin sovjetik në Çekoslovakë. Në këtë është përqendruar tani lufta kryesore e pushtuesve revizionistë sovjetikë, por pikërisht këtu ata nuk kanë arritur akoma suksesin e dëshiruar.

Duke ndërmarrë me ngut agresionin e armatosur kundër Çekoslovakisë, klika udhëheqëse revizioniste sovjetike nuk mundi të sigurojë as edhe mbështetjen

formale të ndonjë grupi a qeverie kuislinge që të justifikonte në njëfarë mënyre para popullit çekoslovak këtë akt tipik fashist. Revizionistët sovjetikë qëndrojnë të zbuluar si pushtues. Lufta bëhet për t'u mbuluar.

Pushtimi i Çekoslovakisë u krye nga revizionistët sovjetikë me lehtësi e pa kundërgoditje sepse klika revizioniste e Dubçek-Svobodës kapitulloi. Ajo frenoi me çdo mjet rezistencën e popullit çekoslovak dhe i dha urdhër ushtrisë çekoslovakë të mos bëjë as kundërshtimin më të vogël. E trembur për vdekje nga presionet e pushtuesve sovjetikë, ajo i siguron ata për «besnikërinë e pandryshueshme ndaj miqësisë me Bashkimin Sovjetik», vazhdon t'i bëjë thirrje të njëpasnjëshme popullit çekoslovak të mos bëjë rezistencë, dënon manifestimet popullore kundër pushtuesve dhe nuk ndalet as para përdorimit të dhunës e arrestimeve në masë ndaj «kokëfortëve që prishin rendin» me fjalë të tjera, ndaj patriotëve të vërtetë që po ngrihen në luftë kundër pushtuesve.

Klika Dubçek-Svoboda iu nënshtrua në vija të përgjithshme diktatit të pushtuesve sovjetikë, gjë për të cilën dëshmojnë qartë marrëveshjet kapitulluese që ajo ka nënshkruar me ta, e që po i zbaton me servilizëm, por që kanë hasur në protestën e ligjshme e gjithnjë në rritje të popullit çekoslovak. Por në kushtet dhe në rrethanat e krijuara, duke përfituar nga rezistenca popullore ndaj pushtimit dhe duke u përpjekur të shfrytëzojë në interes të saj ndjenjat patriotike të popullit çekoslovak, ajo orvatet të rezistojë për t'u shkëputur koncesione sovjetikëve, për t'i detyruar këta të mos e flakin nga postet drejtuese që mban në

parti e në pushtet. Pushtuesit revizionistë sovjetikë janë gati të bëjnë diçka në rast se klika e Dubçek-Svobodës u nënshtrohet planeve të tyre skllavëruese, dhe sidomos, gjë që është me rëndësi jetike për pushtuesit, në rast se ajo pranon të njohë publikisht se sovjetikët gjoja «erdhën si miq, si çlirimtarë, si mbrojtës të socializmit e të popullit çekoslovak», se «vepruan si internacionalistë» etj., etj., me fjalë të tjera, në rast se klika e Dubçek-Svobodës pranon të justifikojë e të përlligjë para popullit çekoslovak e opinionit botëror agresionin revizionist sovjetik. Por kjo klikë, që përfaqëson interesat e borgjezisë nacionaliste çekoslovakë, nuk e pranon këtë hëpërhë, sepse ndryshe çjerr maskën që i shërben për të gënjyer masat dhe do të nënskruante aktin e falimentimit të saj të plotë dhe të vetëlikuidimit. Prandaj ajo, siç thamë, vepron me demagogji, përpiqet të shfrytëzojë në interes të saj momentin nacional, patriotizmin e popullit çekoslovak, për t'u rezistuar presioneve sovjetike.

Ja përse, me gjithë shërbimet që u ka bërë e u bën klika tradhtare e Dubçek-Svobodës për të sabotuar e për të shuar çdo lëvizje rezistence nga ana e popullit çekoslovak, revizionistët sovjetikë nuk kanë besim tek ajo dhe, për të kapërcyer momentin nacional, që përbën sot pengesën kryesore për ta, për të justifikuar e për të përlligjur agresionin e tyre kundër popullit çekoslovak, janë kthyer nga pasuesit e Novotnit, nga klika e të ashtuquajturve veteranë, vegla të drejtpërdrejta e të bindura të udhëheqjes revizioniste sovjetike. Ata kanë shpërthyer, pra, luftën fraksioniste në gjirin

e PK Çekoslllovakë. Kjo luftë po zhvillohet e po thellohet dita-ditës, duke u shtrirë edhe jashtë partisë.

Në periudhën e parë të pushtimit revizionist sovjetik, përkrahësit e rrymës revizioniste novotniste, shërbëtorë të bindur të udhëheqjes sovjetike, të ndodhur përballë protestës popullore kundër pushtimit, e të damkosur si kolaboracionistë, rrinin të struktur e nuk ndiheshin. Tani, me nxitjen dhe me përkrahjen e pushuesve sovjetikë e për nevojat e këtyre kanë filluar të aktivizohen e të ngrenë krye kundër klikës revizioniste të Dubçek-Svobodës. Ata po zhvillojnë një veprimtari të gjerë në parti për të minuar pozitën e grupit të Dubçekut, po organizojnë mbledhje e manifestime të hapëta kundër tij e në mbrojtje të pushtimit sovjetik. Duke spekuluar me demagogji me parullat e mbrojtjes së socializmit, revizionistët «veteranë» akuzojnë klikën revizioniste të Dubçek-Svobodës se me kursin e saj i hapi rrugën kundërrevolucionit në Çekosllovaki, vuri në rrezik fitoret socialiste të popullit çekoslllovak, dhe se me këto veprime i vuri Bashkimin Sovjetik dhe «aleatët» e tjerë nga Traktati i Varshavës para domosdoshmërisë që të ndërhyjnë «për të shpëtuar socializmin dhe për të mbrojtur Çekosllovakinë» etj. Kështu përpiqet njëra klikë revizioniste, ajo novotniste, të minojë e të rrëzojë nga fuqia klikën tjetër revizioniste, atë të Dubçek-Svobodës, të rifitojë pozitën e humbura në janar, të mashtrojë popullin çekoslllovak, të thyejë rezistencën e tij dhe ta detyrojë t'i nënshtrohet kokulur pushtimit fashist të revizionistëve sovjetikë.

Klika revizioniste e Dubçek-Svobodës, që e sheh

rrezikun, po kundërvepron me të gjitha mjetet që ka në dispozicion për të diskredituar e për të mposhtur kundërshtarin dhe për të ruajtur pozitat e veta në parti e në shtet. Ajo po vepron me demagogji të madhe, duke u orvatur ta paraqesë kursin e saj revizionist të pasjanarit si një kurs «socialist të vërtetë» e që gëzon gjoja përkrahjen e masave të gjera të popullit çekoslovak e u përgjigjet gjoja interesave të tij. Njëkohësisht, kërkon të krijojë përshtypjen se çështja e zhvillimit të pavarur dhe e sovranitetit të Çekosllovakisë qenka e lidhur pikërisht me zbatimin e këtij kursi antimarksist e kundërrevolucionar. Në këtë mënyrë, duke spekuluar pa skrupull me ndjenjat kombëtare të popullit çekoslovak, ajo përpiqet ta vërë klikën revizioniste kundërshtare të «veteranëve» në opozitë me masat e popullit, ndërsa veten ta paraqesë si përfaqësuese të interesave e të vullnetit të popullit.

Secili fraksion revizionist, pra, po përpiqet me të gjitha forcat të mashtrorë e të bëjë për vete popullin çekoslovak, ta shfrytëzojë atë për interesat e tij kundërrevolucionarë dhe për të qeruar hesapet me klikën kundërshtare.

Ndërkohë, rezistenca e popullit çekoslovak kundër pushtimit revizionist sovjetik po rritet. Me gjithë masat e egra shtypëse të pushtuesve e të qeveritarëve kapitulantë revizionistë, në ditët e festave me rastin e 50-vjetorit të shpalljes së Republikës Çekosllovaqe, e sidomos të 51-vjetorit të Revolucionit të Tetorit, në shumë qytete të Çekosllovakisë shpërthyen demonstrata kundër pushtuesve, për lirinë dhe për pavarësinë e vendit. Në zona të ndryshme të vendit po ngrihen organizata

klandestine për luftë të organizuar kundër pushtimit. Në procesin e kësaj rezistence popullore në rritje po del çdo ditë e më qartë para popullit çekoslovak fytyra e vërtetë tradhtare e kapitulluese e klikës revizioniste të Dubçek-Svobodës, po duket çdo ditë më sheshit pozita e saj demagogjike e mashtruese lidhur me çështjen kombëtare. Për masat e gjera të popullit çekoslovak po bëhet e do të bëhet çdo ditë më e qartë se liria dhe pavarësia e vërtetë e vendit mund të arrihen vetëm me një luftë të vendosur jo vetëm kundër pushtuesve revizionistë sovjetikë, por edhe kundër klikave revizioniste vendëse, si kundër klikës novotniste të «veteranëve» që janë vegla të bindura të pushtuesve, ashtu edhe kundër klikës revizioniste kapitulluese e tradhtare të Dubçek-Svobodës.

Në kushtet e sotme në Çekoslovakë po kristalizohen, pra, dy vija lufte: nga njëra anë, rezistenca gjithnjë në rritje e popullit çekoslovak, e cila do të shndërrohet në një luftë çlirimtare kundër pushtuesve revizionistë sovjetikë për lirinë dhe për zhvillimin e pavarur socialist të vendit; nga ana tjetër, lufta ideopolitike për pushtet midis dy klikave revizioniste. Të dy klanet revizioniste, njëri i mbështetur nga pushtuesit sovjetikë, tjetri nga borgjezia nacionaliste vendëse e reaksioni i jashtëm imperialist, mund të kalojnë duke i bërë koncesione të përkohshme njëri-tjetrit, ashtu sikundër edhe mund të goditen. Të dy këto klane, për t'u maskuar e për të mashtruar masat me iluzionin e socializmit, do të përpiqen të shfrytëzojnë emrin dhe autoritetin e Partisë Komuniste Çekoslovakë të vjetër.

Në situatat e krijuara, kur populli çekoslovak

është ndeshur ballë për ballë me pushtuesit revizionistë sovjetikë dhe me klikat tradhtarë revizioniste të Dubček-Svobodës e novotniste, kur para tij shtrohet nevoja historike e një lufte për jetë a vdekje për lirinë e vendit dhe për idealet e socializmit, në këto situata marksistë-leninistët revolucionarë çekoslovakë e kuptojnë rolin e madh që duhet të luajnë, e kuptojnë se krijimi sa më parë i partisë revolucionare marksiste-leniniste çekoslovakë është detyrë imperative e jetike. Pa këtë nuk mund të ketë luftë të vërtetë për çlirimin kombëtar e socializmin në Çekoslovakë, nuk mund të kalohet nga rezistenca pasive e spontane në veprime revolucionare aktive e të organizuara në shkallë kombëtare. Rrethanat për krijimin e saj janë të favorshme. Hekuri duhet rrahur sa është i nxehtë, sepse pushtuesit sovjetikë e kuislingët vendës përgatitin koniunktura e kushte akoma më të rënda për revolucionarët marksistë-leninistë e për popullin çekoslovak.

Mund të parashikohet që klika revizioniste e Dubček-Svobodës, për të qëndruar në fuqi dhe për të evituar goditjet e drejtpërdrejta të pushtuesit, t'i bëjë atij të tjera lëshime të shumta. Kjo klikë kapitulluese ka frikë të madhe nga përleshjet civile, nga lufta dhe nga veprimet popullore, të cilat do të shkaktojnë ndërhyrje e presione të reja nga ana e revizionistëve sovjetikë, duke qenë se kjo luftë e këto përpjekje kanë për qëllim goditjen e pushtuesit. Ajo do të vazhdojë kështu të mos guxojë t'u bëjë një rezistencë të vërtetë presioneve, kërcënimeve e shantazhit të pushtuesve. Pra, ajo nuk do të ngurrojë të marrë masa shtypëse, siç po

merr, kundër rezistencës popullore, për të ruajtur kësh-tu pozitat e saj drejtuese në parti e në shtet.

Por marrja e masave represive kundër lëvizjes së rezistencës do të ketë si pasojë të pashmangshme demaskimin dhe diskreditimin e plotë të klikës tradhtare të Dubçek-Svobodës, gjë që, pa dyshim, do të shfry-tëzohet nga pushtuesit sovjetikë për t'i qëruar më në fund hesapet me këta bashkëpunëtorë të pasigurt e për t'i hedhur frenat e partisë e të pushtetit në duart e klikës novotniste të «veteranëve», shërbëtorë të bindur të udhëheqjes revizioniste sovjetike e kuislingë të vërtetë.

Kjo bandë revizioniste, e rikthyer në fuqi, do të përpiqet të rikrijojë një situatë si ajo e kohës së No-votnit, por këtë herë me njerëz të rinj, besnikë të kursit të tanishëm të udhëheqjes sovjetike. Kjo bandë re-negatësh, në ujdi me pushtuesit, do të shpallë një poli-tikë gjoja «të re, të pavarur, në unitet socialist me Bashkimin Sovjetik» etj. dhe që «mban parasysh edhe disa momente pozitive të kursit të pasjanarit». Prapa kësaj zhurme demagogjike, kjo bandë revizioniste, në emër të «socializmit e të diktaturës së proletariatit», do të goditë ashpër rezistencën revolucionare të klasës pu-nëto-re e të popullit çekoslovak, të cilën do ta quajë «kundërrevolucion».

E tillë është situata. Momentet janë të komplikua-ra, por edhe të favorshme për krijimin e partisë së marksistë-leninistëve çekoslovakë dhe për organizimin e luftës revolucionare të popullit çekoslovak. Në ra-dhë të parë e mbi të gjitha këtë e dikton dhe e favori-zon momenti nacional. Gjendja në Çekoslovakia është e

elektrizuar. Rezistenca popullore kundër pushtimit të huaj, kundër pushtuesve revizionistë sovjetikë, për çlirimin e për pavarësinë kombëtare, i ka vënë vulën e vet tërë jetës politike të vendit, është bërë strumbullari kryesor rreth të cilit shtjellohen ngjarjet. Ky është një faktor i brendshëm vendimtar, një moment jetik, mbi bazën e të cilit revolucionarët marksistë-leninistë çekoslovakë mund dhe duhet të bashkojnë e të mobilizojnë masat e gjera të popullit çekoslovak.

Pra, momenti nacional dikton dhe lehtëson formimin e Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) Çekoslovakë, lejon zhvillimin e veprimtarisë së saj ilegale e legale, organizimin e luftës kundër pushtuesve e veprimeve të tyre, si dhe kundër dy rrymave renegate që po shqyhen brenda dhe jashtë Partisë Komuniste Çekoslovakë revizioniste.

Partia proletare e tipit të ri, e ndërtuar mbi baza të shëndosha ideologjike e organizative marksiste-leniniste, me një unitet të çeliktë e disiplinë të ndërgjegjshme proletare, partia e re marksiste-leniniste çekoslovakë do të grumbullojë në gjirin e saj elementët më të mirë e më të vendosur të klasës punëtoare e të masave të tjera punonjëse, njerëz të veprimit revolucionar, të vetëmohimit e të sakrificës për interesat e revolucionit, të socializmit e të popullit, që e dinë se vetëm një parti e tillë është e aftë të udhëheqë e të çojë në fitore luftën e madhe e të vështirë historike që qëndron sot para popullit çekoslovak.

Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) Çekoslovakë do t'i duhet të zhvillojë një luftë konsekuente, të gjithanshme, frontale, sepse nuk mund të zhvillohet

me sukses lufta për çlirimin kombëtar, lufta kundër pushtuesve revizionistë sovjetikë, pa zhvilluar në të njëjtën kohë dhe pa e lidhur luftën çlirimtare me luftën ideologjike e politike kundër revizionizmit sovjetik dhe atij çekoslovak, që përpiqen ta përlligjin dhe ta përjetësojnë pushtimin, si dhe me luftën ideologjike e politike kundër imperializmit, revanshizmit gjermano-perëndimor, borgjezisë çekoslovakë dhe gjithë reaksionarëve të ndryshëm, të cilët përpiqen të rivendosin në Çekoslovakia rendin e shfrytëzimit kapitalist dhe ta lidhin atë pas qerres së borgjezisë ndërkombëtare. Kështu, brenda vendit para Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) Çekoslovakë qëndron një front i trefishtë luftime klasore: kundër pushtuesve revizionistë sovjetikë, kundër klanit revizionist të Dubček-Svobodës dhe kundër klanit revizionist të «veteranëve».

Luftë e pamëshirshme thikë më thikë kundër pushtuesve revizionistë sovjetikë, luftë ideologjike e politike për demaskimin e frazeologjisë së tyre demagogjike «socialiste» e «internacionaliste» dhe luftë e armatosur deri në dëbimin e plotë të tyre nga Çekoslovakia, — kjo është e vetmja parullë e drejtë rreth së cilës do të bashkohen e do të hidhen në aksion masat e gjera të popullit çekoslovak. Kurrfarë kompromisi e lëshimi pushtuesve!

Kjo luftë është arma kryesore edhe për demaskimin dhe për shpartallimin politik e ideologjik të dy grupeve revizioniste çekoslovakë, veçanërisht të klikës së Dubček-Svobodës, që përpiqet të spekulojë me momentin nacional. Në sfondin e kësaj luftime kundër pushtuesve do të dalë sheshit para popullit çekoslovak fy-

tyra e vërtetë e kësaj klike revizioniste si tradhtarë e atdheut dhe bashkëpunëtorë e pushtesit për sabotimin dhe për shtypjen e luftës popullore.

Lufta e PK (marksiste-leniniste) Çekosllovake nuk mund të mos drejtohet, gjithashtu, kundër imperializmit e borgjezisë reaksionare botërore, në mënyrë të veçantë kundër imperializmit amerikan e atij gjermanoperëndimor, që mbeten kurdoherë armiq të rrezikshëm të lirisë së popullit çekoslllovak e të socializmit. Revolucionarëve çekoslllovakë do t'u duhet të mbajnë vazhdimisht lart vigjilencën revolucionare të klasës punëtorë e të popullit çekoslllovak ndaj synimeve skllavëruese të imperialistëve dhe të demaskojnë me vendosmëri planet agresive që fshihen prapa demagogjisë së tyre për përkrahjen që gjoja i japin atij kundër pushtimit të revizionistëve sovjetikë.

Përcaktimi i drejtë i taktikave të luftës revolucionare, duke pasur kurdoherë parasysh luftën kundër pushtesit dhe momentin nacional, është me rëndësi të dorës së parë. Marksistë-leninistët revolucionarë çekoslllovakë kanë në këtë drejtim një eksperiencë të pasur, të fituar në kushtet e vështira të pushtimit nazist, si dhe në luftën për triumfin e revolucionit socialist në Çekosllovaki. Është e qartë se edhe në kushtet e sotme të Çekoslllovakisë së nënshtruar me forcën e armëve, lufta çlirimtare e popullit çekoslllovak nuk mund të zhvillohet me sukses, veçse në formën e luftës së armatosur. Prandaj përgatitja shpirtërore dhe materiale e masave pikërisht për luftën e armatosur, organizimi i sabotimeve të ndryshme, sigurimi i armëve, i radiostacioneve, i mjeteve të tjera të propagandës e të ndër-

lidhjes dhe gjetja e formave të përshtatshme të organizimit e të lidhjes me masat më të gjera të popullit, në kushtet e dhunës e të represioneve të egra të pushuesve e të forcave kuislinge, janë sot problemet e mëdha dhe jetike që presin zgjidhje. Dhe këto probleme mund t'i zgjidhë vetëm një parti e vërtetë marksiste-leniniste, edhe pse në rrethanat ekzistuese ajo është e detyruar të ndërtohet e të veprojë në kushte ilegale, pa lënë pas dore edhe mjetet legale kur këtë gjë e lejojnë rrethanat.

Eksperienca historike ka vërtetuar se për organizimin dhe për udhëheqjen e drejtë të revolucionit e të luftës çlirimtare është e domosdoshme të përcaktohen mirë forcat lëvizëse të saj dhe aleancat me forcat e ndryshme, duke u ruajtur nga çdo lloj deviacionesh oportuniste e sektare, të djathta e «të majta». Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kushtet e sotme të ndërlikuara të Çekosllovakisë, ku janë ndeshur një kompleks i tërë kontradiktash e forcash në luftë. Vendimtare është që në luftë e në përpjekje të krijohet nga baza një front i gjerë popullor, nën udhëheqjen e pandarë të Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) Çekosllovake. Vetëm një front i ngritur mbi bazën e bashkimit të drejtpërdrejtë të masave të gjera të popullit punonjës e të forcave patriotike nën udhëheqjen e partisë revolucionare marksiste-leniniste, dhe jo si aleancë sallonesh midis krerësh, vetëm një front i tillë mund të jetë efektiv e i qëndrueshëm, vetëm ai mund të jetë një mjet i fuqishëm në luftën për lirinë e pavarësinë kombëtare dhe për triumfin e socializmit.

Në Çekosllovaki ka një klasë punëtore të zhvilluar

e me tradita në lëvizjen revolucionare, e cila mund dhe duhet të qëndrojë në pararojë të të gjitha masave punonjëse. Nën udhëheqjen e Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) Çekosllovaqe dhe në aleancë me fshatarësinë e me të gjitha shtresat patriotike, ajo do të luajë rolin vendimtar në luftën për çlirimin e vendit dhe për triumfin e socializmit. Rinia çekosllovaqe, e cila ditë-ditës më me energji e më e vendosur po hidhet në luftën e rezistencës kundër pushtuesve revizionistë sovjetikë dhe po ndërmerr kundër tyre aksione të guximshme, është gjithashtu një forcë e madhe dhe e gjallë në luftën e sotme çlirimtare të popullit çekosllovak, një mbështetje e fuqishme e partisë marksiste-leniniste. Nën kujdesin e partisë e të klasës punëtore, në procesin e luftës çlirimtare, ajo do të flakë tej çdo ndikim helmues të revizionistëve dhe, me gjithë entuziazmin e saj rinor, do të hidhet në zjarr për çështjen e revolucionit e të socializmit në Çekosllovakë.

Duke shfrytëzuar momentin e përshtatshëm politik të krijuar nga regjimi i pushtimit, një fushë të rëndësishme veprimi përbën lufta për të fituar pozita politike e ideologjike edhe në radhët e ushtrisë së sotme çekosllovaqe, ku veçanërisht masa e ushtarëve, që janë bij të punëtorëve dhe të fshatarëve, është pushtuar nga zemërimi dhe është e revoltuar ndaj pushtuesve revizionistë sovjetikë. Por nuk duhen ushqyer iluzione të tepruara ndaj një ushtrie të borgjezuar, e cila komandohet nga oficerë që u binden urdhrave kapitullues të Svobodës e të renegatëve të tjerë. Prandaj, siç e tregon eksperiencia historike e luftërave çlirimtare e revolucionare, e vetmja rrugë e drejtë është krijimi në

luftë e sipër i një ushtrie krejt të re me të vërtetë revolucionare, të përbërë nga militantë të dalë nga gjiri i popullit, të kalitur në beteja e aksione dhe jo të përgatitur në shkolla e akademi borgjeze e revizioniste. Pa krijimin e një ushtrie të tillë, të edukuar, të brumosur e të udhëhequr nga partia revolucionare marksiste-leniniste, as që mund të bëhet fjalë seriozisht për luftë çlirimtare.

Si pjesë përbërëse e luftës së madhe të punonjësve e të popujve të të gjithë botës kundër armikut të tyre të përbashkët — imperializmit botëror, me atë amerikan në krye, dhe kundër agjenturës së tij të rrezikshme — revizionizmit modern, me klikën udhëheqëse sovjetike në krye, si pjesë e pandarë e lëvizjes revolucionare botërore, lufta çlirimtare e popullit çekoslovak gërshe-tohet e shkrihet në një unitet të ngushtë internacjonalist me luftën e madhe parimore antiimperialiste e antirevizioniste të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të të gjitha partive marksiste-leniniste e forcave revolucionare në botë, gëzon përkrahjen e tyre të sigurt e pa rezerva.

Revolucionarët marksistë-leninistë çekoslovakë krijimin e partisë së re, marksiste-leniniste dhe organizimin e luftës çlirimtare kundër pushtuesve revizionistë sovjetikë dhe klikave tradhtare revizioniste vendëse e kuptojnë si detyrën e tyre të lartë jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare. Çekoslovakia është bërë sot një gur prove dhe një pikë nevralgjike për të gjitha forcat revolucionare e përparimtare në klanin e Traktatit të Varshavës, një ndër arenat më të rëndësishme të luftës midis revolucionit e kundërrevo-

lucionit në stanin revizionist. Prandaj shembulli çekoslovak, zhvillimi revolucionar i ngjarjeve në këtë vend nuk mund të mos ndikojnë drejtpërsëdrejti edhe në vendet e tjera të nënshtruara ushtarakisht nga revizionistët modernë sovjetikë dhe që drejtohen prej tyre nëpërmjet klikave tradhtarë revizioniste. Ndërsa në Çekoslovakë bëhet loja me karta të hapëta, në kushtet e regjimit të pushtimit, në Poloni, në Hungari, në Bullgari e gjetkë gjendja i ngjet një kazani të mbyllur që zien dhe është gati për të plasur. Në këto vende po acarohen kontradiktat midis interesave kombëtarë të popujve dhe kërkesave hegjemoniste, imperialiste, të revizionistëve sovjetikë, të cilët ngado kanë dërguar forcat e tyre të armatosura, po acarohen kontradiktat midis masave të gjera punonjëse dhe klikave revizioniste, që i nënshtrohen diktatit të Kremlinit. Lufta revolucionare çlirimtare e marksistë-leninistëve çekoslovakë do të japë, pa dyshim, një kontribut të madh në luftën kundër udhëheqjes revizioniste sovjetike, si një ndër bastionet kryesore të kundërrevolucionit e të reaksionit botëror në kohën e sotme. Në mënyrë të veçantë marksistë-leninistët çekoslovakë do të japin kontributin e tyre për të demaskuar para gjithë popujve, sidomos para popujve të vendeve ku janë në fuqi revizionistët, rolin e vërtetë agresiv e skllavërues të Traktatit të Varshavës, si armë e realizimit të synimeve shoviniste e imperialiste të klikës renegate revizioniste të Bashkimit Sovjetik. Zhvillimi i ngjarjeve në Çekoslovakë dhe lufta revolucionare çlirimtare e marksistë-leninistëve çekoslovakë kundër pushtuesve revizionistë sovjetikë do të jetë një ndihmë dhe një nxitje për

gjithë popujt e vendeve satelite të revizionistëve sovjetikë, sepse do të nxjerrë sheshit kontradiktat e mëdha antagonistë që ekzistojnë nën një mbulesë hiri në gjithë stanin revizionist dhe do të bëjë që popujt e këtyre vendeve të shohin akoma më qartë se momenti i luftës çlirimtare shtrohet në mënyrë imperative edhe për ta.

Ngritja revolucionare në Çekoslovakia, lufta kundër pushtuesve revizionistë sovjetikë dhe veglave të tyre, për çlirimin kombëtar e shoqëror, do të lehtësojnë dhe do të shpejtojnë sidomos përhapjen e procesit revolucionar në Bashkimin Sovjetik, procesin e dekompozimit dhe të likuidimit të rendit revizionist në atë vend dhe në vendet e tjera revizioniste, do të lehtësojnë kontaktet dhe lidhjet me marksistë-leninistët revolucionarë të këtyre vendeve, do të organizojnë e do të koordinojnë veprimet e përbashkëta të pararojës revolucionare dhe, më në fund, do të dobësojnë në gjerësi e në thellësi kalanë e krimbur revizioniste.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 277 (6316), 19 nëntor 1968

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 257

TË JENI KURDOHERË NJERËZ TË PARAROJËS

Fjala në drekën e shtruar në kooperativën bujqësore të Shijakut me rastin e Konferencës së dytë kombëtare për zhvillimin e gjedhit.

6 dhjetor 1968

Në emër të shokëve që kemi ardhur nga Tirana, dëshiroj edhe unë t'ju falënderoj ju, shoku Qazim Top-taga¹ dhe, nëpërmjet jush, organizatën e Partisë dhe të gjithë punonjësit e kooperativës bujqësore të Shijakut, për punën shumë të madhe dhe të shkëlqyer që keni bërë në drejtim të zhvillimit dhe të forcimit të mëtejshëm të kooperativës. Kjo na gëzon pa masë dhe na mbush me shpresë e me besim se kolektivizimi në vendin tonë po ecën në rrugë të drejtë dhe do të ecë edhe në të ardhmen me hapa të mëdhenj përpara. Ne jemi bij të këtij vendi, prandaj kur mendojmë si kanë qenë arat, fushat dhe njerëzit tanë para një kohe jo shumë të largët dhe kur e shohim tani Shqipërinë sa ka ndryshuar e sa është zbukuruar, kur shohim popullin tonë sa ka përparuar e sa i gatshëm është për të ecur në rrugën që i tregon Partia jonë e madhe dhe e

1 Në atë kohë kryetar i kooperativës bujqësore të Shijakut.

lavdishme, atëherë gëzimi ynë është i papërshtuar dhe forcat na shumëfishohen.

Ne shohim se Shijaku, i cili është dëgjuar në histori gjatë luftërave për çlirim, duke përqaftuar, konkretizuar dhe zbatuar më së miri direktivat e Partisë për ndërtimin e socializmit në fshat, edhe sot është bërë shembull për të gjitha kooperativat e tjera bujqësore. Pikërisht këtë kanë vlerësuar Partia dhe Ministria e Bujqësisë kur vendosën të mbahet këtu Konferenca e dytë kombëtare për zhvillimin e gjedhit. Kjo konferencë do të ketë një rëndësi të madhe për këtë problem kaq jetik, për të mirën e popullit dhe të bujqësisë sonë.

U bë shumë mirë që zhvillimi i punimeve të kësaj konference u vendos të bëhej këtu në Shijak. Kjo do t'u japë një impuls akoma më të madh dhe inkurajim, në radhë të parë, vetë organizatës-bazë të Partisë, udhëheqjes së kooperativës dhe gjithë punonjësve të tjerë të saj për të bërë një hop akoma më të madh përpara në këtë sektor të rëndësishëm. Dhe kjo ka rëndësi nga ana politike dhe ideologjike.

Ne ju urojmë nga zemra që edhe në të ardhmen të keni suksese akoma më të mëdha në punën tuaj. Kurdoherë me punë të palodhur dhe të udhëhequr nga mësimet jetëdhënëse të Partisë të jeni njerëz të pararojës. Të thithni dhe të zbatoni në mënyrë krijuese eksperiencën e mirë në punë të klasës punëtore dhe të fshatarësisë kooperativiste të të gjithë vendit, duke qenë kurdoherë në garë me të tjerët, sepse gara ndihmon si kudo edhe në kooperativë zhvillimin dhe përparimin.

Të tërë e dimë se në drejtim të çështjes së gruas, Shijaku përpara, në krahasim me krahinat e tjera të vendit tonë, nuk qëndronte në pararojë. Por ç'konstatojmë tani? Ne shohim se shijakasi po e kuptojnë me të vërtetë dhe e kanë bërë të tyren thirrjen e drejtë të Partisë për emancipimin e gruas dhe për ndihmën që duhet t'i jepet asaj nga e gjithë shoqëria jonë socialiste, me qëllim që gruaja të përparojë. Në stallat e lopëve tuaja. që vizitua, ne pamë shumë vajza të reja, të afta. të pastra dhe të zgjuara. Të tilla, pra, janë bërë sot bijat e patriotëve shijakas dhe këtë ato e kanë merituar me përpjekjet e tyre të mëdha. Edhe ty, shoqe, që të kanë zgjedhur në kryesinë e kooperativës, të përgëzoj, se për të arritur këtu është pasur parasysh edhe kontributi yt si anëtare e Partisë.

Le ta ngremë këtë doli për shëndetin tuaj, për popullin punonjës të Shijakut, për Partinë tonë të lavdishme!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

PËR MBARËVAJTJEN E PUNËS DUIHEN NJOHUR GJENDJA DHE NJERËZIT

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

9 dhjetor 1968

SHOKU ENVER HOXHA: Si pikë të parë në rendin e ditës kemi çështjen: Si punohet për të zbatuar orientimet e Komitetit Qendror të Partisë për rritjen e kuadrove nga radhët e grave në sektorët e arsimit dhe të shëndetësisë.

Kush nga shokët e komiteteve të Partisë dëshiron të flasë? Mund të na flitni ju shoku Adli?

SHOKU ADLI DIBRA²: Për këtë problem edhe në rrethin tonë është treguar kujdes dhe kemi rezultate. Kështu, për shembull, në krahasim me vitin 1966, nu-

1 Në këtë mbledhje, ku raportuan Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, Ministria e Shëndetësisë dhe komitetet e Partisë të rretheve Fier, Lezhë e Dibër, u diskutua për zbatimin e orientimeve të KQ të PPSH për rritjen e kuadrove nga radhët e grave në sektorët e arsimit, të kulturës dhe të shëndetësisë.

2 Në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Dibrës.

mri i grave në sektorin e arsimit është rritur nga 16 për qind në 24 për qind, ndërsa në sektorin e shëndetësisë nga 42 për qind në 52 për qind. Nga 800 arsimtarë që ka rrethi, 200 janë shoqe.

SHOKU ENVER HOXHA: Si punojnë dhe çfarë arsimit kanë shoqet arsimtare në rrethin tuaj? Si i kuptojnë ato direktivat politike të Partisë? Do të jetë më mirë që, në vend të shifrave, të na flitni për gjendjen kulturore, arsimore, politike, ideologjike të këtyre arsimtareve, domethënë për botën e tyre shpirtërore, për shqetësimet dhe kënaqësitë e tyre. Këto na interesojnë, kurse për shifrat e përqindjet jemi në dijeni, ato i kemi parë në raportin që keni paraqitur.

SHOKU ADLI DIBRA: Në shumicën dërrmuese shoqet që punojnë në sektorin e arsimit janë me arsim të mesëm, përgjithësisht kanë mbaruar shkollën pedagogjike. Ato bëjnë mjaft përpjekje për t'u aftësuar në punën që kryejnë, janë shumë të vullnetshme dhe, për ngritjen e tyre ideologjike, politike e profesionale, mësojnë mirë. Në kursin që u organizua gjatë verës për përgatitjen e mëtejshme marksiste-leniniste të arsimtarëve, morën pjesë edhe shoqe, të cilat dolën me rezultate shumë të mira.

SHOKU ENVER HOXHA: Çfarë temash u zhvilluan në kurs?

SHOKU ADLI DIBRA: U zhvilluan disa tema për filozofinë, për materializmin dialektik dhe historik etj.

Në studimin individual shoqet tregojnë më shumë kujdes në krahasim me shokët.

SHOKU ENVER HOXHA: Po seksioni i arsimit ç'punë bën për kualifikimin e mëtejshëm të tyre?

SHOKU ADLI DIBRA: Seksioni i arsimit herë pas here organizon mbledhje me drejtorët dhe me nëndrejtorët e shkollave për probleme të ndryshme, në të cilat fton edhe shoqe arsimtare.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është tjetër punë, ato mbledhje bëhen më tepër për të dhënë detyra, prandaj duhet parë ç'bën seksioni i arsimit për ngritjen e mëtejshme ideopolitike dhe profesionale të arsimtarëve, kujdeset ai për të hapur kurse për ngritjen e tyre ideopolitike dhe profesionale, ashtu siç bëtë ju?

SHOKU ADLI DIBRA: Seksioni i arsimit nuk ka bërë ndonjë gjë të veçantë me shoqet.

SHOKU RAMIZ ALIA: Në Peshkopi kabineti metodik që merret me edukimin e arsimtarëve, sigurisht, duhet të ketë një program të veçantë për këtë qëllim.

SHOKU ADLI DIBRA: Me gratë arsimtare ai nuk bën ndonjë gjë të veçantë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po për gjithë arsimtarët e rrethit ç'bëhet nga ana e kabinetit metodik? Kur zhvillohen tema për kualifikimin e arsimtarëve, kush i bën ato dhe si bëhen? Shikohet ndonjëherë përmbajtja e tyre nga komiteti i Partisë ose nga Ministria e Arsimit, apo mjaftoheni vetëm me titujt e temave që dërgon ministria dhe me kaq punën e konsideroni të përfunduar?

SHOKU ADLI DIBRA: Zakonisht temat na kanë ardhur nga Ministria e Arsimit dhe janë bërë në rreth nga shokët e pushtetit ose nga arsimtarë të kualifikuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Cilat janë më të shkathta, arsimtaret e qytetit, apo ato të fshatit?

SHOKU ADLI DIBRA: Vëmë re se arsimtaret e

fshatit janë më të shkathta dhe më të predispozuara për të kaluar me punë nga periferia në zona më të thella. Kështu, për shembull, shoqet arsimtare nga fshatrat e lokalitetit të qendrës, që propozohen për kandidatë partie, janë të gatshme të shkojnë nga fshatrat e tyre në zonat e thella të rrethit.

Një punë e mirë është bërë, gjithashtu, nga Partia për përgatitjen e kuadrove të rinj për sektorin e shëndetësisë. Përveç atyre që aktualisht vazhdojnë shkollat e mesme për mami dhe ndihmësmjete, këtë vit me forcat tona hapëm pranë teknikumit bujqësor në Peshkopi shkollën trevjeçare të mamive, ku vazhdojnë mësimet 40 shoqe, të cilat janë të gjitha nga fshati. Kemi përgatitur dhe kemi në përgatitje e sipër edhe një numër të konsiderueshëm vajzash për aktiviste sanitare. Shoqet që kanë mbaruar këto kurse përveç punës si sanitare bëjnë edhe detyrën e kujdestares së çerdhes në fshat. Nga ana tjetër kemi pasur parasysh që në sektorin e shëndetësisë të ngrihen shoqe në përgjegjësi.

Për të lehtësuar gratë e fshatit kemi marrë masa që brenda 30 prillit të vitit të ardhshëm të ngrihen çerdhe në të gjitha fshatrat. Këto do t'i bëjmë në formë aksioni, ashtu siç bëmë për ngritjen e furrave të bukës në të gjitha kooperativat bujqësore.

SHOKU ENVER HOXHA: Keni menduar për përgatitjen e kuadrit dhe pajisjet që do të nevojiten edhe për hapjen e çerdheve e të kopshteve, ku mund të futen në punë qindra vajza? Sa fshatra ka rrethi juaj?

SHOKU ADLI DIBRA: Rrethi ynë ka 181 fshatra.

SHOKU ENVER HOXHA: Të 181 fshatrat do të duan rreth 360-400 edukatore. Kjo nuk është një shifër e vogël, prandaj keni marrë masa për t'i përgatitur të gjitha këto?

SHOKU ADLI DIBRA: Për përgatitjen e tyre kemi menduar të hapim kurse tremujore.

SHOKU ENVER HOXHA: Keni menduar seriozisht për këtë çështje se çfarë do të bëni, se, po të fillojnë të grumbullohen fëmijët në çerdhe, ata do të kenë nevojë medoemos për edukatore dhe ja, erdhi prilli.

SHOKU ADLI DIBRA: Do t'i bëjmë, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Si do t'i organizoni këto kurse nga ana teknike dhe pedagogjike? Keni mjete e mësues? Keni menduar për lëndët që do të zhvillohen në to? I keni bërë të gjitha këto përgatitje?

SHOKU ADLI DIBRA: Po, të gjitha përgatitjet i kemi bërë.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, por mos e merrni lehtë këtë çështje, prandaj bëni shumë kujdes!

Për ngritjen e kopshteve dhe të çerdheve, duhet të ndihmojë edhe populli. Është e nevojshme, gjithashtu, të merren masa për organizimin e mirë të punës për përgatitjen e njerëzve që do të merren me fëmijët etj., sepse në qoftë se nuk përgatitet në kohë kuadri i nevojshëm nuk do të funksionojnë dot çerdhet e kopshtet. Është e domosdoshme, pra, të tregohet kujdes dhe të luftohet deri në fund që të bëhen të gjitha këto që thuhet.

Ka ndonjë shok tjetër që dëshiron të flasë?

SHOKU RAMIZ ALIA: Mund të na flasë, mendoj-

më, edhe shoku Jashar Menzelxhiu¹, se ai ka eksperiencë të mirë në këtë drejtim.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është, por Jashari ka edhe eksperiencë jo të mirë. Dje lexova në gazetë një artikull shkruar nga shokët e Elbasanit, në të cilin thuhet që në çdo dyqan të fshatit ka nga 2 shitëse. Në kushtet tona të sotme kjo, më duket mua, nuk shkon.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Këtë vërejtje ma bëri edhe shoku Xhafer [Spahiu]. Dy shitëse mund të ketë në ndonjë dyqan të fshatit ku xhiroja është e madhe, po jo në të gjitha fshatrat.

SHOKU ENVER HOXHA: Të bëhet kujdes në këto gjëra, se gazeta lexohet kudo dhe, kur shkruhet diçka në «Zërin e popullit», është e natyrshme, ajo merret si direktivë. Prandaj edhe redaksia të ketë kujdes, se mund të ndodhë, fjala vjen, në këtë rast, që të na vënë kudo nga dy shitëse. Është e drejtë që në çdo fshat të ketë nga një mami, por dy shitëse në çdo dyqan fshati, nuk është e drejtë, kjo është antiekonomike.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Sektorët ku mund të futen për të punuar më shumë gra e vajza janë arsimi, shëndetësia dhe tregtia. Këtu duhet parë edhe çështja e ngritjes së tyre në përgjegjësi. Në të vërtetë, kohët e fundit edhe në rrethin tonë, si nga komiteti ekzekutiv, ashtu edhe nga komiteti i Partisë, në këtë drejtim është punuar më mirë.

1 Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit.

SHOKU ENVER HOXHA: A veni ju në shkolla ku të njiheni nga afër e të bisedoni me arsimtarë e arsimtare?

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Po, shkojmë. S'ka shumë që isha në shkollën e Gjergjanit. Në këtë shkollë ka 15 arsimtarë, nga të cilët 10 janë vajza dhe 5 djem.

SHOKU ENVER HOXHA: Ke asistuar në ndonjë mbledhje të këshillit pedagogjik? Ç'mund të na thoni për mendimet, konceptet dhe idetë që shfaqin ata në këto mbledhje?

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Në mbledhje të këshillit pedagogjik nuk kam asistuar, por kam vajtur në seminarët e organizuara me arsimtarët, ku kam konstatuar se shumë prej tyre shfaqin mendime konstruktive, luftarake.

Tani që po zhvillohet diskutimi për revolucionarizimin e shkollës, arsimtarët japin mjaft mendime të mira për problemin e mbarëvajtjes së arsimit. Në ato shkolla fshati ku kemi shoqe arsimtare, ato kanë marrë në dorë edhe drejtimin e aktivitetit kulturor në fshat, ndihmojnë dhe marrin vetë pjesë aktive në to, kurse atje ku kemi djem, aktivitetet kulturore janë më të dobëta.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju, mendoj unë, duhet të asistoni edhe në mbledhje të këshillave pedagogjike.

Do të ishte me interes të na thuhej se si reflektohet kultura e arsimtarit në dhënien e mësimit, prandaj duhet të na flitni më konkretisht. Kur themi, për shembull, që arsimtarët i lexojnë gazetën, romanet, vjershat etj. kjo është një gjë shumë e mirë, dhe, në

realitet, ka shumë nga ata që lexojnë, por bëhet pyetja: Kush janë ata që gjatë mësimit përmbajtjen e teksteve e pasurojnë me shembuj më të gjallë, dhe, duke i lidhur çështjet me jetën e vendit, i bëjnë kështu orët e mësimit më frytdhënëse? Nga ana tjetër, pse ndodh që u qëndrojnë strikt teksteve të shtypura dhe nuk e pasurojnë shpjegimin e mësimit me shembuj nga jeta e gjallë? Me një fjalë, si reflektohet në orët e mësimit kultura që marrin vetë mësuesit, çdo ditë, nëpërmjet shtypit dhe librave që lexojnë? Për ngritjen e grave në përgjegjësi është e lehtë të na thuhet se ka konservatorizëm, por ne duhet të dimë konkretisht si kuptohet dhe ku qëndron ky konservatorizëm. Diku ky qëndrim mund të motivohet, sidomos atje ku niveli i shoqeve është akoma i ulët, por neve na intereson të dimë, sidomos, pse ka konservatorizëm në ato raste kur shoqet janë me të vërtetë të ngritura dhe plotësisht në gjendje të drejtojnë, pra, kur e meritojnë të ngrihen në përgjegjësi. Në rast se shohim konkretisht që shoqet kanë iniciativë, i kryejnë detyrat në mënyrë revolucionare, shfrytëzojnë mirë kohën e punës, bëjnë përpjekje për ngritjen e aftësive të tyre, atëherë s'ka asnjë arsye që të qëndrojnë drejtor shkolle një burrë, por është më mirë të bëhet drejtor e shkollës një arsimtare që ka cilësitë e lartpërmendura, se e meriton. Në të kundërtën mund të themi se këtu ka konservatorizëm. Që të realizohet kjo, duhet njohur gjendja, duhen njohur njerëzit. Në punën tuaj ju nuk duhet të kufizoheni vetëm duke vajtur në aktive, po të mbani lidhje me njerëzit edhe gjatë jetës së tyre të përditshme. Kjo ka shumë rëndësi, sepse në një aktiv mund

të marrë pjesë edhe një vajzë e re, e cila nuk është aq e dalluar sa të tjerat, por, me një diskutim të mirë që mund t'ia kenë përgatitur më parë të tjerët, të krijon përshtypjen se është e aftë dhe vendoset për ta ngritur në përgjegjësi para kohe, pra, pa e merituar.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Shpesh, kur vjen puna për të diskutuar ngritjen e një kuadri në përgjegjësi, kandidatët vihen në balancë, kush duhet të ngrihet, një burrë apo një grua. Në rrethin tonë rezulton se në përgjithësi niveli i grave është akoma më i ulët se ai i burrave. Kjo nuk mund të absolutizohet, se nuk duhen mohuar përpjekjet e mëdha që bëjnë shoqet në punë dhe për ngritjen e tyre ideopolitike e profesionale, por konstatojmë se sidomos gratë me fëmijë bëjnë më pak përpjekje për ngritjen e tyre, ndërsa ato që janë të reja në disa sektorë më të përshtatshëm për to, japin më tepër rezultate, siç ndodh për shembull për lidhjen e mësimit me jetën dhe në aktivitetet jashtëshkollore. Në aktivitete të tilla, si në përgatitjen e grupeve artistike dhe në organizimin e shfaqjeve e të manifestimeve të ndryshme në shkollë e jashtë saj, arsimtaret ndihmojnë më shumë.

SHOKU ENVER HOXHA: Punonjësit e Ministrisë së Arsimit e të Kulturës, si dhe shokët e Partisë, që i ndjekin këto çështje, nuk duhet të venë në shkollë vetëm sa për të parë si e japin mësimin arsimtarët. Dihet se, si të gjithë, edhe arsimtarët, pas punës në klasë, diskutojnë për problemet e tyre jo vetëm në mbledhje, po edhe jashtë shkollës. Prandaj veç mbledhjeve që organizohen me ta për çështje të shkollës, duhet parë si i zhvillojnë bisedat midis njëri-tjetrit dhe në kolek-

tivin e tyre. Pra, nuk e kam fjalën vetëm për diskutimet e organizuara, po për bisedat që ata bëjnë në kohën e lirë, pas pune. Në këto biseda, a ngrenë ata vallë probleme të kulturës, a diskutojnë për librat që kanë lexuar ose për probleme të shkencës dhe të lëndëve që japin, për çështje që nuk përfshihen në programet e shkollës? Shkurt, si punonjës të arsimit dhe të kulturës, në orët e lira, a bëjnë përpjekje për ngritjen kulturore të tyre? A interesohen për problemet e shoqërisë 10-15 arsimtarët e një shkolle fshati? Sigurisht, në fshat nuk jepen shfaqje çdo natë, kurse shkëmbime e rrahje mendimesh për librin, për artikujt që lexojnë në gazetë, për këtë a për atë ngjarje që ka të bëjë me punën dhe me luftën e tyre të përditshme, mendoj se duhet të bëhen dhe patjetër bëhen, por është me interes të dimë si bëhet kjo për t'i shërbyer ngritjes së nivelit kulturor të tyre?

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Mund t'ju them ndonjë konkluzion që kam nxjerrë nga biseda që kemi pasur me arsimtarët, sepse posaçërisht e në mënyrë të organizuar për këtë problem nuk kam bërë gjë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sigurisht, sekretarit të parë të komitetit të Partisë të rrethit nuk i kërkohet të dijë me hollësi si e kanë organizuar dhe si e kalojnë arsimtarët kohën e lirë jashtë mësimit, por ama sekretarët e organizatave-bazë të Partisë në fshat që përfaqësojnë atje Partinë duhet t'i dinë dhe t'i zbatojnë në jetë orientimet e Partisë për problemet e shkollës, të dinë si t'i nxitin dhe t'i aktivizojnë punonjësit e arsimit dhe të kulturës në fshat, t'i mësojnë ata dhe të

mësojnë prej tyre. Ne u kemi vënë arsimtarëve për detyrë të mësojnë dhe të edukojnë fëmijët. Kjo është një detyrë partie nga më të rëndësishmet, prandaj komunistët e fshatit dhe sidomos sekretari i organizatës-bazë duhet të interesohen për kulturën e arsimtarëve, për punën dhe jetën e tyre. Në fshat kjo duhet të përbëjë një nga preokupacionet bazë për Partinë, sekretari i organizatës-bazë dhe gjithë komunistët e fshatit t'i ndjekin këto probleme, të thellohen në to dhe të përgjigjen me kompetencë.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Me thënë të drejtën, jemi shumë larg këtyre gjërave. I kemi porositur organizatat e Partisë të merren me jetën dhe me veprimtarinë e arsimtarëve, të kujdesen për hallet e tyre dhe në mënyrë të gjithanshme për problemet e shkollës, por kryerja e këtyre detyrave varet si nga kërkesat tona, ashtu edhe nga niveli i sekretarëve të organizatave-bazë të Partisë. Mirëpo shumë sekretarë organizatash-bazë dhe komunistë, duke qenë me një nivel kulturor më të ulët se arsimtarët, e ndiejnë veten inferiorë para tyre dhe druhen t'i trajtojnë me ta këto çështje.

SHOKU ENVER HOXHA: Ky inferioritet duhet mundur. Sekretari i organizatës-bazë të Partisë në fshat nuk mund të jetë me njohuri enciklopedike e me kulturë të madhe, por ai mundet dhe duhet të jetë organizator dhe nxitës për çdo sektor. Nga ana tjetër, edhe ai vetë duhet të bëjë përpjekje, të lexojë, natyrisht, e, në radhë të parë, në sferën e punës së tij si sekretar dhe si kooperativist. Duke qenë frymëzues, nxitës dhe organizator, në mënyrë shoqërore dhe jo

komanduese, ai mund të thërresë katër-pesë mësues, të cilëve t'u tregojë, fjala vjen, se ka lexuar një artikull për çështjen e shëndetësisë e të higjienës dhe me këtë rast u kërkon edhe atyre të shfaqin mendimin nëse në këtë fushë janë në rregull apo kanë probleme në fshatin e tyre. Këtej fillon diskutimi, gjatë të cilit arsimtarët japin edhe ata mendimet e veta. Sekretari mund të lexojë edhe ndonjë novelë (pasi të tilla botojnë edhe organet e shtypit), ndoshta mund të mos i analizojë dot si duhet momentet, ndjenjat e situatat shoqërore që shtjellohen në të, por jep edhe ai një mendim për të, për shembull, se një nga çështjet që trajtohet atje nuk i duket e drejtë, pse te ne nuk ngjet një gjë e tillë etj. Kështu fillojnë diskutimet, bëhen debate, rrihen mendimet e kundërta dhe në këtë mënyrë zhvillohet niveli kulturor dhe horizonti i arsimtarëve dhe i vetë sekretarit, frymëzohen mësuesit për punën dhe, si përfundim, kur arsimtarët venë në klasë, ua shpjegojnë më mirë nxënësve si duhet kuptuar ky apo ai mësim. Kur mësimi ka lidhje me një problem për të cilin është shkruar edhe në shtyp, mësuesi u thotë nxënësve se kjo çështje përputhet edhe me atë që është shkruar në gazetë.

Ne konstatojmë se, në përgjithësi, sekretarët e organizatave-bazë të Partisë në fshat nuk interesohen për problemet e shkollës, prandaj duhet t'i nxitim që të interesohen, sigurisht, jo në mënyrë skolastike. Për këtë qëllim puna duhet organizuar në atë mënyrë që, kur shokët e Partisë të rrethit venë në bazë, të mos interesohen vetëm për shifrat, por për brendinë e tyre. Kjo ka rëndësinë më të madhe për Partinë. Në rast se

shifrat tregojnë se me ngritjen e grave në përgjegjësi nuk jemi mirë, kjo do të thotë se pengon konservatorizmi, ose se këto janë me nivel ideologjik e kulturor akoma të pamjaftueshëm apo të ulët; atëherë për Partinë del detyrë të punojë për ngritjen ideokulturore të tyre pse kështu do të mund të përmirësohen edhe shifrat. Prandaj t'u vëmë më shumë rëndësi brendisë së çështjeve, aftësisë së njerëzve dhe jo shifrave.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Është e drejtë që ne të futemi më mirë në botëkuptimin e arsimitareve, sidomos të atyre që jetojnë në fshat. Me këto hasim edhe disa vështirësi, mbasi një pjesë e tyre janë të martuara dhe me fëmijë. Arsimtaret që punojnë rreth qytetit venë në fshat paradite sa bëjnë mësimin dhe në mbrëmje kthehen përsëri në qytet, ku kanë familjet. Kështu ato nuk kanë kohë të punojnë pas mësimin në fshat. Ndryshe qëndron puna me arsimtaret e reja, të cilat shkojnë edhe në zonat e thella, por edhe këto pasi shërbejnë atje disa vjet kërkojnë të kthehen përsëri në qytet.

SHOKU ENVER HOXHA: Vajzat e reja të qytetit martohen me djem fshatarë?

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Raste të tilla janë të rralla. Ka vajza që punojnë një kohë të gjatë në fshat dhe nuk vendosin të martohen atje. Bile na ndodhin edhe raste që vajza të fshatit, kur dalin mësuese, përpiqen të martohen në qytet.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është një çështje e rëndësishme, që ka të bëjë me botëkuptimin e njerëzve. Prandaj Partia duhet të punojë politikisht me mësueset e reja, që të lidhen më ngushtë me fshatin, të

krijojnë atje edhe familje, natyrisht në bazë të dashurisë së singertë, komuniste dhe jo me imponim. Pse të mos e pëlqejë një mësuese një djalë fshati, kur ky i shfaq dashurinë dhe i propozon të martohen bashkë?

Shumë vajza të reja nga qytetet, të nisura nga dashuria që kanë për popullin dhe atdheun, vullnetarisht i kërkojnë Partisë të venë për të punuar si arsimtare në zonat e thella. Ky është një gjest i lartë patriotik nga ana e tyre dhe tregon se ato janë të ngritura ideologjikisht dhe politikisht. Ato shkojnë atje dhe u sigurohen edhe banesa, edhe kushtet e tjera për punë dhe jetesë.

Derisa vajza e qytetit pranon të vejë të punojë tre vjet mësuese në fshat, ne mund t'i vëmë detyrë organizatës-bazë të Partisë që brenda kësaj kohe të punojë për t'ia zhdukur kësaj vajze edhe ndonjë pikëpamje mikroborgjeze që mund të ketë për fshatin si edhe të ndihmojë për t'ia bërë jetën në fshat më të këndshme. Shoqëria me të cilën ajo do të ketë të bëjë në fshat duhet të jetë e gjallë, e afërt, e ngrohtë, që arsimtarja të mos e ndiejë veten të izoluar. Ndaj mësuesve dhe mësueseve fshatarët, në përgjithësi, kanë respekt të madh sepse këta u mësojnë kalamanët. Kështu mësuesja mund të jetojë fare mirë, mund të krijojë bile edhe familjen e saj të shëndoshë, duke u martuar me një djalë të mirë, të ndershëm, të shëndetshëm e punëtor, që e ka njohur dhe e do. Një punë e tillë nga ana e komunistëve të fshatit mund dhe duhet të bëhet, po më duket se këto çështje nuk shikohen dhe nuk bëhen objekt i veprimtarisë së organizatave të Partisë në fshat.

SHOKU HYSNI KAPO: Mësueset i duan më shumë se këto futen edhe në familjet e fshatarëve, të cilët i konsiderojnë si bijat e tyre.

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Ne kemi bërë përpjekje edhe për ngritjen profesionale të shoqeve. Për t'ia arritur këtij qëllimi kemi marrë masa për t'i regjistruar në shkollat me korrespondencë. Kështu 70 për qind e të regjistruarve në institutin pedagogjik 2-vjeçar janë shoqe.

SHOKU ENVER HOXHA: Po në sektorin e shëndetësisë si venë punët te ju?

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Në zonat mallore janë hapur spitale, maternitete dhe infermieri, për të cilat kemi përgatitur edhe kuadrot e nevojshëm. Kështu kemi përgatitur 120 infermiere dhe parashikojmë që vitin e ardhshëm të kemi një infermiere në çdo fshat. Kemi hapur, gjithashtu, një kurs ku mësojnë 114 vajza për mami. Deri në vitin 1970 kemi parashikuar që në çdo fshat të ngremë një dhomë për lindje.

SHOKU ENVER HOXHA: Çfarë masash keni marrë për edukimin e mëtejshëm të gjithë këtyre kuadrove që keni përgatitur?

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Mamitë e fshatit vijnë një herë në muaj për të punuar në maternitetin e qytetit, me qëllim që të aftësohen më tepër.

SHOKU ENVER HOXHA: Bëhet në rregull kjo praktikë?

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Po. Kur venë në maternitet ato asistojnë në lindjet, raportojnë edhe për punën që secila ka bërë në fshatin ku shërben.

SHOKU ENVER HOXHA: Kur këto vijnë në qytet, a zhvillohen me to tema të ndryshme që kanë të bëjnë me profilin e tyre, apo u flitet vetëm për kartelat?

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Jo, tema të tilla me to nuk punohen.

SHOKU ENVER HOXHA: Pse nuk organizoni posaçërisht për to punimin e temave të ndryshme nga mjekët?

SHOKU JASHAR MENZELXHIU: Kur mamitë qëndrojnë 2-3 ditë në qytet, atëherë zhvillohen edhe tema.

SHOKU ENVER HOXHA: Ç'mund të na thoni, ju shoku Ciril, për këtë çështje?

SHOKU CIRIL PISTOLI¹: Kohët e fundit theksi në këto tema është vënë në drejtim të mirërritjes së fëmijëve, për kujdesin që duhet treguar për ushqimin, pastrimin, nxjerrjen e tyre në ajër të pastër etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Si zhvillohen këto tema, si leksione, si kurse të njohurive mjekësore, apo jepen si këshilla të rastit?

SHOKU CIRIL PISTOLI: Temat përgatiten më parë nga mjekët. Ndosht që këto bëhen mirë, por ka edhe raste që nuk bëhen në rregull. Disa rrethe si: Elbasani, Durrësi dhe Shkodra në këtë drejtim kanë punuar mirë, kurse ka rrethe të tjera që këtë nuk e bëjnë si duhet.

SHOKU ENVER HOXHA: Kam një pyetje të tillë: Ku venë më shumë vajzat e punëtorëve, mbasi mbarojnë shkollën tetëvjeçare?

1 Në atë kohë ministër i Shëndetësisë.

*SHOKU LAMÇE SHEME*¹: Kur mbarojnë tetëvjeçaren ato preferojnë më tepër të futen në kurse për të fituar ndonjë profesion, si, për shembull, për mami, infermiere, për rrobaqepësi etj. Kjo është e lidhur edhe me interesin material, se pas dy vjetësh ato fillojnë të marrin të ardhura.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë gjëra dolën edhe nga diskutimet tuaja, shokë. Unë kisha për të thënë edhe ndonjë çështje. Për ta përgatitur sa më mirë brezin e ri për jetën shtrohet detyra që, kur bëjmë teori, kur japim mësim në shkolla, të kemi parasysh të mos largohemi nga terreni dhe, tezat e përgjithshme, t'i lidhim me problemet tona konkrete. Domethënë, formimin e botëkuptimit të mos e shikojmë në mënyrë libeske, por në dinamizmin e zhvillimit të vendit tonë, të bazuar në teorinë marksiste-leniniste.

Kjo nuk është një punë e lehtë, por është baza, prandaj na del detyrë të bëjmë më shumë përpjekje në këtë drejtim. Po të shpjegohet, të kuptohet e të përvetësohet mirë ideologjia jonë, atëherë do të zhduken shumë paragjykime dhe koncepte idealiste në kokën e disa të rinjve e të rejave, duke filluar nga ato koncepte jo të drejta që shfaqen në prirjen për zgjedhjen e shkollave. Formula të përgjithshme thuhet vazhdimisht, por kur vjen puna konkretisht, vëmë re se ka vajza dhe djem që kërkojnë të ndjekin shkollën e gjuhëve të huaja, të studiojnë për kimi industriale dhe jo për mësuese, agronome etj., se e kanë të vësh-

1 Në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit.

tirë të punojnë në fshat. Bile kështu veprojnë më shumë vajza të kuadrëve drejtues.

Shokët që merren me çështjet ideologjike, duhet të mendojnë thellë për të gjetur format e metodat më të përshtatshme që teoria jonë të mos mësohet në mënyrë të thatë, abstrakte, në rrugën e formulave.

Ndodh që disa që mësojnë teorinë, nuk janë në gjendje ta lidhin me jetën tonë, kurse disa që e njohin praktikën tonë socialiste, gjejnë vështirësi të mëdha për përvetësimin e teorisë. Më kanë thënë se ka sekretarë komitetesh partie në rrethe, shokë të devotshëm që drejtojnë mirë punën e Partisë, të cilëve, kur venë në Shkollën e Partisë të japin provime, u dhemb koka, megjithëse u është lënë mjaft kohë për t'u përgatitur. Ata nuk duhet ta kenë të vështirë të mësojnë teorinë, sepse gjithë puna jonë është e ndërtuar në bazë të ligjeve të materializmit dialektik e historik. Në rast se pedagogët kërkojnë të flitet «me gjuhën e filozofisë», me formula, siç i dinë e i kanë mësuar ata vetë, këtë, sigurisht, shokët nuk e bëjnë dot të gjithë. Por edhe ata që kanë mësuar e flasin vetëm me formula nuk e bëjnë punën mirë, sepse është e domosdoshme t'i drejtohen realitetit konkret të ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Pra, në të dyja anët kemi të meta, që duhet t'i eliminojmë.

Për të vazhduar mendimin e mësipërm, dëshiroj të vë në dukje se Marksi, duke bërë përgjithësimin e eksperiencës së revolucioneve të 1848-s, ka thënë se në momentet kur në vendet kapitaliste, ndihet njëfarë stabiliteti, është e zorshme të zhvillohet revolucioni por kur fillojnë krizat ekonomike, atëherë shpërthej-

në edhe krizat politike. Ka njerëz që mund të të flasin për çështjen e krizave ekonomike me kompetencë të madhe, sa t'u ngresh kapelën. Mirëpo kjo nuk mjafton, ajo që ka rëndësi është se duke u mbështetur mbi këtë tezë të Marksit, të shohim e të bëjmë analiza si po zhvillohet situata sot.

Me këtë desha të tregoj se ne duhet të përpiqemi që teorinë ta mësojmë në mënyrë të tillë që të jetë e aplikueshme në situatat reale, që fenomenet shoqërore të kuptohen e të shpjegohen nga njerëzit tanë në dinamizmin e zhvillimit dialektik materialist të shoqërisë sonë socialiste. Pra, çështja e filozofisë sonë hyn kudo, te mësuesit, te profesorët, te problemet sociale, te dëshirat etj.

Çështja tjetër që desha të trajtoj ka të bëjë me fëmijët e shtëpisë së fëmijës. Unë mendoj se kthesa kryesore në punën me ta duhet bërë, në radhë të parë, në mentalitetin e njerëzve. Po nuk u bë kjo kthesë, mund t'i ndërrosh sa të duash edukatorët dhe prapë të mos bëhet gjë.

Po cili është mentaliteti i gabuar që duhet luftuar? Ky është mendimi përcmues se fëmijët që dërgohen në këto institucione janë fëmijë «jo të ligjshëm». Pa e zhdukur këtë mendim, asgjë pozitive nuk mund të bëhet në këtë drejtim. Fëmijët që dërgojmë atje janë krijesa të pafajshme, për rritjen e të cilëve duhet të tregohet më shumë kujdes se për fëmijët që rriten pranë prindërve në familje, prandaj atyre duhet t'u krijohen edhe disa kushte të veçanta. Mirëpo për këto shtëpi fëmijësh mendohet pikërisht e kundërta.

Përpara Çlirimit, kur një vajzë lindte një fëmijë

jashtë martese, ka ekzistuar mentaliteti që fëmija të vritej. Ne e luftojmë një mentalitet të tillë kriminal. Po pse bie vajza në një gabim si ky? Mund të ketë shumë shkaqe që nuk kam ndër mend t'i numëroj. Sigurisht, ne duhet t'i edukojmë vajzat dhe djemtë tanë të jenë të ndershëm, të shkojnë në çdo drejtim në rrugën e moralit komunist, por e dimë edhe se si zhvillohet jeta. Ka raste që një djalë e gënjen vajzën me premtime jo të sigërta, ka raste të tjera që gënjehen që të dy. Në të kaluarën ka ndodhur që kur një vajzë arrinte të bëhej nënë me fëmijë të vogël jashtë martese, i ati e vriste. Sot, në bazë të ligjeve në fuqi, po të veprojnë ndonjë kështu, ai futet në burg, ashtu sikurse mund të dënohet edhe një tjetër që bën një krim ose një vjedhje. Por fëmijët e vegjël që lënë ata pas, ç'faj kanë? Ne, si shtet, këtyre u hedhim dorën, i mbrojmë, i futim në shtëpitë e fëmijës. Fëmijët e lindur jashtë martese që mbeten pa nënë dhe baba shteti vërtet i mbron, po disa njerëz me mentalitete prapanike i konsiderojnë ata si fëmijë që s'kanë vlerë. Të tillë njerëz, sot, këtë mund të mos e shprehin hapur, por në realitet kështu e konceptojnë çështjen. Për fëmijën e lindur jashtë martese ata thonë se e ëma ka bërë dashuri dhe duke qenë se kjo quhet një turp i madh, edhe fëmija që ka lindur konsiderohet si krijesa e turp-it dhe, si e tillë, nuk qenka nevoja të tregohet asnjë kujdes për të.

Aksidente të kësaj natyre ngjasin e do të ngjasin në jetë, prandaj Partia duhet të punojë për t'i zhdukur mentalitetet e vjetra, që ekzistojnë lidhur me këto çështje dhe të bëjë që prindërit e vajzës të kenë ku-

rajën ta marrin e ta rritin në shtëpi një fëmijë të lindur në të tilla rrethana. Ne duhet të punojmë shumë me prindërit e vajzave të cilave u ndodh një gjë e tillë që ata të kujdesen jo vetëm për vajzën e tyre, por edhe për mirërritjen e fëmijës që ajo ka lindur.

Për arsye të mentalitetit të vjetër që ekziston, çështjen e mbrojtjes së fëmijës e kanë marrë vetë në dorë, në radhë të parë, Partia dhe shteti pse, po të mos ekzistonte mentaliteti që thamë, një vajzë që lind një fëmijë jashtë martese do ta merrte këtë në shtëpi, ajo do të arsyetohej te prindërit e vet për sa i ndodhi se, pa e njohur mirë, dashuroi një njeri që e gënjeu. Nga ana tjetër edhe prindërit do ta pritnin vajzën në shtëpi, po njëkohësisht do ta këshillonin që në të ardhmen të jetë e vëmendshme, të mos gabojë dhe për fëmijën e lindur të tregojë kujdes ta rritë.

Duke luftuar vazhdimisht mentalitetet e vjetra edhe në këtë drejtim, shoqëria, gradualisht, nuk ka për të komentuar për keq kur të ndodhin ngjarje të tilla. Por nuk është e mundur që këto mentalitete t'i zhdukim përnjëherë me një të rënë të kalemit, prandaj, krahas punës që duhet bërë me djemtë dhe me vajzat për t'i edukuar me parimet e moralit tonë komunist, kur fëmijët lindin jashtë martese, shteti e ka për detyrë t'i marrë ata në mbrojtje dhe të kujdeset që t'i rritë si duhet.

Si mund të thyhet mentaliteti i babait të një vajze, kur ky nuk ia pranon së bijës në shtëpi fëmijën që ka lindur jashtë martese? Ky mentalitet do të thyhet me punë dhe me shembuj konkretë, siç ka vepruar shoku Jashar Menzelxhiu, që, në ditë festash ose

edhe në raste të tjera, ka ftuar në familjen e tij nga këta fëmijë për të kaluar një ditë së bashku me fëmijët e vet. Kur babai i vajzës të shikojë që fëmijën që i ka lindur e bija e ka marrë në shtëpinë e vet sekretari i parë ose shokët e tjerë të komitetit të Partisë, s'ka dyshim se mentaliteti i tij i vjetër do të thyhet. Në këtë rast ai me siguri do të thotë: Kur sekretari i Partisë nipin ose mbesën ma merr në shtëpi të luajë dhe të hajë në një tavolinë me fëmijët e vet, përse të mos e marr atë edhe unë në shtëpi, gjersa ma ka lindur vajza ime? Por opinioni prapanik, që ekziston akoma i fortë, e pengon vajzën që edhe kur i ati e pranon atë në familje t'i kërkojë atij të pranojë bashkë me të në shtëpi edhe fëmijën që ka lindur. Partia duhet të luftojë për ta thyer dhe për ta zhdukur qëndrimin johumanitar ndaj këtyre fëmijëve.

Unë mendoj se është e domosdoshme të caktohen mirë kriteret për kategoritë e fëmijëve që duhen pranuar në shtëpitë e fëmijës dhe njëkohësisht të punohet për të zhdukur mentalitetet e vjetra dhe konsideratat jo të drejta për fëmijë të lindur jashtë martesës, për të cilët shoqëria duhet të kujdeset shumë më tepër se për gjithë të tjerët.

Në qoftë se kujdesi që tregon shteti dhe shoqëria për këta fëmijë kuptohet si një akt me të vërtetë i drejtë, si një veprim i lartë humanitar në kuptimin marksist-leninist, atëherë çdo gjë në shtëpitë e foshnjës dhe të fëmijës do të zgjidhet në rrugë të drejtë, atje do të dërgohen të punojnë si kujdestarë apo edukatorë njerëz nga më të zgjedhurit, me zemër bujare, të ngritur politikisht, edukatorët më të mira të kop-

shteve e të çerdheve, infermieret më të mira të spitaleve etj. I tillë personel duhet dërguar për të rritur ata që pa të drejtë përbuzen. Duhet të punojmë me ndër-gjegje të lartë dhe me tërë kujdesin që këtyre fëmijëve t'u zëvendësojmë në institucionet tona nënën, babanë, familjen dhe ambientin e jashtëm. Si mund të kursejë shteti për mirërritjen e këtyre krijesave sikur edhe 30 ose 40 edukatore më shumë të duhen? Në qoftë se sot nuk kemi mundësi për një gjë të tillë, mund dhe duhet të kursejmë gjetkë e këta fëmijë të trajtohen më së miri. Po të mos i marrim këto masa, atëherë nuk jemi në vijën e Partisë.

Ju shokë të Ministrisë së Arsimit e të Kulturës dhe të Ministrisë së Shëndetësisë keni përgjegjësi të madhe për mbarëvajtjen e këtyre institucioneve. Më duket se faji juaj është i madh dhe pikërisht duke filluar që te njerëzit që drejtoni ju në dikastere ka ekzistuar dhe ekziston i fortë koncepti i gabuar sipas të cilit këto institucione konsiderohen «*refugium peccatorum*». Deri edhe njerëzit që keni pranë i ka munduar mentaliteti i gabuar për këta fëmijë. Nuk mund të nxirret si arsye se kemi vetëm një edukatore për 20 fëmijë, prandaj nuk paska mundësi t'u shërbehet atyre. Po të jetë kështu, na i argumentoni që nevojitet një edukatore për 5 fëmijë.

Rritja dhe edukimi i fëmijëve të kësaj kategorie, përbëjnë një problem të rëndësishëm shoqëror. Ne dëshirojmë që fëmijë të tillë të kemi sa më pak dhe për të pasur sa më pak duhet të punojmë, në radhë të parë, politikisht e ideologjikisht, por kjo varet edhe nga zhvillimi ideopolitik e kulturor i njerëzve për t'i

evituar këto rreziqe. Megjithatë të tilla raste do të ketë dhe shtëpitë e fëmijës do të ekzistojnë. Prandaj duhet të bëjmë kujdes të posaçëm për mirërritjen dhe për edukimin e këtyre fëmijëve.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**ISMET BRUÇAJ RRON E DO TË RROJË NË ZEMRËN
E POPULLIT, TË RINISË DHE
TË KOMUNISTËVE**

*Bisedë me të afërm dhe shokë të Heroit të Punës
Socialiste, mësuesit Ismet Bruçaj*

17 dhjetor 1968

*Pasi u përshëndet me të ftuarit, shoku Enver
Hoxha tha:*

U gëzova shumë që erdhët të takoheni sot me mua. Vdekja e Heroit të Punës Socialiste, djalit tuaj, Ismet Bruçaj, nuk ishte një humbje e rëndë vetëm për ju prindërit, për familjen, po për gjithë rininë, për Partinë dhe për popullin tonë. Ajo na hidhëroi, por nuk na ligështoi. Ne humbën një djalë të ri heroik, besnik të Partisë, të popullit dhe të rinisë, të edukuar nga ju, babai dhe nëna e tij, nga shkolla, nga organizata e rinisë dhe nga Partia, për të vënë të gjitha forcat fizike dhe mendore në shërbim të atdheut. Dhe këtë punë ai e kreu gjer në fund me heroizëm, pa kursyer as jetën. Kjo ngjarje na forcon edhe më shumë besimin në vijën e drejtë të Partisë, na forcon be-

simin te rinia jonë e mrekullueshme, që rritet e kalitet në mënyrë revolucionare, na forcon besimin në të tashmen dhe në të ardhmen e lumtur të atdheut në të cilën po na udhëheq Partia.

Me një rini të tillë heroike, trime, të guximshme, me të reja e të rinj me cilësi të tilla, siç ishte Ismeti dhe siç janë qindra mijëra shoqe dhe shokë të tij, Shqipëria do të rrojë në shekuj e lirë, e pavarur dhe do të ndërtojë me sukses socializmin dhe komunizmin. Prandaj çdo armik që do të përpiqet të hidhet kundër vendit tonë, jo vetëm do të dështojë po këtu do të gjejë vdekjen e sigurt.

Ju e patë vetë se si vdekja e Ismetit ngriti peshë të madh e të vogël në Shqipëri. Akti dhe kujtimi i tij u bënë flamur, emri i tij u bë i dashur dhe i pahirruar si ai i Ndrec Ndue Gjokës, që me veprën e tij frymëzon dhe armatos me forcë të madhe armatën e mësuesve tanë. Prandaj Ismeti nuk ka vdekur, shoku Sali, ai rron e do të rrojë vazhdimisht në zemrën e popullit, të rinisë dhe të komunistëve. Shembulli i tij do të na shërbejë të gjithëve të punojmë ashtu siç punoi dhe luftoi ai.

Na flitni pak, shoku Sali, për jetën e Ismetit.

SHOKU SALI BRUÇAJ: Djali im, shoku Enver, bëri vetëm detyrën ndaj atdheut, siç kanë bërë shumë shokë të moshës së tij, siç bëri arsimtari Ndrec Ndue Gjoka, siç kanë bërë Shkurte Pal Vata dhe të tjerë. Pas rënies së tij janë ngritur qindra e mijëra të reja e të rinj të tjerë për ta zëvendësuar, për t'u shërbyer popullit dhe Partisë. Të na rrojë sa malet Partia, të na rroni Ju, shoku Enver, të na rrojë populli dhe rinia

jonë heroike! Jo vetëm vëllai i tij, Islami, që është më i ri, por edhe unë, nëna e vet, motrat dhe xhaja i tij, jemi gati të japim çdo gjë, po të jetë nevoja edhe jetën, për popullin dhe atdheun. Çdo armiku që do të guxojë të na prekë kufijtë, ne jemi gati t'i derdhim plumbin. Të rrojë Partia, Ju, shoku Enver dhe populli shqiptar, që janë lidhur ngushtë si mishi me kockën me njëri-tjetrin!

SHOKU ENVER HOXHA: Si ngjau aksidenti dhe pikërisht në ç'vend?

SHOKU SALI BRUÇAJ: Ismeti u nis ditën e hënë për të shkuar në fshat. Një pjesë të rrugës e bëri me biçikletë, me qëllim që të mbërrinte në Likaj para afatit, para se të hapej shkolla, se u kishte dhënë fjalën fëmijëve. Ne nuk dinim gjë për çka kishte ndodhur, kishim shkuar në punë. Atje erdhën shokët e Partisë dhe të NB-së e na folën për atë që kishte ndodhur me Ismetin.

SHOKU LYTFI HOXHA¹: Duke shkuar për në Likaj vetëm, Ismeti mbeti në një vend ku nuk kishte më rrugë, se, nga koha e keqe, urën e kishte marrë lumi. Kishte akoma kohë të kthehej, por Ismeti, për të çuar në vend fjalën e dhënë, vazhdoi rrugën, duke u përpjekur të kalonte nëpër një rrëpirë. Siç u pa në vend, pikërisht aty i rrëshqiti çizmja dhe ra 100 metra thellë, ku e kishin ndalur disa drurë. Megjithëse i dërrmuar rëndë ishte munduar të ngrihej, po përsëri kishte rrëshqitur dhe nja 10 metra të tjerë më poshtë

¹ Në atë kohë drejtor i shkollës së mesme pedagogjike «Shejnaze Juka» në Shkodër.

dhe atje kishte mbetur përfundimisht. Po të mos e kishin pritur disa drurë në mes të greminës, kishte rrezik të binte dhe nja 150-200 metra të tjerë më poshtë, në humnerë, ku nuk do të gjendej. Bluza dhe pardesyja e tij, gjatë kohës kur kishte rrëshqitur, qenë grisur. Në vendin e ngjarjes gjetëm një gur të njollosur me gjakun e tij. Ora që kishte në dorë i pat ngelur më 3²⁰ pas mesnate dhe xhami i ishte thyer. Këtë e morëm se kemi menduar ta ruajmë në muze për kujtim të Ismetit. Meqenëse vendi ku kishte rënë nuk ishte rrugë kryesore, nuk kishte mundur ta shihte asnjë kalimtar para se të gjendej.

SHOKU ENVER HOXHA: Po në Likaj vajtët?

SHOKU SALI BRUÇAJ: Po, dhe atje na pritën shumë mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Bëre shumë mirë ti, Bahri që zëvendësove Ismetin në shkollën e Likajt. Ti je djalë i ri. Nga një fshat me Ismetin je ti?

SHOKU BAHRI PIRI: Po.

SHOKU LYTFI HOXHA: Shumë nxënës e pedagogë dolën vullnetarë për ta zëvendësuar Ismetin ashtu si Bahriu, por u vendos për këtë meqenëse ky e kishte pasur shok që nga fëmijëria. Kolektivi u solidarizua me kërkesën e tij dhe Bahriun e përcollëm të gjithë me ceremoni për në Likaj.

SHOKU ENVER HOXHA: Ky është një solidaritet i madh.

Mua, çdo ditë, që nga dita që u dha lajmi i rënies së Ismetit, më vijnë shumë letra, nga të katër anët e atdheut, në të cilat flitet me admirim për shembullin e lartë të Ismetit. Në to punonjësit dhe sidomos të

rinjtë e arsimitarët, shprehin gatishmërinë për të punuar kudo në fshatra e në zona të thella, për të hapur toka të reja etj. Kjo do të thotë se akti i Ismetit, kuraja, besnikëria e tij u bënë flamur për njerëzit tanë.

Ti Islam, tani u veshe ushtar?

SHOKU ISLAM BRUÇAJ: Po, shërbej në një re-part në Shkodër. Megjithatë jam gati të shkoj kudo ku të më thonë Partia dhe Ju.

SHOKU ENVER HOXHA: Mendoj që Islami vetëm për pak kohë të qëndrojë ushtar, se është akoma i vogël. Në këtë moshë, 14-15 vjeç, as ligji nuk e lejon të kryhet shërbimi ushtarak nga të rinjtë. Prandaj atë mund ta çojmë të studiojë në shkollën e mesme ushtarake «Skënderbej». Po të vish në Tiranë për të ndjekur shkollën «Skënderbej», do të dalësh oficer. Apo dëshiron të bëhesh mësues, apo ke qejf ndonjë profesion tjetër? Në rast se do të ndjekësh shkollën «Skënderbej» mund të vazhdosh më vonë edhe shkollën e lartë. Prandaj për çfarë të dëshirosh, na e thuaj hapur! Tani për tani po të lëmë ushtar, duke marrë parasysh dëshirën dhe gatishmërinë tënde. Ti tregove vendosmëri prej njeriu të pjekur politikisht, kur shfaqe dëshirën të veje të zëvendësoje në ushtri vëllanë, që ra në krye të detyrës. Për këtë jemi dakord të qëndrosh ca kohë në ushtri. Megjithatë, po të vazhdosh mësimet në shkollën «Skënderbej», edhe atje do të përgatitesh ushtarakisht. Rinia jonë edhe në shkollë një pjesë të kohës do ta ketë për të kryer përgatitje ushtarake dhe kur vjen koha që i riu të shkojë në ushtri, është më i zhvilluar, më i përgatitur. Tani ti ke nevojë të mësosh dhe të jesh i bindur se kur të

arrish moshën, do të të thërresin për të kryer shërbimin ushtarak.

Si shkoni me punë shoku Sali?

SHOKU SALI BRUÇAJ: Unë punoj e jetoj në ndërmarrjen bujqësore «Perlat Rexhepi».

SHOKU ENVER HOXHA: Si dolët me vreshtin, e dëmtuan gjë shirat këtë vit?

SHOKU SALI BRUÇAJ: Pak e dëmtuan, shpëtoi mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po kryeagronom, Todi Gjermani është? Vazhdon ai të punojë atje?

SHOKU SALI BRUÇAJ: Po, ai është dhe punon mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe unë mendoj që punon mirë. E takova kur vizitova vreshtin herën e fundit që isha në Shkodër.

Po nga gjendja ekonomike jeni mirë?

SHOKU SALI BRUÇAJ: Shumë mirë jam. Të rrojë Partia!

SHOKU ENVER HOXHA: Punon në fermë nëna e Ismetit?

SHOKU SALI BRUÇAJ: Po.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa fëmijë keni?

SHOKU SALI BRUÇAJ: Kam këtë djalë, një tjetër të vogël dhe dy vajza, djali i vogël është në klasën e katërt, edhe dy vajzat janë në fillore.

SHOKU ENVER HOXHA: Të të rrojnë! Cili nga fëmijët i ngjet më shumë Ismetit?

SHOKU SALI BRUÇAJ: Vajza e vogël.

SHOKU ENVER HOXHA: Si shkonte në shkollë Ismeti?

SHOKU LYTFI HOXHA: Mësonte shumë mirë, ishte i thjeshtë, i dashur me shokët, e kishte shumë të zhvilluar shpirtin e sakrificës. Ai ishte njeri i aksionit, dëgjonte shumë e fliste pak. Ne kemi nxjerrë mësime edhe nga ditari i tij, në të cilin duket qartë se ai ushqej vazhdimisht nga mësimet e Partisë dhe Tuajat. Në ditar del në pah partishmëria e tij e lartë, urrejtja për armikun, vendosmëria për luftë të papajtueshme e gjer në fund kundër mbeturinave. Ismeti ishte me të tëra forcat e tij për emancipimin e plotë të gruas. Ai ka nënvizuar me kujdes çdo fjalim Tuajin që është botuar, shoku Enver. Ditari i tij është një botë e tërë, nga i cili ne kemi mësuar mjaft, kemi studiuar metodën e tij të punës dhe shohim që ne pedagogët kemi akoma shumë për të bërë, sepse akoma nuk dimë të futemi si duhet në botën e brendshme të njerëzve, të nxënësve tanë.

SHOKU ENVER HOXHA: Është një botë e madhe kjo e njeriut.

SHOKU LYTFI HOXHA: Karakteristike është edhe autobiografia që ka bërë Ismeti, në të cilën ai shënon: «Familja ime para Çlirimit ishte argate, kurse gjendja e saj pas Çlirimit ndryshoi rrënjësisht, Partia dhe pushteti na dhanë punë dhe tokë. Tani familja jonë ka 700 m² si kopsht personal, po këtë jemi gati ta japim që të forcojmë më shumë pronën socialiste...». Në mbrëmjen e fundit që bëmë kur mbaroi shkollën ai tha: «Shqipëria është një vend i vogël nga ana territoriale, por lavdia e saj është e madhe, pse atë e ngritën lart Partia dhe shoku Enver. Sot, kudo që të shkojmë në Shqipëri e ndiejmë veten si në shtëpinë

tonë». Dhe me të vërtetë mendimet e tij janë një she-mbull i madh, siç thoni Ju, shoku Enver, për gjithë rininë tonë.

Një përshtypje të madhe na bëri qëndrimi i fa-miljes së tij kur i njoftuam lajmin e hidhur. Jo vetëm Saliu, por as nëna e Ismetit nuk qau. Ajo është një fshatare e thjeshtë, po me qëndrim burrnor. Sigurisht asaj iu dhimbs shumë djali, por mbi ndjenjat e nënës, mbi të gjitha vuri dashurinë për Partinë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nëna e Ismetit nga është?

SHOKU SALI BRUÇAJ: Nga Gucia. Është fejuar me mua që kur isha 19 vjeç.

SHOKU ENVER HOXHA: Vëllezërit tanë koso-varë janë njerëz seriozë, ata nuk flasin shumë, më pa-rë mendojnë dhe mendojnë thellë, pastaj flasin dhe veprojnë. E kanë ata këtë karakteristikë, po kanë edhe veti të tjera të çmuara si trimërinë, besnikërinë, patrio-tizmin e pashuar dhe dashurinë e zjarrtë për Shqipërinë. Shumë kanë vuajtur në të kaluarën dhe shumë po vuaj-në akoma edhe sot vëllezërit tanë përtej kufijve lindorë dhe veriorë. Akti heroik i Ismetit do të bëjë përshtypje të madhe edhe në Kosovë, ku populli, siç e ka tre-guar historia, nuk u është nënshtruar kurrë shtypjes, skllavërisë, torturave e vrasjeve të vazhdueshme, qoftë më parë prej kralëve dhe klikave serbomëdha edhe tash së fundi prej klikës titiste. Përkundrazi, populli kosovar e ka ruajtur pastërtinë kombëtare, gjuhën e zakonet, patriotizmin e madh, dashurinë ndaj atdheut, ndaj tokës së tij amtare. Ai ka luftuar dhe po lufton për këtë, prandaj ka fituar admirimin e popullit shqip-

tar, i cili me luftë e me gjak arriti fitore, siguroi lirinë, pavarësinë, sovranitetin e atdheut dhe tani po ndërton me sukses socializmin. Por Shqipëria është përjetë edhe atdheu i tyre. Prandaj, për çdo gjë që bëhet në Shqipëri, për përparimet tona të mëdha, kosovarët gëzojnë, sepse janë vëllezërit tanë. Nga puna dhe sukseset tona të mëdha ata frymëzohen në luftën e tyre të drejtë. Për këtë arsye, sidomos këto kohët e fundit, titistët kanë qenë të detyruar t'u njohin disa të drejta shqiptarëve të Kosovës, por ato janë fare pak. Dëshën nuk deshën revizionistët titistë ua njohën kosovarëve të drejtën e flamurit. Flamuri ngjall, zhvillon e mban të ndezur vazhdimisht ndjenjat kombëtare. Tani në Kosovë populli në çdo festë, deri edhe në raste martesash, do ta vërë para shtëpisë flamurin shqiptar me shkabën me dy krerë dhe me yll. Megjithatë shqiptarët e Kosovës e kuptojnë se këtë lëshim Titoja nuk ua dha nga malli, por nga halli, vetëm për arsye se në Jugosllavinë titiste kosovarët përbëjnë një entitet të madh e nga më revolucionarët, sepse ata kanë qenë kurdoherë nga më të persekutuarit dhe vazhdimisht atyre u janë ngrënë të drejtat në kuadrin e shtetit pseudosocialist që i ka vrarë e prerë gjithmonë. Titistët, duke parë më së fundi se taktikat e tyre ndaj shqiptarëve të Kosovës nuk pinin ujë, se nuk mund t'i shtypnin dot kosovarët që luftonin, u detyruan t'u bëjnë disa lëshime.

Por kosovarët e kanë të qartë se serbomëdhenjtë nuk do t'ua japin kurrë lirinë, se liria fitohet me luftëra, me përpjekje e me sakrifica. Edhe ndonjë lëshim titistët e bëjnë që të mos acarojnë më gjendjen e të

mos u ndodhin ngjarje të tjera më të mëdha që me siguri dhe kundër dëshirës së tyre, do t'u ndodhin. Klikat e Titos ankohet sikur këto lëvizje në Kosovë i organizojmë ne, shqiptarët, por ne mbajmë e do të mbajmë qëndrimet tona të drejta, marksiste-leniniste, të njohura botërisht. Ne kurdoherë do t'i mbrojmë vëllezërit tanë kosovarë kundër serbomëdhenjve dhe krallëve të rinj. Kosovarëve duhet t'u njihen të drejtat që u takojnë. Këto i themi haptazi dhe kjo nuk është aspak «ndërrhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë», siç thonë titistët. Këta armiq shkojnë edhe më tej duke shpifur se trazirat në Kosovë qenkan rezultat i punës subversive të shqiptarëve! Por këtu s'ka asgjë të vërtetë. Lëvizjet në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi ndodhin nga patriotizmi i zjarrtë i vetë kosovarëve, nga lufta e tyre e drejtë për liri. Këtë duan kosovarët, prandaj ziejnë vazhdimisht në zemrat e tyre ndjenjat e flakta të urrejtjes për armiqtë titistë. Le të grijnë sa të duan Titoja e Rankoviçi duke na akuzuar ne si organizatorë të këtyre turbullirave!

Titistët janë frikësuar shumë që në Prishtinë dhe në katër-pesë qytete të tjera të Kosovës janë bërë demonstrata të mëdha, në të cilat rinia ka dalë në rrugë, në mënyrë paqësore, me flamurin shqiptar përpara, duke kënduar këngë kombëtare. Por demonstruesit u provokuan nga serbomëdhenjtë, prandaj u hodhën në sulm duke thyer xhamet e dyqaneve që mbanin tabela serbe, shkatërruan automobila, sulmuan policët dhe marshuan përpara drejt zyrave të pushtetit revizionist, duke u shtënë frikën për vdekje funksionarëve titistë, të cilët e dinë mirë se cilët janë kosovarët.

SHOKU SALI BRUÇAJ: Halli është sa të dalin njerëz që t'i drejtojnë.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe këta në luftë e sipër do t'i nxjerrë vetë populli kosovar. Kështu ndodhi edhe në Shqipëri. Asnjë nuk na njihte ne në atë kohë. Ishim djem të rinj kur krijuam Partinë, e cila na këshilloi të luftonim për popullin e për atdheun dhe ne luftuam e fituam. Kështu do të ngjasë patjetër edhe në Kosovë. Xhavit Nimani e Fadil Hoxha me shokë janë njerëz të Titos, po populli në luftë do të nxjerrë njerëzit e vet besnikë e të guximshëm që do ta udhëheqin. Ky është ligj, nuk mund të mbahet një popull i tërë në zgjedhë, në mos sot, nesër, ai do të ngrihet dhe do të fitojë.

Të gjitha sukseset që korrin sot në Shqipëri ua ngrenë shumë moralin dhe i frymëzojnë për luftë të drejtë revolucionare dhe vëllezërit tanë në Kosovë.

Më thanë se, kur ishte vrrarë Shkurte Pal Vata, e cila e ka nënën nga Kosova, Pal Vatës i kishin dërguar një letër nga fshati i gjyshit të Shkurtes në të cilën i shkruanin se Shkurta ishte mbesa e tyre. Kështu do të ngjasë edhe për Ismetin, vdekjen e të cilit kosovarët, sigurisht, e morën vesh nga radioja, nëpërmjet të cilës ata do të mësojnë që edhe origjina e familjes së Ismetit është nga Kosova. Në Kosovë, ashtu si kurdoherë, gjithë populli, e në mënyrë të veçantë të rinjtë, studentët e mësuesit janë në pararojë. Këta udhëheqin sot kërkesat e popullit kosovar për mbrojtjen e gjuhës shqipe, për shkolla shqip, për të fituar liritë demokratike etj. Studentët në Kosovë janë në ballë të luftës dhe kjo është një gjë shumë e mirë,

duke pasur parasysh se borgjezia titiste jugosllave përpigjet t'i degjenerojë të rinjtë, t'i largojë nga jeta, t'u prishë karakterin dhe moralin e shëndoshë dhe posaçërisht kosovarëve t'u zhdukë ndjenjat e patriotizmit e të atdhedashurisë. Lufta e popullit dhe e rinisë kosovare tregon se titistët nuk ua kanë arritur dot qëllimeve të tyre në Kosovë. Kosovarët nuk flenë dhe kjo ka rëndësi të madhe. Burrat kosovarë shoku Sali, janë shtyllë në Kosovë. Ata e kanë në zemër atdheun e tyre. Këtë e dinë mirë titistët, të cilët përpigjen të zhdukin traditat patriotike e të atdhedashurisë të rinjtë, por kësaj nuk ia arrijnë dot. Kjo vërteton se shqiptarët e Kosovës janë njerëz të fortë dhe patriotë të flaktë, që i edukojnë djemtë dhe vajzat e tyre me ndjenjat e patriotizmit, pavarësisht se nuk janë të shkolluar, pse atje edhe ato pak shkolla që janë hapur, janë të përgjysmuara. Me gjithë vështirësitë e mëdha dhe kushtet e rënda, në Kosovë ka një rini të mrekullueshme.

Në Jugosllavi ka elementë që janë kundër Titos (dhe njerëz të tillë atje ka shumë), të cilët e ndjekin me simpati lëvizjen patriotike që ka filluar në Kosovë. Është tjetër punë që ata hëpërhë nuk po bëjnë atë që duhet në përkrahje të shqiptarëve të Kosovës. Titistët, si armiq të popujve që janë, goditin jo vetëm shqiptarët, por edhe kroatët, boshnjakët, malazeztë, serbët e të tjerë, kur këta janë revolucionarë, marksistë-leninistë.

Në luftën që bëhet në Jugosllavi kundër titizmit dhe revizionizmit modern, shqiptarët e Kosovës janë në ballë. Revolucionarët boshnjakë, kroatë, malazezë

e të tjerë e ndjekin me simpati luftën e kosovarëve kundër titizmit, e cila do të vijë vazhdimisht duke u shtuar. Titistët nuk e kanë jetën të gjatë, populli dhe klasa punëtore në Jugosllavi do të fitojnë.

Sot lexova në gazetë që konferenca e Partisë e rrethit tuaj përfundoi me sukses të madh punimet e veta. Shkodra vazhdimisht po bën përparime. Sekretari i parë u zgjodh një shok tjetër, Prokop Murra, pse shokun Pjetër Kosta kemi vendosur ta marrim në Tiranë në një tjetër detyrë të rëndësishme.

SHOKU LYTFI HOXHA: Konferenca e Partisë e rrethit tonë zhvilloi punimet në atmosferën e një entuziazmi të madh. Pati përshëndetje, përveç të tjerave, edhe nga klasa punëtore e Hidrocentralit të Vaut të Dejës. Gjithë delegatët e kësaj veprë qenë veshur me rrobat e punëtorit. Po kështu përshëndetja e kufitarëve kishte përmbajtje të lartë ideologjike e politike dhe ngriti peshë gjithë delegatët. Në konferencë ishin ftuar edhe Saliu, Pal Vata e të tjerë, të cilët dolën në fotografi me shokun Hysni [Kapo].

SHOKU ENVER HOXHA: Shoku Hysni ishte atje me punë. Si shkojnë tani punët në hidrocentral?

SHOKU LYTFI HOXHA: Shumë mirë. Punëtorët e këtij objekti theksuan edhe një herë që ta mbarojnë atë në afatin që kanë premtuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Dhe tani të bëjmë një fotografi së bashku.

Ju faleminderit shumë për vizitën. Biri juaj, Ismeti u bë tani njeriu i dashur në gjithë Shqipërinë. Me aktin e tij, me rëniën e tij heroike ai nuk ka vdekur.

Ju uroj shëndet të gjithë juve dhe fëmijëve suksese në mësim!

Ti Islam dalsh faqebardhë në shërbimin ushtarak dhe qofsh shëndoshë me nënën, babën, vëllanë, motrat dhe me shokët!

Ty, shoku drejtor, të uroj nga zemra suksese në detyrën patriotike që vazhdon të kryesh në shkollë! Puna revolucionare që je duke bërë, me gjithë personelin e shkollës që drejton, për kalitjen dhe për edukimin e të rinjve duket qartë edhe nga përgatitja e Ismetit. Nxënësit që kanë dalë e po dalin nga shkolla juaj, të edukuar nga Partia dhe nga ju, kudo ku kanë shkuar, po e kryejnë në mënyrë të shkëlqyer detyrën si mësues, ashtu siç bëri Heroi i Punës Socialiste, Ismeti. Prandaj u transmetoni gjithë shokëve mësues, gjithë kolektivit të shkollës suaj dhe nxënësve, përgëzimet e Partisë, të të gjithë shokëve të Komitetit Qendror dhe të miat për punën e madhe që po bëni sipas mësimëve të Partisë dhe ju uroj të gjithëve shëndet e punë të mbarë!

Dhe ty shoku Bahri të uroj shëndet, të punosh me zell që t'i bësh të rinjtë dhe të rejat e fshatit Likaj të zjarhtë, ashtu siç ishte Ismeti!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

**TË ZBATOJMË ME KËMBËNGULJE E NË MËNYRË
KRIJUESE DETYRAT PËR REVOLUCIONARIZIMIN
E PARTISË E TË JETËS SË VENDIT**

*Fjala në Konferencën e 17-të të Partisë
për Tiranën*

21 dhjetor 1968

Shoqe dhe shokë komunistë të organizatës së Tiranës,

Jam shumë i gëzuar që ndodhem sot këtu midis jush, në konferencën e Partisë të Tiranës, të kësaj organizate të madhe, kurdoherë luftarake dhe revolucionare të Partisë sonë, dhe t'ju sjell, me këtë rast, përshëndetjet më të nxehta të Komitetit Qendror të Partisë.

Unë dëgjova me vëmendje raportin mbi aktivitetin e organizatës, që mbajti këtu shoku Manush si dhe të gjitha diskutimet tuaja. Duke e çmuar shumë punën e organizatës së Partisë të kryeqytetit, mendoj se punimet e kësaj konference do të kenë një rëndësi të madhe për organizatën e Tiranës, por ato do të jenë, gjithashtu, një ndihmë për gjithë Partinë, për arsye

se organizata juaj ka një eksperiencë të pasur dhe për arsye se puna juaj rrezatohet në të gjithë Partinë nëpërmjet shokëve që kanë lidhje me rrethet e tjera.

Prandaj komunistët e Tiranës duhet ta ndiejnë dhe të marrin përgjegjësinë e plotë për të qenë komunistë shembullorë. Kjo përgjegjësi për ne, komunistët e Tiranës, është një detyrë përpara Partisë dhe popullit dhe jo një privilegj. Prandaj ne duhet të jemi kërkues e këmbëngulës ndaj vetes në kryerjen e detyrave të Partisë. Në këtë drejtim vërtet janë arritur suksese të mira, por ka edhe të meta e dobësi në punë. Në raport dhe në diskutimet këtu në konferencë u vunë shumë mirë në dukje si sukseset ashtu edhe të metat, u analizuan ato në mënyrë marksiste. Një analizë e tillë, marksiste-leniniste, revolucionare, përcakton rrugët dhe garanton për forcimin e mëtejshëm të organizatës së Partisë të kryeqytetit tonë.

Ju vepruat drejt në këtë konferencë duke vënë theksin në radhë të parë «mbi forcimin e luftës ideologjike» në të gjithë sektorët, pasi ky është kyçi i sigurt për mbarëvajtjen e të gjitha punëve që kryejnë njerëzit, si në frontin ideopolitik ashtu edhe për realizimin e planit të katërt pesëvjeçar para afatit, për progresin teknik dhe për rritjen e iniciativës dhe të vetëveprimit të organizatës-bazë. Ju po veproni drejt që për të tria këto çështje kardinale, që diskutoi konferenca, do të merrni edhe vendimet përkatëse të veçanta.

Kongresi i 5-të i Partisë dhe direktivat e udhëzimet e Komitetit Qendror na kanë vënë përpara një programi të madh pune. Ne do ta realizojmë me sukses këtë program pasi në këtë rrugë të sigurt e të ndritur

na udhëheq, si kurdoherë, Partia jonë e lavdishme.

Më lejoni tani të ngre edhe unë disa çështje. Do të më falni në qoftë se do të përsëris disa gjëra që janë thënë, ose që i prekët edhe ju në këtë konferencë. Ju, me diskutimet tuaja, ndihmuat Partinë dhe mua si Sekretar i Parë i Komitetit Qendror. Ne, shokët e udhëheqjes, vemi në konferencat e Partisë për të nxjerrë mësimë dhe për të ndihmuar. Për këtë qëllim erdha edhe unë në konferencën tuaj. Do të flas, pra, për disa çështje që dalin nga lufta dhe nga eksperiencia e Partisë.

I

KALITJA E VAZHDUESHME REVOLUCIONARE, ZBATIMI REVOLUCIONAR I NORMAVE MARKSISTE-LENINISTE JANË BURIMI KRYESOR I FORCËS SË PARTISË

Konferencat kanë një rëndësi të veçantë, për arsye se ato janë organi më i lartë i Partisë në rreth, por kësaj radhe ato marrin një rëndësi të posaçme, sepse zgjedhjet në Parti në organizatën e Tiranës, ashtu si në gjithë Shqipërinë, u zhvilluan në hovin e madh frontal që ka shpërthyer për revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë dhe të të gjithë jetës së vendit, për thellimin e mëtejshëm të revolucionit tonë socialist.

Zgjedhjet në Parti, duke filluar që nga organizatat-bazë e deri në konferencat e Partisë, në terren dhe në ushtri, u bënë një aksion i madh ideologjik, politik e organizativ i komunistëve dhe i punonjësve tanë. Ato

u zhvilluan në një nivel më të lartë se çdo herë tjetër, u karakterizuan sidomos nga pjesëmarrja e gjallë dhe aktive e gjithë komunistëve në diskutimin e problemeve më të rëndësishme që preokupojnë, aktualisht, Partinë dhe vendin tonë, nga një patos revolucionar dhe vendosmëri e madhe për zbatimin e çdo detyre që ka të bëjë me mbrojtjen e fitoreve historike që janë arritur nën udhëheqjen e Partisë sonë heroike, me ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Zgjedhjet e fundit në Parti u karakterizuan nga zhvillimi i mëtejshëm i kritikës dhe i autokritikës. Në gjithë Partinë, më shumë se çdo herë tjetër, shumica dërrmuese e komunistëve në organizatat-bazë morën pjesë gjallërisht në diskutimin e problemeve që preokupojnë secilën prej tyre. Të nisur nga pozita të drejta partie, në interes të çështjes së madhe të Partisë e të popullit, ata, si komunistë e revolucionarë, të papajtueshëm me të metat dhe me dobësitë e punës së tyre, me zemër të hapët bënë autokritikë, duke u zotuar e duke marrë edhe masa konkrete që t'i zhdukën këto të meta e dobësi me vendosmëri, brenda kohës më të shkurtër. Njëkohësisht, shokët tanë komunistë në organizatat-bazë dhe në konferencat kritikuan me guxim dhe me objektivitet të gjithë ata komunistë e kuadro të cilët kanë vënë re shfaqje të huaja, dobësi e gabime, duke treguar njëkohësisht edhe rrugën e zhdukjes së këtyre të metave. E gjithë kjo përbën një fitore të madhe për Partinë.

Në mënyrë të veçantë zgjedhjet u zhvilluan në një nivel më të lartë në organizatat-bazë të qendrave të prodhimit. Edhe në këtë rast klasa jonë heroike pu-

nëto, si kurdoherë, është shquar për kuptimin e thellë të përmbajtjes ideologjike të këtij aksioni të madh jetësor për Partinë. Mirë janë zhvilluar ato edhe në organizatat-bazë të Partisë të kooperativave bujqësore. Edhe në organizatat-bazë të administratave dhe të dikastereve zgjedhjet u zhvilluan më gjallërisht se herët e tjera. Megjithatë, në këto organizata, sidomos të dikastereve, mund të themi se puna e Partisë akoma lë për të dëshiruar. Aty ka disa të meta e dobësi kundër të cilave duhet luftuar më shumë e më me këmbëngulje, siç janë prirja për të kritikuar më shumë të tjerët poshtë dhe më pak veten, prirja e komandimit dhe e superioritetit si dikaster dhe si kuadro, koncepti i intelektualizmit që i vë më shumë rëndësi urdhrit që duhet të zbatohet të tjerët, pa marrë parasysh kushtet objektive dhe vështirësitë që lindin nga këto kushte. Në këto organizata veçanërisht duhet punuar për një kalitje të shëndoshë ideologjike e politike revolucionare të komunistëve dhe të punonjësve.

Konferencat e Partisë këtë vit marrin, gjithashtu, një rëndësi të posaçme, sepse, sipas orientimeve të Byrosë Politike për përmirësimin e përbërjes shoqërore të organeve udhëheqëse, në krye të organizatave-bazë dhe në komitetet e Partisë erdhën me qindra e qindra shokë dhe shoqe me origjinë dhe me gjendje punëtore, me stazh të vjetër dhe të ri në Parti, njerëz të kalitur në valën e revolucionit. Kjo është rrjedhim logjik i rritjes, i forcimit dhe i kalitjes së Partisë në rrugën revolucionare marksiste-leniniste. Kjo është një dëshmi e vijës së drejtë politike dhe organizative të Partisë në dinamizmin e saj revolucionar dialektik-ma-

terialist, vijë që u përgjigjet kërkesave të kohës, rrethanave të krijuara në luftë dhe në punë, nevojave aktuale dhe të perspektivës për të siguruar pa ndërprerje dhe në rrugën marksiste-leniniste udhëheqjen e Partisë, forcimin e diktaturës së proletariatit dhe ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë.

Detyra të rënda dhe me shumë përgjegjësi i presin shokët e rinj dhe të vjetër me stazh në forume të ndryshme të Partisë. Por shokët kurrë nuk u janë trembur dhe nuk do t'u tremben as punëve të rënda, as përgjegjësi. Nuk e kam këtu çështjen. Në të ardhmen punët në Parti do të na shkojnë edhe më mirë, vija e saj do të përpunohet më thellë, më me pjekuri dhe do të zbatohet me më pak gabime, do të studiohen probleme të shumta që do të gjejnë zgjidhje të drejtë në praktikë. Por unë dua të them disa fjalë për rëndësinë që ka ngritja e shokëve të rinj në udhëheqje, për freskinë që bien ata në të dhe për detyrën që kanë shokët e vjetër, nga njëra anë të përfitojnë nga të rinjtë, nga ana tjetër, t'i kalitin ata.

Të rinjtë vijnë nga tornot, nga minierat e thella, nga puna në ara. Ata sjellin në udhëheqje freskinë, hovin revolucionar, guximin, disiplinën e klasës e të bazës së Partisë. Ata sjellin me vete thjeshtësinë, pjekurinë, mendimin krijues të komunistëve të bazës dhe të klasës. Ata i kanë duart me kallo dhe zemrën të zjarrtë, kanë fjalë pak dhe punë shumë, nuk dinë retorikë, i thonë mendimet troç, pa dorashka, pa marrë parasysh se i pëlqeka ose nuk i pëlqeka tjetrit, mjaft që çështja të jetë në interesin e Partisë. Këto veti kaq të larta njerëzve tanë ua ka farkëtuar Partia, dhe kur

themi Partia kuptojmë edhe udhëheqësit e vjetër me stazh në Parti që janë shembull i komunistëve revolucionarë të paepur.

Prandaj ne të vjetrit në udhëheqje e kemi për detyrë partie të mos i lëmë të rinjtë të mpihen ose të çorientohen përpara detyrave të tyre të reja. Ne vetë të gjallërohemi nga vrulli i tyre, të shkundim pluhurin, në qoftë se na ka zënë në ndonjë qoshe, dhe, duke i bashkuar në një forcat e energjitë tona, të ecim kurdoherë me tempin e të rinjve.

Të rinjtë në udhëheqje kanë nevojë për ndihmën dhe eksperiencën tonë, siç kemi ne nevojë për të tyren. Që ata të përparojnë duhet t'u ngarkosh përgjegjësi në punë, në mënyrë që të mendojnë, të krijojnë, të realizojnë. Kjo është një nga çështjet më të rëndësishme që duhet ta kemi vazhdimisht parasysht. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë, në qoftë se e frenojmë, atëherë kemi lejuar të zhvillohet dhe të lulëzojë në radhë të parë burokratizmi, që i pengon dhe i mbyt përparimin dhe ndërtimin e socializmit.

Në njerëzit tanë, në organizmat e Partisë e të shtetit, duhet të zhvillojmë në një shkallë të lartë iniciativën krijuese revolucionare. Kjo iniciativë nuk mund të zhvillohet pa u dhënë gjithë përgjegjësinë e duhur njerëzve dhe organizmave të krijuar. Mendimit të shëndoshë krijues duhet t'i lësh fushë të lirë veprimi, eksperimentimi e kontrolli. Ndryshe, po i vumë barrikada, njëra pas tjetrës (dhe këto janë barrikada të shumëllojta, «të arsyetuara» dhe jo të arsyetuara të burokracisë), mendimi i njerëzve mpihet, ndrydhet, bëhet i rëndomtë, shterp, humbet guximi revolucionar, zhvi-

llohet rutina, moskokëçarja. Mendimeve krijuese burokracia, me rrjetën e saj të dukshme dhe të padukshme, u errëson horizontet, njëkohësisht u heq njerëzve ndjenjën e përgjegjësisë socialiste, i vë ata në kuadrin e rregullave burokratike, përpara një përgjegjësie automate, për të qenë brenda, brenda ligjeve të burokracisë.

Duhet, pra, që njerëzit tanë, të organizuar në Partinë ose jo, të kuptojnë thellë në radhë të parë ç'do të thotë të marrësh përsipër përgjegjësi socialiste. Kjo të ndihmojë që të zhvillohet mendimi krijues dhe të marrin përgjegjësitë e plota të gjithë organizmat e forumet e Partisë e të shtetit, të çdo instance, në mënyrë që çdonjëri prej tyre të kryejë detyrën e ngarkuar dhe që instanca më e lartë të mos mbytet e të mos pengojë tjetrën, më të ultën.

Është detyrë me rëndësi të madhe që punët të mos i ndërlikojmë, por t'i thjeshtojmë, t'i bëjmë të prekshme, të kuptueshme, të realizueshme nga gjithë masa e njerëzve dhe jo vetëm nga një elitë ose nga disa forume të larta, të cilat u dashka të pyeten vazhdimisht dhe për çdo gjë! Duke bërë këtë ne kemi luftuar, qoftë në Parti, qoftë në shtet, një nga shfaqjet më të rrezikshme e më të neveritshme të burokratizimit, që synon në ngritjen e vlerës së një pakice dhe në nënvleftësimin e vlerave të mëdha të shumicës.

Vendimet duhet t'i paraqitim të prera e të kuptueshme, që të ketë mundësi të zbatohen nga të gjithë. Në zbatimin e drejtë të vendimeve njerëzit e forumet nuk duhet të pengohen me gjithfarë formalitetesh burokratike, por të nxiten të mendojnë në mënyrë kri-

juese, të marrin përsipër përgjegjësi të plotë përpara Partisë, të tregojnë iniciativë të guximshme e të mos pyesin orë e çast për çdo gjë. Kështu realizimi i vendimeve bëhet më i sigurt, lehtësohet kontrolli i zbatimit të tyre. Kontrolli hyn kësisoj në sferën e masave të gjera dhe jo të disa «specialistëve» të veçuar që venë herë pas here nga lart, bëjnë raporte dhe na mbushin me letra, që janë prodhimi i burokracisë.

Të kuptohemi drejt, vendimet duhen kontrolluar nëse zbatohen ose jo. Liberalizmi në zbatimin e direktivave të Partisë dhe të ligjeve të shtetit është pjellë e ideologjisë borgjeze dhe bartës i të gjitha të këqijave që sjell ajo në praktikë, që nga shkeljet më të vogla të disiplinës së Partisë, të ligjeve e të rregulloreve të shtetit, deri në krimet më të rënda. Prandaj ka shumë rëndësi që njerëzit e ngarkuar me punë në administratë, veçanërisht në aparatet e Partisë, të pushtetit, në udhëheqje të ekonomisë, të jenë të klasës, të kenë kalitje të gjithanshme revolucionare. Në rast të kundërt, po qe se këta njerëz, qofshin komunistë ose të paorganizuar në Parti, kanë qejf letrat, teorizimet e jo punën e vërtetë dhe jetën e gjallë, nuk zhvishen nga fryma e komandimit, nuk u lënë përgjegjësi të tjerëve, por i përqendrojnë të gjitha rreth vetes, po qe se ata në stilin e tyre të punës nuk marrin parasysh mendimin krijues të masave, nuk bashkërendojnë kontrollin nga lart me kontrollin e vetë masave nga poshtë, të tillë njerëz nuk bëjnë për administratën tonë socialiste, pavarësisht se janë tanët, sepse kanë prirje të theksuara burokratike. Dhe prirje të tilla te njerëzit e aparateve janë shumë të rrezikshme. Janë pikërisht kë-

ta që i ushqejnë të tilla prirje dhe bëjnë presion që të fryhen aparatet.

Për të administruar sa më mirë duhet të zbatohen me vendosmëri parimet revolucionare të Partisë në metodën e punës. Metoda jonë e punës revolucionarizohet në praktikën revolucionare të zbatimit të vendimeve e të direktivave. Ajo duhet të jetë një metodë armike e burokratizmit, e rutinës, e raporteve stereotipe plot frazeologji mikroborgjeze që lustronë, që vënë në gjumë dhe errësojnë çdo veprim revolucionar e çdo perspektivë. Për të administruar mirë është e nevojshme, gjithashtu, të njohësh mirë teknikën, ligjet që ndihmojnë zhvillimin e forcave prodhuese dhe përsosjen e marrëdhënieve në prodhim e në shoqëri, domethënë duhet të kesh dituri shkencore.

Një masë e rëndësishme që mori Partia kohët e fundit ishte edhe heqja e hallkës së tepërt të organizatës-bazë të përgjithshme dhe shndërrimi i organizatës së Partisë të sektorit në organizatë-bazë. Kjo masë duhet të përpunohet, të kuptohet dhe të zbatohet mirë. Ajo bën që baza e Partisë të lidhet më drejtpërdrejt me komitetin e Partisë. Që t'i arrihet qëllimit duhet të mënjanohet rutina administrative burokratike, forma e vjetër e metodës së punës. E them këtë sepse, me gjithë përmirësimet e mëdha të bëra në këtë drejtim, nuk është zhdukur ende praktika e vjetër e punës.

Anëtarët e Partisë, në radhë të parë udhëheqësit dhe aparatet e Partisë, duhet ta kuptojnë rëndësinë e kësaj mase, e cila synon ta bëjë organizatën-bazë të Partisë çerdhe të vërtetë revolucionare, në mënyrë që ajo të gjykojë, të studiojë, të zbërthejë vetë dhe të

zbatojë me vendosmëri e me iniciativë direktivat e Komitetit Qendror, vendimet e organeve udhëheqëse të Partisë në rrethe, domethënë të jetë një organizëm vetëveprues edhe për sa i përket zbatimit, edhe për sa i përket kontrollit të zbatimit të vendimeve, në bazë të parimeve e të normave të jetës së brendshme të Partisë.

Me gjithë sukseset, ne kemi shumë e shumë për të bërë në këtë drejtim. Çështja nuk qëndron në atë që, me të vendosur një formë, çdo gjë mori fund. Jo, forma duhet ta vërtetojë veten në jetë, në praktikë. Ky vërtetim mund të bëhet i saktë, por mund të bëhet dhe i çalë. Varet nga sqarimet që jepen, nga kuptimi i drejtë i direktivës, varet edhe se si do të zbatohet në jetë kjo direktivë. Në qoftë se udhëheqësit dhe aparatet e gjejnë të drejtë direktivën, por përsëri mendojnë ta zgjidhin me metodat e vjetra të një pune-rutinë, atëherë llogaritë nuk do të dalin. Problemi nuk do të zgjidhet drejt. Komitetet e Partisë do të fillojnë të llogaritin se s'mund të mbajnë dot lidhje me të gjitha organizatat, do ta quajnë veten të shkëputur nga baza e, si rrjedhim, do të arrihet në përfundimin që duhet të shtohen komitetet, aparatet, të fryhen ato, që të mundin kështu t'i kenë organizatat «nën tutelë», «nën kontroll».

Në qoftë se kthehemi në këto forma pune, atëherë nuk ka iniciativa revolucionare në organizatat-bazë, nuk shndërrohen ato në organizma vetëveprues, çdo gjë pritet nga lart, çdo gjë jepet nga lart. Kështu ne preferojmë raportet e një numri instruktorësh, takimet e tyre me organizatat, sepse kështu kujtojmë se jemi

në rregull, se i kemi fijet në dorë, por në fakt lëmë të na fishken dhe të na bëhen automate organizatat-bazë dhe komunistët. Atje ku ka tutelë, ku ka forma pune-burokratike stereotipe, atje s'ka gjallëri, por konformizëm, s'ka diskutime krijuese, s'ka kritikë dhe autokritikë të shëndoshë mbi punën dhe mbi njerëzit, s'ka përgjegjësi komuniste. Prandaj ç'na duhen raportet e gjata e të thata përpara gjallërisë në organizatë, ç'na duhet takimi i një instruktori me njëzet organizatë-bazë përpara luftës revolucionare, përpara përpjekjeve të vetë këtyre organizatave, përpara njohjes së thellë në vend e drejtpërdrejt të punës së tyre nga ana e udhëheqësve dhe e njerëzve të aparateve të Partisë? Që kjo punë të bëhet siç e kërkon Partia, është e domosdoshme të studiohet vazhdimisht në praktikë çështja e lidhjeve me bazën dhe jo t'u qëndrohet skillav formave të vjetruara, të mira ndoshta në një periudhë të mëparshme.

Për ne punonjësit e Partisë këtu qëndron një pjesë e rëndësishme e luftës kundër burokratizmit. Të mos e mësojmë Partinë me shumë letra, me direktiva të shumta e të stërgjatura, të përsëritura, që nuk kanë mundësi as të përtypen dhe as të kontrollohen, sepse mbështillen në fshikëzën e frazave të shumta. Të mos mendojmë se vetëm kontrolli i udhëheqjes bën që të mos vërtetohen gabime në Parti. Ky kontroll, para së gjithash, duhet të jetë një kontroll revolucionar dhe jo administrativ, por ai nuk mund të jetë i vetmi kontroll. Ky do të jetë shumë i pamjaftueshëm, i dobët, jo në rrugë revolucionare, në rast se nuk mbështetet në kontrollin e masave, të komunistëve dhe të puno-

njësve nga poshtë, duke e vënë bile këtë në plan të parë.

Prandaj, gjithçka, duhet të synojë që të vihen mirë në lëvizje organizatat-bazë dhe komunistët. Çdo direktivë, çdo formë organizimi duhet të synojë që organizata-bazë të bëhet një organizëm i gjallë, revolucionar. Komunistët duhet ta kuptojnë dhe ta zbatojnë drejt këtë çështje. Këtë duhet ta kuptojnë mbi të gjitha organet udhëheqëse të Partisë, në të tëra hallkat. Shokëve të këtyre organeve nuk u lejohet të mos i studiojnë thellë jetën e Partisë, gjendjen, zhvillimin, format, metodat e stilit e punës që kërkojnë këto situata dhe zhvillimi i ri i shoqërisë sonë në gjithë dinamizmin e dialektikën e vet.

Një formë tjetër e shëmtuar e burokratizmit që ne s'kemi mundur ta spastrojmë akoma, është «mospërfillja e kohës». Populli ynë thotë «koha është flori». Po për disa ajo nuk është as flori, as argjend, por është bronz, si të thuash. Kemi prirje të flasim gjatë, të shkruajmë gjatë, të diskutojmë gjatë. Dhe në këto tri të katërtat janë fraza të kota stereotipe. Po nuk e thamë këtë edhe atë, na duket sikur nuk thamë gjë. Kështu humbet kohë, humbasin dhe mbyten mendimet e vlefshme në ujë, lulëzon llafollogjia. Ata që kanë fjalë pak dhe punë shumë ngurrojnë të diskutojnë, kurse intelektualit shquhet. Prandaj duhet t'i japim fund një praktike të tillë jofrytdhënëse, bile të dëmshme.

Ardhja në organet udhëheqëse të Partisë e më shumë komunistëve punëtorë nga prodhimi na shtron për detyrë të rishikojmë thellë dhe të revolucionarizojmë më shumë punën në komitete, në sekretariate,

në byrotë dhe në aparatet e Partisë në rrethe. Të kemi parasysh se shokët e rinj që dërgoi Partia në udhëheqje janë njerëz të prodhimit dhe do të qëndrojnë njerëz të prodhimit. Koha e tyre është e llogaritur, prandaj nuk lejohet të shpërdorohet koha e tyre e lirë me gjëra të panevojshme. Sigurisht, atyre do t'u zihet një pjesë e mirë e kohës që u mbetet pas punës. Ata vetë duhet të mendojnë si ta organizojnë në mënyrë të përshtatshme punën e vet si udhëheqës. Por këtej e tutje duhet të organizohet ndryshe puna në komitetet, në sekretariatet e në byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve.

Mbledhjet e gjata, të shumta, raportet dhe diskutimet e pafund, duhet të rregullohen medoemos. Thirrja dhe heqja nga puna orë e çast duhet të marrë, gjithashtu, fund dhe të organizohet puna më mirë nga sa bëhet sot.

Shokët e rinj që vijnë nga prodhimi në udhëheqje nuk duhet të hutohen nga numri i madh i problemeve që ka udhëheqja. Për këto probleme ata duhet të vihen në dijeni me durim. Kjo është detyra e udhëheqjes kolegjiale dhe në radhë të parë e sekretarit të parë dhe e sekretariatit.

Shokët e rinj që u zgjodhën në udhëheqje të Partisë shpejt do ta fitojnë praktikën e punës. Partia është e interesuar shumë që t'ua japë sa më të qartë dhe sa më shpejt këtë praktikë, në mënyrë që këta t'i kryejnë sa më mirë detyrat. Udhëheqja kolegjiale e Partisë dhe sekretarët e saj duhet të tregojnë kujdes të madh në këtë çështje, të organizojnë ndihmën konkrete për shokët e rinj, t'i mbajnë ata në dijeni të të

gjitha problemeve me gjithfarë formash e mënyrash, sidomos për problemet e sektorëve që ata janë ngarkuar të drejtojnë e të kenë përgjegjësi drejtpërdrejt.

Komiteti Qendror krijoi edhe sekretariatet në komitetet e Partisë në rrethe pikërisht për të fuqizuar punën e Partisë në bazë, për të drejtuar në mënyrë të shkathët aparatet dhe për t'u dhënë një ndihmë të madhe komiteteve dhe byrove të tyre në rrethe. Duhet, pra, të shfrytëzohet drejt dhe në mënyrën më frytdhënëse kjo formë e re organizative që u shtohet komiteteve të Partisë, të përcaktohen dhe të zbatohen drejt në praktikë kompetencat e komitetit, të byrosë dhe të sekretariatit.

Të tëra këto masa dhe orientimet e reja në drejtimet që u caktuan nga Komiteti Qendror dhe që u analizuan me sukses nga Partia në mbledhjet për dhënie llogari dhe zgjedhje, janë një hap i madh cilësor në revolucionarizimin dhe në kalitjen e mëtejshme të Partisë. Ato kanë për qëllim ta forcojnë çdo ditë e më shumë Partinë, që ta kemi të fortë, revolucionare, të patundur dhe me unitet të çeliktë marksist-leninist.

Uniteti i Partisë sonë gjithnjë është mbështetur në parimet dhe nuk ka qenë kurrë një unitet oportunist, një «unitet për unitet», njëfarë uniteti i kalbur, i sipërfaqshëm. Përvoja jonë e madhe ka treguar se uniteti i shëndoshë marksist-leninist arrihet vetëm kur në Parti zbatohen në mënyrë revolucionare normat e jetës së brendshme të partisë proletare, kur në të ka luftë të kundërtave, ka diskutime të zjarra për të gjitha problemet, kur tek anëtarët e saj nuk lejohet degjenerimi oportunist, revizionist në politikë e në ideologji,

kur nuk lejohet të zënë vend ose të vegjetojnë arrivistët dhe burokratët mikroborgjezë.

Partinë duhet ta ruajmë kurdoherë nga karrieristët, nga sharlatanët, nga demagogët dhe nga servilët, të cilët dinë të reklamojnë veten dhe ta fshehin qenien e tyre të vërtetë përpara naivëve syleshë. Vetëm puna e gjallë politike, ideologjike, si dhe puna fizike në prodhim, ose i shëron, ose i demaskon ata. Të dyja këto punë së toku janë ilaçi i veçëm për këtë kategori njerëzish. Në mënyrë të veçantë në Parti duhet zhvilluar vazhdimisht e vazhdimisht një luftë parimore dhe e përqendruar klasore.

Kur themi se kjo është e nevojshme për Partinë, duhet menduar, në radhë të parë, edhe për udhëheqjen e saj që nga lart-poshtë dhe të mos kujtojmë se meqë në udhëheqje zgjidhen shokët më të mirë të Partisë, ata janë të paprekshëm nga rreziqet dhe nga sëmundjet mikroborgjeze. Udhëheqësit kanë një përgjegjësi tepër të madhe, prandaj duhen bërë përpjekje që ata të mos preken nga këto sëmundje. Por po u nisëm nga mendimi jorevolucionar se shokët që zgjidhen në udhëheqje janë të imunizuar nga gabimet, atëherë lumi që na mori. Udhëheqjen që zgjedh Partia duhet ta dojë, ta respektojë në rrugën revolucionare dhe jo në rrugën oportuniste, burokratike dhe thjesht hierarkike. Është e nevojshme që Partia ta ketë atë vazhdimisht e vazhdimisht nën kontroll revolucionar marksist-leninist, ta edukojë, ta korrigojë, ta kontrollojë dhe, kur nuk ndreqet dhe vazhdon të bëjë gabime, ta flakë tej.

Një parti që farkëton e siguron një unitet të tillë mbi bazën e luftës parimore e të papajtueshme klasore,

mbi këtë bazë ajo ndërton e forcon çdo ditë rreth vetes unitetin politik dhe ideologjik të popullit, rrit potencia- lin ekonomik dhe fuqinë mbrojtëse të tij. Këtë çelës të sigurt Partia duhet ta mbajë fort në duart e veta.

Gjatë gjithë historisë së vet Partia jonë dhe udhë- heqja e saj janë treguar parimore, vigjilente dhe re- volucionare. Partia nuk ka lejuar të vegjetojnë në udhëheqje karrieristë, oportunistë, trockistë, deviatorë, revizionistë dhe agjentë të armikut. Të tillë elementë, kur kanë mundur të depërtojnë në radhët e saj, ajo i ka spastruar dhe ka demaskuar deri në fund punën e tyre antiparti dhe armiqësore. Është pikërisht kjo luftë e madhe revolucionare që e ka kalitur Partinë tonë, që i ka mbajtur kurdoherë radhët e saj të pastra, që e ka ngritur atë në një nivel kaq të lartë ideopolitik dhe organizativ, që ajo ka pasur dhe ka një unitet kaq të çeliktë, një udhëheqje të qëndrueshme monolite, të përbërë nga shokë revolucionarë të sprovuar marksistë- -leninistë.

Kalitja e vazhdueshme revolucionare e Partisë so- në nëpërmjet luftës klasore, jashtë dhe brenda radhëve të saj, zbatimi revolucionar i normave marksiste-len- iniste, është arsyeja kryesore, burimi kryesor i forcës së Partisë sonë. Është vështirë të gjesh sot një parti që të ruajë një kompaktësi dhe kalitje të tillë revo- lucionare marksiste-leniniste. Partitë revizioniste de- gjeneruan pikërisht sepse shkuan në rrugë të kundërt me atë që ka ndjekur dhe ndjek Partia jonë. Sot for- cat botërore revolucionare dhe partitë e reja marksis- te-leniniste kanë te Partia e Punës e Shqipërisë një shembull të madh, një shembull të shkëlqyer pozitiv

marksist-leninist revolucionar. Ato kanë dhe shembullin tjetër tmerrësisht negativ, partitë revizioniste që tradhtuan marksizëm-leninizmin.

Shokë,

Shumë parime të drejta të Partisë sonë duhet të thellohen akoma më shumë e të zbatohen edhe më mirë në praktikë. Pushtetin s'mjafton ta marrësh, por atë duhet ta mbash, ta përsosësh në bazë të eksperiencës revolucionare të grumbulluar, të shkencës e të teknikës së zhvilluar.

Te ne populli është në fuqi, ai ushtron vullnetin e vet nëpërmjet diktaturës së proletariatit, ai i bën dhe i zbaton ligjet nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të Partisë së tij të Punës. Por sa punë duhet të bëjmë akoma në këtë drejtim që të realizohet plotësisht ky parim i madh! Në qoftë se mendojmë ngushtë, siç mendojnë disa, se ky parim është i zgjidhur i tëri me zgjedhjen e përfaqësuesve të popullit në hallkat e ndryshme të pushtetit politik, atëherë gabojmë. Gabojmë, sepse harrojmë rolin e madh e vendimtar të masave dhe të kontrollit të tyre, sepse anojmë nga prirjet administrative, duke ruajtur gjoja format demokratike. Ka njerëz që mendojnë se përderisa këto forma ruhen dhe përderisa në forume të ndryshme kemi komunistë besnikë dhe patriotë të sprovuar, të zotët dhe të zgjedhur, parimi është realizuar plotësisht. S'ka dyshim se një mendim i tillë është i çalë dhe mund të themi i gabuar.

Së pari, organet e pushtetit kanë nevojë të ushqehen gjithnjë me gjak të ri, me njerëz të rinj, revolucionarë të vendosur, që nxjerr lufta për ndërtimin socialist dhe për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit. Përtëritja e vazhdueshme e pushtetit me njerëz besnikë, të dalë nga gjiri i masave, me njerëz me eksperiencë pune dhe drejtimi, duhet të bëhet kurdoherë në harmoni të plotë: me revolucionarë të vjetër e të rinj, jo vetëm nga stazhi, por edhe nga mosha, me burra e me gra, me njerëz nga qyteti e nga fshati, nga të gjithë sektorët e jetës së vendit.

Së dyti, pushteti revolucionar duhet të mbështetet në radhë të parë në klasën punëtore, sepse ai përfaqëson diktaturën e proletariatit. Ai duhet të qëndrojë diktaturë e klasës punëtore jo vetëm në teori, por sidomos në praktikë. Në teori është më lehtë të pranohet, por realizimi i saj në praktikë has në shumë vështirësi e pengesa, që, po të lihen të trashen, e shtrembërojnë karakterin e diktaturës së proletariatit.

Prandaj Partia, si pararojë e organizuar e klasës punëtore, duhet ta ketë kurdoherë të qartë se pushteti ynë është diktatura e kësaj klase dhe, pra, të mbështetet fort në klasën, ta edukojë atë, ta mësojë atë në teori e në praktikë, ta bëjë plotësisht të zonjën si udhëheqëse të fshatarësisë e të shtresave të tjera të shoqërisë dhe të mos lejojë kurrë që udhëheqja e klasës punëtore të zëvendësohet me udhëheqjen e administratës.

Prandaj ka rëndësi vija e masave, kuptimi i thellë dhe zbatimi i drejtë e me këmbëngulje i kësaj vije. Vija e masave nuk mund të kuptohet pa autokritikën

dhe kritikën e hapët e parimore në Parti e në masat kundrejt të metave e dobësive të kujtdoqofshin. Ne duhet të luftojmë kundër optimizmit pa baza dhe mendjelehtë. Shikimi kurdoherë me sy kritik marksist-leninist i problemeve dhe i rezultateve i afron shumë Partinë dhe komunistët me masat. Të ruash, të zgjerosh e të thellosh pa ndërprerje ndikimin në masat është një problem nga më vendimtarët, nga më të domosdoshmit për Partinë. Për ne çështja qëndron ta bëjmë vijën tonë, ideologjinë tonë një me jetën e masave, të ecim gjithnjë përpara së toku me masat dhe në ballë të luftës politike, ideologjike dhe ekonomike të klasës punëtore e të të gjitha masave.

Këtu duhet të rrahë edhe propaganda realiste e Partisë. Një propagandë e organizuar mirë, që e mban vazhdimisht parasysh këtë pikësynim kryesor, që kuptohet thellë, prek ndjenjat dhe vë në lëvizje masat, lidh Partinë me masat, i edukon ato me frymën revolucionare, ngre klasën punëtore në rolin e saj të madh të pararojës dhe e bën kështu të mos lëkundet për asnjë çast në situatat e vështira që mund të krijohen për të dhe për Partinë e saj marksiste-leniniste gjatë udhës së revolucionit.

Prandaj lidhja e gjerë, e thellë dhe e qëndrueshme me masat punonjëse nuk mund të jetë kurrë e sipërfaqshme dhe nuk mund të krijohet vetëm në takime zyrtare ose sa për të qenë prezent. Një lidhje e tillë nuk e ka jetën të gjatë dhe s'jep përfundimet e dëshiruara. Lidhja e vërtetë e çeliktë me masat krijohet vetëm nëpërmjet lidhjes të thella e të përditshme pune me masat, në valën e veprimit revolucionar, në-

përmjet shpjegimit të qartë e të prekshëm të vijës së Partisë, nëpërmjet organizimit dhe zbatimit në praktikë të kësaj vije, nëpërmjet kapërcimit të vështirësive dhe nëpërmjet korrjes së frytit të luftës e të përpjekjeve.

Në një proces si ky, që përbën thelbin e lidhjes me masat punonjëse, vepron edhe kritika e autokritika e vërtetë marksiste-leniniste për punën në përgjithësi dhe për njerëzit në veçanti. Në një përpunim të tillë kaliten lidhjet e vërteta me masat, ashtu siç bëhet një uji me miellin, që, pasi mbruhet së toku dhe piqen në furrë, formojnë bukën, e cila, natyrisht, del e mirë në rast se uji zgjidhet i pastër, nëse mielli sitet dhe i hiqet krundja dhe nëse brumi, i ardhur mirë, piqet si duhet në furrë.

Një rëndësi të madhe ka këtu kontrolli i klasës punëtore. Ky kontroll nuk duhet të jetë formal dhe nuk duhet të kënaqemi me disa përfundime pa jetë në zbatimin e ligjeve dhe të urdhërësave që disa herë bëhen të papërshtatshme, sepse u ka ikur koha. Jo! Kontrollin punëtor Partia duhet ta bëjë të atillë që të revolucionarizojë dhe të shkundë organizatat e Partisë, udhëheqjet e tyre, administratën, ligjet dhe urdhëresat, në çdo rast që paraqitet nevoja. Po ta kuptojmë ndryshe këtë problem kyç të revolucionit, të diktaturës së proletariatit dhe të Partisë së klasës punëtore, atëherë do të gabojmë, nuk do të zbatojmë në mënyrë revolucionare dhe me kthjelltësi marksiste-leniniste normat e Partisë, nuk do të bëjmë si duhet edukimin marksist-leninist të Partisë dhe të klasës, do të sajojmë shumë arsye e rrethana për të shpjeguar ndodhitë që nuk duhej të merrnin një rrugë të shtrembër.

Kontrolli punëtor, brenda dhe jashtë vendit të punës, duhet të zhvillohet nën parullën e hegjemonisë së klasës punëtore dhe të zbatimit të vijës së masave. Ky kontroll duhet të pranohet me bindje nga të gjithë dhe të shndërrohet në një botëkuptim ideologjik, të kuptohet si një domosdoshmëri objektive që duhet të gjejë shprehjen jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Ai është një nga format më të larta të edukimit klasor që duhet të përdorë Partia e klasës, është një nga mjetet më të sigurta që përdor Partia e proletariatit për t'i bërë plotësisht të ndërgjegjshëm punëtorët të marrin përgjegjësinë e madhe që u takon, përgjegjësinë e drejtimit dhe të edukimit të masave.

Kontrolli punëtor është mjeti i sigurt me anën e të cilit klasa punëtore mban në duart e veta diktaturën e proletariatit dhe garanton zbatimin e vijës së Partisë së vet, të programit të saj.

Partia e Punës e Shqipërisë, si pararojë e organizuar e klasës, është dhe mbetet organizuesja dhe frymëzuesja e kontrollit punëtor. Ajo nuk duhet të lejojë që ky kontroll të bëhet sidokudo, në mënyrë të shturur dhe anarkiste, por ta edukojë klasën në mënyrë të posaçme që kontrollin ta organizojë si duhet, duke ruajtur si sytë e ballit normat, ligjet dhe rregullat e vendosura nga Partia dhe nga diktatura e proletariatit. Në radhë të parë klasa punëtore duhet t'i njohë mirë këto norma e ligje, t'i kuptojë në teori dhe në zbatimin e tyre praktik, sepse kështu ajo do të sigurojë vënien e tyre në jetë, do t'i edukojë masat që udhëheq e do të goditë pa mëshirë cilindo njeri ose institucion që i shkel dhe i shtrembëron ato.

Partia duhet të organizojë grupe të ndryshme punëtorësh, të cilët të instruktohen dhe të dërgohen për të kontrolluar çdo gjë jo vetëm brendapërbrenda qendrave të punës, por edhe jashtë tyre, bile edhe organizata-bazë partie, edhe komitete partie po ta shohë të arsyeshme. Ky është një edukim i madh revolucionar i klasës, që ndihmon Partinë e saj, me qëllim që vija marksiste-leniniste të mos shkelet, të mos degjenerohet. Partia edukon klasën të vendosë rregullin dhe disiplinën e klasës pa më të voglin ngurrim. Partia jo vetëm teorikisht, por edhe praktikisht e edukon klasën të ndërhyjë me rreptësi e të thotë fjalën e fundit kur elementë të borgjezuar dhe revizionistë përpiqen të largojnë Partinë nga vija e saj e drejtë marksiste-leniniste. Tragjedia që i ndodhi Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik është një mësim i hidhur, por i madh, për Partinë dhe për klasën tonë punëtore.

Kur ngrita çështjen e kontrollit punëtor, unë kisha parasysh pikërisht eksperiencën e hidhur të Bashkimit Sovjetik, me qëllim që Partia jonë të qëndrojë kurdoherë e palëkundur në pozita marksiste-leniniste, që revizionizmi modern të mos depërtojë dot kurrë në raddhët tona, që ta shtypim atë për vdekje që në vezë.

Ideja e kontrollit punëtor u përfaqhua me entuziazëm nga të gjithë komunistët e punonjësit e vendit tonë dhe u vu në zbatim kudo me sukses. Shumë të këqija u zbuluan e u spastruan. Po kur kalitet çeliku e digjet qymyri, mbetet edhe zgjyrë, e cila duhet spastruar vazhdimisht. Kontrolli punëtor nuk është një fushatë, por pjesë përbërëse e ideologjisë dhe e praktikës sonë revolucionare marksiste-leniniste, është pjesë përbërëse me

rëndësi jetësore e jetës sonë socialiste dhe komuniste.

Disa nuk kanë arritur ta kuptojnë akoma sa duhet se si mund të zbatohet në praktikë, pa të çara, kontrolli punëtor. Këta hiqen sikur e kuptojnë plotësisht këtë çështje në teori, por derisa nuk e kuptojnë sa duhet zbatimin praktik, duhet ta marrim me mend se kanë boshllëqe edhe në kuptimin teorik.

Këta njerëz u qëndrojnë horizonteve të ngushta të skemave në fuqi, prandaj nuk arrijnë dot të kuptojnë si mund të bashkëjetojnë ose të bashkëveprojnë së toku kontrolli i shtetit me kontrollin punëtor. Do të ngatërrohen, thonë, në praktikë. Aspak! Kontrolli i shtetit është mjet i diktaturës së klasës punëtore, ai është i specializuar, por, nga ana tjetër, ai është i kufizuar në numër, kurse kontrolli punëtor është një kontroll i drejtpërdrejtë i klasës që kryhet nëpërmjet mijëra komisioneve që dalin nga gjiri i kësaj klase. Këto komisione e fuqizojnë Komisionin e Kontrollit të Shtetit, spastrojnë terrenin që më parë nga kalbësi, bëjnë profilaksinë. Kontrolli punëtor jo vetëm nuk i ha bukën Komisionit të Kontrollit të Shtetit, por ai sitis mirë miellin. Dhe sa mirë do të jetë për socializmin kur të arrijë ajo ditë që Partia, me kontrollin punëtor, ta shëndoshë dhe ta kalitë aq mirë njeriun e ri sa ta lërë pa punë Komisionin e Kontrollit të Shtetit dhe ta bëjë atë të panevojshëm. Kjo është perspektiva.

Por ka njerëz, si thashë më lart, që nuk arrijnë dot të kuptojnë se si një grup punëtorësh të një ndërmarrjeje të vejë të kontrollojë një qendër pune tjetër. Dhe aq më tepër këta njerëz e kanë vështirë ta kuptojnë se si një grup punëtorësh mund të dërgohet për

të kontrolluar një organizatë-bazë, ose një komitet partie për të dhënë ndihmë e për të vënë rregull. Partia ka normat, ka rregullat e saj organizative, të cilat nuk lejon të shkelen nga kurrkush. Po kur shkelen këto, ajo kërkon edhe ndihmën e klasës, nga e cila ka dalë dhe për interesat e së cilës rron e lufton. Partia ka komitetet e saj të zgjedhura, ka instruktorët e saj, por në numër të reduktuar; ajo ka byrotë e organizative-bazë dhe sekretarët e tyre, të gjithë të zgjedhur, të gjithë të gatshëm të luftojnë në krye të anëtarëve të Partisë për zbatimin e vijës së saj. Por mund të ngjasë që një organizatë-bazë t'i shpëtojë kontrollit, të bjerë në amulli. Brenda saj mund të ketë grindje që nuk marrin fund. Atëherë, për të ndihmuar Partinë në mënyrë të organizuar, shkon një grup punëtorësh revolucionarë të pararojës që vë rregull, në emër dhe me urdhër të Partisë, në emër të normave dhe të vijës së saj. Disa instruktorëve të kualifikuar Partia u ngjitet me qindra grupe punëtorësh revolucionarë për t'i ndihmuar. Ajo e mëson kështu klasën e vet si të rrojë, të punojë, të frymëzohet me normat e Partisë së vet. Ç'gjë u prish në këtë mes? Ç'normë, ç'rregull organizativ i Partisë u shkel? As edhe një. Çdo gjë bëhet për të mirë. Kur ne ta kemi kalitur klasën punëtore në këtë rrugë, atëherë kemi kalitur Partinë, pasi Partia është e klasës dhe në radhët e saj duhet të bëjnë pjesë njerëzit më të mirë të klasës. Hekuri bëhet çelik duke u futur në zjarrin e furrës; kështu edhe klasa punëtore, që të kalitet dhe të kalitë Partinë, duhet futur në punët që i takojnë me guxim dhe këto të drejta të pamohueshme të saj jo vetëm t'ia japim në teori, por edhe konkretisht në praktikë.

Ideja e kontrollit punëtor të zgjerohet, të thellohet, të krijohen forma të ndryshme në rrugën marksiste-leniniste të Partisë. Le të dëgjojmë me kujdesin më të madh propozimet e vlefshme të punëtorëve në këtë çështje, të bëjmë konkluzione të drejta, të nxjerrim nga kjo praktikë e madhe e klasës parime të çmueshme dhe t'i zbatojmë ato në jetë me forma kurdoherë më të reja revolucionare, që kështu të mos na mundojë e vjetra së cilës i ka kaluar koha.

Dihet se për organet e saj qendrore dhe të rretheve, për aparatën administrativ dhe shtetëror, Partia tërheq vazhdimisht një numër të konsiderueshëm njerëzish të pararojës. E gjithë kjo masë e kualifikuar komunistësh nuk duhet të shkëputet në asnjë mënyrë nga masa e popullit. Funkcionet që kryen ajo duhet t'i kuptojë si pjesë integrale të luftës së masave. Kjo është shprehja dhe praktika e politikës së Partisë me masat. Për këtë qëllim ne themi kurdoherë se komunistët duhet të venë në prodhim. Kjo është e domosdoshme. Të jesh komunist nuk do të thotë të jesh zyrtar. Që komunisti të punojë si klasa, si masa, që ta mësojë atë, t'i edukojë klasën dhe masën me mësimet e Partisë, me shembullin e tij, kjo do të arrihet jo vetëm duke qenë zyrtar, por sidomos duke punuar në prodhim.

Këtë problem të madh ne nuk kemi arritur ta zgjidhim si duhet. E vjetra na mundon. Kohët e para e kërkonin që ne të kishim shumë komunistë nëpër zyra, por tani jo, prandaj në të ardhmen duhet të studiojmë përpjesëtimin e vendosjes së punonjësve komunistë dhe të atyre të paorganizuar në parti, nëpër zyra.

Një pjesë e mirë e masës së punonjësve të administratës shtetërore duhet të dalë drejtpërdrejt nga gjiri i klasës punëtore. Kjo do të bëjë që të zbatohet më mirë detyra që shtron Partia për forcimin e karakterit klasor të aparateve administrative të pushtetit popullor. Por duhet të kemi kurdoherë parasysh që njëkohësisht të ngremë shumë të tjerë në nivelin e atyre që marrim nga klasa punëtore për të punuar në administratë. Këtë ne duhet të mos e harrojmë, të mos e lëmë pas dore. Qëllimi i kësaj pune duhet të jetë i dyfishtë: të forcojmë Partinë dhe pushtetin me njerëz të klasës, të kalitur, të mësuar e revolucionarë, njëkohësisht të forcojmë edhe vetë klasën punëtore mbi të cilën mbështeten Partia dhe pushteti. Klasën punëtore duhet ta forcojmë jo vetëm si numër, por sidomos si cilësi. S'duhet kurrë të lejojmë që të dobësohet klasa punëtore nga ana cilësore.

Nga të gjitha këto dhe të tjera del e domosdoshme që ne të kujdesemi vazhdimisht për përbërjen e Partisë. Klasa punëtore duhet të udhëheqë. Prandaj është e nevojshme ta kalitim atë vazhdimisht, sepse ka shumë rreziqe që një pjesë e saj të mikroborgjehet (ka në radhët e saj edhe elementë që vijnë nga shtresat mikroborgjeze të qytetit e të fshatit).

Të mos harrojmë, gjithashtu, se fshatarësia jonë kooperativiste është me prejardhje mikroborgjeze. Duhet, pra, të bëhet një punë e madhe edukuese, revolucionare, ideopolitike marksiste-leniniste me të, sidomos tani, që ajo po e përmirëson dita-ditës jetën ekonomike dhe ngre nivelin e saj kulturor. Lënia pas dore e edukimit marksist-leninist të fshatarësisë mund të na kri-

jojë tek ajo, prej andej pastaj edhe në Parti, elementë me prirje liberalo-borgjeze që ndikohen lehtë nga revizionizmi modern. Këta elementë mund të bëheshin një rrezik për Partinë në të ardhmen, ashtu siç mund të ishte një rrezik edhe elementi nëpunës, sidomos i ri e me prejardhje intelektuale e nga qyteti. Prandaj për të gjithë, dhe veçanërisht për fshatarët, për nëpunësit, për intelektualët, kërkohet një kalitje e shëndoshë dhe e vazhdueshme ideologjike marksiste-leniniste.

Ne duhet të kemi kurdoherë parasysh edhe një çështje tjetër. Sa më tepër kohë të kalojë, aq më shumë njerëz nga të administratës shtetërore ose të aparateve të Partisë do të dalin në pension. Duke menduar me të drejtë se këta kanë eksperiencë, mund të zgjidhen që të gjithë në hallkat e ndryshme të pushtetit. Kështu do të mbetet pak vend për masat e gjera të popullit, për punëtorët, për rininë, për gratë që mund të mos e kenë atë eksperiencë të madhe si ata, por që shpejt do ta fitojnë. Këtu qëndron, pa e kuptuar, një tjetër rrezik, ai i burokratizimit të pushtetit, të diktaturës së proletariatit, i mënjanimit të rolit të masave.

Natyrisht, punonjësit, kur mbushin moshën e caktuar me ligj, dalin në pension dhe shteti u siguron atyre për të jetuar një të ardhur në përpjesëtim me rrogën që merrte secili kur punonte. Ky pension në të holla është llogaritur që pensionisti të plotësojë nevojat e tij të jetesës. Por dalja në pension duhet të kuptohet drejt, politikisht dhe ideologjikisht, sepse shpeshherë ngjet që kalimi nga gjendja në marrëdhënie pune me shtetin në pension nuk kuptohet kështu. Mendohet se kur pu-

nonjësi del në pension, s'duhet të punojë më, por vetëm të shëtitë dhe të ngrohet në diell. Një gjykim i tillë është i gabuar, jorevolucionar.

Të gjithë këta njerëz me eksperiencë të madhe të mos zgjedhin vetëm dy rrugë: ose të futen në këshilla, në gjykata etj., ose të ngrohen në diell dhe të mos kryejnë asnjë punë. Ata, në mënyrë të organizuar, të futen në masa, të shkrihen me masën, ta edukojnë masën, pa qenë nevoja të kenë medoemos efektivisht funksione në organet udhëheqëse e të administratës. Ata duhet të mësohen të punojnë jo më si zyrtarë, si burokratë, por si aktivistë shoqërorë të masave.

Është e vërtetë se pensionisti fizikisht nuk është në gjendje të bëjë të njëjtat përpjekje që bënte më parë, prandaj çlirohet nga puna fizike e lodhshme, nga puna me tension, nga disa norma, rregulla e nga ajo disiplinë e mëparshme e punës, duke i lënë vendin një tjetri, më të ri.

Pensionisti vërtet nuk është i ri fizikisht, por ai ka pjekuri dhe eksperiencë të pasur. Dhe të mësosh nga eksperiencia e tjetrit është një gjë e domosdoshme, ashtu siç është e domosdoshme të mësosh edhe nga eksperiencia jote. Të dyja këto eksperiencia e ndihmojnë njeriun të përparojë. Aq më shumë ka rëndësi eksperiencia e sprovuar e atyre që kanë punuar tërë jetën dhe në fund dalin në pension. Vihet pyetja: Na lejohet neve që këtë kapital të çmuar njerëzor ta lëmë mënjanë, ta humbasim, të mos e vlerësojmë si një thesar të madh të popullit, të mos e vëmë në shërbim të tij? Këtë çështje nuk e kuptojnë si duhet as disa kuadro të Partisë e të pushtetit dhe as vetë pensionistët. Forca e

madhe mendore dhe eksperiencia e pensionistëve nën-
vleftësohen. Pensionistët mendojnë se me daljen në
pension e mbaruan detyrën ndaj atdheut, kurse shteti
ose organizatat e Partisë, nga ana e tyre, në mënyrë
burokratike dhe automatike, mendojnë se, duke iu për-
mbajtur ligjeve, janë në rregull me pensionistët. As në
rastin e parë, as në rastin e dytë nuk mendohet dhe
nuk veprohet drejt.

Pensionistët, pa përjashtim, duhet të mendojnë se,
për t'u shërbyer popullit dhe Partisë, nuk janë kurrë
pleq, sepse edhe kur të jenë plakur fizikisht, Partia
dhe populli kanë nevojë të madhe për këshillat dhe
për mendimet e tyre krijuese të fituara gjatë gjithë
jetës së tyre plot punë e vetëmohim. Nuk mjafton që
Partia dhe pushteti t'i çmojnë këto vlera në mënyrë
idealiste, por të bëjnë që ky thesar i madh mendor,
moral e shoqëror të vihet deri në fund në shërbim të
shoqërisë e të socializmit. Nuk duhen përjashtuar edhe
rastet kur shteti, prodhimi, shkencat, kultura etj., kanë
nevojë që pensionistët të aktivizohen për kohë dhe për
punime të caktuara. Dhe në këto raste të mos vihen
barrikadat e organikave, të pagave etj. Natyrisht, orga-
nikat janë caqe të domosdoshme që duhet të mos ka-
përcehen, por sa mundësi kemi ne dhe sa të tjera mund
t'i mendojmë, me qëllim që shoqëria të përfitojë sa më
shumë nga eksperiencia e pensionistëve!

Partia dhe shteti jo vetëm duhet të krijojnë kushte
pune të përshtatshme për shumë pensionistë të shquar,
me qëllim që këta të japin ndihmën dhe eksperiencën
e tyre të çmueshme, por të gjithë, pa përjashtim, shpir-
tërisht, moralisht, politikisht, nuk duhet të shkëputen

nga vendi i tyre i punës. Ata duhet të ruajnë gjithë jetën lidhjet me kolektivin e tyre të vjetër, të shkojnë kur t'i thërresin (dhe duhet të thirren, pasi konstatojmë që kjo nuk bëhet), por edhe kur të dëshirojnë vetë. Sa mbledhje pune bëhen në të gjitha hallkat, por pak ose aspak nuk thirren në to punonjësit e vjetër, që kanë dalë në pension. Për këtë punë dhe ndihmë që kërkojnë Partia dhe shteti prej pensionistëve, nuk mund të caktohen as orare, as norma pune. Sidomos një gjë të mbahet parasysh: të dëgjohen me respekt dhe me kujdes këshillat e tyre.

Në rast se nuk e kuptojmë dhe nuk e zgjidhim drejt këtë problem të rëndësishëm, do të kemi humbje të mëdha. Ne jemi një shtet i ri. Disa vjet më parë ky problem edhe nuk ngrihej, sepse njerëzit tanë ishin të rinj, kurse tani ky problem shtrohet. Bile sa më tepër kalojnë vitet, aq më i rëndësishëm bëhet. Prandaj ka ardhur koha që për këtë çështje të mendojmë shumë më mirë se deri tani edhe politikisht, edhe ideologjikisht, edhe organizativisht.

II

ARTI DHE LETËRSIA TË ECIN ME HAPIN E MASAVE TONA REVOLUCIONARE, ME HAPIN E KLASËS PUNËTORE

Arti dhe letërsia janë një nga fushat e rëndësishme të veprimtarisë ideologjike të Partisë. Ka shumë rëndësi çështja nëse arti dhe letërsia do të vihen në

radhët e para të luftës së masave punonjëse për thelimin e pandërprerë të revolucionit socialist, apo nëse ato do të sorollaten në vend, do të gozhdohen në diskutime pa fund, pa kriter e pa bukë.

Në art, ashtu si në të gjitha fushat e ideologjisë, ka luftë klasash. Kjo luftë është shprehje e luftës midis ideologjisë proletare dhe ideologjisë borgjeze, midis realizmit socialist dhe rrymave artistike reaksionare borgjeze, që në mënyra të ndryshme ushtrojnë presion mbi njerëzit tanë. Lufta e klasave në këtë fushë duhet të orientohet drejt, pasi ka rreziqe të shumta e të mëdha, pasi kjo luftë zhvillohet në një terren delikat, të ndjeshëm dhe që përbëhet në masën dërrmuese nga elementë të shtresës intelektuale, shumë të prekshëm në ndjenjat, në mendimet, në unin e tyre, në veprën e tyre. Si kudo, edhe këtu këtë luftë duhet ta udhëheqë Partia, por njëkohësisht duhen tërhequr, duke i vënë në pozita luftarake, njerëzit tanë të letërsisë dhe të artit. Qëndrimi kritik, parimor ndaj gjithë krijimtarisë letrare e artistike duhet të karakterizojë organet drejtuese të Partisë, organizmat drejtues të shkrimtarëve e të artistëve dhe të gjithë artistët e shkrimtarët tanë.

Në rrethin e shkrimtarëve dhe të artistëve tanë zhvillohen diskutime, ka edhe debate. Ata shqetësohen seriozisht për ecurinë e artit dhe të letërsisë sonë, për revolucionarizimin e tyre. Ata duan që arti dhe letërsia të ecin me hapin e masave tona revolucionare, me hapin e klasës punëtore. Ata duan që arti ynë të jetë gjithmonë i ri, i gjallë, i freskët, ashtu siç janë vepra dhe jeta e Partisë sonë.

Në diskutimet dhe në debatet e shkrimtarëve dhe

të artistëve një vend kryesor e zë, me sa duket, edhe çështja e raportit midis së resë dhe së vjetrës, midis novatores dhe traditës. Kjo është një çështje e rëndësishme rreth së cilës zhvillohet sot një luftë ideologjike në fushën e artit dhe të letërsisë edhe në shkallë ndërkombëtare.

Raporti midis novatorizmit dhe traditës duhet kuptuar drejt, në mënyrë dialektike. Kjo, para së gjithash, është çështje e përmbajtjes së artit dhe të letërsisë, prandaj nuk duhet shkëputur asnjëherë nga lufta për t'u thelluar në njohjen e realitetit, për të pasqyruar me besnikëri nga pozita klasore revolucionare luftën heroike të Partisë dhe të masave punonjëse për transformimin socialist të vendit dhe të vetë njeriut tonë.

Arti dhe letërsia, si produkt i veprimtarisë njerëzore, si fenomen shoqëror objektiv, zhvillohen vazhdimisht, janë gjithmonë në rritje, ashtu siç është në zhvillim dhe në rritje vetë shoqëria njerëzore. Një pjesë e krijimtarisë letrare dhe artistike vjetrohët dhe shpesh harrohet, pjesë të tjera lulëzojnë, zhvillohen dhe vazhdojnë të rrojnë për aq kohë sa kanë forcë të kryejnë një funksion në shoqëri e në jetën e njerëzve.

E reja në art nuk lind në vend të zbrazët. Ashtu si në natyrë, edhe në shoqëri çdo ndryshim cilësor nuk mund të ndodhë pa grumbullimet sasiore. Edhe në art e reja nuk është rezultat i eksperimentimeve të artistëve të veçantë, por rrjedhim logjik i zhvillimit dhe i pasurimit të pandërprerë të trashëgimisë letrare, i përpjekjeve të të gjithë shkrimtarëve dhe artistëve për të pasqyruar me vërtetësi realitetin objektiv. Novatorizmi në art nuk duhet kuptuar si mohimi i traditës. Nova-

torizmi dhe tradita nuk janë në kontradiktë dhe nuk përjashtojnë njëra-tjetrën. Është gabim të kuptohet novatorizmi si luftë kundër traditës. Marksistë-leninistët mbajnë ndaj traditës një qëndrim dialektik. Ne çmojmë, ruajmë dhe zhvillojmë nga arti dhe nga letërsia e së kaluarës gjithçka është e mirë, është e afërt me idealet dhe me aspiratat e punonjësve dhe u shërben atyre. Nga trashëgimia artistike e letrare ne veçojmë anët pozitive, progresiste nga ato negative.

Ne jemi si kundër mohimit të thjeshtë, jodialektik të traditës, ashtu edhe kundër hyjnizimit dhe gju-njzimit përpara saj. Mohimi të shpie në qëndrime metafizike, nihiliste. Në pozitë e mohimit të plotë të traditës ndodhen sot modernistët, të cilët janë armëmbajtësit kryesorë të borgjezisë në art dhe në letërsi. Hyjnizimi i traditës, gjithashtu, është i dëmshëm, ai çon në konservatorizëm dhe në shkëputje nga realiteti. Ne jemi, gjithashtu, edhe kundër vlerësimeve të njëanshme, «origjinale», ndaj trashëgimisë letrare. Ne nuk jemi dakord me ata që mbivlerësojnë vlerat e një artisti në dëm të të gjithë trashëgimisë letrare pozitive vetëm duke u nisur nga konsiderata subjektive, nga shijet dhe nga konceptet artistike individuale. Në qoftë se shohim te ndonjë shkrimtar i së kaluarës rezultate të denja për t'i çmuar dhe për t'i përvetësuar, në qoftë se vepra e tij përshkohet nga ide dhe nga ndjenja të afërta për ne, kjo nuk do të thotë se ai i errëson të gjithë dhe se vetëm ai duhet vënë në pararojë të lëvizjeve revolucionare të masave punonjëse.

Është e drejtë kërkesa dhe përpjekja që trajtimi i temave historike të përshkohet nga fryma e kohës, që

ngjarjet historike të vlerësohen nga pozitat marksiste-leniniste. Por edhe këtu duhet kujdes, duhet treguar pjekuri marksiste-leniniste. Të mos mendohet se plotësimi i kësaj detyre do të arrihet vetëm duke përsosur formën artistike, duke i shpallur luftë gjithë traditës që është krijuar në këtë fushë nga arti ynë i së kaluarës dhe ai ndërkombëtar. Gjithashtu, duhet të kemi kujdes që, për hir të novatorizmit, të mos shtrembërojmë të vërtetën dhe realitetin historik.

Kritika parimore, e sinqertë, e matur, jo e frymëzuar nga ndjenja egoiste, karrieriste, subjektive, është ajo që duhet përdorur kur shfaqen mendime si për çdo problem ashtu edhe për veprat e letërsisë e të artit. Kjo është e vetmja kritikë konstruktive, e kuptueshme, e drejtë, e pranueshme dhe edukative.

Shkalla e kulturës, aftësitë profesionale, shijet artistike, forca krijuese nuk janë të njëjllotja në të gjithë shkrimtarët dhe artistët, prandaj edhe veprat e gjithsecilit kanë karakteristika të veçanta, të cilat, me zhvillimin e kohës, me grumbullimin e përvojës, përsosen.

Të fillosh kritikën vetëm duke u nisur nga dëshira jote individuale, nga konceptet e tua për kompozimin e veprës, vetëm nga shijet dhe nga prirjet e tua, të cilat marrin forma të rrezikshme në rast se të ka mbuluar një ndjenjë mikroborgjeze e mendjemadhësie për çdo punë që del nga dora jote, atëherë kritika s'do të jetë objektive, mund të jetë fyese dhe dëmprurëse.

Karakterit disa herë i sëmurë i diskutimeve me qëllime denigruese, krijimi dhe mbështetja e tarafeve për të luftuar njëri-tjetrin, janë të dënueshme. Shkëmbimi dhe rrahja e mendimeve të lira parimore është

njëfarë parapërgatitje e domosdoshme për mbledhjet e organizuara, ku shkohet jo për të bërë gjumë, jo për të heshtur, po për të diskutuar kurdoherë në mënyrë parimore e konstruktive dhe jo për të sulmuar e për të rrëzuar «idole» e për t'i zëvendësuar ato me «idole» të reja.

Në krijimet letrare ne shpesh gjejmë më shumë refleksin e botës së brendshme të autorit dhe më pak jetën e gjallë, luftarake, revolucionare të masave punonjëse, të atyre që luftojnë e veprojnë. Prandaj në mjaft vepra ka shumë subjektivizëm në trajtimin e temave, ka shumë subjektivizëm edhe në mbrojtjen e veprës nga vetë autori.

Një gjë të tillë ne e gjejmë si te të vjetrit ashtu edhe te të rinjtë në moshë. Edhe vlerat pozitive ne i gjejmë po ashtu në krijuesit e rinj e në ata më të vjetër. Nga kjo ne nuk duhet ta flemë mendjen dhe të arrijmë në përfundimin se nuk ekziston dhe nuk shfaqet tendenca e ndarjes në të rinj dhe në të vjetër. Ne duhet të zhdukim nga rrënjët çdo përpjekje artificiale për të krijuar në gjirin e njerëzve tanë të artit «klane», «shtresa», «rryma të ndryshme» sipas modës së botës dekadente. Në qoftë se do ta lejojmë një gjë të tillë, do t'i sjellim dëm të madh vetes. Në kopshtin tonë të virgjër të letërsisë dhe të artit, megjithëse ende janë larg shkallës së përsosmërisë, futim barëra të këqija, shumë herë imagjinare, disa herë mbijnë bisqe që lehtë mund t'i shkulim, por në vend që t'i shkulim, i trajtojmë sikur janë «pemë shekullore».

Unë mendoj se shkrimtarët dhe artistët tanë që i kanë dhënë vepra të denja atdheut, janë në gjendje t'i

japin atij vepra aktuale akoma më të mira. Ata janë në gjendje për këtë. Prandaj nuk jam dakord me ata që thonë se nuk po u përgjigjen kërkesave të sotme. Në qoftë se në veprat e tyre ka disa të meta, disa gabime, në to ka nëntëdhjetë të mira, me të cilat, ata kanë edukuar një brez të tërë. Këta shkrimtarë, piktorë, artistë, muzikantë janë me përvojë të madhe. Në qoftë se në veprat e tyre të kaluara ka gabime, bëj pyetjen: Cili është ai nga ne që mund të thotë se nuk ka bërë gabime në punë? Por ne ecëm përpara, korrigjuam gabimet, bëjmë prapë gabime, prapë i korrigjuam, prapë ecim përpara. Nesër prapë mund të bëjmë gabime, Partia na korrigjon, na edukon, na kalit dhe ne bëjmë gjithnjë e më pak gabime e më shumë gjëra të mira e të vlefshme. Kështu është edhe për shkrimtarët e vjetër në moshë, por edhe për të rinjtë.

Në qoftë se krijimtaria jonë letrare artistike e realizmit socialist nuk i përgjigjet sa duhet aktualitetit, nuk është vënë plotësisht në vijën e parë të luftës së Partisë dhe të masave punonjëse për thellimin e pandërprerë të revolucionit, kjo nuk do të thotë se ajo ka dalë jashtë radhëve të kësaj lufte dhe duhet mënjanuar, se çdo vepër e re që do të pasqyrojë flakë për flakë realitetin, do të krijohet nga hiçi. Asgjë e re, novatore, nuk mund të lindë e shkëputur nga krijimtaria letrare artistike ekzistuese.

Ndryshimet e sotme cilësore në realitetin tonë që kanë shpënë në revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë dhe të të gjithë jetës së vendit, janë një hop i ri cilësor në zhvillimin socialist të vendit. Ky hop nuk shënon mohimin e asaj çka është bërë deri tani; për-

kundrazi, ai është rezultat logjik i zhvillimit dhe i thellimit të vijës së drejtë të Partisë, i veprimtarisë së saj revolucionare. Në letërsi dhe në art edhe më parë vihej re një prapambetje në krahasim me ritmet e zhvillimit të realitetit tonë; kjo prapambetje, përpara ndryshimeve të sotme cilësore, vetëkuptohet që është thelluar. Por kjo duhet të kapërcehet dhe mund të kapërcehet. Duhet fituar menjëherë koha e humbur, duhen bërë më shumë ndryshime cilësore edhe në art e në letërsi. Këto ndryshime nuk duhet të bëhen duke mohuar trashëgiminë artistike të realizmit tonë socialist, ashtu si ndryshimet cilësore në realitetin tonë nuk u bënë duke mohuar veprimtarinë e Partisë dhe të popullit për ndërtimin e socializmit. E reja, novatorizmi, jashtë truallit tonë socialist, jashtë realitetit tonë, është novatorizëm i rremë.

Përpjekjet për ta revolucionarizuar, për ta rinuar artin tonë, nuk duhet menduar se janë detyrë vetëm e disa artistëve dhe e shkrimtarëve të veçantë. Do të ishte gabim, gjithashtu, të mendohej se kjo është detyrë vetëm e artistëve dhe e shkrimtarëve të rinj.

Fryma revolucionare, novatorizmi, janë pjesë organike e vetë realizmit socialist. Duke qenë se arti dhe letërsia jonë qëndrojnë plotësisht në pozitë të realizmit socialist, artistët dhe shkrimtarët tanë janë partizanë të denjë të këtij realizmi, luftëtarë të vendosur të vijës revolucionare të Partisë dhe të masave punonjëse, ata të gjithë do të luftojnë për t'i çuar përpara artin dhe letërsinë tonë, për të krijuar vepra të reja, të denja të qëndrojnë në radhët e para të luftës së

Partisë kundër ideologjisë borgjeze dhe revizioniste, për ndërtimin e socializmit e të komunizmit.

Këtë detyrë do ta kryejnë më mirë ata shkrimtarë, piktorë, muzikantë dhe artistë që do të rrojnë gju më gju me popullin, që do ta duan atë me të gjitha forcat e shpirtit të tyre, që do të punojnë e do të lodhen me të, do të këndojnë e do të trishtohen tok me të. Me një fjalë, në rast se ata kuptojnë mendimet e thella të popullit, preken nga ndjenjat e tij të pastra, frymëzohen nga patriotizmi i tij i madh, nga talentet, nga iniciativat revolucionare, nga krijimtaria e tij e mrekullueshme, atëherë ne do të kemi një letërsi të ndritur popullore socialiste, do të kemi piktura të mrekullucshme, që të shprehin realitetin material dhe shpirtëror të shoqërisë sonë socialiste, do të krijojmë gjithnjë një muzikë me baza popullore, të afërt, të dashur, të kuptueshme, të ndjeshme dhe frymëzuese për popullin, një muzikë që të mos i vërë kazmën folklorit popullor, kësaj pasurie të madhe, por as edhe të ruajë goftë disa forma arkaike që u ka kaluar koha. Nga folklori ne duhet të ruajmë atë që është e mirë, atë që është e popullit, atë që shpreh ndjenjat e pastra të popullit dhe të spastrojmë ato pjesë, goftë në formë a në përmbajtje, në të cilat kanë depërtuar ideologjia dhe frymëzimi i klasave sunduese, i lumpenmikroborgjezisë etj.

Kur flitet për realizmin socialist, kjo çështje nuk duhet kuptuar si një formulë e thatë që përsëritet tej e tëhu, mbi të cilën thuren teori dhe shumë herë nxirren formula akademike. Realizmi socialist është pas-

qyrimi me besnikëri i jetës socialiste, që po ndërtojmë, në të gjitha aspektet e saj, i transformimeve kolosale materiale dhe me temp revolucionar që pëson vendi ynë, shoqëria jonë, njerëzit tanë, në bazë të teorisë marksiste-leniniste dhe në bazë të masave e të vendimeve të përpunuara nga Partia jonë. Por ky realizëm socialist nuk paraqitet aspak në forma statike, të ngurta; ai zien, është në zhvillim të përhershëm e të vazhdueshëm, nëpërmjet një lufte të të kundërtave, nëpërmjet një lufte klase, nëpërmjet luftës të së resë kundër së vjetrës.

Ky realizëm socialist, i paraqitur dhe i kuptuar kështu, është i lidhur me të tanishmen dhe me perspektivën. E tanishmja përgatit të ardhmen dhe këtë të ardhme nuk e përgatit nëpërmjet ëndërrimeve dhe imagjinatave irrealë, por nëpërmjet parashikimeve shkencore materialiste, të drejtuara nga ligje të njohura, të cilat shkencërisht ndihmojnë për të njohur ligje të tjera.

Transformimin revolucionar të shoqërisë e bëjnë njerëzit nëpërmjet organizimit, edukimit, studimit dhe punës. Njerëzit nuk lindin skllëvër dhe nuk mund të durojnë skllavërinë fizike dhe mendore. Vetëm socializmi dhe partia marksiste-leniniste i çlirojnë ata nga skllavëria. Pra, njeriu në vendin tonë punon, mendon, krijon, prodhon, konsumon, riprodhon. Partia ka tendosur të gjitha forcat fizike e mendore që njerëzit tanë të jenë sa më të qartë ideologjikisht, që edhe veprimtaria e tyre të jetë revolucionare e sa më frytdhënëse.

Çdo njeri në jetën e tij revolucionare është krijues, mendimtar, prodhues, transformues. Cilido specializohet pa pushuar të ndiejë, t'i këndojë zemra e tij, të shkru-

ajë dhe të gjykojë për çdo gjë që i takon atij dhe shoqërisë në të cilën ai rron. Këto cilësi, këto shije, Partia përpiqet jo vetëm t'i mbajë gjallë te njerëzit, por t'i zhvillojë më tej, t'i përsosë; dhe pikërisht këtu e ka kuptimin ajo që thotë Partia se kultura dhe artet, arsimi dhe shkenca të bëhen të masave, që masat të jenë njëkohësisht aktorë dhe spektatorë.

Nga kjo masë e madhe dalin talente të shumta që specializohen e perfeksionohen në mënyrë të veçantë nëpër shkolla. Objektivi i këtyre specializimeve janë kurdoherë masat e popullit. Çdo gjë për popullin, çdo gjë që krijohet të mbajë vulën e krijimtarisë popullore, të shpirtit revolucionar popullor, të realizmit socialist. Jashtë këtyre asgjë nuk vlen.

Shkrimtarët dhe artistët tanë nuk duhet ta konsiderojnë veten ëndërrues të zbrazët, as njerëz që mund të krijojnë gjëra të bukura, të shkëputura nga realiteti konkret dinamik i vendit dhe i shoqërisë sonë socialiste. Ata nuk duhet ta vetëgjykojnë të përsosur krijimtarinë e tyre në rast se në veprat që krijojnë nuk pasqyrojnë, të ngritura në art, ndjenjat, shijet, mendimet, krijimtarinë e masave. Disa prej tyre vënë ëndërrimet, fantazinë e tyre mbi krijimtarinë e masave dhe nuk i lidhin ato me përfytyrimin realist dhe objektiv të perspektivës. Disa të tjerë janë dashuruar me vetveten, me veprën e tyre dhe atë e lëmojnë dhe e stërlëmojnë jashtë çdo realiteti objektiv dhe harrojnë se një gjë e tillë i largon nga masat, të cilat janë objekti dhe subjekti kryesor i veprës. Ata nuk durojnë kritikën, ata mendojnë se çdo gjë që del nga dorë dhe truri i tyre është e përsosur.

Disa të tjerë preokupohen më shumë se ç'do të thotë kritika letrare dhe, kur ata lëmojnë e stërlëmojnë veprën, mendojnë dhe parashikojnë jo aq shumë të përshkruajnë realitetin, por t'i dalin përpara kritikës subjektive të ndonjërit, ose të disave, për t'ia imponuar veprën masës nga lart. Kjo është rrugë e shtrembër, që duhet të braktiset.

Ne jemi kundër shkëputjes së arteve dhe të letërsisë nga realiteti, kundër shkëputjes së tyre nga masat. Kërkesat për t'i larguar letërsinë dhe artet nga anakronizmi nuk duhet të identifikohen me përpjekjet për të krijuar një art dhe letërsi të pakuptueshme për popullin.

Rrëshqitja në devijime të tilla në letërsi dhe në artet e ka burimin në shkëputjen nga masat e popullit, nga vija e masave, nga analiza dhe nga shikimi i gjërave, i fenomeneve, i ndryshimeve nën prizmin e teorisë marksiste-leniniste. Një rrëshqitje e tillë formohet gradualisht në rrethanat që përmenda më lart dhe ndihmohet nga mjaft rrethana të tjera subjektive që i ushqen, me dashje ose pa dashje, një ambient i prapambetur, me mbeturina të theksuara mikroborgjeze idealiste, i ushqen origjina klasore e shkrimtarit ose e artistit, tek i cili shkëputja nga pozitat e klasës së vet dhe vënia në pozita klasore revolucionare nuk ka arritur atë shkallë sa të shkallmojë mbeturinat idealiste të një të kaluarë jo shumë të largët.

Borgjezia, revizionizmi modern dhe politika e tyre në letërsi dhe në arte këtë kujdes të madh që tregojnë partitë e vërteta marksiste-leniniste për ruajtjen e pas-tërtisë ideologjike dhe të politikës klasore proletare

në letërsi dhe në arte, si dhe për qartësinë ideologjike të shkrimtarëve dhe të artistëve, e quajnë «një vijë shtrënguese, imponuese, mbyhtëse të mendimit të lirë krijues». Ne e dimë fare mirë ku rrahin borgjezia dhe ideologjia e saj, ku synojnë politika dhe ideologjia e saj në letërsi dhe në arte. Ashtu si në të gjitha drejtimet, ajo zhvillon edhe në drejtimin e letërsisë dhe të arteve luftën e saj për mbrojtjen e sundimit të vet klasor dhe për ruajtjen e shfrytëzimit mbi masat e gjera popullore. Kurse ne, marksistë-leninistët, zhvillojmë në të gjitha drejtimet luftën tonë klasore proletare për të çliruar, për të zhvilluar, për të bërë që të përparojë me hapa viganë mendimi krijues dhe jo për ta frenuar dhe për ta shtypur atë. Dekadenca dhe degjenerimi i letërsisë dhe i artit borgjez janë të llahtarshëm. Këtë degjenerim ajo përpiket ta ngrejë në model e në simbol për ndërtimin e një mënyre jetese «të re», që s'është gjë tjetër veçse pjella dhe pasqyra besnike e një jete dekadente e të degjeneruar. Me degjenerimin e shpirtave dhe të mendjes së njerëzve borgjezia mendon se ka gjetur mjetin e ri të shtypjes së mëtejshme të njerëzve dhe shuarjen e revolucioneve proletare. Në këtë irracionalizëm të pakufishëm në letërsi dhe në arte borgjezia përdor shumë mjete dhe forma, «talente» të këtij mendimi irracional; «talente» në penë e në marifete të të paraqiturit të çështjeve që të mund të gënjejë sa më shumë, që të mund ta bëjë atë të përshtatshme për të infektuar sa më shumë njerëz, ku tërësisht, ku në sipërfaqe, por kurdoherë pa harruar qëllimin për të korruptuar njerëzit e për të trullësuar masat.

Prandaj Partia i mëson, i edukon, i kalit të gjithë.

Veçanërisht njerëzit e letërsisë dhe të arteve të jenë vigjilentë nga kurthet që ngrenë armiku i klasës, si brenda ashtu edhe jashtë, të ruhen nga pilulat e helmatisura letrare dhe artistike të mbuluara me një cipë sheqeri, të mos gënjehen dhe të mos entuziazmohen nga «stilet e ndritshme», nga gjoja «idetë e guximshme» dhe «figurat origjinale». Të mos harrojmë fjalën popullore «çdo gjë që ndrit nuk është ar». Nën këtë ndriçim fals fshihen plagët e qelbura të borgjezisë në dekompozim.

Origjinalitetin, stilin, formën etj., njerëzit tanë të letërsisë dhe të arteve le t'i kërkojnë dhe do t'i gjejnë të bukura, të pastra, mobilizuese dhe entuziazmuese, në radhë të parë, në ambientin revolucionar krijues të popullit tonë të talentuar.

III

NËPËRMJET DISKUTIMIT MASIV TË PËRCAKTOJMË DREJT KONCEPTET REVOLUCIONARE TË SHKOLLËS SONË

Në procesin e madh të thellimit të revolucionit tonë socialist Partia po zhvillon një punë të gjithanshme për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës. Ne duhet të ndërtojmë një shkollë të re që mund të mos e kenë të tjerët. Kjo do të thotë se neve do të na duhet të ecim në disa rrugë edhe të panjohura. Në këtë punë mund të bëjmë edhe disa gabime, por ato vazhdimisht duhet t'i ndreqim dhe ta përmirësojmë kështu shkollën tonë.

Shkolla jonë duhet të jetë masive, popullore, revolucionare dhe t'u përgjigjet nevojave aktuale e perspektive të vendit tonë socialist. Që ta revolucionarizojmë shkollën nuk do të thotë të rregullojmë vetëm disa qoshe, të bëjmë vetëm disa spastrime tekstesh, ose të zgjerojmë rrjetin, por në radhë të parë të rrëzojmë disa koncepte borgjeze që ekzistojnë në brezin tonë për shkollën dhe që pengojnë revolucionarizimin e mëtejshëm të saj.

Koncepte të tilla janë:

Së pari, «shkolla është vendi ku mësohet». Ky koncept duhet të ndryshohet dhe të kthehet në konceptin sipas të cilit «shkolla është vendi ku mësohet dhe punohet».

Së dyti, «mësohet vetëm në shkollë, ose kryesisht në shkollë». Edhe ky koncept duhet të ndryshohet dhe të krijohet koncepti që «nuk mësohet vetëm në shkollë, por mësohet edhe në jetë, edhe në punë, këtu bile ca më shumë». Lidhur me këtë të rrëzohet koncepti që «programet e shkollave të jenë sa më të ngjeshura, pasi këtu duhen marrë të gjitha bazat e diturisë».

Së treti, «shkolla të bën intelektual, të jep diplomë dhe punë të sigurt», koncept që ushqen intelektualizmin dhe karrierizmin, teknokratizmin dhe burokratizmin.

Së katërti, «qëllimi përfundimtar i gjithë shkollës është mbarimi i universitetit». Nga ky koncept lind pikëpamja e gabuar sipas së cilës i gjithë cikli i shkollave duhet të ndërtohet në atë mënyrë që të rinjtë dhe të rejat të mund të ndjekin universitetin dhe sikur ky i përket vetëm një «elite», sikur atë duhet ta ndjekin

vetëm bijtë e disa shtresave a të disa familjeve «të kulturuar», sikur ata të ishin «më të zgjuarit», «më të zotët», «të destinuar për të udhëhequr të tjerët».

Këto koncepte të vjetra nuk marrin parasysh realitetin e zhvillimit tonë socialist dhe pengojnë ecjen përpara në shumë drejtime të rëndësishme për realizimin e qëllimeve tona të mëdha.

E para, ne synojmë të edukojmë në masë popullin dhe rininë, punëtorët e kooperativistët, të cilët, në një të ardhme imediate, duhet të jenë me kulturë të përgjithshme dhe tekniko-profesionale të mjaftueshme për të çuar përpara ekonominë dhe kulturën socialiste. Këta do të jenë kuadro të mesëm në masë të madhe, punonjës me arsim të mesëm të plotë. Kjo është baza. Po harruam këtë dhe po nuk ndërtoam shkollën dhe brendinë e saj për këtë bazë dhe për këto qëllime, ne nuk e kemi revolucionarizuar atë.

E dyta, e gjithë kjo masë që mbaron shkollën nuk ka mbaruar së mësuar. Pajisja me kulturë dhe specializimi i mëtejshëm i kësaj mase nuk mund të bëhen vetëm nëpërmjet universitetit, por edhe nga jeta, nga puna, nga puna fizike, nga puna ideologjike e politike e Partisë dhe e organeve shtetërore e shoqërore, nëpërmjet shtypit, mbledhjeve, konferencave, seminareve, mitingjeve, diskutimeve shkencore dhe një mijë formave të tjera, ku secili jo vetëm plotëson ato që ka mësuar në shkollë, por mëson edhe shumë gjëra të reja, shpesh më shumë e më mirë nga ato me të cilat kërkohet të mbushim tekstet dhe kokat e njoma të të rejave e të të rinjve në bankat e shkollës.

Kjo nuk do të thotë aspak se ne nënvleftësojmë

shkollën dhe rolin që duhet të luajë ajo në hedhjen e bazave për zhvillimin dhe për edukimin e gjithanshëm komunist të njeriut. Pikërisht për të luajtur këtë rol Partia u kushton një kujdes kaq të madh zhvillimit dhe revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës.

E treta, ne duhet të na preokupojë shëndeti i rinisë sonë. Ky faktor bazë duhet të kihet absolutisht parasysh në ndërtimin e shkollës sonë, të mos e rëndojmë atë jo vetëm me gjëra të kota e të panevojshme, por as edhe me ato të cilat nxënësi apo studenti, për të zhvilluar më tej intelektin dhe njohuritë e tij, do t'i mësojë në jetë dhe në punë; të mos e ngarkojmë atë vetëm me mësim, por të gërshetojmë mësimin me punën prodhuese dhe me kalitjen fizike e ushtarake, pasi kështu jo vetëm realizojmë edukimin e gjithanshëm komunist, por edhe rritim një brez të ri të shëndetshëm e të fortë fizikisht.

E katërta, të kemi kurdoherë parasysh se njerëzit që mësojnë në rendin tonë socialist s'janë disa qindra, ose disa mijëra, por me qindra mijë. Shkolla jonë nuk duhet të synojë të krijojë inteligjencien në kuptimin e një shtrese, që vazhdimisht të qëndrojë e shkëputur si shtresë, por të synojë që kjo masë e madhe e mësuar të përbëhet, në radhë të parë, nga punëtorët dhe nga fshatarët dhe ajo pjesë e saj që përbën inteligjencien, të shkrihet me ta. Në këtë masë, pra, vendin e parë do ta zënë punëtorët dhe kooperativistët e sotëm dhe të nesërm të kulturuar.

Prandaj shkollën e re revolucionare nuk mund ta shkëputim nga jeta intensive revolucionare, nuk mund ta shkëputim nga zhvillimi dhe nga modernizimi i in-

dustrisë dhe i bujqësisë, nuk mund ta ndërtojmë jashtë nevojave aktuale dhe të perspektivës së zhvillimit të socializmit në vendin tonë.

Mësimi dhe puna, shkolla dhe jeta duhet të lidhen ngushtë dhe kjo të bëhet që te nxënësit me moshë të re. Sentimentalizmat e sëmurë të disa mësuesve dhe pedagogëve, tendencat enciklopediste, erudicionale dhe shijet e sëmura të disave nuk duhet të na tërheqin aspak nga rruga e drejtë e revolucionarizimit të shkollës sonë.

Përcaktimi sa më i drejtë, sa më real i hallkave të ndryshme të shkollave, domethënë i llojeve të ndryshme, sidomos i atyre të shkollës tetëvjeçare, ka rëndësi vendimtare për shkollën tonë socialiste. Një strukturë e tillë nuk mund të huazohet, apo të kopjohet me sy mbyllur nga një sistem i huaj, por duhet t'i përshtatet vendit tonë, t'i përgjigjet realitetit socialist të vendit tonë, të plotësojë nevojat dhe të përgatitë njëkohësisht në masë për të ardhmen akoma më të përparuar kua-dro dhe punonjës të ngritur me bazë të shëndosha diturie dhe shkence.

Sistemi dhe struktura e shkollave të bëjnë të qartë lëndën që duhet të mësohet në këto shkolla, cilësinë dhe sasinë e saj, të koordinuar me kushtet dhe me nevojat objektive të së tanishmes dhe të së ardhmes për një periudhë më të gjatë. Kur këto të jenë përcaktuar, atëherë hartimi i teksteve, që ka një rëndësi shumë të madhe, që është një punë shumë e vlefshme dhe delikate, do të kryhet me sukses, pasi u përcaktohen atyre orientimet, qëllimet, caqet e sasisë së materialit që do të përmbajë dhe puna përqendrohet më mirë në cilësinë e tyre, që është kryesorja.

Po të veprojmë në punën tonë për revolucionarizimin e shkollës në kuadrin e diskutimit masiv të këtyre problemeve, do të përcaktojmë më drejt konceptet revolucionare të shkollës sonë të re dhe do të jemi më mirë në gjendje të shkëputemi, sidomos në brezi i vjetër i intelektualëve, nga ato koncepte të vjetra që kemi për shkollën. Pedagogët dhe profesorët e universitetit dhe të instituteve të larta do të kuptojnë më mirë se mësimet e larta në universitet dhe në institute duhet të harmonizohen, të ndërtohen në funksion me bazën e shkollave të mesme të shumëllojta dhe jo shkollat e mesme të ndërtohen në funksion të universitetit. Më qartë dua të them se ne nuk duhet të kemi prirje që universitetin tonë ta bëjmë shumë të ngarkuar, pasi atëherë do të na duhet që për ta ndjekur një universitet të tillë edhe shkollat e mesme t'i ndërtojmë në këtë model. Një universitet i tillë nuk është për ne, pasi duke dashur ta rëndojmë, ne kufizojmë jo vetëm atë, por edhe arsimin e mesëm e rëndojmë dhe e kufizojmë.

Rëndimin, dhe si rezultat i tij kufizimin, disa e quajnë cilësi, kurse në të vërtetë harmonizimi i universitetit me bazën e shkollës dhe në përputhje me nevojat e aktualitetit dhe të perspektivës nuk do të thotë aspak rënie e cilësisë, përkundrazi. Në rast se pedagogët e universitetit dhe të instituteve të larta, në bashkëpunim me mësuesit e bazës dhe të gjithë së toku, mbi bazën e ndërtimit të gjithanshëm socialist të vendit dhe të zhvillimit të shkencave, e kuptojnë si duhet këtë orientim, duke zotëruar mirë diturinë dhe shkencën, ata do të jenë në gjendje më së miri të bëjnë thjeshtime dhe spastrime të nevojshme në lëndët e

tyre. Këto jo vetëm nuk do ta ulin nivelin, por do ta ngrenë më lart, do t'u heqin diturisë dhe shkencës pluhurin, do t'i bëjnë ato më të kuptueshme, më të prekshme. Duke vepruar kështu pedagogët do të fitojnë kohë të vlefshme për studentët dhe për veten e tyre. Partia e kërkon këtë punë monumentale prej njerëzve të saj të mësuar, anëtarë partie ose jo, që punojnë në universitet dhe në shkolla. Ata duhet ta bëjnë këtë për brezat e rinj, edukimin e të cilëve ua ka besuar Partia. Këta janë në gjendje ta bëjnë dhe Partia është plotësisht e bindur se këta do t'ia dalin mbanë me sukses kësaj vepre të madhe patriotike dhe revolucionare.

Tani në vendin tonë po bëhet një diskutim i përgjithshëm popullor për këto çështje. Në kuadrin e këtij diskutimi të gjerë masiv mësuesit dhe pedagogët tanë do të japin patjetër kontributin e tyre të çmuar, do të luftojnë për të gjetur zgjidhjen shkencore dhe konkrete të parimeve që shtron Partia, për t'i mishëruar këto parime në sistemin arsimor që do të ndërtojmë, në kategoritë e ndryshme të shkollave, në përcaktimin e përmbajtjes dhe të afateve të tyre, në harmonizimin e mësimit me punën prodhuese dhe me përgatitjen fizike e ushtarake, në përcaktimin e programeve, të teksteve dhe të metodave të mësimit e të edukimit. Zgjidhja e këtyre çështjeve ka rëndësi të madhe aktuale dhe perspektive. Ajo kërkon që të jepen mendime të argumentuara nga të gjitha anët, duke zhvilluar diskutime dhe debate të lira. Për këtë nuk mjafton vetëm të thuhet se shkolla duhet të jetë kaq ose aq vjet, se kësaj lënde mund t'i hiqen kaq ose aq orë, se mua më duket se kështu ose ashtu është më mirë, pa i argu-

mentuar nga të gjitha anët, dhe në radhë të parë nga ana ideologjike e shkencore, propozimet dhe variantet e ndryshme. Përndryshe, mendimet e cekëta dhe të sipërfaqshme, propozimet e bëra vetëm me hamendje, dëshirat dhe prirjet subjektive nuk ndihmojnë efektivisht në zgjidhjen e këtyre problemeve.

Çështja është që t'i shikojmë problemet arsimore të lidhura ngushtë dhe në funksion me problemet themelore të thellimit të mëtejshëm e të gjithanshëm të revolucionit socialist. Kjo ka të bëjë edhe me brendinë e kulturës së përgjithshme që duhet të marrin brezi i ri dhe punonjësit tanë në shkollë. Lidhja e kulturës së përgjithshme me stadin e zhvillimit ekonomik-shoqëror të vendit tonë është e domosdoshme të bëhet dhe për këtë çështje duhen marrë parasysh niveli arsimor dhe kulturor i punonjësve dhe i rinisë sonë, zhvillimi tekniko-ekonomik i vendit sot dhe në një të ardhme pak a shumë të afërt, shkalla e mekanizimit të prodhimit tonë, nevoja e pajisjes së njerëzve tanë me kulturë edhe pas shkollës, si dhe spastrimi rrënjësor i atyre njohurive që mund të duhen për specializime të ngushta, por që nuk i nevojiten gjithë masës. Në të njëjtën kohë, e gjithë kjo kulturë e përgjithshme duhet të përshkohet fund e krye nga ideologjia jonë marksiste-leniniste, nga filozofia jonë e materializmit dialektik dhe historik, duhet të ketë e tëra një bosht të vetëm, boshtin ideologjik marksist-leninist.

Në shtyp dhe në buletinet e Komisionit Qendror lexoj mbi diskutimet e propozimet që bëhen për revolucionarizimin e shkollës. Kjo është një gjë e mirë dhe duhet vazhduar të rrihen mendimet.

Në punën që bëhet për rregullimin e programeve dhe të teksteve duhet të ruhem nga qëndrimet e njëanshme, joshkencore e jodialektike. Për shembull, në abetaren dhe në librat e leximit të shkollës fillore e tetëvjeçare materiali duhet të jetë i pasur e jo vetëm me fenomene e ngjarje nga shoqëria, siç mendojnë disa, por edhe nga natyra. Njëra duhet të plotësojë tjetrën në përpjesëtime të drejta dhe të harmonizuara. Kam lexuar që diskutohet të ruhet apo të mos ruhet përralla. Mendoj se për të vegjëlit, për zhvillimin e fantazisë dhe për edukimin e tyre, duhet ruajtur përralla, qoftë edhe nga jeta e kafshëve, por jo me ëndërrime e simbolizma jashtë realitetit tonë dhe jashtë moralit tonë komunist. Të përgatiten për këtë qëllim tregime dhe pjesë të tjera me përmbajtje realiste për luftën kundër forcave të këqija të së kaluarës dhe të nxitet fantazia e fëmijëve për të ardhmen e ndritur të vendit të tyre, të mbështeten këto tregime në ndodhi të vërteta e me moral të lartë edukues, të trajtuara në gjinitë dhe në format më të ndryshme, duke mos përjashtuar edhe përrallën. Kjo le të diskutohet, por të mos kërkohet t'u bëjmë kalamajve leksione.

Sipas vendimit¹ të Komitetit Qendror, Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë do të studiohet me punëtorët, me fshatarët, me inteligjencien, si dhe në gjimnazet, në teknikumet dhe në shkollat e tjera të larta. Veç kësaj, unë mendoj që të diskutohet edhe se si të studiohen edhe në shkollat tetëvjeçare disa momente

¹ Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. V, f. 499. Tiranë, 1974.

kyç të historisë së Partisë sonë, në forma të përshtatshme për moshën e nxënësve të këtyre shkollave.

Në studimin e historisë botërore të popujve duhet t'u vihet rëndësi fenomeneve të mëdha historike, kthesave dhe ngjarjeve vendimtare në zhvillimin e shoqërisë njerëzore, kryesisht luftës së masave, që bëjnë historinë, dhe jo individëve. Natyrisht, ata individë që kanë luajtur një rol s'ka si të mos përmenden, por jo në hollësi dhe si qëllim në vetvete, siç bën historiografia borgjeze.

Lufta e klasave, si forca kryesore lëvizëse e zhvillimit shoqëror, duhet të përshkojë tërësisht si mësimin e historisë ashtu edhe të lëndëve të tjera shoqërore.

Në lëndën e gjeografisë do pasur kujdes në përcaktimin e drejtë të raporteve midis gjeografisë fizike dhe asaj ekonomike e politike. Nuk mund të ketë gjeografi pa u trajtuar të dyja këto anë. Të nënvleftësosh gjeografinë fizike do të thotë të ndërtohet një gjeografi në erë, së cilës i mungojnë bazat e domosdoshme natyrore dhe shkencore. Por edhe të humbasësh në hollësitë e pafund të gjeografisë fizike në kurriz të gjeografisë ekonomike e politike, do të thotë të nënvleftësosh edukimin klasor ideopolitik të nxënësve dhe të ngarkosh kujtesën e tyre me gjëra të panevojshme.

Për sa u përket shkencave të natyrës — matematikës, fizikës, kimisë, biologjisë etj., krahas rritjes së përpjekjeve për interpretimin materialist-dialektik të fenomeneve, jam i një mendimi me atë që propozojnë që mësimi i këtyre lëndëve të ndërtohet në një mënyrë të tillë që të ketë një brendi më të theksuar politike, të lidhet më shumë me prodhimin tonë so-

cialist, me zbatimin e shkencës dhe të teknikës moderne në prodhim.

Në shkollën tonë i gjithë mësimi, si kultura e përgjithshme ashtu edhe ajo teknike e profesionale, duhet të lidhet ngushtë me punën prodhuese. Realizimi i boshtit ideologjik marksist-leninist në gjithë punën e shkollës nuk mund të arrihet pa zbatuar parimin e njohur marksist-leninist të lidhjes së mësimi me punën prodhuese, pa e zbatuar jo me fjalë dhe në mënyrë akademike, por konkretisht dhe në mënyrë praktike. Kjo ka të bëjë me gjithë punën e shkollës sonë, me strukturën e saj, me përmbajtjen e mësimi dhe të edukimit, si dhe me metodat e tij. Këto çështje tani kanë filluar të diskutohen gjallërisht dhe në këtë diskutim do të luftohen konceptet borgjeze intelektualiste që nënvleftësojnë pjesëmarrjen e rinisë shkollore në punën prodhuese, si dhe do të gjenden rrugët për të kapërcyer vështirësitë që dalin në organizimin efektiv të kësaj pune.

Por unë këtu desha të ndalem pak në rëndësinë që ka ky parim në lidhje me metodën e mësimi dhe të edukimit dhe për konkluzionet që duhet të nxjerrim nga kjo përgjithësisht për revolucionarizimin e metodave të mësimi dhe të edukimit. Është fakt dhe e kemi thënë edhe tjetër herë se revolucionarizimi i shkollës, qoftë i brendisë, qoftë i strukturës së saj, nuk mund të kuptohet pa revolucionarizuar metodat e mësimi dhe të edukimit. Mirëpo duhet të pranojmë se megjithëse në jetë ka disa iniciativa e aksione revolucionare, në këtë drejtim diskutimet teorike për këto çështje janë shumë të cekëta dhe anësore.

Nga kjo pikëpamje ne të gjithë themi se shkolla ka për mision të madh jo vetëm t'u mësojë dituri njerëzve, por t'i armatosë ata me metodën më të mirë si të mësojnë në klasë dhe jashtë saj. Por këtu duhet të shtojmë se vetëm kur e lidhim mirë mësimin me punën fizike ne kemi zgjedhur metodën më të mirë si të mësojmë dhe të punojmë më mirë.

Neve intelektualëve, anëtarë partie ose jo, të mos na rritet mendja se jemi shpikësit e metodave më të mira të punës mendore dhe se në këtë çështje duhet të na ndjekin njerëzit e punës fizike. E kundërta duhet të ngjasë. Te klasa punëtore ne duhet të mësojmë edhe për metodën e punës, pasi atje do të gjejmë metodat më të mira që përmbajnë ato elemente bazë, siç janë vendosmëria, shkathtësia, racionalizmi i vërtetë, kërkesa e përpiktë dhe jo ëndërrimet, disiplina, vullneti i hekurt e shumë të tjera, që lidhin si duhet teorinë me praktikën, që shtyjnë rrotën e zhvillimit krijues përpara duke mos lejuar sklerozimin, pluhurin, plogëshтинë, rutinën, intelektualizmin e sëmurë.

Shkrimtarët, artistët, mësuesit, profesorët, shkencëtarët, që mësojnë nxënësit, më parë duhet të jenë vetë nxënës, dhe jo vetëm nxënës në libra, por në punë, në fabrika, në ara, në laboratorë, në shoqëri.

Gjithë puna jonë edukative me rininë dhe me atë pjesë që ne e quajmë shtresa e inteligjencies duhet të konsistojë në atë që ajo të shkrihet, të marrë plotësisht pamjen shpirtërore dhe praktike revolucionare të punëtorëve dhe të fshatarëve punonjës. Prandaj ne duhet ta bëjmë të përsosur lidhjen e shkollës me punën, lidhjen jo vetëm politike, shpirtërore, por edhe organike

të intelektualëve me punëtorët dhe me fshatarët kooperativistë, të arrijmë në atë që intelektualët të men- dojnë, të ndiejnë dhe të punojnë si punëtorët dhe fsha- tarët. Ky është një problem me rëndësi të dorës së parë, që duhet kuptuar thellë dhe për të cilin duhet të marrim masa serioze e të vazhdueshme që ta bëjmë realitet, sepse ne, si një vend socialist që jemi, po e ngremë pa ndërprerje nivelin arsimor e kulturor të masave, dhe veçanërisht të rinisë, e cila duhet të edu- kohet me tiparet e revolucionarëve të vërtetë. Të mos harrojmë se kjo është e ardhmja, por që rritet në so- cializëm, që nuk ka njohur vuajtjet dhe shtypjen sho- qërore si prindërit dhe gjyshërit e vet. Kjo rini ka shumë nevojë të mësohet e të edukohet, por ka, gjith- ashtu, shumë nevojë të punojë, të lodhet, të djersijë e të shkrihet me klasën punëtore dhe me fshatarësinë punonjëse. Prandaj duhen ndryshuar krejtësisht kon- ceptet gjysmake mbi revolucionarizimin e inteligjen- cies, konceptet e vjetra vetëm të shartuara me të reja, si marrja e masave gjysmake për çështjen e punës, ose kuptimet karrieriste të së kaluarës të fshehura nën një lustër pseudorevolucionare.

Ne duhet të zhvillojmë një luftë të thellë politike dhe ideologjike për këto çështje në të gjithë njerëzit tanë, në prindër dhe në të rinj. Duhet sqaruar vazh- dimisht të rinjtë, inteligjencia aktuale dhe ajo e ardh- shme. T'i edukojmë ata në mënyrë që të veprojnë vazh- dimisht dhe kudo në rrugë revolucionare; edukatën që u japim të rinjve të mos e shtrembërojë prindi me mbeturinat dhe me sensibilitetet e tij të sëmurë.

Në shkollën tonë mësimi dhe puna duhet të gër-

shetohen patjetër edhe me përgatitjen fizike e ushtarake. Nga diskutimi popullor do të dalin edhe rrugët e mundësitë konkrete për zgjidhjen e këtij problemi. Por për arritjen e këtij qëllimi, krahas të tjerave, është e domosdoshme të luftohen konceptet e vjetra që nënvleftësojnë zhvillimin dhe edukimin fizik, sidomos kulturën e përgjithshme fizike. Kultura fizike në shkollë dhe jashtë saj nuk duhet kuptuar përciptas, vetëm si zhvillim i disa sporteve, kryesisht i lojërave me top, që kurrsesi nuk mund të përfshijnë gjithë masën, aq më tepër nuk duhet kuptuar vetëm si zhvillim i disa aktiviteteve që, në disa raste, nxitin vetëm një tifozllëk, por si një lëvizje e gjerë masive e gjithë popullit, e gjithë rinisë, e lidhur ngushtë me jetën e njerëzve, me shëndetin e tyre, me zgjatjen e jetës, me luftimin me sukses të sëmundjeve, të cilave u zvogëlohet sfera dëmprurëse në një organizëm të shëndetshëm. Prandaj duhet luftuar koncepti i vjetër, i mykur se kultura fizike është diçka e tepërt, e panevojshme, se organizmi mund të zhvillohet, të mbrohet dhe të ecë edhe pa të. Natyrisht, tani nuk jemi më si përpara, në këtë fushë ka përparime, por ka edhe formalizëm e stereotipizëm.

Të gjithë dhe kudo nuk mund të zhvillojnë disa lloje sportesh. Të gjitha sportet nuk janë, gjithashtu, njëlloj për të gjitha moshat, por të gjitha llojet e sporteve mund të zhvillohen në çfarëdo terreni. Prandaj asnjë njeri nuk duhet ta braktisë atë lloj sporti të përshtatshëm për organizmin dhe për moshën përkatëse dhe asnjë terren fushor, kodrinor apo malor nuk duhet lënë pa shfrytëzuar për këtë çështje. Zhvillimi i kulturës fizike të mos konsiderohet kohë e humbur, për-

kundrazi, kohë e fituar, sepse i zgjat jetën njeriut.

Lidhur me këtë desha të shtroj pak më gjerë problemin e shëndetit të njeriut. Partia duhet të bëjë shumë për zgjatjen e jetës së njeriut, domethënë për shëndetin e tij. Ky duhet të jetë problemi kardinal i saj në çdo gjë, duhet të mbahet në evidencë dhe kurdoherë të veprohet, të mos qëndrohet në vend, të mos kënaqemi me rezultatet e arritura.

Lufta për shëndetin e mirë të njerëzve tanë nuk duhet matur vetëm me shtimin e numrit të mjekëve, të institucioneve mjekësore, të pajisjeve të tyre me mjete moderne, të cilat kanë, sigurisht, rëndësi shumë të madhe. Të gjitha këto tani te ne janë shtuar e janë perfeksionuar, por duhet akoma më shumë t'ia afrojmë popullit, i cili të shërbehet prej tyre më shpejt dhe më mirë.

Ne duhet të luftojmë edhe në dy drejtime të tjera kryesore: së pari, për përmirësimin e mëtejshëm të ushqimit të popullit, domethënë për ngritjen e nivelit të jetesës së njerëzve tanë; dhe së dyti, për marrjen e masave të mundshme progresive për ta bërë punën kurdoherë e më pak të lodhshme.

Këto janë dy nga problemet tona më kryesore që kanë marrë një rrugëzgjdhje të mirë te ne. Në këto fusha kemi bërë përparime shumë të mëdha në krahasim me të kaluarën, megjithatë ne duhet t'i përqendrojmë akoma vëmendjen dhe energjitë tona në këto dy drejtime kryesore, pasi kemi shumë për të bërë. Këto probleme ne do t'i zgjidhim çdo ditë e më mirë, si duke zgjeruar e duke shumëfishuar prodhimet ashtu edhe duke ecur në rrugën e mekanizimit sa më të madh të proceseve të punës, si në industri edhe në bujqësi.

Ne kemi plane në këto drejtime, të cilat janë duke u zgjidhur me sukses.

Por unë dëshiroj të vë në dukje se, megjithëkëtë, megjithëse Qeveria ka caktuar fonde, megjithëse edhe kooperativat bujqësore kanë fonde të mira për investime të frytshme, në mjaft raste (dhe këto nuk janë të pakta, si në industri, por sidomos në fshat), neglizhohet seriozisht në çështjen e lehtësimit të punës së punonjësve edhe kur janë të gjitha mundësitë të merren masa. Këto neglizhenca duhen dënuar rreptësisht.

Shumë mekanizime dhe racionalizime, sado të vogla, por që lehtësojnë mundin e punëtorëve, nuk bëhen nga udhëheqjet e ndërmarrjeve. Shumë fonde të destinuara posaçërisht për këto gjëra i lënë e digjen, pa menduar humbjen e madhe që pësojmë, duke djegur energjitë dhe shëndetin e punëtorëve tanë. Shumë drejtues ndërmarrjesh duhet t'i shtysh me hosten për të ngritur çerdhet e kopshtet, për të ndërtuar për punëtorët mensat, banjat, dushet e të tjera ambiente nga më të nevojshmet.

Shumë kryesi kooperativash, gjithashtu, abuzojnë me heroizmin në punë, me patriotizmin e shkëlqyer të grave dhe të të rejave kooperativiste. Kur vendoset për të ndërtuar një stallë për lopët a për derrat, ata nuk mendojnë fare nga do të merren uji dhe ushqimi për to. Shokëve drejtues as që u shkon ndër mend të llogaritin se për të rritur, fjala vjen, një mijë derra që ka një kooperativë ose një fermë, sa ushqime duhet të përgatiten dhe sa ujë duhet të sillen nëpër stallat, nuk merret mendimi që transportimi i tyre të mekanizohet, të sillen me qerre, me kuaj, me sulina ose me motopompa,

por ky shërbim lihet të kryhet me krahët e grave dhe të vajzave të reja. Nga një anë, pra, bëjmë luftë kundër zakonit të ngarkesës së grave në disa fshatra, nga ana tjetër, kooperativat bujqësore i ngarkojnë me punë të rënda dhe shpesh të papërshtatshme gratë dhe vajzat që nga mëngjesi e deri në orët e vona të mbrëmjes. Ne nuk mund të pretendojmë qysh tani për një mekanizim të madh, të plotë e të gjithanshëm, një kërkesë e tillë nuk do të ishte reale për kushtet tona aktuale, po kur mundësitë ekzistojnë dhe këto i lëmë pa shfrytëzuar, në dëm të shëndetit të njerëzve tanë dhe të prodhimit, ne bëjmë kështu një gabim të pafalshëm. Puna është nder, ajo na forcon shpirtërisht dhe fizikisht, puna na gjallëron dhe na jep jetë, prandaj në këtë prizëm duhet t'i shikojë Partia punën dhe shëndetin e popullit dhe të mos lejojë askërkënd të shmanget nga kjo rrugë e drejtë.

Për të lehtësuar punën e punonjësve në përgjithësi, dhe në veçanti të grave, jo vetëm që duhet të merren masa të përshtatshme, por dëshiroj të theksoj veçanërisht që ndaj grave shtatzëna Partia dhe pushteti duhet të tregojnë kujdes të posaçëm për zbatimin me rreptësi të madhe të të drejtave të ligjshme të kohës para e pas lindjes. Nga raportet që na vijnë nga organet e shëndetësisë, konstatojmë se një përqindje e mirë e vdekjeve të fëmijëve vjen akoma nga lindja para kohe. Kjo ngjet më shumë me fshataret, sepse ngarkohen me punë të rënda në kohën kritike të barrës dhe nuk zbatohet me rreptësi e drejta e lejes. Kjo gjendje duhet të marrë fund menjëherë, sepse e kërkon interesin i lartë i popullit dhe i atdheut.

Duhet të bëhet, gjithashtu, një punë këmbëngulëse politike me gratë për t'i kushtuar kujdes të veçantë rritjes së fëmijës, që kur lind, dhe, sidomos, deri në moshën 4 vjeç. Me gjithë rritjen e lartë të popullsisë gjatë periudhës së pushtetit popullor, na vijnë raporte se kemi akoma një përqindje jo të ulët vdekjesh, pikërisht në vitet e para të jetës së fëmijëve. Për këtë nënat duhet të ndihmohen me kujdes dhe me durim të madh, si me këshilla mjekësore ashtu edhe me ndihma konkrete nëpërmjet konsultave, ambulancave, spitaleve, çerdheve, kopshteve, ushqimeve, pa lënë pas dore për asnjë moment këshillat dhe masat e vazhdueshme, profilaktike dhe të kontrollit të dhënies së kësaj ndihme e të zbatimit të saj.

Shëndeti i njerëzve, ruajtja dhe forcimi i tij duhet të na preokupojnë shumë dhe vazhdimisht. Ambientin ku rrojnë njerëzit duhet ta mbajmë të përshtatshëm, të kulturuar për ta. Prandaj duhet të kujdese mi akoma më seriozisht dhe të mos kënaqemi me çka është bërë për higjienizimin e çdo gjëje e të banesave brendapërbrenda në qytete, por sidomos në fshatra. Për higjienizimin e fshatrave duhet të zbatohen me këmbëngulje planet rregulluese, të pyllëzohet fshati, të sistemohet mbrojtja sanitare e ujërave të pijshme, të largohen sa më parë bagëtitë nga banesat, të cilat vazhdimisht, periodikisht të lyhen me gëlqere si brenda dhe jashtë, kudo ku ka furra kolektive të ndërtohen lavanderitë e banjat publike dhe mjekët të mos lejojnë ndërtim banesash pa parashikuar vendet e përshtatshme higjienike, të cilave sot nuk u jepet asnjë rëndësi, të sistemohen varrezat larg banesave etj., etj.

Me këto masa të domosdoshme të jashtme, brenda në banesa dhe veçanërisht me higjienën personale, ne do të arrijmë të zgjatim më tej jetën e njerëzve, pasi do t'i ruajmë ata me shëndet të mirë dhe do t'ua bëjmë jetën më të gëzuar e më të këndshme.

Të gjitha sa thamë më sipër janë plotësisht të mundshme dhe të realizueshme. Para nesh qëndrojnë shumë probleme të tilla të rëndësishme dhe komplekse sociale me karakter të theksuar ideologjik. I tillë është edhe problemi i fëmijëve.

Desha të tërheq vëmendjen tuaj edhe në punën për edukimin e fëmijëve, pasi ky problem lidhet me thellimin e luftës klasore ideologjike përgjithësisht, në mënyrë të veçantë për edukimin klasor revolucionar të brezit të ri. Problemi i mirërritjes dhe i edukimit të fëmijëve është mjaft i gjerë dhe i ndërlikuar, me karakter ideopolitik, social dhe pedagogjik. Partia dhe Qeveria kanë treguar gjithmonë një kujdes të madh për këtë problem, në sajë të të cilit, si dhe të preokupacionit të të gjithë popullit e të shoqërisë sonë, brezi ynë i ri rritet i shëndetshëm dhe i fortë fizikisht, i pastër moralisht, i zgjuar dhe i vullnetshëm, i kalitur politikisht dhe ideologjikisht, i denjë për ta marrë në duar dhe për ta çuar më tej stafetën ngadhënjimtare të revolucionit tonë.

Por edhe në këtë fushë etapa e thellimit të gjithanshëm të revolucionit tonë socialist shtron vazhdimisht para nesh probleme dhe detyra të reja. Në radhë të parë ato janë me karakter të theksuar ideopolitik, pasi forcimi i edukimit komunist të brezit të ri në frymën klasore revolucionare është një detyrë me rë-

ndësi të madhe historike për Partinë tonë, për shtetin, për gjithë popullin e për gjithë shoqërinë. Por në të njëjtën kohë përparimi i gjithanshëm i vendit tonë në rrugën e socializmit, industrializimi i shpejtë i vendit, kolektivizimi i plotë i bujqësisë, rritja shumë e shpejtë e popullsisë, sidomos e moshave të reja, pjesëmarrja gjithnjë dhe më e gjerë e grave në punë, krijimi i marrëdhënieve të reja socialiste brenda familjes — të gjitha këto procese të vrullshme revolucionare, si dhe të tjera të kësaj natyre, për sa u përket mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve, shtrojnë shumë probleme të reja e të ndërlikuara, që, krahas përmbajtjes së tyre ideopolitike, kanë edhe karakter të theksuar social e pedagogjik. Për këtë mjafton të shikojmë se, si paraqiten këto probleme në qytetin e Tiranës, ku çdo ditë rriten industria dhe klasa punëtore, shtohet shumë popullsia, sidomos në moshat më të reja, vijnë dhe formohen familje të reja, lindin fenomene e nevoja të reja edhe në jetën shoqërore e familjare.

Në këto kushte është e domosdoshme të merremi të gjithë më shumë me problemin e mirërritjes dhe të edukimit të fëmijëve, t'i njohim e t'i studiojmë më thellë anët e ndryshme të këtij problemi, rrugët dhe metodat që duhen përdorur për zgjidhjen e tij, shfrytëzimin maksimal dhe zgjerimin e vazhdueshëm të bazës së gjerë materiale që nevojitet në punën me fëmijët. Në kuadrin e organizimit dhe të zhvillimit të studimeve komplekse me karakter social, të cilat përgjithësisht janë akoma prapa, një kujdes i veçantë i duhet kushtuar problemit të fëmijëve. Në këtë punë, krahas dikastereve dhe institucioneve të interesuara,

duhet të futen edhe specialistët e fushave të ndryshme — mjekët, psikologët, sociologët, juristët e, në mënyrë të veçantë, pedagogët dhe mësuesit tanë.

Në këtë gamë të gjerë problemesh çështja më e madhe, detyra jonë kryesore, është të rritim një brez të ri aktiv dhe revolucionar, me energji të pashtershme dhe me shpirt të paepur luftarak. Këtij qëllimi duhet t'i shërbejë edukata që marrin fëmijët në familje dhe në shkollë, në organizatën e pionierit dhe të rinisë, puna e tërë shoqërisë. Këto cilësi revolucionare duhet t'i mbjellim e t'i kultivojmë te fëmijët që në vogëli dhe gradualisht t'i forcojmë. Mirëpo kjo nuk është një punë e lehtë. Këtu ndeshemi edhe me kontradikta e me pengesa, me koncepte e me tendenca të huaja.

Fëmijët dhe rinia jonë tani zhvillohen dhe pihen më shpejt nga çdo pikëpamje. Fryma revolucionare e jetës sonë zgjon shpejt interesat e tyre për jetën politike dhe veprimtarinë shoqërore, nxit pavarësinë e mendimit të tyre dhe dëshirën për të qenë të dobishëm për shoqërinë. Por në krahasim me të kaluarën, tani fëmijët tanë futen diçka më vonë në punën prodhuese dhe në jetën e pavarur praktike, qëndrojnë më shumë në shkollë. Nga një pikëpamje kjo është pozitive, pasi ata mësojnë dhe edukohen më gjatë. Por kjo kohë duhet shoqëruar me pjesëmarrje më aktive të tyre në të gjitha sferat e jetës shoqërore-politike, ideologjike, prodhuese etj., me kalitjen dhe me rrahjen e tyre në shkollën e jetës. Dhe pikërisht këtu ndeshemi me pengesat që i nxirren brezit të ri për t'u kalitur në shkollën dhe në luftën e jetës. Pengesa të tilla janë ndikimet e vjetra të edukatës familjare konserva-

tore e patriarkale, të pedagogjisë së vjetër zyrtare, si dhe të burokratizmit e të formalizmit të punës së shkollave dhe të organizatave të rinisë e të pionierit me fëmijët.

Këto pengesa dhe ndikime të huaja kanë shfaqje të shumta në jetën e përditshme. Ka te ne akoma mjaft mësues dhe edukatorë që harrojnë se kalamajtë kanë nevojë edhe të luajnë, të kërcejnë, se duke luajtur ata edhe mund të çirren, të nduken, të zihen pa të keq me njëri-tjetrin. Në qoftë se ndonjë nxënës i thotë diçka shokut të vet të bankës, ose lëviz pak gjatë orës së mësimit, edukatorë të tillë e marrin atë me sy të keq dhe fillojnë ta trajtojnë si prishës të qetësisë. Kurse, çka është akoma më keq, po ta shikojnë ndonjë fëmijë që zihet pa të keq me shokun në oborrin e shkollës ose në rrugë, fillojnë ta quajnë krejt padrejtësisht «rrugaç». Edukatorë të tillë mendojnë se që t'i edukosh mirë fëmijët, duhet t'i mbash mbyllur në kuvli, prandaj ata ua ndrydhin kalamajve iniciativën dhe vetëveprimin, vendosin mbi ta një mbikëqyrje pedante.

Por është me të vërtetë për të ardhur keq kur në të tilla pozita bien edhe udhëheqëset e pionierëve. Ka prej tyre që synojnë të jenë me çdo kusht të pranishme fizikisht në çdo aktivitet të fëmijëve, t'u mbajnë atyre biseda pedagogjike moralizuese e të mërzitshme, ta zhvillojnë çdo aktivitet ose lojë të tyre duke i vënë në rresht dhe duke i organizuar në mënyrë ushtarake. Veprime të tilla shpesh çojnë në atë që shkolla u duket kalamajve si kazermë në kuptimin e keq të kësaj fjale.

Po të bisedosh me edukatorë të tillë për këto qëndrime që mbajnë, ata mund t'i referohen edhe pedagogjisë. Por kjo është një pedagogji e vjetër, zyrtare

dhe pedante, që ka për qëllim t'i bëjë «zap» dhe «sus» fëmijët. Në të vërtetë këtu kemi të bëjmë me veprime antipedagogjike, që e ndrydhnin personalitetin e fëmijës, që e futin edukatorin në një konflikt të panevojshëm me të.

Kurse ne duhet të krijojmë pedagogjinë tonë revolucionare marksiste-leniniste. Në bazë të kësaj pedagogjie edukatorët tanë duhet të punojnë që edhe bisedat, lodrat dhe aktivitetet e ndryshme me kalamajtë të kryhen në mënyrë të natyrshme e të lirshme, me qëllim që të zhvillohen te fëmijët ndjenja e unitetit, dashuria për shoku-shokun, hovi, guximi, vetëveprimi etj. Pikërisht në këtë rrugë do të shpërthejnë ku duhet edhe energjitë e fëmijëve, do të shmangen ata nga pjesëmarrja në aktivitete të padëshiruara, do të nxiten për pjesëmarrje në aktivitete të dobishme, si për edukimin e tyre ashtu edhe për shoqërinë.

Duke nxitur me të gjitha forcat iniciativën dhe vetëveprimin e fëmijëve, nuk do të thotë aspak që çështja e edukimit të tyre përgjithësisht, dhe sidomos në kohën e lirë pas mësimit, duhet t'i lihet spontaneitetit, pasi në këtë mënyrë do të ushqehet indiferentizmi, i cili, edhe kështu, është një tendencë mjaft e përhapur, si te disa mësues dhe edukatorë, e aq më tepër në shumë prindër dhe përgjithësisht në opinionin tonë shoqëror.

Përmirësimi i punës për mirërritjen dhe për edukimin e fëmijëve është i lidhur edhe me shfrytëzimin më të mirë të bazës së gjerë materiale që kemi krijuar për këtë qëllim. Partia dhe Qeveria do të marrin masa që kjo bazë materiale në të ardhmen, gradualisht dhe

brenda mundësive tona, të vijë gjithnjë duke u zgjeruar e duke u pasuruar. Por nuk është e drejtë të kërkohet që vetëm shteti të zgjidhë tërë problemet e mirërritjes dhe të edukimit të fëmijëve, që nga foshnjat e deri te pionierët. Për zgjidhjen e këtyre çështjeve, krahas punës së shtetit, duhet të bashkohen e të kontribuojnë forcat e tërë shoqërisë: prindërit e fëmijëve, uzinat e ndërmarrjet si kolektiva punonjës, kooperativat bujqësore, të gjitha organizatat shoqërore dhe institucionet e ndryshme. Dhe ky kontribut nuk duhet të jetë me fjalë, në mënyrë akademike, por të ndihmojë në mënyrë praktike në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme konkrete. Ta shikojmë, për shembull, në këtë prizëm çështjen e terreneve, të shesheve dhe të ambienteve për lodra dhe aktivitete sportive për fëmijët. Nuk është e drejtë vetëm të kërkohet të kemi terrene të tilla të ndërtuara posaçërisht nga shteti (megjithëse edhe të tilla kemi e do të kemi gjithnjë e më shumë) në një kohë kur nuk mirëmbahen, nuk sistemojnë e nuk shfrytëzohen terrenet e shumta që ndodhen brenda lagjeve dhe oborreve të shtëpive në qytetin e Tiranës, kur nuk ka interesim për t'i mësuar dhe për t'i organizuar fëmijët që ta kalojnë kohën e lirë në mënyrë të frytshme pranë këtyre terreneve.

Të gjitha këto orientime praktike, së bashku me preokupacionin e madh ideologjik për edukimin e fëmijëve, janë kushti themelor për ta çuar përpara punën tonë në këtë fushë, për t'i shfrytëzuar më mirë mundësitë që kemi, për të krijuar çdo ditë mundësi të reja, për t'i dhënë një hov të mëtejshëm interesimit të mbarë shoqërisë për këtë problem me rëndësi jetike.

IV

SITUATA NË BOTË ZHVILLOHET
NË FAVOR TË REVOLUCIONIT DHE NË DËM
TË IMPERIALISTO-REVIZIONISTËVE

Së fundi dëshiroj të prek edhe disa çështje për gjendjen ndërkombëtare.

Sot dy fuqitë e mëdha imperialiste, ajo amerikane dhe ajo revizioniste sovjetike, kanë ndarë zonat e tyre të influencës, sido që këto nuk janë dhe nuk mund të jenë as të përcaktuara me përpikëri dhe as të qëndrueshme, për shkak të kontradiktave dhe të mosmarrëveshjeve midis tyre, për shkak të kontradiktave brendapërbrenda shteteve të ndryshme të çdo zone dhe të kundërshtimeve ndaj fuqive imperialiste përkatëse më të mëdha, për shkak të kontradiktave të forcave të ndryshme kapitaliste brenda çdo shteti kapitalist e revizionist dhe, më në fund, të kontradiktave të thella e të pazgjdhshme midis kapitalit dhe proletariatit, midis kapitalistëve e borgjezisë, nga njëra anë, dhe popullit punonjës, nga ana tjetër.

Imperializmi amerikan, fuqia më e madhe kapitaliste, për të arritur hegjemoninë e tij botërore, është i detyruar të bëjë sforco të mëdha në drejtim të shtimit gjithnjë e më të madh të shpenzimeve kolosale ushtarake, që janë të domosdoshme për sundim, për mbrojtje dhe për luftërat agresive. Imperializmit amerikan i duhet njëkohësisht të përballojë një zhvillim ekonomik të atillë që i sjell fitime, por njëkohësisht

edhe humbje, pasi nga aleatët e tij i kërkohej investime të mëdha, që drejtpërdrejt apo tërthorazi, e dobësojnë ekonominë amerikane, shtojnë konkurrencën kundër saj në tregjet botërore kapitaliste, dobësojnë hegjemoninë amerikane. Të gjitha këto shkaktojnë kriza të rënda ekonomike, kriza të dollarit, të sterlinës, të frangut dhe, si rrjedhim, edhe në fondet monetare të të gjitha shteteve të tjera kapitaliste; shkaktojnë krizën e papunësisë dhe të uljes së nivelit të jetesës së popullsisë, shkaktojnë lëkundje të mëdha dhe puçe në sistemet e tyre shtetërore, lëkundin aleancat politike dhe ushtarake, i dobësojnë këto deri në atë shkallë sa që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për shembull, lihen në baltë të luftojnë vetëm në Vietnam, të financojnë vetë luftën agresive të Izraelit kundër popujve arabë, të pranojnë, në pamundësi të bëjnë ndryshe, që Franca e Dë Golit të tërhiqet nga impenjimet ushtarake të NATO-s dhe të lërë jashtë Tregut të përbashkët Anglinë dhe, tërthorazi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj.

Kapitalistët e zonave të ndryshme, ata të dollarit, të sterlinës, të markës, të frangut, ndodhen në përleshje njëri me tjetrin për shkëputje nga varësia e dollarit, për sa më shumë shkëputje politike, mundësisht edhe ushtarake, sidomos nga tutela tiranike e Pentagonit dhe nga rëndimi i barrës së shpenzimeve ushtarake.

Imperializmi amerikan dhe gjithë partnerët e tij po kalojnë, pra, nëpër një krizë të madhe politike, ekonomike e ushtarake që do të thellohet gjithnjë e më tej.

Në këto kushte imperializmi amerikan është i detyruar të hyjë në ujdë dhe të lidhet në aleancë edhe me imperializmin e ri, me revizionizmin modern sovjetik, i cili, nga ana e tij, synon, gjithashtu, sundimin e botës. Por degjenerimi i Bashkimit Sovjetik dhe i satelitëve të tij në vende kapitaliste zgjeroi sferat e bashkëpunimit kapitalist në të gjitha fushat, jo vetëm ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, por edhe ndërmjet partnerëve kapitalistë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me Bashkimin Sovjetik dhe me satelitët e tij revizionistë të zonës së rublës. U shtua, pra, një element tjetër i madh i konkurrencës kapitaliste botërore, një element tjetër krizash e tensionesh politike për të gjitha palët ndërluftuese, në gjirin e të cilave, edhe pa këtë faktor të ri, veprojnë shumë të acaruara kontradiktat antagonistë që i gërryejnë e i kalbëzojnë.

Bashkimi Sovjetik, si fuqi e madhe revizioniste-imperialiste, dhe tok me të edhe partnerët e tij, kanë hyrë në një krizë aq të rëndë politike, ideologjike dhe ekonomike sa s'dalin dot dhe është e pamundur të dalin nga thonjtë e saj. Shndërrimi i Bashkimit Sovjetik nga një vend socialist në një vend kapitalist e ka futur atë në një kaos të vërtetë. Satelitët e tij revizionistë janë po ashtu në krizë të rëndë. Ata nuk kënaqen nga lëmoshat e aleatit të madh që më shumë u merr sesa u jep dhe kërkojnë rrugë të reja daljeje, ndërtojnë ura të reja me shtetet kapitaliste. Kjo është e natyreshme, por e papëlqyeshme dhe e papranueshme për hegjemonistët sovjetikë, të cilët në këto kushte forcojnë sundimin ushtarak mbi satelitët, gjoja për të

mbrojtur socializmin, por, në realitet, për të ruajtur hegjemoninë e tyre.

Imperializmi revizionist sovjetik lufton të zgjerojë sferën e influencës në botë dhe sundimin e vet mbi popujt dhe mbi shtetet e kontinenteve të ndryshme. Por kjo bëhet me sakrifica të mëdha, që e dobësojnë fuqinë e tij, pasi asgjë nuk është e sigurt për të. Revizionistët sovjetikë përpiqen të ngulin thonjtë mbi vende e popuj të tjerë në një epokë kur revolucioni botëror është në ngjitime, kur popujt zhvillojnë nga të katër anët luftën e tyre çlirimtare, kur në botën kapitaliste ata ndeshen me një konkurrent të fuqishëm dhe agresiv siç është aleati i tyre, imperializmi amerikan, dhe kur vetë imperializmi revizionist sovjetik është i minuar nga brenda dhe i pafuqishëm për të krijuar imperatorinë e vet botërore. Për këtë revizionistët sovjetikë po ndjekin po atë rrugë që kanë ndjekur dikur imperialistët e vjetër në kohë më të favorshme për ta. Ata përdorin gënjeshttrat, shantazhet, kërcënimet, demagogjinë, kreditë dhe investimet me karakter shfrytëzimi kapitalist, traktatet dhe marrëveshjet robëruese. Ata përdorin pushtimin ushtarak, siç është rasti i Çekoslovakisë, krijimin e bazave ushtarake në vende të ndryshme që t'i shërbejnë sundimit të tyre imperialist dhe mbrojtjes së imperatorisë revizioniste, për sulme e luftëra agresive dhe për shfrytëzimin kolonialist të vendeve ku ata arrijnë të vendosin këto baza. Kolonitë e reja sovjetike duhet t'u shërbejnë revizionistëve sovjetikë për të furnizuar metropolin e tyre që është futur në një krizë të thellë e të pandreqshme bujqësore e industriale, me një fjalë, për

të thithur andej gjakun dhe djersën e popujve të tjerë, për të ushqyer dhe për të majmur borgjezinë e re sovjetike, ashtu siç bënin dhe siç vazhdojnë të bëjnë imperialistët e tjerë.

Ç'konkluzione mund të nxjerrim nga kjo pasqyrë e shkurtër e gjendjes së sotme ndërkombëtare?

Kur Partia jonë thotë se revolucionin botëror është në ngjitje dhe situata në botë paraqitet e zhvillohet në favor të revolucionit dhe në dëm të imperialisto-revizionistëve, këtë ajo e thotë në bazë të analizës reale marksiste-leniniste të zhvillimit të ngjarjeve në botë.

Imperializmi, me atë amerikan në krye, dhe revizionizmi modern, me atë sovjetik në krye, përfaqësojnë reaksionin më të zi. Ata përgatitin dhe zhvillojnë luftëra të ndryshme grabitqare për të mbajtur popujt nën robërinë e tyre, për të shuar luftërat çlirimtare të popujve, për të shtypur revolucionin proletar botëror.

Të dyja këto fuqi të mëdha imperialiste botërore dhe satelitët e tyre janë armiq të betuar të komunizmit, të ideologjisë së klasës punëtore, të marksizëm-leninizmit. Ato mbrojnë regjimet shtypëse, pseudodemokratike, luftojnë me të gjitha mjetet kundër triumfit të diktaturës së proletariatit, që është varrmihësi i tyre.

Shfrytëzimi i egër kapitalist imperialisto-revizionist që u bëhet popujve, pavarësisht nga format dhe nga metodat që përdorin shfrytëzuesit, pavarësisht nga veshjet ideologjike të këtyre formave dhe të metodave të shtypjes e të shfrytëzimit, ngjall kudo një rezistencë të madhe dhe në forma të ndryshme, pasive, aktive dhe luftë të hapët nga ana e popujve. Shfrytëzimi ka-

pitalist është bërë tani i padurueshëm për popujt, të cilët luftojnë me vendosmëri dhe me çdo mjet për ta hequr qafe. Kjo situatë pasqyrohet në dinamizmin revolucionar të zhvillimit të ngjarjeve botërore. Bota nuk është e qetë, ajo zien. Qetësinë, statukuonë, e dëshirojnë imperialisto-revizionistët, kurse popujt, revolucionarët, janë kundër qetësisë së gënjeshtërt, kundër statukuosë imperialisto-revizioniste, janë për përmbysjen e tyre. Këtu ekziston antagonizmi i papajtueshëm ndërmjet imperialisto-revizionistëve, nga njëra anë, dhe popujve, nga ana tjetër. Kjo është lufta e ashpër klasore në platformë kombëtare dhe ndërkombëtare që frymëzon dhe udhëheq luftërat çlirimtare dhe revolucionin proletar kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në esencën e aleancave të ndryshme midis kapitalistëve të ndryshëm, midis imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë, si dhe midis vetë shteteve revizioniste, filli i kuq që i përshkon të gjitha këto aleanca kundërrivolucionare është lufta kundër popujve, shtypja e rezistencës së tyre, frenimi i të drejtave të ligjshme dhe shfrytëzimi i tyre ekonomik deri në palcë. Aleancat e tyre synojnë edhe përcaktimin e zonave të influencës, por këto nuk përjashtojnë goditjet e kundërgoditjet me njëri-tjetrin kur kontradiktat në mes tyre arrijnë kulmin, kur ato nuk mund të zgjidhen ndryshe veçse nëpërmjet konflikteve me armë, që përbëjnë luftërat lokale dhe botërore grabitqare për rindarjen e re të zonave të influencës.

I gjithë ky sistem aleancash nuk mund të jetë as i qëndrueshëm, as i fortë, sepse ai përmban në vetvete përçarjen, grindjet, kontradiktat e papajtueshme që

nuk e lejojnë kurrsesi të veprojnë në harmoni, në unitet. Sistemi kapitalist, prona kapitaliste, nuk e lejojnë një gjë të tillë, sepse ajo sjell kalbëzimin e sistemit. Nga ana tjetër, këtë sistem të kalbur që po jep shpirt, po e godit pareshtur vala revolucionare e popujve, e cila shkëput një nga një hallkat e tij të dobëta, derisa ta shfarosë përgjithmonë.

Aleanca sovjeta-amerikane sundon aktualisht skenën botërore kapitalisto-revizioniste. Ç'i shtyn të bashkohen dy fuqitë e mëdha imperialiste botërore që synojnë, si njëra dhe tjetra, të sundojnë mbi popujt dhe të kenë të njëjtat qëllime grabitqare, me gjithë kontradiktat e shumta midis tyre? Cila është ajo forcë, më e fuqishme se arsenalet e tyre atomike, se buxhetet kolosale të luftës, se sistemet e tyre politiko-shoqërore, që si njëra dhe tjetra i trumbetojnë nga «më demokratiket e më përparimtare», që i ka shqetësuar këto kaq shumë sa që u ka prishur gjumin?

Kjo forcë kolosale janë popujt e ngritur në luftë dhe në revolucion, është revolucioni proletar që ngrihet me furi kundër tyre, është «fantazma e komunizmit» që është bërë tani një realitet i madh. Baza e aleancës sovjeta-amerikane është lufta e përbashkët kundër socializmit, kundër komunizmit, kundër marksizëm-leninizmit.

Këto dy shtete imperialiste, duke ndarë sferat e influencës ndërmjet tyre, kërcënojnë botën me të gjitha llojet e armëve që disponojnë, gjer me bombat e me predhat atomike. Ato janë bashkuar për të shtypur luftërat çlirimtare, për të shtypur revolucionin proletar që i kërcënon për vdekje. Në aleancë me njëri-tjetrin

po veprojnë aktivisht kudo ku popujt luftojnë për lirinë e tyre, në Vietnam dhe në ishujt e Karaibeve, në Amerikën Latine, në Afrikë, në Azi, në gjirin e vetë aleatëve të tyre, si në NATO ashtu edhe në Traktatin e Varshavës. Kjo veprimtari komplekse dhe e koordinuar e imperialistëve amerikanë dhe e revizionistëve sovjetikë, me armë dhe me propagandë demagogjike pacifiste, duket sikur nuk është e koordinuar, duket bile sikur kanë kontradikta të thella me njëri-tjetrin. Ky është një mirazh, i cili duhet demaskuar vazhdimisht. Pavarësisht se në veprimet sovjeto-amerikane ka kontradikta të mëdha, të cilat do të thellohen e do të acarohen dhe mund të degjenerojnë deri në konflikte të armatosura ndërmjet tyre, eventualitet ky i papërgjash-tuar në mes kapitalistëve, qëllimi kryesor dhe vendimtar i tyre është i njëjtë, i palëvizshëm.

Diplomacia amerikano-sovjetike ka arritur në konkluzionin se të dyja palët veç e veç janë në gjendje «të sundojnë dhe të mbajnë mirë në fre aleatët e tyre përkatës në aleancat famëkeqe të NATO-s, të Varshavës etj.», dhe të dyja së bashku të udhëheqin luftën kundër socializmit, kundër komunizmit dhe ideve ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit. Por një llogari e tillë nuk mund të jetë veçse e gabuar.

Krizat ekonomike e politike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vendet kapitaliste të Evropës, në Çekoslovakia dhe brenda në vetë Bashkimin Sovjetik, revoltat e popujve dhe të studentëve në Evropë, në Azi, në Amerikën Latine, gjendja e luftës në Lindjen e Mesme, synimet e hapëta dhe kërcënuese të revan-shistëve të Bonit, grushtet e shtetit fashist në Greqi

dhe gjetkë tregojnë sa të gabuara, sa jetëshkurtra janë llogaritë e imperializmit amerikan dhe të aleatëve të tij, revizionistëve sovjetikë.

Krizat e mëdha në gjirin e imperialistëve të ndryshëm, kontradiktat, çarjet e thella në gjirin e borgjezisë së vendeve kapitaliste dhe revizioniste, armatosja dhe përgatitja e tyre për luftëra të reja grabitqare tregojnë pikërisht atë që idetë e marksizëm-leninizmit po sqarojnë dhe frymëzojnë proletariatin botëror dhe masat punonjëse në rrugën drejt revolucionit. Kjo tregon se proletariati botëror dhe masat punonjëse çdo ditë e më shumë dallojnë gënjeshtrenë e pseudodemokracisë borgjeze, falsitetin e votës dhe të parlamentarizmit borgjez e revizionist, falsitetin e «bashkekzistencës paqësore» dhe të pacifizmit borgjez. Proletariati botëror dhe punonjësit nga eksperiencia e jetës po bëhen çdo ditë e më të ndërgjegjshëm se bota kapitaliste dhe bota që predikojnë socialdemokratët e revizionistët modernë, duhet shkallmuar me anën e dhunës revolucionare, me violencën e armëve. Dhe pikërisht pse po ngrihet kjo valë e madhe në asistojmë sot në kriza të mëdha të botës kapitalisto-revizioniste, në përgatitjen e luftës nga ana e tyre, në shtypjen e grevave dhe të luftërave nacionalçlirimtare, në çarjen e partive borgjeze, në krijimin e korrenteve policentriste në gjirin e revizionistëve modernë në përgjithësi dhe në fraksione përçarëse në gjirin e çdo partie revizioniste në veçanti.

Kuptohet se ky kalbëzim që po thellohet në gjirin e frontit imperialisto-revizionist do të degjenerojë në katastrofë për ta dhe në fitore për revolucionin proletar. Mbulesa e tyre duket e blinduar, por ajo është prej

kartoni, pse brenda karapasës zien revolucioni, i cili ka shpërthyer dhe do të shpërthejë pareshtur në të gjitha hallkat e dobëta të saj.

Të gjitha planet djallëzore të imperialistëve e të revizionistëve do të shkatërrohen njëri pas tjetrit prej popujve revolucionarë të botës që sot, nën udhëheqjen e partive komuniste (marksiste-leniniste), nën udhëheqjen e patriotëve revolucionarë, janë ngritur në luftë dhe nga ata që vazhdimisht njëri pas tjetrit e të gjithë së bashku do të ngrihen në luftë dhe në revolucion.

Rigrupimi i komunistëve revolucionarë në partitë e reja marksiste-leniniste përbën një shkëputje të hapët nga revizionizmi modern dhe nga partitë e vjetra komuniste e punëtore që tradhtuan marksizëm-leninizmin. Kjo është pasqyrë e një gjendjeje të re revolucionare në gjirin e klasës punëtore ndërkombëtare, e cila po çahet dhe njëkohësisht po rigrumbullohet. Në gjirin e saj po konsolidohet pjesa e ndërgjegjshme dhe revolucionare e proletariatit për të zhvilluar luftën e pararojës kundër socialistëve, socialdemokratëve dhe revizionistëve modernë, që kanë akoma pozita mjaft të forta, veçanërisht në shtresat e aristokracisë punëtore që gënjejnë masën e punëtorëve.

Lufta do të vazhdojë e gjatë, por pjesa e ndërgjegjshme revolucionare e proletariatit botëror, nën udhëheqjen e partive të reja komuniste marksiste-leniniste, duhet t'u bëjë ballë energjikisht e në mënyrë të organizuar sulmeve të borgjezisë së organizuar dhe të armatosur, si dhe gjithë lakenjve të saj, socialdemokratëve dhe revizionistëve modernë.

Ideja e madhe e revolucionit proletar dhe e vendosjes së diktaturës së proletariatit ndjek rrugën e saj të pandalshme. Atë e vërteton jo vetëm kalbëzimi i borgjezisë imperialiste, por edhe tradhtia e revizionistëve modernë, me ata sovjetikë në krye, këtë e tregon fakti se për t'ia penguar rrugën revolucionit të pandalshëm, revizionistët përpiqen të gjejnë forma të reja lufte, të vënë maska të reja, të përdorin forma të reja organizimi dhe mashtrimi.

Borgjezia imperialiste dhe partitë e saj, me maska dhe me etiketa të ndryshme, që nga ato socialistet deri tek etiketat anarkiste, me zjarr dhe me ideologji, u përpoqën dikur të shuanin revolucionin në botë dhe, veçanërisht, në Rusi. Por më kot. Ata nuk mundën. Edhe tani, megjithëse revizionistët sovjetikë e të tjerë, që janë ose nuk janë në fuqi, përpiqen të shuajnë revolucionin proletar që ngjitet, ata do të dështojnë.

Neve na forcohen besimi dhe vendosmëria në fitoren e revolucionit proletar botëror dhe gëzohemi kur shohim të formohen e të konsolidohen kudo partitë e reja komuniste marksiste-leniniste. Është një eksperiencë e madhe që fitojmë ne nga eksperiencia e përbashkët e të gjitha partive komuniste marksiste-leniniste, të mëdha dhe të vogla, të vjetra dhe të reja në moshë. Ne mësojmë shumë kur shohim se marksistët revolucionarë në botë, duke ruajtur si sytë e ballit pas-tërtinë e teorisë sonë marksiste-leniniste, ndjekin në çdo vend, në mënyrën e tyre, me forma dhe metoda të tyre, luftën kundër imperializmit, borgjezisë, socialdemokratëve, nacionalshovinistëve dhe revizionistëve modernë, të cilët mbulojnë fytyrën e tyre me shumë forma

e me shumë maska. Uniteti i madh marksist-leninist midis partive revolucionare marksiste-leniniste po kalitet në luftë e në revolucion. Pikërisht këtë unitet kapitalizmi dhe revizionizmi modern synojnë ta çajnë dhe ta shkatërrojnë. Por më kot. Revolucioni nuk mund të ndalet dhe uniteti marksist-leninist në revolucion nuk mund të thyhet. Revolucioni është uniteti, kundër-revolucioni është shpartallimi. Se Partia jonë e Punës i qëndron besnike marksizëm-leninizmit, se punon e lufton për revolucionin dhe për unitetin marksist-leninist, prandaj dhe luftohet me të gjitha mjetet e mundshme nga kapitalizmi, nga imperializmi dhe nga revizionizmi modern. Këta s'lënë gjë pa na sharë. Ne kjo na gëzon dhe u themi: Le të vazhdojnë. Malet tona më të larta!

Armiqtë tanë revizionistë që na luftojnë nuk kanë dhe kurrë nuk mund të kenë unitet. Uniteti që gjoja ekziston në kampin revizionist është vetëm formal. Nuk mund të ketë unitet në kushtet e degjenerimit politik dhe ideologjik të klikave që sundojnë në këto vende që quhen socialiste, por që në fakt janë kthyer në vende kapitaliste. Interesat e tyre të pronës kapitaliste i përçajnë ato. Mbi këto baza lidhjet e tyre janë të përkohshme dhe nuk kanë të bëjnë aspak me unitetin marksist-leninist.

Klikat revizioniste në fuqi flasin për lidhje të ngushta në mes tyre dhe na akuzojnë ne si prishës të unitetit marksist-leninist. Por në realitetin e gjërave ato demaskohen para masave të vendeve të tyre, të cilat shohin se uniteti për të cilin flasin revizionistët është i rremë, është në baza kapitaliste. Këto masa li-

dhen në unitet të vërtetë me ne sepse shohin që rruga jonë është e vetmja rrugë e drejtë dhe në baza marksiste-leniniste. S'janë format që na lidhin ne me masat qindramilionëshe kudo në botë, por politika jonë, ideologjia dhe drejtësia jonë. Revizionistët, duke na luftuar ne, krijojnë dhe thellojnë akoma më shumë përçarjen në kampin e tyre. Kurse ne, nga ana jonë, jemi të bashkuar, pra më të fortë, sepse me ne janë proletarët e të gjithë botës.

Fakt është se revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, ishin më të fuqishëm në ekonomi, në organizim, në propagandë, por fakt është, gjithashtu, se ata jo vetëm nuk na thyen dot, nuk na mundën, por jemi ne që i demaskuam keqas e i dobësuam ata. Dhe sa më e furishme vazhdon kundër tyre lufta jonë parimore, sa më shumë përpiqen ata të na luftojnë, aq më tepër koalicioni i tyre çorganizohet, shembet, linden divergjencia të reja e më të mëdha në kampin e tyre, të cilat i minojnë, kurse luftën tonë të drejtë kundër tyre e fuqizojnë.

Revizionistët modernë propagandojnë kundër nesh duke thënë se «qëndrimet tona janë aventurë, janë në kundërshtim me interesat e popullit shqiptar, se ato s'kanë lidhje fare me marksizëm-leninizmin». Atëherë ne pyesim: Përse ky shqetësim kaq i madh nga ana e tyre për «një parti dhe për një vend kaq të vogël», pse këto të qara për një «çështje të fituar me kohë» prej tyre?

Por puna nuk qëndron si thonë ata. Qëndrimet tona janë plotësisht marksiste-leniniste. Ato janë të rrezikshme vetëm për ta, pasi i demaskojnë keq në sytë e komunistëve të të gjithë botës, të cilët po fitojnë

ndërgjegjen e klasës, forcojnë luftën klasore, bashkohen çdo ditë e më ngushtë me ne dhe, së bashku, sulmojmë kalanë e tronditur të revizionizmit modern. Pra, «as madhështia» e tyre, as madhësia e tyre territoriale, as forca e madhe e tyre ekonomike, ushtarake dhe propagandistike nuk mund t'i përballojnë dot forcën tonë të pamposhtur revolucionare, vendosmërinë dhe sulmet tona therëse dhe shkatërruese.

Lufta e lavdishme e Partisë sonë dhe e popullit shqiptar kundër imperializmit, revizionizmit modern dhe gjithë borgjezisë reaksionare nuk bëhet pa sakrifica të mëdha, por ne këto sakrifica i kemi marrë parasysh. Pikërisht për luftën tonë të drejtë dhe të përpikur që bëjmë në interes të revolucionit e të përparimit dhe pikërisht se këtë luftë ne e bëjmë pa marrë parasysh asnjë sakrificë, punëtorët dhe njerëzit përparimtarë të të gjithë botës na simpatizojnë, na duan dhe na respektojnë. Këtu qëndron forca e Partisë dhe e popullit tonë, këtë asnjë forcë e reaksionit nuk mund ta shtypë dot dhe as ta errësojë.

Për arsye se Partia jonë përfaqëson atë forcë revolucionare që bashkon dhe kalit unitetin internacionalist të proletariatit dhe të komunistëve revolucionarë, ajo luftohet me tërbim nga revizionistët modernë. Këta nuk e nënvleftësojnë dot luftën kundër nesh (pavarësisht se ne, siç thonë ata, jemi një «parti e vogël» dhe për këtë në dukje na përbuzin), pasi ne përfaqësojmë dhe luftojmë për një ide të madhe.

Propaganda jonë aktive në botë, duke vënë në dukje rrugën tonë revolucionare marksiste-leniniste në ndërtimin e socializmit në Shqipëri dhe politika jonë

ndërkombëtare kanë ngjallur simpati të madhe jo vetëm në proletariatin botëror, por edhe në borgjezinë e vogël të vendeve kapitaliste, e cila është, gjithashtu, e shtypur dhe e shfrytëzuar nga monopolet e mëdha dhe nga shtetet kapitaliste. Prandaj na vihet si detyrë ta shtojmë dhe ta perfeksionojmë gjithnjë e më mirë propagandën tonë revolucionare.

Duke ndjekur politikën tonë të drejtë dhe të përkulur, si brenda ashtu edhe në arenën ndërkombëtare, ne nuk duhet për asnjë çast të mendojmë se i kemi arritur të gjithë objektivat dhe ta flemë mendjen se armiqtë tanë të shumtë nuk do të na goditin. Ata po armatosen orë e çast. Prandaj detyra jonë kryesore është forcimi i vazhdueshëm i mbrojtjes, forcimi i vigjilencës, që të jemi kurdoherë gati për versionin më të rëndë që mund të na imponojnë armiqtë.

Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë që e udhëheq kanë vendosur e janë gati të shuhen, por kurrë të mos dorëzohen përpara armikut, prandaj ata do të fitojnë. Këtu qëndron kyçi i të gjitha fitoreve. Kjo nuk është vetëm një faktor historik për popullin dhe për Partinë tonë, por është po aq edhe një faktor i vërtetë vendimtar i fitoreve të tyre.

Ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë, të armatosur, ta forcojmë atdheun nga çdo pikëpamje dhe ta mbrojmë atë derisa imperializmi dhe revizionizmi modern të mposhten nga marksizëm-leninizmi e nga revolucionari. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm se duhet të luftojmë kundër armiqve të panumërt dhe të fortë. Duhet të qëndrojmë të patundur, të mos frikësohemi. Çdo rreziku, çdo sakrifice t'i bëjmë ballë. Kurdoherë të ke-

mi besim në forcat tona, në vijën tonë, në drejtësinë e saj. Ne duhet ta mbrojmë me të gjitha forcat tona atdheun nga imperialistët dhe nga revizionistët, ta mbrojmë atë me çdo kusht dhe, gjithashtu, me çdo kusht të fitojmë mbi çdo agresor. Ne, duke mbrojtur atdheun tonë të dashur socialist, mbrojmë njëkohësisht revolucionin botëror dhe socializmin.

Shokë dhe shoqe,

Viti që po mbyllet shënoi për atdheun tonë suksese të rëndësishme si në ekonomi ashtu edhe në arsim e në kulturë. U arritën rezultate të shumta dhe të kënaqshme në industri, në bujqësi, në shkolla, në elektrifikimin e vendit, në ndërtimin e fabrikave, të kombinateve, të hidrocentraleve, të shtëpive të banimit, të shkollave e të spitaleve të reja etj. U arritën, gjithashtu, suksese të mëdha në ndërtimin e rrugëve dhe të hekurudhave të reja.

Ç'vërtetuan të gjitha këto? Ato vërtetuan politikën e drejtë dhe tejpamëse të Partisë, forcën e saj të madhe frymëzuese, lidhjet e saj të çelikta me popullin. Populli ynë i mrekullueshëm, me hov revolucionar të paparë ndonjëherë, me zgjuarsi të rrallë, me heroizëm të papërshkruar dhe me dituri që vazhdimisht e shton, po e bën natën ditë, kapërcen vështirësi të panumërta dhe fiton mbi to.

Ngritja e gjithanshme politiko-ideologjike e të gjitha masave punonjëse, revolucionarizimi i thellë i tyre, bëri që çdo punonjës, kudo ku punon, ta kuptojë

si duhet dhe ta lidhë organikisht detyrën e vet me detyrën e përgjithshme që ka përpara i gjithë atdheu. Secili e ka kuptuar dhe e kupton çdo ditë e më mirë se as puna më e vogël dhe më e thjeshtë nuk mund të jetë e vetmuar dhe e izoluar nga detyrat e ndërtimit të plotë të socializmit. Të gjitha gjymtyrët e trupit të madh të atdheut duhet të ecin, të punojnë, të mendojnë në harmoni, me temp revolucionar. Frymëmarrja e fuqishme dhe e harmonishme e popullit që po edukohet të vërë në ballë interesin e përgjithshëm mbi atë personal, që po mëson organizimin më të mirë të punëve, forcon disiplinën revolucionare në punë, zhvillon dhe zbaton teknikën dhe shkencën e pararojës, që edukohet me vënien e politikës marksiste-leniniste në ballë të çdo gjëje dhe kryen e mat çdo veprim në prizmin e kësaj politike, ka bërë të arrihen suksese të mëdha nga Partia në kalitjen e njeriut të ri, ka bërë të arrihen këto rezultate të rëndësishme dhe të përmirësohet vazhdimisht mirëqenia e popullit. Të mbështetemi në këto rezultate dhe, pa na mbuluar vetëkënaqësia, të vazhdojmë sulmin revolucionar për t'i dhjetëfishuar e për t'i qindfishuar ato në vitet e ardhshme.

Viti jubilar i lavdishëm i 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, viti 1969, po afron. U mbush një çerek shekulli plot heroizma, sakrifica dhe fitore, gjatë të cilit vija e Partisë shkëlqen si drita e diellit dhe socializmi po ndërtohet me sukses në vendin tonë. Shqipëria socialiste u bë e fortë, e respektueshme, e pamposhtur nga çdo armik, goftë i jashtëm apo i brendshëm.

Le të jetë viti 1969 një vit që të shkëlqejë edhe

më shumë, të realizohen e të tejkalohen të gjitha planet, të kapërcehen të gjitha pengesat e vështirësitë, të tejkalohen normat, të tejkalohen rendimentet në bujqësi, të shtohen në kulm iniciativat frytdhënëse të masave, të zhvillohet në shkallë të gjerë mekanizimi dhe organizimi i punës të bëhet më i përsosur. Të mësojnë, të mësojnë dhe vazhdimisht të mësojnë të gjithë njerëzit tanë, të mëdhenj e të vegjël. Revolucionarizimi i vazhdueshm i ndërgjegjes, i mendjes, i punës të ecë kurdoherë pa u ndalur në rrugën e Partisë, pasi kjo do të na i shtojë aq shumë forcat fizike dhe mendore sa që edhe ne vetë do të habitemi nga rezultatet e mëdha që do të arrijmë në të gjitha punët.

I gjithë populli ynë i di detyrat e mëdha të planit të katërt pesëvjeçar që na caktoi Kongresi i 5-të i Partisë. Të gjitha këto detyra ne do t'i realizojmë me sukses. Por Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria kanë menduar e vepruar edhe për ato që do të bëjmë në të ardhmen. Që tani kemi hedhur orientimet e mëdha të planit të pestë pesëvjeçar dhe jo vetëm në kartë. Shumicën e tyre ne e kemi konkretizuar, bile në një mënyrë të atillë që disa nga veprat e pesëvjeçarit të ardhshëm të fillojnë që këtë pesëvjeçar.

Ja, mund t'ju flas për disa, pasi të gjitha do ta kem vështirë t'ju numëroj, kështu që vetëm projekti i planit të pestë pesëvjeçar do t'ju japë idenë e plotë të punimeve dhe të përparimeve madhështore që na presin.

Parashikohet të ndërtohen 30 vepra të rëndësishme, me të cilat do të zhvillohen më tej disa degë të industrisë dhe do të krijohen degë të reja shumë të nevojshme për zhvillimin e ekonomisë sonë popullore.

Një ndër këto vepra industriale të mëdha, bile të një madhësie ndërkombëtare, është kombinati metalurgjik, që parashikohet të ndërtohet në Elbasan, i cili do të përpunojë 800 mijë tonë mineral hekur-nikeli në vit, për të prodhuar rreth 250 mijë tonë çelique të petëzuara me një gamë të gjerë asortimentesh, përveç hekur-nikelit dhe gizës. Ky kombinat do të përbëhet nga një kompleks uzinash e repartesh, nga të cilat uzina e sotme e petëzimit në Elbasan do të jetë ndoshta reparti më i vogël i këtij kombinati gjigant. Sheshi i tij do të zërë rreth 225 hektarë, afro 10 herë më shumë nga sipërfaqja që zënë sot Uzina e Plehrave Azotike dhe Termocentrali i Fierit të marrë së bashku. Ky kombinat modern do të ketë aq makineri e pajisje teknologjike e ndihmëse sa është afërsisht pesha e makinerive dhe e pajisjeve të 25 veprave të planit të tretë pesëvjeçar.

Vepër shumë e madhe e rëndësishme do të jetë, gjithashtu, siç mund ta keni dëgjuar, Hidrocentrali i Fierzës, me kapacitet rreth 400 mijë kilovat, domethënë më e madhe se fuqia e vendosur e të gjitha hidrocentraleve të marra së bashku të ndërtuara në vendin tonë, duke përfshirë edhe atë të Vaut të Dejës. Hidrocentrali i Fierzës do të prodhojë rreth 1 miliard e 700 milionë kilovat-orë energji elektrike në 1 vit, rreth një herë më tepër nga sa do të prodhojë Hidrocentrali i Vaut të Dejës, ose sa dyfishi i energjisë elektrike që prodhohet sot në vendin tonë. Diga e këtij hidrocentrali, 150 metra e lartë, do të jetë në radhët e digave të larta të ndërtuara në botë.

Një kolos tjetër i planit të pestë pesëvjeçar do

të jetë uzina komplekse për përpunimin e thellë të naftës, që do të përpunojë 1 milion ton naftë brut në vit, domethënë afërsisht sa përpunojnë sot të gjitha uzinat tona të rafinimit të naftës. Prodhimet e këtij objekti do të plotësojnë nevojat e vendit me karburante të cilësisë së lartë të standardeve ndërkombëtare. Ky kompleks do të përbëhet nga disa uzina, impiante e reparte. Uzina do të zërë një sipërfaqe prej 100 hektarësh, ose afro 10 herë sa ajo e Uzinës së Plehrave Azotike në Fier, ndërsa pajisjet dhe konstruksionet metalike do të zënë rreth 20 mijë tonë, ose afërsisht sa katërfishi i atyre që janë vendosur në uzinën e plehrave azotike. Pranë këtij kompleksi do të ndërtohet edhe një termocentral me fuqi të vendosur prej rreth 15 mijë kilovatësh.

Vepër e rëndësishme do të jetë edhe uzina që do të prodhojë 6 000 tonë poliklorvinil (PVC) dhe 7 500 tonë sodë kaustike në vit (ose rreth 50 për qind më shumë nga prodhimi i sotëm i Uzinës së Sodës në Vlorë), si dhe prodhime të tjera shumë të dobishme për ekonominë. Kjo uzinë do të plotësojë nevojat në lëndë plastike për Uzinën e Telave të Bakrit në Shkodër, për prodhimin e artikujve të konsumit të gjerë prej plastmazi të fabrikës që është duke u ndërtuar në Durrës, ndërsa një sasi prej disa mijëra tonësh poliklorvinil do të përdoret për prodhimin e artikujve të konsumit të gjerë, të artikujve për ndërtim dhe për prodhim thasësh.

Përveç këtyre, do të dyfishohet prodhimi i plehrave azotike dhe do të zgjerohen uzina e superfosfatit, fabrika e pasurimit të bakrit, fabrika e pasurimit të kromit, uzina e pjesëve të ndërrimit për traktorë, Fa-

brika e Çimentos në Fushë-Krujë, fabrika e pllakave dhe e qyngjeve prej eterniti. Do të ndërtohen, uzina për shkrirjen e bakrit, fabrika e re për pasurimin e bakrit, fabrika për pasurimin e mineralit fosfatik dhe miniera përkatëse, fabrika për prodhimet prej plastmasi, fabrika për pasurimin e asbestit, fabrika për pasurimin e qymyrgurit me aftësi përpunimi prej 450 mijë tonësh në vit, fabrika e pllakave prej fibre me aftësi vjetore prej 5 000 m³, fabrika e letrës me aftësi vjetore prej 7 500 tonësh letër gazete, shtypi dhe vizatimi, kombinati i madh poligrafik.

Gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm do të ndërtohen, gjithashtu, miniera të reja të fuqishme të hekur-nikelit me aftësi nxjerrjeje prej 500 mijë dhe 700 mijë tonësh mineral në vit, Miniera e Qymyrgurit e Valiasit me aftësi nxjerrjeje prej 210 000 tonësh në vit etj. Do të jepen pajisje e mjete për mekanizimin e mëtejshëm të punimeve gjeologjike, të minierave, të ndërtimit, të bujqësisë, do të kryhet zgjerimi i kërkimeve komplekse gjeologjike etj.

Këto janë, siç thashë, vetëm një pjesë e veprave dhe e investimeve që do të bëhen gjatë planit të pestë pesëvjeçar, që do t'i japin një mbështetje të fuqishme materiale teknike zhvillimit të industrisë së lehtë të mallrave të konsumit, si dhe zhvillimit të mekanizimit të bujqësisë, që do t'i ngrejë në një shkallë të lartë rendimentet e prodhimeve bujqësore e blegtorale, do të shtojë të ardhurat e fshatarësisë, do të përmirësohet jeta në fshat e do të ngrihet mirëqenia e gjithë punonjësve, si në qytet ashtu edhe në fshat, do të ngushtohet dallimi në mes fshatit e qytetit.

Kuptohet, pra, rëndësia e madhe e gjithë këtyre veprave kaq shumë të rëndësishme që do të ngremë në pesëvjeçarin që vjen, të cilat do t'i japin një hov të ri të madh ndërtimit socialist të atdheut. Këto na vënë para detyrash të reja të mëdha, realizimi i plotë i të cilave kërkon një mobilizim të gjithanshëm të të gjitha forcave tona.

Prandaj le të mendojmë dhe të punojmë që tani për të realizuar të ardhmen tonë të bukur. Mendoni, shokë dhe shoqe, sa vlerë kolosale ka për ne hovi revolucionar për të realizuar me sukses planin e katërt pesëvjeçar dhe gjithë sa kemi përpara për të bërë. Mendoni sa rëndësi kanë mekanizimi, organizimi i fortë i punës, tejkalimi i normave dhe i rendimenteve, edukimi politik dhe arsimor i njerëzve, kalitja në punë fizike dhe lufta me vështirësitë, vigjilenca revolucionare. Të gjitha këto t'i ngremë çdo ditë e më shumë në një nivel të lartë, pasi beteja të mëdha dhe të lavdishme na presin në të ardhmen e afërt.

I uroj organizatës revolucionare të Partisë të Tiranës suksese të mëtejshme. Punë të mbarë, shokë e shoqe, realizime gjithnjë e më të mëdha!

Rroftë Partia jonë e dashur e Punës, organizatorja e të gjitha fitoreve të popullit tonë!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 306 (6345), 22 dhjetor 1968

Botohet me ndonjë shkurtim sipas librit: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968», f. 447. Tiranë, 1969

BURIMI I PUSHTETIT

Shënime

23 dhjetor 1968

Sipas teorisë sonë marksiste-leniniste pushteti nuk buron nga ligji, qoftë ky i diskutuar dhe i votuar në Kuvendin Popullor, në Sovjetin Suprem, në Sejmin, ose në parlamentet borgjeze. Burimi i vërtetë i pushtetit popullor qëndron në masat e popullit, në veprimet e tyre, në kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë, të vazhdueshëm dhe nga poshtë-lart, në iniciativën e tyre.

Në rendin borgjez administrata, funksionarët, domethënë gjithë aparati burokratik, të udhëhequr nga borgjezia, përbëjnë forcën dhe burimin e pushtetit. Ne, marksistë-leninistët themi se pushteti është i popullit kur buron nga populli. Prandaj njerëzit që punojnë në aparate, dhe këta janë njerëzit tanë, bij dhe bija punëtorësh e fshatarësh, që të mos burokratizohen duhet të zëvendësohen herë pas here, të qarkullojnë dhe të jenë drejtpërdrejt nën pushtetin e popullit, të jenë nën kontrollin e veçantë të tij. Kjo duhet të kuptohet në praktikë, se nëpunësit nuk janë e nuk mund të jenë të palëvizshëm dhe hiqen e zhvishen nga funksionet me kërkesën e masave të popullit.

Po të shikohet problemi i pushtetit, i burimit të tij në këtë prizëm, pra, me sy marksist-leninist, menjëherë dallohet qartë përmbajtja e vërtetë e pushtetit nga forma. Në vendin tonë socialist, ku në fuqi është diktatura e proletariatit, esenca e problemit të pushtetit është kryesorja, kurse në vendet kapitaliste dhe revizioniste, kryesorja është forma dhe esenca e vërtetë e pushtetit është ligji i vendosur nga klasa në fuqi dhe jo pushteti i popullit. Në demokracinë borgjezo-revizioniste rëndësi ka ligji i vendosur dhe i votuar në parlament, ose në Sovjetin Suprem, gjoja nga «instanca demokratike» të zgjedhura nga populli, por në fakt ai është ligj që mbron interesat e diktaturës borgjeze dhe revizioniste. Në këtë rast, as vullneti, as kontrolli i masave s'kanë fuqi mbi ligjin, i cili imponohet nga lart-poshtë, nga diktatura e klasës borgjeze revizioniste dhe nga burokracia e saj që përbëhet nga forca e armatosur e antipopullore dhe nga funksionarët, të cilët janë në shërbim të plotë të borgjezisë e të diktaturës së saj dhe emërohen apo hiqen prej saj kur ia bëjnë ose nuk ia bëjnë detyrën.

Degjenerimi i revizionistëve modernë, që nga titistët deri te revizionistët sovjetikë, duket edhe në qëndrimin e tyre ndaj çështjes së diktaturës dhe të pushtetit të vërtetë popullor. Ata kanë mbajtur, natyrisht, për të gënjer, format e jashtme të praktikës së këtij pushteti, por e kanë zhveshur kryekëput nga brendia marksiste-leniniste; pra, në esencë ata e kanë shndërruar pushtetin në pushtet të klasës së re kapitaliste. Zgjedhjet e këshillave të Sovjetit Suprem, të Sejmit, bile edhe të gjykatave, emërimet dhe shkarkimet e

funksionarëve bëhen gjoja nga populli, ose brenda disa caqeve që në «teori» i quajnë demokratike, por të gjitha janë veprime formale, bëhen vetëm për të ruajtur aparenat gjoja të demokracisë, pse në realitet dhe në esencë, ato janë antidemokratike, antipopullore, janë kundër diktaturës së proletariatit.

E gjithë kjo procedurë synon në eliminimin e rolit të klasës punëtore, të masave punonjëse, në eliminimin e vullnetit e të kontrollit të tyre nga poshtë-lart, nga një anë dhe në forcimin e diktaturës borgjeze shtypëse, nga ana tjetër.

Revizionistët modernë predikojnë rrugën e luftës parlamentare, jo sepse nisen nga përdorimi i saj në disa momente të caktuara koniunkturale për të luftuar dhe për të demaskuar borgjezinë, për të acaruar kontradiktat dhe luftën e klasave, për të arritur në luftën e armatosur dhe për të marrë fuqinë nga ana e proletariatit, por sepse pikëpamjet e tyre politike, ideologjike dhe organizative janë në pajtueshmëri me ato të borgjezisë, sepse qëllimet finale të tyre, pavarësisht nga format dhe nga emërtimet që u vunë këtyre formave, janë një me ato që ka borgjezia.

Prandaj, çështja e sovranitetit të popullit, çështja e kontrollit punëtor, e kontrollit të masave, vija e masave, zbatimi i drejtë dhe i rreptë i luftës kundër burokratizmit, zbatimi i drejtë i normave ndaj nëpunësve, që nga emërimi, nga shkarkimi dhe deri te reduktimi progresiv i rrogave të tyre jo mbi nivelin e rrogave të punonjësve të prodhimit, përcaktimi i ligjeve dhe diskutimi i tyre para se të votohen nga të zgjedhurit, janë parime të mëdha që Partia jonë i mbron dhe do t'i

mbrojë me këmbëngulje, janë parime që Partia jonë i zhvillon dhe do t'i zhvillojë vazhdimisht në dritën e teorisë marksiste-leniniste dhe të eksperiencës së saj të pasur teorike dhe praktike që ka fituar dhe fiton çdo ditë në luftën për ndërtimin e socializmit.

Si marksistë-leninistë të vërtetë duhet të demaskojmë pa pushim revizionistët modernë sovjetikë, titistë e të tjerë, të cilët për t'i shpëtuar vetëdemaskimit përpiqen të ruajnë format e pushtetit revolucionar, që i kanë zhveshur nga përmbajtja revolucionare dhe e kanë zëvendësuar këtë përmbajtje me idetë antirevolucionare, borgjeze.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

REALIZIMI I DETYRAVE TË PLANIT RRIT ENTUZIAZMIN DIHE MOBILIZIMIN E MASAVE

*Fjala e mbylljes në Plenumin e 7-të
të KQ të PPSH¹*

27 dhjetor 1968

Çështjet u shtruan drejt dhe në mënyrë të plotë, si në raport, ashtu dhe në diskutimet e shokëve, vetëm desha të theksoj se plani i vitit 1969, dhe për këtë jemi të gjithë të ndërgjegjshëm, nuk është i lehtë. Për të realizuar këtë plan mjaft të ngjeshur, kërkohet nga të gjithë mobilizim total i forcave, organizim e punë politike sa më e përsosur. Të dyja këto, organizimi dhe puna politike, duhet të shkojnë paralelisht dhe të kombinohen drejt, sepse janë faktorë të domosdoshëm për arritjen e rezultateve që dëshirojmë.

Sukseset e mëdha politike, ideologjike, ekonomike

¹ Plenumi, që i zhvilloi punimet më 26-27 dhjetor 1968, shqyrtoi raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1968 dhe detyrat e projektplanit e të projektbuxhetit të shtetit për vitin 1969» dhe mori vendimin përkatës.

etj., që kemi arritur gjatë këtyre viteve, të frymëzuara dhe të udhëhequra nga Partia, kanë ndihmuar për të mobilizuar masat dhe përbëjnë një bazë të shëndoshë, mbi të cilën duhet të mbështetemi fort për arritje të tjera në të ardhmen.

Entuziazmin e madh dhe frymën e lartë të mobilizimit që janë krijuar kudo në vendin tonë të mos i lëmë të bien. Për këtë qëllim Partia dhe masat tona punonjëse, që kanë tani një eksperiencë shumë të madhe, duke bërë analizën e vazhdueshme të arsyeve të këtij hovi të madh politik, ideologjik dhe të arritjes së sukseseve ekonomike duhet të gjejnë forma të reja të punës politike, ideologjike, organizative e studimore që t'u përshtaten kohëve që do të vijnë, planeve dhe detyrave që kemi përpara, për realizimin e të cilave duhet të mobilizojmë masat.

Si në politikë, ashtu edhe në çdo lëmë tjetër, po t'i lëmë të na fishken format e metodat e punës, në qoftë se në kushte të reja vazhdojmë me të njëjtat metoda dhe forma pune, me atë mënyrë që kemi punuar vjet vazhdojmë të punojmë edhe vitin që vjen, atëherë punën tonë do ta zërë pluhuri. Gjersa shohim që plani i vitit që vjen është i rëndë, i ngjeshur, por i realizueshëm, duhet të mendojmë medoemos për metoda e forma pune të reja në frymën e Partisë e të patriotizmit, forma pune, mobilizimi dhe edukimi më të mira e më të përparuara nga ato që kemi pasur këtë vit. Të mendojmë vazhdimisht për këtë, sepse edhe detyrat që vihen në planin e vitit të ardhshëm, për arsye të një perspektive shumë të madhe që na hapet përpara, janë më të mëdha e më të rëndësishme. Sa

më shpejt e sa më mirë t'i realizojmë planet, aq më shpejt dhe më mirë do të zhvillohet më tej ekonomia, mundësi më të mëdha do të na krijohen për ndërtimin e objekteve të reja të mëdha që kemi përpara.

Realizimi dhe tejkalimi i planit janë nga faktorët vendimtarë për rritjen e entuziazmit të masave të popullit dhe një matës i pagabueshëm i drejtësisë së vijës së Partisë. Kur realizimi i planit sigurohet plotësisht dhe në mënyrë ritmike atëherë masat do të jenë edhe më shumë të entuziazmuara. Ndërsa kur shohim se punonjësit nuk hidhen në sulm me një vrull më të madh, për shkak se në punën drejtuese diçka çalon, ne duhet të na bëjë të mendojmë thellë, të na nxitë ta rishikojmë vazhdimisht veprimtarinë drejtuese të Partisë e të pushtetit në qendër e në bazë, qoftë punën konkrete që duhet bërë në drejtimin e ekonomisë, qoftë atë që duhet bërë në drejtim të punës politike të Partisë. Kjo ka rëndësi të madhe për punën tonë.

Dëshirat e bazës për të ecur sa më shumë përpara në çdo drejtim kanë qenë të mëdha, prandaj edhe kërkesat kanë qenë, gjithashtu, të mëdha. Vërtet s'ka qenë e mundur që t'u jepej përgjigje të gjitha kërkesave të parashtruara, sepse shumë prej tyre ishin jashtë mundësive dhe realitetit tonë, jashtë mundësive tona ekonomike objektive, por nga ana tjetër, këto kërkesa, pavarësisht se nuk u pranuan të gjitha, tregojnë hovin e madh, dëshirën për përparim, perspektivën e qartë dhe forcën e madhe krijuese të masave punonjëse të vendit tonë.

Tani, neve, na vihet detyra që këtë plan kaq të ngjeshur, por të realizueshëm, ta zbërthejmë. Mirëpo

ky zberthim, mendoj unë, nuk mund e nuk duhet të bëhet me një punë thjesht mekanike. Duke pasur parasysh se Partia shtron çështjen që plani të realizohet dhe të tejkalohet, është e domosdoshme që qysh në ditët e para të vitit dhe vazhdimisht, t'i qëndrojmë në krye kësaj pune, të vëzhgojmë, të konsultohemi me masat punonjëse për të përmirësuar metodologjinë e planifikimit, për të futur në këtë metodologji forma e metoda të reja pune gjithnjë më të përshtatshme, për t'i bërë ballë një plani të tillë të ngjeshur jo vetëm në gjerësi, por edhe në thellësi.

Prandaj të gjithë, pa përjashtim, gjatë procesit të punës, duhet të zhdukim nga vetvetja çdo ndjenjë vetëkënaqësie, pse shpesh ndodh që është gjetur një formë ose metodë pune e përshtatshme dhe i qëndrohet asaj skllav vazhdimisht, pa menduar të përsoset më tej në kushte të reja. Për këtë qëllim është mirë dhe e domosdoshme të inkurajojmë edhe iniciativat krijuese të masave. Por këto duhen studiuar me kujdes. Në qoftë se zbatimi i një iniciative kërkon investime, duhet të mendohet edhe për burimet ku do të gjenden këto, pse ne e kemi të qartë që rezervat e Qeverisë nuk janë të mëdha, ato bile do të ishin edhe më të vogla po të mos merreshin masa konkrete për të shtuar planin (dhe u provua se kishte mundësi të plota të shtohet) dhe nga ana tjetër po të mos shkurtoheshin edhe kërkesat e fryra e të tepërta.

Për realizimin e planit të vitit 1969, siç e thashë, do të ketë iniciativa të mëdha. Punonjësve tanë do t'u punojë mendja, ata do të bëjnë propozime e racionalizime të shumta, prandaj për studimin dhe vënien e ty-

re në jetë duhen marrë masat me kohë. Për këtë qëllim të krijohen mundësi investimesh jashtë përcaktimeve që përfshin plani.

Po vallë, ka mundësi ta bëjmë një gjë të tillë? Sigurisht, ka. Së pari, duhet punuar që këto mundësi t'i krijojë vetë baza, duke qenë kurdoherë korrekt me planin, me detyrimet ndaj tij dhe ndaj ekonomisë së përgjithshme; së dyti, të mos u bëhen kërkesa Qeverisë ose ministrive përkatëse jashtë mundësive ekzistuese. Gjatë këtij procesi pune të nxjerrim mirë në pah gjërat e mira dhe të spastrojmë të këqijat që ekzistojnë.

Në këtë kuadër kemi shumë probleme për të studiuar, një nga të cilat ka të bëjë me metodologjinë e planifikimit dhe caktimit të rendimentit e të treguesit për llogaritjen e tij. Duhet t'i rishikojmë me vëmendje të madhe këto çështje që të vihen në rrugën e drejtë, në përshtatje me fazat e zhvillimit tonë ekonomik, të proceseve ekonomike në zhvillim dhe të braktisim format që nuk u përshtaten situatave të reja.

Pra, objekt i një studimi të thellë duhet të bëhen ato probleme, të cilat përfaqësojnë karakteristikat dalluese të punëve tona të mira në zhvillimin e ekonomisë, por edhe disa karakteristika të dobëta të punëve tona, eliminimi i të cilave përbën një rezervë të konsiderueshme që do të na ndihmojë për të realizuar më mirë planet tona. T'i kemi mirë parasysh këto rezerva të brendshme, sepse kështu planin jo vetëm do ta realizojmë, por edhe do ta tejkalojmë.

Për shembull, çështja e përdorimit të mirë të kohës në të gjithë jetën tonë, duke e parë politikisht dhe ideologjikisht, duhet analizuar me kujdes, ndryshe nuk

mund të kuptohet nga punëtorët rëndësia e saj. Të kemi parasysh se jo të tërë punëtorët e kanë të qartë dhe janë të ndërgjegjshëm për këtë problem në atë nivel saqë kohën e punës ta shfrytëzojnë plotësisht dhe në mënyrë racionale. Me këtë dua të them të mos mendojmë se tërë punëtorët janë qelibar. Prandaj ta marrim ashtu siç është këtë çështje, pse ka edhe punëtorë që nuk mbajnë qëndrim të drejtë ndaj punës. E ç'punëtor mund të jetë ai që nuk vepron në frymën e proletariatit? Një punëtor me të tilla qëndrime, hiqet se është punëtor, por në fakt, nuk është formuar ende si i tillë. Prandaj ideologjinë e proletariatit duhet ta shpjegojmë deri në fund dhe jo vetëm për fshatarët dhe inteligjencien, por, në radhë të parë, për vetë punëtorët, të cilët duhet t'i kuptojnë dhe t'i zbatojnë mirë parimet e klasës, të jenë kurdoherë në ballë për të kryer çdo detyrë dhe të shquhen.

Çështja e kuptimit dhe e përdorimit me kriter të kohës, shokë, është e lidhur me jetën tonë, me prodhimin, me punën krijuese. Në qoftë se një punëtor, për shembull, nuk ka kuptim të drejtë ç'do të thotë të lësh punën një orë, gjysmë ore, qoftë edhe një çerek ore, ose orvatet të gënjejë mjekun apo punonjësin e sigurimeve shoqërore etj., për të ndenjur rehat disa ditë më shumë nga sa ia lejon ligji, ai mund ta ketë emrin punëtor, por s'është punëtor në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale. Prandaj disa probleme që shtron Partia, disa orientime me një brendi të rëndësishme ideologjike, duhet t'i detajojmë në teori dhe në praktikë e të mos mbeten si formula në vetvete.

Edhe për disiplinën ka disa formula të veçanta.

Mirëpo disiplina e planit dhe disiplina në punë, më duket mua, nuk janë dy gjëra të huaja për njëra-tjetrën. Disiplina, siç u shtrua edhe këtu, për kooperimin dhe bashkërenditjen e veprimtarisë ekonomike në mes dy ose më shumë ndërmarrjeve, është një çështje me rëndësi të madhe. Disa këtë e kuptojnë shumë thjeshtë, në frymën dikasteriale ose në kuadrin akoma më të ngushtë të një ndërmarrjeje. Nuk e kam fjalën vetëm për sa i përket kooperimit, megjithëse edhe në kooperim konstatojmë se zotimet dhe kontratat s'mbahen, përkundrazi, në mjaft raste shkelen. Janë të shumta ndërmarrjet që kanë detyrime të mëdha ndaj një tjetre, sado që mund të mos jetë e lidhur me dikasterin nga varet vetë. Për shembull, fabrikat e përpunimit të frutave e të perimeve lidhen ngushtë me ndërmarrjet bujqësore. Të gjitha këto së bashku lidhen ngushtë me ato të transportit, të cilat janë të lidhura, gjithashtu, me furnizimin me naftë, me uzinat që prodhojnë pjesë këmbimi etj. Të mos zgjatemi në këtë çështje, pse të gjithë e kuptojmë shumë mirë se koordinimi dhe realizimi i plotë e në kohë i detyrave dhe i zotimeve nga secili kanë të bëjnë me disiplinën e planit, për të cilin duhen bërë përpjekje nga të gjithë që të realizohet në kohë, në cilësi, në sasi, në asortiment etj.

Nuk them se këta tregues në përgjithësi nuk zbatohen, por ka edhe raste që puna nuk shkon mirë, që detyrat dhe zotimet nuk mbahen. Planifikohet, për shembull, eksportimi i një produkti ose i një tjetri dhe ata nuk realizohen as si sasi, as si cilësi etj. E keqja më e madhe është se disa sektorë, megjithëse nuk i realizojnë detyrat e tyre ndaj planit, vazhdojnë t'i bëj-

në kërkesa shtetit. Të bëhet e qartë për të gjithë se kur dikush kërkon, më parë duhet të japë. Kështu duhet të kuptohen realizimi i planit dhe zbatimi i detyrimeve, kështu duhet të kuptohet disiplina e rreptë e planit. Bujqësia kërkon traktorë. Po ku t'i gjejë shteti gjithë këta traktorë, kur nuk realizohet prodhimi i duhanit, i pambukut, i patates etj., etj? Nga do të dalin të ardhurat për t'i blerë?

Të kërkoresh pa dhënë, pa realizuar detyrimet e planit, do të thotë të mos e shikosh drejt çështjen. Sidomos ne që jemi në udhëheqje, jo vetëm duhet t'i kuptojmë mirë vetë këto gjëra, por t'ua bëjmë të qarta që t'i kuptojnë si duhet e gjithë masa, punëtorët dhe gjithë punonjësit e vendit tonë. Po të ecim me këtë frymë, atëherë do të kemi rezultate më të mëdha. Sigurisht, në këtë frymë po ecim, po duhet ta përmirësojmë më tej situatën, se kemi akoma shumë për të bërë.

Përpara, shokë, kemi një punë të madhe. Puna, ne, nuk na tremb, sepse kemi besim të plotë në vijën e Partisë, në forcën e popullit, në forcën e klasës punëtore e të fshatarësisë sonë kooperativiste, si dhe në eksperiencën që ka fituar Partia jonë, prandaj jemi të bindur se do t'ia dalim me sukses dhe planin e vitit 1969 do ta realizojmë patjetër.

Viti 1969 është viti jubilar i 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, që është një ngjarje me rëndësi të madhe. Por, që ta presim siç do Partia, për realizimin e plotë të të gjitha detyrave, duhet të ngremë peshë gjithë popullin, të madh e të vogël. Kjo nuk bëhet me fjalë të përgjithshme, po, në radhë të parë, me një punë të madhe politike dhe ideologjike me masat, duke u

shpjeguar atyre luftën heroike që kanë bërë gjatë këtyre 25 vjetëve nën udhëheqjen e drejtë të Partisë, vështirësitë që janë kapërcyer, sukseset historike që janë arritur, perspektivën e ndritur që kemi përpara dhe unitetin e madh që kanë në mendim e në veprim Partia dhe populli. Në gjithë këtë propagandë duhet të lidhet mirë çështja e detyrave të planit, që është baza konkrete, me punën ideopolitike e edukative, studimi i Historisë së Partisë sonë dhe i gjithë dokumenteve të tjera të saj etj. Tani për tani kemi akoma mungesë tekstesh, pse akoma nuk e kanë në dorë librin e Historisë së Partisë të gjithë njerëzit tanë, megjithatë duhet të organizojmë më mirë studimin e saj, të mos kënaqemi vetëm me një lexim të thjeshtë, por çdo problemi të veçantë t'i bëhet një studim i thellë nga të gjithë, çdo punonjës dhe komunist të shikojë si e ka zgjidhur Partia jonë këtë ose atë problem në situata të vështira të caktuara, si kaloi pastaj Partia në një situatë apo në një etapë tjetër të re, gjersa erdhi në etapën që po jetojmë.

Duke vepruar në këtë mënyrë anëtari i Partisë ose punonjësi që nuk është i organizuar në Parti, do t'i zgjidhë ashtu si duhet problemet që i dalin në çdo moment të jetës dhe të luftës. Problemi që ka përpara komunisti për të zgjidhur mund të mos jetë i njëjlojtë me atë që trajtohet në Historinë e Partisë, por nëpërmjet studimit të saj ai do të dijë të orientohet në ngjarjet e zhvilluara në të kaluarën dhe në eksperiencën e fituar, do të shohë si ka vepruar Partia në një kohë të caktuar, ç'qëndrim ka mbajtur për këtë problem që ka ngjasim me atë që ai ka përpara.

Të bëhen, pra, përpjekje të gjithanshme që vit 1969, të jetë një vit i vrullshëm revolucionar nga të tëra pikëpamjet.

Duke mbyllur këtë mbledhje, dëshiroj të uroj me këtë rast shokët e Plenumit, të ftuarit, gjithë anëtarët e Partisë sonë të lavdishme dhe popullin tonë, gëzuar Vitin e Ri, me shëndet e me suksese sa më të mëdha në realizimin e detyrave!

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë, nga proces-
verbali i mbledhjes së Plenu-
mit të 7-të të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PROPAGANDA JONË, PJESE PËRBËRESE E POLITIKËS SË PARTISË

Shënime

30 dhjetor 1968

Propaganda jonë duhet të konsistojë në zbatimin sistematik të mendimit marksist-leninist për të gjitha çështjet dhe problemet që asaj i duhet të sqarojë.

Ajo nuk mund të jetë diçka sporadike, e përciptë, e paorganizuar, por duhet të mbështetet në parimet bazë dhe të ketë të përcaktuara drejtimet që mund të jenë të vazhdueshme për një kohë relativisht të gjatë, por edhe të ndryshueshme herë pas here. Pra, propaganda e Partisë sonë është, si me thënë, zhvillimi i një lufte, e cila ka strategjinë dhe taktikën e saj.

Qëllimi i vërtetë i propagandës është t'ia bëjë të qarta problemet popullit. Por kjo nuk është e tëra dhe e mjaftueshme. Propaganda jonë, duke e bërë të qartë një çështje, duhet të ngrejë ndërgjegjen e masave, në atë nivel, që këto ta bëjnë të tyren problemin që shtrohet në një kohë të caktuar. Pra masat të bëhen të ndërgjegjshme për problemin që trajton propaganda jonë. Por që propaganda ta arrijë qëllimin plotësisht, duhet të futë në lëvizje e në veprim masat e sqaruara

dhe të ndërgjegjshme për arritjen e rezultateve të dëshiruara.

Propaganda jonë, e bazuar në mendimin marksist-leninist, e zhvilluar si një luftë e veçantë, që ka strategjinë dhe taktikën e saj, duke qenë pjesë përbërëse e zhvillimit të luftës që bën proletariati kundër borgjezisë dhe kapitalit për triumfin e revolucionit proletar dhe për vendosjen e diktaturës së proletariatit, për ndërtimin e shoqërisë socialiste dhe komuniste, ndjek dy qëllime: së pari, ajo nxit mendimin marksist-leninist revolucionar, informon, edukon, nxit pjesëmarrjen në lëvizjet revolucionare. Së dyti, ajo demaskon, djeg dhe shkatërron mendimin borgjez e revizionist dhe organizimin e tij, e shpartallon atë politikisht dhe ideologjikisht, duke qëndruar përkrah luftës revolucionare të masave të udhëhequra nga partia komuniste, që shkatërrojnë nga rrënjët pushtetin e borgjezisë dhe e zëvendësojnë atë me pushtetin revolucionar të diktaturës së proletariatit.

Propaganda e Partisë sonë pra, ndjek, zhvillon dhe mbështet, përveç të tjerave, luftën e klasave që bën Partia. Ajo edukon dhe kalit klasën punëtore dhe masat e gjera të popullit dhe lufton armikun e klasës e të socializmit.

Qëllimi i propagandës sonë marksiste-leniniste është i lartë dhe i madh. Duke ditur se njeriu socialist nuk lind në mënyrë spontane me të ndërruar kushte ekonomike, Partisë i vihet si detyrë ta formojë njeriun dhe ta edukojë me pikëpamje të reja revolucionare, me botëkuptimin e ri materialist, ta bëjë të aftë të kuptojë ligjet objektive të zhvillimit të shoqërisë. Ajo

punon që njeriu ynë t'i bëjë të tijat këto ligje duke u pajisur me mendimin marksist-leninist dhe me virtytet revolucionare, të veprojë, të luftojë me sukses ideologjinë idealiste-borgjeze, mbeturinat mikroborgjeze në veten e tij dhe në të tjerët, të demaskojë dhe të luftojë pikëpamjet metafizike për filozofinë dhe për teorinë e së vërtetës materialiste.

Ndryshimi rrënjësor që u vërtetua në vendin tonë, me ndryshimet e marrëdhënieve në prodhim, nëpërmjet luftës së armatosur dhe revolucionit që udhëhoqi Partia jonë marksiste-leniniste, kërkon edukim ideologjik të vazhdueshëm të njeriut. Këto ndryshime pozitive në mendimin, në psikologjinë e njerëzve etj., janë rezultat i vetë lëvizjes, i aksionit, i pjesëmarrjes së gjallë në veprim, por edhe i propagandës së organizuar mirë të Partisë.

Është e kuptueshme se përgatitja e njeriut të ri të socializmit është shprehje e unitetit të mendimit marksist me praktikën revolucionare. Propaganda e Partisë nuk mund t'i marrë këto dy çështje të shkëputura nga njëra-tjetra, pse atëherë nuk ia arrin qëllimit të caktuar për edukimin dhe për vetëbindjen e masave të gjera punonjëse me objektivat dhe me realizimin e direktivave të Partisë dhe të diktaturës së proletariatit.

Nuk duhet të harrojmë çështjen se një nga objektivat e propagandës së Partisë është edhe ajo e informimit të masave. Ky është problem shumë i rëndësishëm, sepse nëpërmjet informacionit propaganda mban në korent për çdo problem gjithë komunistët dhe masat, shkëmben eksperiencën e gjithsecilit e të të gjithëve, provon mendimin nëpërmjet realizimeve pra-

ktike, bën kritikën dhe kryen nëpërmjet saj, gjithashtu, edukimin, duke nxitur mendimin krijues.

Informacioni, pra, i praktikuar në çdo organizatë-bazë partie, është shumë i domosdoshëm dhe duhet të përfshijë të gjitha aktivitetet politike, ideologjike, ekonomike, shoqërore, arsimore, kulturore etj. të terrenit ku lufton organizata, pa folur këtu për informacionin më të gjerë të të gjithë aktivitetit të vendit dhe jashtë vendit. Kështu kuptohen gjerësia dhe roli i madh dhe i shumanshëm i agjitacionit dhe i propagandës së Partisë.

Propaganda jonë duhet të jetë kurdoherë konkrete, reale dhe e kuptueshme për masat, të jetë e prekshme dhe me fakte të interpretuara drejt, të bazuara në ideologjinë marksiste-leniniste. Pra ajo nuk duhet të jetë vetëm dhe thjesht teorike dhe e përgjithshme. Parullat e përdorura prej saj nuk duhet të formulohen në mënyrë spontane, siç bëhet mjaft herë, sepse kështu nuk mund të kenë forcë bindëse dhe të vazhdueshme. Parullat e propagandës sonë duhet të pasqyrojnë në mënyrë përmbledhëse një realitet, një platformë politike ose ekonomike që jeta jonë shtron për ta zhvilluar në praktikë. Por, kuptohet, se parulla i shërben mobilizimit dhe nuk e zëvendëson platformën dhe as shpjegimin e shumanshëm të saj. Kuptohet, gjithashtu, se një parullë e lëshuar për një çështje mund të bëhet e pavlefshme me krijimin e një gjendjeje të re. Çdo situatë, çdo problem, kërkon parullën e vet.

Propaganda e Partisë sonë, ka një përmbajtje të gjerë dhe të plotë ideologjike, ajo mbështetet në baza shkencore. Duke qenë e tillë, ajo shfrytëzon dhe du-

het të shfrytëzojë të gjithë teknikën e mundshme moderne, se ajo nuk është e lidhur vetëm me edukimin dhe me mobilizimin e një individi, por ka karakter masiv. Propaganda jonë ka si objektiv formimin e opinionit të masave të gjera punonjëse, ajo ka për mision që, duke i edukuar dhe duke i kalitur masat, t'i futë këto në lëvizje revolucionare për të bërë transformime të mëdha shoqërore. Dhe, derisa transformimet materiale shoqërore janë të vazhdueshme edhe propaganda vazhdon, ajo nuk mund të ndërpritet kurrë, por përmirësohet, perfeksionohet dhe ndjek vazhdimisht politikën e Partisë, pra është pjesë përbërëse e saj.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 39-TË V-IX

1968

- DISFATA E REVIZIONISTËVE SOVJETIKË NË BRATISLAVË — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (10 gusht 1968) 1-9
- AGRESIONI IMPERIALIST I REVIZIONISTËVE SOVJETIKË KUNDËR POPULLIT ÇEKOSLLOVAK — NJË KRIM I SHËMTUAR NDAJ LIRISË SË POPUJVE DHE SOCIALIZMIT — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (24 gusht 1968) 10-18
- MBI GJENDJEN AKTUALE NDËRKOMBËTARE — Nga raporti i mbajtur në Plenumin e 5-të të KQ të PPSH (5 shtator 1968) 19-44
- PO U SHTREMBËRUA POLITIKA MARKSISTE-LENINISTE MORËN FUND FITORET PËR ÇDO VEND A POPULL, I MADH A I VOGËL QOFTË — Nga biseda me kryetarin e Misionit të Përherëshëm të Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut në Shqipëri (16 shtator 1968) 45-61
- ME DENONCIMIN E TRAKTATIT TË VARSHAVES NE KRYEM NJË DETYRË TË LARTË KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE — Kryeartikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (17 shtator 1968) 62-67
- NË NDËRTIMIN E RRUGËVE TË KEMI PARASYSH LEVERDINË EKONOMIKE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (19 shtator 1968) 68-74

TË BËJNË GJITHÇKA KËRKON KOHA PËR ZHVI-LLIMIN SOCIALIST TË FSHATIT – Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (19 shtator 1968)	75–85
NË USHTRI MBI TË GJITHA ËSHTË KONTROLLI I PARTISË – Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (19 shtator 1968)	86–92
TË PRODHOJMË NË VEND E ME KOSTO TË ULËT SA MË SHUMË MALLRA TË PËRDORIMIT TË GJERË – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (20 shtator 1968)	93–98
TË CAKTOHEN MIRË E TË RESPEKTOHEN KOMPETENCAT – Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor (23 shtator 1968)	99–104
REVOLUCIONARËT LUFTOJNË NË DY FRONTE: KUNDËR IMPERIALIZMIT DHE KUNDËR REVIZIONIZMIT – Nga fjala në pritjen e dhënë nga ambasada e RP të Kinës (30 shtator 1968)	105–121
DËSHTIMI SKANDALIZI I KONFERENCËS SË PËRGJITHSHME REVIZIONISTE – Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (8 tetor 1968)	122–133
RRUGËT NË TRUPIN E ATDHEUT JANË SI ARTERIET E GJAKUT NË TRUPIN E NJERIUT – Fjala në drekën e shtruar me rastin e inaugurimit të Hekurudhës Rrogzhinë-Fier (12 tetor 1968)	134–140
PARTIA KRENOHET ME KLASËN TONË PUNËTORE – Nga biseda me një grup punëtorësh të Tiranës (16 tetor 1968)	141–143
USHTRIA JONË ËSHTË ARMË E PAMPOSHTUR E PARTISË – Nga biseda me një grup ushtarakësh (16 tetor 1968)	144–147

KUADROT TANË ZBATOJNË ME BESNIKËRI DHE ME GUXIM VIJËN E PARTISË – Nga biseda me një grup punonjësish të dikastereve qendrore (16 tetor 1968)	148–150
GRUAJA SHQIPTARE – FORCË E MADHE E PARTISË DHE E POPULLIT – Nga biseda me një grup grash të rrethit të Tiranës (16 tetor 1968)	151–155
KOLEKTIVIZIMI I BUJQËSISË – FITORE E MADHE HISTORIKE – Nga biseda me një grup kooperativistësh të rrethit të Tiranës (16 tetor 1968)	156–158
PARTIA DHE POPULLI KANË UNITET TË PËRTHYESHËM – Nga biseda me një grup shokësh përfaqësues të ardhur nga të gjitha rrethet e vendit (16 tetor 1968)	159–163
ASGJË TË MOS KURSEJMË PËR ÇËSHTJEN E PARTISË – Nga biseda me punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, të Komitetit të Partisë të Tiranës dhe të Shkollës së Lartë të Partisë «V. I. Lenin» (16 tetor 1968)	164–165
ARSIMTARËT JANË LUFTËTARË TË VIJËS SË PARTISË – Nga biseda me një grup punonjësish të arsimit (16 tetor 1968)	166–170
LETËRSIA DHE ARTI YNË ECIN GJITHNJË PËRPARA SE UDHËHIQEN NGA MËSIMET E PARTISË – Nga biseda me një grup punonjësish të artit dhe të kulturës (16 tetor 1968)	171–175
TË LUFTOJME VAZHDIMISHT QË VENDI YNË TË PËRPAROJË NË TË GJITHA DREJTIMET – Nga biseda me kadro të organizatave të masave (16 tetor 1968)	176–181

BREZI YNË I RI EDUKOHET E PUNON NË MË- NYRË REVOLUCIONARE — Nga biseda me një grup të rinjsh, pionierësh e fatosash të Tiranës (16 tetor 1968)	182—188
SUKSESET E PARTISË JANË VEPËR E GJITHË KOMUNISTËVE SHQIPTARË — Nga fjala në dar- kën e shtruar me rastin e 60-vjetorit të datëlindjes (16 tetor 1968)	189—202
GRUSHTI I KOMUNISTËVE MARKSISTË-LENINIS- TË DUHET TË BJERË FUQISHËM EDHE MBI AVENTURIZMIN E MAJTË — PJELLË E REVIZIO- NIZMIT MODERN — Nga biseda me dy udhëheqës të PK (marksiste-leninistë) të Ekuadorit (21 tetor 1968)	203—224
PËR NJË METODË DHE STIL PUNE REVOLUCIO- NAR — Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë ku bën pjesë (21 tetor 1968)	225—232
AKT QË LEGALIZON KTHIMIN E ÇEKOSLLOVA- KISË NË NJË KOLONI TË REVIZIONISTËVE SO- VJETIKË — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (23 tetor 1968)	233—241
TA MBAJMË VAZHDIMISHT TË GJALLË FRYMËN REVOLUCIONARE TË AKSIONEVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (25 te- tor 1968)	242—255
VËREJTJET NGA BAZA NA NDIHMOJNË PËR TË PËRMIRËSUAR METODËN TONË TË PUNËS — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (25 tetor 1968)	256—260
NË ÇDO QËNDRIM NDAJ KUADRIT TË VEPROJ- MË ME DREJTËSI PARTIE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (25 tetor 1968)	261—265

- EDUKIMI I BREZIT TË RI — PROBLEM JETIK
PËR SHOQËRINË TONË — Diskutim në mbledhjen
e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 tetor 1968) 266—277
- TA ÇOJME EDHE MË PËRPARA REVOLUCIONIN
TEKNIKO-SHKENCOR — Diskutim në mbledhjen e
Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 tetor 1968) 278—282
- QËNDRIMET E GABUARA TË UDHËHEQËSVE KI-
NEZË NUK JANË TË RASTIT — Diskutim në mble-
dhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 tetor 1968) 283—297
- PROCESI I JETËS SONË E BASHKË ME TË EDHE
SHKOLLA, ECIN NË RRUGËN E PAPERË TË
ZHVILLIMIT — Nga biseda me shokun Ramiz Alia
(30 tetor 1968) 298—309
- HISTORIA E PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË
— VEPËR E MADHE NË DUART E KOMUNIS-
TËVE DHE TË MBARË POPULLIT — Bisedë me një
grup punëtorësh të shtypshkronjës «Mihal Duri» dhe
me disa bashkëpunëtorë të Institutit të Studimeve
Marksiste-Leniniste (4 nëntor 1968) 310—332
- REPUBLIKA SOCIALISTE E ÇEKOSLLOVAKISË E
MBËRTHYER NË DARËN E PUSHTUESVE REVI-
ZIONISTË SOVJETIKË — Artikull i botuar në gaze-
tën «Zëri i popullit» (19 nëntor 1968) 333—352
- TË JENI KURDOHERË NJERËZ TË PARAROJËS
— Fjala në drekën e shtruar në kooperativën bujqë-
sore të Shijakut me rastin e Konferencës së dytë
kombëtare për zhvillimin e gjedhit (6 dhjetor 1968) 353—355
- PËR MBARËVAJTJEN E PUNËS DUHEN NJOHUR
GJENDJA DHE NJERËZIT — Nga diskutimi në
mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (9 dhje-
tor 1968) 356—379

ISMET BRUÇAJ RRON E DO TË RROJË NË ZEM- RËN E POPULLIT, TË RINISË DHE TË KOMU- NISTËVE – Bisedë me të afërm dhe shokë të Heroit të Punës Socialiste, mësuesit Ismet Bruçaj (17 dhje- tor 1968)	380–393
TË ZBATOJMË ME KËMBËNGULJE E NË MË- NYRË KRIJUESE DETYRAT PËR REVOLUCIO- NARIZIMIN E PARTISË E TË JETËS SË VENDIT – Fjala në konferencën e 17-të të Partisë për Tira- nën (21 dhjetor 1968)	394–482
BURIMI I PUSHTETIT – Shënime (23 dhjetor 1968)	483–486
REALIZIMI I DETYRAVE TË PLANIT RRIT ENTU- ZIAZMIN DHE MOBILIZIMIN E MASAVE – Fjala e mbylljes në Plenumin e 7-të të KQ të PPSH (27 dhje- tor 1968)	487–496
PROPAGANDA JONË, PJESE PËRBËRËSE E POLI- TIKËS SË PARTISË – Shënime (30 dhjetor 1968)	497–501

Shtypur: Kombinati Poligrafik

Shtypshkronja «Mihal Duri» – Tiranë, 1983